

# ENVER HOXHA

VEPRA

62




**PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

**ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË  
SHQIPËRISË**



ENVER HOXHA



**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH**

# **ENVER HOXHA**

**V E L L I M I**

**62**

**KORRIK 1977 — NËNTOR 1977**

**SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1988**



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 62-TË

Shkrimet e këtij vëllimi, një pjesë e të cilave botohet për herë të parë, i takojnë periudhës korrik-nëntor 1977. Në to lexuesit gjejnë analiza dhe sinteza me rëndësi për kohën, por edhe për perspektivën.

Ndër problemet kryesore që trajtohet në shumanshmëri e thellësi në vëllim është edhe përsosja e mëtejshme e metodologjisë dhe e të gjithë sistemit të planifikimit. Shoku Enver Hoxha thekson detyrat e organeve dhe të organizatave të Partisë për të udhëhequr mirë punën për hartimin e planeve. Veçanërisht ndalet në domosdoshmërinë e përsosjes së planifikimit në ndërmarrjet, në kooperativat bujqësore dhe në institucionet. Ai tërheq vëmendjen që në themel të punës për hartimin e planeve të vihet planifikimi në natyrë i sasisë së asortimenteve të prodhimit sipas cilësisë dhe sipas nevojave të masave punonjëse, të riprodhimit të zgjeruar dhe të mbrojtjes së vendit.

Në vëllim nënvizohet, gjithashtu, ideja se hartimi dhe zbatimi i planeve duhen kuptuar si një unitet i pandarë, me përmbajtje të thellë politike e ideologjike, që përshkohet nga lufta klasore. Shpërpjesëtimet dhe shfaqjet e tjera negative qoftë në planifikim, qoftë në zbatimin e planeve, janë njëlloj të rrezikshme. Kjo shtron nevojën e intensifikimit të luftës së

Partisë kundër shfaqjeve të huaja burokratike e liberale, si njëanshmëria dhe globalizmi, prirjet për të vënë interesat e ngushtë dikasteriale apo lokale mbi interesat e përgjithshëm, fenomenet e spontaneitetit etj.

Për stadin ku kishte arritur ekonomia jonë merrte rëndësi të veçantë thellimi i mëtejshëm i revolucionit tekniko-shkencor. Në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH më 27 tetor 1977 shoku Enver Hoxha shpjegon hollësisht përmbajtjen e këtij revolucioni dhe përcaktón objektivat e tij në degë e sektorë të ndryshëm. Ai orienton të mbahen parasysht drejtime të tilla të rëndësishme, si transformimi i vazhdueshëm e në një shkallë më të lartë i mjeteve të prodhimit dhe i pasurive natyrore të vendit, mekanizimi dhe automatizimi, klmizimi, përqendrimi, specializimi e kooperimi, eksperimentimi shkencor etj. Veçanërisht në këtë problem kapital vlerësohet domosdoshmëria e zbatimit të parimit të mbështetjes në forcat e veta. Gjithashtu theksohet rëndësia e përvetësimit të shkencës dhe të teknikës, e lidhjes së teorisë me praktikën. Në këtë kuadër jepen mjaft porosi që komunistët dhe masat të zgjerojnë më shumë njohuritë politike e shkencore, duke i lidhur ato me teorinë e klasikëve të proletariatit dhe me përvojën konkrete të Partisë sonë. Kujdes i vihet, sidomos, edukimit të rinisë. Në përshëndetjen drejtuar Kongresit të 7-të të BRPSH udhëheqësi ynë i madh e i paharruar i ka dhënë brezit të ri të Shqipërisë socialiste këshillën që ky të brumoset me ideologjinë revolucionare të klasës punëtore, të spastrojë deri në fund «skoriet» dhe të kalitet për të qenë luftëtar i vendosur i vijës së Partisë.

Edukimi ideopolitik i masave, siç vë në dukje autori, lypset të jetë në shkallën që e kërkojnë situatat ndërkombëtare. Duke ua bërë të qartë këtë detyrë komunistëve e punonjësve, shoku Enver Hoxha në mjaft materiale të vëllimit shpjegon zhvillimin e ngjarjeve aktuale në botë, qëllimet e forcave politike në lëvizje.

Krahas demaskimit të politikës ekspansioniste të imperializmit, ai ka goditur me forcë veprimtarinë e rrezikshme të revizionistëve modernë të çdo korrenti. Teju i kritikës në mjaft materiale drejtohet kundër kursit deviacionist të Kinës që po merrte përmasa të gjera, kundër qëndrimeve të udhëheqjes së saj që po gjuhëzohej në Pekin para imperializmit botëror, me SHBA në krye. Duke ndjekur zhvillimet në Kinë, aq sa ishin mundësitë, autori në një varg shënimesh, e veçanërisht në raportin e mbajtur në Plenumin e 3-të të KQ të PPSH, zbulon ku e kanë burimin shkarjet antimarksiste të Kinës. Nëpërmjet analizash të thella e të qarta ai nxjerr në pah rrënjët dhe synimet e këtij varianti të ri revizionist, si dhe falsitetin dhe mashtrimin e madh të teorisë së «tri botëve», të cilën udhëheqësit kinezë orvateshin ta kalonin si teori marksiste. Vëllimi përmban orientime të rëndësishme politike, ideologjike e organizative për zhvillimin e luftës kundër oportunizmit kinez në gjirin e lëvizjes komuniste. Në biseda me miq të Partisë e në materiale të tjera autori ka theksuar se lufta kundër imperializmit, revizionizmit në përgjithësi e atij kinez veçanërisht, kërkon forcimin e unitetit midis marksistë-leninistëve të vërtetë, vendosmëri e organizim të shëndoshë, përho-

*rimin e metodave dhe të taktikave të reja e të përshtatshme.*

*Duke ia bërë të qartë popullit se në kushtet e reja të krijuara lypseshin përpjekje të mëdha për kapërcimin e vështirësive, udhëheqësi i dashur e mësonte atë të vlerësonte drejt situatat, të nxirrte konkluzione e detyra dhe t'u bënte ballë vështirësive me zgjuarsi e mobilizim.*

*Këto mësimë, të pasqyruara në vëllimin e 62-të, janë udhërrëfyese edhe sot për mbarë komunistët dhe masat punonjëse të vendit, të cilat i janë përveshur punës për arritje cilësore në kuadrin e festimit të 80-vjetorit të lindjes së shokut Enver Hoxha.*

*Vëllimi është i pajisur me tregues.*

# DISA MENDIME RRETH MATERIALIT PËR MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR DIJE PËR MONUMENTIN E LIRISË

Shënime

27 korrik 1977

Lexova materialin që na ka dërguar komisioni i Kryeministrit në lidhje me konceptet për muzetë që do të përfshihen në Muzeun Historik Kombëtar dhe për Monumentin e Lirisë që do të ndërtojmë. Që në fillim m'u krijua përshtypja se nuk është bërë një punë serioze. Unë mund të gabohej, sepse vërejtjet e mia i kam nxjerrë vetëm në bazë të materialeve të përmbledhura për platformën e Muzeut Historik e të Monumentit të Lirisë, që m'u dhanë për lexim, por më duket se komisioni dhe shokët drejtues të Ministrisë së Arsimit e të Kulturës e të tjerët nuk janë thelluar as në brendinë që do të pasqyrohet në këto muze, as në konceptimin e Monumentit të Lirisë.

Në këtë material nuk dalin qartë konceptet politiko-ideologjike, kulturore dhe ushtarake të përmbajtjes së muzeve. Materiali ka shumë fraza bombastike, si «madhështore», «monumentale» e shumë të tjera të kësaj natyre. Unë mendoj se nuk është çështja të për-

dorim fjalë të mëdha, por ta paraqitim historinë e popullit tonë në formë të drejtë, të parë në prizmin e marksizëm-leninizmit. Kështu ajo del vetë madhështore dhe nuk është e nevojshme që të përdoren fjalë bombastike, si për brendinë e konceptet që do të shprehën në eksponatet e muzeve, ashtu dhe për ndërtimin arkitektonik të muzeut. Natyrisht, për të ndërtuar një muze, për të bërë planct e projektet e një ose të tri muzeve, duhet të dimë edhe se çfarë të futim brenda tyre. Pa ditur këtë, nuk mund të kemi koncepte të drejta për çka do të ndërtojmë. Por pikërisht ky koncept lidhur me brendinë e muzeve, më duket mua, nuk është studiuar thellësisht dhe aq sa duhet në prizmin e kërkesave të materializmit historik.

Për sa i përket konceptit për Monumentin e Lirisë mendoj se ai është trajtuar gabim, dhe për mua një koncept i tillë është i papranueshëm. Ç'kërkon figura ime në qendër të Monumentit të Lirisë? Lirinë e ka fituar populli shqiptar, me Partinë e tij Komuniste në krye (tash Partia e Punës e Shqipërisë), me Partinë e klasës punëtore dhe jo me një person të vetëm. Pra, liria e popullit shqiptar nuk mund dhe është absurde të personifikohet me mua. Është e vërtetë se unë kam qenë një luftëtar për lirinë e popullit shqiptar, kam qenë udhëheqës i Partisë dhe i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Po të përpiqesha ta mohoja këtë, do të ishte modesti e rreme. Por, duke u nisur nga ky rol, të arrihet të vihet figura ime në qendër të Monumentit të Lirisë, kjo nuk është e drejtë, është antimarksiste. Unë e kam shprehur mendimin tim se si e përfytyroj Mo-

numentin e Lirisë<sup>1</sup>. Sipas mendimit tim, personazhi kryesor i Monumentit të Lirisë duhet të jetë populli, atdheu, Shqipëria, dhe ne jemi ushtarët që, nën udhëheqjen e Partisë sonë, luftuam për lirinë dhe ne personifikohemi në masën e popullit dhe të partizanëve.

Pra, mendimi i dhënë në materialin e paraqitur për ndërtimin e Monumentit të Lirisë është një mendim i shtyrë më tepër nga një simpati jomarksiste, jo e shëndoshë. Këtë gjë nuk e pranoj dhe e dënoj.

Për sa u përket muzeve, mendoj të bëhen muze të zakonshme, natyrisht, jo ndërtesa përdhese, por jo ama të ushqojmë mendime ekstravagante për ndërtesa madhështore, gjigante. Me aq sa është e mundur, këtyre muzeve nga ana e jashtme arkitektonike t'u jepen disa karakteristika popullore, kombëtare të ndërtimeve tona.

Ne, në një mbledhje të Byrosë Politike, kur aprovuam planin rregullues të qendrës së Tiranës, kemi thënë që të bëhen tri korpuse për tri muze, të bashkuara, natyrisht, njëra me tjetrën, për t'i dhënë këtij ansambli një unitet të madh, dhe ky t'i përshtatet gjithë ambientit të sheshit. Komisioni i ngritur për këtë problem më duket se ka qëndruar në mendimin tonë, megjithëse mund të zhvillohej edhe më tej ky mendim.

Unë jam dakord që në tërësi muzeu të quhet Muzeu Historik Kombëtar.

I tërë Muzeu Historik duhet të paraqitë një vazhdimësi të historisë së popullit shqiptar, ashtu siç shpre-

---

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 57, f. 252.

het me të drejtë në platformën që paraqit komisioni. Natyrisht, kjo histori do të jetë e ndarë në etapa dhe çdo etapë duhet të ketë rëndësinë e vet, në madhësinë dhe në përmbajtjen e saj. Historia e Shqipërisë është një dhe kurdoherë në vazhdim, është zhvillimi dialektik materialist i historisë së popullit tonë, prandaj mendoj se është drejt që muzeu të konceptohet si një muze, Muzeu Historik, por jam i mendimit që ky të ndahet në dy pjesë përbërëse të mëdha: njëra pjesë do të përfshijë lashtësinë, mesjetën (me Skënderbeun në qendër) dhe Rilindjen deri në shpalljen e Pavarësisë në Vlorë më 1912, dhe pjesa tjetër — përgatitjen e revolucionit (gjendja në regjimin e Zogut, lëvizja punëtore e komuniste) dhe gjithë periudhën e Partisë, zhvillimin e revolucionit, me Luftën Nacionalçlirimtare e me ndërtimin e socializmit.

Për sa i përket ndarjes në dy apo në tri pjesë dhe emërtimeve të tyre mund të diskutohet nga historianët e shokët tanë. Do të quhet i tëri Muzeu Historik dhe pjesët e tij të jenë dy?

I. **Muzeu i paraluftës** (siç e ka quajtur komisioni, por që s'më duket emërtim i goditur) ose i pararevolucionit (që prapë është për t'u diskutuar si emërtim).

II. **Muzeu i revolucionit** (i cili do të përfshijë si periudhën e Luftës Nacionalçlirimtare, edhe atë të ndërtimit socialist dhe unë jam më shumë për këtë variant, se ndërtimi i socializmit është qëllimi dhe vazhdimi i revolucionit që filluam gjatë Luftës Nacionalçlirimtare) apo do të ketë edhe një pjesë më vete, të tretë, që do të emërtohej:

III. **Muzeu i ndërtimit të socializmit.** Mund të dis-



kutohej edhe varianti, për të cilin kam dëgjuar të fli-tet, që muzeu të ndahej në dy pjesë ose që këto të ishin si dy muze më vete: i pari të quhej Muzeu Historik dhe i dyti Muzeu i Revolucionit.

Por, sipas mendimit tim, për të parin nuk përcaktohet se ç'përmban dhe ky do të ishte një muze historik i cunuar, kurse i dyti, në fakt, është muze historik dhe muze për periudhën historike më të lavdishme të popullit tonë.

Për sa i përket mendimit që komisioni jep në relacionin e vet, për ta quajtur muzeun e dytë muze të Luftës Nacionalçlirimtare, mua më duket se ky emërtim është jo i plotë dhe jo i përshtatshëm, sepse kjo pjesë e muzeut nuk është vetëm e Luftës Nacionalçlirimtare, por është e revolucionit. Populli shqiptar bëri revolucionin, ai i përgatiti kushtet për revolucionin, dhe përgatitjen për revolucionin e filloi që para pushimit nga Italia. Këtu duhet vënë në dukje që gjendja shoqërore e popullit tonë ka qenë e mjeruar, populli vazhdimisht ka qenë i pakënaqur dhe kjo pakënaqësi shkonte duke u rritur derisa shpërtheu revolucionin. Kjo është një nga kushtet kryesore që u arrit fitorja e revolucionit, siç na mëson Lenini. Pakënaqësia e popullit u rrit, u zhvillua dialektikisht.

Edhe para regjimit të Zogut populli ishte i pakënaqur, ishte në mjerim dhe aspironte për çlirimin e tij politik, ideologjik, ekonomik nga feudalët dhe nga të huajt, nga të huajt që e kishin okupuar dhe nga ata që e shtypnin dhe e shfrytëzonin. Pas vendosjes së regjimit të Zogut, pakënaqësia e popullit u shtua, ai revoltuhej gjithmonë e më tepër kundër kësaj shoqërie

të kalbur, kundër regjimit shtypës. Kontradikta midis popullit dhe regjimit në fuqi po thellohej më shumë. Pra një nga kushtet e revolucionit po krijohej.

Regjimi feudal i Zogut, siç e dimë, ishte regjim shfrytëzues, shtypës, vrasës e tradhtar, një regjim i lëkundshëm, që nuk kishte baza në popull. Ai kishte krijuar një rreth të tij prej feudalësh, bejlerësh dhe lakenjsh të tjerë që mbaheshin në këmbë nga një ushtri dhe xhandarmëri e organizuar nga të huajt. Aq i lëkundshëm ishte regjimi i Zogut, sa që në traktatin me Italinë ishte vënë një klauzolë, që nuk është parë në asnjë traktat të botës, dhe kjo klauzolë konsistonte në atë që, në rast se regjimi i Zogut kërcënohej nga brenda nga ndonjë revolucion, atëherë Musolini do të ndërhynte me forca nga jashtë për ta shpëtuar këtë regjim.

Ajo që e acaroi akoma më shumë kontradiktën antagonistë mes regjimit të Zogut dhe masave të gjera të popullit, që kërkonin të ndryshonin shoqërinë, ishte momenti nacional: okupimi i Shqipërisë nga Italia. Përkërisht në këtë moment ndodhi ajo që Lenini e quan kthesë historike, dhe në këtë kthesë historike u themelua Partia Komuniste e Shqipërisë, e cila u bë faktori subjektiv udhëheqës i revolucionit dhe revolucionit shpërtheu. Ky revolucion filloi me rezistencë pasive, pastaj me rezistencë aktive, me demonstrata, me trakte, me punë politike të shumanshme, sidomos kundër okupacionit dhe kundër tradhtarëve që e mbështetnin këtë okupacion. Rezistenca vazhdoi me atentate, pastaj me veprime më të gjera gueriljesh në qytete, me krijimin e çetave, të batalioneve, të brigadave, të divizioneve, të korparmatave etj.

Por Lufta Nacionalçlirimtare kishte përqendrim kryesor marrjen e pushtetit, shkatërrimin që nga themelet të pushtetit të vjetër borgjez dhe ndërtimin në vend të tij të pushtetit të ri të këshillave nacionalçlirimtarë, domethënë të pushtetit demokratik popullor, që në esencë është shteti i diktaturës së proletariatit.

Lufta Nacionalçlirimtare është një nga pjesët kryesore të revolucionit, sepse revolucionin ynë nuk ishte një revolucion pa gjak dhe pa dhunë. Ai ishte një revolucion i gjatë me luftë. Lufta Nacionalçlirimtare është, pra, pjesa kryesore e revolucionit. Revolucionin ynë nuk mund të personifikohet vetëm me Luftën Nacionalçlirimtare. Jo, ai është vepër e popullit, vepër e Partisë në krye të klasës punëtore, në aleancë me fshatarësinë e varfër dhe të mesme, i udhëhequr nga politika e drejtë e Partisë.

Çështja politike, e cila duhet të figurojë, sepse është pjesë përbërëse nga më kryesoret të revolucionit, të asaj dëshire të madhe të popullit për të ndryshuar shoqërinë e vjetër në një shoqëri të re, ishte ideja e madhe e krijimit të pushtetit të ri. Me vendosjen e pushtetit do të konsolidoheshin çlirimi, sovraniteti i popullit, do të bëheshin reformat e mëdha dhe do të ndërtohej socializmi.

Pra, pasi u bënë të gjitha këto pas Çlirimit, vjen faza e ndërtimit të socializmit. Kjo është pjesë e madhe përbërëse e revolucionit tonë dhe në relacionin e komisionit flitet se do të ketë dhe duhet të ketë pjesë të veçanta që do të pasqyrojnë ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Kështu duhen kuptuar koncepti politiko-ideologjik dhe pjesa e muzeut të revolucionit,

që komisioni e quan «Muzeu i Luftës Nacionalçlirimtare». Jo, nuk mund të jetë i drejtë ky emërtim dhe nuk mund, siç thuhet në material, të krijohen dhoma të veçanta për Brigadën I, për Brigadën II e të tjera me radhë, sepse atëherë muzeu nuk do të ketë fund. (Për kryengritjen e armatosur dhe për formacionet e veprimet ushtarake ne mund të kemi dhe muze më vete, muzeun e Ushtrisë Popullore, siç kemi edhe lloje të tjera muzesh. Kjo është tjetër çështje.)

Gjithashtu, muzeu i quajtur i Luftës Nacionalçlirimtare nuk mund të ndërtohet në bazë të platformës e të përmbajtjes së tekstit të «Historisë së Luftës Nacionalçlirimtare», se si tekst kemi edhe «Historinë e Partisë së Punës të Shqipërisë», që, sipas mendimit tim, të dy do të jenë në bazë të platformës për përmbajtjen e muzcut të revolucionit (për periudhën e Luftës Nacionalçlirimtare). Pra, në mënyrë dialektike atje duhet të pasqyrohet në zhvillim i tërë revolucionit, në të gjitha fazat e tij, të cilat duhet të jenë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën dhe nga kjo zgjidhje të spikatin çështjet kryesore: çështja e shkatërrimit të shoqërisë së vjetër nga populli, çështja politike e ngrihtjes së ndërgjegjes popullore, çështja e momentit nacional, e luftës kundër okupatorit dhe tradhtarëve, çështja e krijimit të armës së revolucionit, Ushtrisë Nacionalçlirimtare, në të gjitha fazat e saj dhe kjo të shkojë si një zinxhir i madh i pashkëputur. Të gjitha këto, kuptohet, do të lidhen me vijën dhe me veprimtarinë udhëheqëse të Partisë, por duhet menduar mirë se si do të dalë dhe vetë historia e Partisë sonë me

mbledhjet e dokumentet e saj më të rëndësishme, që nga mbledhja e themelimit e disa momente të tjera.

Në këtë zinxhir të madh, natyrisht, duhet të dalin në pah momentet më të rëndësishme e më kryesore të historisë së popullit e të Partisë sonë.

Çështja tjetër me rëndësi politike është lufta për rrëzimin e pushtetit të vjetër shfrytëzues. problemi kryesor i të gjithë revolucionit, me ngjarjet e mëdha të krijimit të Frontit Nacionalçlirimtar, të zhvillimit të Konferencës së Pezës, të Labinotit, të Kongresit të Përmetit, të Mbledhjes së Beratit e të evenimenteve të tjera, të cilat dominojnë në revolucion.

Organizimi i pushtetit, i këshillave nacionalçlirimtarë, duhet të zërë një vend të rëndësishëm në muze. Prandaj mua më duket se për këtë pjesë komisioni i krijuar duhet të mendohet e të reflektojë thellë dhe jo në mënyrë të sipërfaqshme e shabllone, duke adoptuar disa makete të shkruara, të cilat janë të drejta për një çështje, por që për muzeun në fjalë duhet të kenë një zhvillim të ndryshëm, harmonik, të koordinuar, të balancuar dhe të rreshtuar me vazhdimësi, ashtu siç lindi, u zhvillua dhe arriti fitoret revolucionari i madh që udhëhoqi Partia jonë.

Në këtë mënyrë, më duket mua, duhet shikuar edhe pjesa që i takon lashtësisë. Të mos bejmë gjëra që propagandohen si madhështore, por që në realitet për to mungojnë dokumentacionet. Mendoj se dokumentacionet dhe konkluzionet që kemi për të kaluarën e lashtë të popullit tonë duhet t'i përdorim me mjeshteri, me saktësi dhe pa tejkualuar masat e vërteta të saj.

Për sa i përket kohës së Skënderbeut mua më duket se kjo është një periudhë e shkëlqyer, e cila duhet të zërë një vend të gjerë në historinë mesjetare të vendit tonë. Pastaj duhet të zënë vend, po ashtu, kryengritjet e popullit tonë kundër sundimit osman. Këto kryengritje kanë pasur karakter të ndryshëm: çlirues, ekonomik, politik etj., sinteza e drejtë e të cilave nuk është kaq lehtë të bëhet dhe të pasqyrohet në këtë muze si një rrjedhim i qëndresës shekullore të popullit tonë në faza të ndryshme të zhvillimit të tij. Duke ndjekur këtë fill, kryengritjet kundër Perandorisë Osmane vazhdojnë; natyrisht, një vend të madh zë lufta e rilindësve.

Lufta e rilindësve nuk është luftë vetëm e disa poetëve, e filozofëve ose e shkrimtarëve të mëdhenj. Jo. Këtu duhet të pasqyrohet lufta e popullit shqiptar. Kurse këta njerëz janë të mëdhenj, për arsye se kuptonin, zhvillonin dhe pasqyronin e shprehnin aspiratat, qëllimet dhe veprimet luftarake të popullit. Cilat ishin këto qëllime të popullit? Çlirimi nga zgjedha osmane, çlirimi ekonomik, krijimi i shtetit shqiptar të pavarur, krijimi dhe uniteti i kombit tonë, zhvillimi i kulturës kombëtare, i alfabetit etj., etj. Këto duhet të vihen në dukje. Edhe këtu dalim tek teza leniniste se këto kryengritje nuk kishin karakterin e një revolucioni, por kishin shkaqet që e bënin popullin të ngrihej në kryengritje dhe të luftonte. Ende nuk ishte krijuar ai unitet dhe ai moment kyç, siç thotë Lenini, që populli të bënte revolucionin dhe të ndryshonte shoqërinë e vjetër mesjetare. Kjo u arrit deri në njëfarë shkalle më 1912, kur u kurorëzua me sukses qëllimi dhe dë-

shira e popullit shqiptar, pavarësia e atdheut. Për të arritur këtu populli ynë u mbështet në forcat e veta, por edhe në situatën ndërkombëtare. Për fat të keq, kjo fitore mund të themi se mbeti në mes të rrugës, për arsye se nuk ekzistonin kushtet e tjera, nuk ekzistonte një borgjezi e formuar që ta udhëhiqte revolucionin demokratiko-borgjez, nuk ekzistonte faktori subjektiv, por ekzistonin elementë heterogjenë të klasave të ndryshme, që nga elementë të klasës feudale deri tek elementët e borgjezisë së shtresave të mesme të popullatës. Shtresat e ulëta të popullit nuk u tërhoqën të merrnin pjesë aktivisht në përpjekjet për transformime të mëtejshme.

Mendoj se rëndësi ka që boshti i muzeve të jetë i drejtë. Për sa u përket madhësive, natyrisht, kjo do të lidhet si me përmbajtjen, edhe me proporcionet e sheshit tonë. Në këtë muze ne nuk do të ekspozojmë të gjitha eksponatet që disponojmë, pra të mos e ngarkojmë atë me eksponate. Me kohë do të gjejmë e do të krijojmë eksponate të tjera dhe do të mund t'i zëvendësojmë ato që kishim me më të mira. Të tjerat, që do të konsiderohen më pak të rëndësishme, duhet ose t'i mbajmë në arkiva e t'i ruajmë (por që në mjaft raste nuk është e rekomandueshme të mbahen të vdekura), ose t'ua shpërndajmë muzeve të tjera të vendit. Domethënë, derisa kemi boshtin kryesor të muzeve, të Muzeut Historik Kombëtar, të vendosur drejt, atëherë çdo gjë do të zgjidhet dhe do të ilustruhet si duhet me eksponate të përshtatshme.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, unë formova përshtypjen se komisioni nuk ka punuar aq seriozisht

për këtë çështje, janë aktivizuar disa njerëz, kryesisht disa historianë e arkitektë, por kjo nuk është e mjaftueshme. Në këtë punë duhet të marrin pjesë, përveç historianëve e arkitektëve, një rreth më i gjerë shkencëtarësh e njerëz të kulturës, si dhe kuadro të Partisë dhe të pushtetit, që mund të japin mendime të vlefshme për çështjet në diskutim. Gjithashtu dua të tërheq vëmendjen e shokëve të ngarkuar me këtë punë se kjo çështje po zvarritet shumë dhe dua të theksoj se udhëheqja e Partisë nuk do të lejojë që, si pasojë e zvarritjes në diskutime, të bëhen projektme e ndërtime të nxituara, që nuk do të ishin në lartësinë e historisë së popullit shqiptar e të luftës së Partisë sonë. Edhe si ndërtim arkitektonik muzeu të jetë i denjë për atë që duam të përfaqësojë, për vendin ku do të ndërtohet e t'i qëndrojë kohës.

Unë hodha vetëm disa mendime që mund t'i kenë parasysh anëtarët e komisionit. Këto mendime mund të mos jenë të tëra plotësisht të drejta, por unë mendoj se, pa i parë thellë me syrin marksist-leninist proceset historike dhe pa e lidhur brendinë e muzeve me një fill të kuq, që është dialektika materialiste historike, nuk do të mund të kemi një muze ashtu siç e kërkon Partia jonë, siç e meriton revolucioni i madh që bëri populli shqiptar me klasën punëtore në krye dhe me pararojën e saj, Partinë Komuniste, tash Partia e Punës e Shqipërisë.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



# QËLLIMI I VIZITËS SË TITOS NË KINË DHE STRATEGJIA KINEZE

Shënime

28 korrik 1977

Gazeta jugosllave «Borba» ka filluar ta mburrë Kinën, të përgatitë terrenin për vajtjen atje të Titos dhe të inkurajojë futjen e Kinës në lllumin revizionist. Ajo flet për «politikën e drejtë botërore të Kinës», një politikë që u përshtatet madhësisë dhe ideologjisë së saj, që i përshtatet influencës së saj të madhe që ka në popull. Kjo gazetë shkruan se nuk mund të lejohet të kritikohet një politikë e tillë e drejtë nga ekstremistë, dhe ekstremistët në këtë rast «jemi» ne. Sigurisht, për revizionistët e Beogradit marksistë-leninistët nuk janë revolucionarë, por janë ekstremistë. Për titistët rruga e drejtë është të bëhesh shërbëtor i imperialistëve amerikanë, i kapitalit botëror dhe t'u shërbesh këtyre me besnikëri, ashtu siç bëjnë vetë Titoja dhe shteti titist jugosllav.

Aktualisht Titoja shkon në Pekin me qëllime të caktuara, me detyra të ngarkuara nga imperializmi amerikan dhe nga socialimperializmi sovjetik. Më parë se të mbërrijë në Pekin Titoja, atje do të shkojë Vensi,

ministri i Jashtëm amerikan, i cili do të diskutojë shumë probleme ekonomike dhe politike me Kinën, sidomos çështjen e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve. Dhe Kina do t'i pranojë lidhjet diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, parësisht nga taktimi që i bën çështjes së Tajvanit.

Çështjes së Tajvanit, me siguri, kinezët do t'i gjejnë njëfarë zgjidhjeje, njëfarë *modus vivendi*, e cila do të pranohet edhe nga amerikanët. Kinezët kanë bërë vazhdimisht lëshime për çështjen e Tajvanit, saqë kjo punë është bërë një çështje skandali, që tregon paqëndrueshmërinë politike të Kinës, kalimin e saj nga njëri ekstrem në ekstremin tjetër. Interesat e Kinës në drejtim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e duan që çështja e Tajvanit të zgjidhet ashtu siç do Karteri, për arsye se Kina ka interesa të mëdhenj të afrohet me Shtetet e Bashkuara, për të marrë prej tyre kredi dhe ndihma të mëdha për të mëkëmbur dhe për të modernizuar ekonominë dhe ushtrinë e saj.

Kjo është primordiale për politikën aktuale kineze, kjo është politika pragmatiste, antimarksiste e Mao Ce Dunit, e Çu En Lai, e Ten Hsiao Pin-it dhe e Hua Kuo Fen-it. Të gjithë këta bonzë kinezë antimarksistë, luftojnë për t'ia arritur këtij qëllimi. Strategjia e tyre qëndron në atë që për një kohë prej dy-tre dhjetëvjeçarësh të mund të përfitojnë sa më shumë nga ndihmat dhe teknologjia amerikane dhe e vendeve të tjera imperialiste, natyrisht duke u dhënë këtyre koncesione të mëdha. Kuptohet, këtu fjala është për koncesione ekonomike, t'u shesë atyre lëndë të parë të çdo natyre që Kina ka shumë, që nga vajguri e deri tek të gjitha

mineralet e ndryshme strategjike e për të cilat ata kanë nevojë. Me krijimin e bankave, me krijimin e koncerneve dhe të shoqërive të përbashkëta kino-amerikane, kino-japoneze, kino-franceze, kino-angleze, kino-gjermanoperëndimore etj., kinezët mendojnë që brenda një kohe relativisht të shkurtër të bëhen një superfuqi socialimperialiste. Kjo do të thotë të bëhen një shtet i atillë kapitalist që të ketë votën e vet në skakierën ndërkombëtare, domethënë që bota të mos sundohet nga dy superfuqi, por nga tri. Kina mendon se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do ta lejojnë të zhvillohet e të kalojë si në gjalpë një situatë e tillë domethënë që Kina të zbatojë strategjinë e vet me taktikat dredharake kineze dhe imperializmi amerikan të tregohet aq budalla saqë të bëjë lodrën e saj. Por imperializmi amerikan është dinak, është një imperializëm i fuqishëm dhe me eksperiencë.

Kina mendon të acarojë marrëdhëniet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me Bashkimin Sovjetik dhe t'i futë këta në luftë për të nxjerrë gështenjat nga zjarrri. Ky është vetëm një iluzion, sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë kaluar dy luftëra të mëdha botërore dhe në të dyja këto luftëra aleatët e tyre i kanë ndihmuar, siç i thonë fjalës, në aksham, janë përpjekur të përfitojnë deri në fund nga sakrificat e tyre dhe pastaj kanë dërguar disa divizione për të korrur fitoren për vete dhe për aleatët, por për aleatët e rraskapitur. Këtë taktikë Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndjekin edhe aktualisht në skakierën ndërkombëtare. Ato do ta ndihmojnë Kinën derisa kjo të nxitet kundër Bashkimit Sovjetik, t'i acarojë kontra-

diktat dhe mundësisht të futet në luftë me të. Ky është qëllimi i strategjisë amerikane. Nga ana e tij Bashkimi Sovjetik përpiqet të mos i acarojë marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, acarimi që ka me Kinën e bën Bashkimin Sovjetik që të lëshojë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse nuk dëshiron që të luftojë në të dy krahët, edhe kundër Kinës, edhe kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Bashkimi Sovjetik ka strategjinë globale për dominimin e botës. Natyrisht, edhe ai di, punon dhe dëshiron e përpiqet që armiqtë e kundërshtarët e vet, të parin Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të dytin atë që po ngrihet e po rritet, Kinën, t'i luftojë njërin pas tjetrit dhe jo të dy përnjëherë.

Në këtë skakierë strategjia kincze është në kundërshtim me strategjinë amerikane, është, gjithashtu, në kundërshtim edhe me strategjinë e Bashkimit Sovjetik, pse që të tria këto fuqi të mëdha, dy superfuqitë dhe e treta që aspirojnë të bëhet e tillë, kanë kontradiktat të thella me njëra-tjetrën, të cilat do të thellohen dhe thellimi i tyre i mëtejshëm do të çojë më shpejt në një luftë botërore.

Lufta botërore, sipas mendimit tim, ka mundësi të shpërthejë edhe në mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, jo vetëm në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Përse? Sepse në rast se Bashkimi Sovjetik do t'i acarojë marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në atë mënyrë dhe në ato forma që kërkon Kina, është e qartë se këto dy superfuqi do të ndeshen. Kush do të fitojë? Kina llogarit se do të fitojë ajo, duke menduar që në momentin kulminant

të krizës ta sulmojë Bashkimin Sovjetik që të realizojë kështu aspiratat e saj territoriale, të pushtojë Siberinë dhe pjesë të tjera të Bashkimit Sovjetik, gjë që do të thotë të shpërthejë lufta midis Kinës e Bashkimit Sovjetik.

Pra, të gjithë, kinezët, amerikanët apo sovjetikët, në strategjinë e tyre i kanë kurdoherë parasysh këto mundësi e kthesa dhe, derisa strategjia e tyre bazohet në luftëra grabitqare, në gënjeshtër, në intriga, në komplete, në traktate të fshehta etj., etj., në këtë strategji nuk ka asgjë marksiste-leniniste. Të gjitha këto janë kundër revolucionit dhe çojnë në një luftë grabitqare, në një luftë kriminale, të cilën do ta paguajnë popujt me gjakun e tyre. Prandaj popujt duhet të ngrenë krye kundër atyre politikave imperialiste grabitqare dhe kundër të gjitha atyre partive dhe atyre shteteve që praktikojnë me zell të madh dhe me nxitje të madhe këto politika imperialiste luftënxitëse.

Siç thashë, qëllimi i vajtjes së Vensit në Kinë është për të rregulluar marrëdhëniet e mëtejshme në mes të dy vendeve. Në qoftë se do të mbetet diçka pa u vendosur në favorin e imperialistëve amerikanë, atëherë pas Vensit atje do të shkojë Titoja, agjenti i imperializmit amerikan. Ky, para vajtjes në Kinë, sigurisht do të vihet në dijeni nga amerikanët për rezultatet e bisedimeve të Vensit me Hua Kuo Fenin dhe me Ten Hsiao Pinin, si edhe për synimet e mosarritjet e tyre në këto bisedime, prandaj ai do të këshillohet që të ngulë këmbë te kinezët që të pranojnë kushtet amerikane. Dhe Titoja nuk do të mungojë ta kryejë këtë detyrë të përdronit me diplomacinë e tij të njohur, diplomaci që do

ta zhvillojë në gjerësinë dhe në thellësinë e saj në formë mashtruese, revizioniste, tradhtare. Ai do të përdorë çdo gjë, edhe përkëdhelitë, edhe dredhitë, edhe «madhështinë» e tij, por edhe do t'u bëjë elozhe udhëheqësve kinezë, do të përmendë me aprovim «politikën e drejtë» që bën Kina dhe, në mes të tjerave, do t'u thotë kinezëve se duhet fituar kohë, duhet përfituar nga imperializmi amerikan, i cili ka një potencial të madh ekonomik e ushtarak modern, që Kinës, si një shtet i fuqishëm socialist, i nevojitet. Dhe më tej Titoja do të vazhdojë: shqiptarët janë ekstremistë, ata gabojnë, prandaj nuk është e vërtetë kur thonë se ne (jugosllavët e kinezët) u shitëm tek imperializmi amerikan. Ne, Jugosllavia dhe Kina, marrim nga amerikanët kredi dhe teknologjinë moderne amerikane. Kinën, një vend socialist kaq të madh e kaq të pasur, si mund të guxojnë shqiptarët ta quajnë të shitur tek amerikanët? Ne nuk jemi të shitur te Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do t'u thotë Titoja kinezëve; përkundrazi, ne po përfitojmë nga teknologjia moderne amerikane, e cila disponon edhe për ne.

Natyrisht, Titoja do t'u flasë kinezëve për qëllimet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ne dhe ju, do t'u thotë ai, i njohim cilët janë amerikanët, prandaj që të dyja palët do të kemi kujdes dhe në këtë çështje duhet të jemi në akord të plotë, domethënë të dimë t'u rezistojmë orvatjeve keqbërëse të tyre. Përveç kësaj ne jemi dy lidhësi të dy botëve, ju të «botës së tretë» dhe ne të «botës së paangazhuar». Pavarësisht se kemi emërtime të ndryshme dhe disa forma të ndryshme bashkëpunimi, qëllimi ynë është i njëjtë. Titoja do të pra-

nojë tezën se të dyja palët, si Kina, edhe Jugosllavia. si «bota e tretë», ashtu edhe «bota e paangazhuar», janë forca kryesore e revolucionit kundër imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik.

Pra, Titoja do të punojë në drejtim të shtytjes së Kinës drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por kjo nuk do ta pengojë atë që Ten Hsiao Pinit dhe Hua Kuo Fenit t'u sugjerojë, sa të jetë e mundur, që t'i zbutin disi marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, natyrisht, jo përnjëherë, por gradualisht, pse kjo «do të jetë në interesin e Kinës». Shihni, do t'u thotë Titoja kinezëve, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës bëjnë politikë me socialimperializmin sovjetik dhe herë-herë i acarojnë kontradiktat, por edhe përpiqen të mos shkojnë në ekstrem. Po kështu bëj edhe unë. Titoja do t'u flasë kinezëve edhe për rreziqet që kërcënojnë Jugosllavinë nga socialimperializmi sovjetik dhe këtu patjetër ai do ta forcojë dozën, për të treguar «heroizmin» dhe qëndresën e tij të vazhdueshme kundër Stalinit, që, sipas tij, është armiku i përbashkët i Jugosllavisë e i Kinës, e do t'u sugjerojë kinezëve që ta këqyrin më me kujdes politikën e tyre dhe të shohin se si manovron Jugosllavia përpara hegjemonisë sovjetike. Titoja me kinezët do të flasë për hegjemonizmin sovjetik, natyrisht me terma të matur, pse është dinak dhe ka frikë se edhe të tjerët, siç bën vetë, marrin dhe shpien lajme. Prandaj në këtë drejtim ai do të jetë mjaft i kujdesshëm dhe do të dijë t'u gjejë zemrën kinezëve, t'u flasë në bazë të aspiratave të tyre, të cilat do të përpiqet t'i kanalizojë në interesin e imperializmit amerikan dhe të Jugosllavisë. Dihet se këto vizita që

bën Titoja nuk i ndërmerret vetëm për interesin e të dyja superfuqive. Në radhë të parë ai shikon interesin e tij, kërkon të marrë çeqe të veçanta nga të dyja palët, por në rastin konkret ai do të përpiqet që edhe nga Kina të përfitojë diçka, kredi, ndihma, sidomos në industri dhe në sektorë të tjerë. Fakt është se gjatë kësaj vizite Jugosllavia do të përpiqet t'i zhvillojë marrëdhëniet ekonomike kulturore, politike e ideologjike me Kinën.

Por Titoja, medoemos, do të vendosë edhe marrëdhënie partie me kinezët, të cilët, me siguri, do ta njohin regjimin «socialist» të Jugosllavisë dhe nuk ka asnjë arsye përse të mos e njohin. Me fjalë këtë mund të mos e deklarojnë akoma, por në mes tyre ata do të bien dakord që «Jugosllavia ndërton socializmin». Megjithatë interesat e duan që edhe këtë ta pohojnë me ndonjë shprehje të tërthortë, pse të tjerët, mendojnë ata, armiqtë e tyre dhe veçanërisht shqiptarët, veshët i kanë të ngritur në këtë drejtim. Prandaj me vajtjen e Titos në Kinë ne mund të themi se udhëheqësit kinezë kanë hyrë plotësisht në rrugën e tradhtisë së marksizëm-leninizmit, Kina është bërë një vend revizionist dhe po bën një kthesë 180 gradëshe drejt vendosjes së rendit kapitalist dhe të diktaturës borgjeze fashiste

Kina aspiron dhe lufton për t'u bërë një superfuqi e tretë, për ta ndarë botën me dy superfuqitë e tjera dhe, natyrisht, për të shkuar në luftë, për të çuar popujt në një luftë grabitqare. Synimet e Kinës janë të njëjllota me ato të imperializmit amerikan dhe të atij sovjetik. Këtë e tregon fare qartë ndarja e botës dhe e tregjeve. Tash Kina, me ndarjen e botës dhe duke u futur edhe vetë në «botën e tretë», kërkon që këtë botë



ta bëjë të sajën, ta ketë nën ndikimin e vet dhe të kundërbalancojë kështu fuqinë e imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik. Por kjo është një ëndërr me sy hapur, pse «bota e tretë» nuk e do Kinën. Vendet e «botës së tretë» janë të lidhura ngushtë kush me imperializmin amerikan, kush me imperialistët e tjerë të vjetër anglezë, francezë, japonezë, gjermanoperëndimorë, italianë e të tjerë, dhe kush me socialimperializmin sovjetik. Prandaj Kina vetëm cinin ka si lidërsnip i «botës së tretë», është njëlloj siç thotë populli ynë: «Dhentë e dhitë e Zeres, nami i Hasan Qeres». Pra, vetëm namin mban Kina që është në «botën e tretë», që si fuqi e madhe përpiqet të dominojë në të, por në fakt në këtë «botë të tretë» dominojnë të tjerët, jo ajo. Me këto pikëpamje dhe qëndrime Kina do të demaskohet më tej dhe do të humbasë.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 9, f. 394

# ÇFARË DUHET TË NGREME NË FJALIMIN TONË NË SESIONIN E SIVJETSHËM TË OKB-SË

Shënime

11 gusht 1977

Shokët e Ministrisë së Punëve të Jashtme po përgatiten për mbledhjen e afërme të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Nuk ka dyshim që ata po punojnë në këtë drejtim. Jam i sigurt që edhe Ramizi, i cili është në lidhje të drejtpërdrejtë me ta, kështu si unë mendon. Por mendoj se shokëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme duhet t'u tërhiqet vëmendja se problemet e politikës sonë të jashtme, që do të parashtrijmë këtë vit në mbledhjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, duhet të jenë të lidhura mirë me situatat që janë krijuar.

Ndoshta ata parashikojnë t'i përmbahen përsëri boshtit të vjetër të fjalimeve për të folur për luftën kundër imperializmit amerikan, kundër socialimperializmit sovjetik dhe për mbrojtjen e vendeve, popujve e shteteve të botës nga ndikimi, shtypja dhe shfrytëzimi i dy superfuqive. Vërtet ky bosht nuk është i përshtatshëm, por duke ruajtur këtë, në të ardhmen, nuk duhet të mbahen kurdoherë të njëjtat forma në

paraqitjen e mendimeve e sidomos nuk duhen thënë të njëjtat gjëra me të njëjtat fraza të rreshtuara shumë herë varg si në mbledhjet e mëparshme.

Fjalimet që ka mbajtur titullari i kësaj ministrie herët e tjera në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i kam korrigjuar, duke shtuar bile edhe pjesë të tëra, të cilat nuk ishin kujtuar t'i trajtonin vetë ata. Nuk është me rëndësi vetëm paraqitja e problemeve, por duhet pasur parasysh sidomos që të përdoren edhe mënyrat më të përshtatshme, më të sakta dhe më me efekt për ekspozimin e përmbajtjes së tyre. Kjo gjë ka rëndësi të madhe, veçanërisht, në Asamblenë e Përgjithshme të kësaj organizate ndërkombëtare. Nuk duhet të harrojmë që, në qoftë se më parë ka pasur mjaft interesim për fjalimet tona në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, këtë radhë do të ketë shumë herë më tepër. Për këtë arsye mendoj se fjalimi që do të mbahet këtë herë nga shoku që do të dërgojmë në OKB, duhet të jetë origjinal për sa u përket trajtimit të ideve dhe paraqitjes së mendimeve.

Qëndrimi që mbajti në Kongresin e saj të 7-të dhe artikujt e shumtë që po boton Partia e Punës e Shqipërisë për zbrëthimin e ideve të këtij Kongresi, kanë ngjallur kudo në botë një interesim të madh për politikën tonë. Ne jo vetëm që duhet ta mbajmë gjallë këtë interesim, por, në të njëjtën kohë, të punojmë që ta ngremë më lart dhe t'i shpjegojmë akoma më mirë, më gjerë e më thellë qëndrimet dhe pikëpamjet tona politike dhe vijën ideologjike të Partisë sonë për problemet e ndryshme ndërkombëtare.

Natyrisht, sot botën e preokupojnë shumë probleme, por, në këtë rast, ne duhet të zgjedhim ato më kryesoret për t'i trajtuar në fjalimin tonë, i cili nuk duhet të jetë as shumë i gjerë, as i mbushur me fraza boshe, por të ngjishet me ide e mendime për probleme që neve na duken më interesante dhe që mendojmë se edhe vendeve të tjera do t'u duken po kështu.

Fjalimi ynë në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, pas këtyre situatave që janë krijuar në botë, merr një rëndësi të veçantë sidomos për sa u përket lidhjeve që do të ketë Shqipëria me botën. Ky është një problem që duhet trajtuar me kujdesin më të madh për t'i dhënë gjithë botës të kuptojë se Shqipëria socialiste ndjek një politikë plotësisht të pavarur në fushat politike, ideologjike, ekonomike, ushtarake, shoqërore etj. Duhet të shpjegohet qartë ku e bazon Shqipëria politikën e saj të pavarur, pse kjo politikë është e tillë, në cilët faktorë konsiston varësia e një vendi, e një populli ose e një shteti, dhe pastaj të konkludohet që, meqenëse në Shqipëri këtyre faktorëve u është prerë rruga, nuk mund të ekzistojë varësia. Të shpjegohet, gjithashtu, se një vend me të vërtetë socialist, i lirë, i pavarur dhe sovran, që udhëhiqet nga ideologjia marksiste-leniniste, mund të ecë me këmbët e tij, mund të përparojë vazhdimisht, të ngrejë mirëqenien e popullit dhe të ndërtojë socializmin, duke u mbështetur në forcat e veta.

Nga teksti i fjalimit të dalë qartë se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë në asnjë mënyrë nuk i var ekzistencën, lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e saj jo vetëm nga ndihma e shteteve kapitaliste, borgjeze

dhe revizioniste, nga të cilat as ka marrë, as merr dhe as do të marrë ndihma dhe kredi, por nuk i var as nga ndihma e ndonjë vendi socialist. Në qoftë se Shqipëria ka marrë dhe mund të marrë ndihmë internacionaliste pa kurrfarë interesi nga një vend socialist, kjo ndihmë, në raport me forcat e saj ekonomike, përbën vetëm një pjesë të vogël, që në asnjë moment dhe në asnjë rrethanë nuk mund ta bëjë Shqipërinë të varur prej shtetit socialist nga i cili ajo merr ndihmën. Në këtë çështje duhet ndalur dhe duhet shpjeguar mirë politikisht e teorikisht se ç'përfaqësojnë kreditë dhe ndihmat e botës borgjezo-revizioniste për një vend të vërtetë socialist. Së këtejmi të arsyetohet se për ç'arsye vendi ynë nuk ka pse t'i marrë këto ndihma. Të nënvizohet se Shqipëria e ka sanksionuar në Kushtetutën e saj që me shtetet e tjera dëshiron të ketë marrëdhënie politike, ekonomike, kulturore mbi bazën e barazisë, të respektimit të sovranitetit, të mosdërhyrjes në punët e brendshme dhe të dobisë reciproke.

Në fjalim të përmendet se Shqipëria është një vend plotësisht i pavarur, që e ka denoncuar me kohë Traktatin e Varshavës dhe nuk do të ketë marrëdhënie ushtarake me asnjë shtet. Mbrojtjen e lirisë, pavarësisë kombëtare dhe tërësisë territoriale të vendit të vet Shqipëria dhe populli i saj i armatosur do t'i sigurojnë me sukses, për arsye se politika që ndiqet është një politikë e drejtë që kundërshton çdo formë të agresionit, të luftërave grabitqare, të shfrytëzimit kolonial, të diktatit dhe të hegjemonisë, të tutelës, të shtypjes kombëtare e të dallimit racial. Shqipëria e di që imperialistët do të kërcënojnë atë dhe shtetet e tjera liridashëse,

prandaj ajo i ka marrë të gjitha masat për t'i bërë ballë me sukses çdo rreziku. Shqipëria do të qëndrojë e patundur si shkëmb i fortë, në radhë të parë sepse në krye të popullit të saj prin një parti e fortë dhe e vërtetë marksiste-leniniste, sepse midis Partisë e popullit ekziston një unitet i pathyeshëm. Populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, ndërton me sukses socializmin dhe mbron me vigjilencë fitoret e arritura.

Çështja tjetër, që duhet shtruar dhe duhet bërë e qartë në fjalim, është ajo që të demaskohet mentaliteti i «vakuimit» që ekziston ndër imperialistët e revizionistët për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Shqipëria mund të ketë dhe ka mosmarrëveshje ideologjike me Kinën, por marrëdhëniet miqësore me të i vazhdon, do t'i vazhdojë e do t'i mbrojë. Ne deklarojmë haptazi dhe pa terma diplomatikë: Askush të mos ushqejë iluzione se «Shqipëria u izolua», se ajo «Nuk mund të rrojë pa ndihmën e jashtme», se «Tash u shkëput nga Kina dhe do t'i shtrijë dorën tjetërkujt».

Asnjë fuqie imperialiste të mos i ngjallet dëshira dhe të mos i hapet oreksi për imponimin e vullnetit të saj Shqipërisë socialiste, që nuk kërcënon asnjërin dhe nuk pranon të kërcënohet prej asnjërit. As socialimperialistët të mos ëndërrojnë se mund t'i imponohen Shqipërisë. Në qoftë se këta armiq të lirisë dhe të pavarësisë së popujve, duke praktikuar metodat e tyre të njohura, do të guxojnë të atakojnë ushtarakisht Shqipërinë, me siguri do të gjejnë vdekjen përpara brigjeve të detit dhe maleve të saj. Ne, nga tribuna e kësaj Asambleje, i paralajmërojmë socialimperialistët që të mos ndërmarin tentativa të tilla. Të njëjtën gjë paralajmërojmë

edhe për imperialistët amerikanë dhe veglat e tyre, që shpresojnë të ndërhyjnë në punët e brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë rron dhe do të rrojë e lirë, e pavarur dhe në sovranitet të plotë kombëtar. Prandaj kush mendon të mbushë të ashtuquajturin vakuum në Shqipëri, do të dështojë, pse në vendin tonë nuk ekziston ndonjë boshllëk që pret të mbushet nga imperialistët apo nga socialimperialistët.

Ne nuk jemi autarkikë dhe i kuptojmë drejt marrëdhëniet ekonomike që duhet të ekzistojnë midis vendeve të ndryshme. Këto marrëdhënie duhet të jenë të drejta, të barabarta dhe me leverdi reciproke, sipas parimit «më jep, të të jap». Në qoftë se një vend tregohet dashamir ndaj mallrave tona dhe i blen ato, edhe ne do të blejmë mallrat e tij; përkundrazi, në qoftë se një shtet nuk i pranon mallrat tona, edhe ne nuk do t'i blejmë mallrat e tij. Ne do të marrim e do të japim në fushën e tregtisë atje ku kemi leverdi. Kush ka leverdi të na shesë, ne do t'i blejmë ato mallra që na nevojiten dhe do të bëjmë tregti me ata që duan të kenë marrëdhënie tregtare me ne. Ekonominë tonë socialiste ne, natyrisht, nuk e mbështetim në tregtinë e jashtme, por në zhvillimin e gjithanshëm të industrisë e të bujqësisë, kryesisht me forcat tona, prandaj fakti që bëjmë tregti me vende të tjera nuk do të thotë në asnjë mënyrë që Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është e varur prej tyre.

Edhe marrëdhëniet kulturore me vendet e tjera ne do t'i zhvillojmë në përputhje me parimet e me normat që ka caktuar vendi ynë, natyrisht, kur këto janë të

pranucshme edhe për palën tjetër. Marrëdhënie të tilla ne do të kemi me ato shtete që janë dashamire ndaj nesh. Librat, shfaqjet artistike, teatrot dhe filmat tanë mbështeten në botëkuptimin konsekuent marksist-leninist, që është ideologjia jonë sunduese. Gjithë rendi shoqëror në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë udhëhiqet nga parimet e ideologjisë marksiste-leniniste dhe nga normat e shoqërisë socialiste. Neve në Shqipëri nuk na lejohet të pranojmë nga vende të tjera programe artistike ose filma dekadentë, që mund të ndikojnë në korruptimin dhe në çoroditjen e ndërgjegjes së njerëzve tanë. Ne do të dëshironim që aktivitetet kulturore dhe artistike të vendeve të tjera në Shqipëri të kishin frymë përparimtare, liridashëse dhe popullore. Pa dyshim aktivitete të tilla, si kurdoherë, do t'i presim me kënaqësi, sepse këto janë një mjet i përshtatshëm për komunikimin me popujt dhe me vendet e ndryshme të botës.

Çështja tjetër me rëndësi që duhet të trajtojmë në këtë sesion të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara është ajo e «botës së tretë». Kjo çështje të mos trajtohet atje nga ana ideologjike dhe të mos polemizohet rreth saj, por vetëm të demaskohen imperiaлизmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe të gjitha ato shtete reaksionare që kërkojnë të shfrytëzojnë situatat strategjike, politike, ekonomike të botës dhe prapambetjen e disa vendeve si mjet për të sunduar mbi popujt. Ne duhet të tregojmë se jemi miq me të gjithë popujt e botës, veçanërisht me popujt që luftojnë për liri, pavarësi dhe sovranitet dhe të vëmë mirë në dukje se këta popuj kanë tradita të lashta patriotike



dhe kulturore, kanë etje e dëshirë të madhe që të rrojnë të lirë e të lumtur dhe luftojnë për këtë qëllim të lartë. Ne, sipas Kushtetutës sonë, do të mbështetim luftën e këtyre popujve pa përjashtim për liri, pavarësi e përparim shoqëror. Mjaft nga këta popuj po luftojnë jo vetëm me armikun e jashtëm, që përbëhet nga superfuqitë dhe shtetet e tjera imperialiste, por, natyrisht, edhe me armiqtë e brendshëm, që tradhtojnë interesat kombëtarë për t'u shërbyer fuqive të huaja imperialiste. Ekzistenca e armiqve të brendshëm nuk mund të mohohet, sepse historia e njerëzimit ka provuar në mënyrë të pakontestueshme se deri sot nuk ka pasur asnjë revolucion nacional-demokratik e antiimperialist që nuk është ndeshur me armiq të brendshëm, tradhtarë të shitur.

Armiku i jashtëm është i përbashkët, atë duhet ta luftojnë të gjithë popujt e atyre kontinenteve që nuk janë çliruar akoma dhe që vuajnë nën sundimin e tij. Populli shqiptar që është çliruar nga armiqtë e jashtëm, që urren shtypjen dhe shfrytëzimin e huaj, dëshiron t'i shohë të lirë, të pavarur e sovranë të gjithë ata popuj që janë akoma nën zgjedhë.

Armiku i brendshëm duhet të luftohet nga vetë populli. Ne nuk kemi ndërhyrë dhe nuk ndërhyjmë kurrë në punët e brendshme të të tjerëve, por jemi kundër politikanëve jopërparimtarë të mjaft vendeve, të cilët, duke qenë të lidhur me fuqitë e mëdha imperialiste dhe duke bërë lojën e tyre, u bëhen pengesë popujve që kërkojnë liri, demokraci, pavarësi e sovranitet kombëtar, që duan të shpëtojnë nga varfëria, të

gëzojnë jetën e re dhe të shfrytëzojnë në dobi të tyre pasuritë e vendit.

Epokën e tanishme, sipas pikëpamjes sonë, e karakterizojnë jo një, por katër kontradikta të mëdha shoqërore, që Partia jonë i ka vënë në dukje teorikisht dhe politikisht në dokumentet e saj të shpallura botërisht. Këto kontradikta veprojnë objektivisht, prandaj nuk mund të mos llogariten kur përcaktohet një strategji e drejtë. Të katër kontradiktat zhvillohen e thellohen gjithmonë e më shumë. Ky zhvillim patjetër do të ketë si pasojë atë që nga sasia të kalohet në cilësi, në shpërthimin e revolucionit.

Pakënaqësia e popujve kundër shfrytëzimit kolonial, tutelës, diktatit dhe hegjemonisë, shtypjes kombëtare e dallimit racial do të arrijë kulmin. Faktorët subjektivë janë krijuar e do të krijohen edhe në të ardhmen dhe momenti kur do të pëlçasë revolucioni do të vijë. Revolucioni çlirimtar, antiimperialist e demokratik, sipas teorisë sonë marksiste-leniniste, do të zhvillohet me konsekuencë e do të çohet deri në fund.

Në kemi të drejtë të shprehim hapur pikëpamjet dhe bindjet tona politike e ideologjike edhe këtu në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për këtë problem kaq të madh siç është revolucioni. Natyrisht, ne nuk jemi ata që do ta bëjmë revolucionin në vende të tjera, sepse revolucioni është çështje e vetë popujve të këtyre vendeve. Popujt vetë do ta arrijnë çlirimin kombëtar nga zgjedha e çfarëdo pushtuesi të huaj, si dhe çlirimin shoqëror. Kush na beson, edhe do të na dojë. Ne jemi të interesuar për miqësinë dhe dashurinë e njerëzve të mirë, të nder-

shëm dhe revolucionarë të vërtetë. Kush nuk na beson, le të na kundërshtojë, ne nuk jemi kundër polemikës për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.

Ne shqiptarët, që i duam popujt liridashës për të cilët flasim, jemi të bindur se edhe këta popuj na duan pse ne flasim drejt dhe hapur. Ne e kemi fituar lirinë me gjakun dhe me djersën tonë dhe po shijojmë të mirat e saj, prandaj shprehim hapur dëshirën tonë të zjarrtë që të jenë të lirë edhe popujt e tjerë vëllezër me tradita luftarake, që kanë një kulturë të përparuar, e cila në epoka të ndryshme ua ka kaluar të gjitha kulturave evropiane. Pse të mos i mbështetim dhe të mos i mbrojmë këta popuj? Pse qeveritë ose qarqet reaksionare të disa vendeve paskan të drejtë edhe të shpifin e të intrigojnë kundër nesh, kurse ne nuk u dashka të vëmë në dukje politikën skllavëruese të tyre mbi popujt e vendet që sundojnë?

Ne luftojmë që popujt e botës të na duan, që ata të kenë simpati për ne, pavarësisht nga qëndrimi armiqësor që mbajnë në marrëdhëniet me ne disa klika sunduese të tyre, të cilat edhe ne i urrejmë si antipopullore. Aleanca jonë me popujt bazohet në parimet e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar, në politikën e përkrahjes së lëvizjes çlirimtare etj., prandaj ekzistojnë kjo miqësi, ky solidaritet e mirëkuptim mes popujve të kontinenteve të botës dhe Shqipërisë së vogël socialiste. Shqipëria socialiste flet në mënyrë të guximshme jo vetëm sepse mbështetet te populli i saj i çliruar, gjë që ka shumë rëndësi, por sidomos sepse ajo mbështetet edhe te vendet e popujt liridashës të botës. Shqipërinë socialiste nuk do ta gjejë asnjë rrezik,

sepse ajo ka me vete qindra milionë njerëz në botë që e simpatizojnë. Këtu qëndron forca jonë dhe kjo forcë drejtohet kundër imperializmit, socialimperializmit dhe kundër të gjithë oportunistëve dhe revizionistëve me maska, si dhe klikave reaksionare që përpiqen të gjithë, me djallëzi e me intriga, të çoroditin, të gjakosin, të robërojnë, të shtypin dhe të shfrytëzojnë popujt. Imperializmi, socialimperializmi, revizionistët dhe reaksioni ndërkombëtar përpiqen të krijojnë perandori të reja, të krijojnë zinxhirë të rinj për popujt. Ne jemi kundër këtyre zinxhirëve të rinj, prandaj popujt i duam dhe ata na duan ne me gjithë shpirt.

Përveç çështjeve që paraqita më sipër, në këtë fjalim ne nuk duhet të lëmë mënjanë ekzistencën e kontradiktave mes shteteve, dhe këtu të gjejmë mënyrën e përshtatshme të trajtimit e të shtruarjes së tyre, të shpjegojmë se ku e kanë burimin këto kontradikta e, me këtë rast, të demaskojmë në mënyrë të veçantë «mosangazhimin» titist dhe «teoritë» e tjera të krijimit të shumë botëve, të shprehura me shifra algjebrike ose aritmetike, që nuk kanë asnjë bazë. Në këtë mbledhje ky problem mund të përmendet shkarazi, por ne duhet të themi qartë se mes shteteve të botës ka konflikte të ndryshme e të vazhdueshme, se çdo ditë vërtetohen ngjarje kur njëri shtet hidhet kundër tjetrit dhe sa shuhet njëri zjarr ndizet një tjetër. Po kush i ndez këto zjarre, kush i shkakton këto konflikte? Popujt? Jo, aspirata e popujve është solidariteti, dashuria dhe vëllazërimi. Dhe kur themi kështu, ne nuk jemi aspak çndërrues idealistë, por gjykojmë realisht si marksistë-leninistë. Këto situata krijohen vetëm sepse ekzistojnë klasat

shfrytëzuese, që luftojnë kundër klasave të shfrytëzuar; sepse në planin kombëtar dhe ndërkombëtar ekzistojnë interesa të kundërt e të papajtueshëm midis këtyre klasave që ndeshen me njëra-tjetrën. Antagonizmi i madh e i papajtueshëm midis këtyre klasave kapërcehet vetëm me revolucion. (Brenda këtyre caqeve që shpreha mendoj se duhet të përmenden si shembull ata që shkaktuan luftërat në Lindjen e Mesme, midis Somalisë dhe Etiopisë, në Angola, grindjet në Kongo etj.)

Këto probleme, në fjalimin që do të mbahet, të trajtohen duke ruajtur modestinë dhe të mos shtjellohen në formë historike, por të dalin si konkluzione të natyrshme të tezave që përmenda më lart. Idetë të shprehen me stil konciz, të qartë dhe të kuptueshëm, më shumë në planin politik se ideologjik, duke pasur parasysh veçanërisht që shtetet, të cilat sapo kanë fituar pavarësinë politike, të na kuptojnë drejt, por në të njëjtën kohë t'u përgjigjemi edhe akuzave që na bëjnë në armiq të, si dhe iluzioneve që ushqejnë ata për qëndrimin tonë të ardhshëm.

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 9, f. 507*

## NJË POPULL ME FOLKLOR TË PASUR E TË LARMISHËM

Shënime

21 gusht 1977

Mësova se një grup kritikësh të artit e të letërsisë paskan bërë një letër në lidhje me ansamblin artistik grek «Marinela», që dha shfaqje në vendin tonë. Në përgjithësi autorët e letrës nuk flasin keq për ansamblin, por thonë se «nuk kishte sa duhej dhe si duhej këngë popullore, nuk ekzistonte folklori i popullit grek». Me fjalë të tjera, për këtë ata kritikojnë institucionet tona të interesuara.

Kritika e këtyre njerëzve nuk është e drejtë edhe nga ana politike. Ardhja e ansamblit grek në Shqipëri ka karakter politik dhe politika, natyrisht, është e lidhur edhe me anën artistike të këtij ansambli. Këta «kritikë» letraro-artistikë duhet të dinë se aktualisht marrëdhëniet me Greqinë shkojnë duke u përmirësuar. Kjo nuk do të thotë që Greqia është bërë një shtet socialist. Jo, por situatat dhe interesat e saj, si dhe tonat e duan që akulli të shkrihet, por ne, natyrisht, duke qëndruar në pozitën tona parimore. Shtetit tonë i intereson që me Greqinë të mbajë marrëdhënie të mira

fqinjësie dhe në këto marrëdhënie përfshihen edhe marrëdhëniet kulturore. Këta njerëz duhet të dinë që në Greqi ka elementë që po bëjnë shumë për Shqipërinë, dua të them që po propagandojnë shumë mirë për vendin tonë. Gazetat greke aktualisht shkruajnë për Shqipërinë, publikojnë artikujt tanë, atje shfaqen filma shqiptarë etj., etj. Kjo është një gjë shumë e mirë.

Në këto kushte ne ramë dakord që pala greke të dërgonte një grup artistik dhe ne, gjithashtu, do të dërgojmë një grup artistik nga tanët, bile shumë më të madh nga ai që erdhi nga Greqia, dhe këtë qeveria greke e ka pranuar. Pra, nga ana politike ky është një sukses.

Tash në Greqi propagandohet në favor të Shqipërisë socialiste, mbahet një qëndrim dashamir ndaj vendit tonë dhe ne kemi bindjen se populli grek e do Shqipërinë. Megjithatë ne e dimë se monarko-fashistët dhe vorioepirotët nuk kanë vdekur, as politika e «mëgaliidhesë», por këto rryma reaksionare aktualisht janë tulatur, sepse qeverisë greke i intereson të ketë marrëdhënie të mira me ne.

Për ardhjen e ansambilit grek, natyrisht, ambasada jonë në Athinë ka biseduar me palën greke dhe u ka sugjeruar se e mira do të jetë që ansambli, sa të jetë e mundur, të ketë pjesë folklorike popullore, pse ne dëshirojmë që ai të korrë sukses të plotë kur të vijë te ne dhe kështu të forcohet miqësia. Kaq mund të bënim ne në këtë drejtim, kurse, sipas këtyre «të zgjuarve», ne s'paskemi bërë shumë. Një kjo. Kjo është ana politike, por edhe çështjen artistike po ta marrim, më

duket se këta kritikë nuk kanë njohuritë e duhura për artin dhe për folklorin grek.

Megjithëse nuk kam shumë dijeni për gjendjen e këtij folklori, nga leximet e mia për historinë e popullit grek, për zhvillimin e arteve dhe të kulturës së tij, mund të them disa fjalë.

Në bazë të njohurive të mia mund të them me siguri se Greqia, ashtu si vendi ynë, ka një folklor të pasur e të larmishëm. Populli ynë ruan traditat e kësaj pasurie të madhe të tij dhe populli grek, gjithashtu, i ruan deri në njëfarë shkalle pasuritë dhe traditat e veta. Por, ndërsa në vendin tonë zhvillimi i folklorit ka marrë një hov shumë të madh, në Greqi nuk e ka atë zhvillim, për arsye se në jetën muzikore e artistike të këtij vendi kanë hyrë ndikimet moderniste. Megjithëkëtë kjo nuk do të thotë se folklori grek është zhdukur. Me sa di unë, folklori grek është i lidhur ngushtë kryesisht me fenë e me kishën, prandaj në Greqi vallet dhe këngët folklorike ekzekutohen më shumë gjatë festave fetare nëpër kisha dhe manastire. Liturgjia luan një rol në këtë folklor, dhe, kur flasim për traditat e folklorit grek, sipas literaturës që kam lexuar, nuk duhet mënjanuar ndikimi fetar.

Në Greqi, gjatë festave ose të dielave, rrugicat, rrugët dhe sheshet mbushen me njerëz, shtëpitë bien erë mish qengji të pjekur dhe verë recinë. Në këto festa populli vallëzon; gratë, të veshura me kostume tradicionale, shumëngjyrëshe, me mëngë të gjera, me shami të bardha në kokë etj., etj., hedhin valle. Duhet ditur se grekët janë edhe tradicionalistë. Në lartësinë e Parnasit, nëpër fshatra, si, për shembull, në Rahovë



afër Delfit, zhvillohen çdo vit festa folklorike që u kushtohen, për shembull, shën Gjergjit etj. Ka valle e këngë për dragonjtë, ka këngë që u këndojnë trimërive të Apolonit, shën Nikollës etj., kurse perëndisë më të madhe të grekëve, Zeusit, në folklorin aktual i kanë dhënë pamjen e shën Ilias. Ata ruajnë, për shembull, në Kretë, traditat e Mikenës, por kurdoherë të lidhura me kishën. Në katedralet e vogla të Kretës ata bëjnë edhe kurbane.

Në Eube, në Atikë, deri diku edhe në Peloponcz ruhen traditat folklorike, por jo në atë shkallë sa ruhen në veriperëndim të Greqisë, ku ka një zhvillim të folklorit në këto forma e gjerësi si në fshatrat tona. Megjithëse në fshatrat greke kanë filluar të zhduken bile edhe instrumentet e vjetra popullore, prapçesepër një ka dashamirë të folklorit që i ruajnë këngët dhe vallet folklorike.

Unë kam lexuar se trupa e baletit folklorik që quhet «Dora Stratu», i ruan këngët dhe vallet popullore dhe ka krijuar disa valle që edhe në kohën tonë, nëpërmjet tyre, shikohet e kaluara e lavdishme e popullit grek. Për shembull, një nga vallet e bukura trimërishte që praktikohen në folklorin grek, siç kam lexuar, është ajo që quhet «Pirike». Në folklorin grek ka edhe këngë heroike, edhe këngë të tjera, që janë nga më të bukurat që ka krijuar gjenia popullore greke. Këto këndohen të shoqëruara me lirë dhe u kushtohen trimërive të kapedanëve grekë në luftën kundër osmanëve.

Por në Greqi, me sa duket, aktualisht janë lënë mënjanë këngët e kleftëve, këngët e palikarëve. Vetëm

nëpër fshatra, ose ndër pijetore, fshatarët apo punëtorët, kur dalin nga puna, këndojnë, para gotës së uzos dhe kukurecit, këngë popullore me ritme të ngadalshme.

Nuk ishte e drejtë që ne të mos kënaqeshim nga ky folklor që na u paraqit nga ansambli «Marinela».

Ne mund të themi se orkestra greke e Marinelës, që dha shfaqje në vendin tonë, u prit ngrohtësisht, për arsye se këngët dhe vallet e saj ishin melodioze, ato përmbanin në vetvetë dhimbjet, dashurinë dhe shpresat e popullit grek. Sipas mendimit tim, për aq sa e njoh unë artin grek nëpërmjet leximeve dhe pikturave, këngët u interpretuan shumë bukur, në radhë të parë nga vetë Marinela, artistja kryesore, e cila me këngët, me mimikën dhe me gjestet e saj u përngjiste koreve dhe kërcimtarëve të kohës antike, të paraqitura me art në dramat e Eskilit, të Aristofanit e të shkrimtarëve të tjerë të mëdhenj grekë, që luheshin në amfiteatrin e Delfit të Dodonës, në Panteonin e Athinës e kudo gjetkë. Lëvizjet e gishtave, të duarve e të krahëve të shkathët të kësaj artisteje greke, me plastikën e tyre, u ngjishnin pikërisht monumenteve të kohës së Praksitelit, të Perikliut, monumenteve të Venusit, të Afërditës, e të Fitores së Samotrakës. Shikoja me vërejtje interpretimet e këngëve të kësaj artisteje të shquar dhe mendoja për artin e famshëm grek.

Interpretimi luajti një rol të madh në paraqitjen me nivel të këngëve dhe të valleve popullore, por edhe brendia shoqërore e tyre nuk ishte e keqe. Marinela këndoi dy-tri këngë dashurie. Mirë bëri. Pse, këngëtarët tanë popullore, artistët dhe populli ynë vallë nuk

këndojnë këngë dashurie? Këndojnë, si nuk këndojnë, dhe bëjnë mirë. Partia rekomandon që të këndohen edhe këngë dashurie, sepse pa dashuri nuk ekziston jeta. Ansambli grek, veç dashurisë, i këndonte edhe varkës që fundosej në Egje. Kënga melodioze e marinarit me mjekër e jepte si duhej intonacionin e mjerrimit që i kishte ngjarë. Më erdhi në vesh se ndonjë «purist» paska thënë se do të ishte më mirë që ai të mos kishte mjekër. Por një njeri i tillë duhet të dijë se ai nuk ishte hipi dhe të ketë parasysh se marinari, që bredh detin Egje dhe Mesdheun, kur i mbytet varka nuk ka kohë të pispilloset, të rruajë dhe të livandosë mjekrën.

Edhe vallet e tjera, si, për shembull, vallja e shoqëruar me këngën «Djemtë e Pireut», u interpretuan shumë bukur dhe jo «bugi-bugi» siç paskan thënë. Po kështu mund të thuhet edhe për këngën popullore të shoqëruar me buzuk, e cila ishte një kryevepër e folklorit popullor grek. Gjithashtu me përmbajtje shoqërore dhe prekëse ishte dhe kënga e kurbetit etj.

Për të gjitha këto arsye ne mund të themi që ansambli i Marinelës ishte i zgjedhur, ai u pëlqye dhe la përshtypje të mira në popullin tonë.

Të them të drejtën nuk më erdhi mirë kur më thanë që, kur paska dhënë ky ansambël shfaqjen e parë, e cila ishte një shfaqje shumë e bukur, ku ishin të pranishëm plot kuadro, ndonjërit nuk i paska pëlqyer që Marinela dridhte supet me një muzikë xhazi, që imitonte kërcimet e popujve afrikanë.

Edhe në shfaqjet e ansambleve tona popullore vajzat dredhin supet para publikut. Atëherë pse këta nje-

rëz nuk kritikojnë valltaret tona për shfaqje të tilla, por gjestin e Marinelës, i cili, sikurse më thanë, nuk ishte ashtu siç është pretenduar. Ajo godiste me def mesin, këllqet e saj. Ç'do të bënë këta njerëz këtu në rast se do të kërkojë të vijë për të dhënë shfaqje dhe të kërcejë një ansambël i ndonjë vendi afrikan, bie fjala, nga Uganda ose Tanzania, muzika dhe vallet e të cilave nuk ngjasin fare me tonat? Shteti ynë do t'i pranojë medocmos këta e duhet ta duartrokasim folklorin e tyre, pse ai shpreh aspiratat e atyre popujve, luftën dhe kulturën e tyre.

Çdo popull ka kulturën e vet. Ne kemi kulturën tonë, ata kanë kulturën e tyre, por ne duhet të marrim çka është e mirë nga kultura e të huajve dhe ata, po të duan, le të marrin nga kultura jonë atë çka u pëlqen. Ne jemi internacionalistë dhe i shikojmë çështjet në prizmin marksist-leninist, gjë që nuk do të thotë kurrësesi të jesh konservator, sektar ose liberal.

Në art duhet parë njëkohësisht edhe ana politike. Siç më thanë, jo vetëm shfaqjet, por edhe qëndrimi politik i ansambilit ishte shumë progresist dhe shumë dashamir ndaj vendit tonë. Kudo ata u shprehën me ngrohtësi për pritjen e përzemërt që u bëri populli ynë në Korçë e gjetkë.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha, "Dy  
popuj miq", f. 243*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, "Dy popuj  
miq", f. 243*

## **INTELIJENCIA JONË KA DALË NGA POPULLI DHE I SHËRBEN POPULLIT**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**27 gusht 1977**

Punën me kuadrot dhe me inteligjencien Partia duhet ta ketë vazhdimisht në qendër të vëmendjes, për arsye se inteligjencia mund të influencohet nga presioni i jashtëm politik, ideologjik, ekonomik dhe teknik. Marksizmi na mëson se çdo klasë përgatit inteligjencien e vet, domethënë, përgatit kuadrot e saj, si kuadrot politiko-ideologjike, ekonomike, teknike e administrative. Meqenëse në shoqërinë kapitaliste kuadrot dalin e mësohen nga borgjezia, ata i shërbejnë kësaj dhe përpiqen të influencojnë në zhvillimin e jetës me idetë e klasës së tyre, pra të borgjezisë që i ka përgatitur e me të cilën janë të lidhur organikisht. Ata punojnë, gjithashtu, që të vendosin sundimin e idealizmit borgjez në botëkuptimin filozofik të shoqërisë.

Po të shohim zhvillimin historik të shoqërisë një-rëzore para ardhjes në fuqi të borgjezisë, domethënë në periudhën e mesjetës, do të vëmë re se privilegjin e

përgatitjes së kuadrit e kishte kisha. Kisha me ideologjinë e saj udhëhiqte kulturën, arsimin, artin, muzikën, letërsinë etj., me një fjalë krejt superstrukturën e shoqërisë së feudalizmit, të regjimeve monarkiste. Ajo bënte të gjitha përpjekjet që të mos lejonte në asnjë mënyrë që zhvillimin shpirtëror të njerëzve, përpunimin e mendimit njerëzor ta merrte në dorë dikush tjetër dhe ta orientonte jashtë ndikimit të saj. Pra, mund të themi se këtë monopol e kishte kisha, e cila ishte vënë në shërbim të feudalizmit e të monarkisë dhe kishte gjetur atje terrenin më të përshtatshëm për realizimin e qëllimeve të saj, kështu që influenca e kishës në mesjetë, në kohën e feudalizmit dhe të monarkisë, ishte e plotfuqishme.

Kur u krye Revolucioni Demokratiko-Borgjez i 1789-s në Francë, u krijua një çarje në mes kishës dhe shtetit. Kjo gjë ngjau edhe në vende të tjera, sepse influenca e këtij revolucioni pati reperkusione të mëdha edhe në ato vende ku akoma sundonte monarkia. Revolucioni Demokratiko-Borgjez krijoi një shoqëri të re, që përmbysi monarkinë e feudalizmin dhe në tërë ato peripeci borgjezia mori fuqinë në dorë. Por, kur u bë mbledhja e «*les états généraux*»<sup>1</sup>, feudalët dhe klerikët e mëdhenj kaluan nga një anë, kurse «*le tiers état*»<sup>2</sup>, domethënë masat e fshatarësisë dhe klerikët e varfër, kaluan në anën tjetër. Më vonë, kur kisha u

1. Frëngjisht — Mbledhja e përfaqësuesve të tri shtresave kryesore në Francë (e fisnikëve, e klerikëve dhe e shtresës së tretë), në prag të Revolucionit Demokratiko-Borgjez të 1789-s.

2. Frëngjisht — Shtresa e tretë, ku përfshiheshin të gjithë ata që nuk u përkisnin dy shtresave të para.

nda nga shteti, shkolla në përgjithësi u bë laike. Objektiviteti kryesor i borgjezisë ishte që në këtë shkollë të përgatiste kuadrot e saj. Borgjezia, si klasë ose shtresë e përparuar, në raport me feudalizmin e mykur, ishte progresiste dhe kishte në plan jo vetëm të sundonte, por edhe të shpejtonte zhvillimin në përgjithësi, që e kishin penguar monarkia e kalbur, kisha dhe vetë feudalizmi. Prandaj, në ato kohë morën zhvillim të mirë ekonomia, industria etj.

Kësaj borgjezie, pra, i duhej të krijonte inteligjencien e saj, kuadrot e vet ekonomikë, teknikë etj., sepse vetë zhvillimi që kishte nisur i kërkonte këta kuadro. Edhe bujqësia pësoi ndryshime, sido që fshatarësia mbetej përsëri nën sundimin e borgjezisë, në mos aq e shtypur si në feudalizëm, por prapë nën sundim ishte. Në atë kohë, pas revolucionit, pati përpjekje për të vendosur barazinë për të gjithë, për ndarjen e barabartë të tokës, jo për t'ia marrë këtë kishës, por për të ndarë në mënyrë të barabartë tokat e feudalëve etj. Këtë e propagandonin babëfistët, me ideologun e tyre Babëfin<sup>1</sup>. Babëfizmi është komunizmi utopist, krahu i majtë ekstrem i Revolucionit Demokratiko-Borgjez Francez. Duhet thënë se në përgjithësi të gjithë përkrahësit e revolucionit dolën nga masat e popullit. Borgjezia shoqërinë e re nuk e preu me thikë; ajo, sigurisht, mori edhe vese, tradita e njerëz të shoqërisë së mëparshme, por krijoi edhe kuadrot e vet. Po të studiojmë historinë, shikojmë zhvillime jo të barabarta

---

1. Fransua Noel Babëf (1760-1797), komunist utopist francez.

në këtë drejtim dhe sigurisht që kështu do të ndodhte.

Kurse në Itali ngjet ndryshe. Atje ku është qendra e Vatikanit, cerga e merimangës fetare ka shtrirje jashtëzakonisht të gjerë dhe shkollat fetare ekzistojnë. Kjo nuk do të thotë se borgjezia italiane s'ka përgatitur kuadrot e vet, por këta kuadro nuk e kanë atë frymën laike që kanë kuadrot francezë, të cilët kanë një shpirt më revolucionar. Intelektuali francez nuk shkon jashtë shtetit me frymën kozmopolite, por ai shkon atje që të përhapë kulturën franceze, sundimin e gjithçkaje franceze, kurse mentaliteti i kuadrove që ka përgatitur borgjezia italiane është i pleksur me ideologjinë fetare. Kështu truri italian emigron dhe shitet gjatë më shpejt edhe për arsye të zhvillimit të veçantë të borgjezisë italiane.

Edhe te ne kleri katolik ka ndjekur këtë qëllim, por nuk e arriti dot, sepse periudha qëkurse filloi të zinte vend ndikimi i fesë ishte e shkurtër. Megjithatë, përgatitjen e kuadrove, të inteligjencies katolike, kisha, në programin e saj, e kishte të theksuar. Këtij qëllimi i shërbenin shkollat, gjimnazet, shoqëritë etj. të asaj kohe. Në regjimin e Zogut (ndonëse ky regjim as e vriste mendjen për shkollat), elementët përparimtarë influencuan dhe kështu edhe te ne u hapën shkolla laike. Katolicizmit nuk iu pre koka, por iu prenë duart. Shkolla laike u hapën aq sa u hapën dhe lindi tendenca që, me mbarimin e këtyre shkollave, të kalohej në shkollat e larta të vendeve të huaja, që të merrej ai pak arsim i lartë që u mor. Prandaj vendi ynë në të kaluarën, duke qenë një vend i prapambetur, natyrisht, nuk kishte as kuadro. Kuadrot tanë, të vjetrit, kanë qenë



më tepër nëpunës administrativë të perandorisë turke. Ata ishin brumosur me frymën e nëpunësve të kësaj perandorie dhe s'dinin gjë tjetër veç merr rrogat, administro, mblihd taksa, qeveris etj. Meqë industri s'kishte, artizanët ishin, si të thuash, shtresa më e përparuar e shoqërisë, sepse ata prodhonin.

Kështu që te ne gati e tërë inteligjencia dhe kuadrot që kemi sot janë të rinj. Ata janë të lidhur me klasën organikisht, politikisht, ideologjikisht, administrativisht e teknikisht; janë të gjithë djem e vajza të dalë nga gjiri i popullit punonjës, të edukuar nga Partia. Prandaj ata kuadro të përgatitur para Çlirimit, që ruajnë mbeturina të së kaluarës, fryma dhe ideologjia e vjetër, ndonëse përpiqen të influencojnë te kuadrot e rinj, nuk do t'ia arrijnë dot qëllimit. Ky është një avantazh i madh, kolosal i punës ideologjike dhe praktike të Partisë, e cila jo vetëm luftoi fenë si ideologji e botëkuptim, por likuidoi edhe mjetet propagandistike e lufurgjike të saj dhe luftoi edhe atë ndikim të paktë që mund të helmatiste kuadrot tanë dhe sidomos inteligjencien tonë popullore.

Tani të vijmë te kjo që duam të theksojmë. Duhet të kemi kujdes se rreziku mund të na vijë nga të tëra anët. Ky, në përgjithësi, është i evitueshëm nga ana jonë, por me kusht që te kuadrot dhe tek inteligjencia jonë (dhe në këto dy kategori kemi parasysh deri edhe mjeshtrin, se edhe ai që drejton një repart është kuadër) të forcojmë bindjet politike në vijën e Partisë. Këtë vijë të Partisë duhet ta shpjegojmë mirë edhe historikisht, duke e lidhur me zhvillimin tonë shoqëror, të brendshëm e të jashtëm, sepse ka rreziqe që duhen

parandaluar. Inteligjencia jonë, në drejtim të zhvillimit të saj nga ana teknike, nuk mund të mbyllet në vetete. Partia duhet ta edukojë e t'i shpjegojë asaj çështjet politike, ideologjike, kulturore etj., dhe këtu duhet të insistojmë. Për sa u përket njohurive profesionale e teknike, këto ne, natyrisht, ia japim në universitetin tonë.

Bota borgjezo-kapitaliste ka zhvilluar dhe po zhvillon përditë shkencën dhe teknikën në shkallë të lartë, sepse i ka mjetet dhe mundësitë. Njerëzit tanë, sigurisht, nuk janë më pak të zgjuar, prandaj detyra jonë është që ta njohim këtë zhvillim e të përfitojmë prej tij, gjë që Partia e ka theksuar vazhdimisht. Kjo është e domosdoshme për përparimin e mëtejshëm të shkencës, të industrisë e të ekonomisë sonë në të gjitha drejtimet. Por këtu duhet të kemi parasysh se zhvillimi i mekanikës, i fizikës, i kimisë, i mjekësisë e i të gjitha shkencave të tjera që mësohen në universitet, jo vetëm nuk duhet të vihen mbi interesat e klasës punëtore, por të tëra të jenë, sikurse janë, në shërbim të saj, sepse ajo sundon mbi të gjitha. Pra, kuadrot tanë janë të lidhur organikisht me klasën që i ka nxjerrë, siç ishin dhe siç janë në shoqërinë kapitaliste mjeku, inxhinieri e të tjerë, që punojnë për interesat e klasës së tyre borgjeze. Çështja është se, duke u njohur me atë zhvillim të madh të shkencës e të teknikës së huaj, të arritur në një periudhë kohe shumë të gjatë, intelektualët tanë, në qoftë se nuk janë të ngritur sa duhet politikisht, mund të krijojnë përfytyrime jo të sakta për botën borgjezo-kapitaliste e t'u ngjallet ajo që ne i themi kulti i së huajës. Prandaj, në këtë drej-

tim duhet të bëjmë kujdes, veç jo duke u mbyllur portat kulturës e përparimit, por ideologjisë borgjezo-revizioniste dhe këtë ta kuptojmë mirë. Ndërsa borgjezia i përdor shkencën e teknikën për qëllimet e veta, ne i përdorim ato për qëllimet tona. Edhe në këtë drejtim, si kudo, duhet të paraprijë ideologjia e Partisë. Prandaj kuadrot tanë, kur shohin një makinë elektronike moderne, që i bën llogaritë me aq shpejtësi etj., të mos thonë «More, ku janë ata e ku jemi ne!», por të mendojnë që ne vërtet aktualisht jemi në këtë stad, veçse jemi në gjendje të përvetësojmë shkencën pa e bërë njeriun skllav të makinerisë automatike, të kësaj teknike, të këtij kombinati etj. Edhe klasa jonë punëtore është në gjendje të përgatitë kuadrot e vet për ta përvetësuar këtë shkencë e teknikë dhe për ta vënë në zbatim e në shërbim të popullit.

Çështjen e kuadrove Partia duhet ta shikojë mirë. Aktualisht vajzat dhe djemtë e popullit që mbarojnë shkollën e lartë, marrin kulturë të mirë dhe bëhen njerëz të zotë. Një shok që ka ardhur nga Parisi më thoshte se djemtë tanë, që kanë studiuar në Francë, kanë shkëlqyer në shkencat e natyrës edhe në krahasim me studentët e huaj, si, për shembull, djali i Ethem Gjinnushit e ndonjë tjetër. Nuk dallohen vetëm këta që kanë studiuar jashtë, por në përgjithësi të rinjtë tanë janë njerëz të përgatitur. Në qoftë se, kur dalin në jetë, ata ndeshen me një drejtues që nuk bën përpjekje për të zgjeruar intelektin e vet, që nuk di t'u përgjigjet atyre për problemet që dalin, atëherë respekti i intelektualëve të rinj për të do të jetë një respekt fiktiv. Në punë e sipër kuadri i ri do të kuptojë që ky shok,

qoftë sekretar i organizatës-bazë të Partisë apo drejtor i ndërmarrjes ose i institucionit, nuk qenka gjë, se zgjidhja që dha nuk është me vend dhe nuk i shërben punës.

Unë e pata fjalën për përgatitjen e inteligjencies, por u futu në të gjitha këto shpjegime për të treguar se sa shumë rëndësi ka përgatitja e kuadrit. Është e kuptueshme që kuadri drejtues që merret, për shembull, me sektorin e arsimit, me çështjet ushtarake ose me ndonjë punë tjetër, sado me eksperiencë të jetë, nuk është në gjendje t'i përgjigjet me kompetencë edhe një problemi që është jashtë sektorit ku ai punon. Në këtë rast kuadri i ri do ta kuptojë drejt këtë pozitë të shokut të vet drejtues. Por, kur kuadri drejtues, që është në krye të një sektori teknik, nuk është në gjendje t'u përgjigjet pyetjeve e kërkesave të specialistëve që ai ka në varësi, atëherë këta kanë të drejtë të thonë: «Ç'më rri ti atje?! Ne kemi respekt partie për ty, por ti nuk e meriton këtë vend, se edhe pengon punën, edhe krijon pakënaqësi!». Prandaj mund të lindë edhe pyetja: Po Partia pse nuk i shikon ose si i shikon këto gjëra?

Si konkluzion mund të them se inteligjencien duhet ta kemi në kujdes, se në përgjithësi e kemi të pastër, është një inteligjencie e re e dalë nga gjiri i klasës sonë punëtore dhe i fshatarësisë punonjëse që bënë revolucionin dhe ndërtojnë socializmin. Influenca e inteligjencies së vjetër gati nuk ekziston fare, kurse influenca e jashtme, siç thashë, është politiko-ideologjike, por është edhe teknike. Prandaj këto gjëra një-rëzit tanë duhet t'i kenë parasysh e të mos i nënvlef-

tësojnë. Është mirë që të bëhen edhe seminare për këto probleme në universitet.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Inteligjencia është pjesa më delikate për të tëra ato arsye që ju shtjelluat. Por këtu është problemi i tërë Partisë, se kjo luftë e madhe ideologjike, politike që ndërmerr Partia, nuk është e lehtë dhe njerëzit do të gabojnë sikur të mendojnë që i kuptuan përnjëherë të tëra gjërat, se këto janë probleme tepër serioze. Prandaj, duke u nisur nga ajo që thoni ju, është shumë e drejtë që Partia, me komunistët, me masat, me rininë dhe me tërë popullin, duhet të jetë përgjithësisht tepër e kujdesshme, bile të shtrohet këmbëkryq me ta për të biseduar e për të sqaruar edhe gjërat më të vogla. Vija e Partisë është e drejtë, revolucionare, e mbështetur plotësisht në marksizëm-leninizmin. Për këtë bindja është absolute në popull, në masat e rinisë dhe në masat e Partisë në veçanti, por ama neve nuk na duhet vetëm kjo bindje e përgjithshme, por duam bindje të thella, bindje politike. Këtu e kisha mendimin që ne duhet t'i qëndrojmë në kokë shumë e vazhdimisht kësaj pune, me inteligjencien po se po, por edhe me masat e tjera.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Është problem i gjerë edhe nga ana teknike. Por me anë teknike të mos kuptojmë vetëm teknologjinë etj., por edhe çështjen e drejtimit e të administrimit. Për këto biseduam mbrëmë edhe me shokun Hysni. Është me rëndësi absolute të administrosh shtetin, pasuritë e vendit, që asgjë të mos vejë dëm dhe nga çdo gjë të përfitojë populli, të mos bëhen abuzime e të mos shkelen ligjet. Për këtë qëllim kemi drejtorë bankash, kemi shefa të seksione-

ve të arsimit, të seksioneve të bujqësisë, të financave etj., me një fjalë të gjithë aparatin tonë shtetëror e kemi pak a shumë në format më revolucionare, më demokratike. Por kur financieri për shembull, krijon mendimin se ka arritur perfeksionin dhe se ato që bën ai janë plotësisht të drejta, të vërteta e të përshtatshme me periudhën dhe me detyrat edhe kur nuk janë të tilla, kjo jo vetëm mund të bëhet pengesë, por mund të shkaktojë edhe dëme.

Çështja e financës është me rëndësi të madhe dhe pikëpamje e qëndrime të tilla, si ato që përmenda, nuk duhet të ketë. Po pse ka? Sepse teknikisht financierët kanë arritur në vetëkënaqësi dhe teknikën nuk e kuptojnë lidhur me politikën e Partisë. Kur i japin paratë, për shembull, kanë parasysh vetëm që duhen dhënë, sepse janë caktuar apo se janë akorduar kreditë, pa i dhënë prioritet asaj që këto kredi duhen kontrolluar si përdoren e si realizohen, sepse shteti i proletarëve nuk ka dalë për sadaka: të japë para e pastaj, një mëngjes, të thuash se s'kam më para. Në qoftë se nuk ke para, atëherë pse i ke dhënë kreditë e përse nuk i ke kontrolluar?

Pse disa nuk i mendojnë kështu këto gjëra? Nuk i mendojnë, se artin e drejtimit, domethënë teknikën e administrimit, megjithëse hiqen sikur e dinë, në fakt, nuk e njohin si duhet; megjithëse hiqen sikur e kuptojnë politikisht, nuk e kuptojnë kështu. Ne e kemi ndihmuar dhe do ta ndihmojmë fshatarësinë, por brenda disa rregullave dhe pa shkelur ligjet e shtetit. Edhe fshatarësia duhet të punojë, edhe punëtorët duhet të punojnë që mirëqenia e popullit të ngrihet, të mos

dobësohet shteti ynë, të mos pengohet ndërtimi i socializmit. Prandaj na ka vënë Partia në këto vende drejtuese, që nga qendra e deri në bazë, dhe jo që të na rritet mendja duke thënë se ky ose ai është specialist i vjetër. Në qoftë se është specialist i vjetër, në sektorin e tij nuk duhet të ngjasin gabime e dëmtime, siç kanë ngjarë. Sigurisht që ndonjë gabim s'mund të evitohet, por jo të bëhet rrugë.

Prandaj, në këtë drejtim të ruhem nga influencat e huaja, nga mbeturinat që ekzistojnë te kuadrot dhe veçanërisht në inteligjencien tonë, pavarësisht se është e dalë nga klasa; gjithashtu të bëjmë kujdes që, jo t'i hedhim poshtë shkencën e teknikën e përparuar të vendeve të tjera, por t'i njohim e t'i përvetësojmë ato dhe t'i vëmë në shërbim të popullit e të ndërtimit të socializmit në vendin tonë, duke i pastruar nga pikëpamjet e huaja ideologjike, duke i përdorur ato me efektivitet. Ne bëjmë kursime. Kështu vepron edhe shteti kapitalist, por ai i përdor ato për xhepin e tij, kurse në shtetin socialist kursimet, që janë në rendin e ditës, venë në shërbim të popullit, në dobi të zhvillimit të forcave prodhuese. Gjithë kjo që thashë bën pjesë në vijën politike të Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga blseda  
e incizuar që gjendet në AQP*

# **NË ÇËSITJET KAPITALE TË MARKSIZËM-LENINIZMIT UDHËHEQËSIT KINEZË JANË REVIZIONISTË ME DAMKË**

**Shënime**

**1 shtator 1977**

**Pikëpamja kineze që mbron Tregun e Përbashkët Evropian dhe «Evropën e Bashkuar», është revizioniste më se e qartë, për arsye se Tregu i Përbashkët Evropian nuk është veçse një trajtë e eksportimit të kapitaleve publike (jo më private) në kuadrin e neokolonializmit dhe tipar i kësaj organizate është zhvillimi i integracioneve të ndryshme imperialiste. Sipas teorisë kineze, kapitali monopolist shtetëror është një transformim brenda stadi më të lartë të imperializmit, që i jep mundësi shtetit të kontrollojë deri në njëfarë shkalle monopolet kapitaliste private ose trustet dhe koncernet private. Këtë teori kinezët e bazojnë në atë që shteti kapitalist financon prodhimin privat, duke i dhënë atij subvencione dhe hua me çmime të reduktuara, gjithashtu duke financuar ndërmarrjet e konsumit ose të shërbimit publik, si, për shembull, shpenzimet parazitare për ushtrinë dhe policinë, shpenzimet sociale, si ato për sigurimet shoqërore, banesat e**



të tjera e të tjera. Pra, meqenëse shteti kapitalist bën pak a shumë një planifikim publik, revizionistët mendojnë se, duke e mbështetur këtë teori të kapitalit monopolist shtetëror, duke u futur brenda në shtetin kapitalist, ata mund të influencojnë dhe të dominojnë ekonominë kapitaliste pa luftëra, pa dhunë, por me reforma parlamentare.

Është e ditur se teoria revizioniste për kapitalin monopolist shtetëror në asnjë mënyrë nuk është vazhdim i teorisë së marksizëm-leninizmit, përkundrazi, ajo është një devijim nga teoria marksiste-leniniste. Lenini këtë çështje vetëm kalimthi sa e ka prekur në kohën e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, në vitin 1917, kurse Stalini as që e përmend fare. Teoria revizioniste për kapitalin monopolist shtetëror u zhvillua sidomos pas Luftës së Dytë Botërore.

Revizionistët nuk kanë mundur kurrë ta realizojnë teorinë e tyre për kapitalin monopolist shtetëror. Ata vetëm sa bëjnë një përmbledhje të mjeteve të reja të ndërhyrjes që disponon shteti në një stad të nivelit ekonomik, të cilat përbëjnë armën ekonomike të një tipi të ri të kapitalizmit, dhe thonë se kjo armë mund t'u japë mundësi forcave demokratike dhe revolucionare ta rikthejnë këtë treg të kapitalit monopolist shtetëror kundër monopoleve, duke marrë pikërisht nën kontrollin e tyre shtetin. Por kjo është vetëm një ëndërr.

Pra, kinezët, si të gjithë revizionistët e tjerë, sidomos perëndimorë, që e mbështetin me të madhe pikëpamjen sipas së cilës «Evropa e Bashkuar» duhet të jetë një unitet i fortë dhe se Tregu i Përbashkët Ev-

ropian duhet të forcohet, nuk futen thellë ta shpjegojnë këtë çështje, se nuk kanë argumente, nuk kanë mundësi teorike, prandaj ata e kanë lënë mënjanë shpjegimin teorik të saj. Qëllimin e tyre ata e kanë përcaktuar vetëm të shpjegimi që bëjnë se një grumbullim i tillë në një «Evropë të Bashkuar» dhe një forcim i Tregut të Përbashkët Evropian do t'i rezistojë sulmit iminent të imperializmit dhe të socialimperializmit sovjetik. Me këtë ata u thonë proletarëve që të harrojnë kontradiktat të cilat ekzistojnë në mes tyre dhe kapitalit; u thonë ta lënë shtetin kapitalist të veprojë në ndihmë të monopoleve dhe të interesave privatë të kapitalit; të mos ngrenë krye, të mos nxjerrin konkluzione teorike, praktike dhe revolucionare nga krizat e vazhdueshme dhe të rënda të kapitalit monopolist; u thonë të mos marrin masa për të luftuar papunësinë, urinë, shtypjen shoqërore që u bëhet atyre nga kapitali monopolist botëror dhe ai i vendit, në aleancë të ngushtë me njëri-tjetrin.

Pra, kinezët veprojnë si revizionistë me damkë në këtë çështje kapitale të teorisë sonë marksiste-leniniste dhe të praktikës së revolucionit.

Kinezët e dinë mirë se klasikët e marksizëm-leninizmit, në bazë të metodologjisë materialiste, e ndajnë kapitalizmin në dy faza (ose stadi): në kapitalizmin paramonopolist dhe në kapitalizmin monopolist ose imperializëm. Fazën e dytë, imperializmin, ata e kanë quajtur fazën më të lartë dhe të fundit, pas së cilës, nëpërmjet revolucionit proletar, në mënyrë të pashmangshme, vjen socializmi. Prandaj Lenini e ka quajtur imperializmin vigjilje të revolucionit proletar.

Renegatët e marksizëm-leninizmit janë përpjekur gjithmonë që kapitalizmin monopolist shtetëror ta ndajnë nga imperializmi si një fazë të veçantë, me tipare krejt të reja, duke e paraqitur atë edhe si «socializëm shtetëror». Edhe revizionistët kinezë e pranojnë tezën revizioniste se kapitalizmi monopolist shtetëror është një fazë e veçantë; për më tepër e shpallin atë si një fazë të domosdoshme që duhet kaluar nga çdo vend para se të arrihet në socializëm. Me fjalë të tjera, si dhe revizionistët e tjerë modernë, ata kërkojnë t'i zgjatin jetën kapitalizmit, kurse proletariatit dhe popujve t'u thonë që të presin sa të arrihet kjo fazë e domosdoshme, dhe, kur të jetë arritur, rruga për në socializëm nuk kalon nëpërmjet revolucionit proletar, por ky kalim duhet bërë me mjete paqësore, parlamentare, duke rënë në ujdi me partitë e tjera; domethënë predikojnë pluralizmin, krejt në kundërshtim me mësimin e Leninit që ka thënë se vetëm me anën e revolucionit dhe në revolucion, kapitalizmi monopolist shtetëror kalon drejtpërsëdrejti në socializëm. Kinezët nuk e thonë troç këtë, por teza e tyre e unitetit dhe e aleancës së «botës së tretë» me «botën e dytë», duke shuar divergjencat me vendet kapitaliste dhe imperialiste të dikurshme, dhe e aleancës së këtyre dy botëve me imperializmin amerikan kundër socialimperializmit sovjetik, nuk tregojnë gjë tjetër veçse rrugën trockiste që kanë marrë udhëheqësit revizionistë kinezë.

Lidhjet që krijon Kina me ekonominë botërore kapitaliste, përbëjnë një mbështetje që ajo u jep neokolonializmit dhe zhvillimit të kapitalit monopolist financiar botëror. Kina është një nga mbështetëset

dhe përfitueset e eksportimit të kapitaleve të huaja që bëhen atje.

Prandaj çështja kineze nuk është shumë e thjeshtë. Kinezët, nga megalomania e shtetit të madh, mendojnë se të tjerët mund të tërhiqen prej tyre, se mund të mashtrohen nga demagogjia e tyre, por maska që kanë vënë ata, është e qepur me pe të bardhë.

Leninizmi na mëson se duhet të mposhtet kapitalizmi që të fitojë socializmi dhe të vendoset shoqëria socialiste. Prandaj është absolutisht e domosdoshme që masat punonjëse të një vendi, të udhëhequra nga proletariati me partinë e tij komuniste marksiste-leniniste në krye, të luftojnë vazhdimisht dhe në luftë të krijojnë ndërgjegjen klasore dhe bindjen e patundur se vetëm me luftë përmbysët kapitalizmi dhe shoqëria kapitaliste shndërrohet në shoqëri socialiste. Në luftën kundër kapitalizmit krijohet dhe rritet edhe ndërgjegjja e klasës.

Si teoria e «tri botëve», ashtu edhe teoria titiste e «vendeve të paangazhuara» janë pjellë e teorisë absurde për marrjen e fuqisë nga ana e proletariatit në rrugë parlamentare. Të flasësh për marrjen e fuqisë në këtë rrugë (gjë që në kushtet e sotme është e pamundur), do të thotë të bësh një ndarje artificiale të luftës politike nga lufta ekonomike dhe këtë luftë ta kanalizosh e ta futësh në një sërë ligjesh, organizimesh dhe rregullimesh që ka bërë borgjezia më parë. Pra, parlamentarizmi nuk shtyn proletariatin drejt revolucionit, por ndihmon kapitalizmin, duke e mbrojtur atë që të ecë i qetë. Me një fjalë, edhe rendin borgjez, që është vendosur me kohë në Jugosllavi e që po ven-

doset tash në Kinë, këto teori e ndihmojnë që të zhvillohet në mënyrë normale dhe të ketë një ecje të qetë. Sipas këtyre dy teorive, në vendet e të ashtuquajturave botë e tretë ose botë e paangazhuar grevat e punëtorëve duhet të kenë vetëm karakter ekonomik, ose disa herë vetëm karakter politik, por me kusht që t'i përshtaten rrugës parlamentare. Kjo do të thotë që grevat të jenë të shpërndara, të kufizuara, domethënë të bëhen në kuadrin e një, dy ose tri fabrikave, por jo të jenë greva të përgjithshme kombëtare me karakter revolucionar luftarak. Kjo do të thotë, gjithashtu, që klasa punëtoresh të udhëhiqet në këto greva nga lëvizjet sindikale të drejtuara, natyrisht, nga partitë socialiste, socialdemokrate etj., të cilat bëjnë llogje për zhvillimin paqësor të kapitalizmit dhe mendojnë që me këto greva të arrihet në disa reforma, ose në sigurimin e disa mjeteve për të edukuar klasën punëtoresh që ajo gjoja mund të marrë pushtetin e të ndërtojë socializmin në rrugë parlamentare dhe paqësore.

Aktualisht shohim se kontradiktat e sistemit kapitalist ushqejnë kombativitetin e proletariatit, i cili me frymë luftarake hidhet në një luftë me të vërtetë revolucionare. Një grevë e përgjithshme, e pandalshme, një kundërshtim i tillë i madh nga ana e klasës punëtoresh dhe e masave punonjëse për çështje themelore politike dhe ekonomike, bëjnë që të tronditet shteti i kalbur borgjez. Lufta e proletariatit në një formë të tillë i hedh në revolucion të ndërgjegjshëm masat që e ndjekin e që dëshirojnë të ndërrojnë mënyrën e jetesës dhe shoqërinë. Kur klasa dhe partia e saj mar-

ksiste-leniniste qëndrojnë në ballë të kësaj lufte, ato e çojnë atë drejt objektivit të shkatërrimit të shtetit kapitalist dhe zëvendësimit të tij me diktaturën e proletariatit. Në greva dhe në përpjekje të tilla proletariati dhe klasat e shtypura e të shfrytëzuara bëjnë një shkollë të madhe. Në rast se një gjendje e tillë revolucionare vazhdon për disa muaj, kjo është një lloj sikur masat të kenë bërë një shkollë prej shumë vjetësh.

Prandaj shohim që revizionistët modernë, e veçanërisht titistët, spanjollët, francezët, italianët dhe kinezët, nuk flasin më për revolucionin dhe për diktaturën e proletariatit, nuk flasin më për hegjemoninë e klasës punëtore, por flasin për zhvillim normal dhe paqësor qoftë edhe të grevave me karakter ekonomik ose dhe politik, në kuadrin e një zhvillimi normal të shoqërisë borgjeze. Veçanërisht titistët dhe kinezët këtë anë e kanë shumë të theksuar. Ajo që thonë ata, se janë kundër dy superfuqive, është një formulë sa për t'u mbuluar, se ndryshe do të demaskoheshin plotësisht. Por, në fakt, të dyja palët, dhe veçanërisht kinezët, me teorinë e «tri botëve», jo vetëm që nuk predikojnë lëvizjen revolucionare, lëvizjen greviste të përgjithshme me karakter politik dhe ekonomik kundër fuqive kapitaliste sunduese, por u bëjnë thirrje proletariatit të këtyre vendeve dhe masave të shtypura që të bashkohen me këdo, pra të bëhen një edhe me udhëheqjet e tyre borgjeze-kapitaliste.

Kinezët thonë se Bashkimi Sovjetik, i cili kërkon ekspansion, do të sulmojë Evropën. Këtë e kemi thënë

edhe herë tjetër dhe ka mundësi që ai ta bëjë një gjë të tillë, por çështja është se vetë kinezët kanë frikë që sovjetikët mund të sulmojnë edhe Kinën dhe, për ta mënjanuar këtë sulm ndaj tyre, kanë ngritur tezën se sovjetikët po rrezikojnë Evropën, me qëllim që ta shtyjnë Bashkimin Sovjetik drejt Evropës dhe t'u nxjerrë kështu kinezëve gështenjat nga zjarri. Por, në qoftë se Bashkimi Sovjetik do të shpallë luftë, mendoj se ai do ta bëjë këtë më parë kundër Kinës, sepse, si një shtet i madh socialimperialist që është, sulmon në atë drejtim ku mendon se «fronti» është më i dobët e i sjell fitime dhe sepse mendon që Kina rrezikon kufijtë e Bashkimit Sovjetik. Kina kërkon që këta kufij të ndryshohen, prandaj, për të mënjanuar një sulm kinez, ka shumë mundësi që sovjetikët ta sulmojnë Kinën më parë. Prandaj, në qoftë se do të vihet çështja kë do të sulmojë në fillim, Kinën apo Evropën, Bashkimi Sovjetik më parë mund të sulmojë Kinën. (Natyrisht në qoftë se nuk sulmohet më parë Bashkimi Sovjetik nga Evropa, nga ndonjë shtet, ose më mirë të themi nga një koalicion shtetesh, me një fjalë nga NATO-ja, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye.)

Por çështja qëndron në atë që Kina, për të fshehur frikën dhe për të realizuar ëndrrat e saj, i acaron akoma më tepër kontradiktat në vendet e tjera të botës dhe veçanërisht në Afrikë, duke thurur intriga në mes amerikanëve dhe sovjetikëve. Të tre këta kërkojnë të ngrohen në diellin afrikan, prandaj i acarojnë kontradiktat në mes tyre, kërkojnë aleatë në mes udhë-

heqësve borgjezë-kapitalistë të vendeve afrikane dhe pengojnë popujt dhe proletariatin e këtyre vendeve të zhvillojnë revolucionin. Këtu qëndron antimarksizmi i tërbuar i kinezëve.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, "Shënime për Kinën", vëll. II, f. 585*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, "Shënime për Kinën", vëll. II, f. 585*



# **PËRGATITJA TEKNIKE DHE NIVELI IDEOPOLITIK TË MATEN ME REALIZIMIN E DETYRAVE**

**Shënime**

**6 shtator 1977**

Duke gjykuar situatën e naftës, konstatoj (dhe këtë konstatim ua vura në dukje shokëve sekretarë të Komitetit Qendror) se nuk organizohen kurse teknike të shkallëve të ndryshme për kualifikim të mëtejshëm me punonjësit e naftës, po mjaftohet me atë kurs që punonjësi, tekniku ose inxhinieri ka bërë në shkollën ose në kursin që ka kryer dhe për ta ekziston vetëm puna praktike. Mirëpo vetëm puna praktike nuk është e mjaftueshme, e mjaftueshme nuk është as puna politike.

Partia bën shumë punë politike me naftëtarët për çdo problem, por shihet se politika e Partisë nuk zërithehet në çështjet teknike, prandaj përgatitja teknike e naftëtarëve nuk i përgjigjet si duhet ngritjes politike. Në raportet që kam lexuar vihet në dukje se nga ana teknike ngjasin avari, ka mungesë disipline shkencore, ka punonjës që i zë gjumi në punë e sipër, ka parashikime të gabuara, gjeologë dhe deri njerëz të caktuar në pusët nuk zbatojnë me përpikëri të gjitha proceset dhe kërkesat teknike të punës etj.

Këto ngjasin, më duket mua, për dy arsye: e para, sepse teknikisht punonjësit e sektorit të naftës nuk organizohen që të studiojnë për t'u ngritur nga ana profesionale e ideologjike, dhe e dyta është se në këtë sektor nuk veprohet si në të gjitha ndërmarrjet e tjera. Gjeologu jep pikën, pa doli ose nuk doli naftë, s'ka asnjë përgjegjësi materiale për të; tekniku e shtrëngoi mirë vidhën e astës apo nuk e shtrëngoi mirë, edhe ky «ku rafsha, mos u vrafsha». U bë avaria, «e po u bë», thonë, dhe atij që ka përgjegjësi vetëm një kritikë i bëhet në organizatën-bazë; duhet hequr apo nuk duhet hequr sonda, veprime të tilla bëhen si pa gjë të keqe, pa lejen e Qeverisë ose të ministrisë, e cila vendos se në ç'pikë do të bëhet shpimi. Këto gjëra, më duket mua, nuk janë vetëm çështje politike e nuk kanë të bëjnë vetëm me disiplinën teknike, por duhen lidhur edhe me të ardhurat vetjake që merr nga puna çdo punëtor. Prandaj, ashtu siç punojnë me norma në ndërmarrjet e tjera industriale, ashtu siç punojnë në bujqësi, ashtu duhet të punojnë edhe në sektorin e naftës që nga gjeologët, inxhinierët, teknikët dhe deri te punëtorët më të thjeshtë.

Kur nuk jepen pika për shpim, vihet pyetja: Pse nuk jepen? Në qoftë se nuk jepen, atëherë kjo duhet të reflektohet në të ardhurat e gjeologëve. Në qoftë se jepen pika dhe llogaritë bëhen të gabuara, pa zbatuar si duhet të gjitha masat teknike për verifikimin e vendit, atëherë edhe kjo duhet të reflektohet në të ardhurat e gjeologut dhe të inxhinierit. Në qoftë se ndodh një avari, këtë duhet ta ndiejnë në pagë që të gjithë. Duhet të caktohet sa duhet të shpojë sonda në

minutë, se shifrat e caktuara mund të jenë në bazë normale të vjetra, por këto as mbahen, as kontrollohen dhe as përgjigjet njeri teknikisht dhe ekonomikisht për këto.

Prandaj, këto probleme duhet të bëhen objekt i një studimi të veçantë në Ministrinë e Industrisë e të Minerave, pse ka vite që nuk po zbulojmë fusha të reja naftë. Aktualisht konstatoj se sondat janë grumbulluar në vendburimet ekzistuese, kurse në fusha të reja ka shumë-shumë pak sonda. Specialistët e naftës u janë qepur vendeve të njohura ku bëhet shfrytëzim, pse në to diçka merret, pa gjë s'mbeten dhe me këtë ata mbulojnë mungesat e mëdha të zbulimit të fushave të reja, për të cilat ka nevojë absolutisht të domosdoshme ekonomia jonë. Kështu, kur zbulojmë një pus si ky i fundit, mungon krejt disiplina shkencore, gjë që rrezikon shtresën. Prandaj, për këto çështje duhet një rishikim i punës, u propozova shokëve sekretarë të Komitetit Qendror.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **Ç'ËSHTE ZYRA E PËRGJITHSHME NË KINË?**

**Shënime**

**7 shtator 1977**

Agjencia HSIHUA transmetoi artikullin me titull «Të kemi gjithnjë në mendje mësimet e kryetarit Mao dhe të këmbëngulim në vazhdimin e revolucionit nën diktaturën e proletariatit», të cilin më 8 shtator do ta botojë gazeta «Zhenminzhibao». Ky artikull është shkruar nga grupi i «studimeve teorike» i Zyrës së Përgjithshme të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, për të përkujtuar përvjetorin e parë të vdekjes së kryetarit Mao Ce Dun.

Theksoj se ky është artikull i Zyrës së Përgjithshme të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës. Për herë të parë dëgjojmë që një zyrë e tillë ekziston në Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, por me funksione krejt të tjera nga ato që kanë këto zyra të përgjithshme në aparatet e partive komuniste dhe punëtorë të ndërtuara sipas tipit leninist dhe sipas teorisë marksiste-leniniste.

Ky artikull në fillim vë në dukje se «Mao Ce Duni është marksisti më i madh i kohës sonë», domethënë Mao Ce Duni qenka më i madh se Stalini po se po (që

kinezët s'e kanë pasur kurrë në konsideratë), por edhe nga Lenini, bile edhe nga Marksi e Engelsi!

Përveç kësaj, më poshtë në këtë artikull shkruhet se «Shoku Hua Kuo Fen, pasuesi i zgjedhur prej vetë Maos, e ka udhëhequr gjithë partinë në shpartallimin, me një të goditur, të bandës antiparti të «të katërve». Van Hun Venit, Çan Çun Çiaos, Çian Çinit dhe Jao Ven Juanit, duke shpëtuar kështu revolucionin dhe partinë. Duke mbajtur lart flamurin e madh të kryetarit Mao, udhëheqësi ynë i urtë, kryetari Hua, ka çuar përpara traditën revolucionare» etj., etj. Këto dy citate të fillimit të këtij artikulli, siç do ta shohim më poshtë, meritojnë një vëmendje të madhe. Ato nuk janë të rastit dhe nuk janë thjesht ditirambike, por kanë lidhje me çështjet organizative dhe të drejtimit të Partisë së ashtuquajtur Komuniste të Kinës. Pra, si do ta shohim më vonë, në bazë të këtij artikulli udhëheqësi vendimtar i vetëm i kësaj partie, i ushtrisë dhe i popullit është kryetari Mao Ce Dun dhe tash, pas tij, kryetari Hua Kuo Fen. Të gjithë të tjerët janë në këmbët e tyre dhe duhet t'u binden mendimeve e urdhrave të kryetarit.

Në këtë artikull për veprën e Maos shkruhet se «Kontributi i tij monumental do të jetojë sa bota dhe do të ndriçojë si dielli. Flamuri i madh i ideve të Mao Ce Dunit është flamuri i fitores së revolucionit të popullit kinez dhe i revolucionit të popujve të botës».

Tash të vijmë në thelbin e çështjeve. Zyra e Përgjithshme e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës përbëhet nga një personel, numri i të cilit nuk dihet, se nuk thuhet, vetëm shpjegohet se në këtë

personel të kësaj Zyre të Përgjithshme ka komandantë dhe luftëtarë të njësisë 8341 të Ushtrisë Çlirimtare Popullore.

Ç'është kjo njësi numër 8341? Ne nuk mund ta përcaktojmë dot, se nuk jepet ndonjë shpjegim, por, siç është thënë nga vetë kinezët, ky është reparti i rojave të sigurimit, që ruanin Mao Ce Dunin, dhe kur thuhet reparti i rojave të Maos, kuptohet që ky do të ketë qenë një repart i madh me të gjitha mjetet. Personeli i kësaj Zyre të Përgjithshme udhëhiqej nga kryetari Mao dhe vetëm nga ai, dhe pra ky personel «ishte i lumtur që përkrahte dhe mbronte Mao Ce Dunin», i cili e brumosi këtë me idetë e tij.

«Ne, — thuhet në artikull, — do të donim të kujtonim kursin luftarak që morëm nën udhëheqjen e tij si dhe këshillat e tij që të ngrohnin zemrën, të cilat do të na inkurajojnë edhe më shumë për të ecur përpara fitimtarë sipas vijës së tij revolucionare proletare».

Nga leximi i mëposhtëm i artikullit kuptohet se përmbajtja e tij nuk është një gjë e thjeshtë, nuk është njëjloj siç mund të shprehet një komitet partie ose një drejtori ndërmarrjeje që «ne u udhëhoqëm nga këshillat e kryetarit Mao në fitore». Jo. Në bazë të analizave të mëposhtme të këtij artikulli del se Mao Ce Dani udhëhiqte vetëm me këtë personel të Zyrës së Përgjithshme; se kjo zyrë ishte e plotfuqishme, mbi Byronë Politike, mbi Sekretariatit, mbi Komitetin Qendror dhe mbi nënkryetarët e Komitetit Qendror; del gjithashtu se kjo zyrë përngjet si dy pika uji me atë të Këshillit të Sigurimit Kombëtar që krijon pre-

sidenti amerikan mbi qeverinë dhe mbi partinë, i cili merr masa, vepron dhe u imponon ministrave ose organeve të tjera politikën e tij të diskutuar dhe të miratuar vetëm në Këshillin e Sigurimit. Pra, Maoja e bënte politikën me personelin e Zyrës së Përgjithshme të Komitetit Qendror të Partisë.

Ku e bazojmë këtë konkluzion? Pikërisht në atë që thuhet në këtë artikull, se, duke qenë një sektor i rëndësishëm i Komitetit Qendror të Partisë, «Zyra e Përgjithshme kishte detyrat e ruajtjes së kryetarit Mao dhe të Komitetit Qendror të Partisë, si dhe të trajtimit të çështjeve shumë sekrete të partisë dhe të problemeve të tjera të rëndësishme. Ishte çështje e një rëndësie praktike për interesat themelore të të gjithë partisë, të të gjithë ushtrisë dhe të të gjithë popullit në të gjithë vendin nëse udhëheqja e Zyrës së Përgjithshme qëndronte në duart e shtabeve proletare të kryesuara nga kryetari Mao, si dhe nëse arrihej plotësisht sigurimi i kryetarit Mao, i Komitetit Qendror të Partisë dhe i çështjeve shumë sekrete të partisë». Pra nga artikulli bëhen të qarta kompetencat e kësaj zyre. Me pak fjalë, në qoftë se kjo Zyrë e Përgjithshme ekzistonte, atëherë gjithë vendi, gjithë partia, gjithë shteti drejtohehin prej saj dhe kjo merrte urdhra e direktiva nga Maoja.

Sipas këtij artikulli, qoftë grupi i Liu Shao Çisë, qoftë Lin Biaoja, qoftë grupi i «të katërve» janë përpjekur që ta futnin nën drejtimin e tyre këtë Zyrë të Përgjithshme të KQ të Partisë. Nga ky artikull del që Liu Shao Çia u përpoq të fuste në këtë zyrë njerëzit e tij, domethënë shtabin borgjez, dhe u angazhua në komplete antiparti; që grupi i Liu Shao Çisë e kishte

hedhur në dorë Zyrën e Përgjithshme, sepse tash kuptohet që Mao Ce Duni nuk e kishte më atë fuqi që kishte pasur më parë në këtë zyrë; që tërë drejtimin e kishte marrë Liu Shao Çia, ndërsa kryetari Mao kishte mbetur me gisht në gojë. Prandaj kuptohet pse ai ngriti në këmbë hunveibinët.

Ne atëherë mendonim se Mao Ce Duni gaboi që nuk u mbështet te partia dhe nuk e zgjidhi këtë çështje me anë të partisë, kurse tash kuptohet shumë qartë: ai ngriti hunveibinët, sepse partia i kishte ikur atij nga pushteti. Gjithçka atje ishte në duart e Zyrës së Përgjithshme, ku kishte hedhur thonjtë Liu Shao Çia. Pra, Mao Ce Duni duhet të ngrinte në revolucion elementët jashtë partisë. Këtu e ka shpjegimin pse u ngrit «Garda e kuqe» dhe pse u dha urdhri «të sulmohen shtabet». Thirrja «të sulmohen shtabet» tash shpjegohet lehtë dhe kjo donte të thoshte në radhë të parë të kapej Zyra e Përgjithshme, sepse kjo zyrë drejtonte gjithë vendin, kurse çdo gjë tjetër, partia, bashkimet profesionale, ishin vetëm fasada dhe në funksion të kësaj zyre. Prandaj Revolucioni Kulturor ishte për rimarrjen e drejtimit të Zyrës së Përgjithshme, të cilën Maos ia kishin rrëmbyer Liu Shao Çia, Ten Hsiao Pini e të tjerë. Këtë e vërteton edhe artikulli, ku thuhet: «Kryetari Mao na udhëhoqi në demaskimin e krimeve antiparti të kryera prej tyre (domethënë prej bandës së Liu Shao Çisë) në Zyrën e Përgjithshme, duke i zhveshur nga funksionet e tyre dhe duke e vënë Zyrën e Përgjithshme edhe një herë në duart e shtabeve proletare».

Kjo u përngjet kohëve të zotërve të luftës, të ci-



lët, në provincat ku sundonin, bënë si të donin; pa-  
varësisht se kishte njëfarë administrate, në të gjitha  
territoret ku sundonin, ata kishin njerëzit e tyre në  
disa vende kyç dhe nëpërmjet këtyre ushtronin sun-  
dimin.

Artikulli i kësaj zyre që bënte çdo gjë, nuk zgjatet  
shumë me këtë çështje, por na hedh në prill të vitit 1966  
dhe thotë se «Ne përpiluam një libër me citate të zgje-  
dhura të kryetarit Mao në përputhje me novojat e luftës  
dhe ia dërguam kryetarit Mao për miratim». Pra libri i  
kuq i citateve të Mao Ce Dunit nuk qenka vepra e Lin  
Biaos, por e kësaj Zyre të Përgjithshme, kurse Lin  
Biaoja, i cili natyrisht ishte njeri me influencë dhe i  
dyti pas Maos, i dha bujë të madhe këtij libri me ci-  
tate.

Janë të çuditshme funksionet që ka kjo zyrë. Në  
artikull thuhet: «Kryetari Mao na udhëzoi se duhej ta  
drejtonim lëvizjen në mënyrë të tillë që t'u përshta-  
tej natyrës dhe karakteristikave të punës së Zyrës së  
Përgjithshme dhe të frenoheshim nga vendosja në  
sbkallë të gjerë e kontakteve me shoqërinë, me qëllim  
që të siguronim funksionimin normal të zyrës në të gji-  
thë punën në shërbim të Komitetit Qendror të Partisë».  
A nuk është ky një shpjegim shumë i qartë, që s'ka  
nevojë për shpjegime të tjera, për sa u përket kom-  
petencave të mëdha e të çuditshme të Zyrës së Për-  
gjithshme? Kjo zyrë ka drejtuar «Revolucionin e Madh  
Kulturor», por çdo gjë nuk shkoi si në gjalpë, sepse,  
sipas njerëzve të Zyrës së Përgjithshme, «Lin Biaoja  
bashkëpunoi me «bandën e të katërve» dhe, në më-  
nyrë flagrante, veproi në kundërshtim me udhëzimet

e kryetarit Mao». «Në një përpjekje për të uzurpuar pushtetin, — vazhdon artikulli, — ata dërguan shpesh lakenjtë e tyre në këtë zyrë për të shkaktuar erëra të dëmshme, nxitën trazira, organizuan sulme të fshehta, përhapën mashtrime të tilla reaksionare si «të gjithë të dyshimtë», goditën kuadrot udhëheqës revolucionarë, i shtynë njerëzit të komplotonin me të jashtëmit dhe, në orvatje të kotë për të uzurpuar pushtetin në Zyrën e Përgjithshme, çirreshin se «Çungnanhai duhej të hidhej në kaos»».

Ç'duan të thonë të gjitha këto? Duan të thonë që as Lin Biaoja, as Çu En Lai, as anëtarët e tjerë të byrosë e asnjeri tjetër nuk kishte të drejtë të përzihej në punët e Zyrës së Përgjithshme. Kjo, me Maon në krye, ishte e plotfuqishme të vepronte, të drejtonte gjithë Kinën, gjithë sektorët e jetës në Kinë. Anëtarët e Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror nuk kishin të drejtë të propozonin kuadro të përshtatshëm për këtë zyrë. Në qoftë se dikush propozonte dhe arrinte të kishte në këtë zyrë njerëz më të përshtatshëm, ai konsiderohej si komplotist dhe komploti natyrisht ngrihej, sipas tyre, nga kuantitativ në kualitativ, siç ndodhi në fund me grupin e «të katërve», që gjoja kërkonin të merrnin pushtetin me forcë.

Kryetari Mao i paskësh parë të gjitha këto; gjithashtu paskësh parë edhe se Çian Çini ishte bashkuar me Lin Biao dhe komplotonte e, siç thotë artikulli, «duke u bazuar mbi gjendjen e kësaj lufte, kryetari Mao dha udhëzime të veçanta lidhur me lëvizjen në Zyrën e Përgjithshme. Lëvizja vazhdoi në forma

të shumëllojta sikundër kërkohej nga rrethanat e ndryshme dhe u morën masa efikase për mënjanimin e ndërhyrjeve. Kjo i edukoi masat dhe i dha mundësi lëvizjes të përparojë mirë».

Sipas artikullit, kontradiktat u trashën, pse Çian Çini, pas incidentit të 13 shtatorit të vitit 1971, kur u zhduk Lin Biaoja, e shtyrë gjoja nga motivet e saj kundërrevolucionare, «shpifi poshtërsisht kundër njësisë 8341», me qëllim që të shpartallonte Zyrën e Përgjithshme të Komitetit Qendror dhe njësinë.

Pra, duhet të nxjerrim përfundimin se udhëheqësit e tjerë të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike e të Sekretariatit as që dëgjoheshin dhe, si pasojë, dëshironin që të ndryshohej kjo situatë. Supozojmë se ata janë përpjekur që të vendoseshin norma të reja organizimi e drejtimi dhe të likuidohej një situatë e tillë që pengonte, pse këtu vetëm Mao Ce Duni dëgjohej, dhe ky vepronte nëpërmjet kuadrove të Zyrës së Përgjithshme e të këtij reparti.

Sipas artikullit, edhe «katërshja», ashtu si Liu Shao Çia, «për arritjen e qëllimit të saj djallëzor, punoi pa pushim për të rrëmbyer pushtetin udhëheqës në Zyrën e Përgjithshme të Komitetit Qendror». Këtë del se me grushtet e shtetit, qoftë të Liu Shao Çisë, apo të Maos, të Lin Biaos, apo të të ashtuquajturit grup i të katërve, qoftë edhe ky i Hua Kuo Fenit, të gjithë janë përpjekur kush e kush ta kishte në dorë këtë Zyrë të Përgjithshme dhe organizoheshin puç pas puçi.

Në artikull shkruhet: «Në shumë raste «banda e të katërve», prapa shpinës së kryetarit Mao, donte t'i

shpërndante në të gjithë vendin dokumentet, fjalimet dhe incizimet e bëra prej tyre», pa iu përmbajtur udhëzimit të kryetarit Mao që «të gjitha dokumentet e telegramet e nxjerra në emër të Komitetit Qendror të Partisë mund të dërgohen vetëm mbasi t'i kem parë unë; përndryshe ato janë të pavlefshme». Artikulli thekson se «ne i raportuam kryetarit Mao për orvatjet e tyre. Kryetari Mao e censuroi «bandën e të katërve» për planet e tyre të poshtra dhe demaskoi qëllimet e tyre djallëzore».

Pra, kuptohet qartë se Mao Ce Duni, si një diktator, nuk lejonte që ndonjë nga bashkëpunëtorët e tij, anëtarë të Byrosë dhe anëtarë të Sekretariatit ose të Komitetit të Përbërshëm të Byrosë Politike, të mund t'u jepte direktiva Komitetit Qendror, partisë, repartëve ushtarake, administratës etj. Çdo veprim i tyre, pa dijeninë e Maos, konsiderohej djallëzor.

Natyrisht, duke qenë përpara një situatë të tillë, «banda e të katërve» është përpjekur që ta ndryshojë këtë gjendje, dhe këtë veprim të saj, autorët e artikullit e quajnë komplot që synonte të shtinte në dorë Zyrën e Përgjithshme dhe komisarët politikë të njësisë 8341. Kështu që përpjekja e saj dështoi. Artikulli i shkruar nga personeli i kësaj zyre thotë që «Maoja na inkurajoi dhe na mbrojti vazhdimisht. Kryetari Mao vazhdimisht e inkurajonte personelin e tij punonjës për t'u ngritur kundër Çian Çinit». Pasi erdhi në fuqi Hua Kuo Feni, mori në dorëzim edhe Zyrën e Përgjithshme. Është e qartë, vazhdon artikulli për «katërshen», se tashmë «orvatja e tyre synonte të priste lidhjet e kryetarit Hua e të Komitetit Qendror me ba-

zën dhe të merrte përgjegjësinë për të lëshuar urdhra në të gjithë vendin. Ata vodhën sekrete të partisë. qëllimisht mënjanuan rojat tona dhe kryen veprimtari klandestine kudo».

Kuptohet se ç'pushtet të madh e të fuqishëm kishin kjo zyrë dhe ky repart special. Pra, kryetari Hua vendosi të ndërmernte një veprim të menjëhershëm kundër «katërshes», kështu që njësia 8341, tani nën udhëheqjen e kryetarit Hua dhe nën komandën e drejtpërdrejtë të tij e të nënkryetarit Jeh, zbatoi me vendosmëri urdhrin gjoja të Komitetit Qendror dhe e arrestoi «bandën e të katërve». Ky pushtet i madh e i fuqishëm, po citoj artikullin, «u dha mundësi zyrës dhe njësisë sonë të vazhdonin të bënin përparime mes një lufte të ashpër klasore gjatë rrugës së vazhdimit të revolucionit nën diktaturën e proletariatit dhe siguroi funksionimin normal të të gjitha degëve të punës, të tilla si ruajtja dhe shërbimi ndaj kryetarit Mao», e tashti të kryetarit Hua Kuo Fen, të dy këta «xhevahirë» të rrallë.

Për udhëheqjen e punëve nga Maoja në artikull jepen edhe shembuj. Për të konstatuar se si shkonin kooperimi bujqësor dhe blerja e grurit nga shteti, Maoja urdhëroi të caktohej një person nga çdo prefekturë dhe ky të punonte në njësinë e rojës së tij personale. Ai e konsideronte hetimin nga ana e këtyre njerëzve të rojës së tij personale në zonat fshatare si një gjë me rëndësi për të kontrolluar gjendjen atje. Prandaj, sipas artikullit, Maoja mbledhi personelin e Zyrës së Përgjithshme të Komitetit Qendror dhe efektivin e njësisë 8341 dhe u shpjegoi «të mirat e hetimeve, çfarë

të hetosh dhe si ta bësh atë», u shpjegoi me hollësi rojave të tij «të mirat e kryerjes së hetimeve në fshatrat e tyre të lindjes». Kur ata në fund u kthyen e i raportuan, — gjithnjë sipas artikullit, — Maoja u tha: «M'u deshën vetëm tri orë që të mësoja për gjendjen e 60 milionë njerëzve në dy provinca. Kjo është me të vërtetë një metodë e shkëlqyer. Ju keni shërbyer si hallkë midis meje dhe masave të fshatarëve». Artikulli vazhdon: «Duke bërë gjeste me lëvizjen e tri gishtave, kryetari Mao tha: «Ju keni takuar fshatarët dhe unë ju kam takuar ju. Kështu, unë jam takuar në mënyrë të tërthortë me fshatarët midis kësaj distance. Ju jeni fshatarë me armë dhe me ndërgjegje klasore».

A mund të imagjinohet nga marksistë-leninistët e vërtetë një punë e tillë e katandisur në rojat personale të sigurimit ose në disa nëpunës burokratë të një zyre administrative, të cilët janë të vënë që të kontrollojnë 60 milionë ose 800 milionë fshatarë se si jetojnë e si punojnë? Dhe Maoja i konsideron këto roja si njerëz me ndërgjegjen e klasës, pa përfillur që për këtë çështje kaq të madhe, domethënë për fatin e kooperativizmit në Kinë, duhet të futë në lëvizje dhe të ngarkojë partinë që të kontrollojë! Tash ne i kuptojmë thëniet e Maos drejtuar shokëve tanë më 1966: «Ç'të mbështetesh te sekretarët e partisë, të cilët shiten për një kile mish derri?». Mao Ce Duni i ka thënë këto tekstualisht kështu përpara shokëve të delegacionit tonë të Partisë e të Qeverisë, ku bënte pjesë edhe Hysniu, dhe kjo tregon përçmimin që kishte Mao Ce Duni për partinë, ose mendimin e tij për mosekzistencën e saj. Ai bazohet vetëm në rojat personale dhe në njerëzit e zgjedhur

të kësaj zyre, që nuk ishin tjetër përveçse sahanlëpi-rës që i bënëin qejfin Mao Ce Dunit.

Artikulli ka edhe budallallëqe të tjera. Mirëpo kë-to budallallëqe ngrihen në teori, sikur Mao Ce Duni paska thënë xhevahire të mëdha! Ja disa prej tyre: «Në qoftë se secili nga ju (domethënë nga rojat) shkruan një letër në çdo dy muaj ose katër apo pesë letra brenda vitit për të pyetur a kanë apo jo fshatarët ushqim të mjaftueshëm për të ngrënë, si dhe për prodhimin dhe kooperativat, dhe në qoftë se ju do të m'i tregoni mua përgjigjet, unë do të jem i mirinformuar». «Nëpërmjet kanaleve dhe metodave të ndryshme, — vazhdon artikulli, — udhëheqësi ynë i madh, kryetari Mao, përpiquej vazhdimisht për të mësuar zhvillimet e fundit në shoqëri, për të hetuar dhe për të nxjerrë përvojën, për të mësuar pikëpamjet dhe aspiratat e masave si baza për të hartuar politikën, në mënyrë që të drejtonte lëvizjet e masave me fitore përpara në rrugën e drejtë». Pika që s'i ra Mao Ce Dunit dhe «gjenialitetit» të tij, i cili bazohet në këta burokratë dhe në këta elementë të këtij fare njësi për të formuluar në kokën e tij «gjeniale» politikën e partisë dhe vijën e përgjithshme që duhej të drejtonte lëvizjen e masave për ecjen përpara! Po kjo s'hahet fare! Kjo është pak të thuash antimarksiste.

Artikulli vërteton se Mao Ce Duni nuk mbështetej asgjëkund te partia, ndonëse thoshte se mbështetej; ai u diktonte çdo gjë anëtarëve të personelit të tij, u jepte urdhra dhe direktiva. Ky artikull thekson se Maoja u thoshte atyre: «Kthehuni pastaj dhe më thoni diçka nga ato që patë» dhe bën pyetjen: «A nuk është

kjo një ide e mirë?». Unë u përgjigjem se kjo është një ide e çakërdisur e kryetarit Mao, i cili s'merr në konsideratë aspak partinë dhe pushtetin popullor, e pastaj akuzon Liu Shao Çinë se grumbullonte disa njerëz të besuar nëpërmjet kontakteve sekrete. Po «timonieri i madh» Mao çfarë ka bërë me këtë personel të tij? Po atë punë që bënte edhe Liu Shao Çia. Mao Ce Duni u thoshte këtyre njerëzve: «Shkoni shikoni çfarë kanë bërë komplotistët», dhe i porosiste: «Mos vritni asnjëri dhe bëni pak arrestime, me përjashtim të vrasësve, dëmtuesve të pasurisë dhe helmuesve». «Me helmues unë nënkuptoj, — thoshte Mao Ce Duni, — më shumë ata persona që helmojnë ushqimin, sesa ata që përhapin helm politik». Pra, për sa i përket helmit politik, për sa i përket reaksionarëve, Mao Ce Duni natyrisht rekomandonte që ata as të mos dënoheshin, as të mos vriteshin, por të edukoheshin!

- Artikulli në fjalë është mjaft i gjatë, ka 41 faqe dhe në këto faqe ka një varg të panumërt historish dhe përrallash se si kjo zyrë e plotfuqishme, nën drejtimin e Maos, ka bërë një luftë të rreptë për mbrojtjen e vijës gjoja revolucionare të Mao Ce Dunit dhe «ka shpëtuar» Partinë Komuniste të Kinës dhe vetë Kinën nga katastrofa. Kjo zyrë nuk është si ato zyrat që kanë komitetet qendrore të partive komuniste, sidomos ato parti që janë në fuqi. Këto zyra të ne nuk kanë dhe nuk mund të kenë ato kompetenca që ka kjo zyrë «e famshme» e Partisë Komuniste të Kinës, e mbështetur edhe nga një repart i sigurimit.

Organizimi leninist i partisë komuniste, të cilin



zbaton Partia jonë, i përcakton qartë funksionet. Zyrat administrative, të cilat kanë për detyrë vetëm të transmetojnë direktivat e Komitetit Qendror, të Byrosë Politike e të Sekretariatit, në asnjë mënyrë nuk mund të errësojnë, qoftë edhe një grimë, kompetencat e organeve të larta të Partisë. Vetëm mbledhjet plenare të këtyre forumeve dhe pastaj gjithsecili pjesëtar i këtyre, i cili i ka të përcaktuara kompetencat e tij nga organi kompetent, mundet, duhet dhe jep urdhra e direktiva, të cilat nuk janë personale e subjektive, por të bazuara në direktivat e Kongresit, në orientimet e Komitetit Qendror, në zërbërthimin e problemeve që shtrojnë Byroja Politike dhe Sekretariatit.

Me fjalë të tjera, gjithë kjo metodë pune e kinezëve në përmbajtje dhe në formë është antimarksiste dhe nuk ka asnjë mbështetje në parti, prandaj ne nuk kemi arritur kurrë ta kuptojmë se si funksiononte partia në Kinë. Ata nuk na e bënë të njohur një gjë të tillë, nuk pranonin të dërgonin një delegacion partie, i cili të merrte ose të jepte eksperiencë. Çfarë eksperiencë të jepnin? Ata e dinin që partia e tyre nuk funksiononte si Partia jonë; partia e tyre nuk kishte ato kompetenca që ka Partia jonë.

Tash duket qartë se kush sundonte dhe kush drejtonte në partinë kineze. Kurse në Partinë tonë drejtimi ka qenë dhe është kolegjial; forumet e saj, që nga Kongresi e deri në organizatën-bazë, kanë të drejtat, detyrat dhe kompetencat e tyre të caktuara.

Në Kinë, pra, siç po del, është bërë luftë për pushtet personal. Pushteti i Maos ishte bërë i paatakushëm, Maoja ishte kthyer në një perëndi dhe kupto-

het fare mirë përse zhvillohej dhe pse ishte ngritur kaq lart kulti i tij. Mao Ce Duni ishte i vetmi që drejtonte me një grup njerëzish dhe këta njerëz ishin ata që i bënë qejfin, që zbatonin mendimet e tij. Ata që nuk i zbatonin mendimet e Maos, ai i quante «komplotistë», «revizionistë», i quante çfarë të donte dhe i eliminonte. Kjo nuk do të thotë se ndër ata që janë eliminuar nuk ka pasur revizionistë e komplotistë, por metoda e punës dhe e drejtimit, një metodë natyrisht antiparti, antileniniste, të lë të dyshosh për vërtetësinë e të gjitha veprimeve që janë kryer nga një person i rrethuar prej një personeli të grumbulluar në një Zyrë të Përgjithshme dhe në një repart sigurimi. Këtu i thonë drejtim antimarksist, drejtim personal.

Siç duket, ky organizim ishte bërë një pengesë, pavarësisht se kush ishin Liu Shao Çia dhe Ten Hsiao Pini. Këta dhe banda e tyre revizioniste nuk e durojnë një situatë të tillë, prandaj u përpoqën me kohë, krijuan terrenin për të forcuar pozitën, përgatitën njerëzit, morën pushtetin në dorë dhe Mao Ce Duni nuk e likuiduan, por e mënjanuan për një kohë.

Është fakt se Mao Ce Duni u mbështet tek ushtria dhe te Lin Biaoja, në sajë të të cilit ai rimori fuqinë në këtë Zyrë të Përgjithshme dhe në repartin e sigurimit. Por pastaj, sigurisht kur Mao Ce Duni pa se Lin Biaoja dhe e ashtuquajtura bandë e të katërve kërkonin të bënin ndryshime në mënyrën e drejtimit dhe të organizimit, gjë që natyrisht lypte ndryshime në pikëpamje politike dhe ideologjike, kur pa se ata synonin të zgjidhnin njerëz të besuar me pikëpamje më të gjera demokratike revolucionare për të hyrë në

këtë zyrë dhe në këtë repart, atëherë Mao Ce Duni, me pikëpamjet e njeriut të plotfuqishëm që e karakterizonin, tok me njerëzit e tij të kësaj zyre, gjoja diktoi komplotin e Lin Biaos. Sipas artikullit, komploti i Lin Biaos nuk ishte vetëm çështja e vënies së një mine, por Lin Biaoja kishte organizuar flotën, bombardierët etj., etj., me një fjalë, gjithë forcën ushtarake për të marrë pushtetin. Nga kush do ta merrte këtë pushtet, kur Mao Ce Duni me njerëzit e vet ishin në krye të ushtrisë, të kësaj zyre dhe të këtij reparti të famshëm?

Maoistët dhe njerëzit e Huasë, që arrestuan «katerëshen», ngrenë çështjen se edhe komploti i kësaj drejtohej kundër Mao Ce Dunit, për ta likuiduar këtë fizikisht dhe se gjoja tërë kombinacionet e tyre janë arritur në mbledhje të ndryshme, në fjalime të ndryshme, në citate të ndryshme e plot gjëra nga këto, por që asnjëra nuk mund të besohet. Një fakt del qartë: të katër këta, që u likuiduan nga Hua Kuo Feni, dëshironin të sillnin një erë tjetër në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës. Se sa ishin të zotët e të organizuar, sa të drejta i kishin parimet dhe veprimet e tyre, këtu është e zorshme të themi ndonjë gjë të saktë. Në pozitat oportuniste, revizioniste të Partisë Komuniste të Kinës, nën udhëheqjen e Mao Ce Dunit, edhe këta të katër me shokët e tyre është zor që të kishin pikëpamje me të vërtetë të qarta revolucionare leniniste për çështje ideologjike, organizative dhe për çështje drejtimi. Fakt është që Mao Ce Duni likuidoi pushtetin personal të Liu Shao Çisë, të Ten Hsiao Pitit dhe të Pen Çenit me ndihmën e hunveibinëve dhe

me ndihmën e udhëheqjes së Revolucionit Kulturor, ku bënë pjesë Çen Po Taja, Kan Sheni, Lin Biaoja, Çian Çini, Van Hun Veni, Jao Ven Juani dhe Çu En Lai. Pra ishin këta që i ridhanë Maos fuqinë. Maoja, si njeri i lëkundshëm, por edhe prepotent, mbështetej herë në një fraksion, herë në një fraksion tjetër. Ai nuk ishte i sigurt në qëndrimet e tij politike; bazat në parti, në ushtri ose në pushtet nuk i kishte, gjithashtu, të sigurta. Natyrisht, në Revolucionin Kulturor fraksioni i Liu Shao Çisë u thye, por brenda në pushtet mbetën shumë njerëz të tij. Një nga këta ishte Çu En Lai.

Ne kemi parë që në Revolucionin Kulturor u kritikua Çu En Lai, por atë e shpëtoi Maoja. Çu En Lai u bë një oportunist ndaj Maos dhe Lin Biaos, por ai i bënte temena dhe mburrje edhe Çian Çinit, me qëllim që të fitonte kohë për të rigrumbulluar forcat e për të konsoliduar pozitat që në momentin e duhur t'i likuidonte të gjithë kundërshtarët e tij.

Fakt është se pozitat e Çu En Lait, të mbështetura nga Mao Ce Duni, u forcuan pas likuidimit të Lin Biaos, i cili, për çfarë qëllimesh s'mund ta dimë, duhet ta ketë kundërshtuar politikën e brendshme dhe politikën e jashtme të Kinës. Strategjia kineze pas likuidimit të tij u kthye drejt kursit revizionist, drejt marrëveshjes me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me titizmin, drejt marrëveshjes me të gjitha vendet kapitaliste. Edhe «katërshja» nuk ishte dakord me këtë vijë, por Çuja arriti fitoren, derisa Ten Hsiao Pinin, «Hrushovin numër dy të Kinës», e rehabilitoi, e sollë në fuqi dhe e bëri zëvendësin e tij të parë në pushtet,

zëvendësin e parë të Maos në parti dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm në ushtri.

Çu En Lai e dinte se do të vdiste, prandaj e rehabilitoi Ten Hsiao Pinin. Këtë gjë Maoja ia imponoi «katërshes» dhe Çuja, tok me Ten Hsiao Pinin, që ishte dhe aktualisht është nënkryetar i partisë, forcoi pozitat brenda në Zyrën e Përgjithshme të Komitetit Qendror dhe në repartin 8341.

Pas vdekjes së Maos, pushtetin e mori Hua Kuo Feni. Ky, siç e dimë, erdhi në fuqi në mënyrë antimarksiste dhe ishte personi që Maoja e caktoi si zëvendësin e tij. Ky njeri kishte mbështetje Jeh Çien Jinin, kishte mbështetje shefin e rojave të Maos, nënkryetarin e Komitetit Qendror të partisë, i cili drejtonte Zyrën e Përgjithshme, domethënë personelin kryesor të Maos, dhe kështu «me një të goditur» ai shpartalloi «katërshen», e cila, pas vdekjes së Çu En Lait dhe pas vdekjes së Maos, ka pasë menduar se kishte ardhur koha që ta merrte ajo fuqinë në dorë. Mirëpo grupi i Hua Kuo Fenit, i Ten Hsiao Pinit dhe Jeh Çien Jinit ishte më i përgatitur dhe i likuidoi ata të katër.

Duke e gjykuar çështjen në dritën që na hedh ky artikull, kuptohet se grupi i Hua Kuo Fenit dhe i Ten Hsiao Pinit, që kanë ardhur në fuqi dhe që bëjnë gjithë këtë propagandë shurdhuese sikur «katërshja» ka bërë kërdinë dhe ka dëmtuar në të gjithë sektorët e aktivitetit jetik të Kinës, në fakt gjithë kritikën ia drejtojnë Mao Ce Dunit dhe drejtimit të tij unik personal, pavarësisht se edhe drejtimi i Hua Kuo Fenit është një drejtim personal e s'ka të bëjë hiç me një

drejtim partie. Gjithçka që zihet në gojë si parti, si komitet qendror, si kongres etj., është fasadë ose vijë e përcaktuar nga një grup i vogël, që mbështetet nga një juntë dhe bën të aprovohen këto pikëpamje dhe kjo politikë nga ca organe gjoja partie ose shtetërore të zgjedhura dhe të emëruara. Kur Hua Kuo Feni me shokë thonë se «ne do të udhëhiqemi nga flamuri i Mao Ce Dunit», duhet të kuptohet ky drejtim, domethënë drejtimi personal; pra Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini duhet të konsiderohen po aq të plotfuqishëm sa ç'ishte Maoja në drejtimin e partisë dhe të Republikës Popullore të Kinës.

Aktualisht është Hua Kuo Feni kryetar i partisë dhe kryeministër, por Zyra «e famshme» e Përgjithshme e Komitetit Qendror, me repartin e sigurimit numër 8341, nuk është plotësisht në duart e Hua Kuo Fenit, siç ka qenë në duart e Mao Ce Dunit, bile në disa momente ajo ka pasur luhatje dhe as në duart e Maos nuk ishte, por ka kaluar nga një dorë në një dorë tjetër. Tani në këtë zyrë dhe në këtë repart ka njerëz edhe të Hua Kuo Fenit, edhe të Ten Hsiao Pinit, edhe të Jeh Çien Jinit, domethënë në këtë zyrë dhe në këtë repart ekzistojnë fraksione të ndryshme, të cilat luftojnë dhe do të luftojnë për të pasur epërsinë. Kjo luftë do të jetë e vazhdueshme dhe nuk dihet kush do të fitojë. Kjo varet jo vetëm nga aftësia e njërit ose e tjetrit, Hua Kuo Feni ose Ten Hsiao Pini a ndonjë tjetri për të rigrupuar kryesisht forcat e sigurimit dhe forcat e ushtrisë, por varet edhe nga koniunkturat e brendshme, ndarja, «balanca» e forcave, e simpatizantëve të njërit e të tjetrit. Kështu Pe-

rëndimit mund t'i duhet Ten Hsiao Pini, por forcave «moderatore» të brendshme mund t'u duhet një Hua Kuo Fen, ashtu siç është, «i caktuar nga Maoja» dhe që mund të luajë më mirë rolin e «centristit». Për sa u përket forcave të administratës shtetërore ekonomike, do të jenë, pa diskutim, Ten Hsiao Pini, Li Hsien Nieni, Fan Jia e të tjerë ata që do të drejtojnë transformimin e «socializmit kinez» në kapitalizëm.

Është e qartë se drejtimi do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë ekonomiko-politik me imperializmin amerikan, me borgjezinë kapitaliste të vendeve të ndryshme të Evropës dhe të Azisë, e pse jo, edhe me socialimperializmin sovjetik. Do të vijë koha që Ten Hsiao Pini do të konsolidojë pozitat dhe ose do ta lërë Hua Kuo Fenin si një figurë, kryetar të së ashtuquajturës Parti Komuniste të Kinës, ose do t'i kurdisë edhe atij njëfarë orvatjeje komploti dhe do ta plasë në errësirë. Kështu do të shkojë fati i Republikës Popullore të Kinës dhe këtë fat ia ka përcaktuar Mao Ce Duni me idetë e tij antimarksiste, antileniniste, anarkiste, me idetë e një udhëheqësi që ushtronte pushtet personal; që predikonte thjeshtësinë, por që nuk ishte i thjeshtë; që predikonte vijën e masave, por që në praktikë nuk e zbatonte këtë vijë; që predikonte marksizëm-leninizmin, por nuk e zbatonte; që predikonte luftën kundër prirjeve të shtetit të madh e të popullit të madh, por pikëpamjet e veprimet e tij ishin që Kina, dhe ai në krye të saj, të dominonte botën. Teoria e «tri botëve» të çon pikërisht te shovinizmi i shtetit të madh.

«Politika e madhe, e gjerë dhe botërore» e Maos,

— siç e quan artikulli i grupit «të shquar» teorik të Zyrës së Përgjithshme, — ishte «një diell dhe një monument i jëlës»! Në të vërtetë kjo tregon megalomanië e Maos, idetë e tij antimarksiste, organizimin personal të Partisë gjoja Komuniste të Kinës dhe të shtetit gjoja socialist kinez.

Aktualisht, me ardhjen e Hua Kuo Fenit në fuqi, e gjithë kjo strukturë e partisë dhe e shtetit do të vazhdojë si përpara, sepse edhe këta, si Ten Hsiao Pini ashtu dhe Hua Kuo Feni, janë nga shkolla e Mao Ce Dunit, sido që kanë qenë kundër tij. Ata e morën në dorë të famshmen Zyrë të Përgjithshme të Komitetit Qendror, domethënë kanë në dorë ushtrinë dhe sigurimin, dhe tash do të bëjnë ligjin, do të drejtojnë siç është drejtuar më parë, por duke e demaskuar me marifet Mao Ce Dunin. Në fakt, artikulli i shkruar nga kjo zyrë zbulon se gjithë kalbësira që ka ekzistuar dhe që do të ekzistojë në kokën drejtuese, ka qenë vepra e Mao Ce Dunit. Këtë gjë Ten Hsiao Pini dëshiron ta vërë në dukje dhe nga ana tjetër dëshiron të krijojë disa forma të tjera drejtimi personal tok me Hua Kuo Fenin, ose duke e eliminuar këtë, që kjo perandori e re kineze t'u përshtatet më mirë formave moderne të drejtimin të një vendi kapitalist.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha, «Shënime  
për Kinën», vëll. II,  
f. 601*

*Botohet sipas librit  
Enver Hoxha, «Shënime për  
Kinën», vëll. II, f. 601*



# MANOVRIME REVIZIONISTE. STRUKTURË ANTIMARKSISTE

Shënime

8 shtator 1977

Në shënimet e mia të herëpashershme kam shkruar për shumë çështje, për disa nga të cilat edhe rreptë. Duke i gjykuar nga prizmi marksist-leninist, nga eksperiencia teorike e praktike dhe nga organizimi leninist i Partisë sonë, shumë gjëra politike, ideologjike apo organizative të Partisë Komuniste të Kinës, të Mao Ce Dunit, të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, të revolucionit kinez dhe të goditjeve të ndryshme kundër deviacionistëve më janë dukur dhe i kam theksuar si jo shumë të qarta, bile shumë herë për to kam përdorur terma të ashpër. Këtë e kam bërë sepse ndërgjegjja komuniste, eksperiencia e Partisë dhe studimi i veprave të klasikëve të marksizëm-leninizmit nuk më lejonin t'i zbutja termat përpara shumë situatave konfuzë dhe të dyshimta. Pastaj, shpesh, i mbushur nga marazi kur shikoja e lexoja gjithë këto që po bëheshin në kurriz të marksizëm-leninizmit, në dëm të çështjes së proletariatit, edhe kam shfryrë në disa raste, në këtë ditë timin, ndoshta më fort se ç'duhet.

Shumë herë në shkrimet për këto çështje jam shprehur se me pikëpamjet tona mund të ndikojmë mbi Partinë Komuniste të Kinës. As shokët, as unë nuk kemi munguar që në fjalimet publike të flasim mirë dhe shumë mirë për Kinën, megjithëse e kemi njohur realitetin kinez dhe kemi dyshuar për shumë çështje e për shumë probleme të ndryshme të Kinës. Qëndrimet tona publike nuk bashkërendoheshin me pikëpamjet që kishte formuar në të vërtetë udhëheqja jonë e Partisë kur analizonim çdo qëndrim politik të Kinës. Edhe në kontaktet që kemi pasur me delegacionet e ndryshme kineze, natyrisht ne kemi thënë gjëra të mira për Kinën, për Mao Ce Dunin po e po, por në mënyrë shoqërore dhe diplomatike, domethënë në mënyrë të tërthortë, duke theksuar eksperiencën tonë, ne kemi synuar po ashtu t'i influenconim shokët kinezë për në rrugën marksiste-leniniste dhe e gjykonim ekspozenë tonë si një qëndrim kritik kundër shumë veprimeve të tyre. Ka pasur edhe raste që me Çu En Lain e me Li Hsien Nienin të jemi ndeshur drejtpërdrejt dhe të kemi bërë edhe kritika të hapëta për probleme të rëndësishme, për të cilat ata kërkonin të na impononin pikëpamjet e tyre të gabuara. Ne kemi qenë në kundërshtim të hapët me shokët kinezë për çështje politike të dorës së parë, sidomos për çështjen e Stalinit, të cilin ne e mbronim, kurse ata e kritikonin ashpër, dhe për çështjen e luftës së klasave, që ata pretendonin se ne nuk e zhvillonim si duhej dhe ata e bënin «mirë», kurse në fakt realiteti fliste e flet krejtësisht të kundërtën.

Në të tëra këto kontradikta që kemi pasur, si edhe

në kontradiktat për sa i përket qëndrimit ndaj sovjetikëve, ku kinezët kanë qenë jashtëzakonisht të lëkundshëm në etapa të ndryshme, që pas Bukureshtit dhe deri në fund, ne kemi luftuar. Udhëheqësit kinezë, jo vetëm Liu Shao Çia, por edhe Mao Ce Duni, edhe Çu En Lai, edhe Li Hsien Nieni, me përjashtim të Kan Shenit, kanë qenë për shuarjen e polemikës me sovjetikët. Në këtë çështje ne kemi pasur jo vetëm diskutime teorike, por edhe kundërshtime praktike, se ata donin jo vetëm që të shuhej polemika, por edhe të zhvilloheshin kontakte miqësore me sovjetikët pas një lufte kaq të ashpër që bëmë me ta. Kinezët kishin shpresa të mëdha të «shokët sovjetikë», siç i quanin pas rrëzimit të Hrushovit, dhe neve na thoshin se nuk duhej të ishim aq të ashpër kundër tyre, se ata do t'i ndreqnin gabimet. Ne u kemi thënë kinezëve hapur se edhe udhëheqësit e rinj sovjetikë janë revizionistë, se ata nuk ndërrojnë pikëpamje dhe se do të ndjekin rrugën e tradhtarit Hrushov, pa Hrushovin.

Kinezët nuk ishin dakord me pikëpamjet tona dhe nuk u bindën për ato që u thamë. Ata nuk u bindën, e për këtë kam shkruar edhe më parë, për arsye se, duke pushuar polemikën me sovjetikët, kërkonin të fitonin kohë për t'u bërë një fuqi e madhe. Kurse sovjetikët mendonin ndryshe, mendonin që Kina të bëhej një vend revizionist, i cili të ecte nën drejtimin dhe diktatin e tyre. Kur e kuptuan kinezët qëllimin e sovjetikëve, atëherë u bë ndarja dhe u zhvillua polemika për një kohë në mes tyre. Kjo vazhdoi, duke ndryshuar njëkohësisht edhe strategjia e Kinës, e cila u kthye drejt

Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo strategji e likuidoi Lin Biaon dhe «katërshen».

Të gjitha këto i kam shkruar dhe koha po i vërteton. Koha do të vërtetojë akoma shumë gjëra, duke na treguar edhe më qartë kalbëzimin e madh, mashtrimin e madh që kanë bërë Mao Ce Duni dhe përkrahësit e tij, duke na treguar se si i kanë shfrytëzuar ata situatat e favorshme revolucionare të Kinës për ta hedhur këtë në kaos. Tash klika e Hua Kuo Fenit akuzon «katërshen» e me miliona njerëz të tjerë të thjeshtë që e donin dhe e duan socializmin, se gjoja luftonin për te vendosur kapitalizmin në Kinë, për të krijuar kaosin, për t'u lidhur me Bashkimin Sovjetik, e shumë akuza të tjera. Por realiteti qëndron ndryshe: klika në fuqi është një bandë antimarksiste, një bandë kapitalistësh, që ecën me të shpejtë drejt kursit kapitalist, drejt afrimit dhe bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të kundërbalancuar socialimperializmin sovjetik, për t'u bërë një superfuqi, një vend i zhvilluar ekonomik dhe ushtarak në rrugën kapitaliste dhe jo një shtet i madh socialist, siç pretendojnë këta renegatë. Edhe ato anë pozitive që mund të gjenden në thëniet e Maos, të cilat vetë ai në praktikë nuk i zbatoonte, po zhduken.

Udhëheqësit revizionistë kinezë e pritën Titon me triumf. Kjo do të thotë se ata janë dakord me vijën politike, ideologjike, ushtarake dhe ekonomike të tij, janë dakord me organizimin shtetëror të ekonomisë dhe të vetadministrimit jugosllav, janë dakord me teoritë antimarksiste të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Këto teori e praktika antimarksiste udhëheqësit

kinezë tash do t'i zbatojnë edhe në Kinë, pse ato u shërbejnë tradhtisë ndaj marksizëm-leninizmit, imperializmit amerikan dhe vendeve kapitaliste të botës, të cilat tani do të investojnë kapitale, do të krijojnë banka, do të krijojnë shoqëri të shumanshme në Kinë për ta futur Kinën në prehrin e tyre imperialist.

Kundër këtyre situatave, pavarësisht nga disfatat e përkohshme që kemi pësuar, ne duhet të luftojmë me ashpërsinë më të madhe, të mbrojmë marksizëm-leninizmin, të mbrojmë teorinë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, që qëndron kurdoherë e fortë, e pastër, ngadhënjimtare. Popujt dhe proletariati botëror nuk e humbasin as kurajën, as shpresën në fitore. Ata po luftojnë e do të luftojnë akoma më ashpër; ata do të shohin çdo ditë e më qartë tradhtinë e këtyre pseudokomunistëve, do të shohin se kjo tradhti e rëndon akoma më tepër zgjedhën e kapitalit botëror dhe të kapitalit të brendshëm në kurrizin e tyre. Kështu ata do të vijnë në konkluzionin ku kanë arritur Marksit, Engelsi, Lenini dhe Stalini se popujt e proletariati duhet të krijojnë ato situata revolucionare, të krijojnë ato parti marksiste-leniniste, që të kryejnë revolucionin dhe të marrin pushtetin për të ndërtuar një shoqëri socialiste, një shoqëri të tyre, me një pushtet të diktaturës së proletariatit.

Çështja e komunizmit kinez ka qenë për mua një enigmë. Këtë nuk e them tash, por dyshimin e kam shprehur vite më parë në shkrimet e mia. Ky dyshim më ka lindur që pas Mbledhjes së Bukureshtit dhe më është ngjallur për arsye të qëndrimit të frikshëm të mbajtur nga kinezët atje. Nga pala kineze në Buku-

resht foli i pari Pen Çeni. Në Mbledhjen e Moskës erdhi nga Kina Ten Hsiao Pini me një referat shumë pajtues ndaj hrushovianëve, por Tenin e detyroi vep-rimi i Hrushovit që ta ndryshonte këtë referat dhe ta bënte pak më të ashpër, për arsye se Hrushovi lëshoi një material ku sulmohej Kina dhe e shpërndau para mbledhjes. Po ashtu atë e detyroi edhe qëndrimi i vendosur i Partisë sonë, gjë që është një histori e gjatë. Qëndrimet e mëvonshme të kinezëve, — flas për qëndrimet politike dhe ideologjike, — kanë qenë një luh-  
hatje e vazhdueshme dhe pikërisht këtu qëndronin enigma dhe dyshimi. Kishte periudha kur ata kërkonin me të madhe të shuhej polemika mes nesh dhe revizionistëve hrushovianë; kishte dhe momente që acarohesh polemika mes tyre. Me rrëzimin e Hrushovit u ringjall përsëri tendenca e theksuar e shuarjes së polemikës dhe e unitetit me hrushovianët, gjoja kundër imperia-  
lizmit amerikan. Përsëri, pas një kohe, ndryshoi stra-  
tegjia e tyre. Kinezët filluan kritikën ndaj revizionis-  
tëve sovjetikë nëpërmjet botimit të fjalimeve dhe të shkrimeve tona. Pastaj, më vonë, kritikën e vazhduan duke botuar edhe ata shkrimet e tyre, por përsëri lë-  
kundeshin.

Erdhi periudha e luftës së ashpër mes Mao Ce Du-  
nit dhe Liu Shao Çisë dhe periudha e Revolucionit  
Kulturor. Revolucioni Kulturor mbajti qëndrim anti-  
sovjetik, kundër revizionizmit, kundër reaksionit të  
brendshëm dhe kapitalizmit, kundër Liu Shao Çisë dhe  
imperializmit amerikan.

Të gjitha këto qëndrime politike të lëkundshme  
ishin të dyshimta për ne. Por Partia jonë, ne, megjii-

thëse këto qëndrime ishin enigmatike, përsëri mendonim se Kina, si shtet i madh socialist dhe me një udhëheqës marksist-leninist të madh, bënte një politikë shumë të gjerë dhe me perspektivë, pavarësisht se kjo politikë, siç thashë më parë, nuk inkadrohej në parimet kryesore të doktrinës sonë të pavdekshme marksiste-leniniste. Këtu qëndron enigma, por tash mund të themi se kjo politikë e Kinës ka qenë një mashtrim i madh, një manovër e madhe e revizionistëve kinezë për t'u maskuar.

Struktura e partisë kineze dukej dhe propagandohesh sikur ishte e njëllotë me atë të ish-Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit, me atë të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të të gjitha partive marksiste-leniniste. Evenimentet na tregojnë se kjo propagandë ishte një mashtrim. Partia Komuniste e Kinës kishte një strukturë organizative që në dukje mund të zbatonte një vijë të drejtë marksiste-leniniste, por në realitet nuk ishte kështu. Edhe për diktaturën e proletariatit në Kinë kinezët propagandonin se ishte e bazuar në mësimet e marksizëm-leninizmit si në Shqipëri. Në këtë çështje ne kemi dyshuar. Kemi dyshuar jo se patëm një verifikim të strukturave organizative të partisë dhe të organeve të shtetit në Kinë, se dyert për eksperiencën e kësaj partie motër neve na ishin mbyllur, por sepse nuk na pëlqenin mjaft nga qëndrimet dhe veprimet që kryheshin. Ne bënim pyetjen: Pse një vendi mik, siç ishte Shqipëria socialiste, dhe një partie motër, siç ishte Partia e Punës e Shqipërisë, të cilat iu gjendën në krah Partisë Komuniste të Kinës në mo-

mentet më të vështira të saj, nuk u jepej mundësia të njiheshin me eksperiencën e partisë etj.?

Dua të ritheksoj këtu se, kur kanë vajtur në Kinë delegacione të Partisë sonë, kinezët çdo gjë e mbulonin me një propagandë të bujshme, me mitingje, me duartrokitje, me gonge dhe me disa mbledhje pa bukë. Të gjitha mbledhjet ishin demonstrative dhe e gjithë vizita ishte shëtitje, shko andej e shko këtej. Pyetjeve që u bënë shokët tanë shokëve kinezë, këta të fundit u përgjigjeshin si në mjegull, ose vetëm me disa slogane e citate të mësuara përmendsh, aq sa asgjë nuk mund të mësoje prej tyre, ose thoshin diçka se kjo ose ajo gjë ishte gjoja e përafërt me tonat. Faktet tregojnë se ata praktikonin shumë mashtrimin politik, ideologjik dhe organizativ.

Në Kinë ka pasur organizata-bazë partie, komitete partie të distrikteve, të komunave, të provincave dhe Komitet Qendror. Të gjitha këto organe dhe organizata vepronin gjoja sipas normave të një partie leniniste. Në këto forume zgjidheshin «demokratikisht» komunistë, që mblidheshin rregullisht dhe merrnin vendime. Thuhej se partia udhëhiqte pushtetin, administratën dhe ekonominë; partia gjoja ishte mbi ushtrinë dhe ajo komandonte pushkën e jo pushka partinë. Pra, atje flitej sikur drejtonte Komiteti Qendror, Byroja Politike, ose Komiteti i Përhershëm i Byrosë Politike. Në fakt këta ekzistonin, por formalisht, se gjithë struktura organizative e partisë konsistonte në drejtimin personal nga Mao Ce Duni, që maskohej me një të ashtuquajtur drejtim kolegjial, i cili nuk vepronte. Pra, vepronte Maoja, i mbështetur nga Zyra e Përgjithshme



dhe nga roja e tij personale, për të cilat kam shkruar më parë. Mbi këto baza punonin pushteti, fabrikat dhe komunat. Kishte disa drejtime, disa rregulla, disa ligje, që të tërë duhej t'i zbatonin atje ku punonin etj., etj.

Thuhet se grupi i Liu Shao Çisë kishte një kartë me ku di unë sa pika për organizimin e ndërmarrjeve sipas shembullit të Magnitogorskit sovjetik, kurse po në atë kohë Maoja formuloi një «kartë» tjetër që u quajt e Anshanit, por kjo «vepër» e Maos, siç pohojnë vetë kinezët, u mbajt 10 vjet e mbyllur në sirtar. Nga kush? Pse? Si mund të ngjiste kjo, kur kryetar i partisë, të paktën zyrtarisht, kishte qenë vetë Maoja?! Luftë e çuditshme fraksionesh e vijash! Me fjalë të tjera, struktura e Partisë Komuniste të Kinës na del se nuk ka qenë strukturë e tipit të Partisë Bolshevike të Leninit. Tash ne e kuptojmë qartë këtë strukturë dhe këtë vijë, por për të kemi dyshuar më parë. Kemi shkruar se Mao Ce Duni nuk e ka pranuar në realitet strukturën leniniste të ndërtimit të partisë. Ai e «pranonte» këtë vetëm për të maskuar pikëpamjet e tij jomarksiste, ose e shumta, të themi, eklektike.

Revolucioni në Kinë i është dashur Maos për të organizuar dhe për të fshehur pushtetin e tij personal dhe të një klike të madhe rreth tij. Atje, siç po duket, ka pasur shumë klika, ka pasur shumë vija. Çdo provincë ishte si një mbretëri më vete dhe çdo shef provincë ishte një zot i luftës. Ne dimë se drejtuesi i komitetit gjoja të partisë dhe i komitetit ekzekutiv kishte në dorë të gjitha pozitat kyç të provincës; ai kryente edhe detyrën e komandantit të korparmatës, që ishte në atë provincë etj.

Në realitet ky organizim i Kinës, pas revolucionit më duket se u modernizua. Aparatit të regjimit të vjetër të perandorisë dhe më pas të Çan Kai Shisë iu bënë ndryshimet që i përshtateshin kohës, dhe këto ndryshime u veshën me petka gjoja marksiste-leniniste. Në fakt, struktura e partisë në Kinë nuk ka qenë një strukturë e tipit leninist, jo vetëm se atje ka qenë e plotfuqishme Zyra e Përgjithshme dhe kryetari i saj, udhëheqësi i partisë, por edhe për arsyen tjetër, që në këtë parti (dhe vetë kinezët e njohin këtë çështje) ekzistonin të paktën dy vija, se Maoja predikonte që «të lulëzonin njëqind lule», të zhvilloheshin shumë vija. Kjo s'është gjë tjetër veçse, siç e kam theksuar edhe herë të tjera, pluralizmi për të shkuar në socializëm, por në një socializëm që nuk i përngjet socializmit shkencor të përcaktuar në doktrinën e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Edhe për sa i përket çështjes së organizimit shtetëror, kurdoherë kemi dyshuar. Na thoshin se, përveç organeve të larta të pushtetit dhe të administratës shtetërore në qendër, ekzistonin organet lokale të pushtetit dhe të administratës shtetërore në provinca. Këto provinca në Kinë janë të mëdha dhe kanë me dhjetëra milionë banorë, sa një shtet i tërë si Franca, Japonia ose Republika e Ukrainës etj. Si drejtoheshin këto provinca? Këto drejtoheshin nga një i ashtuquajtur komitet partie relativisht i zgjeruar, që mund të kishte nja 100 anëtarë, nga një byro politike e përbërë prej 10-12 anëtarësh dhe një komitet ekzekutiv që ishte pak a shumë i ngjashëm me komitetet ekzekutive të rretheve të Shqipërisë. E çuditshme ishte kjo

ndarje administrative për Kinën, për një territor aq të madh, për atë popullsi aq të madhe dhe për atë vend me kombësi të ndryshme.

Vinim pyetjen: Si ishte e mundur që me këto forma organizimi e probleme kaq të mëdha të realizoheshin në mënyrë të drejtë lidhjet e qendrës me tërë këtë territor e me këta miliona banorë? Këtu qëndronte pikëpyetja dhe njëkohësisht enigma për ne. Por, siç del qartë, këto drejtoheshin në mënyrë personale, nëpërmjet një përqendrimi të pushtetit dhe një centralizmi burokratik; urdhrat dhe direktivat dilnin nga Maoja, e që këtu i merrnin për zbatim kryeministri dhe ministrat. Pra, Maoja nga kjo Zyrë e Përgjithshme u dërgonte urdhra drejtpërdrejt sekretarëve të provincave dhe mleti i zbatonte. A bëheshin mbledhje dhe konferenca? Sigurisht që bëheshin, bile bëheshin shumë e zgjateshin me ditë të tëra për të shpjeguar këtë ose atë direktivë gjoja të madhe dhe për t'ua futur njerëzve gjoja në kokë, që këta ta zbatonin me përpikëri. Paraqitej sikur kjo ishte direktivë e partisë, por, në fakt, nuk ishte kështu, ajo ishte direktivë personale. Këtëj arrihet në përfundimin se në këtë regjim të ashtuquajtur socialist të Kinës nuk kishte parti që të udhëhiqte dhe të drejtonte, nuk kishte udhëheqje kolegjiale, por kishte vetëm drejtim burokratik personal. Ky lloj organizimi, në forma personale, pasqyrohet edhe në provinca, për të cilat, sa herë bëhet luftë grupesh e fraksionesh, bëhet fjalë se kjo provincë është me Ten Hsiao Pinin, ajo tjetra me «katërshen» etj. Kështu Shangai, i cili është një qytet shumë i madh, prej rreth 10 milionë banorësh, që për shumë kohë

konsiderohej «kështjella» e grupit të të katërve: Çan, Çian, Jao e Van, më vonë sillej si shembull për miliona veta që i nxorën në rrugë e demonstruan për të dënuar «bandën e të katërve». Këtu pasqyrohen edhe disnivelet e mëdha në trajtimin e kuadrove në raport me masat në rroga dhe në favore. Populli bënte një jetë të thjeshtë dhe duhet thënë se ishte i kënaqur, për arsye se revolucioni i kishte sjellë njëfarë ndryshimi në gjendjen ekonomike, kishte siguruar të paktën punë e bukën e gojës (orizin).

Mashtrimi qëndron edhe në përdorimin e një terminologjie marksiste, me të cilën Mao Ce Duni dhe klika rreth tij maskonin veprimtarinë e tyre borgjeze, kapitaliste e revizioniste. Kur ne lexonim katër vëllimet e veprave të Mao Ce Dunit, nxirrnim disa konkluzione dhe këto konkluzione ishin pozitive. Bile unë kam shkruar se atje nuk është lehtë të gjesh ndonjë problem të trajtuar teorikisht në mënyrë të gabuar. Maoja lëshonte shumë parulla që dukeshin të thjeshta, por dukeshin edhe të mjegullta, edhe filozofike, edhe marksiste. Në fakt, realiteti i zhvillimit të shoqërisë kineze ishte krejt ndryshe. Atëherë ç'po ngjiste? Pse nuk akordoheshin shkrimet e Maos me veprimet e këtij elementi të plotfuqishëm? Këtu është çështja, enigma e këtij problemi, dhe nuk ka se si shpjegohet kjo enigmë veçse me faktin që, kur janë hartuar dhe janë përgatitur për botim këto katër vëllime të veprave të Maos, natyrisht janë rregulluar nga njerëz kompetentë që e kuptonin marksizmin dhe që aberracioneve revizioniste të Maos duhej t'u jepnin një ngjyrë marksiste-leniniste.

Nuk ka si kuptohet ndryshe kjo gjendje që u krijua në Kinë, me këto turbullira të mëdha idcologjike dhe politike, nuk ka si kuptohet kjo paqëndrueshmëri në vijën politike të partisë dhe ky ndryshim i vazhdueshëm i strategjisë së partisë kincze dhe i shtetit kinez, pale i taktikave. Tash kuptohet pse Mao Ce Duni ishte aq entuziast kur u hodh baltë kundër Stalinit, pse ishte aq entuziast për Hrushovin, të cilin e ka cilësuar si «Leninin e kohëve tona», dhe këtë e kemi dëgjuar vetë. Shkaku i këtij entuziazmi është se Maoja ishte kundër marksizëm-leninizmit, kundër shtetit socialist të ndërtuar nga Lenini dhe të forcuar nga Stalini, ishte kundër normave leniniste të partisë dhe të diktaturës së proletariatit, ishte për një diktaturë personale, dhe te Hrushovi ai pa një diktator të ri revizionist, një armik të parimeve e të normave leninistestaliniane.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha, «Shënime  
për Kinën», vëll. II,  
f. 621*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Shënime për  
Kinën», vëll. II, f. 621*

## SOT ËSHITË NJË DITË E GËZUAR, SE KUJTOJME KONFERENCËN E PEZËS

*Nga biseda me shokun Myslim Peza*

18 shtator 1977

*Në 35-vjetorin e Konferencës së Pezës, në një nga dhomat e shtëpisë-muze, ku u mbledh kjo Konferencë, shoku Enver Hoxha u takua me Babë Myslimin dhe zhvilloi këtë bisedë:*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si ke qenë, Babë, si je?

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Të na rrojë Partia! Të rroni edhe ju, shoku Enver!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sot është një ditë e gëzuar, se kujtojmë Konferencën historike që u bë këtu 35 vjet më parë. Ne do të vijmë përsëri kur të festojmë jubiletë e kësaj ngjarjeje të shënuar, se jemi komunistë dhe të fortë. Tani këtu në Pezë vijnë edhe të rinjtë. Ja ku është edhe Nexhmija. Gëzuar këtë ditë, gëzuar!

Tani sa u kthjem nga varrezat e dëshmorëve. Shumë mirë i kanë ndërtuar, me një stil të bukur. Kalluam rreth e rreth tyre dhe pamë gjithë atë ambient aq të dashur për ne. Edhe monumentin e kanë bërë

bukur, edhe hyrjen, gjithashtu, e kanë bërë në mënyrë të hijshme. Duhet dhe një muaj akoma që te këto varreza çdo gjë të jetë në rregull.

E ndien veten akoma të lodhur, Babë, apo je në gjendje të ngrihemi të shkojmë në miting?

*SHOKU MYSLIM PEZA:* Si të doni, si të thoni ju, shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Të ngrihemi kur të na thonë këta të rinjtë, se këtyre ua kemi lënë në dorë çdo gjë, çdo punë ata po e kryejnë.

*SHOKU MYSLIM PEZA:* Janë brezat e rinj që po vijnë tashti kudo.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, vijnë brezat e rinj. Edhe radhët e Partisë po shtohen vazhdimisht me elementë të rinj. Në këtë mënyrë edhe Partia mbetet gjithmonë e re, ajo nuk plaket kurrë.

*SHOKU MYSLIM PEZA:* Partia nuk do të vjetrohët kurrë!

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ashtu është, nuk do të vjetrohët. Neve na kaloi moshja, por vazhdimisht vijnë në Parti dhe kudo njerëz të moshave të reja. Në varrezat e dëshmorëve ishin radhitur sot plot pionierë, midis të cilëve kishte edhe pionierë nga të Pezës, bij dhe bija të atyre që luftuan dje. Sa bukur dukeshin ata në varreza, tamam si lule! Ishin veshur bukur dhe përsipër mbanin edhe nga një mushama të bardhë, që të mbroheshin nga shiu. Shumë mirë!

Kur shkuam për në varreza, u poqa me motrën e Kajos dhe me motrën e Myrvetit. Atje kishin ardhur për të bërë homazhe shumë njerëz, nuk e di nëse ishin

edhe Shaba<sup>1</sup> me Hysen Cekën<sup>2</sup> e shumë të tjerë. Ata mbase ishin atje, po unë nuk i pashë dot, se qe kallaballëk i madh.

Sot na ra pak shi, po tash pushoi. Për bujqësinë ai do të bëjë mirë. Mbrëmë pashë në televizor se Ndroqit i shkoi uji i pijshëm. Të gjithë banorët e këtij fshati dukeshin shumë të gëzuar.

E, Babë, si thua, të ngrihemi tash të shkojmë në miting, meqenëse te sheshi përpara lapidarit janë mbledhur të gjithë dhe po na presin të fillojmë?

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Dakord, nisemi.

*Pas mbarimit të mitingut shoku Ramiz Alia e prezantoi shokun Enver Hoxha me një grup shokësh e shoqesh anëtarë të delegacionit të Partisë Komuniste të Brazilit që ndodheshin për vizitë në vendin tonë.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të rrojë Partia Komuniste e Brazilit! Të rrojë shoku Amazonas!

**SHOKËT BRAZILIANË:** Të rroni ju, shoku Enver Hoxha! Të gjithë jemi me ju, shoku Enver. Lavdi Partisë së Punës të Shqipërisë!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të rroni ju, shoqe dhe shokë të Partisë Komuniste të Brazilit!

*Miqtë brazilianë, të emocionuar e të përlotur, nuk gjenin dot forca të shkëputeshin nga ky takim i papritur me shokun Enver Hoxha. Ata dolën të gjithë së bashku në fotografi. Bashkë me ta doli edhe patriotja e njohur kosovare Bije Vokshi.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po hajde, moj Bije, si ke qenë me shëndet? Si je?

1. Shaban Rexha, veteran.

2. Veteran.



**SHOQJA BIJE VOKSHI:** Mirë kam qenë, por ty të paçim mirë kurdoherë, o trim!

**SHOKU ENVER HOXHA:** (*Duke iu drejtuar shoqëve brazilianë.*) Kjo është shoqja ime Nexhmije, kurse kjo tjetra është Bije Vokshi, një nga shoqet tona më të forta, shoqe e vjetër dhe trime, që e kemi pasur kurdoherë pranë në ato ditë të vështira të Luftës Nacional-lirimtare, kur akoma nuk kishte lindur dielli në Shqipëri.

**SHOQJA BIJE VOKSHI:** Akoma më i bukur do të ndrijë dielli këtu, në Shqipëri, po edhe për gjithë shqiptarët.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Do të ndrijë, me siguri që do të ndrijë.

**SHOKËT BRAZILIANË:** Të rrojë Partia e Punës e Shqipërisë! Të rroni ju, shoku Enver!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ju falemnderit! Rroftë Partia Komuniste e Brazilit! Lavdi dëshmorëve të rënë në luftë! Rroftë shoku Amazonas! Rroftë shoku Arruda!

(*Duke u ndarë me Babë Myslimin.*) Hajde, Babë, të përshëndetemil! Të na rrojë Partia! Të rroni ju! Të rrojë populli!

**SHOKU MYSLIM PEZA:** Të rroni ju, shoku Enver, të rrojë Partia!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të rrojë Partia! Të rrojë rinia! Të rrojë klasa punëtore!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

# **TË GJEJMË RRUGËT E PËRSHTATSHME PËR FORCIMIN E METODOLOGJISË SË PLANIFIKIMIT E TË DREJTIMIT TË EKONOMISË**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**19 shtator 1977**

Meqenëse nuk ka ndonjë shok tjetër për të diskutuar, dëshiroj të bëj edhe unë disa vërejtje.

Materiali që na ka paraqitur Kryesia e Këshillit të Ministrave është me rëndësi të veçantë, i trajton drejt çështjet dhe tregon se organet e pushtetit tonë janë në korent si të punës praktike që zhvillohet nga organet shtetërore në bazë, ashtu edhe të anës teorike. Tash propozohet që sistemit tonë të planifikimit t'i bëhen mjaft përmirësime, me të cilat, në përgjithësi, jam dakord. Gjithashtu, propozoj që diskutimet që bënë shokët këtu në Byronë Politike, Komisioni i Pla-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi masat për përsosjen e mëtejshme të sistemit të planifikimit dhe parimet e detyrat e planifikimit socialist të ekonomisë sonë popullore».

nit të Shtetit t'i marrë dhe të reflektojë mbi to, sidomos mbi ato më kryesore, pasi kam përshtypjen se propozimet dhe sugjerimet e shokëve janë mjaft të vlefshme për përsosjen e plotësimin e metodologjisë së planifikimit tonë socialist, por sa, qysh dhe si do të realizohen ato, këtë punë t'ia lëmë në dorë Qeverisë ta vendosë. Komisioni i Planit të Shtetit me disa specialistë t'i përpunojnë këto propozime dhe t'ia paraqitin Këshillit të Ministrave për miratim.

Eksperienca e madhe që ka tash Partia jonë na jep mundësinë ta përsosim më tej planifikimin me mjaft nga ato çështje që parashtrohen, si në materialin e Kryesisë së Këshillit të Ministrave, ashtu edhe në diskutimet e shokëve. Megjithatë, mendoj të parashtroj edhe unë disa mendime, se mund të shërbejnë për qëllimin tonë.

1. Kongresi i 7-të i Partisë shtroi detyrë të forcohet më tej karakteri shkencor i planifikimit në bazë të kërkesave të stadi të sotëm të zhvillimit tonë ekonomik-shoqëror, në mënyrë që planifikimi dhe tërë procesi i drejtimit me plan të ekonomisë të sigurojnë zbatimin drejt të politikës ekonomike të Partisë. Në kërkim të rrugëve për vënien në jetë të këtij pikësynimi, në metodologjinë e re janë bërë disa përmirësime e plotësime të nevojshme që i dikton koha, si dhe të atilla që ndihmojnë për t'u mbyllur shtigjet disa shfaqjeve e veprimeve voluntariste e subjektiviste, shfaqjeve të spontaneitetit e të njëanshmërisë, metoda-ve globaliste në drejtimin e ekonomisë.

Por me këto përmirësime e plotësime që bëhen në metodologjinë e planifikimit, të cilat janë në vazh-

dim të përmirësimeve të derisotme, nuk do të thotë aspak që të flemë mendjen e të kujtojmë se zgjidhëm çdo gjë. Jeta e zhvillimi revolucionar te ne ecin përpara dhe metodologjia e planifikimit tonë socialist duhet të përsoset e të plotësohet me gjërat më progresive e më revolucionare të këtij zhvillimi. Natyrisht, këtu çdo hap duhet hedhur i matur e i peshuar mirë, sepse ka të bëjë me çështje nga më të rëndësishmet për mbarëvajtjen e punëve.

Lidhur me këtë është shfaqur edhe mendimi që për disa nga problemet e drejtimit me plan, ku mendohet të bëhen përmirësime, më parë të bëhet eksperimentimi. Kjo duhet praktikuar më gjerësisht edhe për arsye se Partia jonë, në bazë të tezave themelore të klasikëve të marksizëm-leninizmit, çan rrugë të reja në shumë drejtime.

Por themelore këtu është që metodologjia e planifikimit të zbatohet sa më drejt, sepse sot vihen re jo pak raste të mosnjohjes si duhet, të kuptimeve të cekta dhe të zbatimeve të gabuara të çështjeve që ajo përmban.

Në praktikën e realizimit të planit shpesh vihen re edhe raste që, kur shfaqen të meta e dobësi, fajin ia vënë metodologjisë së planifikimit dhe nuk e shikojnë problemin të lidhur me tërë kompleksin e drejtimit me plan të ekonomisë. Planifikimin tonë socialist nuk e bëjnë vetëm metodologjia dhe metodikat. Këto janë absolutisht të domosdoshme. Por ai duhet parë shumë më gjerë edhe në atë se sa mbi baza shkencore e socialiste përdoren në ekonominë tonë dhe pasqyro-

hen në planet tona normat, ligjet e kategoritë e tjera ekonomike, si i kuptojnë dhe si i zbatojnë në praktikë njerëzit këto çështje, sa metoda e drejtimit është e shëndoshë e revolucionare, në përputhje me tërë vijën dhe politikën ekonomike të Partisë dhe me një sërë problemesh të tjera. Metodologjia dhe metodikat do të ktheheshin në gjëra pa vlerë pa këtë kompleks çështjesh nga më themeloret, pa përmbajtjen socialiste të normave, të ligjeve e të kategorive të tjera ekonomike. Tamam në tërë këto anë duhen parë e gjetur edhe rrugët e përshtatshme për forcimin e karakterit revolucionar të vetë metodologjisë së planifikimit tonë socialist e të drejtimit me plan të ekonomisë.

2. Plani unik shtetëror i zhvillimit të ekonomisë sonë, si pasqyrim i politikës ekonomike të Partisë, është në fakt një kompleks përpjesëtimesh e treguesish të harmonizuar. Në të pasqyrohen detyrat e zhvillimit të degëve e të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë e të kulturës. Por fillimet e tij janë në bazë, në brigadë, në sektor, në repart, në fabrikë, në ndërmarrje e në kooperativë e kështu me radhë deri në qendër.

Niveli i karakterit shkencor të planit unik shtetëror varet edhe nga niveli shkencor i planifikimit në bazë. Aq sa të drejta, shkencore e teknike janë metodat e planifikimit, normat, kategorizimi i vendeve të punës dhe normativat e materialeve, aq sa përdoret metoda bilancuese në ndërmarrje e kooperativa, aq sa tërhiqen masat e gjera punonjëse për të thënë fjalën e për të dhënë përvojën e tyre të pasur për këto probleme, po aq shkencor është edhe plani në bazë e në qendër.

*«Pa norma teknike, nuk mund të ketë ekonomi të planifikuar»<sup>1</sup>,*

thoshte Stalini. Kjo është thënë në një kuptim shumë të gjerë, sepse pa norma të bazuara teknikisht e shkencërisht nuk mund të ketë bilance shkencore. Por metoda bilancuese është metoda bazë e planifikimit. Prandaj dobësitë e të metat që vihen re në praktikë në normimin e punës, fakti që normat teknike janë shtrirë vetëm në 50-55 për qind të operacioneve e të proceseve të punës, që një pjesë e mirë e normativave të harxhimit të materialeve janë ende eksperimentale-statistikore, që në vlerësimin e kategorizimit të një pjese të proceseve e të vendeve të punës bëhen lëshime, duke i vlerësuar ato me kategori më të larta nga sa u takon në fakt, që rendimentet e prodhimeve bujqësore planifikohen në nivele të ndryshme, edhe kur kushtet janë të barabarta etj., të gjitha këto tregojnë se edhe niveli shkencor i planifikimit është akoma i ulët, edhe shkalla e unitetit të planit është e pamjaftueshme. Prandaj organet tona shtetërore, duke filluar nga Komisioni i Planit, Ministria e Financave dhe gjithë dikasteret e tjera, si dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, vëmendje të veçantë duhet t'i kushtojnë përsosjes së planifikimit në bazë, gjithë atij kompleksi që do të çonte në ngritjen e nivelit shkencor të planifikimit, pa përmendur këtu detyrat e mëdha që kanë ata vetë në këtë fushë. Detyra të mëdha u dalin këtu organeve shtetërore dhe ekono-

---

1. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 14, f. 28.

mike në ndërmarrje, në kooperativa bujqësore e në institucione të ndryshme.

3. Nga studimi i materialit të metodologjisë së planifikimit del se mjaft plotësime e përmirësime janë bërë në fushën e zbrërthimit të planit në treguesit në natyrë (sipas asortimenteve dhe cilësisë), në inkuadrimin më gjerësisht të kooperativave bujqësore në planin unik shtetëror, në planifikimin e investimeve e të ndërtimeve, në shtrirjen më gjerësisht të metodës bilancuese etj. Megjithatë mendoj se këtu kërkohet që vëmendja të përqendrohet më mirë në disa çështje:

Duke u mbështetur në orientimet e Plenumit të 9-të të Komitetit Qendror të korrikut 1976 dhe në dokumentet e tjera të Partisë lidhur me luftën kundër globalizmit dhe njëanshmërisë problemi i planifikimit të asortimenteve në natyrë duhet të thellohet më tej e të bëhet kujdes më i madh, duke filluar nga baza e deri në qendër.

Ekonomia jonë socialiste ka për qëllim plotësimin e nevojave të masave të gjera punonjëse, të prodhimit dhe të riprodhimit të zgjeruar socialist me vlera të caktuara përdorimi, plotësimin e nevojave konkrete për forcimin e mbrojtjes së vendit. Këtej del që këto nevoja duhet të plotësohen jo dosido, por në sasi të duhura dhe sipas një radhe të caktuar. Mirëpo, në qoftë se në praktikë vihen re fenomene të tilla negative, si mospërputhja e anës financiare me atë materiale, e planeve të prodhimit me bazën materiale e teknike, e prodhimit me shpërndarjen dhe me transportin, apo krijimi i mbinormativave me mallra që kanë qarkullim të ngadalshëm ose stoqe, këto duhet të

na bëjnë të mendojmë thellë se këtu ndeshemi me pasojat e një planifikimi global në vleftë të përgjithshme, që nuk u përgjigjet si duhet kërkesave konkrete të ekonomisë e të popullit për produkte, për lloje dhe për asortimente të caktuara të prodhimit. Kur nga Partia u shtrua me të drejtë me forcë problemi i luftës kundër mallrave stoqe e me qarkullim të ngadalshëm, ndodhi që për disa artikuj tregtia të pakësosjës kërkesat ndaj prodhimit deri në atë masë sa që u ndie dhe po ndihet mungesa e tyre në treg. Kjo erdhi sepse nuk njihen si duhet e nuk bëhen llogaritje të sakta e shkencore të kërkesave të popullit e të prodhimit në natyrë, në asortiment etj., por veprohet me metoda globaliste e në përgjithësi, me përqindje e në vleftë. Kurse dihet se vleftat e përgjithshme bazën e kanë të llogaritjet, më parë, në natyrë, në asortiment. Prandaj kjo kërkon që në themel të hartimit të planeve, duke filluar nga baza, në organet prodhuese e tregtuese, të vihet planifikimi i sasisë së asortimenteve të prodhimit sipas nevojave të ekonomisë, të mbrojtjes së popullit dhe radhës së domosdoshme të plotësismit të këtyre nevojave. Ne nuk duhet të lejojmë në asnjë mënyrë që të prodhohet sa për të prodhuar, por të prodhohet me disiplinë të fortë dhe me destinacione të caktuara shkencërisht. Duke folur për planin ekonomik unik, V. I. Lenini vinte në dukje se

*«Duhet, më në fund, të mësohemi ta çmojmë shkencën, ta godasim mendjemadhësinë «komuniste» të diletantëve dhe burokratëve, duhet të mësohemi, më në fund, të punojmë në*



*mënyrë sistematike, duke shfrytëzuar eksperiencën tonë, praktikën tonë!».*

Dhe më poshtë ai vazhdonte:

*«Natyrisht, «planet» në thelbin e tyre janë një gjë e tillë, për të cilën mund të flasësh dhe të diskutosh pa mbarim. Por nuk duhet të lejojmë llomotitje dhe diskutime të përgjithshme mbi «parimet» (e ndërtimit të planit) në një kohë kur duhet t'i përvishemi studimit të të vetmit plan shkencor, që kemi sot, dhe ndreqjes së tij në bazë të mësimeve të eksperiencës praktike dhe të një studimi sa më të hollësishtëm të tij. Natyrisht, e drejta për «të aprovuar» dhe për «të mos aprovuar» i mbetet gjithnjë funksionarit të lartë ose funksionarëve të lartë. Po ta kuptojmë këtë të drejtë në mënyrë të arsyeshme dhe po t'i interpretojmë në mënyrë të arsyeshme vendimet e Kongresit VIII në lidhje me aprovimin e planit të pranuar prej tij, plan, për të cilin u vendos të bëhej një propagandë sa më e gjerë, atëherë me fjalën pranim duhet kuptuar një varg porosish dhe urdhrash: të blihet akcila gjë, në akcilën kohë dhe në akcilin vend, të fillohet ndërtimi i akcilit objekt, të grumbullohen dhe të transportohen këto ose ato materiale etj. Po ta interpretojmë në mënyrë burokratike, atëherë «pranimi» do të thotë arbitrarizëm prej funksionarësh, zvarritje burokratike, lojë me*

*komisione kontrolli, me një fjalë, mbyttje thjesht burokratike e punës së gjallë<sup>1</sup>.*

Një planifikim i shëndoshë e mbi baza shkencore i gjithë anëve të ndryshme të planit do të bëjë që edhe treguesit financiarë të hartohen e të vlerësohen më drejt, me tërë seriozitetin e duhur.

Prioriteti që ka dhe duhet të ketë vlera e përdorimit të produkteve në shoqërinë tonë socialiste nuk duhet të çojë në asnjë rast në nënvleftësimin e vlerës së tyre, përndryshe krijohen pasoja negative edhe për vetë rritjen dhe zgjerimin e produkteve e të vlerave të përdorimit. Po nuk u vlerësua kostoja, po nuk u caktua drejt norma e rentabilitetit, po nuk u bë mirë llogaritja e leverdisë ekonomike etj., atëherë do të ulet edhe akumulimi socialist dhe, si pasojë, do të pakësohen fondet për investime dhe për zgjerimin e prodhimit etj. Dhe shfaqje të tilla ka. Vërchet prirja që nuk i kushtohet kujdesi i duhur dhe nuk përqendrohet vëmendja në treguesit financiarë aq sa për treguesit e tjerë të planit. Kjo ndodh si gjatë procesit të analizës së rezultateve, ashtu edhe gjatë fazës së hartimit e zbatimit të planit.

Inkuadrimi më i mirë që bëhet në metodologjinë e planifikimit edhe për anët financiare duhet të çojë në drejtimin më shkencor edhe të këtyre proceseve. Po të drejtohen këto procese shkencërisht dhe jo, si të thuash, nëpër këmbë e nëpër duar, siç na ka ndodhur disa herë me uljen e normës së akumulimit në një

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 32, f. 154-155.

pjesë kooperativash bujqësore, ose këtë vit, kur si 6-mujor, nga 28 ndërmarrje që ishin planifikuar me humbje, numri i atyre që nuk plotësonin detyrën e planifikuar të uljes së kostos e të fitimit dhe dolën me humbje, arriti në 90 etj., atëherë edhe perturbacionet financiare në ekonomi do të jenë më të vogla, ose do të mënjanohen.

Problemet financiare te ne duhet të zgjidhen brenda të gjitha normave, kriterëve, rregullave dhe vendimeve që kanë vendosur Partia e Qeveria. Si është e mundur të lihen disa kooperativa bujqësore deri në fund të muajit gusht të këtij viti pa u dhënë fondet që u takojnë për t'ua shpërndarë anëtarëve në fund të vitit nga prodhimet e realizuara vitin e kaluar, në një kohë kur, sipas rregullave që kemi vendosur, ato duhet të likuidohen brenda muajit mars? Kush e jep këtë të drejtë? Planet financiare, plani i arkës, buxheti i shtetit etj. janë pjesë përbërëse dhe i nënshtrohen planit unik shtetëror të zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit. Ato kurdoherë zgjidhen e duhet të zgjidhen në harmoni dhe të ndihmojnë për plotësimin e detyrave e të objektivave që parashikon plani i shtetit. Përndryshe, po qe se problemet financiare zgjidhen jashtë këtij pikësynimi të madh, ato do të zgjidhen në mënyrë të çalë dhe të gabuar, pasojat e të cilave do të bien jo vetëm mbi ekonominë e popullit, por edhe mbi vetë proceset dhe anët e ndryshme financiare. Prandaj edhe me rastin e përmirësimeve e të plotësimeve që po kryhen në metodologjinë e planifikimit, në problemet financiare të bëjmë më shumë kujdes.

Si ekonomi grupi, kooperativat bujqësore kanë ve-

çorinë e tyre, por, duke qenë ekonomi të grupit socialist, ato njëkohësisht drejtohen nga shteti në bazë të parimit të centralizmit demokratik. Duke u nisur nga kjo, mbase ka nevojë të llogariten e të planifikohen edhe disa tregues, sikurse janë fuqia blerëse dhe mbulimi i saj, qarkullimi i monedhës, plani i qarkullimit të mallrave për tregtinë shtetërore etj., sepse këta lidhen edhe me ekonominë në tërësi, ndryshe do të mbeteshin pa këtë bazë. Problemet që lidhen me planifikimin në kooperativat bujqësore kërkojnë të mbahet më mirë parasysh karakteri i pronës së grupit.

Gjatë konsultimeve të ndryshme kam dëgjuar se është ngritur çështja që, krahas me shqyrtimin e projektplanit nga dikasteret qendrore për çdo degë, do të ishte e nevojshme që projektplanin i rrethit për disa tregues të rëndësishëm të shqyrtohej edhe nga Komisioni i Planit të Shtetit së bashku me aparatën e Këshillit të Ministrave. Kjo nuk e cenon parimin e planit sipas degëve ekonomike. Përkundrazi, në këtë mënyrë zhvillimi i ekonomisë sipas degëve do të bashkërendohet më mirë edhe me zhvillimin sipas territorit.

Sikurse thuhet edhe në materialin e paraqitur nga Kryesia e Këshillit të Ministrave, aktualisht veprohet kështu: ndër marrjet dhe kooperativat bujqësore projektplanin ua çojnë përkatësisht seksioneve të tyre. Këto të fundit, pasi i përmbledhin të dhënat, ia kalojnë seksionit të planit të rrethit dhe pastaj bëhet aprovimi nga komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit. Që këtë çdo seksion ia dërgon planin dikasterit të vet, kurse sot Komisionit të Planit të Shtetit nga rrethi nuk i dërgohet gjë, përveç bilancit të forcave të punës, më

duket mua, dhe bilancit të të ardhurave dhe të shpenzimeve në të holla të popullatës, që i dërgohet edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Shtetit.

Çdo dikaster sjell në Komisionin e Planit të Shtetit planin e degës që mbulon dhe jo problemet, raportet, proporcionet që krijohen në rrethe për periudhën që planifikohet.

Më duket se këtu krijohet një boshllëk për një nga proporcionet kryesore në zhvillimin me plan të ekonomisë, siç është zhvillimi proporcional i rretheve dhe brenda tyre.

Është fakt që këto probleme nuk kanë mbetur pa u zgjidhur drejt nga Partia dhe Qeveria. Të gjitha rrethet kanë ndryshuar si dita me natën me të kaluarën. Por disa probleme të zhvillimit më proporcional të rretheve dhe brenda tyre mund të zgjidhen në mënyrë më të ndërgjegjshme e jo t'i lihen njëfarë spontaneiteti.

Këtu nuk është fjala as për të kaluar në planifikimin e përqendruar sipas rretheve, siç ka qenë dikur, as në ndonjë shkarje të tipit revizionist. Të tërheq vëmendjen një thënie e V. I. Leninit, kur bën fjalë për zhvillimin me plan të ekonomisë:

*«Mungesa në bazë e bashkërendimit të punës së dikastereve të ndryshme është një nga të këqijat e mëdha që pengojnë ndërtimin ekonomik. Kësaj çështjeje duhet t'i kushtohet një vëmendje shumë e madhe»<sup>1</sup>.*

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 32, f. 461.

Në këtë rast, përveç dikastereve, një front i rëndësishëm pune i takon Komisionit të Planit të Shtetit, që i shikon problemet e zhvillimit me plan të ekonomisë nga një kënd më i gjerë në krahasim me dikasteret qendrore.

Propozimi konkret i bërë nga baza është që seksionet e planit të rretheve, pasi bëjnë përmbledhësen e planeve të seksioneve të ndryshme të komitetit ekzekutiv, t'i dërgojnë Komisionit të Planit të Shtetit vetëm disa tregues, për shembull, raporti që krijohet në rreth midis industrisë dhe bujqësisë, plani i investimeve që parashikojnë të bëjnë dikasteret, zënia me punë e popullsisë aktive, mbulimi i fuqisë blerëse dhe ndonjë tregues tjetër, të shoqëruar me një relacion se çfarë problemesh ekonomike e shoqërore krijohen në rreth me projektplanin e ri që u punua me dikasteret dhe që kërkojnë zgjidhje.

Në materialin e paraqitur bëhet fjalë për nevojën e hartimit të metodikave të planifikimit të çdo dege nga dikasteret qendrore. Kjo është një punë me shumë përgjegjësi, por këtu vihen re zvarritje, gjë që tregon se nuk kuptohet sa duhet domosdoshmëria e metodikave të planifikimit. Në metodikat e dikastereve konkretizohen kriteret më të përgjithshme që përmbahen në metodologjinë e planifikimit, duke pasqyruar në to veçoritë që lidhen me natyrën e prodhimit, apo të shërbimit të secilës degë të ekonomisë. Këto metodika kanë afro 18 vjet që nuk janë përtërirë dhe ndërmarrjeve u mungojnë. Mirëpo mungesa e tyre cenon edhe kriteret unike dhe unitetin e planifikimit tonë socialist.

Në metodologji janë përcaktuar më drejt kriteret

se si të vlerësohet veprimtaria ekonomike e financiare e ndërmarrjeve. Këto kritere janë diametralisht të kundërta me kriterin e vetëm revizionist që vlerëson punën e tyre me anë të fitimit. Mendoj se nuk është e drejtë të lihen jashtë metodologjisë kriteret e vlerësimit të punës së kooperativave bujqësore. Se cilët mund të ishin treguesit, kjo çështje duhet studiuar konkretisht.

4. Nga të dhënat e tabelës së paraqitur në fund të raportit del se bëhet një përqendrim i ndjeshëm i zërave e i nënzërave të planit në kompetencën e organeve qendrore. (Nomenklatura e Qeverisë rritet më shumë se 2 herë, e dikastereve 1,7 herë, e rretheve 1,2 herë. Për të gjitha së bashku 1,8 herë.)

Përse duhet të përqendrohet në nomenklaturë të dikasterit të industrisë çdo lloj tulle, ose karriget e kurbuara, llojet e fundeve e të bluzave, llojet e djathërave etj.? Arsyetimi për këtë përqendrim është pak a shumë ky: duke i kaluar në nomenklaturën e organeve qendrore disa tregues të planit, atëherë këta do të jenë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të tyre dhe të detyrueshëm për t'u zbatuar. Sigurisht, kjo luan një rol të rëndësishëm, por jo përcaktues, sepse nuk mund të thuhet, për shembull, se plani i perimeve nuk është realizuar këto vitet e fundit, për arsye se ishte në nomenklaturën e rrethit. Ai nuk është realizuar edhe kur perimet kanë qenë në nomenklaturën e Qeverisë ose të ministrive.

Po të nisemi nga koncepti i drejtë se treguesit e planit janë njëlloj të detyrueshëm për t'u zbatuar, pa varësisht nga organi që ka në kompetencë nomenklaturën e tyre, atëherë është e mundur që të mos kalojmë

në një përqendrim të tillë. Organet qendrore duhet të kërkojnë plotësimin e të gjitha llojeve të nomenklaturave, duke mos lejuar asnjëfarë spontaneiteti.

5. Në material flitet shkarazi për planet prognozë, duke vënë theksin në përgatitjen e disa studimeve për degë të veçanta. Mendoj se, si në parimet, ashtu dhe në metodologji, hartimi i planeve prognozë duhet të zërë një vend më të rëndësishëm, më të qartë, e më të plotë. Kjo detyrë është jo vetëm e Komisionit të Planit të Shtetit, por për këtë duhet të mendojë e të punojë çdo ndërmarrje e kooperativë, çdo rreth e dikaster. Secili duhet të dijë mirë cila është perspektiva e sektorit që mbulon.

Mirëpo në praktikë kjo nuk është kuptuar kurdoherë kështu. Në fakt plani i Akademisë së Shkencave ka mjaft tema studimore, dikasteret qendrore, institutet kërkimore-shkencore dhe një pjesë byrosh teknike e teknologjike kanë parashikuar studime të ndryshme. Por ndoshta duhet parë e diskutuar problemi se sa lidhen ato me zhvillimin dhe me hartimin e planit tonë perspektiv. Veç kësaj, kjo është një punë e pjesshme, sepse shumicës së ndërmarrjeve e të kooperativave në planet e tyre u mungon plani i punës kërkimore-shkencore për zhvillimin aktual dhe perspektiv. Plani i punës kërkimore-shkencore duhet të pasqyrohet edhe në metodologjinë e planifikimit, si pjesë e planit të ndërmarrjeve, të kooperativave, të rretheve e kështu me radhë. Po të punohet që çdo qendër pune, rreth e dikaster të studiojë e të dijë zhvillimin e vet perspektiv, atëherë lehtësohet edhe puna për hartimin e planit prognozë në



shkallën e të gjithë vendit nga Komiteti Qendror dhe Qeveria.

6. Me rastin e plotësimit e të përmirësimit të metodologjisë së planifikimit, me siguri do të lindë nevoja që të bëhen përmirësimet e nevojshme edhe në fushën e evidencës statistikore. Por mendoj se kryesorja këtu është se si konceptohet puna në këtë sektor, si vlerësohet ai, si shfrytëzohen e si përpunohen të dhënat statistikore, si përdoren ato për të nxjerrë konkluzione, për të evidencuar prirjet dhe tendencat pozitive e negative, me qëllim që të përmirësohet më tej puna organizuese e drejtuese, duke e larguar atë nga shfaqjet e drejtimit në përgjithësi e kryesisht mbi baza të empirizmit e të praktikizmit, që vihet re shpeshherë në praktikë.

Në këtë kuadër del e nevojshme të luftohen disa koncepte e praktika që vihen re te punonjësit e statistikës, të cilët e konsiderojnë veten më shumë si regjistruer, ndërsa konkluzionet që mund të nxirren nga të dhënat statistikore, duhet t'i bëjnë të tjerët. Po kështu mjaft drejtues këto të dhëna i shfrytëzojnë shumë pak, i mbajnë nëpër sirtare, në blloqe, në çanta, sa për t'iu përgjigjur fët e fët ndonjë kërkesë nga lart, dhe nuk arrijnë vetë bashkë me vartësit të nxjerrin konkluzione e të përcaktojnë masa konkrete për përmirësimin e punës. Duke vepruar kështu vetë ata, edhe vartësve e punonjësve të statistikës nuk u kërkojnë pikërisht ato gjëra që duhen. Kurse V. I. Lenini thoshte:

*«Një ekonomist i vërtetë, në vend që të merret me teza të kota, do t'i përvishet studimit të*

*fakteve, të shifrave, të të dhënave, do ta analizojë eksperiencën tonë praktike dhe do të thotë: ky është gabimi dhe duhet ndrequr kështu. Një administrator serioz, pas një studimi të tillë, do të propozojë ose do të bëjë vetë zhvendosjen e personave, ndryshimin e evidencave, riorganizimin e aparatit etj. Te ne nuk gjen as këtë as atë qëndrim serioz dhe praktik ndaj planit ekonomik unik<sup>1</sup>.*

Nga ana tjetër, sot ndodh që në ndërmarrje e kooperativa mbahen përgjithësisht vetëm ato evidenca që kërkohen nga lart. Kurse mendoj se, pa rënë në burokraci, duhet të mbahet një sistem më i gjerë e më i plotë treguesish e të dhënash, të cilat jo vetëm ndihmojnë për të përsosur drejtimin konkret e operativ të prodhimit, por edhe krijojnë një bazë më të fuqishme për të ndërtuar një plan mbi themele më shkencore.

7. Ashtu siç ka theksuar kurdoherë Partia, problemeve u japin zgjidhje të drejtë njerëzit e brumosur me ideologjinë tonë marksiste-leniniste, që njohin thellë ligjet objektive të zhvillimit dhe zotërojnë mirë zanatin e tyre, që punojnë e luftojnë çdo ditë si revolucionarë të vërtetë.

Edhe vënia në rrugën e drejtë të problemeve as që mund të mendohet pa revolucionarizuar më tej konceptet e njerëzve tanë. As lufta kundër globalizmit e njëanshmërisë, as përmirësimi i cilësisë e rritja e aku-

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 32, f. 155-156.

mulimit të brendshëm socialist, si dhe gjithë problemet e tjera të mëdha që ka ngritur Partia në fushën e përmirësimit të drejtimit me plan të ekonomisë, nuk zgjidhen me metodologji.

*«Që ta kuptojnë këtë, — theksonte V.I. Lenini, — duhet që ekonomistët, letrarët, statisticienët të mos llomotitin për planin në përgjithësi, por të studiojnë me hollësi realizimin e planeve tona, gabimet tona në këtë punë praktike, mënyrat për t'i ndrequr këto gabime. Pa një studim të tillë ne do të jemi të verbër. Po të bëhet ky studim, po të studiohet krahas me të eksperiencën praktike, — atëherë mbetet vetëm çështja e vogël e teknikës administrative»<sup>1</sup>.*

Prandaj kërkohet të përmirësohet e të përsoset më tej tërë metoda jonë e drejtimit, duhet të njihen thellë ekonomia politike marksiste-leniniste, ligjet objektive të zhvillimit. Këtë Partia e ka theksuar dhe e thekson vazhdimisht. Duke folur rreth kushteve në të cilat lind dhe fillon të veprojë ligji i zhvillimit të planifikuar të ekonomisë kombëtare, Stalini theksonte se ky ligj

*«...u jep mundësi organeve tona të planifikimit ta planifikojnë drejt prodhimin shoqëror. Por mundësia nuk duhet ngatërruar me realitetin. Këto janë dy gjëra të ndryshme. Që*

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 32, f. 153.

*kjo mundësi të bëhet realitet, duhet studiuar ky ligj ekonomik, duhet zotëruar ai, duhet mësuar që ai të zbatohet me njohuri të plotë të çështjes, duhen hartuar plane të tilla, që të pasqyrojnë plotësisht kërkesat e këtij ligji»<sup>1</sup>.*

Se çfarë pune e madhe mbetet për t'u bërë, në këtë fushë, mjafton të vëmë në dukje se, pas dërgimit të planit të këtij viti nga Ministria e Industrisë së Lehtë e Ushqimore, rrethet dhe ndërmarrjet i drejtuan asaj afro 100 letra, me anën e të cilave vinin në dukje mospërputhje që rridhnin për faj të tyre ose të ministrisë dhe kërkonin ndryshimin e planeve.

Prandaj njohja e thellë e ligjit të zhvillimit të planifikuar e proporcional të ekonomisë dhe e ligjeve të tjera ekonomike objektive të zhvillimit do të na ndihmojë që ato të pasqyrohen sa më drejt në planet e zhvillimit tonë ekonomik-shoqëror dhe, nga ana tjetër, jo vetëm të mos biem vetë në gabime e në shkarje borgjezo-revizioniste, por edhe t'i luftojmë e t'i demaskojmë këto me vendosmëri.

8. Për sa i përket projektvendimit që është përgatitur, mendoj se ai duhet ripunuar e plotësuar, në mënyrë që në të të gjejnë pasqyrim edhe probleme të tjera të rëndësishme që Komiteti Qendror e Qeveria dhe së fundi Kongresi i 7-të i Partisë kanë ngritur në

---

1. J. V. Stalin, «Problemet ekonomike të socializmit në BRSS», Tiranë, 1974, f. 10.

fushën e përsosjes së drejtimit me plan të ekonomisë. Shumë nga këto probleme duhet të freskohen dhe të pasqyrohen në këtë material.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verballi i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## PER NXJERRJEN E NAFTËS KËRKOIHEN STUDIME DHE GUXIM

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

19 shtator 1977

Të gjitha veprimet tona në sektorin e rëndësishëm të naftës duhet t'i shërbejnë nxjerrjes së naftës nga nëntoka. Kjo kërkon nga ne që të bëjmë mirë vlerësimin e shtresave. Për këtë të organizohen ekipe, në mënyrë që të klasifikohen strukturat ranore, gëlqerore etj. A është bërë një klasifikim i tillë apo jo? Këtu duhet parë edhe një problem tjetër. Të gjitha studimet që kryhen, për shembull, studimi i eksperiencës së huaj dhe studimi i eksperiencës sonë, të dhënat tona që dalin në bazë të gjithë atyre analizave që përgatitim, si dhe përdorimi i metodave të veçanta, bëhen në kompleksitet, apo të shkëputura? Domethënë, kur bëhen studime për të parë nëse ka apo nuk ka naftë në

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për punën e organizatave-bazë të Partisë dhe të levave të tyre në industrinë e naftës.

një strukturë, krahas analizave, a çohen këto studime në sektorët përkatës dhe a diskutohet atje në kompleks për këto studime?

Këtu u tha se, kur ballafaqohen metodat, vihet re që jo të gjitha metodat e përdorura sjellin rezultate të njëjta. Shkencërisht nuk duhet të ngjasë një fenomen i tillë. Këtu, mendoj, ndikojnë edhe faktorët që rrjedhin nga një punë e pakujdesshme, si pasojë e së cilës, për shembull, ndodh që në një pus, në vend që dinamiti të futet 30 metra thellë, futet më pak etj.

Duke lejuar pakujdesi të tilla, humbet besimi, krijohen lëkundje te specialistët dhe arrihet deri aty sa disa prej tyre janë dakord të shpohet një pus në ndonjë zonë të caktuar, ndërsa të tjerët janë kundër këtij veprimi, siç ndodhi me atë të Cakranit etj.

Prandaj është e nevojshme që specialistët e naftës t'i referohen edhe literaturës së huaj, pasi për zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara që dalin për nxjerrjen e naftës, shkenca e ka thënë fjalën e saj. Këtu kërkohet edhe guxim. Në qoftë se ndodh, për shembull, që të dhënat sizmike nuk vërtetohen kur shpohet pusi, atëherë nuk duhet tërhequr, por të thellohemi në të dhënat shkencore dhe të shpojme pusët në pozicione më të përshtatshme, në përputhje me këto të dhëna, duke vepruar me guxim derisa të merret rezultati i kërkuar. Në qoftë se shpojme katër puse dhe nuk na japin naftë, do të shpojme edhe të pestin, i cili mund të na japë, ose në qoftë se shpojme gjashtë puse dhe nuk na japin, mund të shpojme edhe të shtatën që mund të jetë produktiv. Pra, disa puse do t'i shpojme, por veç duhet pasur shumë kujdes që të

shpohen sa më pak puse të pafrytshme. Për ta realizuar këtë, brenda kësaj norme të pranueshme kërkohen edhe studime, edhe guxim. Megjithatë, me këtë nuk dua të them që të veprohet siç bënin armiqtë e popullit në sektorin e naftës, të cilët shponin pusin 2 mijë metra thellë dhe, pasi nuk nxirrnin naftë aty, shponin një pus tjetër pak më tutje, pa kriter dhe pa asnjë bazë shkencore, pa u mbështetur në studime. Këto gjëra ne duhet t'i kemi parasysh, prandaj të mos na trembin vështirësitë.

Kështu duhet parë edhe gabimi që është bërë në Cakran, duke mos i arritur shtresat e gëlqerorëve në puset që kemi shpuar deri 2 200 metra. Këto duhen rishikuar dhe të përcaktohen puset që mendohet se paraqitin interes për t'iu rikthyer që të gjejmë gëlqerorët e të nxjerrim naftë.

Në ato raste kur gjatë shpimit të puseve rezultojnë mospërputhje me projektet, duhen gjetur faktorët që çuan në një fenomen të tillë. Bie fjala, mos vallë kompleksi i punimeve nuk është kryer mirë nga ana tekniko-shkencore? Duhet parë, gjithashtu, nëse sektori shkencor që funksionon pranë Drejtorisë së Nxjerrjes së Naftës dhe që, siç u tha këtu, ka 30 specialistë, e kryen ose jo rolin për të vepruar shkencërisht dhe për të zgjidhur ato detyra që i takojnë. Të punojnë 30 specialistë është një gjë e madhe. Por ku është efektiviteti i punës së tyre? Po ashtu, a e bëjnë si duhet punën edhe gjeologët në studimet që kryejnë për projektimin e puseve të kërkimit?

Kjo, sigurisht, lidhet me kualifikimin e tyre të vazhdueshëm, me kualifikimin pasuniversitar. Gjith-



ashtu, shtrohet çështja edhe për kuadrot me arsim të mesëm. Pse, këta nuk kanë nevojë për t'u specializuar? Po për punëtorët e thjeshtë a janë organizuar specializimi e kualifikimi? Ministria e Industrisë dhe e Minierave duhet t'i ndjekë këto probleme. Ajo të ndihmojë shkencërisht, metodikisht dhe me materiale. Shokët e ministrisë duhet të studiojnë vetë më shumë dhe të mos shkojnë te pusi i naftës për të marrë dafinën, sepse kjo u përket naftëtarëve dhe jo atyre.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# **PER FORCIMIN E MËTEJSHËM TË NDERMARRJEVE BUJQËSORE PARTIA TË KAPË KYÇET KRYESORE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**21 shtator 1977**

Për raportin që na është paraqitur kam disa vërejtje paraprake. Në radhë të parë mendoj se shokët që përgatitin raportet për Sekretariatit e Komitetit Qendror duhet të bëjnë më shumë kujdes. Sot konkretisht e kam fjalën për shokët e aparatit të Komitetit Qendror që merren me bujqësinë. Ky raport iu paraqit Sekretariatit të Komitetit Qendror, funksionet e të cilit dihet që ndryshojnë nga ato të Qeverisë, të Kryesisë së Këshillit të Ministrave dhe të Ministrisë së Bujqësisë. Sekretariati i Komitetit Qendror ka për detyrë të kontrollojë si zbatohet vija e Partisë; si janë kuptuar direktivat e Kongresit të saj të 7-të nga komunistët, nga populli, nga funksionarët shtetërorë; si qëndrojnë ko-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi masat për zbatimin e orientimeve të Kongresit të 7-të të Partisë së Punës të Shqipërisë, që ndërmarrjet bujqësore të bëhen shembull dhe pararojë në sektorin e bujqësisë».

munistët dhe masat përpara problemeve që shtruan në Kongres; ç'masa po merren për zgjidhjen e tyre dhe si reagon Partia në këto drejtime. Pra, për realizimin e planit nuk ekzistojnë vetëm çështje ekonomike, por, në radhë të parë, çështje politike dhe ideologjike. Këto janë kërkesa shumë të rëndësishme që u shtrihen punonjësve dhe Partisë për t'i plotësuar. Në qoftë se nuk plotësohen, plani në vetvete dhe çdo detyrë që ka lidhje me të nuk mund të realizohen.

Nga materiali që po shqyrtojmë sot mund të të krijohet përshtypja që, ose Partia nuk është kurdoherë në krye të detyrave, ose ne udhëheqja, me aparatet që kemi, nuk jemi në gjendje të pasqyrojmë si duhet realitetin. E them këtë se në raportin që na është dhënë nuk flitet për qëndrimet e komunistëve dhe të masave punonjëse ndaj vijës së Partisë, ndaj detyrave të shtruar. Shokët që u morën me përgatitjen e tij mendoj se duhej t'i kishin pasur parasysh këto probleme të dorës së parë. Duke ndjekur planin qoftë në drejtimet ku ky realizohet, edhe në ata sektorë ose zëra ku nuk realizohet, duhet gjykuar se cilat janë arsyet (jo vetëm ato objektive, por edhe ato subjektive) që pengojnë. Vërej se mosrealizimi i planit rrjedh kryesisht për shkak të dobësive të mëdha në kuptimin politik të vijës së Partisë në bujqësi, në kuptimin ideologjik të detyrave të mëdha që ka caktuar Kongresi i 7-të i Partisë për bujqësinë, dhe në kuptimin e problemeve organizative, pa të cilat, thekson Stalini, asnjë plan nuk mund të realizohet si duhet. Organizimi i drejtë që ne kemi në bujqësi nuk mund të na sjellë vetvetiu rezultatet e dëshiruara, në qoftë se Partia nuk është në krye të masave.

Shokët e sektorit të bujqësisë më kanë dërguar edhe një material prej 22 faqesh, po edhe në këtë nuk ka konsiderata partie. Në raport, siç kam nënvizuar, thuhet: «Ministria dhe organet drejtuese të bujqësisë në rreth nuk kanë zbërthyer e nuk kanë ndjekur në shkallën e duhur zbatimin e detyrave të caktuara nga Partia. . . ». Vihet pyetja: Po pse nuk i kanë bërë këto zbërthime? Puna e Partisë është që të ndjekë kuptimin ideopolitik dhe zbatimin e plotë të detyrave. Pikërisht për të metat në këto drejtime dhe për këto mungesa serioze duhet të jepet llogari këtu në Sekretariat, duke argumentuar se cilat janë arsyet: është mefshtësia, ka nënvleftësime, ka moskuptim të detyrës apo ka arsye politike, sabotime etj. Mirëpo në këtë material që na është paraqitur, nuk flitet për këto gjëra.

Më poshtë është shkruar: «Tendenca e njëanshmërisë dhe mosndjekja e detyrave në front nga organet drejtuese të bujqësisë në qendër dhe në bazë. . . ». Por edhe për këtë mendoj se duhet sqaruar pse ndodh kështu dhe çfarë bën Partia që nuk e eliminon këtë tendencë. Në material nuk flitet se cilat janë arsyet që organet shtetërore, Ministria e Bujqësisë dhe Partia në rreth e në bazë nuk i ndjekin këto probleme në mënyrë frontale. Këto janë vërtet çështje teknike, por, para së gjithash, janë çështje partie.

Le të vazhdojmë leximin e materialit: «Gjithashtu edhe të dhënat e studimeve të eksperimentimit shkencor, të rejat e shkencës dhe të teknikës nuk janë shfrytëzuar kudo në masën e duhur. . . ». Vihet gjithashtu pyetja: Përse nuk janë shfrytëzuar të rejat e shkencës? Kush ka përgjegjësi këtu? Sigurisht, Minis-

tria e Bujqësisë në rrugën shtetërore, por në radhë të parë ka përgjegjësi Partia, sepse edhe kuadrot që punojnë në organet shtetërore, që nga ministria e deri në bazë, janë njerëz të Partisë, bile mjaft prej tyre janë komunistë dhe militojnë në organizatat-bazë të Partisë.

Dihet që në Sekretariat ne mbledhemi që të diskutojmë edhe për realizimin e planeve, prandaj në këtë drejtim mendoj se më shumë duhej të na kishte ndihmuar materiali. Në të kam nënvizuar disa paragrafë që kanë të bëjnë me çështje partie, për të cilat as në raportin e Ministrisë së Bujqësisë nuk na jepen shpjegime.

Materiali që më kanë paraqitur shokët e sektorit të bujqësisë është ndarë në disa kapituj, aty jepen statistika dhe bëhen krahasime me kooperativat e tipit të lartë. Këto të dhëna mund të merren edhe në Drejtorinë e Statistikave etj., prandaj me një paraqitje të tillë të çështjes neve nuk na jepet ndonjë ndihmë konkrete. Ka shokë instruktorë këtu në aparatën e Komitetit Qendror, që me mendimet e tyre na kanë ndihmuar me të vërtetë në mënyrë shkencore në sekretarët e Komitetit Qendror. Nga të dhënat që na japin ata, në sekretarët orientohemi në diskutimet tona. Mirëpo për vete e kam vështirë të diskutoj sot për këtë problem të mprehtë, pse në raport mungojnë të dhënat që duhet të preokupojnë Partinë. Megjithatë kjo nuk do të thotë se, për shkak të këtij boshllëku, unë nuk mund të diskutoj për këto çështje që po marrim në shqyrtim, mund të diskutoj, por ama jo nga të dhënat që janë rreshtuar këtu, por nga ato që na dërgon Partia në rrugë të tjera, si nga shtypi, nga shokët sekretarë që më mbajnë në korent etj. Prandaj studimet që na jepen për shqyrtim

të përgatiten më mirë, në atë nivel që, kur të analizohet një problem në Sekretariat, në Byronë Politike ose në Plenumin e Komitetit Qendror, çështjet që ngrihen të kthehen në direktiva për Partinë. Instruktori, kur vete në bazë me shërbim, flet me njerëzit dhe puna e tij është me vlerë, po ndryshe është kur dërgohet në bazë një raport ose një udhëzim i Byrosë Politike apo i Sekretariatit të Komitetit Qendror, ai studiohet me shumë vëmendje nga Partia.

Materiali që na është dërguar do të kishte më shumë vlerë në rast se problemet kryesore të Partisë do të ishin shtruar në mënyrë analitike; shkurt, duke shënuar si janë zbatuar detyrat, pse nuk janë zbatuar një pjesë e tyre dhe për ç'arsye nuk janë arritur rezultatet që kemi parashikuar. Veç kësaj, ky material ka datën e sotme, 21 shtator 1977! Edhe kjo nuk është serioze. Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë mendoj se herë tjetër nuk duhet t'i dorëzohet një material, duke i shënuar një datë që s'ka ardhur akoma! Secili që paraqet materiale në udhëheqje duhet të mendojë se ato bëjnë fjalë për çështje serioze mbi të cilat udhëheqja do të reflektojë, se asaj do t'i duhet të shikojë edhe dokumente të tjera për problemin. Nuk është hera e parë që ne flasim për dobësitë e ndërmarrjeve bujqësore, nuk është hera e parë që Byroja Politike e Sekretariati, Këshilli i Ministrave dhe Kryesia e tij i marrin në studim këto probleme. Atëherë çfarë tregojnë këto të dhëna që na janë dërguar, kur në to nuk bëhet fjalë si janë zbatuar vendimet? Mendoj se këto janë nënvleftësime që nuk lejohet të përsëriten.

Ne duhet ta dimë si është gjendja politike dhe

ideologjike në ndërmarrjet bujqësore, pse nga kjo varet realizimi i rendimenteve në të gjithë zërat. Duhet të dimë si drejton Partia në ndërmarrjet bujqësore. Dërisa atje nuk realizohen detyrat si duhet, kjo do të thotë se organizatat e Partisë nuk kanë punuar mirë, se në ndërmarrjet bujqësore nuk janë kuptuar mirë detyrat e Kongresit të 7-të, as referatet e leksionet e zhvilluara, as çështjet e tjera që ngrihen nga udhëheqja.

Disa mendime u hodhën këtu, ashtu thjesht, me anën e pyetjeve. Mirë bënë shokët e bashkimeve profesionale që pyetën shokët e bujqësisë, por më parë mendoj se ata duhej t'ia bënë vetes pyetjen përse me qindra punëtorë të ndërmarrjeve bujqësore nuk shkojnë rregullisht në punë. Diçka kanë ata, po cila është kjo diçka dhe nga buron, nga mungesa e një pune politike, nga mungesa e kontrollit në normat, nga nënvleftësimi i detyrave të planit në bujqësi, apo nga ndonjë shkak tjetër?

Në Kongresin e 7-të të Partisë kjo çështje me rëndësi të madhe u ngrit me forcë si një nga më vendimtarët në situatat aktuale. Ju e dini, shokë, që sikur edhe për disa ditë të mungojnë në treg vaji, sheqeri ose mielli etj., krijohet pakënaqësi në popull. Pse kooperativa bujqësore e Donofrosës në rrethin e Beratit, për të cilën edhe sot shkruhet në gazetë, merr 22 kuintalë luledielli për hektar dhe në toka mbi ujë? Kemi bërë gjithë këto mbledhje deri tani, atëherë a do të lejojmë që të vazhdohet të merren akoma 4 dhe 3.5 kuintalë pambuk për hektar kur ka kooperativa që marrin edhe 22 dhe 23 kuintalë për hektar? Kështu, pas gjithë kësaj eksperience mbi 30-vjeçare, ka ekonomi që po kthe-

hen në rendimentet e viteve të shkuara në këtë bimë! Për ç'arsye vijnë këto ndryshime? I analizoni ju, shokë të bujqësisë, këto situata apo jo? Këtu ka edhe shkaqe objektive, por ka më shumë shkaqe subjektive, bile të mëdha, dhe këto duhet të shikohen seriozisht, më duket mua. Qeveria, nga ana e saj, për sa u përket masave organizative, kontrollit dhe gjithë anëve të tjera, duhet të jetë e rreptë në këtë drejtim, por duhet të jemi të rreptë edhe ne e të mbajmë përgjegjësi, sepse pa udhëheqjen e Partisë nuk mund të ngrihet nivell i kuadrove në bujqësi.

Në materialin për të cilin vura në dukje disa anë negative, nuk flitet gjë as për edukimin teknik të kuadrove të kooperativave dhe të ndërmarrjeve bujqësore ose të kooperativave bujqësore të tipit të lartë. Bën efekt ky edukim në kuadro apo nuk bën? Unë nuk e mohoj që bën efekt, por, kur vijmë këtu në Sekretariat, duhet të dimë sa është bërë, qysh është bërë dhe ç'masa duhet të marrim që të bëhet edhe më mirë se deri tash.

Në këtë drejtim ne edhe herë tjetër kemi folur. Edhe për një material që na është dhënë e që është nja katër faqe, kisha vërejtje të kësaj natyre. Mund të them me kënaqësi se atë e kam marrë 20 ditë përpara, por konstatoj se njëlloj edhe ky titullin e ka bombastik dhe në të nuk flitet gjithashtu se ç'mendon aparati i Komitetit Qendror për këto probleme.

Më duket se punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror duhet të punojnë më mirë. Nuk është çështja se s'kanë eksperiencë, përkundrazi, por mendoj se në disa raste e në disa drejtime stili dhe metoda e punës duhen



përmirësuar kokë e këmbë, ndryshe nuk do të kryejmë mirë funksionet e detyrat që na janë ngarkuar.

*Pasi dëgjoi përgjigjet e disa pyetjeve që bëri dhe mendimet që u shprehën në këtë mbledhje, shoku Enver Hoxha tha:*

Në vazhdim të diskutimeve që bënë shokët, dëshiroj të shpreh pikëpamjen që krijova pas fjalës së shokës Themije [Thomai], si dhe pas diskutimeve të shokëve të ftuar nga baza.

Fakt është që, si nga ana e Partisë, nga dikasteri i bujqësisë, ashtu edhe nga ana e organeve shtetërore, në përgjithësi, ka një interesim të madh për ndërmarrjet bujqësore, për zhvillimin e tyre të mëtejshëm, sepse të gjithë janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka sektori shtetëror socialist i bujqësisë. Megjithatë, është e qartë se detyrat që u janë vënë ndërmarrjeve bujqësore nuk janë realizuar të tëra. Vetë shokët sekretarë të byrove të Partisë të ndërmarrjeve bujqësore «8 Nëntori» të Sukthit e «Çlirimi» të Fierit dhe sekretari i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit, të pranishëm në këtë mbledhje, nuk e mohuan këtë dhe bënë autokritikë për mosrealizimet. Por me këtë rast dëshiroj të theksoj që ne duhet të largohemi nga autokritika për autokritikë dhe kjo është një vërejtje që nuk e kam vetëm për ju, shokët e bazës, por edhe për ne këtu në qendër.

Autokritika që mund të bëjmë ne lidhur me këtë mbledhje, e cila, sipas mendimit tim, na dha një pasqyrë të rezultateve që janë arritur në sektorin shtetëror të bujqësisë sonë socialiste, është se nuk kemi men-

duar të dalim me një vendim, që t'u shërbejë qoftë ministrisë, qoftë organizatave dhe komiteteve të Partisë në rrethe dhe në bazë. Nuk mjafton vetëm ta përsëritim autokritikën, rëndësi ka që, pas saj, të realizojmë pa vonesë kthesën për zhdukjen e atyre të metave e dobësive që vërehen. Fakt është se ka raste që edhe në mbledhjet tona dalim pa vendime, edhe kur lind nevoja të merret një vendim. Jam i bindur se ju në bazë merrni vendime për problemet që analizoni. Por në këtë, në Komitetin Qendror të Partisë, duhet të marrim më shumë vendime, pavarësisht se herë pas here nxjerrim buletin. Nuk po ju pyes se sa ju ndihmon ky buletin, por, po t'ju kërkohet të më flisnit drejt, jam i bindur se do të më thoshit që atje shpeshherë ka orientime të përgjithshme. Ua thashë edhe shokëve sekretarë të Komitetit Qendror gjatë pushimit që bëmë se, po të marrim një vendim për ndërmarrjet bujqësore, projektin e të cilit duhej ta kishim përgatitur mirë përpara mbledhjes, ky duhej të kishte jo detyra të përgjithshme, por detyra konkrete të përcaktuara për Partinë, për të gjitha forumet e saj, për komitetet e rretheve dhe për organizatat-bazë.

Problemet që ngritët para Sekretariatit të Komitetit Qendror ju, shokë sekretarë të Partisë të ndërmarrjeve bujqësore, më krijuan bindjen se Partia në bazë punon, ajo mendon, krijon dhe realizon, por aparatet tona (që janë në dijeni të problemeve, natyrisht, jo aq hollësisht sa ju) duhet të bëjnë më shumë përpjekje që të na raportojnë më mirë për gjendjen, të na japin eksperiencën e bazës nëpërmjet një materiali për-

fundimtar, të cilit ne sekretarët e Komitetit Qendror mund t'i bëjmë disa përmirësime. Kjo për sa i përket Partisë, puna e së cilës është e lidhur edhe me drejtimin e ekonomisë, që, si çdo sektor tjetër i jetës së vendit, pa udhëheqjen e drejtë të vazhdueshme e të kujdeshme të Partisë, nuk mund të ecë përpara. Po nuk funksionoi Partia duke i ditur e duke i zbërthyer të gjitha direktivat dhe duke qëndruar në krye për të ndjekur zbatimin e tyre, asgjë nuk mund të realizohet si duhet. Situatat nuk janë të tilla që çështjet të merren lehtë e ta ndiejmë veten të kënaqur. Në asnjë mënyrë dhe asnjëherë nuk duhet të ketë vetëkënaqësi nga ne.

E ngre rëndësinë që ka shikimi i këtij problemi, si i çdo problemi tjetër, në rrugë partie, dua të them nga ana politike, ideologjike, organizative, si dhe nga ana praktike, se çfarë duhet të bëjë Partia në të gjitha këto drejtime, sepse kjo është vendimtarja. Kështu në vendimin që duhej të merrnim, lypsej të kishte edhe disa probleme ekonomike të lidhura me detyrat që përmenda e, bashkë me to, disa vërejtje për organet e Partisë dhe ato shtetërore, deri edhe për Qeverinë, për mosrealizimet që janë shkaktuar.

Qeveria, për shembull, ka marrë vendim, ka caktuar edhe fonde që të ndërtohen koçekë për depozitim e misrit. Këtë detyrë e kanë marrë përsipër ta kryejnë disa ente. Janë dhënë edhe fonde monetare, janë siguruar materialet e nevojshme, mirëpo konstatohet se organet e ngarkuara nuk tregojnë kujdes t'i ndërtojnë koçekët, dhe jo vetëm kaq, por edhe kur dalin të tjerë, siç përmendi shoku i ndërmarrjes bujqësore të Sukthit, dhe propozojnë që t'ua japin këtyre

fondet monetare dhe materialet, se janë gati t'i ndërtojnë vullnetarisht me forcat e tyre, ata të ndërtimit nuk pranojnë. Atëherë, në rastin konkret, ne do të vinim në vendim një pikë për t'i thënë Qeverisë që të marrë sa më parë masa për ndërtimin me domosdo dhe në kohën e duhur të koçekëve, siç do t'i themi që të marrë masa urgjente për t'u paguar ditët e punës kooperativistëve në disa rrethe, ku për muaj me radhë, në kundërshtim me direktivat, nuk u janë paguar.

Duke përcaktuar detyra konkrete në vendimet tonë, si dhe duke parashikuar edhe masa ndaj atyre që neglizhojnë zbatimin e tyre, besojmë se këto nuk do të mbeten më si orientime të përgjithshme, se të tilla kemi boll. Kështu do të bëheshin përpjekje më serioze për zbatimin e detyrave.

Ne vëmë re edhe një praktikë shumë të gabuar. Kur del një vendim për një çështje të caktuar, ka nga ata që i harrojnë të mëparshmet. Në dokumentet e Partisë dhe të Qeverisë ekzistojnë vendime e orientime për çdo problem, vetëm se ndodh që ato lihen mënjanë, nuk mbahen kurdoherë parasysh e nuk ndiqen sistematikisht. Edhe këtë duhet ta shpjegojë Partia, përse lihen mënjanë, cilat janë shkaqet subjektive, organizative apo teknike që vendimet nuk ndiqen në vazhdimësi. Partia, derisa e ka të qartë rolin e saj drejtues dhe kontrollues, këtë duhet ta luajë si duhet, në radhë të parë duke frymëzuar njerëzit politikisht dhe ideologjikisht, por njëkohësisht të marrë edhe masa të rrepta për t'i vënë punonjësit e organeve të pushtetit dhe të organizatave ekonomike, qofshin këta anëtarë

partie ose jo, përpara përgjegjësisë dhe për t'i kontrolluar vazhdimisht se si i ndjekin vendimet.

Me gjithë boshllëqet që kemi për realizimin e detyrave në disa sektorë, kur shikon gjithë këto rezultate që janë arritur në ndërmarrjet bujqësore, njeriu nuk mund të mos ndiejë një kënaqësi të ligjshme. Shoqja ministre e Bujqësisë na raportoi këtu se brenda vitit është reduktuar numri i ndërmarrjeve bujqësore që subvencionohen nga shteti, pse dalin me humbje. Kjo është një punë e mirë, megjithatë të mos na vërë në gjumë, pse duhet punuar akoma në mënyrë që të gjitha ndërmarrjet bujqësore, pa përjashtim, të dalin me plane të realizuara në cilësi, në sasi dhe në kosto. Këtë është kollaj ta thuash me fjalë, por, për ta realizuar, duhen kryer një sërë detyrash të mëdha partie dhe shtetërore. Kuptojeni drejt këtë. Ne nuk jemi idealistë. Mos mendoni se, kur themi, fjala vjen, «duhen realizuar detyrat», kujtojmë se çdo gjë do të kryhet vetvetiu e në mënyrë të përsosur. Jo, se ka edhe raste që detyrat e planet nuk plotësohen. Por, kur shohim që nuk realizohen disa detyra që mund të realizoheshin, bile jo me një sforcim dhe aq të madh, një gjë e tillë nuk ka si të mos na hidhërojë. Pra, me gjithë përmirësimet e dukshme që shihen në ndërmarrjet bujqësore, nuk ka vend për vetëkënaqësi. Për forcimin dhe fuqizimin e mëtejshëm të tyre Partia duhet të bëjë kujdes, të kapë mirë kyçet kryesore, disa prej të cilave, që janë të rëndësishme, ju i përmendët këtu.

Një nga këto kyçe është problemi i kuadrove që kemi mësuar dhe kemi edukuar në sektorin e bujqësisë, të cilët kanë fituar tashmë një eksperiencë të

mirë teknike. Mirëpo duhet punuar vazhdimisht me ta që diturinë dhe eksperiencën ta vënë plotësisht në zbatim me një organizim të përsosur. Vetë ata e dinë më mirë nga kushdo tjetër se si duhet punuar. Zbatimi i një eksperience të përparuar kërkon patjetër edhe një organizim të përparuar. Partia duhet të punojë që ta bëjë të ndërgjegjshëm specialistin se misri hibrid, për shembull, kërkon një organizim të mirë të punëve e disiplinë me të vërtetë të rreptë. Por, në qoftë se specialistët tanë nuk e realizojnë këtë orientim dhe vazhdojnë të flasin e të punojnë në përgjithësi, duke menduar se këtë punë duhet ta bëjë Partia etj., etj., kjo do të thotë se ata nuk e kuptojnë mirë detyrën e tyre. Natyrisht, për të realizuar detyrat që na vihen përpara, Partia duhet të veprojë si në luftë, në mënyrë të organizuar, dhe të tërheqë me vete e të udhëheqë si duhet masat punonjëse, se ato janë faktori vendimtar. Ashtu si në luftë, ku Partia nuk shkon vetëm, po me popullin e organizuar, edhe për realizimin e detyrave në bujqësi, të një eksperimenti të përparuar etj. kërkohet organizimi përkatës, duke vënë në lëvizje si duhet brigadat, sektorët, gjithë kooperativën, dhe në krye të të gjithë këtyre duhet të jenë komunistët. Por rol me rëndësi kanë, gjithashtu, edhe specialistët e teknikët, të cilët, qoftë në kooperativa, qoftë në ndërmarrjet bujqësore apo në rrethe, duhet të bëjnë një punë shumë aktive, revolucionare, duke u larguar absolutisht nga rutina e zyrës dhe, me komunistët në ballë, t'i mobilizojnë masat për të realizuar detyrat.

Ajo që na ngriti me të drejtë sekretari i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit për financierët dhe

ekonomistët e bujqësisë, që nuk lëvizin nga zyrat, është një sëmundje e rrezikshme. Të jesh financier në kooperativë, duhet të jesh, sipas mendimit tim, shumë i lidhur me prodhimin, me sektorët, të shkosh vazhdimisht pranë parcelave ku prodhohet. Financierit i kërkohet të mbajë kontakt të vazhdueshëm me punëtorët e ndërmarrjes ose të kooperativës që punojnë në sektorë dhe në brigada, t'u shpjegojë atyre që të luftojnë për të zbatuar të gjitha detyrat e për të kryer të tëra shërbimet ndaj bimëve, me qëllim që të realizohen rendimentet e parashikuara për çdo parcelë, dhe këto t'ua lidhë me anët financiare dhe ekonomike. Duke ndjekur punën në terren, duke filluar që nga këqyrja e cilësisë së plugimit të tokës, e plehërimit të bimëve, e prashitjes dhe e ujitjes së tyre etj., duke vrojtuar me imtësi se si i kryejnë të gjitha këto procese të domosdoshme punonjësit e bujqësisë, për shembull, sa pleh i hedhin bimës, kur ia hedhin e kur nuk ia hedhin, duke u njohur me të gjitha këto probleme, financieri do të bëhej njëkohësisht edhe agronom, ashtu sikundër kemi thënë se duhet të bëhen edhe traktoristët. Këta duhet të mësojnë jo vetëm si t'i drejtojnë traktorët, si t'i ngasin në fushë apo si t'i ndreqin, por edhe sa thellë duhet punuar toka, kur duhet filluar puna etj., etj., me një fjalë të njohin mirë agroteknikën.

Kjo kërkohet edhe nga financieri. Në qoftë se ai i ndjek këmba-këmbës problemet, do të jetë në gjendje t'i vërë gishtin plagës, të zbulojë se në cilin sektor apo parcelë ekzistojnë dobësi dhe atëherë, tok me shtabin e specialistëve, domethënë me agronomin, me veterinerin, me zooteknikun, me skuadrën që merret me ple-

hërimin e të tjerë, propozon të bëhet mbledhje. Aty ai vë në dukje që, në qoftë se punonjësit dhe specialistët nuk grumbullojnë e nuk hedhin në arë aq pleh sa është parashikuar, nuk do të merren rendimentet që priten, si rrjedhim do të ketë kaq minus në prodhim, kështu që edhe niveli i parashikuar i ditës së punës do të ulet. Ai u sinjalizon me këtë mënyrë anëtarëve të kooperativës që të mos shkojnë me mendimin se vlerën e ditës së punës që kanë caktuar në plan, ta zëmë 16 lekë, e kanë në xhep pa bërë përpjekje për realizimin plotësisht të detyrave të planit. Jo, këtë sasi parash, u thotë financieri, ju nuk do ta merrni, po të mos i realizoni të gjitha detyrat e parashikuara. Siç e shikni, është me rëndësi të madhe roli i punonjësit të financës. Prandaj, në qoftë se ai rri tërë ditën në zyrë, ku fundi i fundit nuk bën ndonjë gjë të madhe, do të thotë që nuk e kryen detyrën. Unë mendoj se edhe financieri duhet të jetë një nga kuadrot e kooperativës që të ndihmojë për realizimin e çdo detyre plotësisht dhe në kohë. Të gjithë specialistët e një ndërmarrjeje apo kooperative bujqësore duhet të përqendrojnë në mënyrë sa më të organizuar fuqitë, dijenitë dhe eksperiencën e tyre që kooperativa ose ndërmarrja bujqësore të përparojë.

Duhet të braktiset ajo metodë pune që ndjekin disa kuadro që shkojnë në bazë vetëm sa për të dhënë urdhra dhe direktiva, si «mbillni në këtë kohë ose mbillni në atë kohë» etj. Shefi i seksionit të bujqësisë pranë komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit mund t'i japë ndonjë mendim kryetarit ose agronomit të kooperativës se në ç'kohë duhet ta mbjellë



misrin, por më e arsyeshme do të ishte të diskutonin bashkë nëse duhet mbjellë apo nuk duhet mbjellë atëherë kur mendojnë specialistët e rrethit. Kuadrot përgjegjës në rreth mund të kenë dhe duhet të kenë mendime, po mendimet e tyre janë disi larg realitetit, ato mund të jenë jo të bazuara. Prandaj në të tilla raste këshillimi me bazën është i domosdoshëm. Natyrisht, shefi i seksionit të bujqësisë në rreth duhet të bazohet në ato të dhëna të meteorologjisë që ka shteti ynë dhe, duke gjykuar sipas tyre, t'i tërheqë vëmendjen bazës kur afron afati i mbjelljes, por në rast se kjo i thotë «dale, të presim edhe ca ditë, se mos bën kohë më e mirë, pastaj të mbjellim», atëherë duhet të këshillohet me të dhe, kur është i bindur, urdhrin ta argumentojë, t'u mbushë mendjen vartësve, me qëllim që puna të kryhet si duhet.

Dihet që lufta nuk bëhet vetëm me gjeneralët, por në radhë të parë me luftëtarët e thjeshtë dhe me komandantët e tyre të niveleve të ulëta, duke filluar që nga ata të skuadrave e të togave. Të gjithë këta duhet të jenë të mësuar, shokë, prandaj stërvitemi që tani, që të jemi të përgatitur. Kështu duhet të veprohet në çdo sektor pune, pra edhe në bujqësi. Beteja për prodhimet bujqësore e blegtorale duhet të fillojë që nga punëtori më i thjeshtë dhe deri te përgjegjësi më i lartë, prandaj na bie detyrë që të gjithë këta t'i mësojmë vazhdimisht. Kjo kërkon që të merren me kohë masa që shkollat dhe kurset, kudo që i hapim, të funksionojnë dhe ta kryejnë mirë detyrën. Në qoftë se duhet të hartohet një plan unik për to, ky të përgatitet sa më shpejt dhe pa humbur kohë. Të hapen kurse për

sektorë e për bimë të veçanta dhe jo t'i lihet kjo çështje spontaneitetit apo punonjësit të bien në praktikizëm, se në këtë rrugë nuk mund të arrijmë rezultatet e larta që parashikojmë.

Janë plotësisht të vërteta ato që vuri në dukje në diskutimin e tij shoku Qirjako Mihali për mjelësen e ndërmarrjes bujqësore «Gjergj Dimitrov» këtu në Tiranë, Gjyze Marën, e cila, pavarësisht se nuk ka ndonjë shkollë të lartë, në realitet, në praktikë, ajo zbaton shkencën, sepse shkenca zooveterinare nuk kërkon gjëra të tjera, veçse të zbatohen pikërisht të gjitha ato që praktikon kjo punëtoare e dalluar. Por të kemi parasysh se në republikë nuk janë të tëra mjelëset si Gjyzja, bile si ajo mund të mos jetë edhe ndonjë specialist me arsim të lartë. Atë punë aq të mirë që bën bariu i dëgjuar Lezan Pislë në rrethin e Matit me dhinë e veta, zootekniku që ka mbaruar Institutin e Lartë Bujqësor, të paktën në vitet e para nuk e bën dot. Prandaj edhe kuadrot me arsim të lartë duhet të mësojnë nga librat vazhdimisht, por duhet të mësojnë edhe nga eksperiencia e madhe e njerëzve të shquar të prodhimit dhe të jenë modestë, pse shkenca këtej ka dalë, nga prodhimi. Grami<sup>1</sup>, që shpiku makinën që mban emrin e tij, nuk ishte inxhinier, ai një punëtor i thjeshtë ishte, por ama shpiku një makinë që i dha hov të madh zhvillimit të mekanikës. Pra, mësimi, në të gjitha format e tij në shkolla dhe në kurse, lidhur ngushtë edhe me praktikën, me eksperiencën e më të mirëve, si kudo,

---

1. Zenob Grami, shpikës belg (1826-1901), shpiku kolektorin dhe ndërtoi dinamon e parë industriale.

edhe në fushën e bujqësisë, është një kyç me rëndësi.

Por ashtu si problemi i mësimit në bujqësi ka edhe shumë probleme të tjera. Të marrim, për shembull, farërat e zgjedhura. Këto kanë teknikën e tyre dhe kjo teknikë duhet mësuar, por ky problem ka të bëjë njëkohësisht edhe me ngritjen e ndërgegjes së të gjithë kooperativistëve, sidomos të atyre që janë të ngarkuar të merren me farërat, që këto të zgjidhen, të trajtohen dhe të konservohen sa më mirë deri në kohën e mbjelljes. Edhe toka, që është baza kryesore në bujqësi, ka anët e saj. Natyrisht, jo çdo njeri i kupton rëndësinë e përbërjes së tokës dhe shndërrimet fiziko-kimike që pëson ajo vazhdimisht, prandaj specialisti duhet të grumbullojë të gjitha të dhënat për këtë problem kyç dhe mbi bazën e tyre të nxjerrë detyrat që duhen zbatuar në praktikë për përmirësimin e strukturës së tokës.

Pa hyrë në detajet e prodhimit, mendoj se në të gjitha këto çështje Partia luan rolin vendimtar. Po të punohet që detyrat të kryhen me frymë revolucionare, atëherë do të gjallërohet i madh dhe i vogël në ndërmarrje apo në kooperativa bujqësore. Në qoftë se çështjet nuk do të zgjidhen nëpërmjet debateve serioze, por duke dhënë urdhra të pamenduar thellë apo direktiva të pazbatueshme, sigurisht që do të krijohet indiferentizëm në punonjësit e bujqësisë. Prandaj është e domosdoshme të dëgjohet me vëmendje zëri i masës apo i specialistëve me arsim të mesëm e tetëvjeçar, që janë faktorë me rëndësi në prodhim. Nuk duhen nënvleftësuar mendimi dhe puna e specialistëve me arsim të lartë, por, pa masën e punonjësve të thje-

shtë dhe të teknikëve me arsim 8-vjeçar dhe të mesëm, ata nuk do të mund të bëjnë shumë gjëra. E kam përmendur edhe një herë tjetër si shembull mendimin e urtë që kam dëgjuar nga një sahatçi në Gjirokastër, këtu e rreth 60 vjet përpara. Ky kishte lidhje çdo ditë me njerëz të popullit që i çonin sahatet për t'ua ndrequr. Unë e kisha kushëri, prandaj i veja shpesh në dyqan dhe e pyesja: More ç'bën ngahera me këta sahatë? «Dëgjo këtu,» m'u përgjigj ai një ditë, duke nxjerrë nga xhepi një sahat sa një qepë, dhe, pasi e hapi, më tha: «I shikon pllakat e mëdha të sahatit? Po u prish një nga këto, sahati prapë punon, kurse po u prish qimja e vogël, mbeti, nuk punon më, atëherë hidhe në lumë». Unë nuk e kuptoja atëherë këtë filozofi të tij, por ai e merrte me mend pozitën time, prandaj më thoshte: «Ik tani, se do ta kuptosh më vonë, kur të rritesh».

Me këtë dua të them se teknikët e ulët, si kudo, edhe në bujqësi, si ata që kryejnë shkollat e rezervave, edhe ata që përgatiten në rrugë të tjera, janë «duart» e specialistëve me arsim të lartë, janë ata që futin drejtpërdrejt duart në baltë, që ndjekin zhvillimin e bimës që kur ajo del mbi sipërfaqe të tokës derisa rritet dhe arrin pjekurinë. Por, për të arritur deri këtu, atyre u duhet t'i bëjnë prashitjen, tëharrjen, ujitjen etj. Prandaj Partia, më duket mua, duhet të bëjë përpjekje akoma më të mëdha që njerëzit e prodhimit të ngrihen në masë në një nivel gjithnjë e më të lartë.

Të gjitha këto probleme t'i lidhim vazhdimisht mirë me situatat. Partia në bazë nuk është se nuk i kupton dhe nuk i lidh detyrat e përditshme me situa-

tat politike. Ajo, në përgjithësi, i kupton drejt dhe i lidh ato, por, kur konstatojmë se te punonjësit e disa ndërmarrjeve e kooperativave bujqësore ka njëfarë vetëkënaqësie, kënaqësia që ndiejnë ata, natyrisht, nuk është pa baza, sepse niveli i jetesës së njerëzve tanë ka ardhur duke u përmirësuar vazhdimisht, por, kur bien në vetëkënaqësi e kënaqen me pak, kjo duhet të na shtyjë të nxjerrim konkluzionin se puna politike e Partisë sonë me njerëzit nuk është në atë shkallë që e lypin situatat politike ndërkombëtare, ku jetojnë dhe luftojnë mbarë punonjësit e vendit tonë socialist. Të gjithë këta njerëz ta kenë të qartë se s'duhet të jenë të kënaqur ngaqë kanë arritur një nivel të caktuar jetese. Ky nivel jetese që kemi është akoma i ulët, prandaj të luftojmë që ta ngremë edhe më shumë dhe të krijojmë për republikën tonë socialiste një situatë ekonomike shumë më të shëndoshë, të rritim vazhdimisht rezervat, siç kemi vendosur, në mënyrë që të jemi në gjendje të përballojmë çdo të papritur, çdo rrezik eventual që mund të na vijë.

Këto probleme të mos i shtrojmë vetëm sa për t'i shtruar, por herë pas here t'i kujtojmë dhe t'i rikujtojmë jo në mënyrë skolastike, por lidhur ngushtë me jetën, me punën. Në qoftë se këto probleme që ka ngritur Partia, për realizimin e të cilave ajo ka mobilizuar anëtarët e saj dhe masat brenda vendit, ka angazhuar edhe opinionin e shëndoshë përparimtar jash-të, do të dimë t'i gërshetojmë me veprimtarinë dhe me punën e përditshme që bëjnë njerëzit, s'ka asnjë dyshim se do të kemi më shumë rezultate.

Sëmundja e burokratizimit nuk ekziston vetëm

në bazë, por edhe në organet qendrore. Duhet të mbajmë mirë parasysh se në organet qendrore ajo bëhet shumë më e rrcizkshme. Në qoftë se baza konstaton se ka disa forma pune, planifikimi, shpërndarjeje që nuk ecin, të cilave u duhen bërë ndryshime dhe përmirësime, një nevojë e tillë t'u bëhet e njohur edhe komiteteve të Partisë, edhe ministrive, ku është e domosdoshme të diskutohet për to dhe, kur këto nuk gjejnë zgjidhje, problemi duhet shtruar drejtpërdrejt edhe përpara Qeverisë dhe Komitetit Qendror të Partisë.

Megjithatë brenda caqeve që lejohen dhe pa prishur planin, duke realizuar kursime më të shumta, baza duhet të ketë iniciativë për të bërë shumë gjëra në të mirën e ekonomisë popullore. Iniciativa që morët ju në Elbasan për të ndërtuar impiante për ujitjen në formë shiu në tokat e Belshit, është e mirë. Megjithatë dëshiroj të vë në dukje që, si ju, ashtu edhe ndërmarrjet që ju ndihmuan për përgatitjen e këtyre impianteve, e dinë fare mirë se çdo gjë duhet bërë me plan, të jetë e parashikuar. Prandaj ato ndërmarrje që jua përgatitën impiantet, pavarësisht nga puna e mirë që bënë, duhet të japin llogari për këtë shkelje të planit. Ato të përgjigjen, se këto impiante jashtë planit i bënë duke mbajtur mënjanë rezerva materialesh të panjohura nga organet e planifikimit, pra i kanë fshehur ato. Sigurisht që këtë rezervë ata nuk e shpërdoruan, se jua dhanë juve që realizuat ujitjen në formë shiu, pra i përdorën për një punë të interesit të përgjithshëm, por përpara udhëheqjes së Partisë dhe udhëheqjes shtetërore një praktikë e tillë duhet kritikuar

dhe të mos përsëritet më. Të gjithëve na kujtohet se si vepronte armiku Lipe Nashi. «Një urë të tërë ju bëj unë», u thoshte ai shokëve drejtues në rrethe, sepse me kokë të tij apo duke i fryrë dikush në vesh, mbante rezerva materiale e monetare të pakontrolluara nga qendra dhe këto i përdorte sipas tekave, dëshirave të tij e për të arritur qëllime të caktuara. Prandaj i kemi dënuar ne këto praktika dhe ngulim këmbë që çdo gjë të planifikohet. Kur të tilla gjëra bëhen jo me materiale rezervë ose të fshehura me qëllim, por me lëndë të parë të kursyer, pa dëmtuar cilësinë, apo duke bërë racionalizime etj., etj., atëherë ato janë me të vërtetë për t'u lavdëruar.

Juve në Sukth, shoku sekretar<sup>1</sup>, nuk do t'ju dënonim në rast se patëllxhanët që nuk jua tërhoqi as tregtia për t'ia dhënë tregut, as industria për t'i përpunuar, do t'i kishit vënë turshi vetë. Vërtet do t'ju duhej të harxhonit një sasi kripe jashtë planit, po ne do t'ju përgëzonim për këtë iniciativë. Në qoftë se nga rrethi do t'ju tërhiqnin vërejtjen, do të ndërhynim ne dhe do t'u thoshim shokëve drejtues në Durrës: Vërejtjen mos ua bëni kuadrove të ndërmarrjes së Sukthit që u përpoqën për të mos e lënë prodhimin të kalbej, por Ministrisë së Industrisë. Duhet bërë shembull dhe duhen inkurajuar iniciativat e drejta, natyrisht, kur këto nuk i sjellin perturbacione ekonomisë.

Duhet kuptuar edhe një gjë. Plani bëhet në bazë. Këtë çështje e diskutuam edhe pardje në mbledhjen

---

1. I drejtohet sekretarit të byrosë së Partisë të ndërmarrjes bujqësore «8 Nëntori» të Sukthit.

e Byrosë Politike, ku u bënë propozime për përmirësime të tjera të mëtejshme në metodologjinë tonë të planifikimit. Këto propozime do t'i rishikojë Qeveria dhe në të ardhmen ne do të kemi një planifikim më të drejtë. Sidoqoftë, pavarësisht se çdo gjë është e planifikuar, vështirësitë që ju janë shkaktuar në bazë për tërheqjen e disa prodhimeve, kanë ndodhur nga mosrealizimi i planit në sektorë të tjerë. Kështu Ministria e Komunikacionit mund të ketë tërhequr nga parqet makinat e destinuara për transportimin e prodhimeve bujqësore dhe ia ka dhënë, fjala vjen, kromit. Prandaj domatet apo patëllxhanët e prodhuar jashtë planit nuk janë transportuar, janë lënë kështu të prishen, duke menduar se «këto prodhime nuk kanë ndonjë vlerë të konsiderueshme përpara kromit, i cili ka rëndësi më të madhe ekonomike». Me një sy të tillë shikohen ngandonjëherë këto çështje nga dikasteret. Qëndrime të padrejta vihen re edhe nga baza, sepse planifikimi unik dhe i organizuar në shkallë republike parashikon që plani të realizohet në kohë, në afat dhe në cilësi. Edhe transporti ynë mbi këtë bazë është mbështetur, ky nuk ka aq tepër mjete që t'i dërgojë atje ku mund të paraqitet nevoja, ose kur ka diçka të paparashikuar. Pikërisht në këto raste duhet iniciativa nga vetë baza.

Ju shokët e bazës, me paraqitjen e gjendjes që na bëtë këtu në Sekretariatit e Komitetit Qendror të Partisë, na ndihmuat, siç na ndihmuan edhe gjithë materialet e tjera që na janë paraqitur, duke përfshirë edhe raportin e shokëve të aparatit të Komitetit Qendror që merren me bujqësinë, që është, gjithashtu,



një dokument me rëndësi, të cilin shokët duhet ta studiojnë, pse aty do të gjejnë një pasqyrë të gjendjes ekzistuese në ndërmarrjet bujqësore. Por, siç vura në dukje, problemet kryesore në të duhej të paraqiteshin në mënyrë analitike, duke vënë në dukje qartë se si janë realizuar detyrat, cilat prej tyre nuk janë realizuar dhe për ç'arsye, si dhe masat që mendohet të merren për përmirësimin e gjendjes etj. Unë e di që shokët e aparatit që merren me bujqësinë, e kuptojnë drejt kritikën, pse sqarova që, kur vijmë në mbledhjet e Byrosë Politike ose të Sekretariatit të Komitetit Qendror, problemet i shtrojmë ndryshe nga ç'shtrohen në Qeveri. Me këtë nuk dua të them se Qeveria e lë mënjanë anën politike dhe ideologjike të problemeve që diskuton. As në këtu nuk e lëmë në harresë anën ekonomike, por theksojmë më shumë anën politike, sikurse na e vunë mirë në dukje shokët e bazës që na raportuan në mbledhjen e sotme të Sekretariatit.

Për mosrealizimin e planit të grurit diçka mund t'ju falim, shokë të Ministrisë së Bujqësisë, por për misrin jo, pse këtë vit, sidomos, sipërfaqen më të madhe të mbjellë e kemi nën ujë. Pastaj kemi edhe misrin hamullor, i cili duhet të na i kompensojë ca boshllëqet që na u krijuan nga mosrealizimi i planit.

Kisha edhe një pyetje: Unë e di se një komitet partie ka si për Ndërmarrjen Bujqësore të Kamzës, ashtu edhe për Institutin e Lartë Bujqësor. Mos pengon gjë ky organizim? Mendoj se duhet të pengojë, pse Instituti i Lartë Bujqësor është një institucion i madh, po edhe ndërmarrja bujqësore është e madhe,

prandaj ndoshta duhet parë ndarja e tyre<sup>1</sup>. Në qoftë se do të arrihet kjo, atëherë instituti, sa herë vjen radha e punës praktike të studentëve, mund t'i vërë këta në dispozicion të ndërmarrjes bujqësore në kohë të caktuara.

*Botuar për herë të parë,  
me shkurtime, në librin:  
Enver Hoxha, «Raporte e  
fjalime 1976-1977», f. 380*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjëndet në AQP*

---

1. Në bazë të kësaj porësie, në vitin 1978 u krijuan dy komitete partie: një për Institutin e Lartë Bujqësor dhe një për Ndërmarrjen Bujqësore të Kamzës.

# STUDIMI I TEORISË MARKSISTE-LENINISTE TË BAZOHET NË VEPRAT E KLASIKËVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

21 shtator 1977

*Në fillim të mbledhjes shoku Enver Hoxha bëri disa pyetje e ndërhyrje:*

Cili nga shokët e ftuar mund të na vërë në korent për probleme të veçanta që kanë të bëjnë me çështjen që kemi në rendin e ditës? Njëpërmjet diskutimeve mund të na plotësohet më shumë materiali që na është paraqitur. Mirë, shoku Zija [Xholi], mund të na flasësh. Edhe ti qenke zbardhur nga flokët. Jam në dijeni se ti nuk rri pa punuar, shkrimet e tua që kam lexuar janë shumë të mira, për mendimin tim, janë shkrime me partishmëri.

Ç'thonë studentët për politikën që ndjek aktualisht udhëheqja e Kinës? Ç'mendime kanë ata? Mund të na thoni ndonjë gjë? Kinezët propagandojnë se ka

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për nivelin e lëndëve marksiste-leniniste dhe për masat për përmirësimin e tyre.

tri botë. Sipas tyre duhet të bashkohen vendet e «botës së tretë», të «botës së dytë» plus edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër Bashkimit Sovjetik. Ata vetë lënë të kuptohet se qëndrojnë në «botën e tretë», kurse «bota e dytë» është mikja jonë, thonë.

Ju në universitet i studioni këto teori idealiste dhe antimarksiste? Është e nevojshme t'i studioni, se, po nuk i njohët, s'keni as si t'i luftoni. Për shembull, teoria e Lombrosos<sup>1</sup> është një teori reaksionare, e cila, që të luftohet, më parë duhet njohur, domethënë të kuptohet se ku e bazon Lombrozoja teorinë e tij për kriminalitetin. Në Shkollën e Partisë studiohen pjesët që Marksia ka shkruar kundër teorisë së Rikardos etj., por kaq nuk mjafton, se janë nxjerrë vetëm citate nga kjo teori. Prandaj pedagogu duhet ta njohë, që ta demaskojë këtë edhe në çështjet e tjera.

Materialet që përmbajnë teori idealiste, antimarksiste, në asnjë mënyrë nuk i duhen dhënë çdo njeriu. Edhe ne vetë kemi mësuar në shkollat e borgjezisë, prandaj na është dashur, në moshë të rritur, të pasurojmë «hauret». Po të jepen libra të Frojdit, për shembull, ndonjë i ri ose ndonjë lexues tjetër ka rrezik që të bjerë në pozita të sëmurë idealiste, kurse edukatorit, pedagogut, që zotërojnë mirë marksizëm-leninizmin dhe dinë ç'të fshijnë e ç'të mbajnë nga kjo apo ajo teori, mund t'u jepen. Ata duhet ta kuptojnë dhe të dinë ku konsistojnë pikëpamjet idealiste e metafizike, ndryshe nuk kanë si t'i luftojnë këto. Natyrisht, pe-

---

1. Cezare Lombroso (1835-1909), psikiatër e antropolog Italian.

dagogëve ose kujt do tjetër të tillë libra do t'u jepen me qëllim që t'u kundërvihen teorive që mbrojnë autorët në këta libra, se, po t'ua japim vetëm sa për t'u njohur, kjo do të mbetet si një stoli, ose një teori e tillë mund të influenconte negativisht mbi ta. Çështja, pra, është t'u jepen materiale që të reflektojnë dhe të zhvillojnë luftën kundër teorive që ato përmbajnë.

*Në përfundim të diskutimeve shoku Enver Hoxha tha:*

Unë, shokë, desha të shtoja diçka lidhur me atë që përmendi shoku Ramiz. Pedagogët tanë të marksizëm-leninizmit lypset të bëjnë përpjekje që ata vetë, në radhë të parë, ta përvetësojnë këtë teori si duhet, në gjerësinë e saj dhe në aspekte të ndryshme, si në drejtim të zhvillimit të shoqërisë sonë socialiste, ashtu edhe të luftës kundër ideologjive armiqësore idealiste, kapitaliste, revizioniste e të tjera. Në qoftë se pedagogët tanë e studiojnë marksizëm-leninizmin në këtë prizëm, ata do të jenë më të zhdërvjellët dhe më në gjendje që t'u japin kyçet e kësaj teorie dëgjuesve, nxënësve, studentëve, masave të gjera të Partisë dhe të popullit. Duke qenë të përgatitur si duhet, pedagogët do të dinë t'i kapin mirë këto kyçe dhe ta bëjnë mësimin sa më të kuptueshëm, jo me terma të rëndë filozofikë, por me ide të asimilueshme dhe të lidhura ngushtë me situatat e me ngjarjet. Ne jemi të ndër-gjegjshëm se, si rezultat i punës së madhe të gjithanshme që është bërë dhe po bëhet nga Partia, opinioni marksist-leninist jo vetëm i Partisë, por edhe i popullit tonë është formuar dhe është forcuar; por, në qoftë se edhe pedagogët do të arrijnë ta bëjnë mirë këtë

punë, mendoj se do ta ngremë akoma më shumë nivelin ideopolitik të Partisë dhe të popullit.

Pedagogët tanë të marksizëm-leninizmit, në mes kësaj morie njerëzish që përgatitin, do të gjejnë elementë të talentuar, për të cilët ne kemi shumë nevojë. E kam fjalën për ata njerëz që i përgatitim për të edukuar komunistët dhe masat e popullit me ideologjinë marksiste-leniniste. Nga ata kërkohet shumë kujdes që kuadrot e rinj ta përvetësojnë sa më mirë teorinë tonë, pse, siç na mëson Partia, edhe pedagogët, edhe komunistët e masat e popullit duhet ta kenë kurdoherë si busull marksizëm-leninizmin, që të orientohen në çdo moment prej tij për zgjidhjen e drejtë të problemeve tona të brendshme, për kuptimin e ngjarjeve që zhvillohen jashtë, për të kapur me mprehtësi gabimet ideologjike, prirjet idealiste ose reaksionare që mund të shfaqen në shkencën e ndryshme.

Të kemi parasysh se vendi, Partia, shteti dhe shkencën jonë nuk mund të zhvillohen e të përparojnë duke qenë të izoluar nga bota që na rrethon, nga ai që e quajmë «presion i jashtëm», i cili vepron mbi ne. Ka shkencëtarë dhe elementë të tjerë progresistë në botë, dijenitë e të cilëve duhet t'i përvetësojmë, por nuk përjashtohet që edhe ata, ndërsa në një drejtim janë në përparojë, në pozita përparimtare, në një drejtim tjetër mund të jenë të pleksur në mos me një ideologji idealiste fare reaksionare e të dukshme për cilindo, me një ideologji jo fort të pastër, me ide, si të thuash, në pamje të jashtme përparimtare, por që në thelb s'janë kështu. Një kuadër i paformuar mirë, që bie në kontakt me ide të tilla, e ka vështirë ta da-

llojë, siç thotë populli, shapin nga sheqeri dhe ka rrezik të bjerë në pozitë e asaj teorie apo filozofie që nuk është jona, ose t'i kuptojë gabim problemet ekonomike apo praktikën e tjera shkencore.

Duhet ta kemi të qartë se shabllonizmi në edukimin marksist-leninist të njerëzve nuk i pajis ata me aftësi orientuese. Sidomos leksionet apo shpjegimet e pedagogëve ose të atyre kuadrove të Partisë që nuk janë pedagogë, po merren drejtpërdrejt me sektorin e edukimit dhe që gjatë punës së tyre me njerëzit përdorin vetëm fraza propagandistike, me format shabllone nuk mund të shpjegojnë shumë gjëra dhe të edukojnë masat punonjëse ashtu siç kërkohet nga Partia. Për revizionizmin modern shpesh përmenden fraza nga disa kuadro, mirëpo revizionizmi nuk është vetëm një rrymë e madhe dhe e fuqishme, që është ngritur sot kundër marksizëm-leninizmit, por ai është një përqendrim i të gjitha teorive antimarksiste idealiste që kanë dalë deri sot. Prandaj, në rast se nuk studiohen si duhet klasikët tanë të marksizëm-leninizmit, Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini, dhe gjithë kësaj pasurie kolosale teorike nuk i shtohet edhe historia e praktikës sonë revolucionare, e cila bazohet në këtë teori, nuk mund të kuptohet si duhet, për shembull, tradhtia e udhëheqjes kineze.

Ne nuk flasim akoma haptazi për revizionistët kinezë, por tanimë dihet se mosmarrëveshjet tona me ta nuk janë vetëm për teorinë e «tri botëve» dhe për zhvillimin e luftës në të dy krahët, kundër imperializmit e revizionizmit. Këto janë mosmarrëveshje për çështjet kryesore, për çështjet bazë, ku duket qartë

devijimi i tyre nga marksizëm-leninizmi. Revizionizmi aktual kinez, analizës së të cilit i duhet futur thellë (dhe për këtë unë nuk do të zgjatem këtu), është si kubi me shumë faqe. Rryma revizioniste kineze ka shumë synime, ajo përpiqet të arrijë shumë objektiva, përdor shumë taktika, që përbëjnë të gjitha një drejtim antimarksist; ajo, në fakt, i vjen në ndihmë sistemit kapitalist në kalbëzim. Kjo rrymë e re revizioniste do të përpiqet të krijojë prapë forma të tjera në rrugën e shmangies nga marksizëm-leninizmi. Mund të themi ne se ekonomia kineze do të zhvillohet sipas shembullit të ekonomisë titiste? Këtë do ta shohim, por, në bazë të analizave që ka bërë Partia jonë, themi se revizionizmi kinez nuk i ka rrënjët mbi ujë, se edhe ky është një revizionizëm i thellë dhe në shumë drejtime, prandaj ai do të kërkojë forma të reja organizimi për të shkuar në kapitalizëm.

Për Marksën dhe Engelsin, për Leninin dhe Stalinin shmangiet e renegatëve të ndryshëm nga ideologjia e klasës punëtore nuk kanë qenë të panjohura. Titizmi doli në kohën kur rronte Stalini. Ai e luftoi këtë rrymë të rrezikshme, ashtu sikurse e luftuan Partia Bolshevike, Partia jonë dhe parti të tjera komuniste e punëtore. Po t'i futemi thellë dhe ta analizojmë ç'është titizmi në ideologji, në politikë, në ekonomi, në organizim, do të dalim në përfundimin se ai është një amalgamë e disa teorive antimarksiste dhe idealiste, të cilat janë shfaqur që në kohën e Marksit, Engelsit dhe Leninit që i kanë luftuar dhe i kanë hedhur poshtë. Në këtë amalgamë gjejnë shprehjen e vet anarkosindikalizmi, prudonizmi etj., që janë luftuar pa mëshirë



nga klasikët e marksizëm-leninizmit, por që sot ka marrë një formë të re, të cilën ne e quajmë titizëm.

Aktualisht po flitet për eurokomunizmin. Ç'është eurokomunizmi? Do të gabohehim në qoftë se do ta shpjegonim atë thjesht si një shkëputje të një grupi partish revizioniste të Evropës Perëndimore nga e ashtuquajtura Parti Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Në fakt eurokomunizmi nuk qëndron vetëm në shkëputjen nga tutela e Moskës. Është e kuptueshme se edhe tendenca për shkëputje është një synim i atyre që e përkrahin eurokomunizmin, por kjo rrymë revizioniste synon të shkojë më tej. Ajo e ka hedhur poshtë edhe atë maskë të trashë që përpiqen të mbajnë revizionistët sovjetikë, të cilët vetëquhen leninistë dhe ruajnë disa tipare të jashtme formale sa për t'u mbuluar nga demaskimi i plotë.

Eurokomunizmi është një revizionizëm që i hedh poshtë të gjitha maskat. Ku qëndron thelbi i këtij varianti të revizionizmit? Thelbi i tij qëndron në grumbullimin e të gjitha teorive të vjetra antimarksiste, që nga trockizmi, anarkizmi, prudonizmi, bernshtajnzimi, kautskizmi e gjer te revizionizmi modern, dhe në adaptimin e tyre për kohën tonë. Shokët që merren me studimin e filozofisë i njohin fare mirë të gjitha teoritë «socialiste» që ka përdorur borgjezia me kohë, siç janë socializmi kristian, socializmi katolik, socializmi feudal, socializmi mikroborgjez, të cilat i ka luftuar e i ka demaskuar Marks. Të gjitha këto përbëjnë një amalgamë teorish të stërholluara, të cilat revizionistët, përkrahës të eurokomunizmit, kërkojnë t'i quajnë si «një marksizëm të përshtatshëm për epokën tonë». Kur e

shikon thellë këtë teori, e kupton mirë që kjo mbështetet jo në idetë e socializmit shkencor, por në kapitalizmin monopolist shtetëror.

Marsheja, Karriljoja dhe Berlingueri duan të marrin fuqinë, duke u vetëquajtur marksistë-leninistë, por jo si në kohën e Marksit, pse Marksi do ta quante një utopi këtë «marksizëm» të tyre, që ata e paraqesin sikur na qenka një marksizëm-leninizëm i zhvilluar në bazë të situatave aktuale. «Nuk duhet të bëjmë revolucion për të hedhur në dorë pushtetin», thonë ata. Mirëpo kjo tezë e tyre, natyrisht, është në kundërshtim me teorinë tonë. Eurokomunistët propagandojnë marrjen e pushtetit vetëm me reforma, vetëm me anën e parlamentit. Këta revizionistë e pranojnë shtetin borgjezo-kapitalist aktual dhe bile mohojnë nevojën e shembjes së tij. Këtë shtet e quajnë si «një fillim të rrugës për socializëm», meqenëse pas Luftës së Dytë Botërore ky ka shtetëzuar një sërë ndërmarrjesh ekonomike. Natyrisht, qeveritë borgjeze të vendeve perëndimore kapitaliste kanë shtetëzuar për interesat e klaseve sunduese ato ndërmarrje që nuk lëndonin aspak trustet dhe kapitalet shumëkombëshe, por kjo nuk do të thotë që borgjezia e shndërroi natyrën klasore të shtetit të saj shfrytëzues. Meqë në këto vende shteti administron disa sektorë të jetës, si shëndetësinë, ushtrinë dhe ndonjë tjetër, atëherë, thonë këta revizionistë të rinj bernshtajnistë, kautskistë, hrushovianë e të tjerë, ne duhet të mos e rrëzojmë këtë pushtet, por të infiltrohemi edhe vetë në të! Sipas eurokomunistëve, Lenini e kishte gabim që theksonte se duhet shkallëmuar nga themelet pushteti i borgjezisë, prandaj ata

thonë që me anën e zgjedhjeve të përpqemi të futemi në parlament dhe atje të luhet loja demokratike. Në qoftë se ne do të sigurojmë shumicën e votave, do të vijmë në fuqi dhe kjo do të na japë mundësi të bëjmë më shumë shtetëzime. Kështu, sipas tyre, shteti borgjez, kur ata të jenë në krye, do të bëhet më shumë demokratik dhe me anën e tij do të ecet drejt socializmit pa gjakderdhje, pa polici, pa ushtri të proletariatit, sepse policinë dhe ushtrinë e të gjitha aparatet shtetërore do t'i trashëgojnë nga shteti borgjez.

Revizionistët kinezë e pëlqejnë këtë teori dhe nesër me siguri do ta mbështetin. Po në ç'mënyrë, në ç'forma dhe deri ku do të shkojnë, këtë do ta shohim. Ata, gjatë rrugës së tyre për shndërrimin e Kinës në një vend kapitalist, do të ecin pa u ndalur. Disa formave të këtij procesi kanë filluar t'u duken veshët që tani. Rajonizimin, siç është çështja e organizimit të pesë a gjashtë zonave, që po mendohet të bëhet, duhet ta vërejmë, të analizojmë anën e tij politike, ideologjike, administrative e shumë aspekte të tjera me radhë. Mbi të gjitha duhet të studiojmë çështjen e partisë në Kinë. Po t'i futemi thellë kësaj, si gjatë periudhës së Revolucionit Kulturor që u zhvillua në Kinë, edhe tash, në këtë grupim aktual nuk do të shohim ku është partia dhe mbi ç'baza politike, ideologjike dhe organizative është ndërtuar ajo. Duke i studiuar këto probleme në kompleksitetin e tyre, do të jemi në gjendje të kuptojmë edhe ndryshimet që po ndodhin tani dhe format që do të marrin më vonë.

Të gjitha këto i thashë për të kuptuar se lufta që kemi përpara është e ashpër dhe shumë e komplikuar.

Kjo është një luftë politiko-ideologjike. Që ta zhvillojmë me sukses këtë luftë duhet të bëjmë të ndërgjegjshëm komunistët për karakterin e përgjithshëm të deviacionit të madh idealist-revizionist-kapitalist, që ka për qëllim të shpëtojë kapitalizmin nga kriza e madhe ku është futur. Ata që kanë ardhur në fuqi në Kinë kanë pikëpamje idealiste, janë kapitalistë të rinj me shpirt të vjetër. Marksizëm-leninizmi ka qenë vetëm një mbulesë për ta, po kjo mbulesë tash u gris.

Partia jonë duhet të kuptojë jo vetëm në përgjithësi, por edhe në veçanti se të gjitha rrymat revizioniste kanë të njëjtin karakter dhe synojnë të realizojnë një qëllim të përbashkët: të luftojnë kundër revolucionit, kundër marksizëm-leninizmit, kundër partive marksiste-leniniste, por, megjithëkëtë, secila nga këto rryma në veçanti ka karakteristikat e saj, që duhet t'i dimë. Prandaj, ata që e studiojnë marksizëm-leninizmin, dhe në radhë të parë pedagogët që e japin këtë shkencë, të mos i harrojnë këto që përmenda, të mos flasin kundër Kautskit, Bernshtajnit, Internacionales së Dytë dhe këtij apo atij deviatori ose rryme antimarksiste sa për të kaluar radhën.

Ne e përdorim me përbuzje termin «trockist», por duhet ta bëjmë mirë të njohur cilat janë pikëpamjet e Trockit në luftën kundër Leninit e Stalinit, kundër Partisë Bolshevike, me një fjalë kundër komunizmit. Tani revizionistët e Evropës Perëndimore, Karriljoja me shokë, po ngrenë lart Trockin dhe «kritikojnë» Hrushovin, se ky nuk u ka vajtur deri në fund disa çështjeve, siç është edhe rehabilitimi i Trockit! Aktualisht në botë ka plot trockistë dhe trockizmi po mbu-

lohet me frazeologji që është ca e vështirë të luftohet me sukses, po të mos njihet thelbi i kësaj agjenture të rrezikshme të borgjezisë në radhët e lëvizjes punëtore ndërkombëtare.

Tezat e marksizëm-leninizmit nuk duhet të përdoren si dogma në luftën kundër rrymave të ndryshme antimarksiste, prandaj në radhë të parë, nga pedagogët këto teza nuk duhet të jepen në mënyrë dogmatike. Qëllimi është që parimet dhe idetë e doktrinës sonë të përvetësohen mirë dhe të mbahen kurdoherë në mendjen e njerëzve tanë, që ata të dinë se kjo ose ajo rrymë revizioniste përdor këtë taktikë, tjetra përdor këtë ose atë maskë dhe, në këtë mënyrë, të bëhet e qartë se si duhet luftuar. Të gjitha këto rryma armiqësore, si bernshtajnzimi, trockizmi, titizmi, hrushovizmi, eurokomunizmi, revizionizmi kinez etj., duhen luftuar, pse janë antimarksiste dhe revizioniste.

Një luftë të madhe kemi përpara për të bërë, shokë, prandaj, me këtë rast desha të theksoja edhe një herë se Partisë i vihet detyrë të përvetësojë si duhet marksizëm-leninizmin. Natyrisht, të gjithë filozofë nuk do të bëhen, por pedagogët e marksizëm-leninizmit, kuadrot e Partisë dhe studentët e Shkollës së Partisë e të shkollave të tjera të larta që i mësojnë më me themel këto parime, t'i kenë të qarta dhe jo t'i marrin si dogma. Mësimet në filozofi të shërbejnë si busull për t'u udhëhequr kurdoherë drejt në luftën e madhe që zhvillon Partia.

Kina aktualisht, në të katër anët e botës, po krijon parti false të vetëquajtura marksiste-leniniste. Këto formohen me dy, tri, pesë apo dhe me 20 veta dhe

menjëherë njihen nga ana e saj si parti, mjaft që t'i dërgojnë nga një telegram Partisë Komuniste të Kinës se ato aprovojnë Kongresin e saj të 11-të. Shtypi kinez ka muaj që boton dita me ditë lumenj telegramesh, bile ka filluar t'i ribotojë këto për t'i dhënë opinionit botëror përshtypjen sikur gjithë komunizmi ndërkombëtar është dakord me kursin e Kongresit të 11-të të partisë së tyre.

Partia jonë e di fare mirë se këto «parti», që dalin si kërpudhat pas shiut, janë grupe njerëzish që synojnë të mashtrojnë botën. Partia ka thënë, gjithashtu, se çdo gjë do të arrihet në kohën e saj, prandaj porositi: «Shpejtohuni ngadalë, mos shkëlmi kurrë parimet, ndiqni me besnikëri orientimin që jepet, mbronvi vijën e Partisë dhe shpjegojeni drejt këtë vijë!».

Ne nuk ia vumë gishtin Kinës kur folëm në Kongres<sup>1</sup> kundër qëndrimeve të saj, por gjithë bota e ka marrë vesh ku ishte qëllimi i Partisë sonë. Ne akoma nuk e përmendim me emër Kinën kur flasim për idetë dhe për qëndrimet e saj të gabuara. Veprojmë kështu për arsye taktike, por me siguri do të vijë koha që t'i adresohemi asaj hapur. Unë nuk po ju them ndonjë gjë që ju, shokë, s'e dini, por e vërteta është se në Kinë nuk ka qetësi. Atje bëhen edhe debate dhe kjo është e natyrshme.

Me këtë ndërhyrje desha të theksoja që, sa të jetë e mundur, studimi i teorisë marksiste-leniniste të bazohet në veprat e klasikëve, të cilët kanë parashikuar proceset esenciale dialektike të zhvillimit historik të

---

1. Në Kongresin e 7-të të PPSIL.

shoqërisë e të luftës ideologjike, dhe, nga ana tjetër, teoria e tyre të lidhet vazhdimisht edhe me eksperiencën konkrete të Partisë sonë e me situatat aktuale ndërkombëtare.

*Notohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## ÇDO PROGRAM I PARTISË ZGJON TE RINIA ENERGJI TË REJA

*Përshëndetje drejtuar Kongresit të 7-të të BRPSH<sup>1</sup>*

26 shtator 1977

Të dashur shokë dhe shoqe të rinisë,

Me Kongresin tuaj jeton sot jo vetëm rinia, por mbarë populli ynë, gjithë Shqipëria. Është një gëzim i veçantë për mua që, me një ndjenjë të lartë dashurie për brezin e ri, të ardhmen e bukur të atdheut, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, t'ju përshëndes nxehëtishtë dhe t'ju uroj nga zemra sukses të plotë në zhvillimin e punimeve të Kongresit të 7-të të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë!

Partia ka besim të plotë se ju, shokë e shoqe delegatë, do ta përfaqësoni denjësisht brezin e ri të mrekullueshëm. Ju do të sillni në atë tribunë të madhe zërin e fuqishëm dhe mendimin e kthjellët të rinisë, besnikërinë e patundur të saj ndaj popullit, që e lindi dhe e rriti, ndaj Partisë, që ia bëri jetën të gëzuar e

---

1. Kongresi i 7-të i BRPSH i zhvilloi punimet në qytetin e Elbasanit, më 26-29 shtator 1977.



të lumtur, ndaj marksizëm-leninizmit dhe idealeve komuniste, që e brumosin dhe e kalitin si revolucionare të vërtetë. Ju do të shprehni edhe një herë gatishmërinë e plotë për të marrë përsipër detyra të reja, më të mëdha, në të gjitha fushat e ndërtimit socialist e të mbrojtjes së atdheut, për zbatimin me sukses të vendimeve të Kongresit të 7-të historik të Partisë.

Kongresi juaj i 7-të, me diskutimet e gjalla që do të zhvillojë dhe me vendimet e pjekura që do të marrë, do ta çojë përpara gjithë punën mobilizuese dhe edukuese të Bashkimit të Rinisë, të kësaj organizate militante shumë të dashur të rinisë, ndihmëse besnike dhe rezervë luftarake e Partisë.

Ju jeni mbledhur në qytetin e bukur të Elbasanit, me emrin e të cilit lidhen shumë aksione të rinisë, si domos ndërtimi i hekurudhave. Por ka një kuptim të madh fakti që Kongresi juaj i zhvillon punimet pikërisht në një nga repartet e Kombinatit Metalurgjik, të kësaj vepre monumentale të Partisë dhe të klasës sonë punëtore heroike, ku po derdhet edhe djersa e rinisë sonë të lavdishme. Duke jetuar këto çaste në atë ambient industrial, mendoni, shokë dhe shoqe delegatë, se në çfarë lartësie e ka ngritur Partia atdheun tonë të shtrenjtë. Shqipëria është bërë sot një vend i lulëzuar, me industri moderne, me bujqësi të përparuar, me arsim e kulturë të zhvilluar, me një mbrojtje të pathyeshme. Ëndrrat e bukura për të cilat dhanë jetën e tyre të re Qemal Stafa, Vojo Kushi, Misto Mame, Margarita Tutulani, Zonja Çurre, Manush Almani, Shyqyri Ishmi, si dhe mijëra e mijëra dëshmorë

të tjerë; u realizuan nën udhëheqjen e Partisë sonë të dashur.

Rinia e vendit tonë ka qenë dhe mbetet forcë e gjallë e revolucionit dhe e ndërtimit socialist. Ajo kurdoherë është treguar patriotë e zjarrtë, luftëtare besnike për çështjen e Partisë dhe mbrojtëse e flaktë e vijës së saj marksiste-leniniste.

Partia, populli dhe të gjithë në shokët e brezit të luftës, në emër të çlirimit të atdheut, e kemi parë rininë heroike të vendit tonë të përfytet me armikun duke përbuzur edhe vdekjen, sepse pa këtë luftë nuk mund të fitohej liria e të vendosej pushteti i popullit tonë, e kemi parë të shkojë nga aksioni në aksion, të ndërtojë rrugë e ura, fabrika e kombinatë, të ngrejë diga të hidrocentraleve për t'i dhënë vendit dritë, të thajë moçale e të ngjitet kodrave e maleve për t'i dhënë popullit bukë, të ulet në bankat e shkollave dhe të universitetit për të mësuar e për të përvetësuar dijet e kulturën, shkencën e teknikën, sepse Shqipëria e re kërkonte dituri. Në çdo front lufte e pune ku Partia e ka thirrur rininë, kjo i është përgjigjur me dinamizmin e moshës, me entuziazëm të lartë, me hov revolucionar, me gatishmëri të plotë, me vendosmëri komuniste.

Çdo ngjarje e rëndësishme në jetën e Partisë e të vendit hyn menjëherë në jetën e brezit të ri. Çdo program i Partisë zgjon te rinia energji të reja. Kongresi i 7-të i Partisë dhe vendimet e tij historike i kanë dhënë krahë të fortë dhe energji të pashtershme rinisë, kanë ndriçuar mendimin e saj për punë e vepra më të

mëdha e më heroike në të ardhmen, në interes të popullit e të atdheut. S'ka dyshim se rinia dhe organizata e saj luftarake do të qëndrojnë, si kurdoherë, në radhët e para të betejave që na presin në të ardhmen, për ta çuar deri në fund revolucionin tonë fitimtar, për ta bërë Shqipërinë më të bukur, më të begatshme, më të fortë.

Në atdheun tonë socialist rinia është e rrethuar nga kujdesi i madh i Partisë dhe i popullit. Partia i ka hapur asaj perspektiva të shkëlqyera, i ka krijuar të gjitha mundësitë që të punojë, të mësojë e të jetojë si revolucionare. Kjo nuk mund të ndodhë në vendet kapitaliste e revizioniste, ku rinia jeton një gjendje të vështirë. Imperializmi dhe socialimperializmi, borgjezia dhe revizionizmi punojnë që të mpijnë forcën e rinisë, ta hutojnë në pështjellim e çoroditje të përgjithshme ideologjike e morale, të nxitin tek ajo prirjet për një jetë boshe, pa ideale, ta hedhin në veprime anarkiste e aventureske. Ndërkohë, propaganda e tyre nuk mungon të llomotitë për «lirinë» e «personalitetin» e njeriut, sidomos të brezit të ri. Po për ç'liri e personalitet mund të bëhet fjalë në vendet borgjezo-revizioniste, kur masa të tëra të rinisë enden rrugëve pa punë e pa shpresë, kur ndërsa dyert e shkollave janë mbyllur, kishat e institucionet e shumta fetare, me kubetë e tyre mistike e të rënda, të marrin frymën, kur qosheve e rrugëve, natë e ditë, vërtiten narkomanë, rrugaçë, vjedhës e vrasës, që kryejnë krimet në përpjesëtime përherë e më të mëdha? Gjendja e mjeruar në atë botë në kalbëzim nuk mund të mos

çojë në revoltën e ligjshme të rinisë, në përpjekjet e saj për një jetë më të mirë, për liri, demokraci e socializëm.

Partia, klasa punëtore dhe mbarë punonjësit e vendit tonë janë angazhuar sot më tepër se kurrë në një luftë të madhe për të zgjidhur me forcat e veta problemet e zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë socialiste, për të përballuar, si kurdoherë, me sukses presionet e bllokadat e vazhdueshme të rrethimit imperialist e revizionist, për të mbrojtur marksizëm-leninizmin nga sulmet e borgjezisë e të reaksionit, nga goditjet e shtrembërimet e revizionistëve dhe të oportunistëve të vjetër e të rinj. Duke marrë pjesë në këtë luftë, si forcë goditëse dhe repart sulmues, brezi i ri zbukuron të sotmen e të ardhmen e vet socialiste e komuniste, edukohet e kalitet për të mbetur kurdoherë një brez i pamposhtur revolucionarësh.

Edukimi i rinisë me idetë e marksizëm-leninizmit, me ideologjinë e mësimet e Partisë sonë, është një detyrë e vazhdueshme për të gjithë Partinë dhe organizatën e Bashkimit të Rinisë. Idealet komuniste i japin rinisë qëllimin e jetës, të luftës dhe të përpjekjeve që ajo bën nën udhëheqjen e Partisë për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Këto ideale e bashkojnë atë me klasën punëtore dhe me masat e tjera punonjëse në një unitet të çeliktë rreth Partisë sonë. Brumosja me ideologjinë revolucionare të klasës punëtore i jep mundësi rinisë që të orientohet drejt në çdo situatë, të kalitet për të qenë luftëtare e vendosur e besnike deri në fund e Partisë dhe e vijës së saj, e gatshme për

t'ua kushtuar energjitë, talentin dhe jetën ndërtimit të socializmit, mbrojtjes së diktaturës së proletariatit dhe atdheut socialist. Këtij qëllimi të madh duhet t'i shërbejnë pjesëmarrja aktive e gjithë rinisë në jetën politike e ideologjike, ekonomike e kulturore të vendit, hedhja e saj në aksione e veprime revolucionare, aktivizimi i saj në zhvillimin e luftës së klasave kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm, kundër shfaqjeve të ideologjisë borgjezo-revizioniste e qëndrimeve liberale ndaj tyre, mbeturinave patriarkale e konservatore.

Traditat patriotike të të parëve tanë, ndjenjat e lirisë dhe të atdhedashurisë, dashuria për kulturë e për punë, që mbollën ata përmes heroizmave dhe sakrificave të panumërta në shekuj, virtytet e larta moralopolitike, që u kalitën e u pasuruan më tej në epopenë e madhe të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e në vitet e socializmit, janë një thesar i madh, burim i pashtershëm frymëzimi dhe edukimi për brezin e ri. Duke u njohur me këto tradita të shquara, rinia e sotme dhe brezat e ardhshëm do të kuptojnë më mirë vijën e Partisë, ideologjinë e saj marksiste-leniniste, përmbajtjen e luftës që ajo ka bërë e bën në ballë të masave punonjëse për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë, fitoret e revolucionit popullor, për të ndërtuar shoqërinë më të përparuar në historinë e njerëzimit, socializmin e komunizmin.

Kongresi i 7-të i Partisë miratoi planin e gjashtë pesëvjeçar, realizimi i të cilit do ta forcojë akoma më shumë ekonominë popullore, do të zhvillojë më lart kulturën socialiste e do të fuqizojë më tepër mbrojtjen e vendit. Pa angazhimin e gjerë të brezit të ri, të rinisë

punëtores, kooperativiste dhe të inteligjencies së re, nuk mund të arrihen me sukses objektivat që ka vënë Partia në këtë pesëvjeçar. Në luftë për realizimin e planit të shtetit do të shprehet, si gjithnjë, patriotizmi i flaktë i rinisë, do të shpërthejë forca e saj vigane, do të ngrihen më lart ndërgjegjja dhe fryma e saj revolucionare.

Me besim të patundur në vijën e Partisë, me dashuri të pakufishme për popullin, sulmoni, shokë e shoqe të rinisë, në të gjitha frontet e ndërtimit socialist, atje ku është më vështirë, në fshat e kudo që ka nevojë atdheu ynë socialist!

Ndërtimi i shoqërisë socialiste kërkon punë e dituri, njerëz me kuptim të thellë marksist-leninist, me horizont e kulturë të gjerë. I takon brezit të ri — të rinjve e të rejave punëtores e fshatarë, nxënësve e studentëve që të marrin arsim e kulturë, të përvetësojnë me vullnet, me këmbëngulje e me pasion dijet, të zotërojnë shkencën, teknikën e artin tonë ushtarak dhe të gjitha këto t'i vënë kurdoherë në shërbim të popullit, të atdheut, të socializmit.

Shokë dhe shoqe delegatë,

Partia ia ka bërë brezit të ri jetën të bukur e të gëzuar, ashtu si mbarë popullit. Natyrisht, kjo nuk ka qenë e lehtë. Në rrugën tonë kemi ndeshur e do të ndeshemi me vështirësi e pengesa jo vetëm të rritjes, por edhe të shkaktuara nga armiku i klasës. Rinia nuk u është trembur dhe nuk u trembet kurrë as vështirësive.

as armikut dhe as rrethimit të egër imperialisto-revizionist. Pranë kazmës dhe librit ajo shtrëngon fort në duar edhe pushkën, për të qenë e gatshme t'i japë përgjigjen e merituar kujtdo që do të orvatet të cenojë sadopak lirinë dhe pavarësinë e vendit, fitoret e revolucionit e të socializmit.

Situatat sot në botë janë të turbullta dhe të rënduara me rreziqe të mëdha për shkak të politikës agresive, ekspansioniste e luftënxitëse të të dyja superfuqive. Rinia jonë duhet të ndjekë me kujdes zhvillimin e ngjarjeve ndërkombëtare në bazë të vijës marksiste-leniniste të Partisë, të bëjë vlerësim të drejtë të situatës, të nxjerrë konkluzione e detyra, të dijë me zgjuarsi e zotësi t'u bëjë ballë kompleteve të imperializmit amerikan e të socialimperializmit sovjetik, të jetë gjithnjë luftëtare e vendosur kundër revizionizmit e çdo lloj oportunitizmi. E edukuar me frymën e internacionalizmit proletar, ajo të përkrahë, si kurdoherë, luftën e drejtë revolucionare që bën rinia në botë, duke qenë e bindur se, sado të mëdha që të jenë forcat e reaksionit, e ardhmja u përket popujve dhe rinisë.

Gjithë përvoja e deritanishme ka vërtetuar rëndësinë vendimtare që ka udhëheqja e Partisë për fatet e popullit dhe të rinisë, për të sotmen dhe të ardhmen e revolucionit e të socializmit në vendin tonë. Sa më thellë të rrënjoset ky kuptim në ndërgjegjen e rinisë, aq më e vetëdijshme do të jetë ajo për rolin e madh që luan në shoqërinë socialiste, aq më shumë do të shtojë përpjekjet për të njohur me themel vijën e Partisë, për ta mbrojtur atë me vetëmohim e për ta zbatuar deri në fund me vendosmëri.

Komiteti Qendror i Partisë shpreh bindjen se organizata e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë edhe në të ardhmen do të luajë rolin e madh që i takon në organizimin, mobilizimin dhe edukimin e masave të gjera të rinisë, do të jetë kurdoherë krahu i djathtë i Partisë, shtyllë e çeliktë e saj.

Nën udhëheqjen e Partisë, le të shkëlqejë e bukur, e pastër dhe heroike figura e lartë e rinisë sonë, e brezit të ri të lavdishëm të Shqipërisë socialiste! Le të ndihen kudo, në fabrika e në ara, në shkolla e në reparte ushtarake, hovi revolucionar i rinisë, mendja e saj e shëndoshë, dora e saj e fuqishme, që atdheu ynë i dashur të përparojë dhe të lulëzojë kurdoherë!

Rroftë rinia heroike e vendit tonë!

Rroftë organizata revolucionare e luftarake e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë!

Rroftë Partia jonë e lavdishme!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Për Komitetin Qendror të Partisë  
së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 232 (9 091), 27 shtator 1977

Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për rininë»  
(Përmbledhje veprash), vëll. II,  
f. 469



# DEVIZË PËR NE ËSHTË EKSPORTI, NË KONIUNKTURAT AKTUALE TREGTIA TË SHESË SA MË SHUMË MALLRA ME DEVIZË

## Shënime

27 shtator 1977

Në bisedën që pata sot me shokun Prokop Murra<sup>1</sup>, ai më tha se kishte biseduar për çështje pune me ministrin e Komunikacionit dhe kishte rezultuar se gjendja në Portin e Durrësit është bërë shumë e vështirë në lidhje me eksportimin e mallrave tona jashtë, me shkarkimin e vaporëve që sjellin mallra importi, si dhe në lidhje me evadimin e shpejtë të atyre mallrave që duhen shpërndarë në brendësinë e vendit. Natyrisht, ky problem vihet në radhë të parë për këtë port tonin, i cili është shumë i ngushtë për situatat aktuale të ekonomisë sonë të zhvilluar, ndërsa disa vaporë vazhdojnë të mos shkarkohen në Portin e Vlorës, ku kemi ndërtuar disa skela. Prokopi më tha, gjithashtu, se ministri i Tregtisë së Jashtme kishte kërkuar nga Ministria e Financave që t'i çelte kredi në bankat e jashtme për të sjellë nga importi mallra që i nevojiten ekonomisë sonë.

---

1. Në atë kohë sekretar i Komitetit Qendror të Partisë.

E pyeta Prokopin se çfarë kredie kërkonte ai që t'i çelte Ministria e Financave: dollarë, devizë? Në rast se ai kërkon devizë, ku do ta gjejmë atë? Jemi ne një shtet që disponojmë devizë në një masë të tillë? Jo, nuk jemi. Devizë për ne është eksportimi jashtë i mallrave që prodhojmë, gjetja e tregjeve për to në vende të ndryshme. Eksportimi i këtyre mallrave duhet bërë sa më parë. Për këtë duhen bërë përpjekje të mëdha, duke siguruar vetë transport dhe veçanërisht duke përmirësuar cilësinë e mallrave tona. Ndryshe ne nuk do të mund të çelim kredi. Kromi qëndron në sasi të mëdha në Durrës, pse në një përqindje të konsiderueshme është përzier me gurë. Male me fuçi bitumi etj. qëndrojnë gjithashtu në portet tona. Këtyre mallrave ose nuk u gjendet treg, ose u gjendet, por nuk realizohen kontratat, prandaj devizë nuk kemi, kështu që edhe nuk kemi ç'të japim.

E këshillova Prokopin që njerëzit e tregtisë sonë, ekonomistët dhe të gjithë shokët drejtues duhet të thellohen gjithmonë e më shumë në njohjen e situatës ndërkombëtare, sidomos lidhur me marrëdhëniet tregtare, me import-eksportin mes shteteve të ndryshme kapitaliste dhe shteteve kapitalisto-revizioniste, nga njëra anë, dhe mes tyre e shtetit tonë socialist, nga ana tjetër. Aktualisht edhe Kina ka hyrë në radhën e shteteve kapitaliste dhe tregtia e saj me ne do të synojë të bëhet në forma kapitaliste. Këtu të mos kemi as më të voglin iluzion.

Ne duhet të kuptojmë se shoqëritë shumëkombëshe, që janë truste kolosale, kanë hyrë në kooperim me njëra-tjetrën, kanë zaptuar tregje, kanë zbutur deri

në njëfarë shkalle konkurrencën mes tyre dhe kanë investuar kapitalet e tyre sidomos në Bashkimin Sovjetik, në vendet e tjera revizioniste, në vendet e Afrikës dhe të Azisë e tash edhe në Kinën e Hua Kuo Fenit. Ky është një litar që u është hedhur në grykë shteteve revizioniste, duke filluar që nga Bashkimi Sovjetik dhe deri to Kina e Mao Ce Dunit, dhe ky litar çdo vit u shtrëngon gjithnjë e më tepër grykën.

Shtetet revizioniste janë kthyer tashmë në shtete kapitaliste, ku sundon diktatura e fortë e kapitalit, e cila nuk lejon protesta, u imponon klasës punëtore dhe popullit të vet vendimet e saj. Në këto vende krahu i punës është i lirë, por edhe import-eksporti i mallrave është i vogël në përgjithësi, nuk kalon 15 për qind ose 20 për qind të prodhimit kombëtar. Në këto kushte ato krijojnë me vendet kapitaliste shoqëri të mëdha, truste, në kooperim të hapët ose të fshehtë, me aksione 49-50 për qind. Kështu trustet kapitaliste kanë zaptuar, si me thënë, tregje të gjera të këtyre vendeve të vetë-quajtura komuniste. Në Bashkimin Sovjetik investimet e shoqërive të mëdha shumëkombëshe kapitaliste kanë zënë rrënjë të thella. Rokfelcri, Shelli e të tjerë kanë kooperuar me trustin e madh të naftës të Bashkimit Sovjetik në Siberi e kështu me radhë.

Teknologjinë dhe modernizimin e uzinave e të fabrikave këto vende i kanë vënë nën saçin e këtyre koncerneve të mëdha kapitaliste, pse nuk janë në gjendje të paguajnë me devizë. Ne kemi parë në shtyp se disa herë Bashkimi Sovjetik është orvatur të hedhë në treg flori për të rikuperuar devizë, dollarë ose monedha të konvertueshme të shteteve të tjera, mirëpo hedhja e

floririt në tregun ndërkombëtar ka bërë që vlera e tij të bjerë. Kështu Bashkimi Sovjetik, me atë sasi floriri që hedh në treg, nuk mund të blejë devizën që i duhet, prandaj është detyruar ta ndalojë shitjen e arit sa më parë dhe të vazhdojë skllavërimin e vendit nga kapitali i huaj i shoqërive supenacionale, duke marrë e rima-rrë kredi të shumta. Këto shoqëri kanë kontrollin e tyre në fabrikat e uzinat sovjetike, dinë koston e mallrave të fabrikuara dhe kanë rënë në marrëveshje për çmimet me të cilat do të shiten në ato vende nga kanë dalë investimet e teknologjisë etj. Pastaj këto truste kanë të drejtë që mallrat e prodhuara t'i shesin ku të duan vetë.

Një veprimtari e tillë ka shkaktuar papunësi në vendet kapitaliste perëndimore, si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e gjetkë. Ajo vjen duke u rritur pikërisht sepse këto shtete kapitaliste, që janë nën saçin e këtyre trusteve të mëdha, sigurojnë më tepër fitime nga investimet jashtë vendeve të tyre. Bashkimi Sovjetik, për shembull, do të paguajë ratat që rrjedhin nga këto investime me mallra të cilësisë së mirë, në bazë të çmimeve të caktuara që më parë, kurse investitorët, për shembull, Franca ose Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kanë të drejtë t'i shesin këto mallra në tregun botëror me çmime ndërkombëtare, që i caktojnë vetë ato, dhe të nxjerrin kështu dyfish fitime, e një pjesë fare të vogël ia japin, sa për ta gënjyer, klasës punëtore që e hedhin në rrugë dhe e lënë pa punë. Këtë gjë ka filluar ta bëjë edhe Kina.

Kur Partia jonë deklaroi se nuk mund të mbështetesh në një imperializëm për të luftuar një imperia-

lizëm tjetër, kishte parasysh pikërisht këtë vijë kapitaliste skllavëruese, ku është futur Kina. Kina thotë se imperializmi amerikan nuk është agresiv dhe do statukuonë. Pse e thotë Kina këtë? E thotë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës u tërhoqën nga Vietnam me turp, por kjo tërheqje, rezultat i luftës së popullit vietnamez, nuk u bë për arsye se vendosi Niksoni, por se vendosën trustet e mëdha të Rokfelerëve e të Dyponëve, të cilëve u hapeshin perspektiva të mëdha fitimesh si në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe në Kinë. Vajtja e Niksonit dhe e Kisingerit në Kinë, vizita e Brezhnjevrit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kështu me radhë ecejaket e gjithë të tjerëve, kishin pikërisht për qëllim të përgatitej kjo situatë që po zhvillohet aktualisht.

Janë pikërisht shoqëritë e fuqishme shumëkombëshe që diktojnë politikën e qeverive kapitaliste, që janë të interesuara të ruajnë deri në njëfarë mase «qetësinë», sepse lufta ua prish planet e shfrytëzimit të popujve, pse kreditë që kanë dhënë, humbasin, dhe pas luftës nuk janë të sigurt se kush vjen në fuqi.

Imperializmi amerikan është i sigurt deri në njëfarë shkalle për udhëheqjen tradhtarë të Brezhnjevrit. Ai ka kaq vjet që po e studion edhe udhëheqjen kineze dhe është siguruar e po sigurohet nga dita në ditë që edhe kjo udhëheqje është e predispozuar që të bëhen në Kinë investime kapitalesh dhe kështu imperializmi amerikan të nxjerrë fitime, me një fjalë të pushtojë Kinën ekonomikisht, ashtu siç ka pushtuar Jugosllavinë dhe vende të tjera të botës. Por kjo situatë, natyrisht, nuk është një situatë e qetë për imperializ-

min, pse popujt, proletariati dhe njerëzit përparimtarë shikojnë ç'po ndodh, shikojnë fitimet kolosale skandaloze të pronarëve të mëdhenj kapitalistë, nga njëra anë, dhe varfërinë e masave, nga ana tjetër, prandaj përpiqen dita-ditës të organizohen kundër këtyre shushunjave gjakpirëse që u janë ngjitur në trup. Dhe me siguri do të vijë dita që sasia të kthehet në cilësi. Në Perëndim shpërthejnë me furi grevat e punëtorëve, shprehje e një proteste të fuqishme, të cilat, po të punohet si duhet nga ana politike, i shkaktojnë kapitalit një tronditje të pandreqshme. Por edhe në vendet revizioniste, edhe në Kinën aktuale ekzistojnë forca, të cilat do të përmbysin gjendjen kur njerëzit të shohin akoma më qartë rrugën tradhtare dhe inkuadrimin e shteteve të tyre «socialiste» në sferën e kapitalizmit botëror.

Çështja e kompromisit në Lindjen e Mesme duhet të kuptohet, gjithashtu, lidhur me këto situata, pse trustet e mëdha shumëkombëshe dhe shtetet e tyre i rrezikonte një luftë në këtë rajon të botës. Lufta e popujve arabë ishte me rëndësi të madhe, prandaj Shtetet e Bashkuara të Amerikës, erdhën në ujdë me Bashkimin Sovjetik dhe e shtypën.

Zhurmat për Angolën, për Mozambikun, për Portugalinë janë të natyrshme, efekt ky i luftës për ndarjen e tregjeve. Por në qoftë se popujt nuk do të organizohen për të hequr qafe zgjedhën, kjo ndarje do të arrijë në një moment që të gjejë njëfarë stabiliteti mes fuqive të mëdha imperialiste dhe shoqërive shumëkombëshe. Cila, pra, është rruga ku duhet ecur? Rruga nëpër të cilën duhet ecur është ajo e luftës politike,

ideologjike dhe deri e armatosur e të gjithë popujve dhe e forcave përparimtare e revolucionare kundër fuqive imperialiste, kundër reaksionit botëror, kundër kapitalizmit, kundër shoqërive të mëdha shumëkombëshe.

Pra, në këto koniunktura, tregtia jonë nuk e ka të lehtë. Këtë punonjësit e saj duhet ta kuptojnë dhe të bëjnë shumë përpjekje për të shitur sidomos mallrat tona që kanë për ne një vlerë të konsiderueshme devize, si, për shembull, krom e minerale të tjera, artikuj ushqimorë që shiten me lehtësi, kurse mallrat e tjera të fabrikuara realizohen me zor, duhen gjetur shtete që t'i pranojnë, pse shtetet e industrializuara në shkallë të lartë nuk i pranojnë aq kollaj mallrat e industrisë sonë të re dhe sidomos me atë cilësi që i prodhojmë ne dhe për të cilën vetë populli ynë ka vërejtje.

Çmimet ndërkombëtare janë diçka e disfavorshme për ne, për arsye se mallrat tona të eksportit dhe ato të importit do të varen shumë nga koniunkturat e tregut ndërkombëtar, i cili luhetet sipas interesave të mëdhenj të tregut botëror. Ne duhet të përpiqemi të shesim mallrat tona me devizë dhe këtë devizë ta ruajmë mirë, pse do të na krijohen situata të vështira. Ka shtete të mëdha që nuk kanë mundësi të sigurojnë devizë e të blejnë me devizë e jo ne, prandaj deviza kliring duhet të zhvillohet dhe, që të zhvillohet, ne duhet të sigurojmë mallra të mira me kohë dhe të importojmë për ekonominë tonë nga ato shtete me devizë kliring mallra të nevojshme.

Në arenën ndërkombëtare ekzistojnë dhe do të thellohen gjithnjë e më shumë kontradiktat në mes fuqive

imperialiste, do të thellohen të katër kontradiktat e epokës së sotme<sup>1</sup>, që kanë përcaktuar Lenini dhe Stalini. Këto kontradikta do të bëjnë që imperializmi, kapitalizmi në kalbëzim, të shkatërrohet nga revolucioni. Këto ne i kemi kurdoherë parasysh dhe Partia lufton me të gjitha forcat në këtë drejtim, që politikën e saj të drejtë t'ua shpjegojë popujve të botës.

*Botuar për herë të parë,  
me disa shkurtime, në li-  
brin: Enver Hoxha. «Su-  
perfuqitë», f. 424*

*Marrë nga libri:  
Enver Hoxha, «Ditar për çë-  
shtje ndërkombëtare» (botim  
i brendshëm), nr. 9, f. 707*

---

1. Kontradikta midis dy sistemeve të kundërta — socialist e kapitalist; kontradikta midis punës e kapitalit në vendet kapitaliste; kontradikta midis popujve e kombeve të shtypura dhe imperializmit; kontradikta midis fuqive imperialiste.



**PARTINË E RININË, TË BASHKUARA SI NJË TRUP  
I VETËM ME POPULLIN, S'KA FORCË  
NË BOTË QË T'I THIYEJË**

*Fjala me rastin e mbylljes së Kongresit të 7-të  
të BRPSH*

**29 shtator 1977**

Të dashur shoqe dhe shokë,

Më parë se të dorëzohen flamurët, dëshiroj të shpreh nga zemra dashurinë e zjarrtë të Partisë, të Komitetit Qendror dhe timen për rininë heroike të vendit tonë. Dëshira ime ishte shumë e zjarrtë të ndodhesha në mesin tuaj. Dhe ja, erdha të gëzohem tok me ju dhe t'ju përgëzoj për këtë Kongres historik. Unë ju ndoqa vazhdimisht. Ju pashë dhe ju dëgjova me anë të televizionit, ju pashë të vinit njëri pas tjetrit në këtë tribunë të Kongresit tuaj, të thoshit mendimin tuaj përparimtar, të shfaqnit dashurinë e zjarrtë dhe të pakufishme për Partinë tonë të lavdishme dhe për popullin shqiptar, për atdheun socialist. Ju na frymëzuat ne të gjithë. Unë mund të them se u bëra 20 vjet më i ri. Ju, rinia jonë heroike, keni treguar pjekuri dhe

vendosmëri të madhe, guxim dhe heroizëm në vijën e Partisë, në kuptimin e zbatimit e drejtë të saj. Çdo gjë më pëlqeu në diskutimet tuaja. Vetëm do të më falni se nuk mund t'i përsëris të tëra ato që thatë ju. Por do të përsëris vetëm një mendim të një biri të klasës punëtore që punon këtu në Kombinatin Metalurgjik, i cili, sipas mendimit tim, e ka kuptuar drejt teorinë tonë, marksizëm-leninizmin, dhe e lidh mirë me praktikën. Ai tha se furnalta nuk mund të ecë dhe nuk mund të kemi çelik, po nuk spastruam skoriet. Kjo u përgjigjet parimeve kryesore të marksizëm-leninizmit, luftës së klasave, e cila duhet të vazhdohet me rreptësi si kundër armiqve të brendshëm, ashtu edhe kundër armiqve të jashtëm. Ne duhet t'i spastrojmë deri në fund skoriet, duhet t'i spastrojmë me idealin tonë, me idetë tona marksiste-leniniste.

Ju, shokë të rinj dhe të reja, e keni jetën të bukur përpara, sepse si për këtë jetë të bukur që kemi ndërtuar, ashtu edhe për të ardhmen, që do të jetë akoma më e bukur, ju keni derdhur gjakun tuaj, do të derdhni djersën tuaj, keni vënë forcën e muskujve tuaj rinorë, mendimin tuaj krijues, diturinë tuaj dhe dashurinë e zemrës suaj të zjarrtë. Këtu ju folët vetëm për një pjesë të atyre veprave të mëdha që i keni dhënë popullit. Ishit modestë në ato që thatë, por është shumë mirë të jesh modest. Unë ju përgëzoj, sepse veprat tuaja janë të panumërta, ato jua njeh Partia, jua njeh populli dhe mburren me ju. Ju jeni lulja më e bukur e atdheut, por jeni edhe të fortë si çeliku, më të fortë se çdo çelik që mund të derdhë një kombinat nga më modernët në botë. Ju jeni nga ato çelique speciale, ash-

tu siç janë një çelik special komunistët, jeni të pathyeshëm, siç janë komunistët. Ju jeni të tillë sepse jeni bijtë dhe bijat e një populli të lavdishëm e heroik. Ju jeni të tillë sepse Partia jonë e Punës ju ushqen çdo ditë me ideologjinë e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, që ju kalit në punë e në jetë, që ju mëson ta lidhni mirë teorinë me praktikën. Dhe ja ku janë veprat, ato i shikon gjithë populli ynë, ato i shikojnë si miqtë dhe armiqtë.

Partia ju ka besuar juve të rejave e të rinjve të drejtoni punët e shtetit, të ekonomisë, të ushtrisë, të kulturës e të shkencës. Fakt është se me mijëra e me qindra mijë të rinj e të reja drejtojnë në mënyrë të mrekullueshme ndërtimin e socializmit dhe mbrojnë me punë e vigjilencë të lartë diktaturën e proletariatit.

Siç theksoi Komiteti Qendror në përshëndetjen që ju dërgoi, Partia dhe populli kanë besim të madh te ju, dhe ne, brezi më i vjetër, do të derdhim djersën krahe për krahe me ju, do të derdhim edhe gjakun, në qoftë se do të jetë nevoja, dhe do t'ju ndihmojmë kurdoherë të ecni përpara, të merrni stafetën dhe ta çoni më tej. Të keni kujdes që brezat e rinj që do të vijnë, të rriten si ju, në luftë e në punë, të kaliten në kudhrën e lavdishme të Partisë, të Partisë së proletariatit, të mbushen radhët e saj me gjak të ri, në mënyrë që Partia jonë të jetë deri në shoqërinë komuniste kurdoherë e re, e fortë, e pamposhtur dhe fitimtare. Ajo me siguri do të jetë e tillë. Këtë s'e themi për mburrje, por deri sot kemi hasur furtuna e stuhi të mëdha dhe i kemi përballuar me sukses. Edhe në të ardhmen do të ndeshemi me armiç, por frikën, nuk ua kemi. Ata që men-

dojnë se ne jemi të izoluar, gabojnë rëndë. Ne në asnjë moment nuk kemi qenë, nuk jemi dhe nuk do të jemi të izoluar, sepse Partia jonë ecën me flamurin e asaj ideologjie shkencore ngadhënjimtare, të marksizëm-leninizmit, që ka pushtuar zemrat dhe mendjet e proletariatit botëror dhe udhëheq partitë e vërteta marksiste-leniniste. Kjo është një forcë kompakte, e çeliktë, përpara së cilës do të thyejnë kokën armiqtë imperialistë, socialimperialistë, revizionistë, oportunistë, sharlatanë. Prandaj, të dashur të reja dhe të rinj, ta duam e ta kalitim Partinë tonë heroike, së cilës i detyrojmë të gjitha fitoret. Populli i detyron asaj jetën e re të bukur socialiste që kemi ndërtuar dhe që do ta bëjmë akoma më të bukur. Kjo dashuri të kalitet jo si diçka sentimentale, por në rrugën marksiste-leniniste. Të forcojmë unitetin në Parti, ta ruajmë Partinë pikërisht nga ajo që tha punëtori i metalurgjisë, nga skoriet. Ta ruajmë nga skoriet edhe rininë tonë, që e kemi aq të pastër, aq heroike, aq trime, aq të guximshme, aq të pjekur dhe të qeshur. Partinë e rininë, të bashkuara si një trup me popullin, s'ka forcë në botë që t'i thyejë. Ky unitet ekziston dhe do të kalitet edhe më tej.

Kongresi juaj, pas Kongresit të 7-të historik të Partisë, do t'i japë një vrull të paparë zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të vendit tonë. Ju këtu morët zotime të guximshme. Partia ju falënderon dhe është e bindur se ju ato do t'i realizoni. Ajo do t'ju japë të gjithë ndihmën që t'i plotësoni me sukses. Në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe në emrin tim, ju them të punoni, të mendoni, të krijoni, të realizoni dhe të vigjiloni. Një vajzë e re këtu, në qoftë se s'gabohem, nga

Shishtaveci, tha se e kemi syrin pishë në shënjestër të pushkës. Ashtu duhet. Duke realizuar të gjitha këto punë të mëdha, ne duhet të jemi të armatosur e kurdoherë në rojë të atdheut e të fitoreve të socializmit. Të jemi edhe strategë të ndërtimeve të hidrocentraleve e të kombineve, por edhe strategë ushtarakë. Populli ynë ka qenë trim dhe luftëtar. Ashtu siç mëson Partia, bijtë e tij, që trashëguan virtytet e larta patriotike të të parëve të vet, që i ngritën ato më lart në Luftën e lavdishme Nacionalçlirimtare e i përforcuan me Artin Ushtarak Popullor Shqiptar, do të thyejnë çdo armik, çdo koalicion armiqsh, qofshin imperialistët amerikanë, socialimperialistët sovjetikë ose lakenjtë e tyre. Prandaj ta forcojmë vendin brenda e të ndihmojmë edhe në forcimin e unitetit ndërkombëtar marksist-leninist.

Ne shohim këtu se si internacionalizmi proletar, që na mëson marksizëm-leninizmi, po zhvillohet po kalitet. Në këtë Kongres na kanë ardhur miq dhe shokë nga shumë vende. I dëgjova të flitnin në këtë tribunë me zjarr dhe me dashuri për popullin shqiptar, për Partinë e Punës, për rininë tonë. Edhe ne i duam ata me gjithë shpirt dhe me gjithë shpirt do t'i ndihmojmë kurdoherë e do të bashkëpunojmë në luftën tonë të përbashkët për çështjen e revolucionit. Ne i sigurojmë miqtë dhe shokët tanë marksistë-leninistë se do t'i kryejmë deri në fund detyrat tona. Në emër të Komitetit Qendror të Partisë i falënderoj ata për ndihmën e madhe e të pakufishme që na japin në arenën ndërkombëtare, ndihmë që ne e çmojmë dhe e vlerësojmë shumë. Ata luftojnë në kondita të vështira dhe

ecin përpara, përhapin idetë marksiste-leniniste, luftojnë për socializmin dhe fitoren e revolucionit. Nga zemra i falënderoj të gjithë këta miq e shokë.

Edhe një herë ju përshëndes ju, shokë delegatë dhe nëpërmjet jush gjithë rininë e vendit tonë. Përshëndes klasën punëtore heroike dhe veçanërisht punëtorët, teknikët dhe inxhinierët e Kombinatit Metalurgjik, ku zhvilloi punimet ky Kongres, që do t'i fuqizojnë ekonominë tonë, vendin dhe vetë klasën punëtore. Përshëndes gratë heroike të vendit tonë, përshëndes fshatarësinë kooperativiste, përshëndes Ushtrinë e lavdishme Popullore, mbrojtësen e fitoreve të atdheut tonë, përshëndes qytetarët luftarakë, arsindashës e përparimtarë të Elbasanit.

**Të rrojë Partia!**

**Të rrojë rinia!**

*Botuar për herë të parë në gazetën "Zëri i popullit", nr. 235 (9094), 30 shtator 1977*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha. "Për rininë" (Përmbledhje veprash), vëll. II,*

*f. 476*

# **LUFTA PËR FITOREN E SOCIALIZMIT NUK MUND TË MPOSITET NGA ASNJË FORCË, SADO REGRESIVE DHE E EGËR QOFTË**

*Nga biseda<sup>1</sup> me shokë të udhëheqjes së Partisë  
Komuniste të Brazilit, Zhoao Amazonas  
dhe Diogenes Arruda*

**30 shtator 1977**

*Pasi u uroi mirëseardhjen miqve brazilianë, shoku  
Enver Hoxha vazhdoi:*

Jemi shumë të lumtur që ju shohim përsëri në  
vendin tonë, shokë. Kur erdha dje për të asistuar në  
Kongresin e 7-të të rinisë sonë, pashë që edhe ju ishit  
atje.

**SHOKU ZHOAO AMAZONAS:** Me ardhjen tuaj,  
shoku Enver, kongresi u mbyll si me një çelës floriri.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kur zhvilloi punimet  
Kongresi i 8-të i Bashkimeve Profesionale të Shqipë-  
risë, unë isha i zënë me punë, prandaj nuk mora pjesë.

---

1. Në këtë bisedë, që u zhvillua në zyrën e shokut  
Enver Hoxha në sellinë e KQ të PPSII, morrte pjesë edhe shoku  
Ramiz Alla.

Duke diskutuar me shokët, e gjetëm me vend që të shkoja në Kongresin e 7-të të rinisë, sepse edhe rinia, puna me të kanë rëndësi të madhe për ne.

Shumica e rinisë te ne vjen kryesisht nga klasa punëtore dhe nga fshatarësia, për faktin se inteligjencia jonë e vjetër ka qenë në një numër fare të kufizuar. Elementët e rinj që futen në Parti, vijnë nga radhët e rinisë punëtore, pastaj edhe nga rinia kooperativiste. Këta elementë, që zgjidhen për të mbushur radhët e Partisë me gjak të ri, duhet të jenë të fortë dhe të kulluar. Pra, na bie detyrë të kujdesemi që ta kemi rininë tonë gjithmonë të pastër, për arsye se influencat e huaja armiqësore depërtojnë në forma që duhet t'i konsiderojmë të rrezikshme, sepse ato të tilla janë. Partia është dhe duhet të jetë kurdoherë vigjilente për ruajtjen e brezit të ri nga ndikimet negative të botës së jashtme.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** 63 për qind e të pranuarve në Parti te ne vijnë me rekomandim të organizatës së rinisë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Rininë ne e konsiderojmë si fidanishten e Partisë.

Siç e dini, ngjarjet që janë duke u zhvilluar në botë dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare janë shumë të ndërlikuara, prandaj, kur takohemi dhe këmbëjmë pikëpamjet me shokët e partive marksiste-leniniste, sqarohemi më mirë, na hapen horizonte të reja dhe forcohemi më shumë në luftën e përbashkët që kemi për të bërë kundër armiqve tanë.

Shoku Ramiz më ka vënë në dijeni se jeni duke punuar intensivisht. Edhe Partia jonë kështu na më-



son ne, të punojmë pa u lodhur për interesat e popullit, të revolucionit e të socializmit, por, në të njëjtën kohë, na rekomandon të kujdesemi edhe për shëndetin, me të vetmin qëllim që t'i shërbejmë sa më gjatë asaj dhe popullit.

**SHOKU ZHOAO AMAZONAS:** Sa herë që takohemi me ju, shoku Enver, nga njëra anë, gëzohemi shumë që ju takojmë, pse në raste të tilla kemi mundësi të dëgjojmë mendimet tuaja të qarta, që neve na hapin perspektiva, nga ana tjetër, duke ditur që keni shumë punë, e ndiejmë se jo vetëm ju lodhim, por edhe ju «vjedhim», si të thuash, kohën tuaj të çmuar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ju lutem, mos e thoni këtë fjalë! Takimet midis nesh marksistë-leninistëve janë nga detyrat tona kryesore.

Më dukeni që të dy mirë me shëndet, prandaj gëzohem shumë.

**SHOKU ZHOAO AMAZONAS:** Janë idetë e socializmit që na përtërijnë, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kjo është e vërtetë. Lufta dhe përpjekjet që bëjmë ne për të mposhtur armiqtë e popujve tanë dhe të socializmit na japin forca të punojmë pa u lodhur, sikur të ishim të rinj. Duke qenë vazhdimisht në luftë me armiqtë e popujve dhe të socializmit, ne forcohemi vazhdimisht, forcat tona ringjallen, përtërihen.

Me siguri që ju lodhëm ca me materialin<sup>1</sup> që ju dhamë për të lexuar, sepse ishte i gjatë. Ne jemi për-

---

1. Fjala e mbajtur në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH më 29 qershor 1977 (Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 61, f. 383).

pjekur të bëjmë aty një rikapitulim për situatat e kaluara dhe analizë për problemet aktuale. Komiteti Qendror i Partisë sonë mendoi se për përmbajtjen e këtij materiali ishte mirë të viheshin në dijeni edhe një sërë kuadrosh të Partisë sonë, megjithëse nuk pretendojmë që ai të jetë një punim i plotë. Sidoqoftë, mendojmë se do të ndihmojë që ata t'i kuptojnë drejt situatat që po kalojmë.

Anëtarët e Partisë sonë tashmë kanë në dorë raportin e Kongresit të 7-të, si dhe artikullin e 7 korrikut 1977 «Teoria dhe praktika e revolucionit» dhe janë të qartë për problemet që shtrohen në ta. Megjithatë menduam që në këtë material pikëpamjet e zhvilluara në Kongres t'i trajtonim të lidhura më mirë me revizionizmin kinez që, sipas mendimit tonë, është sot një problem shumë i koklavitur. Qëllimi i kësaj pune është që kuadrot tanë të jenë sa më të qartë dhe sa më të përgatitur për problemet ideologjike të kohës. Tashti, duke përfitur edhe nga prania juaj në vendin tonë, menduam të konsultoheshim edhe me ju për problemet që trajtohen në këtë material, mbasi do të na ndihmonit me vërejtjet tuaja.

*SHOKU ZHOAO AMAZONAS:* Ne mund t'ju themi se ai është një material i mrekullueshëm.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shoku Ramiz më ka vënë në dijeni për bisedimet që keni zhvilluar me të dhe për çështjet që ju dalin në punën që po bëni me shokët e rinj. Për sa na përket neve, dyert e Partisë dhe të Komitetit tonë Qendror i keni kurdoherë të hapura. As qederin më të vogël të mos keni, prandaj,

sa herë të keni nevojë dhe të dëshironi, mund të na drejtoheni pa druajtje fare.

Shoku Ramiz më ka vënë, gjithashtu, në dijeni se kishit dëshirë të bisedonim së bashku edhe për disa probleme të tjera, për t'i thelluar më tej pikëpamjet tona të përbashkëta. Në materialin që ju dhamë, ne nuk kemi pasur mundësi të thelloheshim në të gjitha problemet dhe dëshiroj t'ju them se e ndiejmë që duhet t'i thellojmë akoma më shumë analizat për to edhe duke i rrahur pikëpamjet me shokë të partive të tjera marksiste-leniniste. Ne kemi besim te këta shokë, kemi këmbyer e do të këmbejmë mendime edhe në të ardhmen me ta, sepse për sa u përket disa çështjeve që kanë lidhje me revizionistët kinezë, ne duhet të ecim me kujdes, të shpejtojmë ngadalë. Prandaj dëshiroj t'i thellojmë bashkërisht disa probleme dhe të plotësojmë kështu edhe kërkesën për të diskutuar çështjet që keni ngritur ju.

*SHOKU DIOGENES ARRUDA:* Ne jemi shumë të kënaqur t'ju dëgjojmë edhe gjatë, shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Para leximit të këtij materiali të ri<sup>1</sup> do të më falni t'ju vë në dijeni se në fillim të tij, në bazë të eksperiencës së Partisë sonë, trajtoj disa probleme që kanë të bëjnë me parimet e ndërtimit të partisë. Natyrisht këto parime janë të njëjta për të gjitha partitë e tipit Lenin-Stalin, siç janë

---

1. Këtë material, ku i bëhej analizë devijimit të Kinës nga marksizëm-leninizmi, shoku Enver Hoxha e kishte përgatitur për ta mbajtur në Plenumin e 3-të të KQ të PPSH. (Shih në këtë vëllim f. 352.)

partitë tona. Ju i njihni ato ashtu si edhe ne, po mendova që këto çështje partie të trajtuara në fillim të këtij materiali t'i lidhnim me revizionizmin kinez, duke vënë në dukje se si mendojnë Partia jonë dhe partia juaj për to dhe dëshirojmë që kështu të mendojnë për këto probleme edhe partitë e tjera marksiste-leniniste. Prandaj, kur bëhet fjalë aty për zbatimin e këtyre parimeve, ne kemi kurdoherë parasysh kinczët që vepronë në të kundërtën e tyre. Prandaj me këtë qëllim i kemi vënë në fillim të këtij materiali këto çështje dhe në asnjë mënyrë për t'ju treguar juve se si duhet ndërtuar partia, si duhet të funksionojë ajo dhe të tjera çështje parimore, që ju i dini shumë mirë. Qëllimi ynë ky është, siç ju thashë. Më tej pastaj në material flitet edhe se si është e si ka vepruar Partia Komuniste e Kinës.

Ne e dimë që shokët brazilianë, Amazonas, Arruda dhe të tjerë janë të shkollës leniniste-staliniane dhe e kanë të qartë problemin e partisë. Në mes dy partive tona ekziston një unitet i çeliktë që ne po punojmë bashkërisht ta kalitim vazhdimisht, se jemi ndjekës të një shkolle, zbatojmë të njëjtën ideologji, jemi me një fjalë, të të njëjtit brumë. Prandaj, pa u zgjatur, ju lutem të na e kuptoni këtë çështje.

*Pasi përfundoi leximin e materialit, në vazhdim të bisedës shoku Enver Hoxha tha:*

Në propagandën e tyre kinezët thonë se Maoja është marksist-leninist, por ne mendojmë që botimi i dokumentit «Mbi dhjetë marrëdhëniet kryesore» nga puçistët, nga Hua Kuo Feni me shokë, ka për qëllim ta demaskojë dhe ta diskreditojë Mao Ce Dunin. Po të le-

xohen me vëmendje 10 pikat e këtij dokumenti, del qartë se çështjet që trajton Maoja aty për Stalinin, për zhvillimin e industrisë, të ekonomisë, të aleancave etj. nuk bien fare erë marksizëm-leninizmi. Për ne është e qartë se edhe botimi më vonë i artikullit për Zyrën e Përgjithshme ka për qëllim ta demaskojë Maon. Kur lexon këtë artikull, kushdo bën me të drejtë pyetjen: Pse i botuan kinezët këto dokumente? Çfarë interesi kanë? Interesi i tyre, na duket neve, është të demaskojnë Maon, të vënë në dukje para gjithë botës se ky mbante në duart e veta gjithë pushtetin, kurse Liu Shao Çinë, Ten Hsiao Pinin, Çu En Lain dhe shokët e tyre t'i paraqesin si njerëz të mirë.

Ne shpesh kemi pasur debate të rrepta me udhëheqësit kinezë, sidomos me Çu En Lain, për një sërë problemesh. Çu En Lai është përpjekur të na bëjë të besojmë se Stalinin nuk e zhvillonte luftën e klasave; ai akuzoi, gjithashtu, edhe Partinë tonë në këtë çështje. Ne ia hodhëm poshtë me fakte e me dokumente akuzat e pabazuara, si për Stalinin, ashtu edhe për Partinë tonë. Me gjithë kundërshtimet tona për akuzat që i bënte Stalinin, Çu En Lai qëndroi në pozitën e tij dhe ne qëndruam në tonat, kurse akuzën që bëri kundër Partisë sonë se ne nuk bënim luftë klasash, e tërhoqi dhe na kërkoi falje, duke u justifikuar se nuk e njihte situatën në vendin tonë.

A mund të akuzohet Stalinin se nuk e zhvillonte luftën e klasave? Në asnjë mënyrë! Tërë jeta dhe veprimtaria e tij flasin për të kundërtën. Përveç të tjerave, për të cilat edhe ju jeni vetë në dijeni, Hrushovi neve na ka thënë me gojën e tij se, kur ishte gjallë,

Stalini e kishte akuzuar se, ashtu si mendonin dhe si po vepronin, ai dhe shokë të tij do ta tradhtonin Bashkimin Sovjetik dhe do të bashkoheshin me imperializmin amerikan. Atëherë, një udhëheqës i tillë, që akuzon deri disa anëtarë të byrosë politike të partisë se do të tradhtonin, dhe në fakt u vërtetua se ata tradhtuan, nuk nuhaste dhe nuk bënte luftë klasash? Prandaj kjo që thonë kinezët për Stalinin është shpifje. Për të argumentuar pikëpamjet dhe akuzat e tyre, ata kapen pas ndonjë thënieje të tij dhe këtë e zgjatin dhe e stërzgjatin për t'i bërë të tjerët t'u besojnë, por realiteti është krejt ndryshe. Është e vërtetë se kohët e fundit të jetës së tij, për arsye të moshës, Stalini nuk dilte dot për të marrë kontakt me masat dhe, duke përfutur nga kjo, aparatçikët ia fshihnin realitetin. Pra, duke mos qenë i informuar mirë për gjendjen, ai edhe mund të mos i ketë kapur disa çështje gjatë kësaj periudhe të jetës së tij. Dhe tash të akuzosh Stalinin se nuk ishte kundër borgjezisë dhe kapitalizmit, kjo nuk mund të pranohet, siç thashë, kjo është shpifje.

Por Çu En Lai, gjykojmë ne, i bëri këto akuza për arsye se personalisht ai kishte kundërshtime, natyrisht, joparimore, edhe ndaj Revolucionit Kulturor. Ky revolucion, në realitet, kishte për objektiv likuidimin e elementëve kundërrevolucionarë, reaksionarë, të udhëhequr nga Liu Shao Çia dhe nga Ten Hsiao Pini me shokë. Çu En Lai, që ishte i së njëjtës rrugë me këta kundërrevolucionarë, e dinte qëndrimin tonë, prandaj u përpoq të na vinte edhe ne në këtë rrugë. Për këtë qëllim erdhi ai në Shqipëri dhe, kur nuk ia doli dot, filloi të na akuzonte, duke shpifur sikur ne nuk kishim

bërë kurrë dhe vazhdonim të mos bënim luftë klasash në vendin tonë.

Për sa i përket Mao Ce Dunit, ne mendojmë se nuk ka ardhur akoma koha ta demaskojmë hapur, sepse duhet thelluar edhe më shumë në analizat për çështjet që kanë të bëjnë me problemin kinez. Po për t'ia arritur këtij qëllimi, hëpërhë, e kemi ca të zorshme, pse, siç e dini, ekziston një boshllëk i madh, nuk kemi dokumente që të flasim shumë për Kinën. Kohët e fundit është botuar atje vëllimi i 5-të i veprave të Maos, po kjo punë është bërë pas vdekjes së tij dhe nën kujdesin e Hua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit me shokë. Dihet se Maoja fliste mbarë e prapë me të gjithë ata që takonte dhe të gjitha fjalimet e tij regjistroheshin nga njerëzit që kishte pranë. Tani që klika e Hua Kuo Fenit e ka marrë vetë në dorë Zyrën e Përgjithshme, ai, bashkë me Tenin, i kanë manipuluar sipas interesit të grupit të tyre të gjitha këto materiale. Ju e keni lexuar artikullin për Zyrën e Përgjithshme, ku del qartë se pjesëtarët e grupit të «të katërve» nuk lejoheshin të merrnin e të lexonin dokumente të partisë! Kjo është e çuditshme. Si mund të mos u jepeshin anëtarëve të byrosë politike dokumentet e partisë për t'i lexuar? Sipas mendimit tonë, ky fakt është dhënë në artikull, siç thashë, për të demaskuar Maon. Megjithatë, udhëheqësit e sotëm të Kinës vazhdojnë ta mbajnë flamurin e Maos, pse, në përgjithësi, idetë e tij përputhen me idetë e tyre për sa i përket zhvillimit të Kinës jo në rrugën socialiste, jo në bazë të ideologjisë shkencore të marksizëm-leninizmit por në rrugën kapitaliste.

**SHOKU ZHOAO AMAZONAS:** Ne ndihemi shumë

të lumtur, se jemi të parët që dëgjojmë mendimet e shokut Enver për këtë çështje. Sipas pikëpamjes sime përmbajtja e materialit që na u lexua ka një rëndësi të jashtëzakonshme dhe na vjen keq që ky do të mbetet një dokument i mbyllur brenda përbrenda nesh. Unë i kuptoj arsyet, por, siç e tha shoku Enver, ne marksistë-leninistët jemi përpara një situatë shumë të rëndë dhe të vështirë që, për ta kapërcyer me sukses, na duhet të armatosemi mirë ideologjikisht.

Ne mendojmë se vlerësimi që i bëhet Kinës në materialin që ka përgatitur shoku Enver ka një vlerë shumë të madhe. Gjatë periudhës prej një muaji që ne ndodhemi në Shqipëri, si bisedat që kemi bërë me shokët shqiptarë, ashtu edhe materialet për revizionizmin kinez që na keni dhënë ju për të lexuar, na kanë sqaruar për shumë probleme. Prandaj themi se nuk do të largohemi nga Shqipëria ashtu siç erdhëm. Megjithatë mendojmë se problemi i maoizmit, miti që është krijuar kudo në botë për personin e Mao Ce Dunit, mbetet një problem serioz, të cilin ne duhet ta shohim me kujdes. Prandaj do të na duhet të rishikojmë të gjitha qëndrimet tona ndaj këtij problemi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Çështja është që në radhë të parë të gjejmë format dhe metodat se si do t'i sqarojmë komunistët për demaskimin e pikëpamjeve maoiste. Duhet menduar për të gjetur shpjegime bindëse në rrugën marksiste-leniniste, në mënyrë që uniteti i mendimit në radhët e partive tona të forcohet më tej. Kjo ka rëndësi të madhe. Megjithatë, të mbajmë parasysh që mund të ketë edhe «skorie», dua të them elementë që nuk do të na kuptojnë. Për sqarimin e ko-



munistëve na ka ndihmuar edhe eksperiencia që kemi fituar në luftën kundër titistëve dhe hrushovianëve. Çështjet ne i shtruum më parë qartë dhe në mënyrë parimore në Kongresin e 7-të të Partisë. Për Mao Ce Dunin, siç e keni parë, në Kongres folëm me terma të moderuar. Kishte kështu për të një *decalage*<sup>1</sup> në krahasim me të kaluarën dhe Partia na kuptoi për këtë. Përveç këtyre, brenda radhëve të Partisë filluam shpjegimet, duke vënë në dukje shtrembërimet teorike që viheshin re në vijën politike dhe ideologjike të Partisë Komuniste të Kinës.

Për të dalë publikisht me emër kundër qëndrimeve antimarksiste të udhëheqjes kineze dhe të Mao Ce Dunit duhet të veprojmë, siç thotë populli, duke matur 7 herë, pastaj të presim një herë, domethënë të ecim gradualisht, me kujdes. Të kemi parasysh se në vepërimtarinë e tij Mao Ce Duni ka pasur edhe anë pozitive. Të udhëheqësh revolucionin për çlirim nga të huajt në një vend aq të madh sa një kontinent, siç është Kina, ta shpëtosh nga uria popullin e saj prej 700-800 milionësh etj., të gjitha këto janë suksese, qoftë edhe me ato forma që i kanë realizuar kinezët. Natyrisht, revolucionin e bën populli, pasi të jenë krijuar më parë kushtet për shpërthimin e tij. Populli kinez vazhdon të ushqejë respekt për Maon. Ky respekt nuk ka mbetur vetëm brenda Kinës, por ka kaluar edhe jashtë saj. Shumë marksistë-leninistë dhe njerëz përparimtarë në botë kanë besim dhe respekt për Maon, bile edhe ne vetë kemi pasur besim, sidomos në ato momente kur ai dhe udhë-

---

1. Frëngjisht: spostim, ndryshim.

heqësit kinezë u vunë kundër revizionistëve hrushovianë. Edhe borgjezia kapitaliste, me propagandën që ka bërë, i ka dhënë një popullaritet të madh Mao Ce Dunit.

Përveç këtyre, ka edhe diçka që duhet pasur parasysh, mendojmë ne. Sipas zërave që na vijnë, disa parti motra shpejtohen në këtë çështje dhe flasin kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe Mao Ce Dunit. Mirëpo qëndrimi që mbajnë ato bën efekt në bazë dhe kjo vë përpara udhëheqjes së vet pyetjen: Përse Partia e Punës e Shqipërisë nuk del hapur kur është puna kështu? Çfarë bën ajo? Një gjendje e tillë sjell domosdo një përçarje në pikëpamjet e komunistëve. Ata që thonë pse nuk del haptazi Partia jonë, hiqen si puristë, si marksistë-leninistë të vendosur, si elementë të avantgardës. Mundet që ata të jenë shokë të mirë, por çështja është se nuk kanë parasysh gjerësinë e problemit, metodat dhe taktikat që duhet të përdorin në luftën kundër revizionizmit kinez. Pavarësisht se ne nuk përmendim me emër as Kinën, as Mao Ce Dunin, kushdo që ka lexuar artikullin e «Zërit të popullit» apo materialet e tjera, si «Hrushovi në gjunjë para Titos», ka konkluduar se aty kritikohen Kina, politika e saj dhe Mao Ce Duni. Ne marksistë-leninistët duhet të mos e nënvleftësojmë ndikimin e maocedunidesë.

Këto dy dekadat e fundit lëvizja komuniste në botë dhe çështja e revolucionit pësuan një humbje të madhe. Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera ish-socialiste degjeneruan, prandaj të gjitha partive tona dhe marksistë-leninistëve kudo që janë u vihet detyrë ta ruajnë pastërtinë e marksizëm-leninizmit, të luftojnë për ta përhapur dhe për ta mbrojtur atë me vendos-

mëri nga armiqtë. Ne e dimë se barra që kemi marrë përsipër është shumë e rëndë, se lufta që kemi ndër-marrë kërkon shumë mundime e sakrifica dhe fitorja që synojmë të arrijmë nuk është çështje as e një viti, as e dhjetë vjetëve.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Mua më duket, shoku Enver, që ne duhet të hedhim poshtë revizionizmin modern në vijën, në konceptet ideologjike të tij. Kështu është më lehtë të demaskojmë edhe ideologët që i përhapin ato. Kur u fillua lufta me Hrushovin, për njëfarë kohe ne vazhdonim ta thërrisnim atë «shoku Hrushov», në të njëjtën kohë luftonim bazën ideologjike të hrushovizmit, e demaskonim në teori dhe në praktikë. Kjo taktikë është ndjekur edhe në artikullin tonë të 7 korrikut, edhe në artikullin e shokëve brazilianë, qëllimi i të cilëve është të hidhet poshtë teoria maoiste e «tri botëve», që është mbështetja e tërë kësaj politike revizioniste. Dhe të tërë ata që i kanë lexuar artikujt, thonë se këta drejtohen kundër Mao Ce Dunit, kundër Kinës, pse këta janë frymëzuesit e teorisë së «tri botëve».

**SHOKU ENVER HOXHA:** Udhëheqësit kinezë na bënë një letër në muajin dhjetor të vitit të kaluar, me të cilën na akuzonin se kemi sulmuar doktrinën e Mao Ce Dunit.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Edhe për artikullin që botuat në gazetën tuaj, shokë brazilianë, kinezët thanë se është një sulm kundër tyre.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Termi «botë e tretë» ka dalë që në kohën e Ruzveltit, në vitin 1945. Më vonë atë e përdori Hrushovi në vitin 1960 dhe ne e demas-

kuam që në atë kohë. Mao Ce Duni e shpalli këtë teori më 1974 dhe tash kinezët na akuzojnë se qenkemi ne që kemi sulmuar idetë e Mao Ce Dunit, po në realitet janë ata që kanë sulmuar idetë marksiste-leniniste të Partisë sonë.

Të dyja partitë tona, shokë, me artikujt që botojnë, sulmojnë teoritë revizioniste, vënë në dukje dhe trajtojnë luftën e klasave, problemin e aleancave, rrezikshmërinë e imperializmit. Mbi të gjitha këto çështje njerëzit reflektojnë. Sidoqoftë, ne do të botojmë edhe materiale të tjera që do të jenë më plotësuese.

**SHOKU ZHOAO AMAZONAS:** Mendimet e shprehura sot nga shoku Enver na e bëjnë akoma më të qartë problemin e strategjisë dhe të taktikave që duhet të ndjekin partitë tona. Për ne është i qartë roli kundër-revolucionar i revizionizmit hrushovian, po me të gjitha këto që mësuam kësaj radhe në Shqipëri, shikojmë se ç'rol negativ kundër-revolucionar po luan në botë edhe revizionizmi kinez. Ai është në aleancë të drejtpërdrejtë me imperializmin amerikan dhe me klikat fashiste që shtypin lëvizjet revolucionare. Kjo situatë duhet të tërheqë vëmendjen tonë në mënyrë të veçantë. Por ne nuk duhet të nënvleftësojmë në asnjë rast edhe rrezikshmërinë e hrushovizmit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Është e drejtë ajo që thoni ju, shoku Amazonas. Kinezët po bashkëpunojnë hapur edhe me xhelatin e popullit kilian, Pinoçetin. Revizionistët sovjetikë e botuan një artikull kundër eurokomunizmit, kurse kinezët janë takuar me Karriljon që ka sulmuar haptazi Marksën, Engelsin dhe Le-

ninin. Pra, kinezët bashkëpunojnë fare haptazi me re-  
 aksionin më të zi.

**SHOKU ZHOAO AMAZONAS:** Ne mendojmë se Kongresi i 7-të i Partisë së Punës të Shqipërisë ka qenë një udhërrëfyes i madh për demaskimin e teorive revizioniste. Një hap tjetër i madh ka qenë artikulli i «Zërit të popullit» më 7 korrik. Është e qartë që ne duhet të punojmë shumë në bazë të këtyre materialeve për të sqaruar komunistët. Ne jemi plotësisht dakord me ju dhe jemi të bindur se mendoni shumë drejt kur thoni «të shpejtohem i ngadalë». Gjithashtu, shoku Enver, duam t'ju shprehim kënaqësinë tonë të thellë për përkrahjen e madhe që na keni dhënë e na jepni.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kjo është një detyrë dhe bashkëpunim reciprok mbi baza internacionaliste, shoku Amazonas. Refleksionet tuaja dhe shkëmbimi i mendimeve me ju do të na shërbejnë shumë.

Dëshira jonë, shokë, është të rrini edhe ca kohë në vendin tonë, sidomos tani që moti është i bukur. Të vini në Shqipëri kur të doni dhe sa herë të doni. Mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## FORCA JONË QËNDRON NË IDETË DHE NË UNITETIN TONË

*Nga biseda<sup>1</sup> me shokët Zhoao Amazonas  
dhe Diogenes Arruda*

5 tetor 1977

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jeni, shokë? Si jeni ju, shoku Amazonas?

**SHOKU ZHOAO AMAZONAS:** Shumë mirë e kemi kaluar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Edhe koha këto ditë ka qenë e bukur. Në përgjithësi vjeshtën ne e kemi me shira, kurse verën një çikë të thatë, por Partia i ka marrë të gjitha masat për ujitjen e bimëve bujqësore. Ne sot ujitim 56-60 për qind të sipërfaqes së punueshme të tokës, por po luftojmë dhe do të luftojmë që këtë pesëvjeçar të shtohet akoma sipërfaqja e tokës së ujitshme në malësi, së fushën e kemi nën ujë dhe të sistemuar. Edhe në malësi të sistemuar e kemi tokën, por ujë na duhet më shumë.

---

1. Në këtë bisedë merrnin pjesë edhe shokët Hysni Kapo, Ramiz Alia e të tjerë.

Sivjet patëm disa vështirësi të shkaktuara nga koha, sidomos në mbjelljen e grurit. Kjo bëri që të mos marrim rendimente shumë të mira në grurë, kurse misrin e kemi mirë. Megjithatë, bukën e bëjmë vetë. Ka mundësi dhe rezerva të mëdha për të prodhuar më shumë, prandaj me më tepër punë dhe përpjekje çdo gjë do të na shkojë akoma më mirë.

Sidoqoftë, vështirësi ka e do të ketë, se pa to nuk do të ekzistonte as gëzimi që ndihet në kapërcimin e tyre. Kot mendojnë ata që nuk punojnë e që shfrytëzojnë të tjerët se janë më të lumturit në botë. Me jetën e zbrazët që bëjnë, ata janë më të mjeruarit e botës. Vetëm ai që punon e që nuk shfrytëzohet, është me të vërtetë i lumtur.

Ne ndiejmë gëzim të madh kur na vijnë shokë të partive komuniste motra. Sa herë që të kemi rastin, dhe duhet t'i krijojmë shpesh këto raste, të takohemi, të bisedojmë, të shkëmbejmë mendime me njëri-tjetrin, sepse një gjë e tillë është e nevojshme. Kjo duhet të bëhet, mendoj unë, jo vetëm se zhvillojmë luftë të përbashkët dhe kemi një strategji të përbashkët, të njëjtë, se e njëjtë është ideologjia jonë, por edhe sepse njohja më në detaje e situatave dhe e zhvillimit të tyre, e luftës së partive tona në kushtet e tyre të brendshme ka rëndësi shumë të madhe, sepse përfitojmë nga eksperiencia e njëri-tjetrit, pavarësisht se mund të ketë, dhe në fakt ka, ndryshime në zhvillimin shoqëror ose ekonomik të secilit vend. Armiqtë, kudo që janë, përdorin pothuajse të njëjtat metoda, megjithëse këto kanë veçoritë e tyre specifike. Pra, metodat që përdorin armiqtë, ju i njihni në situatat tuaja, ne i njohim në

situatat tona. Duke shkëmbyer eksperiencë, partitë tona forcohen edhe ideologjikisht, edhe politikisht, marrin kurajë të madhe për të vazhduar e për të forcuar akoma më tej luftën. Ja pse kur ju vini në Shqipëri, ne gëzohemi.

Jemi të bindur se, pavarësisht nga vështirësitë që hasim në rrugën tonë, ne do të fitojmë, do t'i mundim rrymat e ndryshme armiqtësore që na luftojnë, imperialistët, socialimperialistët, oportunistët kinezë dhe oportunistët e tjerë, natyrisht, me luftë, me përpjekje e me sakrifica, të cilat janë në rendin e ditës për komunistët. Ne komunistët shqiptarë i urojmë suksese partisë suaj në veprimtarinë e vet për t'u forcuar më tej, për të konsoliduar unitetin e saj me proletariatin dhe me të gjitha masat e popullit.

Në artikullin «Të mbajmë gjithmonë lart flamurin e pamposhtur të marksizëm-leninizmit», që botuat në organin e komitetit qendror të partisë suaj, ku theksoni se duhet pasur mirë parasysh vija e demarkacionit, ju i trajtoni drejt problemet. Është tragjedi e madhe për lëvizjen komuniste botërore devijimi i Kinës. Do të kemi vështirësi dhe luftë me revizionistët kinezë, të cilët punojnë në dëm të lëvizjes komuniste. Me rrugën që kanë nisur, ata po ecin drejt greminës.

Kur lexuam fjalimin e ministrit të Jashtëm të Kinës, Huan Hua, në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, na dukej sikur fliste Hua Kuo Feni në Kongresin e 11-të të Partisë Komuniste të Kinës. Fjalimi i tij ishte mbushur me fraza për situatën «e shkëlqyer», për luftën kundër «katërshes», për Kinën që «mbron» gjithë popujt e botës etj., etj. Ai foli për Afrikën, për «botën



e tretë», për «botën e paangazhuar» e për «botën e dytë» që po na u afroka me «botën e tretë»; për imperia-  
lizmin amerikan që nuk qenka shumë i rrezikshëm. Kurse kontinentin e Amerikës së Jugut nuk e zuri fare në gojë, sikur ky të mos ekzistonte. Me këtë fjalim Huan Huaja përpiqej të linte përshtypjen se pa Kinën bota nuk mund të rrojë, nuk mund të rrojnë as Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Bashkimi Sovjetik, pale shtetet e tjera. Të gjithë do të kenë qeshur me këtë fjalim të ministrit të Jashtëm të Kinës! Kinezët mendojnë se fama e Mao Ce Dunit në botë është aq e madhe, saqë tash të gjithë me kokë ulur duhet të respektojnë edhe Hua Kuo Fenin, sepse, siç thonë ata, këtë e ka caktuar Maoja vetë si pasardhësin e tij. Edhe Elisabeta, mbretëresha e Britanisë së Madhe, kur të lërë trashëgimtar të fronit djalin e saj, mbase do të mbledhë ata që ka përreth e do t'ua thotë mendimin e vet, kurse Mao Ce Duni, kryetar i një partie komuniste, vendos vetë për zëvendësin e tij! Ka norma leniniste këtu?!

Çështja e shtypit dhe e botimeve ka rëndësi të madhe, prandaj mendoj se duhet të bëhen përpjekje për të përkthyer sa më shumë vepra të literaturës marksiste-leniniste. Shumë të tilla ne i kemi përkthyer. Kam lexuar një libër ku është botuar raporti «sekret» i Hrushovit kundër Stalinit. Ndër të tjera, atje thuhej se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik kishte marrë vendim për të zhdukur të gjitha dokumentet që i përkisnin periudhës së Stalinit!

Ky është vërtet krim i madh! As për vendet bor-  
gjeze nuk e kemi dëgjuar një gjë të tillë. Janë rrëzuar

e janë zëvendësuar qeveri edhe në shtete fashiste, por një gjë të tillë nuk e kemi dëgjuar! Në këto vende dokumentet klasifikohen dhe për ruajtjen e tyre caktohen afate 50 vjet, 70 vjet etj., kurse disa prej tyre ruhen përgjithmonë.

Ju e njihni mirë të kaluarën e Amerikës Latine dhe të popujve të saj. Jo vetëm meksikanët, peruanët, brazilianët, por edhe paraguajanët, uruguajanët e të gjithë popujt e tjerë latinoamerikanë janë popuj me kulturë të lashtë. Nga sa kemi lexuar, rezulton se lëvizjet shoqërore të këtyre vendeve kanë qenë të mëdha. Amerika Latine ka pasur një zhvillim të shkëlqyer qysh në periudha të vjetra. Karakteri i libertadorëve ka pasur një reminishencë të madhe, njerëz të shquar nga ky kontinent kanë komanduar në ushtrinë e revolucionit francez. Në gjirin e popujve të Amerikës Latine duket aktualisht një lëvizje e madhe e proletariatit, e studentëve, e punëtorëve me mëditje në bujqësi etj. Atje ekziston një fushë e gjerë veprimi për revolucionarët e vërtetë.

Kurse Afrika është ndryshe. Edhe atje ka një fushë të gjerë veprimi, por kushtet janë më specifike. Në Afrikë duhet një punë e veçantë, sepse ka, si të thuash, një virgjinitet. Në Amerikën Latine borgjezia është e djallëzuar, më me përvojë. Atje imperialistët amerikanë janë shtruar këmbëkryq. Megjithatë, rëndësi ka shpirti revolucionar i popujve latinoamerikanë.

Nga analizat që i janë bërë së kaluarës së popullit tonë, del qartë se regjimi i Zogut, borgjezia e sapollindur, të ndihmuar edhe nga okupatori, i errësonin të kaluarën e popullit, zhvillimin dhe traditat revolucio-

nare, lëvizjet dhe përpjekjet e tij për drejtësi, për liri, për demokraci. Ata përmendnin vetëm disa figura të shquara të këtyre lëvizjeve e përpjekjeve, të cilat nuk kishin se si të mos i zinin me gojë, por linin në harresë shumë e shumë figura të tjera të rëndësishme në historinë e popullit tonë. Megjithatë populli, inteligjencia përparimtare, me aq sa mundën, i njohën e i ruajtën këto tradita. Më vonë, kur Partia udhëhoqi revolucionin dhe fitoi, ruajtja dhe zhvillimi i traditave revolucionare ishin problem kapital. Duhej t'i bëheshin të njohura popullit jo vetëm origjina, por edhe autoktonia e kultura e tij, që nga kohët e lashta deri në ditët e sotme, duke kërkuar, duke zbuluar e duke studiuar dokumente, duke bërë *fouilles*<sup>1</sup>, duke ngritur muze, duke hapur universitetin me degë të veçanta e institute për të studiuar probleme të ndryshme ekonomike e shoqërore, zakonet e vjetra, folklorin etj. Pra, Partia është përpjekur t'i vërë dhe i ka vënë në dukje pasurinë kulturore dhe traditat e mira të popullit tonë. Kjo ka ngjallur në popull pikërisht atë krenari të ligjshme, të cilën ia kishin mohuar të tjerët në të kaluarën, e ka bërë popullin shqiptar të kuptojë e të thotë se u ka rezistuar kohës, furtunave e invaduesve. Partia është përpjekur t'i tregojë popullit me dokumente se nuk është asimiluar për arsye të kulturës, të burrërisë dhe të luftës që ka bërë brez pas brezi. Ndryshe ka ndodhur me disa popuj të tjerë. Për shembull, etruskët, popull me kulturë të lulëzuar, u asimiluan nga romakët, dokumente

---

1. Frëngjisht: gërmime. (Fjala është për gërmime arkeologjike).

të shkrimit të tyre ekzistojnë, por ato nuk lexohen, sepse gjuha e etruskëve u zhduk ashtu siç u zhdukën edhe ata vetë si rezultat i këtij asimilimi.

Ose të flasim, për shembull, për inkasit dhe kulturën e tyre. Rezistenca e inkasve kundër pushtesve ka qënë e madhe, megjithatë ata u shkatërruan nga spanjollët. Kur lexon për zhvillimin, për strategjinë dhe për fortifikimet e tyre, mëson se ai popull ka pasur një kulturë të pasur tradicionale, nga e cila përfituan edhe spanjollët e portugezët. Por, natyrisht, borgjezia degjeneroi dhe kultura e arti i lashtë i popujve në vende të ndryshme të botës janë lënë vetëm si një çështje folklorike, si diçka që u intereson vetëm disa studiuesve. Megjithatë, populli nuk e harron traditën.

*Duke folur për rëndësinë e luftës së Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Shqipërisë socialiste kundër imperializmit dhe revizionizmit, për rolin e shokut Enver Hoxha në këtë luftë, si dhe për rëndësinë e Kongresit të 7-të të PPSH, shoku Zhao Amazonas, ndër të tjera, theksoi: . . .*

Ne duam t'u themi shokëve se jemi plotësisht dakord me të gjitha mendimet që shprehu në këtë bisedë shoku Enver dhe jemi të gatshëm të punojmë së bashku për t'i realizuar detyrat e mëdha që na dalin përpara në luftën tonë revolucionare. Ne duhet të ndihmojmë në radhë të parë popullin tonë të dalë nga shtypja, por gjithashtu mund dhe duhet të kontribuojmë me mundësitë dhe me forcat tona, të cilat akoma nuk janë të shumta, në fushën ndërkombëtare, që të bëjmë të dalin fitimtare idetë e Marksit, të Engelsit, të Leninit, të Stallnit, të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të

shokut Enver Hoxha. Jemi të sigurt se në këtë luftë, cilatdo qofshin vështirësitë, fitorja do të jetë jona.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Faleminderit, shoku Amazonas, për këto që thatë për Partinë tonë, kurse sa për mua, unë jam vetëm një ushtar i Partisë. Është marksizëm-leninizmi, janë mësuesit tanë të mëdhenj, Marksi, Engelsi, Lenini e Stalini, ata që na mësojnë të gjithë ne, shokët shqiptarë dhe ju shokët brazilianë, popujt e të gjithë marksistë-leninistët në botë, për të luftuar në rrugën që na kanë hapur dhe për të fituar. Forca jonë qëndron në madhësinë e ideve të marksizëm-leninizmit, që duhet t'i zbatojmë kudo dhe kurdoherë, dhe në unitetin tonë të përbashkët.

Ne komunistët shqiptarë jemi shumë të prekur për vlerësimin e lartë që ju i bëni Partisë sonë. Do të vëmë të gjitha forcat për ta merituar këtë besim dhe nuk do të kursehemi të bëjmë deri dhe sakrificën e fundit për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit dhe për të ndihmuar shokët e partitë motra marksiste-leniniste me të gjitha mundësitë që kemi.

*Pasi shoku Diogenes Arruda foli për përshtypjet nga mbledhjet e disa organizatave-bazë të Partisë, ku shokët brazilianë kishin qenë të pranishëm, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Edhe te ne ka të meta, por ne luftojmë që ato t'i ndreqim. Punëtorët e fshatarët flasin drejt. Në punën e përditshme ka edhe shfaqje formalizmi, konformizmi e indiferentizmi. Këto shfaqje janë shumë të rrezikshme për jetën e organizatave-bazë të Partisë. Të meta ka edhe në punën e drejtuesve, ka nga ata që nuk venë të përgatitur mirë në mbledhjet e organizatës. Mirëpo

njerëzit nuk janë të gjithë njëloj, si të prerë me thikë, njëri është i ngritur, tjetri është i ri e ka eksperiencë të paktë, një tjetër e shikon kështu si themi ne problemin, por ka që e shikojnë nga një kënd tjetër etj., etj. Prandaj shokët drejtues të organizatës duhet t'i kenë medoemos parasysh të gjitha këto, se mund të ndeshen me mendime e qëndrime të ndryshme në organizatën-bazë dhe të dinë se si të veprojnë, t'i presin ato me serenitet<sup>1</sup> dhe t'i gjykojnë si marksistë-leninistë. Në këto çështje drejtuesi i organizatës duhet të thellohet mirë dhe jo të thotë pse ky nuk tha kështu, apo pse foli në atë mënyrë, e meqë nuk tha kështu, nuk është i mirë. Ai duhet të reflektojë, t'u flasë e t'u përgjigjet njerëzve për t'i bindur, por jo të kërkojë që ata medoemos të flasin ashtu si flet ai.

Kur sekretari i organizatës-bazë shkon i përgatitur si duhet në mbledhje, diskuton mirë dhe përgjigjet qartë, atëherë të gjithë binden. Në qoftë se nuk i mësojmë njerëzit të bëjnë luftë revolucionare, t'i shfaqin hapur mendimet e tyre, shfaqet indiferentizmi e njëfarë frike. «Mos fol», mund të thotë dikush, «ç'të duhet ty?» etj.

Puna e Partisë, që ne bëjmë çdo ditë, është aq interesante, aq e bukur, edukuese, frymëzuese, saqë drejtuesit e Partisë, kur ndjekin rrugën marksiste-leniniste, kanë një mori formash të larmishme për të edukuar njerëzit, për t'i bindur dhe për të mësuar nga ata. Prandaj ne përpiqemi, por kemi shumë për të bërë në këtë drejtim, si edhe në drejtime të tjera. Nga shkolla e Partisë «V.I. Lenin», e cila ka një eksperiencë të madhe

---

1. Nga frëngjishtja: qetësi.

pune, kanë dalë me mijëra kuadro që punojnë shumë mirë. Përveç kësaj, kemi hapur edhe kurse partie, ku një numër kuadrosh të Partisë mësojnë dhe rifreskojnë njohuritë e fituara. Ne kemi arritur, deri në njëfarë shkalle, që kjo teori të mos mbetet libeske, por të jetë e lidhur me praktikën, me prodhimin, me punën që bëjmë për ruajtjen e pasurisë së shtetit etj. Domethënë synojmë që ato çka kemi mësuar nga Lenini të mos mbeten slogane. Në këtë çështje ne ngulim këmbë.

Në punën tonë ne kemi dhe gjithmonë duhet të kemi parasysh se Partia është gjë e gjallë, përherë e re. Brezat vijnë valë-valë dhe ne duam që të rinjtë të mësojnë, të ndjekin rrugën e saj. Puna e Partisë, siç ju thashë edhe më lart, është jashtëzakonisht e bukur dhe frymëzuese. Ekzistojnë forma të shumta pune dhe vetë jeta ka vërtetuar e vërteton se marksizëm-leninizmi nuk është dogmë, por teori e gjallë për veprim.

Pedagogët e Shkollës së Partisë bëjnë përpjekje dhe leksionet e tyre i lidhin me fakte nga jeta e gjallë e konkrete e Partisë. Përveç kësaj, një muaj në vit ata shkojnë në bazë në mënyrë të organizuar, studiojnë çështje të caktuara, punojnë atje, nxjerrin konkluzione nga kjo punë dhe, kur kthehen, diskutojnë për ato probleme që u dalin dhe pastaj bëjnë leksionin. Kjo është një mënyrë përgatitjeje, por ka edhe shumë forma të tjera pune për këtë gjë.

Uniteti në udhëheqjen tonë është i çeliktë, metoda e punës që kemi vendosur është e atillë që udhëheqja kolegjiale e Partisë është e plotë dhe e përditshme. Të gjithë ne anëtarët e Byrosë Politike takohemi përditë me njëri-tjetrin, jo në mbledhje, por pasi mbarojmë

punën vemi e ulemi në një shtëpi, si kjo këtu, për të pirë një kafe e bisedojmë së toku një orë apo një orë e gjysmë për probleme që kanë të bëjnë me punën tonë të përditshme. Atje bëjmë debate politike, që kontribuojnë në përpunimin e thellimin e vijës së Partisë dhe në veprimtarinë e saj. Natyrisht, këto debate bëhen pa letra dhe protokolle, por duke shkëmbyer mendime me njëri-tjetrin. Kjo është një formë pune që flet për unitet të mendimit në shokët e udhëheqjes sonë. Por kemi edhe forma të tjera. Për shembull, në mëngjes vemi në punë dhe, mbas disa orësh, bëjmë një pushim e bisedojmë për të rejtat e ditës. Kurse Ten Hsiao Pini, siç ka shkruar vetë Mao Ce Duni, për 15 vjet rresht nuk i kishte vajtur ndonjëherë për t'i thënë se si shkonin punët. Si rezultat i kësaj metode pune, kur përgatitëm raportin e Kongresit të 7-të të Partisë, nuk ishte nevoja të mbylleshim brenda dhe të diskutonim gjatë për të sqaruar problemet që do të shtrojm, sepse probleme të tilla, si ato të «botës së tretë» etj., ne kishim kohë që i diskutonim.

Mendoj ta mbyllim këtë takim, shokë, sepse edhe ju jeni të lodhur. Si ju, edhe ne do të bëjmë të gjitha përpjekjet që miqësia midis dy partive tona të çeliko- set akoma më shumë. Ne dëshirojmë të na vini më shpesh, sepse kështu do të mësojmë më shumë nga njëri-tjetri e do ta ndiejmë veten më të fortë. Ju uroj rrugë të mbarë e shëndet të plotë! Mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*



## VENDIMET TË ZBËRTIHEHEN MIRË E TË ZBATOHEN DERI NË FUND

Shënime

14 tetor 1977

Me shokët sekretarë bëra një bisedë lidhur me masat që janë marrë ose që do të merren sipas artikullit të «Zërit të popullit» për firot. Siç konstatojnë artikulli, firot legale janë të mëdha dhe duhen marrë masa që këto të zvogëlohen në minimum. Kjo do të thotë që të forcohet disiplina kudo për këtë çështje, sepse është një humbje e madhe për ekonominë tonë.

U thashë shokëve se për një problem të tillë, për një direktivë të tillë, që shtrohet në organin qendror të Partisë, nga organet shtetërore dhe nga Partia duhet të merren menjëherë masa dhe të ulët firoja legale. Kjo kërkon një punë organizative të thelluar e të shpejtë dhe jo të zvarritur, ku dalin një mijë e një gjëra, me qëllim që të mos organizohet ulja e firove. Organizimi i duhur nuk po bëhet dhe jo vetëm për këtë problem, por edhe për të tjera. Ne marrim vendime në Byronë Politike dhe në Sekretariatën e Komitetit Qendror, bile i firmos edhe unë këto dhe i dërgojmë në bazë. Por në bazë nuk merren kurdoherë masat që rekomandohen,

puna nuk organizohet si duhet, për shembull, as në ndërmarrje, as në kooperativa bujqësore, dhe kështu planet nuk realizohen. Atëherë përse i dërgojmë në këto vendime në bazë? I dërgojmë që të zërthehen dhe të zbatohen deri në fund me një organizim të shëndoshë e zbatimi i tyre të kontrollohet imtësisht nga organet shtetërore dhe nga organet e Partisë.

U theksova shokëve se kjo çështje nuk i takon vetëm udhëheqjes, por është çështje e gjithë organizimit shtetëror dhe të Partisë. Duhet një koordinim i përbashkët e i harmonizuar i organeve të qendrës dhe të bazës, të pushtetit dhe të Partisë, për të përqendruar vëmendjen në realizimin e planeve në mënyrë të organizuar. Kur them në mënyrë të organizuar, kam parasysh që planet, qofshin këto ekonomike, politike, ideologjike apo ushtarake, të cilat përcaktohen në bazë të direktivave të marra nga Partia dhe nga pushteti, duhet të zërthehen, dhe në fakt zërthehen, por ky zërthim nuk bëhet si duhet.

Koordinimi i punëve mes organeve të Partisë dhe të pushtetit, si dhe kooperimi mes ministrive nuk bëhet si duhet. Edhe kooperimi mes ndërmarrjeve të një sistemi nuk bëhet si duhet etj. Të gjitha këto lypin një detajim të problemit që vihet për t'u zgjidhur dhe detajimi bëhet në mënyrë shkencore. Për realizimin e kësaj detyre që është zërthyer bëhen përgjegjës të gjithë, që nga baza e deri lart. Pa organizimin e zërthimit të detyrave, nuk mund të realizohet si duhet asnjëra prej tyre. Kjo punë nuk bëhet gjithmonë në këtë mënyrë dhe nuk del si duhet përgjegjësia e gjithsecilit

si individ, si organ pushteti, si organ partie, po çdonjëri përpiqet të mbulojë mungesën e organizimit, mungesën e punës, të disiplinës, duke ia hedhur fajin tjetrit. Kjo është e dëmshme, prandaj një çështjeje të tillë t'i kush-tojmë një vëmendje të madhe. Pa një kujdes të tillë kjo çështje nuk mund të vihet në rrugën e vërtetë që kërkon Partia, nuk mund të ecë përpara ekonomia jonë e planifikuar, e unifikuar dhe e harmonizuar pa ekzistuar ky organizim, ky harmonizim, ky kooperim për të cilin fola më lart.

Këto ne i kemi thënë, janë bërë urdhëresa, janë marrë vendime, po nuk zbatohen si duhet deri në fund. Kontrolli i zbatimit të tyre duhet të vërtetohet medoemos në bazë të realizimeve. Të mos ngopemi në asnjë mënyrë me lugë të zbrazët, si i thonë fjalës, pra të mos pajtohemi me mosrealizimet, të mos gënjehemi nga justifikimet, pse justifikime për mosrealizimin e detyrave gjenden kurdoherë dhe me shumicë, për arsye edhe të asaj që ne jemi akoma një vend jo shumë i përpunuar në teknikë dhe nuk notojmë në bollëk, në lëndë të para, të përpunuara ose të papërpunuara. Prandaj kjo duhet të na bëjë të mendojmë që të kemi shumë më tepër disiplinë dhe organizim në punë.

Ky nuk është problem i një, i dy apo i dhjetë personave, po u përket gjithë aparateve shtetërore dhe të Partisë, ai është problem i klasës punëtore dhe i punonjësve të tjerë, që duhet të bëhen të ndërgjegjshëm për detyrat e gjithsecilit dhe për detyrat e përbashkëta. Në qoftë se nuk arrijmë kuptimin e vërtetë ideologjik e politik dhe pastaj zbatimin teknik të problemit që na

vihet përpara, nuk mund të realizojmë planet dhe detyrat e mëdha në situatat e vështira të rrethimit kapitalisto-revizionist të vendit tonë.

Shumë gjëra të tregtisë së jashtme, që me vështirësi të madhe realizohen, ne duhet t'i kemi parasysh, prandaj të luftojmë që t'i kapërcejmë pengesat. Ato ne mund t'i kapërcejmë tërësisht, por mundet edhe jo tërësisht. Çështja për ne vihet që të gjitha ato plane që duhet të realizohen me forcat tona të brendshme, të bëhen përpjekje që të realizohen plotësisht, në kohë dhe me cilësi shumë të mirë, sepse kështu jo vetëm furnizojmë popullin, por krijojmë mundësi të mëdha që edhe importet të realizohen. Pra ne duhet të realizojmë në kohë eksportin tonë, pse eksporti i mirë krijon tregje të qëndrueshme. Këtë gjë duhet ta kuptojë çdo individ dhe çdo kolektiv. Po nuk e kuptoi këtë secili, atëherë mund të nxirren arsye, si «nuk na ka ardhur çeliku, nuk na ka ardhur pambuku nga jashtë, prandaj nuk mund të prodhohen me cilësi të mirë stofi ose veglat e ndërrimit» etj.

U thashë shokëve se, qoftë nga ana e Qeverisë, qoftë nga ana jonë si Sekretariat i Komitetit Qendror, duhet të punohet shumë me aparatet. Aparatet kanë rëndësi të madhe, po këto nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë të burokratizohen. Në këto aparate punojnë qindra veta, të mos flasim pastaj për ministrinë, për komitetet ekzekutive dhe për ndërmarrjet. Atëherë përse nuk punojmë sa duhet me këta? Ja, e vë problemin konkretisht: vazhdimisht ne marrim kontakt me ministrat, po shumë rrallë takohemi me zëvendësministrat që janë

drejtpërdrejt përgjegjës për sektorë të ndryshëm të ministrisë. Po kështu rrallëherë aparatet tona marrin kontakt drejtpërdrejt me drejtorët e ministrive ose me përgjegjësit e sektorëve të komiteteve të Partisë në rrethe, por mjaftohen me takimet me sekretarët, siç bën edhe sekretari i komitetit të Partisë të rrethit që merr kontakt vetëm me kryetarin e kooperativës, me sekretarin e organizatës-bazë dhe jo me të gjithë udhëheqjen e kooperativës, me drejtuesit e sektorëve, bile edhe me njerëzit e bazës, ku vendoset realizimi i prodhimit. :

Këtë e them jo se nuk bëhet gjë fare, po se nuk bëhet siç kërkohet. Këto kontakte ne duhet t'i forcojmë e t'i zgjerojmë, se mirë diskutojmë këtu për shumë probleme çdo ditë, rrahim mendimet, marrim edhe vendime, por të mos mbetemi vetëm në kontaktet me ministrin, ta zëmë, dhe t'i themi këtij të bëjë këtë ose atë punë. Mirëpo ministrit i thonë nga të katër anët «bëj këtë e bëj atë», nga baza i kërkojnë deri edhe majën e gjilpërës. Atëherë ç'të bëjë ai më parë? Të gjitha këto kërkesa nuk ka mundësi t'i plotësojë. Prandaj, sikur të dijë ta organizojë punën në një mënyrë të tillë, që aparatet e ministrisë të punojnë, të funksionojnë, dhe kur them aparatet e ministrisë, mendoj edhe aparatet përkatëse në varësi të çdo dikasteri pranë komiteteve ekzekutive, drejtorive të ndërmarrjeve e kështu me radhë, kjo me siguri do të sjellë rezultate. Një gjë e tillë ka rëndësi të madhe, se ekonomia jonë ecën, njerëzit tanë punojnë, pra s'mund të thuhet që nuk ecet fare, por që nuk ecet kurdoherë mirë. Ka, sidomos, disa sektorë ku vërtetohen neglizhenca të mëdha dhe të meta serioze që bëjnë të mos realizohen 50-60 zëra njëherësh nga

150 që i përkasin Qeverisë. Po pse nuk realizohen këta? Ja, për arsytet që thamë. Lëre pastaj ç'bëhet për zërat që janë në kompetencën e komiteteve ekzekutive të këshillove popullorë të rretheve dhe të vetë ministrive e ndërmarrjeve vartëse.

Prandaj i këshillova shokët që për problemet e mëdha nuk duhet lejuar të fillojë puna pa organizuar më parë detajimin e tyre me personelin vartës që bashkëpunon me ne e me dikasteret dhe ky detajim të bëhet deri në fund me shpejtësi e të vihet në zbatim në jetë etj. Ndryshe do të kemi vështirësi në realizimin e planit dhe në ndërtimin e socializmit.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## REVIZIONIZEM I SHARTUAR

Shënime

14 tetor 1977

Mbrëmë lexova krycartikullin e «Zhenminzhibaos» «Mbi lulëzimin e njëqind luleve dhe konkurrimin e njëqind shkollave», teori e vjetër kjo e Mao Ce Dunit, që në kohën kur sundonte klika e Liu Shao Çisë, Ten Hsiao Pinit, Pen Çenit e të tjerëve, kundër të cilëve u bë «Revolucioni i madh Kulturor», bile «proletar».

Mao Ce Duni e hodhi këtë ide, si të thuash, «gjeniale», që u përshtatej pikëpamjeve të tij oportuniste, mbasi një ide e tillë donte të thoshte që të gjitha pikëpamjet borgjeze, kapitaliste, marksiste, pseudomarksiste, revizioniste, trockiste, anarkiste, në çdo lëmë, duheshin lënë të lira të zhvilloheshin dhe për to të diskutoheshin. Kjo vijë kishte lidhje me pikëpamjet e tij oportuniste, sepse, siç duket nga shkrimet e tij, ai «socializmin» në Kinë nuk e ka udhëhequr në bazë të teorisë marksiste-leniniste, por në bazë të një «teorie» që e ka shartuar dhe që e quajnë maocedunide. Këtë «socializëm» në Kinë nuk e udhëheq vetëm Partia Komuniste e Kinës, dhe këtë Maoja e pohon me gojën e vet. Atë e udhëheqin edhe partitë e tjera të borgjezisë, që janë të bashkuara

në një front të përbashkët me Partinë Komuniste të Kinës. Edhe këto parti, sipas Mao Ce Dunit, duhet ta qeverisin Kinën tok me Partinë Komuniste. Është e kuptueshme që, sipas kësaj «teorie», këto parti kanë të drejtën jo vetëm të thonë fjalën e tyre në ndërtimin e një Kine të re, por edhe të shprehin pikëpamjet e tyre filozofike për artin, për kulturën, për ndërtimin e shtetit, për ushtrinë etj., etj.

Orientimi i teorisë së «lulëzimit të njëqind luleve e të konkurrimit të njëqind shkollave» nuk dilte jashtë vijës filozofike të Mao Ce Dunit, vetëm se kjo quhej dhe cilësohej si përfytyrim i një lufte model të masave, domethënë i një politike në fuqi që masat të zhvillojnë debate. Mirëpo ç'ndodhi kur u vu në fuqi kjo «teori» e kryetarit Mao? Ndodhi ajo që gjithë borgjezia reaksionare në Kinë filloi të shkruante me mijëra artikuj politikë, teorikë, kulturorë etj., etj., që binin në kundërshtim flagrant me marksizëm-leninizmin. Njëpërmjet këtyre artikujve bëheshin përpjekje për të ringjallur në masat e gjera të popullit idenë se socializmi i ndërtuar në Bashkimin Sovjetik, nën udhëheqjen e Stalinit, nuk ishte i përshtatshëm, prandaj Kina duhej të zhvillohej në një rrugë tjetër, në rrugën borgjezo-kapitaliste. E gjithë kjo fushatë dhune që po ngrihej ishte e mbështetur nga klika reaksionare e Liu-Tenit.

Përnjëherë, kur u pa një situatë e tillë, domethënë kur Mao Ce Duni me grupin e tij panë se shpërthimi i këtyre «djajve», që vetë i nxorën nga shishja, ishte tepër i rrezikshëm, u morën masat për ta ndaluar. Ky shpërthim i kapërcente kufijtë e qëllimeve të Mao Ce Dunit, sepse ai dhe grupi i tij vërtet e pëlqenin një zhvi-



llim të tillë të «lulëzimit të njëqind luleve dhe të konkurrimit të njëqind shkollave», por jo në atë formë që mori. Një gjë e tillë tregoi se i qe dhënë fund zhvillimit të kësaj ideje «gjeniale» të Maos.

Mirëpo, siç e dimë, Mao Ce Duni pas kësaj ngriti në këmbë «Revolucionin e madh Kulturor», bile edhe «proletar», me studentët, me «Gardën e kuqe» dhe me ushtrinë, duke likuiduar partinë dhe organizatat e masave, dhe me këtë mënyrë ai likuidoi shtabin e Liu Shao Çisë. Në fakt, Maoja likuidoi Liu Shao Çinë, si dhe Pen Çenin e disa krerë të tjerë reaksionarë, por jo Tenin, që ishte Liu Shao Çia numër dy, e disa të tjerë revizionistë me damkë si ky.

Të mos zgjatemi. Revolucioni Kulturor bëri përpjekje, natyrisht të çala, pse koka e tij, Mao Ce Duni, nuk ishte në pozita të vërteta marksiste-leniniste për ta udhëhequr deri në fund një revolucion të tillë, domethënë një revolucion nën diktaturën e proletariatit. Në këtë revolucion nuk hyri në fuqi dhe në veprim diktatura e proletariatit; përkundrazi, ky revolucion, që quhej «proletar» dhe «nën diktaturën e proletariatit», siç thoshte Maoja, nuk veprroi i udhëhequr nga kjo diktaturë, por nga disa mendime jo të qarta, jorevolucionare. Gjatë Revolucionit Kulturor u morën masa të mira dhe të këqija, derisa Mao Ce Duni, prapë, u tremb prej tij dhe, pasi kishte likuiduar Liu Shao Çinë, ai tok me Çu En Lain, e frenuan lëvizjen dhe u përpoqën ta vinin Kinën në pozitat që mendonte Maoja vetë, në pozita jorevolucionare, jomarksiste, por oportuniste dhe liberale. Dhe këtij qëllimi Maoja ia arriti; ai e rehabilitoi Tenin dhe

e emëroi edhe këtë zëvendëskryeministër dhe nënkryetar të partisë.

Mirëpo, pas vdekjes së Çu En Lait, në Byronë Politike ekzistonte një «katërshë», siç e quajnë Hua Kuo Feni me shokë, të cilën e akuzuan se ishte reaksionare, radikale, pseudo e majtë, por që u quajt në fakt e djathtë dhe ishte kundër çdo gjëje. Kjo, siç thonë këta, ishte «për të sjellë borgjezinë në fuqi, për të likuiduar socializmin» etj., etj. Kështu që Hua Kuo Feni me ushtrinë, pas vdekjes së Çu En Lait dhe të Maos, «me një të goditur» e likuidoi «katërshen», domethënë e stabilizoi gjendjen me puç.

Tash të vijmë te «njëqind lulet dhe njëqind shkollat». Vija e puçistëve, pra, është e qartë. Kjo «teori» e vjetër e Mao Ce Dunit u duhej atyre, por, sipas kryeartikullit të botuar në «Zhenminzhibao», atë e pengoi në zhvillimin e saj të gjerë «katërshja». Në goftë se «katërshja» e ka penguar atë, ka bërë shumë mirë, por Hua Kuo Feni e Ten Hsiao Pini me shokë e akuzojnë «katërshen» se me këtë paska bërë një krim të madh, dhe prandaj tash botuan këtë kryeartikull, ku predikojnë zhvillimin e «njëqind luleve dhe të njëqind shkollave». Kjo do të thotë që të lulëzojnë të gjitha rrymat filozofike konfuciane dhe ato borgjezo-kapitaliste, dhe kjo ideologji idealiste, kapitaliste e pragmatiste, kjo maocedunide, mbulohet me petkun marksist-leninist. «Ky zhvillim i ri i mendimit përparimtar kinez, — thuhet në këtë artikull, — është vazhdimësi dhe zbatim i përpiktë i ideve të Mao Ce Dunit». Në fakt kështu është: zhvillimi i ideve jomarksiste të Mao Ce Dunit.

Kjo i duhet ekipit revizionist që ka ardhur atje në

fuqi për transformimin e Kinës socialiste në një vend kapitalist; kjo i duhet për të përgatitur terrenin për investime të mëdha kapitaliste të shoqërive shumëkombëshe dhe për krijimin në Kinë të koncerneve të mëdha, të cilat të hyjnë në kooperim me koncernet e mëdha amerikane dhe të vendeve të tjera kapitaliste të zhvilluara ekonomikisht, domethënë të «botës së dytë». Kjo botë dhe koncernet e mëdha që ekzistojnë në të, dëshirojnë të investojnë në Kinë, se kanë interesa kolosale. Tregu kinez është i pafund, pasuritë e Kinës janë të mëdha. Për këtë qëllim këto vende kërkojnë që Kina të ketë stabilitet në pushtet, që atje të evitohet revolucioni dhe, që të arrihet kjo, jo vetëm që në pushtet duhet të jenë kundërrevolucionarët, por edhe organizimi, struktura e superstruktura e shtetit kinez të jenë kapitaliste, domethënë që zhvillimi i marrëdhënieve ekonomike, politike dhe ideologjike të tij me fuqitë e mëdha imperialiste të shkojë në harmoni. Prandaj «teoria» e «lulëzimit të njëqind luleve dhe e konkurrimit të njëqind shkollave», që është një teori tipike revizioniste, është e përshtatshme për ta.

Pardje lexova një artikull në gazetën franceze «Lé Monde», një korrespondent i së cilës trajtonte disa pikëpamje të revizionistit francez Garodi; mes të tjerave ky shpreh të njëjtat pikëpamje si dhe kinezët për zhvillimin e artit dhe të kulturës, por pa e zënë në gojë shprehjen e «njëqind luleve dhe të njëqind shkollave». Autori i këtij artikulli thoshte se duhet lënë i lirë zhvillimi i arteve, i kulturës dhe i filozofisë sipas mendimit dhe besimeve të gjithsecilit e se në asnjë mënyrë nuk duhet drejtuar veçanërisht nga dogmat e vjetruara,

por duhet lejuar konfrontimi i tyre që e ardhmja vetë të shpiket dhe jo të parashikohet, pra të shpiket nga mendimtarët, të cilët duhen lënë të lirë të zhvillojnë pikëpamjet e tyre heterogjene. Me fjalë të tjera, siç del edhe nga ky artikull, Garodia predikon po ato pikëpamje që predikon edhe Maoja. Diku në një vend korrespondenti i gazetës «Lë Mond» thotë se i vjen shumë keq që, kur ka mësuar filozofinë në universitetin e Parisit, nuk mësoi edhe për filozofinë indiane, për filozofinë kineze, për filozofinë arabe etj.

Kinezët ideologjikisht janë së bashku, në të njëjtat pozita, me të gjitha rrymat revizioniste të botës, të cilave ata do t'u shtojnë edhe karakteristikat e vetë revizionizmit kinez, që do të dalin mbi ujë, për arsye të terrenit të vetë shoqërisë kineze, të aspiratave të klikës revizioniste dhe të filozofisë së vjetër kineze. Me fjalë të tjera, revizionizmi kinez do të jetë një shartim mjaft i ndërlikuar, mistik dhe djallëzor, sepse kinezët do të avancojnë vazhdimisht në mbrojtjen e teorive të tyre revizioniste eklektike. Karakteristikë e ideologjisë revizioniste kineze do të jetë krijimi i një konfuzioni të madh në shkallë kombëtare jo vetëm për të shuar lëvizjet revolucionare dhe për të diskredituar marksizëm-leninizmin, por ky eklektizëm do të shkaktojë njëkohësisht edhe një konfuzion në ideologjinë e revizionistëve të tjerë, sidomos të atyre që mbështetin revizionizmin sovjetik.

Konfuzionin ideologjik kinezët nuk do ta shkaktojnë të shtyrë vetëm nga dëshira për demaskimin e revizionizmit sovjetik, por edhe për arsye të psikologjisë dhe të mentalitetit aziatik konfucian të Kinës dhe në

përgjithësi të filozofisë idealiste aziatike. Kur flasim për filozofinë, nuk mund ta përjashtojmë ndikimin te kjo të fesë: të budizmit, të brahmanizmit, të kristianizmit e të myslimanizmit, këta të fundit në atë shkallë sa mund të paraqiten në kontinentin aziatik dhe në nënkontinentin kinez.

Përveç kësaj, politika e Kinës do të jetë e karakterizuar edhe nga një paqëndrueshmëri e madhe dhe e vazhdueshme. Për një kohë të gjatë kjo do të karakterizohet nga hipokrizia, nga buzëqeshjet, por njëkohësisht edhe nga goditjet, nga sulme e kundërsulme jo-parimore. Gjithë kjo politikë do të karakterizohet nga tendenca për krijimin e një ambienti konfuz edhe në vende të tjera, veçanërisht në Azi dhe në Afrikë, ku Kina të mund të ketë influencën e vet dominuese, me fjalë të tjera të krijojë ato tregje dhe ato zona të influencës që i nevojiten asaj për t'u bërë një superfuqi.

Në këtë vështrim duhet zhvilluar lufta kundër revizionizmit kinez. Politika «e madhe» e Kinës do të ndeshet ballë për ballë jo vetëm me luftën e vendosur të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të të gjitha partive të tjera komuniste dhe punëtore marksiste-leniniste të botës, por njëkohësisht edhe me kundërshtimin e popujve të së ashtuquajturës botë e tretë, me të cilët Kina mendon se mund të luajë një politikë të gënjeshtërt, shumëfaqëshe, me shumë flamuj. Ajo do të bjerë në kontradikta me njërin popull apo me tjetrin, sepse vetë revizionizmi është i atillë që krijon kontradikta. Por edhe qëllimet imperialiste të Kinës do të krijojnë kontradikta jo vetëm ndërmjet saj dhe imperialistëve, jo vetëm midis saj dhe shteteve të mëdha të industrial-

zuara, domethënë imperialistëve të tjerë më të vegjël se imperializmi amerikan dhe imperializmi sovjetik, por edhe mes saj dhe shteteve e popujve që ajo i quan të «botës së tretë».

Kina ndihmoi Mobutun, ajo mori anën e kundërt të popullit kongolez. Tash, në konfliktin midis Etiopisë e Somalisë shohim që Kina ka filluar të tërhiqet, sepse e pa që u diskreditua në Afrikë me qëndrimet e mbajtura më parë. Ajo duket që aktualisht mban anën e Somalisë, e cila lufton kundër Etiopisë. Lufta në mes këtyre dy vendeve afrikane është shkaktuar nga superfuqitë, nga interesat strategjike dhe ekonomike të imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik. Socialimperializmi sovjetik ndihmon Etiopinë, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndihmojnë Somalinë. Kinës i duhej të ndihmonte Somalinë kundër Etiopisë dhe këtë ajo tash e bën, por me shumë prurëncë. Megjithatë kjo krijon përsëri një kontradiktë dhe e demaskon pretendimin «e madh» të Kinës se ajo është gjoja ndihmëse e popujve të vegjël. Atëherë, kur është e prirur për të ndihmuar popujt e vegjël, ajo duhet të përcaktojë se çfarë ndihme duhet t'u japë këtyre. Por Kina nuk është në gjendje ta përcaktojë një politikë të tillë të drejtë, për arsye se politika e saj nuk është marksiste-leniniste, por një politikë koniunkturale, një politikë eklektike, kapitaliste. Ajo ose duhet të mbështetë njërin grup kapitalist dhe të luftojë tjetrin, ose ndryshe s'ka si bën. Po të ishte marksiste-leniniste politika e Kinës, kjo duhej të godiste gjithë ata që i organizojnë këto luftëra mes popujve, kurse popujve të këtyre dy vendeve t'u tregonte rrugën e tyre të vërtetë, dome-

thënë rrugën e pavarësisë, të lirisë dhe të sovranitetit të vërtetë, duke larguar influencën dhe ndërhyrjet e imperialisto-revizionistëve. Këtë Kina nuk mund ta bëjë, prandaj politika e saj do të jetë kurdoherë një politikë koniunkturale, një politikë kapitaliste, një politikë që do të bjerë në kontradikta të vazhdueshme, që do ta diskreditojë atë nga ana politike dhe ideologjike.

Qëllimi i vërtetë i Kinës është marrja e kredive të shumta nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në radhë të parë, po edhe nga Japonia, nga Gjermania Perëndimore, nga Franca etj., për forcimin e ushtrisë dhe të ekonomisë së saj. Këta janë dy objektivat e Kinës në politikë dhe në ideologji. Asgjë marksiste-leniniste nuk ka në këto orientime; përkundrazi, kjo është një politikë dhe ideologji borgjeze, që do ta kthejë Kinën në një shtet me potencial të madh ekonomik-ushtarak, por me një strukturë e superstrukturë kapitaliste.

Marksistë-leninistët çdo ditë e çdo muaj që kalon, do ta shohin akoma më qartë këtë politikë antimarksiste të Kinës. Edhe popujt e varfër të botës, që kërkojnë liri dhe pavarësi të vërtetë, dëshirojnë të çlirohen nga prangat e kapitalit. Po ashtu ata do të shohin dhe do të kuptojnë çdo ditë e më mirë se politika e Kinës është një politikë po aq skllavëruese sa edhe ajo e imperializmit amerikan dhe e socialimperializmit sovjetik, ata do të kuptojnë se Kina bën politikë me udhëheqjet reaksionare të vendeve të botës dhe jo me popujt vetë.

Natyrisht neve marksistë-leninistëve, veçanërisht Partisë së Punës të Shqipërisë, na duhet të bëjmë një luftë të madhe, të ashpër, të pabarabartë me të gjitha fuqitë imperialisto-revizioniste. Lufta që ne po bëjmë

kundër revizionizmit kinez është e rreptë dhe ajo do të shkojë duke u ngritur, pavarësisht nga taktikat e përkohshme që do të ruajmë, për arsyet që kemi thënë. Por çështja qëndron në atë që të gjitha partitë e tjera të vërteta komuniste marksiste-leniniste duhet të kuptojnë se kemi të bëjmë me një armik të madh dhe se lufta jonë është shumë e ashpër, shumë e koklavitur, prandaj gjatë zhvillimit të saj do të gjejmë vështirësi e pengesa të mëdha, do të kemi edhe fitore.

Partitë komuniste marksiste-leniniste në botë duhet të punojnë intensivisht e të sqarojnë masat e punëtorëve dhe gjithë punonjësit e vendeve të tyre për qëllimet e Partisë, për programin minimal e maksimal të saj. Ka rëndësi që kjo punë të konkretizohet, dhe do të konkretizohet javash-javash, por konkretizimi duhet të jetë i çimentuar, jo i sipërfaqshëm, pse një konkretizim i sipërfaqshëm nuk ta krijon atë mundësi të shëndoshë për të kapërcyer fazat kritike dhe momentet e vështira që lëvizja marksiste-leniniste, socializmi, komunizmi dhe revolucioni do të hasin në botë.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 640*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 640*



## **TË MBAJME GJITHMONË TË PASTER EDUKATËN DHE MORALIN TONË PROLETAR**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**24 tetor 1977**

*Në këtë takim shoku Prokop Murra informoi për punën që bëhej në rrethin e Krujës lidhur me parandalimin e krimeve dhe për disa probleme që kishin dalë në kooperativat bujqësore të këtij rrethi. Gjithashtu, shoku Hekuran Isai informoi për zhvillimin e mbledhjes së plenumit të Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës.*

**SHOKU PROKOP MURRA:** Këto ditë isha në rrethin e Krujës. Nga analiza që iu bë gjendjes lidhur me problemin e kriminalitetit doli se puna e Partisë atje në këtë drejtim nuk ka qenë në nivelin e duhur. Pjesa dërrmuese e krimeve ndaj pronës socialiste kryhej nga punonjës të tregtisë.

Diçka tjetër që më tërhoqi vëmendjen lidhur me këtë problem, ishte zbatimi i një mase të tillë: po të dilte shitësi dyqind lekë deficit, e pushonin nga puna dhe, në qoftë se e kalonte këtë shumë, atëherë e çonin

në gjyq. Mendoj të shikohet ky problem, sepse janë të shumtë ata që largohen nga tregtia si njerëz që kanë dëmtuar arkën e shtetit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, po, e kuptoj mirë se si veprohet. Por unë këtu shoh diçka tjetër, se mos marrja e masave si këto që përmende më sipër e vë Partinë në gjumë, në inaktivitet, duke menduar se ajo nuk ka përse të bëjë punë politike me këta njerëz që shpërdorojnë pronën dhe pasurinë socialiste. Me fjalë të tjera, kur bëhet kontroll në një dyqan dhe rezulton një deficit prej dyqind lekësh, shitësja menjëherë pushohet nga puna, pa marrë parasysh asnjë rrethanë!? Kjo do të thotë që Partia të heshtë dhe të mos punojë me njerëzit sa duhet, duke menduar se punën e saj mund ta bëjë një masë e tillë. Problemi është: A studiohen me kujdes rastet e deficiteve? A arsyetohet një çikë se si i dalin këtij apo atij shitësi dyqind lekë më pak? Unë mendoj që Partia duhet ta shikojë me kujdes këtë problem. Si është e mundur të pushohet menjëherë nga puna një vajzë e re e pa përvojë për dyqind lekë? Mundet që këto lekë asaj t'ia ketë vjedhur magazinieri, i cili, sipas asaj që thatë ju, shoku Prokop, me «ustallçqet» që përdor, rrallëherë ndodh që të dalë deficit. Prandaj kjo mënyrë të vepruari nuk më duket e drejtë dhe nuk i shërben qëllimit tonë.

Zbatimi i masave të tilla administrative jo vetëm që vë në gjumë Partinë, por bën që të dënohen penalisht edhe një numër elementësh që mund të mos e meritojnë. Partia e ka për detyrë t'i studiojë me kujdes të veçantë të gjitha rastet, të punojë me njerëzit, t'i këshillojë ata. Ne përpiqemi të edukojmë edhe ata që

kanë kryer faje të rënda e jo të mos luftojmë për të edukuar e për të ndrequr një vajzë të re që dëmton arkën me një shumë të tillë lekësh e që mbase edhe nuk di të bëjë llogari mirë. Mendoj se në raste të tilla nuk veprohet drejt.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Ndërsa në tregti veprohet në këtë mënyrë, në sektorët e tjerë të ekonomisë ndodh ndryshe. Ndërmarrjeve u janë caktuar normativa për harxhimin e materialeve, të lëndëve të para e të lëndëve djegëse. Mirëpo ne vëmë re se punëtorët harxhojnë më shumë qymyr, karburant, metal, çelik etj. dhe të tëra këto i bëhen në ngarkim ndërmarrjes. Ja një shembull konkret. Për të prodhuar një ton gëlqere, ne pamë se norma ishte që të harxhoheshin 125 kilogramë qymyr, por, në realitet, punëtori harxhonte 135 kilogramë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Në këtë rast ka njëfarë ndryshimi: është tjetër gjë në qoftë se atij që shet artikuj të ndryshëm, kontrolli i gjen në arkë dyqind lekë më pak, pra, kur malli mungon, se është përvetësuar, dhe tjetër është kur punëtori harxhon më shumë lëndë të parë sesa e ka normativa. Unë jam dakord që dëmin shitësja ta paguajë, por jam kundër asaj që ajo të pushohet menjëherë nga puna. Jo, kështu nuk duhet vepruar!

Harxhimi i tepërt i qymyrit për prodhimin e gëlqeres, për shembull, ka të bëjë me shumë faktorë që mund të mos varen nga punëtori, por nga teknologjia, nga lloji i qymyrit, nga vendi ku nxirret ai, nga fuqia kalorifike e tij etj. Një arsye tjetër për këtë mund të jetë edhe lloji i gurit gëlqeror, nëse ai është i butë apo

i fortë. Sigurisht, prodhimi i gëlqeres nga gurë të fortë kërkon më shumë kalori, pra do më shumë qymyr. Punëtori, kur shikon se plani nuk është realizuar, të paktën siç e mendoj unë, se specialist për këtë punë nuk jam, por flas në bazë të logjikës, atëherë ai i ndez furrat me më shumë qymyr, që të ketë një sasi më të madhe nxehtësie, në mënyrë që të shpejtohet procesi i prodhimit të gëlqeres. Natyrisht, ne mund të kritikojmë atë që nuk mori me kohë masat për realizimin e planit, por unë e kam fjalën se puna duhet parë në tërësi, se ndodh që qymyri nuk vjen kur duhet e si duhet. Kështu që nuk mund t'ia ngarkosh punëtorit tërë fajin pse harxhoi më shumë qymyr nga normativa. Nga ai në këtë rast mund të kërkojmë përse nuk ka realizuar planin, por jo që të paguajë edhe qymyrin.

Pra, puna në tregti ndryshon, ndaj, siç e thashë edhe më sipër, mënyra se si veprohet me shitësin që del deficit deri në dyqind lekë nuk më duket e drejtë.

Mirë, po kush i cakton këto rregulla e udhëzime? Ç'bën organizata e Partisë? Po organizatat e bashkimeve profesionale dhe organizatat e tjera të masave?

Pa dyshim që për mbrojtjen e pasurisë së popullit duhet punuar. Por edhe masat që merren ndaj njerëzve, në rastet kur ka dëmtim të kësaj pasurie, duhet të jenë të logjikshme, me frymë partie, me karakter edukues, se kemi të bëjmë me çështje delikate. Dihet se, kur ndodh që një vajzë e ndershme, nga një familje e mirë, del dyqind lekë deficit dhe pushohet menjëherë nga puna, atëherë njolloset jo vetëm figura e vajzës, por edhe e familjes së saj, pasi të tjerët i vënë gishtin e i thonë «hajdute». Pas kësaj bëhet edhe mbledhja e

organizatës së Frontit në lagje, ku i tërhiqet vërejtje edhe familjes që nuk e ka edukuar mirë vajzën etj., etj. Pra, kemi të bëjmë me një zinxhir të tërë pasojash që mund të ndodhin për shkak të marrjes së masave administrative të nxituara e të papeshuara mirë. Po të veprohet në mënyrë shabllone, pa u thelluar në secilin rast, pa e parë problemin me sy politik, mund të prishet punë më shumë, duke menduar se kështu po i edukojmë njerëzit dhe po veprojmë për të mirën e shoqërisë.

Në jetë ndodhin edhe aksidente. Ka raste që disa njerëz dalin deficit deri në dyqind lekë, por qëllon që dalin edhe 8 mijë lekë. Prandaj problemi duhet të shihet me kujdes, si ndodhi e pse ndodhi një gjë e tillë, në ç'rrethana etj., domethënë, në zbatimin e rregullave e të udhëzimeve të dhëna të veprohet me logjikë e jo mekanikisht. I shikoni mirë këto punë. Në qoftë se në praktikë ndodh kështu, mua më duket se duhen rishikuar medoemos disa rregulla e urdhëresa. Përpara çështjeve si këto Partia të mos heshtë, të mos vihet në gjumë, por të luftojë për edukimin dhe për ndreqjen e njerëzve e jo të priret më shumë nga dënimi i tyre.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Një pjesë e të dënuarve në tregti nuk janë të implikuar me ndërgegjeje në krimin e vjedhjes.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk ke ç'bën, gjëra të tilla edhe do të ngjasin, sepse ai ose ajo që caktohet të punojë në tregti, mund të mos ketë hiç haber nga kjo punë dhe, në qoftë se matrapazi në ndër-marrje ia ka hedhur një herë dikujt tjetër, kësaj që është e re ia hedh njëqind herë. Por, pavarësisht nga kjo, shitësja u

pushoka nga puna edhe për dyqind lekë deficit! Ngjitu këtë njollë atyre vajzave krutane dhe hajde gjej pastaj nga ato që të shërbejnë në tregti! A nuk mendohet se sa shumë ka luftuar Partia për ta nxjerrë vajzën krutane jashtë mureve të shtëpisë, për t'i hequr asaj perçen dhe për ta futur në punë?! Kam qenë vetë atje ku enden qilimat dhe kam gjetur nënat plaka që rrinin te dera e ndërmarrjes dhe prisnin sa të mbaronte orari i punës, që vajzat të mos shkonin vetëm në shtëpi. Prandaj e theksoj se gjëra të tilla duhen parë mirë, se nuk ndodh vetëm në Krujë ky fenomen, por me siguri edhe gjetkë. Rruga e masave ndëshkimore është më e lehtë sesa puna edukuese që duhet bërë me njerëzit.

Ja, shoku Prokop, vetë na the që magazinierët s'dalin as me deficite, as me suficite, por gjithmonë gjenden në rregull. Mirëpo ne jemi të bindur se një gjë e tillë nuk është gjithmonë reale, pse edhe këta nuk janë të imunizuar nga gabimet e fajet, pra edhe tek ata mund të ndodhin humbje dhe vjedhje. Por ata, siç the ti, janë «ustallarë» dhe dinë t'ua hedhin shitëseve të reja. Kjo tregon, pra, se ka lloj-lloj njerëzish.

Rregulla e ligje ka, por kontroll ka pak. Prandaj të punohet që kontrollet të bëhen më të shpeshta. Partia duhet të bëjë një punë akoma më të madhe për edukimin politik të njerëzve, për ngritjen e tyre ideologjike në një shkallë më të lartë.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Unë shkova edhe në një kooperativë bujqësore dhe vura re se disa vendime e urdhra që lëshon Qeveria nuk shoqërohen me udhëzime sqaruese. Si rrjedhim, bëhen interpretime e konkluzione jo të drejta. Është një vendim i Qeverisë për

administrimin e drithit. Sipas tij, kooperativës nuk i lihet gjë për blegtorinë, pasi të gjithë tepricën e prodhimit të drithit ajo duhet t'ia dorëzojë shtetit. Koncentratin që i nevojitet për bagëtitë duhet ta marrë në ndërmarrjen e grumbullimit, në bazë të planit të caktuar nga shteti.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Unë nuk e di pse është vendosur të vepohet në këtë mënyrë. Në qoftë se është bërë për ekonomizim të drithit e për t'u prerë rrugën abuzimeve, atëherë mundet që ia vlen barra qiranë. Pse e them këtë? E them sepse kështu kooperativa vihet më mirë para përgjegjësisë. Tokat e destinuara për foragjere ajo t'i mbjellë me foragjere, sepse shteti nuk mund t'i japë koncentrat aq sa i nevojitet asaj për të gjitha bagëtitë. Pjesën tjetër të ushqimit të bagëtive kooperativa duhet ta plotësojë vetë, duke marrë sa më shumë njësi ushqimore për hektar. Po e arriti këtë, do të thotë se ka vepruar drejt, përndryshe del se nuk ka punuar mirë, prandaj të merren masa për ta ndrequr gjendjen.

Mendoj se çështja duhet parë pak më thellë. Mund të duket sikur tërë prodhimi është i kooperativës. Po ta shikojmë në këtë mënyrë, atëherë ne nuk mund të vëmë rregulla e të caktojmë edhe sasi të sa të mbajë kooperativa për vete e sa t'ia dorëzojë shtetit, se dikush edhe mund të thotë: «Pse më jep kaq grurë? Ky është drithi im, se unë e kam prodhuar». Pra, ai mund të kërkojë më shumë. Edhe ndonjë tjetër mund të thotë po kështu, se është prodhimi i tij. Jo, një mendim i tillë është i gabuar. Në shtetin tonë socialist ekonomia është e organizuar në atë mënyrë që drithi që ka pro-

dhuar kooperativa nuk është vetëm i saj, por i tërë popullit, se te prodhimi bujqësor që merret nuk është vetëm puna e kooperativistit, por kanë ndikuar edhe mekanizimi, ujitja, plehërimi kimik etj. Pra, në atë prodhim janë dhe djersa e mundi i klasës punëtore. Ashtu siç punon kooperativisti, ashtu punon edhe punëtori. Edhe ai mund të dojë të ardhura më shumë, por e sheh se sa janë mundësitë. Prandaj problemi duhet shtruar drejt, nga ana parimore.

Mendoj se problemi duhet shtruar kështu për disa arsye. Kooperativës i thuhet të mbajë rezervën aq sa i është caktuar. Mirëpo çfarë ka ndodhur disa herë? Në fund të vitit rezerva s'është më 20 tonë, për shembull, sa që në fillim, por 15 tonë. Ç'u bënë atëherë 5 tonë drithë? Thuhet se drithi është tharë, ka bërë firo, se u depozitua i njomë, se ishte ashtu apo ishte kështu etj. Por në të vërtetë na ka dalë se drithi është përdorur, bile ndonjëherë edhe për bagëtinë.

Prandaj mendimi im është që, për sa i përket këtij problemi, të mos jemi as burokratë, por as edhe idealistë. Them të mos jemi idealistë, sepse fshatarësia jonë kooperativiste vërtet është e ndërgjegjshme, por jo në mënyrë absolute, sa që të mos bëjë asnjë veprim jo të rregullt, në favor të interesit personal. Në qoftë se organizata e Partisë mendon kështu, gabohet, por edhe në qoftë se niset nga mendimi që këto gjëra do të ekzistojnë dhe, oburra, të jemi liberalë e oportunistë, atëherë përsëri do të gabonte. Në rast se komunistët tregohen përherë vigjilentë, atëherë punohet me mend në kokë dhe nuk bëhen shpërdorime të drithit. Por meqenëse ka raste kur organizata e Partisë apo komu-



nistë të veçantë nuk janë në këto pozita dhe ndërgjegjja e fshatarësisë sonë kooperativiste nuk është akoma në një shkallë aq të lartë, sa të reagojë përherë drejt në këto çështje, për koncentratin e bagëtisë, me sa duket, është gjetur kjo rrugëzgjdhje që kooperativa ta blejë atë në ndërmarrjen e grumbullimit. Pra, duhet parë se pse është dhënë ky urdhër e të mos shohim vetëm interesin e kooperativës. Të jetë dhënë urdhri për të marrë shteti pesë lekë më shumë nga shitja e drithit kooperativës?! Jo, s'ka përse të bëhet kjo, sepse ne e dimë që shteti kooperativave u bën disa favore dhe s'ka se ç'të fitojë nga këta pesë milionë lekë, për shembull, që mund të bëheshin nga shitja e gjithë koncentratit. Rëndësi ka të sigurojmë sa më shumë drithë. Koncentratet gjithmonë janë harxhuar në sasi të mëdha dhe përsëri vazhdon të ndodhë një gjë e tillë, veçanërisht për derrin. Ne përherë kemi luftuar në këtë drejtim, por, me sa duket, problemi nuk është aq i thjeshtë për t'u zgjidhur, prandaj kërkohet një punë më e madhe nga të gjithë. Abuzime në përdorimin e koncentratit ka jo vetëm për derrin, por edhe për lopët.

Çështja nuk duhet parë vetëm duke u nisur nga fakti se ç'do të thotë një kooperativë për një vendim apo urdhër që është dhënë, por se sa ata janë të drejtë e të zbatueshëm. Marrja e një mase të tillë jo vetëm i shërben blegtorisë, por është edhe në interes të popullit, sepse nxit kooperativistin që të punojë më shumë për të marrë rendimente sa më të larta në foragjere. Kështu, për shembull, ndërmarrja bujqësore e Lushnjës të mos i japë derrat pesë njësi koncentrat, por

një ose një e gjysmë, dhe pjesën që mbetet ta plotësojë me ushqime të tjera.

Dihet se administrimi i ekonomisë në kooperativat tona bujqësore nuk është i përsosur; shpesh vihen re edhe të meta. Në kooperativa ekziston prona socialiste, por është edhe një pronë tjetër: çdo familjeje kooperativiste i kemi lënë edhe një oborr dhe një numër të caktuar bagëtish që ajo duhet t'i ushqejë që t'i japin prodhim. Pra, puna këtu nuk është si me punëtorët e fabrikave, të cilët marrin rrogën në bazë të realizimit të normës, të kualifikimit, të stazhit në punë etj., etj. dhe nuk kanë asnjë burim tjetër të ardhurash. Kooperativisti, siç thashë më sipër, ka një copë tokë e ca bagëti të tijat, për të cilat kujdeset që të marrë sa më shumë prodhime. Por kjo e nxit atë shpeshherë që të abuzojë duke i kullotur bagëtitë në parcelat e kooperativës. Mjafton të kujtojmë se pothuajse të gjitha kundërvajtjet në fshat, të gjitha dëmtimet e pronës së kooperativës ndodhin për arsye të oborreve, që të ushqehen bagëtitë personale që ne vetë ia kemi lënë kooperativistit. Ne i kemi thënë kooperativës që të sigurojë bazë ushqimore edhe për bagëtitë personale të kooperativistëve. Kjo është thënë kaq herë, por kemi konstatuar që kooperativat, megjithatë, në mjaft raste, nuk kanë siguruar hiçgjë. Kooperativave u është thënë, gjithashtu, që t'u lënë fshatarëve edhe tokë për bagëtitë personale. Mirëpo, në realitet këto ose nuk u japin fare, ose u japin shumë pak. Kështu kooperativisti s'ka nga t'ia mbajë dhe detyrohet t'i kullotë bagëtitë në pronën e përbashkët. Siç shihet, në kooperativat bujqësore ka një varg çështjesh që duhen parë e

zgjidhur me kujdes, para se të kërkoet llogari për zbatimin e vendimeve e të urdhrave.

Rezervën që mban, kooperativa e ka për veten e saj. Drithi është flori; po të dojë, kooperativa ia jep shtetit dhe ky i jep para. Kjo është njësoj si me paratë që dikush ka në arkën e kursimit. Në qoftë se ai do të martojë vajzën dhe nuk ka lekë në shtëpi, atëherë shkon dhe merr paratë që ka depozituar në arkën e kursimit. Pra, në qoftë se kooperativa do të investojë, me se do të investojë? Ose do t'i jepet kredi, ose ajo do të përdorë rezervat që ka, ndryshe përse e ka rezervën?

Dua ta qartësoj mirë këtë gjë. Rezerva që mban kooperativa është e saj; ajo me shtetin është në rregull dhe është akoma më në rregull kur ka punuar dhe e ka shtuar rezervën e drithit. Shteti i thotë: «Mbaje këtë rezervë dhe jo vetëm të mcs e prekësh, por dalëngadalë dhe nga viti në vit ta shtosh!». Rezervat që mbahen duhet të shtohen edhe në shkallë republike. Kjo është një pasuri e madhe dhe përbën një detyrë me rëndësi ekonomike e politike për vendin tonë, se nesër mund të na ngjasë ndonjë gjë e papritur dhe ne i kemi rezervat në dorë, prandaj t'i ruajmë e të kujdesemi për to. Këtë ta kemi të qartë të gjithë.

Mirëpo del problemi i investimeve që do të bëjë kooperativa. Ku do t'i gjejë paratë ajo? — shtrohet pyetja. Po pse, ministria duhet të merret me këtë çështje?! Jo! Vetë kryetari i kooperativës të vejë në komitetin ekzekutiv e të thotë se i duhen investime për këto e ato objekte. Komiteti ekzekutiv, kur e shikon të arsyeshme kërkesën, duhet të ndërhyjë e t'i thotë Mi-

nistrisë së Bujqësisë dhe asaj të Financave që kjo kooperativë ka në rezervë kaq grurë, nga e cila, gjysma, fjala vjen, i duhet në para për të bërë stallat. Atëherë gjysma e sasisë së këtij drithi bëhet pronë e shtetit dhe kooperativës i paguhen paratë. Kështu është kjo çështje, kështu e kërkon logjika të bëhet kjo punë.

Siç e thashë edhe më parë, rezerva që mbajnë kooperativat është si rezerva që mban një familjar. Domethënë, në qoftë se familjari ka menduar të heqë mënjanë 1 000 lekë për të përballuar një hall, natyrisht, për ta krijuar këtë shumë, do të harxhojë më pak gjatë javës apo muajit. Pra, për të përballuar hallin që parashikon, ai mendon për të që më parë. Kështu duhet të ndodhë edhe me kooperativën. Ajo vë rezervë aq apo kaq kuintalë drithë dhe e llogarit që kjo sasi gruri bën kaq para, pra këto i ka aty, në depo, para-mall. Këto para-grurë kooperativa mund t'i ketë planifikuar për një investim që i duhet ta bëjë me doemos. Mirëpo burim tjetër për të siguruar para ndodh që nuk ka, veç rezervës që ka hequr. Prandaj ajo i drejtohet shtetit dhe i thotë: «Përveç drithit që dorëzova, kam edhe 10 tonë grurë, të cilët mendoj të t'i shes, sepse më duhen para për investime. Prandaj, ose më jep kredi dhe unë ta mbaj grurin vetë në depo, ose më bli grurin. Kjo është rrugëzgjidhja, tjetër rrugë nuk ka për mua». Malli nuk matet me investime, por me lekë, me vlerën që ka. Në qoftë se kooperativa atë vlerë malli e ka caktuar në plan për ta investuar, atëherë është tjetër punë. Por mundet që ajo të mos e ketë caktuar për këtë gjë.

Duhet të jetë e qartë, gjithashtu, se paga për

ditë-punë preket kur nuk është realizuar plani dhe nuk ka të bëjë me rezervën që mbahet. Kush e cakton këtë, Qeveria? Si do t'i caktojë Qeveria kooperativës sasinë e drithit për rezervë? Qeveria i thotë që të investojë e të punojë për të marrë një rendiment prej 45-50 kuintalësh grurë për hektar, për shembull. Ky është objektiv të cilin kooperativa duhet të përpiqet që ta arrijë. Kurse çështja e rezervës është punë e saj. Kooperativa mund të lërë edhe 100 kuintalë grurë rezervë. Qeveria u ka thënë kooperativave që nga prodhimi i drithit të mbajnë sasinë e domosdoshme për farë, për bukë e zahire, për këtë e për atë, dhe ç'të mbetet, të futet në rezervë të saj. Atëherë, si i caktohet kooperativës që kaq mijë kuintalë grurë duhet t'i ketë rezervë?!

Drithi që do të mbajë rezervë kooperativa, nuk është një sasi fikse, për arsye se, kur nuk realizon rendimentin, kuptohet që drithin nuk e realizon as në sasi. Nga kjo del se mund të krijohet edhe më shumë rezervë, por mund të krijohet edhe më pak. Prandaj caktimi i sasisë së drithit për rezervë nga ana e Qeverisë duhet marrë në mënyrë relative. Kështu duhet kuptuar kjo çështje, ndryshe, për hir të rezervës, kooperativës mund t'i takojë të paguajë shumë pak lekë për ditë-punë.

Ka rëndësi të kuptohen drejt këto probleme: Mirë, Qeveria mund ta parashikojë se sa kuintalë drithi duhen hequr për rezervë, po kjo arrihet në qoftë se kooperativa e realizon planin. Në rast se ajo e tejkalon rendimentin për hektar, atëherë aq më mirë, mund të krijojë një rezervë edhe më të madhe sesa parashikon

Qeveria. Po në qoftë se kooperativa nuk e realizon rendimentin (pra edhe planin) për këto e për ato arsye, atëherë nuk ka si ta krijojë rezervën që i është caktuar.

Sigurisht që, po nuk e realizove prodhimin, mund të marrësh edhe shumë më pak lekë për ditë-punë nga sa që parashikuar, gjithmonë sipas parimit «sa punon, aq do të shpërblehesh, aq do të hash». Këto çështje t'u bëhen të qarta mirë kooperativistëve.

Thuhet ndonjëherë se çdo paqartësi e çrregullim duhet ta zgjidhin dikasteret. Unë s'jam kundër mendimit që dikasteret t'i sqarojnë mirë të gjitha orientimet që jepen, por edhe rrethet të punojnë për këtë. Partia dhe komitetet ekzekutive në rrethe duhet t'i dinë këto gjëra fare mirë, sepse çdo rreth ka financierë, llogaritarë, juristë e të tjerë, domethënë, janë të gjitha mundësitë që t'i zgjidhin këto probleme. Në qoftë se presin t'ua shpjegojë Ministria e Bujqësisë çdo çështje të parashikuar që u del në rreth, mendoj se kjo nuk është as e drejtë dhe as e mundur që të bëhet. Pra, unë nuk them që të mos angazhohen ministritë me të tilla gjëra, por ato nuk janë në gjendje t'i sqarojnë të tëra problemet që dalin.

Lidhur me të gjitha këto çështje rëndësi ka që ne të çojmë në bazë frymën që na mëson Partia. Baza është kryesorja dhe jo ministritë. Shokët e Partisë që punojnë në bazë duhet t'i dinë dhe t'ua shpjegojnë mirë njerëzve këto probleme. Këtë frymë t'i çojmë në bazës, t'i inkurajojmë shokët që punojnë në rrethe, që në të tilla raste të veprojnë vetë. Nuk duhet nxitur mendimi që këto punë i takojnë kësaj apo asaj minis-

trie dhe, meqenëse jemi në Tiranë, të kërkojmë t'i zgjidhin ato të gjitha problemet që dalin në bazë. Ne që jemi në udhëheqje, kemi marrëdhënie me ministritë, prandaj t'u themi atyre t'ia qartësojnë një çikë më shumë këto probleme bazës.

Kur vemi në bazë, t'u themi shokëve atje që këto gjëra t'i kenë të qarta ata, se nuk janë probleme dhe aq të komplikuar. Natyrisht, ato mund të bëhen edhe të ndërlikuara, sepse vetë jeta është e tillë. Njerëzit nuk janë prerë të tërë me një thikë, pra, nuk mendojnë të gjithë njëloj. Ka punonjës me mentalitete të ndryshme. Këto gjëra Partia duhet t'i ketë parasysh në punën e saj të përditshme. Pikërisht këtu duhet ngulur këmbë, që Partia të jetojë vazhdimisht me problemet, në çdo moment të jetë në korent të gjendjes në rreth, në ndërmarrje e në organizatë, pra, siç themi ne, Partia duhet ta ketë situatën në pëllëmbë të dorës. Kjo ka të bëjë me punën politike që zhvillohet, me studimin e materialeve të Partisë, me leximin e shtypit të përditshëm, me përgatitjen moralo-politike të të gjithë njerëzve dhe, në radhë të parë, të komunistëve. Me njerëzit të flitet konkretisht për probleme të veçanta që shqetësojnë Partinë dhe jo në përgjithësi. Për shembull, në rast se do të merret në diskutim mbrojtja e pronës së përbashkët, nuk mjafton të thuhet se ç'pasoja të rënda i sjell shoqërisë dëmtimi i saj, por është e domosdoshme të analizohen një për një rastet që kanë ndodhur, për ta pasur të qartë se krimet ndaj pronës përbëjnë një numër të konsiderueshëm.

Së pari, organizata-bazë e Partisë duhet t'ua bëjë të qartë të gjithëve se, kur bëhet fjalë për dëmtimin

e pasurisë së përbashkët, nuk ka vend për sentimentalizëm e subjektivizëm. Ajo duhet të punojë me secilin komunist e ta bindë atë se për ne është i huaj subjektivizmi kur gjykon dikë që ka kryer krim ndaj pronës socialiste. Të gjitha rastet e krimeve ai duhet t'i gjykojë me objektivitet, qoftë ky krim i kryer nga motra, vëllai, djali apo ndonjë i afërt tjetër i tij. Për çdo rast njerëzit te ne e, në radhë të parë, komunistët duhet të nisen vetëm nga interesi i përgjithshëm.

Së dyti, Partia duhet të ndalet më seriozisht në zbulimin e shkaqeve që shtyjnë në kryerjen e krimit. Po ta bëjë mirë këtë punë Partia në fshat, medoemos që situata atje do të jetë më e shëndoshë. Ka disa arsye që e bëjnë këtë ose atë njeri të dëmtojë pasurinë e përbashkët. Nganjëherë kjo ndodh edhe sepse ne nuk organizojmë mirë punën për realizimin e planeve, të rendimenteve në drithërat e bukës apo në bimët foragjere dhe, si rrjedhim, nuk i japim kooperativistit atë çka i është thënë se do t'i jepet. Në qoftë se ndodh kështu, pavarësisht nëse e lejon apo jo morali proletar, janë mundësitë që vjedhjet të vazhdojnë. Prandaj, ç'është caktuar për t'ua dhënë kooperativistëve, u duhet dhënë patjetër, që të parandalohen dëmet. Jo vetëm t'u jepet ajo copë tokë që u është caktuar, por edhe të ndihmohen që të marrin prej saj prodhime sa më të bollshme.

Për çështje të tilla si këto s'më duket me vend të themi se duhet t'i zgjidhë Komiteti Qendror apo instruktorët e aparatit të tij. Këta pa dyshim që i shtrojnë këto probleme, bile jo një herë, por vazhdimisht. Edhe Qeveria apo ministritë po ashtu veprojnë. Pse,



për herë të parë po i themi këto gjëra ne?! Jo, nuk i themi për herë të parë, por ja që aty-këtu ekziston indiferentizmi, i cili është shumë i rrezikshëm. Se nuk mjafton të themi që luftojmë indiferentizmin dhe se ai ka këtë apo atë pasojë për socializmin, por të shikohen konkretisht veprimet e qëndrimet e njerëzve.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Edhe në plenumin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës u tha se Partia ka mundësi për ta zhvilluar më mirë këtë luftë. Atje u dhanë mjaft shembuj që tregonin se, kur vihet dorë konkretisht mbi problemet, situata ndryshon.

Drejtoresha e trikotazhit foli për punën e bërë në fabrikën e saj për t'u prerë rrugën shfaqjeve të huaja që manifestoheshin nga disa vajza e gra. Organizata-bazë e Partisë e analizoi këtë problem, dhe kuadrot më të mirë, vajza e gra, u caktuan që të shoqëroheshin me to, të dilnin e t'i përcillnin në shtëpi, të venin e të vinin së bashku në fabrikë. Puna që u bë dha frytet e saj.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shoqet e trikotazhit mendoj se kanë vepruar mirë.

Vënia në rrugë të drejtë e opinionit të përgjithshëm për moralin e femrës është një nga çështjet më të rëndësishme të Partisë. Në këtë drejtim Partia, me punën e saj të vazhdueshme e këmbëngulëse, ka thyer shumë koncepte e mentalitete të huaja që s'e linin vajzën të bënte një çap më tej nga dera e shtëpisë. Sot vajzat tona, së bashku me djemtë, i gjen kudo, në bankat e shkollës e deri në ato të universitetit, i gjen në fabrikë, në arë e në aksione. Ky është një sukses i madh për shoqërinë tonë. Partia ka folur edhe për sim-

patinë e për dashurinë që lind midis të rinjve e të re-  
jave në jetë e në punë. Është e natyrshme që midis një  
vajze dhe një djali, që rrinë së bashku gjithë atë kohë  
në një jetë plot gjallëri e bukuri, në punë, në stërvitje  
ushtarake e në aksion, të lindë simpatia, pavarësisht  
nga fakti nëse kjo ndjenjë kthehet në dashuri e nëse  
ata vendosin të lidhin jetën të dy ose jo.

Mirëpo një gjë e tillë, në radhë të parë, frenohet  
nga disa prindër, të cilët nuk pajtohen plotësisht me  
bashkimin e të rinjve në moshë të re e, në përgjithësi,  
nuk i pëlqejnë këto gjëra. Kjo ndodh sepse tek ata  
ekzistojnë mbeturinat e mentalitetit të vjetër, por edhe  
pse te vetë të rinjtë shfaqen mbeturina të së kaluarës.  
E them këtë sepse nuk ekziston gjithnjë një opinion i  
shëndoshë për shoqërinë midis një vajze e një djali.  
Kur dy të rinj të ndershëm, që janë shokë, dalin shë-  
titje e diskutojnë me njëri-tjetrin për probleme të ndry-  
shme të jetës, disave menjëherë u shkon mendja se  
ata diçka kanë midis tyre dhe thurin lloj-lloj intrigash  
për ta e në mënyrë të veçantë për vajzën. Kështu kri-  
johet opinioni se djali i filanit nuk mund ta marrë atë  
vajzë që ka shëtitur me një tjetër, megjithëse ajo është  
e ndershme. Ajo edhe mund të ketë pasur ndonjë ndje-  
një simpatie për atë djalë, e pastaj çfarë u bë? Është  
jeta kolektive, puna e përbashkët që kanë lindur sim-  
patinë për shoqi-shoqin, por kjo nuk do të thotë se  
vajza është e pandershme. Logjika e shëndoshë dhe  
botëkuptimi ynë për shoqërinë nuk duhet ta lejojnë  
një mendim të tillë. Duhet luftuar koncepti i vjetër që  
manifestohet te disa njerëz, sipas të cilit djali nuk  
mund të marrë një vajzë që e ka zënë nga dora një

djalë tjetër e se atë nuk e merr më njeri për grua. Kurse për djalin, gjithnjë duke u nisur nga ky mentalitet, një veprim i tillë jo vetëm nuk është gjë, por ai mund të shkojë lule më lule e mund të marrë edhe një vajzë më të mirë e më të re.

Ta shikojmë problemin në një aspekt tjetër. Simpatia është simpati, por kjo mund të kthehet në një dashuri të pastër dhe të rinjtë do të kërkojnë të bëjnë martesën. Mirëpo disa prindër në këto raste këmbëngulin që të rinjtë të rrinë të fejuar, të njihen mirë me njëri-tjetrin. Përderisa ata e kanë njohur shoqi-shoqin duke punuar për një kohë të gjatë së bashku, nuk ka arsye që të rrinë më gjatë të fejuar. Sa duhet të rrinë akoma që të njihen këta të rinj mirë, sa të venë 30 vjeç?! Dje më treguan një rast që «nuk hahet» dhe, natyrisht, nuk mund të përgjithësohet, por ndodh edhe kështu: Një nënë ka qortuar djalin, pse ky u martua i ri, 21 vjeç. Nëna kundërshton jo se nuk e ka dashur vajzën që mori djali i saj, por vetëm pse ai u martua 21 vjeç! Shikoni deri ku i çon mentaliteti disa njerëz! Por, siç thashë, ky nuk është mentaliteti i të gjithëve. Prandaj në këto raste duhet vepruar me logjikë. Kur të rinjtë dashurohen me njëri-tjetrin prej kaq kohësh, nuk është e logjikshme të kërkojnë që ata të vazhdojnë akoma të njihen mirë.

Ndodh që dy të rinj, të cilët e duan njëri-tjetrin, martohen me entuziazëm të madh dhe pastaj, për një-rën arsye ose për një tjetër, ndahen. Por ne nuk duhet të lejojmë që të rinjtë të bien nën ndikimin e njerëzve me mentalitete të vjetra. Detyra jonë është të punojmë me njerëzit për të pasur sa më pak raste divorcesh. Të

tilla do të ketë, se ekziston e drejta për divorcim. Ky është fenomen i njohur, pra nuk është i ri. Edhe sot bashkëshortët, kur nuk mund të bashkëjetojnë me njëri-tjetrin, ndahen, ligji e parashikon këtë, por këtë liri që kanë ata është e domosdoshme ta përdorin si duhet. Në këtë drejtim të punojë edhe Partia. Vëmë re se numri i divorceve po shtohet. Pse ndodh kjo? Shpesh divorcet ndodhin nga papjekuria e të rinjve, ngaqë ata nuk i mendojnë e nuk i kuptojnë thellë të gjitha problemet, gjë që është fare e natyrshme. Për këto arsye Partia duhet të punojë me të rinjtë. Por komunisti duhet të jetë i pjekur, i ngritur ideologjikisht, që të mund të bëjë një punë bindëse me ta. Në qoftë se ai nuk e sheh problemin në platformën që thashë, nuk do të ketë rezultat në punën e tij, por nuk duhet të gjykojë as si sektar, sepse jeta sot ka ndryshuar. Vetë prindi, përderisa e dërgon vajzën në shkollë ose në punë, pranon që ajo të shoqërohet me të rinj, dhe kjo mund të çojë edhe në miqësi e dashuri midis tyre. Natyrisht, prindërit i këshillojnë fëmijët, djalin e vajzën, që të zgjedhin një njeri të mirë e të ndershëm në jetë, u shpjegojnë ç'është martesë etj., etj. Biseda të tilla duhet të bëhen me të rinjtë, sepse në këtë mënyrë i orientojmë drejt ata dhe edukatën e moralin tonë i mbajmë gjithmonë të pastër.

Te ne ekzistojnë mundësi të mëdha që të evitohen sjelljet e pahijshme e të pakësohen divorcet, por për këtë, në radhë të parë, duhen luftuar mentalitetet e vjetra. Puna e Partisë në këtë drejtim të ngrihet në një shkallë më të lartë. Ka edhe vajza, por edhe djem, që futen në rrugë të gabuar e degjenerojnë. Të përpiqemi

të mos i lëmë ata të rrëshqasin, por t'u japim dorën dhe të punojmë me ta. Se sa efekt të madh ka puna që bëhet në raste të tilla e tregon shembulli që u tha këtu për Fabrikën e Trikotazhit në Korçë, ku midis gjithë atyre punëtorëve kishte disa vajza jo të rregullta. Organizata-bazë e Partisë atje ngarkoi disa shoqe të mira t'i mbanin afër ato, t'i shoqëronin, t'i përcillnin për në shtëpi dhe t'i këshillonin. Kjo bën që ato të reflektojnë drejt dhe ta kuptojnë se shoqet po mundohen për të mirën e tyre, që ato të kthehen në rrugë të mbarë.

Diçka tjetër që duhet të na tërheqë vëmendjen të gjithëve, por në radhë të parë organizatës së gruas, është çështja e aborteve. Nga statistikat mësoj se ka më pak aborte nga gratë kooperativiste e punëtore. Kjo tregon se shkakut i aborteve nuk është puna që bëjnë ato. Në arë apo në fabrikë është e domosdoshme që gruaja shtatzënë të mënjanohet nga punët që e dëmtojnë. Këto gjëra nuk duhen parë në mënyrë burokratike nga drejtuesit e ndërmarrjes apo nga brigadieri. Gjendja e gruas shtatzënë duhet mbajtur parasysh gjatë gjithë kohës së barrës dhe jo vetëm kur të marrë lejen e lindjes. Sa gra shtatzëna mund të ketë një brigadë? Një, dy a tri. Po pse, do të dëmtohet puna e brigadës në qoftë se tregohet një çikë më shumë kujdes për këto gra gjatë asaj periudhe? Sigurisht që jo.

Gjithashtu, nga statistikat del se nga gratë intelektuale ka aborte më tepër se nga gratë fshatare e punëtore. Kjo ka të bëjë me edukatën, me kujdesin më të madh që duhet treguar në këtë drejtim. Për këtë gjë duhet të punojë edhe Partia, por, sidomos, të punojnë më shumë komunistët me njëri-tjetrin, me shoku-shokun.

Por edhe organizatat e masave, veçanërisht organizata e gruas, të punojnë me gratë, të flasin hapur me to.

A duhen bërë këto biseda? Po, mendoj se duhen bërë. Po kush mund t'i thotë e t'i shpjegojë më mirë këto gjëra? Burri t'ia thotë gruas, shoku t'ia thotë shokut e shoqja shoqes e sidomos mamitë. Përse i kemi gjithë këto mami? Ato e kanë për detyrë t'ua shpjegojnë mirë këto gjëra grave, që këto të mos veprojnë sipas kokës së vet, duke rrezikuar edhe jetën e tyre nga veprime të tilla.

Unë nuk jam dakord me ndonjë propozim që na bëhet për të përdorur mjete që përdor bota jashtë. Jo, këtë nuk duhet ta lejojmë, jo vetëm se jemi një popull i vogël që duhet shtuar, por edhe se në këtë rrugë jashtë kanë ndodhur skandale të mëdha, prandaj s'kemi pse të hyjmë edhe ne në rrugë të tilla, por t'u shpjegohet qartë njerëzve se aborti është krim dhe për këtë mund dhe duhet të parandalohet.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Po, këto lloje krimesh mund të parandalohen, shoku Enver. Ky është një problem shoqëror që ka të bëjë me edukatën e që mund të vihet në rrugë të drejtë, me një punë më të kujdeshme nga njerëzit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Partia me punën e saj ideopolitike e bën vazhdimisht të qartë faktin se sot në jetën tonë kanë ndodhur ndryshime të mëdha shoqërore, janë përmbysur koncepte të tëra. Që ngjasin disa fenomene të huaja për moralin e shoqërisë sonë të re, kjo nuk mund të mohohet, por nuk duhet ekzagjeruar, sepse, po të lexosh historinë sociale të vendeve të tjera, ka prej tyre ku shoqëria, familja po

shkojnë drejt shturjes së plotë. Në disa vende të rinjtë e të rejtat nuk i lënë të rrinë tok. Po ç'sjell një gjë e tillë? Asgjë nuk sjell, pikërisht atje bëhen gjëra akoma më të ulëta. Kurse këtu te ne midis të rinjve dhe të rejave që jetojnë, punojnë e mësojnë pranë njëri-tjetrit krijohet një ndjenjë shoqërore e një edukatë tjetër, e shëndoshë, sepse normat tona morale janë të atilla që u japin atyre mundësinë të krijojnë një koncept të drejtë për shoqërinë. Në vendet borgjeze këto probleme janë të mprehta, atje vajza ndahet nga familja që në moshë fare të re, zë një dhomë dhe martohet me atë që do, pavarësisht nga dëshira e prindërve. Në këto vende ndodhin edhe marrëveshje të turpshme midis dy bashkëshortëve, të cilët bien dakord që gruaja të shkojë me një tjetër e burri me një tjetër, gjë që nuk konsiderohet e pamoralshme. Ja, deri ku të çon degjenerimi borgjez!

Te ne, në përgjithësi, mbizotëron një situatë e pastër dhe një moral i shëndoshë. Me punën tonë këmbëngulëse arritëm që vajzat të shkojnë në shkollë bashkë me djemtë, të punojnë në fabrika dhe në ara tok me ta. Tashti na duhet të punojmë për konsolidimin e politikës, të ideologjisë dhe të moralit proletar. Të konsolidojmë moralin proletar dhe jo sektarizmin e vjetër patriarkal, por të mos lejojmë as shturjen liberale. Jo, në asnjë mënyrë nuk do ta lejojmë këtë, pale pastaj mënyrën dekadente të jetesës të vendeve të tjera, revizioniste e kapitaliste.

Nuk do të jemi realistë, në qoftë se do të themi se te ne nuk manifestohen shfaqje të huaja, por këto nuk duhet të na trembin, se nuk janë mbizotëruese. Ne i

gjykojmë si të tilla dhe duhet t'i gjykojmë kështu, se duhet t'i pakësojmë ato. Këtë mund ta bëjë vetëm Partia me punën e saj, duke krijuar një mentalitet të shëndoshë për të gjitha këto fenomene.

Para pak kohësh më shkruante një grua: «Shoku Enver, jam e martuar me një oficer, kam edhe një fëmijë. Të dy e duam njëri-tjetrin, jemi martuar me dashuri. Tashti që u transferuam, më janë qepur nëna e babai i djalit dhe kërkojnë të më ndajnë nga burri. Në fillim burri u përpoq t'ua kundërshtonte mendimin prindërve të tij, mirëpo tashti ka rënë edhe ai në ato pozita. Ju lutem ndërhyni». Ky rast tregon qartë se mentalitetet e vjetra e pengojnë të renë të ecë përpara. Fëmijët rriten, martohen, krijojnë familje dhe për arsye të kushteve mund të jetojnë në një apartament më vete nga prindërit. Në qoftë se djali, që ka qenë i zënë me punë, nuk shkon të shohë prindërit gjatë javës, tek ata nuk duhet të ngrenë krye ndjenja të tilla, si xhelozia, egoizmi etj., gjë që shprehet pastaj në marrëdhëniet me djalin e me nusen. Konceptet e vjetra nuk zhduken lehtë, por Partia duhet të ngulë këmbë me punën e saj të vazhdueshme.

*Botuar për herë të parë,  
me shkurtime, në librin:  
Enver Hoxha, «Për rininë»  
(Përmbledhje veprash),  
vëll. II, f. 481*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e inçizuar që  
gjendet në AQP.*



# PRODIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE LIDHET NË RADHË TË PARË ME ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

25 tetor 1977

Problemi i energjisë elektrike është një problem i madh që lidhet në radhë të parë me zhvillimin ekonomik të vendit. Çështja është që energjia elektrike të shihet në funksion të zhvillimit të forcave prodhuese, sidomos të industrisë, të bujqësisë dhe të kulturës. Skicë-ideja është interesante, por ajo varet nga planet tona. Më parë duhet të na vijë planet, pastaj të vendoset për këtë çështje.

Këtu në Byronë Politike mund të na jepen shpjegime lidhur me skicë-idenë, disa të dhëna, për shembull, për anën financiare, të dimë se sa do të na kushtojnë përafërsisht veprat që parashikohet të ngrihen, me

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth skicë-idesë «Mbi perspektivën e zhvillimit të burimeve energjetike për periudhën 1975-1990», paraqitur nga Këshilli i Ministrave i RPSSH.

qëllim që t'i kemi vazhdimisht parasysh, duke marrë për bazë edhe potencialin ekonomik të vendit tonë. Dihet se hidrocentralet e mëdha, si ai i Skavicës ose i Vjosës, kërkojnë shumë fonde. Mundet që të mos jetë parë hollësisht çështja nga kjo anë, sepse ky është një problem i madh, sidoqoftë, disa gjëra mund të na thuhën. Për shembull, sa më shumë mund të na kushtojë hidrocentrali i Skavicës?

Ju thoni se hidrocentrali i Skavicës, në krahasim me atë të Fierzës, do të kushtojë 50 për qind më shumë. A është llogaritur këtu edhe çështja e gjashtë mijë hektarëve tokë buke që humbasim? Kjo mund të jetë e leverdishme, por meqë prishen gjashtë mijë hektarë tokë, duhet të intensifikojmë punën për të siguruar toka të reja që të prodhojmë bukën.

Unë mendoj se, me faktorët klimatikë dhe me reshjet e bollshme që ka vendi ynë, nuk mund të ndodhë që të thahet Drini. Megjithatë lind pyetja: Sa metra kub ujë mund të duhen në një vit thatësire që të plotësohet sasia e domosdoshme e tij në liqenin e Hidrocentralit të Fierzës, në qoftë se bie niveli i këtij liqeni? Kam lexuar diku apo kam dëgjuar që ekzistojnë metoda të pompimit të ujërave në kohën e shirave në bacsnet e hidrocentraleve për të evituar uljen, rënien e nivelit të ujit dhe të energjisë elektrike, natyrisht duke krijuar basene plotësuese, të cilat do të përdoren pastaj në kohën e duhur. Dua të di më shumë për këtë metodë dhe nëse ka mundësi të realizohet një gjë e tillë. Me sa u shpjegua këtu, del se te ne nuk ka nevojë për zbatimin e një metode të tillë, por vështirësi për prodhimin e energjisë elektrike në kohë thatësire

patjetër do të kemi. Prandaj duhet menduar si t'i evitojmë këto vështirësi.

Nga leximi i skicë-idesë, për hidrocentralin e Skavicës gjërat qartësohen, ndërsa për atë që do të ndërtohet mbi lumin e Vjosës nuk jam i qartë, sepse në skicë-ide kalohet pak përciptas për këtë hidrocentral. Megjithatë mund të them se, siç del aty, ngritja e hidrocentraleve mbi lumin e Vjosës është e leverdishme. Por unë e kam fjalën lidhur me ekonominë tonë dhe me çështjen e tokave të bukës. Problemi është edhe te ngarkesa, prandaj duhet të bëhen mirë llogaritë. Tani për tani janë paraqitur disa variante të ndryshme. Por, duke marrë parasysh zhvillimin e forcave prodhuese të ekonomisë sonë, sidomos zhvillimin e industrisë, duke pasur parasysh në përgjithësi kapacitetet e minierave tona, të naftës, duke llogaritur edhe shumë të papritura që mund të kemi në naftë, si edhe në nxjerrjen e mineraleve, në zhvillimin e bujqësisë etj., duhet përcaktuar drejt se çfarë radhe duhet të ndjekim deri në vitin 1990, me çfarë vepre duhet të fillojmë pasi të ketë mbaruar Hidrocentrali i Komanit. Në qoftë se duhet filluar me Skavicën, atëherë duhet ditur që më parë sa kohë do të duan studimi dhe projektimi i këtij hidrocentrali me forcat që disponojmë, duke pasur parasysh dhe punën që kemi në duar; duhen bërë mirë llogaritë edhe për të gjitha shpenzimet që do të kërkojë ai. Kuptohet, sot nuk vendosim dot gjë për këtë. Duhet të bëjmë njëherë llogarinë e plotë ekonomike për këtë vepër, si dhe për të gjithë skicën e përgjithshme të planit të ardhshëm pesëvjeçar.

Mendoj se skicë-ideja që po diskutojmë duhet të

inkuadrohet në planet dhe në mundësitë tona. Gjithashtu të mbajmë parasysh se, për momentet që po jetojmë, do të hasim akoma më shumë vështirësi, për kapërcimin e të cilave duhen parashikuar me kohë masat e nevojshme.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# **PLOTËSIMI I KONTINGJENTIT PËR SHKOLLAT E MESME KËRKON NJË PUNË MË TË MADHE POLITIKE DHE IDEOLOGJIKE**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**25 tetor 1977**

Unë nuk do të them shumë gjëra, por desha të theksoja se studimet që përgatiten me kujdes, janë bindëse, sqarojnë problemet që krijohen, duke na treguar ku ka të meta, anomali etj.

Kam përshtypjen se anomalitë në shpërndarjen e punonjësve me arsim të lartë e të mesëm nuk kanë qenë të mëdha, domethënë organizmat shtetërorë nuk kishin krijuar kontingjente të mëdha në një sektor, ndërsa një tjetër ta kishin lënë pa gjë. Ka pasur raste të tilla e, natyrisht, do të ketë edhe më vonë, por problemi nuk paraqitet aq shqetësues. Unë jam dakord me rregullimin që është bërë, tani, pra, na ka ardhur në

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth raportit «Mbi përgatitjen, shpërndarjen dhe përdorimin e punonjësve me arsim të lartë e të mesëm».

një platformë më të pëlqyeshme, më të drejtë, pavarësisht se përsëri do të ketë ndonjë gjë për të ndrequr, por, në përgjithësi, çrregullimet janë ujdur.

Arsimi ynë në përgjithësi, aktualisht, nga shkolla 8-vjeçare deri në universitet, është stabilizuar, janë vendosur rregulla dhe janë gjetur forma se si duhet vepruar. Tani, natyrisht, mbetet që t'i përfeksionojmë këto më tej dhe të studiojmë edhe propozimet që u bënë këtu, duke pasur parasysh, siç e thanë shokët, jo vetëm anën financiare, po edhe çështjen që u vu në dukje, që mjaft fëmijë, të cilët nuk vazhdojnë shkollat e mesme, nuk futen në punë për arsye të moshës dhe disa prej tyre kryejnë akte rrugaçërie. Sipas ligjit, nuk duhet t'i lëmë ata të punojnë në moshë të njomë. Fëmija që ka mbaruar shkollën 8-vjeçare është 14 vjeç. Puna e rëndë në këtë moshë dëmton shëndetin. Në qoftë se atij në fshat i ngarkohet të ruajë delet, ta zëmë, një punë e tillë nuk e dëmton, por në qoftë se vihet të punojë me bel apo të prashitë, kjo është punë e rëndë për moshën e tij dhe nuk i bën mirë për shëndetin. Sidoqoftë, ky është një problem që duhet ta shohim mirë dhe nga të gjitha anët.

Çështjet që ngriti shoku Manush [Myftiu] duhen pasur parasysh. Përqindjen më të madhe të të rinjve dhe të të rejave të qytetit ne do t'i drejtojmë në fshat, për arsye se zhvillimi i industrisë sonë duhet të shkojë drejt mekanizimit dhe automatizimit. Me këtë rendimenti do të ngrihet, do të zgjerohen njohuritë dhe dituritë e njerëzve, do të përmirësohen më tej mjetet e prodhimit. Kështu që do të ketë njerëz nga qyteti që do të duhet të venë për të punuar në fshat. Pra, në

qoftë se për fëmijët e qytetit e bëjmë shkollën e mesme të detyrueshme, shumica e maturanëve do të drejtohet në fshat. Por edhe këtë ta mendojmë mirë, sepse nuk është e rregullt që i riu dhe e reja e qytetit të venë më të mësuar në fshat, pra më superiorë nga i riu dhe e reja e fshatit, që, duke mos qenë të detyruar të ndjekin shkollën e mesme, do të mbeteshin me një nivel arsimor e kulturor më të ulët. Fshatarët punojnë, kjo është e vërtetë, por edhe në fshat, ashtu si në qytet, ka njerëz që bëjnë shkelje, qofshin këto edhe të vogla, por që sjellin dëme. E fut tjetri lopën në arat e kooperativës dhe dëmton të mbjellat, ndonjë bën edhe vjedhje në pronën e kooperativës etj.

Ne nuk duhet ta neglizhojmë këtë problem, por, në qoftë se e studiojmë, ta studiojmë nga shumë anë, lidhur me zgjerimin e planit dhe me nevojat tona. Të mos harrojmë, pra, që krahas dërgimit të rinisë qytetare në fshat, duhet të punojmë edhe për zhvillimin e fshatit, që këtë të mos e lëmë në një nivel më të ulët se qyteti nga pikëpamja e ngritjes arsimore e kulturorë të njerëzve. Prandaj ngritja e përgjithshme, si në drejtim të nivelit arsimor, por edhe të kulturës tani duhet të marrë një hov më të madh edhe në fshat. Kjo është e domosdoshme, sepse të kemi parasysh që të rinjtë e të rejat e fshatit prapë janë në një nivel më të ulët nga të rinjtë e qytetit.

Shkollat e ulëta profesionale ne nuk duhet t'i nënvleftësojmë dhe të mos mendojmë t'i zëvendësojmë me shkolla të mesme, por të bëjmë përpjekje më të mëdha që të rinjtë e të rejat t'i vazhdojnë këto shkolla. Ne edhe në shkolla profesionale do t'i dërgojmë ata, por

do të ngjasë edhe ajo që na ngjet aktualisht, që i riu ose e reja nuk duan të vazhdojnë shkollën, ose nuk e kanë qejf atë zanat që duam të marrin dhe nuk tregojnë interesim për të, vetëm se ne nxjerrim ligjin që i detyron të vazhdojnë shkollën.

Ligji ka anën e detyrimit, që na bën të marrim sanksione. Sanksionet janë të mira, por kanë edhe të këqijat e tyre. Na raportojnë shokët që vajtën në rrethe, se në fshat gjobiten mjaft njerëz. Kështu, siç na raportoi Hekurani [Isai], është krijuar një situatë që këto masa janë bërë si diçka e zakonshme. «Punë e madhe se u dënova me gjobë, — thotë tjetri, — unë po i them djalit të lëshojë lopën të kullotë dhe, po e panë, mirë, po nuk e panë, unë fitoj, kullos lopën, fundja edhe gjobën e paguaj».

Ne nuk mund të mendojmë ta bëjmë të detyrueshme shkollën e mesme, duke e sanksionuar me ligj. Këtu më parë vihet çështja e bindjes së prindërve, që t'i nxitin fëmijët të vazhdojnë shkollat e mesme ose shkollat e tjera një dhe dyvjeçare. Këto kanë një gjë të mirë, mendoj unë, se e lidhin nxënësin me disa profesione më të detajuara. Shkolla politeknike, natyrisht, është më e mirë, por në shkollat e ulëta profesionale nxënësi merr një specialitet të ngushtë dhe ne kemi nevojë edhe për teknikë të tillë, të cilët duhet të bëhen ndihmësit e atyre që mbarojnë shkollën e mesme. Natyrisht, eksperiencia do t'i bëjë edhe këta që të ecin përpara.

Unë njoh një djalë që shërben pranë meje, Dashi<sup>1</sup>

---

1. Dashnor Antonl.



e thonë, dhe është nipi i Gogos [Nushi]. Djalin tim, që ka mbaruar universitetin, nuk e krahasoj me të nga ana praktike, pse Dashi është i aftë sa nuk lë gjë pa bërë, edhe televizorin e ndreq. Atij ç'i sheh syri i bën dora, prandaj kam një admirim të madh për të. Kjo është një gjë pozitive dhe tregon se shkollat politeknike nxjerrin kuadro shumë të kualifikuar.

Plotësimi i kontingjentit të planifikuar për shkollat e mesme kërkon një punë më të madhe politike dhe ideologjike, që t'i nxitim të rinjtë ta duan shkollën, ta ndjekin atë. Mund t'u themi edhe që shkolla është e detyrueshme, por sanksione të mos vëmë, të mos nxjerrim ligj për këtë çështje. Ne mund të shtojmë ritmet e pranimit në shkollat e mesme, në qytet në mënyrë më të shtrënguar, kurse në fshat një çikë më pak.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verball i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## PARTIA JONË U DEL PËRPARA SITUATAVE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

25 tetor 1977

Tash kisha edhe një çështje tjetër, atë të marrëdhënieve tona me Kinën, kursi antimarksist i së cilës po merr proporcione të rrezikshme. Unë mendoj se duhet të bëjmë një hap përpara për shpjegimin në Parti të qëndrimeve ideopolitike të Partisë Komuniste të Kinës. Këtë çështje duhet ta vendosim në Byronë Politike.

Për problemin kinez më duket e nevojshme të mos mbetemi më në stadin e kritikës së teorisë së «tri botëve» dhe të luftës vetëm në një krah, kundër imperializmit, me një fjalë në problemet që shtruan në Kongres, në ato që trajton artikulli i 7 korrikut «Teoria dhe praktika e revolucionit» dhe në çështjet që ngritëm në Plenumin e 2-të të Komitetit Qendror të Partisë, por të shkojmë më tutje. Unë kam reflektuar ca, jam

---

1. Pasi përfundoi diskutimi i çështjeve që përmbante rendi i ditës i kësaj mbledhjeje, duke marrë përsëri fjalën, shoku Enver Hoxha ngriti disa probleme që kishin të bënin me përgatitjet për mbledhjen e Plenumit të 3-të të KQ të PPSH.

përpjekur dhe kam përgatitur një material që është një çikë i gjatë, rreth 500 faqe<sup>1</sup>. I tërë ky nuk mund të jepet në Plenum, sepse problemi, siç e dimë, është shumë i gjerë, shumë i thellë, dokumente zyrtare edhe kemi, po edhe s'kemi, pastaj nuk është e lehtë të nxjerrësh konkluzione të plota për një problem kaq të madh. Megjithatë, kam bërë një përpjekje në këtë drejtim dhe në Plenum, për të cilin kam përgatitur materialin që ju do ta shikoni, mendoj të shtroj teorisht çështjen e tendencave dhe të veprimeve të Kinës për t'u bërë një superfuqi socialimperialiste, të argumentuar me fakte dhe të shpjeguar në bazë të marksizëm-leninizmit.

Çështja e dytë është analiza e maocedunidesë, domethënë a është kjo një teori marksiste-leniniste e zbatuar në kushtet e Kinës, apo nuk është? Natyrisht, këtë ne e kemi diskutuar dhe e diskutojmë vazhdimisht dhe na del që nuk është e tillë.

Këto dy çështje mendoj të shtjellojmë në Plenum. Çështja tjetër është që në këtë situatë detyrat e Partisë bëhen shumë më të mëdha. Partia tani duhet ta kuptojë më mirë gjendjen e vendit tonë. Kur ne themi që jetojmë në rrethim, të jemi të ndërgjegjshëm se jetojmë me të vërtetë në rrethim; kur themi të mbështetemi fort në forcat tona, të mendojmë që me të vërtetë të bazohemi në forcat tona.

Ky material mund të jetë si i pari, një çikë më i shkurtër, dhe për këtë jemi duke punuar me Ramizin,

---

1. Është fjala për librin «Imperializmi dhe revolucioni», që u botua në shqip dhe në disa gjuhë të huaja në vitin 1978.

me Nexhmijen dhe me disa shokë të tjerë. Materiali tjetër është plotësues. Për këtë qëllim ristudiova veprën «Imperializmi, si faza më e lartë e kapitalizmit» të Leninit dhe mjaft libra të ekonomisë që kemi nëpër duar. Çështja është ta shpjegojmë drejt këtë situatë. Për këtë jam përpjekur të shpjegoj se si zhvillohet aktualisht imperializmi, si është interferuar ai në vendet revizioniste, se si kapitali i madh financiar dhe monopolet, nëpërmjet kredive dhe investimeve, kanë shtrirë sundimin në vendet ish-socialiste dhe në këtë drejtim hedh një ide, kap një temë tjetër, «Kina dhe imperializmi», me të cilën dua të them se edhe Kina ndjek po këtë rrugë.

Këtu ka edhe shumë probleme të tjera, si ai i popujve të «botës së tretë», duke i parë këta nga ana historike, shoqërore, ekonomike, ideologjike, nga gjendja politike dhe strukturore, si dhe duke shpjeguar çfarë synimesh ndjek Kina ndaj tyre.

Kam pastaj edhe një material më volumincz, në të cilin nuk hyn analiza e Revolucionit Kulturor, pasi për këtë kam përgatitur një material të veçantë, se e kam ndjekur Revolucionin Kulturor që kur filloi dhe deri tash që po bëhen gati 11 vjet. Gjatë kësaj periudhe, etapë pas etape, kam mbajtur shënime rreth zhvillimit të tij, natyrisht, me aq sa kam mundur. Aty ka orientime politike, ideologjike, organizative; flitet për qëndrimet e mbajtura, për rezultatet e arritura etj. Materiali<sup>1</sup> është

---

1. Ky material voluminoz, i nxjerrë nga «Ditari për çështje ndërkombëtare», u bë i njohur për publikun, duke u botuar në librin me dy vëllime «Shënime për Kinën» në vitin 1979.

rreth 1 500-2 000 faqe, se përfshin gjithë këta vjet, por ky duhet punuar, plotësuar dhe redaktuar.

Me pak fjalë, desha të thosha këtë, që ne, Byrosë Politike dhe Komitetit Qendror, na vihet një detyrë e madhe, që, në unitet dhe në bashkëpunim, ta përcaktojmë më saktë këtë rrymë të madhe të revizionizmit që po zhvillohet në Kinë, që po ngrihet krahas imperializmit dhe socialimperializmit sovjetik. Për studimin e këtij problemi me siguri do të na mësojë edhe koha. Por këto që themi duhet t'i mbështetim dhe të bëjmë që t'i shërbejnë Partisë sonë, njëkohësisht të ruajmë autoritetin e madh që ka fituar ajo në botë, sidomos në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Unë mendoj se duhet të vendosim si do të bëjmë në Parti, sa do të themi e çfarë do të themi më parë.

Brenda këtij muaji do të caktojmë mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror, që do ta bëjmë në muajin nëntor, dhe raporti që do të mbahet atje është bërë gati. Ai do t'u shpërndahet shokëve të Byrosë Politike që ta studiojnë, pastaj të bëjmë mbledhjen e Byrosë, ku të jepet mendimi kolektiv për të. Besoj se 10 ditë janë të mjaftueshme për ta studiuar raportin shokët e Byrosë Politike.

Tok me raportin që kemi për Plenumin, mendoj t'ju dërgoj edhe këtë material që ta studioni; gjithashtu mendoj që, mbasi ta pranojmë raportin me korrigjimet që do t'i bëhen etj., t'u mos veprojmë siç vepruam më përpara, domethënë që e lexuam, po t'u japim mundësi shokëve të Plenumit ta studiojnë që të diskutojnë. Këtu ka kolegjialitet, ka aprovim të vijës, është një vijë që caktohet në momente historike.

Ne do të vendosim si do të ecim përpara. Kur studiojmë pyetjet që janë bërë në bazë, na mbushet mendja se Partia është e qartë, se ajo është e ngritur politikisht dhe ideologjikisht. Prandaj na vihet detyrë t'u dalim përpara situatave. Partisë t'ia themi më mirë këto çështje. Në qoftë se jeni dakord, atëherë do t'jua dërgoj materialin.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# SI DUHET TË KUPTOHET E TË THELLOHET MË TEJ REVOLUCIONI TEKNIKO-SHKENCOR

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

27 tetor 1977

Në mbledhjen e sotme kemi thirrur shokë të ndryshëm që janë të lidhur me çështjen që do të diskutojmë dhe kemi bindjen se ata do të na ndihmojnë. Asistojnë me këtë rast edhe disa sekretarë të komiteteve të Partisë të rretheve, për të cilët nuk është i huaj problemi i revolucionit tekniko-shkencor.

Dëshironi t'u bëni pyetje shokëve? Relacionin për këtë çështje e ka bërë Komisioni i Planit. Ju, shokë të planit, e keni bërë vetë apo në bashkëpunim me të tjerë? Keni mbajtur parasysh vendimet që kanë dalë për këtë problem? A ka një kuptim të qartë teorik, politik dhe organizativ të revolucionit tekniko-shkencor?

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga Komisioni i Planit të Shtetit «Mbi punën që është bërë për zbatimin e detyrave të Plenumit të 3-të të KQ të PPSH mbi revolucionin tekniko-shkencor, problemet që dalin dhe masat që duhet të merren».

Janë bërë shpjegime për këtë çështje. Këtu mund të na flitet, por edhe ne mund të themi që në Kombinatin e Tekstileve në Berat, fjala vjen, nuk po bëhet sa duhet në këtë drejtim dhe çështje për zgjidhje ka plot. Se çfarë ka planifikuar atje Komisioni i Planit të Shtetit, është tjetër punë, por të na thuhet a janë kuptuar mirë apo jo konceptet e revolucionit tekniko-shkencor, se Partia i ka shtruar me kohë këto probleme. Ne duhet të kuptojmë më parë, për shembull, se ç'është revizionizmi që të mund ta luftojmë me sukses. Që të mund të luftojmë armikun, duhet të kuptojmë dhe të përvetësojmë Artin Ushtarak të Luftës Popullore, ku përfshihen edhe teoria, edhe arma, pra këtë duhet të dimë që të korrin fitoren. Kështu ndodh edhe me revolucionin tekniko-shkencor.

Në Kryeministri kemi komision për problemin e revolucionit tekniko-shkencor? Unë di se është bërë një studim shumë i hollësishëm dhe shumë i rëndësishëm lidhur me rigjenerimin e pjesëve të ndërrimit, që të mos i importojmë nga jashtë, si dhe me përdorimin e mirë të automjeteve e të traktorëve për të reflektuar pastaj në kursimin e karburanteve e të lubrifikanteve. Çfarë keni bërë ju, shokë të Kryeministrit, me të? E keni marrë në studim dhe e keni detajuar? Kërkoj shpjegime të qarta për këtë çështje. A e keni organizuar mirë punën dhe cilat çështje keni gjetur të drejta e cilat jo? Keni thirrur, për shembull, shokë drejtues të Ministrisë së Bujqësisë dhe t'u shpjegoni që kjo është kështu, kjo tjetra ashtu dhe për të kemi marrë këto apo ato vendime?

Ju thoni se studimi që iu paraqit komisionit qeve-



ritar, iu dërgua bazës i shkurtuar. Shkurtimet kanë një kuptim, por, kur shkojnë në bazë, çështjet duhet të zgjerohen, të bëhen më të kuptueshme dhe jo të shkurtohen. Ato duhet të zërthehen, t'u shpjegohen masave që do t'i vënë në jetë.

A figuronte në plan vendimi që u mor në komisionin qeveritar për të vënë në jetë studimin? Domethënë a kishin reflektuar dikasteret për këtë çështje me rëndësi? Dalim me konkluzionin që ministritë e kanë marrë studimin thjesht si literaturë. Një vendim që ka dalë nga Qeveria, ka rëndësi të madhe dhe duhet të vihet në zbatim. Atëherë përse nuk është reflektuar më parë? Prandaj shikojeni një çikë këtë punë që nga fillimi. Kur merret në shqyrtim një çështje nga komisioni qeveritar, nuk do të thotë se u mor nga Qeveria, por kur kjo çështje shtrohet në Qeveri, atëherë vendoset prej saj dhe duhet të zbatohet deri në fund, por jo, si me thënë, «hajde e thuaj këtu pesë fjalë», por të merren masa që të organizohen ekipe dhe njerëzit të venë në qendra pune. Ja, pyes: duhen vënë në zbatim apo jo normat teknike? Si duhet të punojë tornoja? Kështu mund të flasim edhe për çështje të tjera. Por të kësaj natyre janë edhe çështjet që janë ngritur në studim, si dhe nga shokë të Ministrisë së Bujqësisë, pse në këtë sektor të ekonomisë nuk kemi të bëjmë me punë hekuri, por me problemin nëse rritet apo nuk rritet bima, zhvillohet apo ngordh kafsha. Prandaj, në qoftë se këto probleme nuk ngrihen si duhet që nga qendra e deri në bazë, nuk mund të zgjidhen drejt.

Sa figuron në planin e vitit 1978 rigjenerimi i aty-

re pjesëve që kanë të bëjnë me mekanizimet etj.? Të mos hallakatemi për këtë çështje, se, po u hallakatëm, nuk do të na ecë puna.

A është dhënë ndonjë direktivë që për vitin 1978 të planifikohet rigjenerimi tri herë i pjesëve të ndërrimit dhe a janë instruktuar njerëzit? Plani doli më përpara, po tani që ai u kthye, janë dhënë shpjegime për të? Këto çështje Partia i ka ngritur shumë herë. Prandaj, kështu siç na thuhet, që janë me mijëra e mijëra pjesë këmbimi, natyrisht kjo punë nuk realizohet dot as vitin tjetër. Por ne marrim parasysh se kemi një klasë punëtore të ngritur, kemi specialistë të aftë etj., etj., kemi edhe kohë që po i futemi këtij problemi, prandaj ta shohim si po organizohet kjo punë, sepse deri tani nuk ka qenë në nivelin që kërkohet.

Në Byronë Politike është diskutuar disa herë për punën me norma, por, në qoftë se nuk gabohem, 56 për qind të punëtorëve punojnë akoma pa norma, pa lëri normat teknike. Për normat teknike është folur me kohë që të zbatohen dhe këtu u drejtohem të gjitha dikastereve, gjithë Partisë, që vendimet që marrim, të cilat janë jetike për vendin, të kuptohen si duhet nga të gjithë, të zbatohen drejt e në kohë dhe të kontrollohet zbatimi i tyre.

Unë kam këtë këshillë: komisionet për problemin e revolucionit tekniko-shkencor janë krijuar dhe janë të nevojshme, por ato duhet të konsiderohen si ndihmëse kryesore dhe të mos ngrihen vetëm sa për të dhënë mendime, sepse mendime jepen në komision, po jepen edhe në konferenca e kudo, por në mbledhjet që bën komisioni përcaktohen detyra konkrete, të cilat

duhet t'i marrë në shqyrtim kolegjiun e ministrisë ose Qeveria vetë, kur kemi të bëjmë me një komision qeveritar. Kështu një e nga një çështjet duhen detajuar dhe të çohen atje ku duhet, ndryshe, ata që marrin pjesë në komision, do të mblidhen, do të japin mendime, do të bëjnë edhe propozime, por pastaj do të bisedojnë me njëri-tjetrin që «kemi folur shumë herë për këto apo për ato probleme, por s'po bëhet gjë» dhe ata kanë të drejtë të pyesin se përse ndodh kështu. Unë nuk them se nuk punohet, sepse bëhen shumë gjëra të mëdha dhe njerëzit tanë janë për t'u lavdëruar për to, por ka gjëra që, nga një organizim jo i shëndoshë, nga një diletantizëm në drejtim, krijojnë një gjendje jo të kënaqshme. Kuadrot tanë kanë aftësi dhe ne duhet të kemi konsideratë të madhe për ta, pse, në qoftë se nuk vlerësohen mendimet dhe puna e tyre, ata mund të bëhen inaktivë.

Për përgatitjen e materialit që është paraqitur këtu, janë mbledhur shokë të sektorëve të ndryshëm në Komisionin e Planit të Shtetit dhe kanë dhënë mendimet e tyre për këtë problem. Mirëpo këto mendime nuk janë mbajtur parasysh, prandaj na ka dalë një material si ky që është i dobët për mendimin tim. Jo 15 faqe, por edhe sikur 100 faqe të ishte ky material, ne do ta studionim, por jo të na vijë këtu një material ujë. Në sekretarët e Komitetit Qendror këtu në aparat bisedojmë me njëri-tjetrin. Shokët mund të më thonë mua që na ka ardhur një material, të cilin ne e studiuam, është një çikë i gjatë, por na jep me të vërtetë një pasqyrë të qartë se çfarë po bëjmë ne me revolucionin tekniko-shkencor, ku gjendemi, dhe atëherë marrim një

vendim jashtë vendimit që kemi marrë më parë që në përgjithësi raportet duhet të mos na vijnë me më shumë se 5 faqe, për arsye se ky është një problem i madh.

*Pasi u dhanë shpjegime për pyetjet e bëra dhe për çështjet e ngritura në mbledhje, në përfundim të diskutimeve e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Kam përshtypjen se shoqja Themije [Thomai] dhe shoku Fehmi Shehu<sup>1</sup> e kanë kuptuar mirë ç'është revolucionin tekniko-shkencor, në teori dhe në praktikë. Mendoj se vepruan mirë këta shokë që nuk na bënë teori këtu. Sidoqoftë, ato që shtruan, janë edhe teori, edhe praktikë. Që ka të meta në këtë çështje, dihet, prandaj problemet duhen kapur më mirë e të ndiqen si duhet.

Përpara se ta mbyllim diskutimin, dëshiroj të them edhe unë disa fjalë për revolucionin tekniko-shkencor.

Raporti i paraqitur nga Komisioni i Planit të Shtetit për zbatimin e detyrave të Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror të Partisë lidhur me revolucionin tekniko-shkencor, më duket se paraqet një tablo të cekët të asaj pune të madhe që është bërë e bëhet në këtë drejtim në vendin tonë nga klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjencia popullore, nën udhëheqjen e Partisë. Ky raport është një rreshtim i thjeshtë e naiv i disa të dhënave të zhvillimit të përgjithshëm, që mund të thuhet sot, mot dhe për shumë vjet, por jo të zhvillimit e të thellimit të revolucionit tekniko-shkencor. Prandaj ai tregon se problemi jo vetëm nuk është ndjekur si duhet nga Komisioni i Planit të

---

1. Në atë kohë dekan i Fakultetit të Inxhinierisë të Universitetit të Tiranës.

Shtetit, por shkruesit e këtij raporti s'kanë treguar as kujdesin më të vogël për ta thelluar atë, jo në gjerësi, por as edhe vetëm në disa drejtime kryesore.

Ndjekja e zhvillimit të shkencës e të teknikës nuk është detyrë vetëm e Komisionit të Planit të Shtetit. Me çështjet e ndjekjes së zhvillimit teorik të shkencës e të zbatimit të saj në jetë merren e duhet të merren Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, Akademia e Shkencave, sektorët përkatës në Kryeministri dhe në aparatet e Komitetit Qendror të Partisë e të tjerë. Se si shkon veçanërisht zbatimi i kësaj teorie dhe i teknikës në praktikë për fushat që mbulojnë, duhet t'i ndjekin e të përgjigjen Ministria e Industrisë dhe e Minierave, Ministria e Bujqësisë, e Ndërtimit, e Komunikacionit dhe dikasteret e tjera. Zhvillimi i revolucionit tekniko-shkencor nuk ndiqet me seriozitet nga ana e këtyre dikastereve; detyrat e shtruara nga Kongresi i 7-të i Partisë në këtë fushë duhet të kuptohen e të zbatohen më thellë, në teori e në praktikë.

S'mund të them të njëjtën gjë për projektvendimin e paraqitur, i cili, megjithëse duhet ripunuar e plotësuar, është më serioz, vihen detyra që në raport nuk përmenden fare ose u shkohet shkarazi.

Që kemi një industri të fuqishme mekanike, të naftës, minerare dhe degë të tjera ku zbatohen disa metoda komplekse, siç përmenden në mënyrë të përgjithshme në raport, këto i dimë. Dimë, gjithashtu, që njerëzit tanë të shkencës e të teknikës, punëtorët, kooperativistët e kuadrot, nuk rrinë duarlidhur, përkundrazi, kanë bërë përparime të mëdha, gjë për të cilën flet tërë zhvillimi ynë dinamik e i pandalshëm përpara.

Por pikërisht këtë nuk e gjejmë në raport, jo që nga koha e Çlirimit, por as gjatë këtyre dhjetë vjetëve, që nga koha e Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror<sup>1</sup>, kur problemi u shtrua më me forcë dhe në një kuadër shumë më të gjerë, në përputhje me stadin e arritur dhe me detyrat që na viheshin përpara.

Pse në raport nuk u përgjigjemi disa objektivave e detyrave konkrete që vuri Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror, si bie fjala: deri në çfarë shkalle kemi arritur të përdorim bazën tonë materialo-teknike e pasuritë minerare dhe çfarë duhet të bëjë revolucioni tekniko-shkencor në këtë fushë? Ku jemi me përqendrimin, specializimin e kooperimin jo vetëm në industrinë mekanike, por në tërësi, çfarë duhet të bëjmë më tutje? Çfarë bëhet për studimin e teorisë dhe të praktikës së prodhimit nga masat e gjera punonjëse, për aftësimin profesional të tyre dhe për përgjithësimin e tërë asaj përvoje të pasur që po krijohet nga njerëzit tanë duar-artë në ndërtimin e veprave të mëdha e komplekse që po ngremë? Cila është puna që bëhet për tërheqjen e masave në revolucionin tekniko-shkencor, ç'vend zë tani eksperimentimi shkencor masiv dhe probleme të tjera shumë të rëndësishme që shtroi Plenumi? Krahas këtyre në raport të ngriheshin problemet e reja që na dalin përpara, pengesat e vështirësitë që hasen, çfarë masash janë marrë e duhet të merren nga Partia e Qeveria.

Ne jemi kundër globalizmit në planifikim, por edhe kundër raportimeve të tilla, qofshin këto në Byro-

---

1. Ky Plenum i zhvilloi punimet më 13-14 tetor 1967.

në Politike të Komitetit Qendror, në Sekretariat, në Qeveri e kudo.

Ashtu siç ka konstatuar vazhdimisht Partia, revolucionin tekniko-shkencor të ne zhvillohet në rrugë të drejtë, ai udhëhiqet kurdoherë nga politika dhe nga ideologjia e Partisë, por kjo gjë në raport nuk jepet.

Direktivat e saj për revolucionin tekniko-shkencor, duke u përvetësuar nga masat, tanimë janë bërë pjesë e ndërgjegjes së tyre dhe i kanë hedhur ato në një lëvizje masive me një rol të kontribut të pazëvendësueshëm për zhvillimin e forcave prodhuese, për fuqizimin e bazës materialo-teknike dhe për ndërtimin tonë socialist. Kjo flet qartë për drejtësinë e vijës e të politikës që ka ndjekur dhe ndjek Partia, si në çdo fushë, edhe për zhvillimin e thellimin e revolucionit tekniko-shkencor.

Është vija e drejtë e Partisë dhe udhëheqja e saj e pandarë, është rendi ynë ekonomik-shoqëror, që i kanë çelur rrugë të gjera zhvillimi edhe revolucionit tekniko-shkencor dhe jo anasjelltas, ashtu siç propagandojnë e spekulojnë ideologët borgjezë e revizionistë, që përpiqen të shfrytëzojnë çdo zhvillim dhe rezultat të shkencës e të teknikës për të zëvendësuar revolucionin social me revolucionin tekniko-shkencor dhe lloj-lloj falsifikimesh të tjera reaksionare.

Me përvojën e ndërtimit socialist, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, si i vetmi shtet i diktaturës së proletariatit që ndërton socializmin, vërteton njëkohësisht se parimet e marksizëm-leninizmit janë kurdoherë të drejta, se ato nuk e humbasin asnjëherë forcën e tyre kur zbatohen me këmbëngulje e në baza shkencore. Revolucionin tekniko-shkencor, si pjesë për-

bërëse e revolucionit tonë socialist, duke ndihmuar përzhvillimin e përparimin e mjeteve të prodhimit, si dhe në fusha të tjera të zhvillimit tonë ekonomik-shoqëror, vërteton e duhet të vërtetojë, gjithashtu, vendin dhe rolin e tij të madh në zhvillimin e mbrojtjen e socializmit shkencor.

Prandaj aktualisht del nevoja që t'u kthehemi e t'u rikthehemi mësimeve të klasikëve tanë të mëdhenj, të Partisë sonë, të Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror dhe të Kongresit të 7-të të Partisë për këtë problem, për t'i përvetësuar ato sa më thellë, sepse këto mësime janë e duhet të bëhen akoma më shumë në të ardhmen armë të fuqishme në duart tona. Në të njëjtën kohë të nxjerrim konkluzione e detyra konkrete në përputhje me objektivat që duhet të arrijmë aktualisht e në perspektivë dhe t'i ndjekim, t'i kontrollojmë e t'i zbatojmë ato ashtu si duhet.

Krahas kësaj, jeta dhe zhvillimi ynë revolucionar aktualisht kanë nxjerrë edhe një varg problemesh që kërkojnë një kuptim më të thellë të përmbajtjes së revolucionit tekniko-shkencor, caktimin e detyrave e të objektivave më të saktë që duhet të arrijë zhvillimi i këtij revolucioni në degë e sektorë të ndryshëm të ekonomisë, mobilizimin më të madh të forcave e të energjive krijuese të punonjësve tanë për shfrytëzimin më të mirë të bazës së fuqishme materialo-teknike ekzistuese dhe përparimin e saj të mëtejshëm.

Revolucioni tekniko-shkencor në vendin tonë ka për qëllim transformimin e mjeteve të prodhimit, zhvillimin dhe përparimin e tyre, por nuk është vetëm ky qëllim. Këtu kemi të bëjmë me një kompleks të fakto-



rëve evolutivë, që varen nga njëri-tjetri, që janë njëkohësisht shkencorë, teknologjikë, teknikë shoqërorë dhe njerëzorë.

Në bazë të zhvillimit të shkencës, të teorisë, del diçka e re që i imponon ndryshime një teorie ose një praktike të mëparshme. Kështu ndërtimi i socializmit në vendin tonë shtron përpara nesh shumë çështje, për shembull, shfrytëzimin e energjisë e të lëndëve të para për prodhim makinerish e pajisjesh, zbatimin e një teknologjie të re dhe të metodave e proceseve të ndryshme më të përparuara. Të gjitha këto çështje ne duhet t'i njohim e t'i mësojmë, pse ato kanë zhvillimin e tyre shkencor. Ato kanë për objektiv të rregullojnë në mënyrë shkencore prodhimin, ta bëjnë këtë gjithnjë e më modern. Pikërisht revolucioni tekniko-shkencor na mëson të tilla metoda veprimi, të nevojshme për të prodhuar ato sende e produkte me të cilat plotësohen nevojat që kanë te ne shoqëria dhe shteti. Këto nevoja të zhvillimit të teknikës e të prodhimit lindin edhe detyra e probleme të reja për shkencën, të cilat nxitin zhvillimin e mëtejshëm të mendimit shkencor. Kjo bëhet akoma më e qartë në kohën e sotme, kur zhvillimi i një sërë degësh të teknikës e të prodhimit kërkon kryerjen e kërkimeve dhe të eksperimentimeve jo në një shkencë të caktuar, por në disa degë të shkencave, të lidhura e në bashkëveprim midis tyre. Në këtë mënyrë shkenca ushtron një ndikim të madh në përsosjen dhe në zhvillimin e teknikës e të prodhimit. Në themel të përparimit teknik qëndrojnë rezultatet e shkencës, të kërkimit e të eksperimentimit shkencor masiv. Lidhur me këtë K. Marksi ka theksuar se

*«...mjeti i punës merr një formë ekzistence materiale, e cila kërkon që forca e njeriut të zëvendësohet me forca të natyrës dhe rutina empirike — me zbatimin e vetëdijshëm të shkencave të natyrës»<sup>1</sup>.*

Prodhimi, nga ana e vet, i jep shkencës një material të pasur e të shumanshëm eksperimental, pa përmendur këtu atë që ai u siguron shkencave të ndryshme bazën e nevojshme materialo-teknike. Në këtë kuptim zhvillimi i prodhimit dhe i teknikës çon përpara edhe zhvillimin e mendimit shkencor. Këtu kemi të bëjmë, pra, me veprimin reciprok të shkencës e të kërkimit shkencor, me zhvillimin e teknikës e të prodhimit.

Këtu duhet të kuptohet mirë edhe roli i teknikës në përgjithësi dhe i teknikës së prodhimit në veçanti. Lenini na mëson se

*«...përparimi i teknikës shprehet pikërisht në faktin se puna e njeriut ia lëshon vendin gjithnjë më shumë punës së makinave»<sup>2</sup>.*

Kjo është thënë në një kuptim të gjerë dhe që teknika të arrijë qëllimet e caktuara, ka një pamje materiale kryesore, një ndërtim e një mënyrë të caktuar drejtimi e veprimi. Prandaj, për ta krijuar e për ta përdorur atë si duhet, kërkohet mjeshtëri, duhet të fi-

1. K. Marks, «Kapitali», vëll. I, libri 2, f. 104.

2. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 1, f. 84.

tosh eksperiencën edhe të prodhuesit të izoluar, edhe të prodhuesit kolektiv.

Duhet të kuptohet se çdo sektor ka teknikën e vet. Në bujqësi kjo teknikë është e ndryshme nga ajo e fabrikimit të mekanizmave bujqësorë, e nxjerrjes dhe e përpunimit të mineraleve etj. Në kuptimin e përgjithshëm teknika konsiderohet si një totalitet, por ekziston, gjithashtu, edhe shkenca, që edhe kjo është një totalitet. Si teknika, edhe shkenca, që në përgjithësi duken si entitete të veçanta, janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën.

Teknika zhvillohet gjatë prodhimit në funksion të zhvillimit të forcave prodhuese dhe është pikërisht niveli që arrin kjo forcë zhvilluese ai që përcakton edhe shkallën e procesit të përparimit të teknikës. Novatorët e racionalizatorët e vendit tonë janë ata njerëz që çojnë përpara teknikën. Këta vrasin mendjen dhe adaptojnë ose krijojnë metoda, forma dhe mjete pune gjithnjë më të përparuara, për ta çuar më përpara zhvillimin e prodhimit. Një punë e tillë e tyre nuk është vetëm materiale, teknike, por është, në të njëjtën kohë, edhe shkencore, prandaj lind nevoja që, njëkohësisht, njerëzit tanë të edukohen me praktikën dhe me shkencën dhe këtë shkencë ta zbatojnë në praktikë për zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese.

Të zhvillosh forcat prodhuese do të thotë të transformosh, për shembull, industrinë, bujqësinë, duke i kthyer nga një stad i prapambetur në një stad shumë të evoluar, të krijosh me mjete më moderne makineri dhe fabrika moderne. Në raport flitet që ne do të krijojmë fabrika e pajisje të reja e komplete dhe kjo është

e vërtetë, por, që t'i krijojmë këto, problemin e novatorizmit dhe të zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor nuk duhet ta konsiderojmë si një çështje fushate, si diçka për të marrë tituj ose flamurë. Kjo është çështje e një edukate të vazhdueshme, të përditshme, progresive në zhvillimin e intelektit dhe në zgjerimin e pasurimit e pandërprerë të praktikës, duke zbatuar shkencën me mjete moderne, të cilat ne duhet t'i ndërtojmë vetë dhe të bëjmë me to transformime të thella e të mëtejshme të mjeteve të prodhimit që disponojmë. Shkenca dhe teknika në vendin tonë socialist janë ndihmëse të domosdoshme dhe të nevojshme për një-rëzit në luftën për të zotëruar natyrën.

Revolucioni tekniko-shkencor në vendin tonë socialist nuk synon çfarëdolloj zhvillimi të elementeve materiale të forcave prodhuese, të shkencës dhe të teknikës, por një zhvillim të tillë që të përputhet me ideologjinë dhe me interesat e klasës punëtore, me zhvillimin dhe përsosjen në rrugë revolucionare të marrëdhënieve socialiste në prodhim. Mbështetja fuqimisht në filozofinë marksiste, duke e përvetësuar e duke e zbatuar atë kurdoherë me konsekuencë, ka qënë dhe mbetet një kusht i domosdoshëm për zhvillimin në rrugë të drejtë të shkencës e të teknikës.

*«Le të thonë ç'të duan shkencëtarët, — theksonte Engelsi, — mbi ta sundon filozofia. Çështja është vetëm nëse duan ata që mbi ta të sundojë ndonjë filozofi e keqe e modës apo duan të udhëhiqen nga një formë e tillë e me-*

*ndimit teorik, e cila mbështetet në njohjen e historisë së mendimit dhe të sukseseve të saj*<sup>1</sup>.

Partia dhe njerëzit tanë ndërmarrin një aksion, një studim shkencor ose një iniciativë në këtë fushë, e shikojnë dhe e analizojnë problemin jo thjesht nga fitimi, nga leverdia e ngushtë dhe nga interesat e çastit, siç veprojnë kapitalistët e revizionistët, por e analizojnë atë nga të gjitha anët: si ndihmon ai për zhvillimin e vendit në rrugën e socializmit, për forcimin e fuqisë mbrojtëse, për shpejtimin e ritmeve të zhvillimit, për ngushtimin e dallimeve midis punës fizike e mendore, midis fshatit e qytetit etj. A nuk flasin qartë për këtë aksionin i madh i elektrifikimit të të gjithë vendit, iniciativat e studimet që kryhen dhe masat që merren për vënien në jetë të kursit të Partisë për industrializimin socialist, duke i dhënë prioritet industrisë së rëndë, masat e forta që merren për rritjen e shkallës së sigurimit teknik e të mbrojtjes në punë të punonjësve në veprat ekzistuese dhe në ato që ngrihen rishtas, pavarësisht nga kushtimi i tyre etj.?

I theksova këto sepse shikoj që në praktikë disa herë revolucionin tekniko-shkencor e konceptojnë ngushtë ose vetëm për disa degë e sektorë, sikur ai ka të bëjë kryesisht me industrinë mekanike, atë kimike, me disa probleme të bujqësisë apo me ndonjë anë të prodhimit e të zhvillimit të forcave prodhuese, pa përmendur ato raste kur me arritjen e disa rezultateve revolucionin tekniko-shkencor konsiderohet se u krye.

---

1. F. Engels, «Dialektika e natyrës», f. 242.

Kuptimi i thellë i çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e me thellimin e revolucionit tekniko-shkencor merr një rëndësi të veçantë në stadin aktual të zhvillimit tonë ekonomiko-shoqëror dhe në kushtet e rrethimit të egër imperialisto-revizionist, në të cilat ne punojmë e luftojmë për ndërtimin e mbrojtjen e socializmit. Tani kudo kërkohet një ngritje e re më e fuqishme e masave të gjera punonjëse për ta zhvilluar e për ta çuar më përpara revolucionin tekniko-shkencor. Ashtu siç theksoi Kongresi i 7-të i Partisë, studimet e kërkimet tekniko-shkencore, dhe përgjithësisht revolucionin tekniko-shkencor, duhet të përshtojnë çdo punë, të ndihmojnë fuqimisht jo vetëm për probleme të veçanta e në disa degë, por në të gjitha fushat e problemet e prodhimit dhe të zotërimit të natyrës. duke u udhëhequr kurdoherë nga politika dhe nga ideologjia e Partisë.

Pa objektiva të qartë nuk mund të arrihen rezultatet që priten nga zhvillimi i revolucionit në teknikë dhe në shkencë. Ku i gjen dhe ku duhet t'i gjejë këta objektiva revolucionin tekniko-shkencor? Ata gjenden të sintetizuar në vijën e përgjithshme të Partisë për ndërtimin e socializmit, në politikën ekonomike dhe në planet korrente e perspektive të zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit. Duke u bazuar në to, caktohen edhe objektivat për detyrat aktuale dhe perspektive që duhet të realizojë ky revolucion.

Kongresi i 7-të i Partisë ka dhënë një program të madh dhe ka çelur horizonte shumë të gjera e të sigurta për zhvillimin e vendit tonë në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Në planin e gjashtë pesë-

vjeçar që aprovoi Kongresi, pasqyrohen detyrat konkrete për vënien në jetë të politikës së Partisë për zhvillimin ekonomik e kulturor. Prandaj edhe objektivat e detyrat aktuale të revolucionit tekniko-shkencor në çdo degë dhe sektor të ekonomisë e të kulturës burojnë e duhet të burojnë nga lufta dhe nga synimi për zbatimin plotësisht të direktivave të Kongresit të 7-të të Partisë dhe të detyrave të planit të gjashtë pesëvjeçar.

Krahas kujdesit për zgjidhjen e detyrave që ndihmojnë për zbatimin e planit pesëvjeçar, të cilat aktualisht duhet të kenë prioritet, vëmendje të veçantë kërkojnë problemet e së ardhmes. Perspektiva jonë është ndërtimi i plotë i socializmit dhe i komunizmit. Prandaj revolucionit tekniko-shkencor nuk mund të mos mbajë parasysh e të mos ndihmojë zgjidhjen e problemeve që kemi përpara në rrugën ku e ka futur popullin tonë dhe po e udhëheq me vendosmëri Partia, ndryshe ai nuk ia arrin qëllimit, nuk u shërben interesave të klasës punëtore e të revolucionit. Prandaj në zhvillimin dhe në thellimin e revolucionit tekniko-shkencor shtrohet domosdoshmëria që detyrat aktuale me ato të perspektivës të shikohen të lidhura ngushtë organikisht.

Në kuadrin e këtyre detyrave është e nevojshme që jo vetëm të mbahen kurdoherë parasysh tërë drejtimet që përfshijnë zhvillimi e thellimi i revolucionit tekniko-shkencor, siç janë problemet e elektrifikimit të prodhimit, të mekanizimit e të automatizimit, të kimizimit e të zbatimit të proceseve të reja teknologjike ose problemet e organizimit shoqëror të punës e të prodhimit, që kanë të bëjnë me përqendrimin, specializimin e kooperimin, problemet e eksperimentimit shkencor ma-

siv: e drejtime të tjera, por edhe të konceptohen ato shkencërisht e në tërë gjerësinë e tyre, në përputhje me stadin aktual të zhvillimit tonë ekonomik-shoqëror dhe me veçoritë, kushtet e rrethanat në të cilat ne punojmë e luftojmë për ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit.

Themelore është që në kuptimin dhe në zbatimin e revolucionit tekniko-shkencor të mbahet kurdoherë parasysh parimi i madh marksist-leninist i mbështetjes në forcat e veta. Ky parim, që është një domosdoshmëri imperative, edhe në këtë fushë kërkon që ne të përballojmë vetë zgjidhjen e problemeve të mëdha e të ndërlikuara, duke zbatuar në mënyrë krijuese ligjet e përgjithshme tekniko-shkencore në përputhje me veçoritë tona shoqërore, gjeografike dhe klimatike, me pjesën më të madhe të terrenit të thyer e malor, me poliminerale, që kanë ligjësitë e tyre të sktrirjes, që shpesh ndryshojnë nga ato të vendeve të tjera.

Duke e trajtuar kështu çështjen, ngushtimi që u bëhet problemeve të trajtuara në raportin e paraqitur, tregon se ende nuk është kapërcyer ai koncept i ngushtë i prodhimit të vogël e artizanal që ka ekzistuar në të kaluarën te ne, por që tash është zëvendësuar përgjithësisht me një prodhim të madh dhe gjithnjë e më modern. E theksoj këtë, sepse, po nuk u kapërcyen këto koncepte, nuk do t'i hapet fushë e gjerë veprimi edhe revolucionit tekniko-shkencor. Tani kur në prodhimin tonë flitet me shifra relativisht të mëdha, kur janë agritur degë të reja e komplekse, kur baza materialo-teknike është fuqizuar mjaft, edhe konceptet tona duhet të zgjerohen, edhe shkenca e teknika duhet të gjej-



në një zbatim më të gjerë, edhe pretendimet e kërkesat ndaj vetes duhet të jenë më të mëdha.

Po përpiqem ta konkretizoj këtë që thashë. Lenini, duke bërë fjalë për rëndësinë e ligjit të rritjes me prioritet të mjeteve të prodhimit në krahasim me sendet e konsumit, thekson, ndërmjet të tjerash, se

*«Gjithë kuptimi dhe rëndësia e këtij ligji të rritjes me të shpejtë të mjeteve të prodhimit është vetëm e vetëm se zëvendësimi i punës së dorës me punën e makinave — përgjithësisht përparimi i teknikës në industrinë që punon me macina — kërkon një zhvillim të madh të degëve që nxjerrin qymyrguri dhe hekur, këto «mjete» të vërteta «të prodhimit për mjetet e prodhimit»»<sup>1</sup>.*

Pse e ilustrua me këtë citat? Sepse vetë Lenini na këshillon që të përdorim citate të klasikëve dhe vetë ai përdorte pjesë të gjera nga vepra të Marksit dhe të Engelsit, për të bërë të mundshëm kuptimin më të thellë e më të shpejtë të problemeve. Në shumë raste Lenini jep nga një gjysmë, deri edhe një faqe të tërë, citate të Marksit. Prandaj, kur duam të shpjegojmë diçka, të përpiqemi të gjejmë idenë bazë orientuese, duke u mbështetur te klasikët tanë të mëdhenj: Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Te këta duhet ta gjejmë ne farin për t'u orientuar për çdo problem, pse udhëheqësit tanë të mëdhenj janë një botë e tërë pa kufi; në di-

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 1, f. 107.

turinë e tyre gjen çdo gjë, ajo është shumë e gjerë.

Partia ka punuar dhe vazhdon të punojë me perspektivë që nga fillimi i industrializimit socialist të vendit tonë. Kjo ligjësi te ne është bërë një realitet i gjallë. Po si mund të pajtohemi me faktin që në miniera afro 52 për qind e proceseve të punës kryhen me dorë, në shfrytëzimin pyjor afro 63 për qind, në mjaft ndërmarrje të lejohen «vende të ngushta», në bujqësi të vazhdojë kontradikta midis fuqisë tërheqëse motorike që është e avancuar, dhe prapambetjes së makinave e agregateve të punës e të kryerjes së proceseve të ndryshme në bujqësi? Në raport flitet për shfrytëzimin e aftësive prodhuese ekzistuese dhe të atyre të reja, por nuk thuhet që me një pjesë të mirë të makinave metalprerëse, të destinuara dhe të afta për të nxjerrë një prodhim të madh e me një cilësi të veçantë, ne ende vazhdojmë të prodhojmë edhe gjëra nga më të rëndomtë. Sipas konceptit të vjetër e artizanal koha e punës e këtyre makinave «është shfrytëzuar», por ky është një shfrytëzim jo shumë efektiv, jemi akoma larg një shfrytëzimi të tillë.

Është një sukses i rëndësishëm i Industrisë sonë mekanike që në këta 10 vjetët e fundit prodhimi i makinave dhe i pjesëve të ndërrimit është rritur përkatësisht afro 10 dhe 5 herë kundrejt 2,6 herë që është rritur prodhimi i përgjithshëm industrial. Industria mekanike duhet të vazhdojë të realizojë objektivat e caktuar nga Kongresi i 7-të i Partisë, që të sigurojë në vend 95 për qind të pjesëve të ndërrimit, të mbajë në këmbë bazën industriale e prodhuese që kemi dhe të prodhojë mekanizma e pajisje komplete. Megjithatë

fakti që në totalin e prodhimit të mjeteve të prodhimit në vendin tonë është akoma e vogël pesha specifike e prodhimit të mjeteve të punës, e cila shkon nga 13 për qind, që ishte në vitin 1975, në 15 për qind në vitin 1980, shtron nevojën që baza jonë mekanike të përdoret në mënyrë më efektive dhe të futet më gjerësisht në prodhimin me forcat e veta të fabrikave, linjave e uzinave të nevojshme.

Por duke theksuar këtë, më duket se nuk është i drejtë qëndrimi që mbahet disa herë në praktikë kur nënvleftësohet mekanizimi i vogël i punës e i prodhimit në industri apo në bujqësi, në ndërtim apo në shërbimet ndaj popullatës. Kjo jo vetëm që e bën më të rëndë punën e punëtorit e të kooperativistit, ka rendiment të ulët e kosto të lartë, por edhe angazhon shumë forca njerëzore aktive, të cilat mund dhe duhet të përdoren më me efektivitet dhe atje ku ato mungojnë.

Me kushtet e reja të krijuara, kur ne po i prodhojmë vetë çelikun, lëndët e para (bazë) kimike, kur kemi aftësi të pangarkuara plotësisht në industrinë mekanike e, mbi të gjitha, kur kemi edhe kuadro me përgatitje e përvojë të mirë, kjo detyrë mund dhe duhet të bëhet një realitet i vërtetë.

Arritja me sukses e këtyre objektivave do të bëjë që ekonomia jonë të jetë më e pavarur nga jashtë, të zhvillohet pa u ndalur. Prandaj për organet e organizatat e Partisë dhe levat e tyre, veçanërisht për organet shtetërore dhe ekonomike në bazë e në qendër, mbetet detyrë të kapen mbas disa hallkave më konkrete në fushën e organizimit të punës për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor, në atë të studimeve e të eksperi-

mentimeve shkencore dhe në fushën e ndërmarrjes së aksioneve konkrete.

Në qoftë se industria mekanike i ka më të qartë objektivat e revolucionit tekniko-shkencor, më duket se për degët e tjera të industrisë, si ato të energjetikës, të minierave, të naftës, të kimitës, të industrisë së lehtë e ushqimore etj., duhet të studiohen, të nxirren e të përcaktohen më konkretisht objektivat e këtij revolucioni në fushat e tyre, për të zgjidhur problemet e mërehta teknike, teknologjike, ekonomike, shkencore, që do të ndihmonin për të zbuluar dhe për të nxjerrë më shumë naftë, mineral kromi e bakri, hekur-nikel, qymyrguri dhe minerale të tjera, aq shumë të nevojshme për ekonominë tonë, për të prodhuar më shumë mallra të konsumit të gjerë, me cilësi më të mirë dhe me kosto më të ulët.

Një front mjaft i rëndësishëm në stadin aktual të zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor në vendin tonë është aplikimi i teknologjive të reja, i proceseve kimike e i metodave më efektive në ndërtim, si dhe përvetësimi i proceseve teknologjike të veprave të reja. Teknika dhe teknologjia janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Kur ato shkojnë paralel, arrihen rezultate mjaft pozitive. Teknologjia është një dije relative mbi mjetet që shërbëjnë për realizimin e shumë detyrave që i caktohen veprimtarisë prodhuese ekonomike. Ajo është një tërësi metodash e procesesh që përdoren në përpunimin e lëndëve të para e të materialeve të ndryshme gjatë procesit të prodhimit. Pa u futur gjërisht në ndryshimin e në përmirësimin e teknologjive

të prodhimit, nuk mund të arrihen ato ndryshime progresive që presim.

Futja, gjithashtu, e metodave dhe e proceseve kimike në degë të ndryshme të prodhimit tonë socialist hap perspektiva reale për zhvillimin e degëve të ndryshme të prodhimit, bën të mundur të zgjerohet baza e lëndëve të para të industrisë, sepse në sferën e prodhimit futen mjaft lëndë të para e materiale që më parë nuk përdreshin, të cilat përbëjnë rezerva kolosale të pashfrytëzuara në prodhim. Karl Marksi e vlerësonte lart industrinë kimike, e cila i shfrytëzon mbeturinat e prodhimit dhe, në përputhje me këtë, zgjeron bazën e lëndëve të para të industrisë. Ai shkruante se industria kimike është shembulli më i shkëlqyer i përdorimit «të mbeturinave» të prodhimit.

*«Ajo nuk konsumon vetëm mbeturinat e veta, duke gjetur mënyra të reja për t'i futur në punë, por edhe mbeturinat e degëve më të ndryshme të industrisë dhe e shndërron, për shembull, katranin e qymyrgurit, që më parë ishte pothuajse krejt i padobishëm, në ngjyra aniline, në alizarinë, kurse kohët e fundit edhe në medikamente»<sup>1</sup>.*

Një konceptim më të gjerë dhe luftë më të organizuar kërkon kapërcimi i fazës artizanale edhe në fushën e organizimit të punës e të prodhimit. Kjo çështje përbën sot një nga rezervat e mëdha për shtimin e pro-

1. K. Marks, «Kapitali», vëll. III, libri 1, f. 134.

dhimit e të rendimentit të punës. Kryerja e studimeve dhe marrja e masave konkrete në këtë fushë është me mjaft efekt dhe me pak shpenzime. Mirëpo, siç shohim nga praktika, kjo fushë shpeshherë lihet jashtë sferës së revolucionit tekniko-shkencor. Mund të kesh makineri nga më modernet, por në qoftë se puna vazhdon të organizohet në mënyrë artizanale dhe jo në seri ose në linjë zinxhir, atëherë përsëri faza artizanale e prodhimit nuk është kapërcyer plotësisht. Dihet se format e organizimit të punës e të prodhimit objektivisht burojnë dhe janë të lidhura ngushtë me rendin ekonomiko-shoqëror dhe me vetë procesin teknik e teknologjik. Ndryshimet në teknikë e në teknologji kërkojnë ndryshimin e përsosjen e formave të organizimit të punës e të prodhimit.

Nuk ka kuptim që në një fabrikë ose repart të vihet në një vend pune dhe për një operacion të caktuar një makinë ose linjë moderne, pra, dhe me prodhimtari të lartë, kur kjo nuk shoqërohet me organizimin e ri të punës, me nivelin dhe kulturën e prodhimit, me aftësitë e hallkave të tjera, sepse, në këto kushte, këto hallka bëhen «vend i ngushtë» me tërë anomalitë që rrjedhin nga kjo. Po i jap vetëm sa për shembull: Ditët e fundit, kur u ridiskutua plani i vitit 1978 në fabrikën e filaturës së tekstileve të holla (të leshta) në kombinatin e tekstileve «Stalin», rezultoi se në dhjetëra makina, ku punohet për kthimin e fjongove në fill, ngaqë ndërrohen shpesh llojet e fillit dhe të ngjyrës, ndalesa e makinerive arrin në 20-30 për qind të kohës së punës, nga më pak se 10 për qind që e ka projekti. Po që se krijohet njëfarë rezerve në llojet e fijeve që

kërkohen dhe do të punohet me parti më të mëdha (e jo 5-ditore), këto ndalesa pakësohen mjaft dhe rendimenti, vetëm nga ndryshimi i organizimit të punës, mund të rritet 10-15 për qind.

Kështu ndodh me humbjet e kohës në shumë makineri metalprerëse. Afro 100 ofiçina e baza riparimi kanë nga 1-3 torno, sepse ndërrimi i shpeshtë i detaleve kërkon edhe gradime të reja të makinave. Pa bërë disa përqendrime e riorganizime të punës e të prodhimit në to, nuk do të mund të bëhet një shfrytëzim efektiv. Edhe në mjaft ndërmarrje të ngritura me forcat tona ky mbetet një problem i madh.

Natyrisht zbatimi i prodhimit në seri ose në linja zinxhir te ne duhet të marrë mirë parasysh faktin se nevojat për disa produkte plotësohen shpejt, prandaj seritë duhet të jenë të vogla ose të mesme dhe të manovrueshme, përndryshe vetëm nga kjo dobësi dhe nga kjo mungesë krijohen mallra e produkte stoqe dhe humbasin vlera të mëdha pune e materiale, siç ndodh sot në disa raste. Vihet re jo rrallë që disa nga njerëzit tanë janë shumë konservatorë për të bërë ndryshime përnjëherë, kur e do nevoja, dhe vazhdojnë të prodhojnë në seri e të na mbushin depot me mallra që nuk tërhiqen. Këto qëndrime janë me pasoja të rënda. Për kapërcimin e metodave artizanale kërkohet, gjithashtu, çuarja më përpara e standardizimit, e unifikimit në seri të shumë produkteve e pjesëve të ndërrimit në industrinë mekanike, në atë të gomë-plastikës, të veshmbathjes, të pjesëve të parafabrikuara në industrinë e material ndërtimit etj.

Kapërcimi i fazës artizanale në fushën e organi-

zimit ka të bëjë edhe me përsosjen e organizimit të vogël e të madh të punës deri në shkallën e të gjithë vendit dhe në planin unik shtetëror. Nuk mund të thuhet se ekziston ky organizim kur disa herë po na ndodh që, për mungesa të transportit e të përdorimit jo të mirë të mjeteve, disa produkte bujqësore mbeten fushave dhe rrezikohen nga shirat e ngricat, kur kapaciteti i depove të drithërave është më i vogël nga prodhimi, kur diku nuk çohen karburanti e lëndët e para sipas planit dhe në kohë e, si pasojë, traktorë e mekanizma të tjerë rrinë pa punuar. Prodhimi i madh e modern socialist kërkon edhe organizim të përsosur, deri në sinkronizim, po të jetë e mundur. Këtë përpiqen ta realizojnë edhe kapitalistët e veçantë brenda ndërmarrjeve e degëve të tyre në periudha të caktuara. Por, si pasojë e veprimit të ligjeve të ekonomisë kapitaliste të anarkisë e të konkurrencës dhe të një sërë ligjesh të tjera, kjo çorganizohet në shkallën e gjithë ekonomisë. Kurse në kushtet e drejtimit të planifikuar të ekonomisë dhe kur drejtuesit tanë janë të ndërgjegjshëm e i njohin mirë politikisht problemet dhe hallet tona, këtë organizim të përsosur është e domosdoshme ta realizojmë në praktikë.

Revolucioni tekniko-shkencor e ka në objektivat e vet synimin për përmirësimin e cilësisë së prodhimit, por për të nuk mund të flitet si 10-15 vjet më parë, siç na raportohet. Edhe këtu duhet kapërcyer kufiri i kuptimit të ngushtë të cilësisë si cilësi e produktit me gjithë kërkesat shoqëruese, që janë në vetvete shumë të drejta, si për shembull, «cilësia është sasi» etj. Lufta



duhet bërë në këtë fushë deri në arritjen e standardeve ndërkombëtare.

Mendoj se kur flasim për cilësinë, ka ardhur koha që me këtë të kuptojmë e të kërkojmë se në ç'nivel është organizimi i prodhimit, cila është shkalla e kompleksitetit të shfrytëzimit të lëndëve të para dhe të energjisë, në mënyrë që nga e njëjta lëndë e parë e konsumuar të arrihet të merret maksimumi i mundshëm i produkteve të dobishme dhe «hedhurina» të ketë sa më pak ose aspak. Të shikohet se si po realizohet direktiva e Partisë për përpunimin në vend të lëndëve të para minerale, në mënyrë që të rritet puna e akumuluar brenda vendit. Kjo rrit më tej efektivitetin e punës e të prodhimit dhe forcon akoma më shumë pavarësinë e vendit tonë.

Si rezultat i vijës së drejtë të Partisë te ne është arritur që industria dhe degët e tjera të mbështeten në burimet e lëndëve të para dhe energjetike të vendit. Megjithatë disa ndërmarrje e degë një pjesë të lëndëve të para e ndihmëse vazhdojnë t'i importojnë nga jashtë. Aktualisht ato zënë afro 50 për qind të importimeve tona. Prandaj rritja e përpjekjeve për të vënë në jetë direktivën e Kongresit të 7-të të Partisë për të arritur që të sigurojmë në vend materialet dhe burimet më të rëndësishme të lëndëve të para e ndihmëse, që kanë rëndësi vendimtare strategjike për pavarësinë dhe për ekonominë tonë socialiste, përbën një objektiv të rëndësishëm në luftën e masave të gjera punonjëse, të shkencëtarëve dhe të instituteve tona kërkimore-shkencore për zhvillimin e thellimin e revolucionit tekniko-shkencor.

Këtu duhet menduar, studiuar e punuar në rrugë e mënyra nga më të ndryshmet, që nga përdorimi më me kursim dhe gjetja e zëvendësuesve tjerë të zbulimi e shfrytëzimi i burimeve tona të mëdha natyrore mbi e nëntokësore.

Ne importojmë mineral fosfatik për të prodhuar plehra të superfosfatit. Mirëpo në kushtet kur industria jonë prodhon sasi të mëdha nitrati, duke përfshirë edhe urenë, krijohet një kontradiktë, për zgjidhjen e së cilës kërkohet rritja e prodhimit të superfosfatit. Për këtë në vitin 1976 në rrethin e Lushnjës, me iniciativën e vetë rrethit, u ngrit linja e përpunimit në formë gjysm-industriale të fosforiteve të vendit. Deri tash janë prodhuar mbi 2 400 tonë, me kosto afërsisht sa gjysma e asaj të superfosfatit të Laçit, me ndryshim që ky duhet të përdoret me dyfishin e dozës së zakonshme, pra edhe kostoja e plehut për një hektar është aty-aty. Rrethi i Lushnjës na informon se kërkesat nga ana e ekonomive bujqësore janë për sasi më të mëdha nga mundësitë që ka rrethi, sepse edhe rezultatet në kushte toke të barabarta kanë qenë pothuajse të njëjta me plehurat e superfosfatit të Laçit. Por çfarë po bëhet për të përhapur këtë përvojë nga bujqësia e industria kimike? Rrethet e tjera për këtë nuk po e vënë hiç ujin në zjarr. Këtu kërkohet që edhe informacioni tekniko-shkencor nga baza dhe nga qendra të përsoset për të inkurajuar zhvillimin dhe masivizimin e punimeve në këtë fushë dhe për të mos lejuar paralelizma e shpërndarjen e forcave.

Por për të gjetur rrugë e mënyra të ndryshme zgjidhjeje duhet vrarë mendja, kërkohen studim, eksperi-

mentim dhe, mbi të gjitha, frymë e shëndoshë proletare e kuptim i thellë i situatës dhe i parimit të mbështetjes në forcat e veta, që njerëzve tanë po u rrënjoset çdo ditë e më shumë.

Partia më se një herë ka theksuar se bujqësia, si dega bazë e ekonomisë sonë, është një fushë e rëndësishme, ku kërkohet të zhvillohet e të thellohet më tej revolucioni tekniko-shkencor.

Rezultatet e rëndësishme të arritura në shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, në sigurimin e bukës në vend, janë fryt i mendimit krijues dhe i djersës së të gjithë punonjësve të bujqësisë, i eksperimentimit shkencor masiv. Këto rezultate kanë kaluar nëpërmjet procesit të transformimeve revolucionare që janë bërë në tërë ekonominë tonë socialiste, si dhe në krijimin e njeriut tonë të ri të pajisur me ideologjinë e Partisë sonë, duke krijuar koncepte e qëndrime të drejta ndaj punës, pronës e prodhimit.

Natyrisht, në raportin e paraqitur nuk mund të flitej për tërë problemet që lidhen me çuarjen përpara të revolucionit tekniko-shkencor në bujqësi. Por ka shumë vend për të na informuar dhe për të ngritur probleme për farërat në përgjithësi dhe për farërat hibride, për përmirësimin e tokave, për kimizimin e tyre, për përdorimin e gipsit në tokat e kripura, për ujitjen e tokave ose ushqimin e bagëtive. Këto çështje nuk duhet të na shtrohen vetëm duke na dhënë disa shtesa rendimentesh, por të na vihet në dukje se si po shkon ky revolucion në këto drejtime. Kur flitet për revolucionin tekniko-shkencor dhe për shfrytëzimin racional të aftësive prodhuese në bujqësi, nuk mund të

mos bëhet fjalë për një mjet kryesor prodhues, siç është toka, kjo pasuri e madhe e vendit. Trajtimi me kujdes i saj në punim, në plehërim, në ujatje, në qarkullimin bujqësor etj. bën të marrim më shumë prodhim, siç po shohim në shumë ndërmarrje e kooperativa bujqësore, dhe e kundërta ndodh kur ajo keqpërdoret dhe gërryhet nga erozioni. Edhe këtu revolucioni tekniko-shkencor ka një front të gjerë.

Në bujqësi kërkohet të bëhet një punë më e studiuar për prodhimin e farërave të zgjedhura dhe hibride për të gjitha bimët e arave, veçanërisht për drithërat e bukës, në mënyrë që ta konsolidojmë më tej fitoren e arritur duke siguruar bukën në vend. Natyrisht, kjo lidhet edhe me shumë faktorë të tjerë, por problemi i farërave ka vendin e vet të rëndësishëm. Në qoftë se prodhimi i hibrideve të misrit është futur në rrugën e zgjidhjes dhe mund të thuhet se punohet mirë, për bimët e tjera kërkohet të punohet më shumë.

Një drejtim tjetër i rëndësishëm, ku mund të thellohet më tej revolucioni tekniko-shkencor në bujqësi, është mekanizimi i proceseve të punës. Ne nuk duhet të lejojmë që të mbjellim 19 mijë hektarë duhan me dorë si shumë vjet më parë, ose me mijëra hektarë të tjerë me lakra, domate etj., pa përmendur këtu nevojën e mekanizimit më të gjerë të punimeve e të shërbimeve në bimët e arave, në pemëtari, vreshtari, blegtori etj.

Problem me rëndësi mbeten zhvillimi dhe studimet që duhen bërë për blegtorinë. Pa blegtori të zhvilluar nuk mund të ketë bujqësi të përparuar. Këta dy sektorë, siç u theksua edhe në Plenumin e 3-të të KQ të

PPSH të vitit 1967, janë degë të të njëjtit trung ekonomik, njëra nuk mund të bëjë pa tjetrën. Kjo lidhje e këtyre sektorëve dikton ndërmarrjen e studimeve për rritjen e produktivitetit të blegtorisë nëpërmjet seleksionimit e mbarështimit. Ne kemi bërë përparime të mëdha në këtë drejtim, por stadi aktual dhe kushtet e krijuara nuk mund të justifikojnë gjendjen ekzistuese.

Shteti ka sjellë nga jashtë lopë e damazë të racave me prodhimtari të lartë, linja për prodhimin e pulave për vezë e mish. Çështja shtrohet që këtë bazë që disponojmë ta ruajmë dhe të bëjmë përpjekje të vazhdueshme për të krijuar racat e linjat tona për mish, vezë etj. Puna që ka filluar për linjat e shpendëve është një gjë e mirë, por përpjekjet duhet të intensifikohen për të krijuar linja në nivelin e atyre që sjellim nga jashtë ose të përfaqëta me to.

Zhvillimi dhe përmirësimi racor i bagëtive nuk mund të kuptohen pa zhvilluar bimët foragjere dhe rritjen e rendimenteve të tyre. Këtu kërkohet të studiohet e të përhapet më mirë përvoja pozitive, siç është ajo e sektorit të Uznovës të Ndërmarrjes Bujqësore të Beratit, që në 100 hektarë tokë arë mban 200 krerë lopë dhe me prodhimtari të lartë, në një kohë kur mesatarja e të gjitha NB-ve është 25 krerë lopë për 100 hektarë tokë arë. Në këtë sektor e tërë sipërfaqja arë është vetëm me bimë foragjere. As që mund të mendohet që kjo të bëhet për të gjitha NB-të, por atje ku ka sektorë të specializuar për prodhim qumështi dhe ku i kemi mundësitë, kjo përvojë mund të studiohet e të përhapet.

Këtu përmenda vetëm disa nga gjithë ato probleme që ka në sektorin e bujqësisë për shtimin e drithë-

rave të bukës, zhvillimin kompleks e harmonik të prodhimit bujqësor në front të gjerë nëpërmjet specializimit e kooperimit, luftimin e sëmundjeve e të dëmtuesve të bimëve në fushë e në depo, zhvillimin me ritme të larta të zonave kodrinore e malore etj., etj.

Problemi i zbatimit të studimeve dhe i kërkimeve të ndryshme që kryhen nga punonjës dhe institute për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor nuk duhet t'i mbetet spontancitetit. Këto studime e kërkime duhet të analizohen në këshilla shkencorë e byro teknike dhe, sipas rëndësisë e vlerës së tyre, të diskutohen në drejtoritë e ndërmarrjeve, në komitetet ekzekutive, në kolegjiunet e dikastereve dhe deri në Qeveri, në mënyrë që të mos mbeten si çështje fakultative, por të vihen në jetë. Natyrisht, kur ato duan investime, do të vendoset sipas rregullave që ekzistojnë, ndërsa të tjerat që sigurojnë kursime e përsosin një proces pune e prodhimi, pa shpenzime të mëdha suplementare, duhet të zbatohen pa hezitim dhe të mos sillen pengesa burokratike. Çdo shfaqje diletantizmi në udhëheqjen dhe në drejtimin e punëve që kanë të bëjnë me çështjet e revolucionit tekniko-shkencor, pengon ecjen përpara. Këtu duhen organizim e planifikim i përsosur, shpirt praktik dhe mobilizim revolucionar.

Një tregues matës sintetik i zhvillimit dhe i thellimit të revolucionit tekniko-shkencor dhe objektiv i tij ka qenë e duhet të jetë rritja e rendimentit individual e shoqëror të punës.

*«Fuqia prodhuese e punës, — na mëson Karl Marksi, — përcaktohet nga rrethana të ndry-*

*shme, midis së tjerash, nga shkalla mesatare e shkathtësisë së punëtorit, nga niveli i zhvillimit të shkencës dhe shkalla e zbatimit teknologjik të saj, nga kombinimi shoqëror i procesit të prodhimit, nga madhësia dhe efikasiteti i mjeteve të prodhimit dhe nga kushtet natyrore»<sup>1</sup>.*

Është fakt që gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit rendimenti i punës në industri kundrejt vitit 1966 është rritur 29 për qind, në punimet e ndërtim-montimit ai është rritur 55 për qind dhe po kështu janë rritur rendimentet e bimëve bujqësore.

Plotësimi i detyrave për rritjen e rendimentit të punës është bazë edhe për plotësimin me sukses të planit pesëvjeçar, për mbajtjen e ritmeve të larta të rritjes së prodhimit e të akumulimit të brendshëm socialist, për ngritjen e mirëqenies së punonjësve. Por këtu duhet të na tërheqë më shumë vëmendjen fakti që në shtesën e produktit shoqëror dhe të të ardhurave kombëtare rritja e rendimentit të punës shoqërore këto vitet e fundit ka pasur një ndikim më të vogël.

Po të krahasohet rendimenti në punë në prodhimin industrial plotësuar në 6-mujorin e parë të vitit 1977, me atë të 6-mujorit të parë të vitit 1975, del se brenda dy vjetëve rendimenti në punë është rritur vetëm 1 për qind, kurse detyra e pesëvjeçarit për këta dy vjet është 3,5 për qind. Natyrisht në vite të caktuara mund të ketë edhe ndonjë luhatje. Rritjet e rendimentit që

---

1. K. Marks, «Kapitali», vëll. I, libër 1, f. 65-66.

mund të arrihen, kur ai është fare i ulët, mund të mos arrihen gjithnjë. Po atëherë përse planifikohet rritja për dy vjet 3,5 për qind dhe pastaj nuk arrihet?

Kjo çështje kërkon studim më të thellë dhe marrje masash serioze, por mendoj se këtu duhen parë mirë si shfrytëzohet baza materialo-teknike që kemi dhe të gjitha ato çështje që përmenden më sipër.

Revolucionin tekniko-shkencor e bëjnë masat e gjera punonjëse, e bëjnë punëtorët, kooperativistët, kuadrot. Pjesëmarrja e masave të gjera punonjëse në revolucionin tekniko-shkencor është kusht i domosdoshëm për zhvillimin e thellimin e tij të mëtejshëm dhe për forcimin e karakterit socialist.

Në forcat prodhuese elementi kryesor është njeriu. Kjo flet për raportin e përhershëm të njerëzve ndaj natyrës, për punën që bëjnë këta për transformimin e ambientit që i rrethon. Në vendin tonë socialist teknika është ndihmësja e domosdoshme dhe e nevojshme për njerëzit në luftën e tyre për të zotëruar natyrën. Njerëzit tanë duhet të mësojnë se si t'i përdorin mjetet e prodhimit, mjetet e punës, disa procedura që quhen teknike, me qëllim që të prodhojnë më shumë, më mirë dhe më lirë.

Në këtë çështje Partia na mëson ta luftojmë teknokratizmin, po edhe ta kuptojmë atë, të mos biem në këtë gabim të madh teorik dhe praktik, pse teknokratizmi manifestohet në format e një pushteti të atyre që kanë në dorë mjete teknike dhe, kuptohet, edhe kompetencat kryesore teknike. Në këtë pseudoteori të teknokratëve bazohet edhe kuptimi revizionist i revolucionit tekniko-shkencor, që përpiqet të zëvendësojë



revolucionin proletar, duke sjellë si argument se tash ekonominë nuk e drejtojnë më kapitalistët, por janë teknokratët, janë teknikët ata që e drejtojnë, prandaj, sipas saj, nuk është më nevoja të bëhet revolucioni proletar dhe mjetet e prodhimit të kalojnë nga një dorë në një dorë tjetër, pse ky proces gjoja është bërë dhe po bëhet nëpërmjet revolucionit tekniko-shkencor. Në vendet kapitaliste, dhe tani edhe në ato revizioniste, specialistët e lartë dhe ata të mesëm, në shumicën e tyre, përbëjnë atë që quhet aristokraci e klasës punëtore.

Këto çështje Partia na i ka shtruar e i ka sqaruar teorikisht edhe herë të tjera. Por a janë kuptuar e a janë përvetësuar thellë nga të gjithë këto mësime? Ne duhet të ruhemi nga shfaqjet burokratike e nga teknokratizmi ose nga mosshtruarja e problemeve shkencore në prizmin marksist-leninist, dhe të bëjmë kontrollin e rreptë të zbatimit të këtyre mësimeve shkencore në praktikë. Ato duhet të maten me rezultatet.

Revolucion tekniko-shkencor do të thotë të ecësh përpara, të bësh transformime sasiore dhe cilësore, kurse rutina, indiferentizmi, mosstudimi me këmbëngulje i teorisë e i shkencës e pengojnë këtë proces, bile ndihmojnë teorinë revizioniste për revolucionin tekniko-shkencor. Atje ku këto çështje nuk njihen si duhet dhe ka ose krijohet boshllëk në përvetësimin e teknikës e të shkencës, krijohet truall i favorshëm për të rënë në gabime ose humbet vigjilenca revolucionare ndaj atyre që me qëllim ose pa qëllim veprojnë ndryshe nga ç'thotë Partia.

Si konkluzion duhet të kuptojmë se për ne ka rën-

dësi të madhe që të gjithë punëtorët t'i bëjmë të kualifikuar dhe të përpiqemi të arrijmë që punëtori i thjeshtë i çdo profesioni të ngrihet gradualisht në rangun e kuadrove të mesëm të kualifikuar dhe t'i afrohet inxhinierit. Por, për t'ia arritur këtij objektiv, është e domosdoshme që ai të fitojë njohuritë teknike, të veçanta dhe të përgjithshme, bile të veçanta në thellësi, po edhe të përgjithshme gjithashtu në thellësi, dhe të kuptojë shkencërisht zhvillimin e kësaj procedure në marrjen dhe në fitimin e njohurive teknike, pse këto njohuri nuk mund të konsiderohen thjesht artizanale, por rezultat i një zhvillimi teorik. Kur ne punojmë kështu, bëjmë që revolucioni të ngrihet nga një stad praktik në një stad shkencor.

Prandaj t'i vëmë rëndësi të madhe atestimit të punëtorëve. Ky nuk duhet të konsiderohet si një çështje formale dhe për të ngritur në kategori njerëz që aspirojnë të marrin rroga, pa marrë më parë dituri, shkencë dhe teknikë. E theksoj këtë, pse në vija të përgjithshme konstatoj që ecet në këtë rrugë të gabuar. Atestimi duhet ta ndihmojë punëtorin ose teknikun e çfarëdo kategorie që të ngrihet në një kategori më të lartë, duke bërë përpjekje për të marrë njohuri të shëndosha shkencore dhe teknike. Këto njohuri ai duhet t'i vërë në zbatim për të bërë që prodhimi të evoluojë, të ecë përpara, të transformohet në të mira materiale, që mjetet e prodhimit të perfeksionohen, të bëhen më automatike, të prodhojnë më shumë, më shpejt dhe më lirë.

Tani gjithë ky qëllim, gjithë ky proces është ai revolucion tekniko-shkencor që kërkon Partia të zhvillohet në mënyrë të pandërprerë dhe jo me fushata. Në

revolucion kërkohen njerëz që të jenë të guximshëm, të dinë të luftojnë dhe përse të luftojnë, domethënë njerëz të ngritur politikisht, ideologjikisht dhe teorikisht, që të dinë mirë edhe artin ushtarak, po të dinë edhe armën që ta përdorin në luftë. Në të tilla kushte duhet të vihen njerëzit tanë, klasa punëtore dhe punonjësit e tjerë të bujqësisë e të çdo sektori në revolucionin tekniko-shkencor.

Njerëzit tanë duhet të ngrihen vazhdimisht politikisht, ideologjikisht, teknikisht dhe shkencërisht për të transformuar natyrën, për të transformuar mjetet e prodhimit, që këto t'u shërbejnë atyre për të zotëruar si duhet ligjet e natyrës dhe për t'i transformuar këto ligje për të mirën e njerëzve. Kësaj i thonë të ndërtojmë socializmin shpejt, mirë, me sa më pak shpenzime dhe me forcat e veta. Po të veprohet ndryshe, kjo do të thotë se revolucionin tekniko-shkencor nuk është kuptuar si duhet.

Me qëllim që ai të japë efektin maksimal, kërkohet një planifikim sa më i shëndoshë, duke i përfshirë çështjet që do të zgjidhë si pjesë të planit unik shtetëror nga baza në qendër, sepse kështu revolucionin tekniko-shkencor do të ndiqet më mirë nga organet e organizatat e Partisë, nga institutet e specializuara dhe nga dikasteret përkatëse.

Për sa i përket propozimit që bëhet nga aparati i Komitetit Qendror, që mund të organizohet edhe një aktiv ose konferencë kombëtare për revolucionin tekniko-shkencor, kjo le të studiohet dhe të vendosim konkretisht. Por themelore është të mobilizohemi e të punojmë me të gjitha forcat për ta çuar më përpara

këtë revolucion, si pjesë përbërëse shumë të rëndësishme të revolucionit tonë socialist.

*Dotuar për herë të parë,  
me disa shkurtime, në li-  
brin: Enver Hoxha, "Ra-  
porte e fjalime 1976-1977",  
f. 394*

*Botohet sipas tekstit të nxje-  
rrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ  
të PPSH, që gjendet në AQP*

# **PARTIA TË PUNOJË PËR NGRITJEN E KULTURËS SË PËRGJITHSIME TË MASAVE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**27 tetor 1977**

Marrim tani në shqyrtim pikën e dytë të rëndit të ditës. Për këtë çështje kanë ardhur materiale nga rrethi i Korçës dhe i Mirditës dhe kemi thirrur të na flasnin shokë nga rrethi i Elbasanit dhe i Pukës. Raportet i kemi kënduar dhe i kemi studiuar, në bazë të tyre ju mund të bëni pyetje, mund të kërkonin ndonjë shpjegim suplementar nga shokët.

Para dy-tri ditësh pashë në televizor disa grupe artistike të Pukës. Më pëlqyen shumë këngëtarët, po kështu edhe këngët që këndonin. Pastaj u gëzova që edhe gratë dilnin shumë në skenë për të kënduar.

Kur kam qenë në Pukë në vitin 1970, vajzat dhe gratë e këtij rrethi më kanë bërë përshtypje shumë

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për punën e komiteteve të Partisë për të vënë në jetë direktivën e Kongresit të 7-të të Partisë për ta bërë kulturën sa më masive.

të madhe, jashtëzakonisht të madhe. Ato janë të shkathtëta, të zgjuara, të guximshme, me gjithë mend unë jam entuziazmuar nga gjendja dhe nga personaliteti i tyre.

Në përgjithësi, dihet se është ngritur niveli kulturor i popullit të Pukës dhe për këtë s'ka asnjë dyshim. Por, përveç informimit për këngët dhe vallet, për grupet e estradës ose të teatrit, do të dëshiroja të kishim një pasqyrë të shkurtër të ngritjes së kulturës së përgjithshme të masave punonjëse të këtij rrethi. Për ta kuptuar më mirë atë që dëshiroj, nuk mjafton të na thuhet sa shkolla ka në rreth, por të na jepet një ide e përgjithshme që sa këto shkolla, së bashku me shtypin, me artin etj., që ka zhvilluar atje Partia, kanë krijuar në masat e gjera të popullit të Pukës një ngritje të kulturës së përgjithshme në jetën e tyre. Nuk e kam fjalën të dëgjojmë këtu ato gjëra që na përsëriten shpesh, se kanë ndryshuar shtëpitë, dhomat, mënyra e jetesës etj. Kjo është një gjë shumë e mirë, por unë dua të di nëse kur piqesh me një pukjane apo me një pukjan, deri në njëfarë shkalle dhe pa kërkuar shkencë e dituri të madhe nga ata, me gjithë këtë punë që është bërë e po bën Partia, janë ata në gjendje të të japin një përgjigje, po t'u bësh, për shembull, një pyetje historike për të kaluarën e vendit dhe të popullit tonë, ose po t'i thuash një gruaje apo vajze: «Moj shoqja pukjane, ç'mendon ti për këtë zhvillim të ekonomisë apo të industrisë sonë? Ke shëtitur, ke parë, prandaj si të duket kultura, fjala vjen, në Berat, ç'përshtypje të ka bërë ajo?» etj., etj.

Pra, a interesohen masat për historinë dhe jo vetëm të Shqipërisë në përgjithësi, por edhe të krahinës së tyre, të njerëzve, për muzetë? Historia e luftërave të fshatarëve të rrethit të Pukës kundër bajraktarëve, kundër okupatorëve a vihet në dukje? A gërmohet në popull për këto çështje? Partia duhet t'i grumbullojë këto materiale. Duhet punuar me to në popull për të ngritur ndërgjegjen klasore dhe patriotike të njerëzve atje, që masat të mos mendojnë se kanë qenë vrima e fundit e kavallit.

Partia duhet t'i vërë mirë në dukje këto ngjarje dhe në mënyrë të organizuar, duke u përgatitur mirë dhe duke organizuar pastaj konferenca të posaçme nga mësuesit. Këto do të ndihmojnë për ta ndier më fort solidaritetin e madh të popullit. Se jo vetëm në Pukë, por edhe gjetkë ka mbeturina të ndjenjave të lokalizimit. Prandaj duhet me pasë kujdes për këtë çështje. Siç dimë, ka akoma familje patriarkale të cilat duhen njohur. Në të tilla familje sundon babai. Në qoftë se njëra nga nuset e djemve kërkon fustan, duhet t'i japë paratë babai. Pra mund të themi se veprojnë akoma normat e kanunit.

Këto probleme, si edhe qëndrimi ndaj vajzave e grave, ndaj martesave etj. duhen studiuar në rreth e të shihen lidhur me punën që është e nevojshme të bëhet për ngritjen e nivelit arsimor e kulturor të njerëzve. Duhet parë, punëtorët dhe kooperativistët a e ndjekin shkollën? Gjithashtu e kam fjalën edhe për fëmijët që mbeten pa mbaruar shkollën 8-vjeçare. A ka në Pukë nga këta?

*Pastaj, duke kaluar në disa probleme të përhapjes së kulturës në rrethin e Korçës, shoku Enver Hoxha iu drejtua shokut Pirro Lako, në atë kohë sekretar i komitetit të Partisë të këtij rrethi, me të cilin shkëmbeu disa mendime.*

Ju thatë se vdekshmëria foshnjore në rrethin tuaj është e lartë në zonën e Moglicës, sidomos në fshatrat Gopesh e Dobroçan. Moglica është si Labëria e Gjirokastrës, kurse Pogoni, Lunxhëria nuk kanë vdekje në fëmijë. Po s'c' kuptoj përse të jetë i lartë mortaliteti i fëmijëve në Bilisht. Ky është qytet.

Kur përmende Gopeshin, më kujtove kohën e luftës. Atëherë kam qenë atje. Na çoi përmes rreziqesh të mëdha një fshatar nga Gopeshi, që quhej Kupe. Kur arritëm, ky më mori mënjanë dhe më tha:

— Shoku komisar, kam një hall.

— Çfarë halli ke, more Kupe? — e pyeta unë.

— Më quajnë ballist, — m'u ankua ai.

— Po pse të quajnë ballist, more Kupe?

— E po ja, kështu më quajnë, ç'të them unë? Erdhi këtu një ditë Nexhip Vinçani me dy-tre partizanë dhe më kërkoi pekmez për të ngrënë. — «Nuk kam, o shoku Nexhip», — i thashë unë. — «Të gjesh ku të duash», — m'u kërcënua ai. — «Unë s'kam ku të gjej pekmez», — iu përgjigja. Atëherë ai më tha: — «Ti je ballist!». Kështu i kanë thënë edhe Hasan «beut»<sup>1</sup>, — më tha Kupja, — dhe ky me këtë sy më shikon.

— Po jo, more Kupe, — e qetësova, — ty po të

---

1. Hasan Moglica, komandant çete partizane.



them unë që s'je ballist. Megjithatë eja mbas dy ditësh në barakat e Zvarishtit dhe atje piquemi me Hasanin.

Pas dy ditësh erdhi Hasani, u poq me Tekiun<sup>1</sup>, dhe biseduam. Kupja, që kishte ardhur aty, rrinte nga dhoma tjetër. Atëherë unë i thashë Hasanit:

— More, më ka folur Kupja nga Gopeshi se ju e quani ballist.

— Po, — u përgjigj xha Hasani, — ballist është.

— Po mirë, pse është ballist? — e pyeta.

— Po ja, Nexhipi më ka thënë...

— Po sikur të ta shpjegoj unë një çikë këtë punë, — i thashë, — dhe ia tregova ngjarjen.

Hasani u ngrit në këmbë dhe tha:

— Sa ka nga këto gjëra Xhipja!

— E rregullojmë tani këtë çështje, se kemi edhe Kupen këtu, i thashë Hasanit. Ky u bind, prandaj thirrëm Kupen. Xha Hasani i dha dorën dhe i tha: «Jo, more Kupe, nuk je ballist ti, tani sa më shpjegoj komisarit se si qëndron puna». «Na dil nganjëherë andej nga çeta», — e ftoi pastaj Hasani dhe u miqësuan të dy. «Mirë, xha Hasan, unë kurdoherë me Partinë jam», — i tha Kupja.

Ti, Pirro, je fizikan. Tani si sekretar zanatin tënd si fizikan në ç'mënyrë e përdor në punën e Partisë? Të shërben ai ty në këtë punë? Dua të di, e ke lënë në harresë këtë shkencë apo përpiqesh ta lidhësh me punën e Partisë? Sigurisht, jo vetëm duke vajtur për vizita nëpër shkolla, por edhe në fusha të tjera të aktivitetit. Dua të them, kultura jote si fizikan si mund ta

---

1. Teki Kolaneçl

ndihmojë Partinë? Ti si specialist mund të na e sqarosh këtë më mirë. Për shcmbull, në kontaktet e ndryshme me komunistët, me njerëzit që s'kanë lidhje fare me fizikën, ti, në mendjen tënde, a bën përgjithësim praktikë të fizikës lidhur me jetën e njeriut, me natyrën? A përpiqesh të gjesh format, rastet, mënyrat se si t'u nxitësh njerëzve intelektin lidhur me problemet që kanë, edhe me njohuritë e fizikës, por ama duke i vulgarizuar këto? Pra, e kam fjalën kështu për fizikën e vulgarizuar, që ti vetë duhet ta përpunosh dhe ta përdorësh në punën e Partisë.

Fizika është shkencë ekzakthe. Ka njerëz që nuk e dinë, nuk e kuptojnë po t'u flasësh për teorinë e gravitetit, por natën, kur ruajnë bagëtitë, ata ngrenë kokën lart dhe shikojnë yjet, lëvizjet e tyre dhe thonë: «Si nuk bien, pse nuk bien, pse bie molla?». Edhe ky prapë vulgarizim është dhe ai duhet bërë që t'i kuptojë tjetri këto fenomene, ndryshe nuk i kupton.

Në jetë ka gjëra shumë interesante. Ju përmendët këtu disa mbeturina fetare. «Ta do zemra», thotë tjetri për diçka. Mirëpo është një filozofi e tërë puna e zemrës dhe e sentimenteve. Kush dominon te njeriu, zemra apo sentimentet? Ka pasur filozofë të mëdhenj që kanë diskutuar për këto gjëra, lidhur kurdoherë me fenë, ose mund të ketë njerëz pleq që thonë: «More kjo toka është rrafsh, nuk është e rrumbullakët». Mirëpo atyre duhet t'ua shpjegosh këto, por t'ua shpjegosh me lezet, sepse, po t'u flasësh për teorinë e Ptolemeut, për të Keplerit ose për çdo shkencëtar tjetër, ku i kuptojnë ata, nuk dinë nga këto teori. Prandaj fizika, matematika mund të përdoren të thjeshtësuara, që të sqarohen

njerëzit për gjëra të tilla. Për shembull, pse ka muajt janar ose mars 31 ditë, prilli 30 dhe shkurti 28 ditë dhe një herë në katër vjet 29 ditë, jo vetëm populli, por ka edhe intelektualë që nuk e dinë. Është kështu? Natyrisht, këto shpjegohen në mënyrë shkencore, por mund të shpjegohen edhe në mënyrë popullore dhe kështu zhvillohet kultura e njerëzve të thjeshtë, e masave.

Po te ju<sup>1</sup>, në Mirditë, si është mortaliteti infantil? Këtij problemi i vini kujdes më shumë. Populli i rrethit tuaj ka humor dhe është i gëzuar. Ai ka dhe shije artistike. Drurin e punojnë artistikisht në qendër. Po në kooperativat bujqësore a e punojnë atë artistikisht? Ansamblet kulturore, folklorike të qendrave të tilla si Rrësheni, Rubiku, Kurbneshi, a shkojnë nëpër kooperativat bujqësore për të dhënë shfaqje, a kanë plan për këtë?

Si shkon iniciativa që kanë marrë shumë vjet përpara arsimtarët e rrethit të Mirditës? Çfarë rezultatesh ka dhënë kjo iniciativë? Sigurisht, ajo ka dhënë medoemos rezultate, po unë dua të di diçka sidomos lidhur me personalitetin e grave dhe të vajzave. A janë shtuar mësueset në Mirditë dhe si punojnë ato me gratë e sektorit të bujqësisë?

Mrika e Bardhok Bibës dhe vajza që e kam mbajtur në duar kur ka qenë e vogël, si janë? U bëni shumë të fala nga unë.

---

1. I drejtohet shokut Tonin Sata, në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Mirditës.

*Gjatë diskutimit, që u zhvillua në formë bisede, të pranishmit në mbledhje iu përgjigjën pyetjeve të bëra.*

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

"

## NE TREGTINE E JASHTME T'I BEJME LLOGARITE MIRE

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

29 tetor 1977

*Në fillim shoku Hekuran Isai informoi për punën që ekipi i Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit bëri në Ndërmarrjen e Serrave. Rezultoi se konstatimet e këtij ekipi ishin të ngjashme edhe me ato të ekipeve që kishin kontrolluar punën e organizatave të Partisë në Ndërmarrjen e Ndërtimit dhe në kooperativën bujqësore të Luzit të Vogël në Kavajë.*

*Pasi bëri disa ndërhyrje, ndër të tjera, shoku Enver Hoxha tha:*

*Nuk e kuptoj, pse të praktikohet puna me ekipe në këtë shkallë kaq të gjerë? Unë konstatoj një gjë: ekipet e shumta ka rrezik të mënjanojnë organizatat e Partisë dhe ato të masave. Kjo nuç duhet lejuar. Për të zgjidhur probleme në ndërmarrje, në radhë të parë, është organizata-bazë e Partisë. Kur është nevoja, ajo mund të ndihmohet, por jo të spostohet ose të likuidohet roli i saj, se kështu ajo burokratizohet dhe fishket.*

Edhe kontrolli punëtor në asnjë mënyrë nuk duhet të dobësojë rolin e organizatës-bazë, që është roli i Partisë në ndërmarrje, institucion ose kooperativë bujqësore. Kontrolli punëtor është klasa punëtore, kurse organizata-bazë është pararoja e kësaj klase. Komiteti i Partisë mund të organizojë kontrollin punëtor, por këtë do ta bëjë kur e do puna. Unë i quaj qëndrime shumë të drejta ato kur kontrolli punëtor vihet në lëvizje në kohën që ka probleme shqetësuese. Si rregull, organizata-bazë e Partisë e kontrollon vetë punën. Në këto raste, është e natyrshme që s'ka pse të vihet në lëvizje kontrolli punëtor. Për të metat që zbulon, organizata-bazë bën kritikë e autokritikë, përpiket vetë. Kontrolli punëtor do të dërgohet në ato raste kur shihet që puna nuk bëhet mirë, sidomos në disa drejtime. Mendoj se duhet pasur kujdes në këto gjëra. Edhe kur dërgohen ekipe, të shihet se çfarë i mbetet të bëjë kontrollit punëtor.

Nuk i them këto gjëra vetëm për sa dëgjojmë e që lidhen edhe me punën e ekipeve në Durrës. Sot këndova një artikull që flet për kontrollin punëtor në Tiranë, ku vihen në dukje edhe masat e marra prej tij. Po çfarë të drejtë ka ky kontroll punëtor që vete dhe pushon nga puna 12 punëtore menjëherë? Gjëra të tilla më parë duhen vërtetuar mirë, pastaj të vendoset. Kontrolli edhe mund të pushojë ndonjë njeri, por edhe ky i fundit ka të drejtë ta hedhë në gjyq, në qoftë se masa nuk është e drejtë.

Sipas artikullit, del që ka ndërruar edhe natyra e kontrollit punëtor, të cilin kanë filluar ta quajnë «kontroll punëtor shoqëror». Kjo do të thotë që kontrolli

punëtor është edhe shoqëror, sepse në të futen edhe specialistë! Me këtë përbërje, kontrolli punëtor në Tiranë shkoi në disa çerdhe, kontrolloi, i raportoi edhe Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Tiranës dhe menjëherë u pushuan 12 punëtore të çerdheve. Unë nga ana ime jam kundër një mase të tillë. Si mund të pushojë kaq kollaj 12 veta nga puna komiteti ekzekutiv? Edhe në qoftë se i ka në nomenklaturë, në asnjë mënyrë nuk ka të drejtë t'i pushojë. Ne kemi ligje, në bazë të të cilave fajtori i jepet gjyqit, dënohet sipas fajit, por ta pushosh tjetrin nga puna, pa i gjetur punë tjetër, nuk lejohet. Te ne një njeri mund të pushohet nga puna kur gabon, por duhet të dërgohet të punojë në një punë tjetër, ose mund të ulet nga përgjegjësia atje ku është.

Artikulli që këndova sot nuk është i gabuar, por fjalën e kam se ai që ka organizuar kontrollin punëtor është specialist funksionar, ka përgatitur se çfarë do të kontrollohej nga grupi i kontrollit punëtor. Pse, kështu është kontrolli punëtor? Kësaj i thonë: «Unë, specialisti i ndërmarrjes, po i përgatis punën këtij grupi të kontrollit punëtor që do të vejë të kontrollojë duke mos pasur haber hiç se çfarë duhet të kontrollojë». Një kontroll të tillë nuk e ka në dorë Partia. Mirëpo Partia ka levat e saj. Komiteti i Partisë ka, në radhë të parë, organizatën-bazë të Partisë, pastaj dhe organizatat e masave. Atëherë përse dërgohen në bazë gjithë këto ekipe? Ekipe do të organizojmë, por jo në dëm të rolit të organizatës-bazë; kontroll punëtor do të organizojmë, por jo me specialistë e pa iu përmbajtur udhëzimeve të Partisë. Këto gjëra duhen parë mirë, se nuk ndodhin

vetëm në Durrës. I shikoni me kujdes, shokë! Ç'janë këto ekipe apo grupe kontrolli punëtor, që venë e përjashtojnë njerëz nga Partia dhe i thonë organizatës-bazë: «Bëni kështu si ju themi ne!?!». Ekipi që shkon për kontroll s'ka të drejtë të veprojë kështu, por të vejë, të kontrollojë, të japë ndonjë ndihmë në vend dhe, pasi të kthehet, t'i bëjë raport komitetit të Partisë. Mund të ndodhë që organizata-bazë të mos jetë dakord me konkluzionet e ekipit dhe të kërkojë të vejë në mbledhjen e saj një nga sekretarët e komitetit të Partisë. Ajo ka të drejtë bile të thotë që për një çështje të caktuar s'është dakord edhe me Komitetin Qendror. Këtë e parashikon edhe Statuti i Partisë. Demokracinë proletare në Parti duhet ta zbatojmë drejt e jo ta shkelim.

Nuk duhet të sillemi si të duam me organizatën e Partisë. Në qoftë se ajo në ndonjë rast nuk është në gjendje të zgjidhë një problem, atëherë çështja mund t'i vejë komitetit të Partisë, i cili ndihmon organizatën e Partisë, aktivizon organizatën e bashkimeve profesionale, të rinisë, të gruas etj., mund të ngrejë edhe një grup të kontrollit punëtor për të ndjekur problemin. E përsëris, kur ekipi ose grupi i kontrollit punëtor sheh se një kuadër ose punonjës ka bërë faje, këta ulen nga përgjegjësia atje ku janë. Në rast se nuk duhet të punojnë aty, transferohen në një vend tjetër, po pa punë nuk mund të lihen. Më së fundi, në qoftë se kanë bërë krime, sipas rregullave, i jepen gjyqit. Ka edhe faje të vogla që Partia i kritikon dhe i fal, por jo të dënohen 60 veta, siç ka ndodhur në Luz të Kavajës, të tilla gjëra nuk duhet të lëjohen.



*Në këtë takim merrte pjesë edhe shoku Nedin Hoxha, në atë kohë ministër i Tregtisë së Jashtme, i cili informoi për gjendjen e marrëdhënieve tregtare me Kinën. Lidhur me këtë shoku Enver Hoxha, tha:*

Të tëra këto që u ngritën këtu janë probleme shumë të rëndësishme. Unë kam arritur në përfundimin se kinezët tani janë vënë në pozita të tilla që synojnë të na dëmtojnë dhe, në të njëjtën kohë, të na frikësojnë. Tani edhe ne, duke marrë parasysh këto pozita të tyre, të mbajmë qëndrimin që meritojnë. Para së gjithash, të evidencojmë dëmet e mëdha që ata i kanë sjellë vendit tonë. Këto që them i vërtetojnë mënyrat arrogante se si i shtrojnë çështjet ata. Ne nuk mund të pranojmë një situatë të tillë, mbasi, po e pranuar, do të thotë që të na hedhin litarin në grykë dhe të na e shtrëngojnë si të duan ata.

Unë mendoj që grupi i punës të vejë në Pekin, të marrë me vete listat e kontingjenteve të mallrave dhe t'u thotë kinezëve se ka vajtur atje pikërisht për të caktuar kontingjentet. Ai t'u vërë në dukje, gjithashtu, se «Ministria jonë e Tregtisë së Jashtme ju ka dërguar një promemorje, për përmbajtjen e së cilës ju vetë keni dhënë edhe disa mendime. Tani le të shohim më konkretisht se ç'janë këto». Por unë mendoj që kryetari i grupit të theksojë se «këto probleme shumë të rëndësishme ekonomike, veçanërisht për vendin tonë, nuk po trajtohen në rrugë të drejtë nga pala juaj, që kërkon të na imponojë vullnetin e saj. Qeveria shqiptare nuk i pranon pa i diskutuar këto probleme tregtare, pse janë të përbashkëta, prandaj nuk mund të vendosen në mënyrë të njëanshme».

«Ju i keni kërkuar përfaqësuesit tonë tregtar, — t'u vihet në dukje kinezëve, — edhe çështjen e çmimeve koniunkturale, që na e keni shtruar shumë herë. I keni shtruar, gjithashtu, edhe çështjen se me ç'monedhë do të bëhen llogaritë, si edhe problemin e transportit. Mirëpo të tria këto çështje nuk janë aq të thjeshta sa tha përfaqësuesja juaj tregtare, përkundrazi, janë shumë të koklavitura dhe u interesojnë të dyja palëve. Meqenëse ju na i ngrini këto probleme, duhet të na jepni edhe shpjegime se në ç'baza do të llogariten çmimet ndërkombëtare dhe me cilin treg». Nuk keni njerëz si Naum Stralla<sup>1</sup> në tregti, Nedin, që të jenë specialistë për këto probleme, sidomos për çmimet? Naum Stralla i njihnte shumë mirë të gjitha problemet e tregtisë. Ai ishte edhe merceolog. Çmimet e mallrave të tregut botëror i dinte, koniunkturat i ndiqte, po kështu edhe të tëra problemet e tjera ekonomike. Stralla kishte kohë që na thoshte neve se sovjetikët po përpiqen të na e hedhin në këtë ose në atë çështje, edhe pse kishim marrëdhënie të mira atëherë me sovjetikët. Ai na thoshte, gjithashtu, edhe për çekët se nuk po tregohen korrektë e të ndershëm me ne dhe na i argumentonte këto çështje konkretisht, me fakte. Të tillë njerëz duhet të përpiqemi që t'i përgatitim, se janë të domosdoshëm!

«Çështja e monedhës është një problem që duhet të studiohet e të diskutohet mes nesh», mund t'u thuhet kinezëve dhe shokët tanë të ngulin këmbë në këtë çë-

---

1. Ekonomist i shquar i vendit tonë, që ka punuar në Komisionin e Planit të Shtetit.

shtje. Specialistët tanë duhet ta shikojnë me kujdes se cila na leverdis: të dimë se me ç'monedhë duhet t'i bëjmë llogaritë: me dollarë, me juanë, me frangun francez, me sterlinën, apo me frangun zviceran? Për këtë çështje ata kanë mendimet e tyre, po edhe ne kemi mendimet tona. Megjithatë, meqenëse e propozuan ata këtë çështje, ne kërkojmë më parë që, kur të mblidhen delegacionet e të dyja palëve, të na jepen shpjegime për të, të sqarohet se si do të bëhen llogaritë.

Për sa i përket çështjes së transportit fob<sup>1</sup> mendoj që edhe kjo të studiohet një çikë më thellë e të diskutohet nga të dy delegacionet. Duhet që të dyja palët çdo gjë ta ndreqim me mirëkuptim, pse, po humbi mirëkuptimi, nuk do të jetë mirë as për ata e as për ne. «Ne dëshirojmë dhe kërkojmë, — mund t'u thuhet kinezëve, — që mallrat e prapambetura të na livrohen sa më parë». E kam fjalën për mallrat e tregtisë dhe jo për mallrat që na jepen me kredi, se këto janë një çështje tjetër dhe që i takon qeverisë së tyre për ta shikuar bashkë me këto çështje që do të trajtohen nga delegacioni ynë. Edhe kjo ka rëndësi t'u thuhet, se kështu i kujtojmë që ne kemi për të folur edhe për këtë.

Çështja tjetër që duhet të ngremë me ta është se cilave probleme do t'u jepet prioritet dhe për këtë të përgatitemi mirë që më parë. Mendojmë se në këtë frymë duhen diskutuar me ta listat e mallrave, dome-

---

1. Fob: (germat e para të tri fjalëve anglisht: *fre on board*), term tregtar që do të thotë se shitësi i merr përsipër vetë shpenzimet e transportit deri te bordi i vaporit në portin prej nga nisen mallrat.

thënë t'u thuhet se përse nuk e merrni këtë ose atë mall. Për shembull, cigare ju keni marrë ngahera, prandaj mendojmë se duhet të na i merrni edhe tani.

Me sa na tregojnë dhe me sa kemi lexuar për ato që kanë deklaruar ata, del se «katërshja» i ka dëmtuar edhe në ekonomi. Kjo, natyrisht, është një çështje që ka të bëjë me punët e tyre të brendshme. Kurse kërkesat tona, si ato të eksportit, ashtu edhe të importit, mendojmë se duhet të diskutohen në frymë miqësore, shoqërore e tregtare. Natyrisht, ne nuk duam t'u imponojmë atyre mallrat tona, por dihet se po këto mallra prej shumë kohësh kanë qenë dhe janë të vlefshme edhe tash për konsumin e tyre. Puna është këtu, që duhen gjetur argumentimi e formulimi sa më i mirë i këtyre çështjeve. T'u theksohet bashkëbiseduesve kinezë që «ne dëshirojmë të jemi korrektë me ju për këto probleme, por edhe ju, nga ana juaj, duhet të jeni korrektë me ne».

Pra, duhet përgatitur mirë për këtë punë dhe të shkohet për bisedime me kinezët, por duke qenë sa më korrektë. Ne të kërkojmë që të bëhen bisedime reciproke dhe të përpiqemi t'i vëmë gjërat në rrugë një për një.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar, që gjendet në AQP*

# PËRSËRI PËR ARTIKULLIN KINEZ QË FLET PËR TEORINË E «TRI BOTEVE»<sup>1</sup>

Shënime

3 nëntor 1977

Ky është një artikull antimarksist, se mohon revolucionin proletar dhe merr në mbrojtje imperializmin, borgjezinë dhe reaksionin ndërkombëtar. Nëpërmjet tij predikohet uniteti i proletariatit me kapitalizmin dhe synohet të përgatitet terreni që Kina të bëhet një superfuqi. Teza mbizotëruese e kinezëve edhe në këtë artikull është kundërshtimi i socialimperializmit sovjetik, por, për demagogji, për të gënjyer më mirë lexuesit e shtypit ose dëgjuesit dashamirë të radios së tyre, ata, përkrah socialimperializmit sovjetik, vënë edhe imperializmin amerikan. Këtë gjë kinezët e bëjnë për arsye se e panë që teza e tyre, sipas së cilës «imperializmi amerikan është bërë si një mi. . .», nuk pati jehonë të mirë dhe u demaskua.

Në këtë artikull del se «miu» nuk qenka më mi,

---

1. Lidhur me këtë artikull të kinezëve, shoku Enver Hoxha ka hedhur në Ditar refleksionet e para të tij në datën 31 tetor 1977. Shih: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 653.

por një superfuqi, me ekonomi të fortë dhe me potencial ushtarak të madh, me prirje për një ekspansion të gjerë ekonomik në të gjithë botën. Edhe Bashkimi Sovjetik po i tillë na qenka, veçse ai, sipas revizionistëve kinezë, është më agresiv se i pari.

Nga studimi me kujdes i këtij artikulli, shihet se revizionistët kinezë bëjnë përpjekje të vënë në gojë të Mao Ce Dunit disa fraza për domosdoshmërinë e forcimit të kompaktësisë me vendet socialiste, për kompaktësinë me proletariatin botëror e me kombet e shtypura etj. Kurse në realitet ata po veprojnë në drejtim krejt të kundërt me ato që deklarojnë, sepse nuk po kryejnë asnjë nga këto detyra kundrejt vendeve socialiste dhe proletariatit botëror. Përkundrazi, gjithë politika e tyre synon që kompaktësia me proletariatin botëror të përçahet dhe kompaktësia me vendet socialiste të shpartallohet. Në fakt, revizionistët kinezë nuk janë e s'mund të jenë për kompaktësi me vendet socialiste gjersa ata i inkadrojnë në «botën e tretë».

Çështje tjetër për të cilën bëhet fjalë në artikull, është «faza e bukur» për luftën e domosdoshme kundër të gjitha shfaqjeve të shovinizmit të fuqisë së madhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, që revizionistët kinezë jo pa qëllim nuk mungojnë ta përsëritin me rast e pa rast. Në shqiptarët, që praktika e marrëdhënieve me Kinën na ka bërë ta shohim shumë të theksuar shovinizmin e shtetit të madh kinez, e kuptojmë mirë se këto fraza janë fund e krye një bluf. Kështu si ne mendojnë edhe shumë kombe e shtete të tjera në botë.

Revizionistët kinezë pretendojnë se, në periudha

të ndryshme, situatat ndërkombëtare duhen analizuar shkencërisht. Kjo tezë po theksohet prej tyre shumë herë, sepse me të duan, nga njëra anë, t'u mbushin mendjen të tjerëve që analizat e tyre qenkan të përpiktë, të kohës dhe, nga ana tjetër, të arsyetojnë disl devijimin strategjik dhe taktikat e tyre joproletare, pseudomarksiste, pra duan të fshehin daljen e tyre nga binarët e marksizëm-leninizmit. Këto slogane, sado shpesh të përdoren, nuk mund të maskojnë tradhtinë e revizionistëve kinezë.

Sipas revizionistëve kinezë teoria e «tri botëve» qenka shpikur nga kryetari Mao Ce Dun. Ata thonë se është Maoja ai që, «duke e parë realisht gjendjen e përgjithshme bashkëkohore të klasave në shkallë botërore, mbrojti dhe zhvilloi tezën bazë të marksizëm-leninizmit». Është një gjë e mirë që revizionistët kinezë e përcaktuan aftësinë e kësaj teze, sepse këtu duket zelli i tyre i tepruar për të bërë të vetat idetë e armiqve të marksizëm-leninizmit. Në realitet «tri botët» nuk i polli mendja e Mao Ce Dunit. Ky term është njohur në botë para se ta përdornin kinezët, pra para vitit 1974. Bota kapitaliste, që është kundër Marksit dhe Leninit, e ka përdorur termin «bota e tretë» për të treguar se krahas vendeve të mëdha e shumë të mëdha ekzistonin edhe vendet e vogla, të cilat porsa ishin çliruar. «Botën e tretë», këtë produkt të fjalorit kapitalist, që kishte të bënte vetëm me nivelin e zhvillimit ekonomik të këtyre vendeve, revizionistët kinezë e kanë kopjuar dhe e kanë përcaktuar si një «forcë të madhe lëvizëse», gjoja duke pasur si bazë marksizëm-leninizmin! Nuk mund të pranohet që teoria e «tri

botëve» na qenka një «përcaktim marksist i situatës bashkëkohore botërore», siç theksojnë propagandistët në Pekin.

Në këtë artikull pretendohet se shfaqjet e jetës politike ndërkombëtare bashkëkohore kinezët i shikojnë nga pozitat e materializmit dialektik, duke u nisur nga realiteti, dhe predikojnë që edhe të tjerët t'i shohin këto probleme nga të njëjtat pozita. «Për të vërtetuar» teorinë e tyre antimarksiste, artikullshkruesit kanë cituar në mënyrë të cunguar Leninin dhe Stalinin, të cilët me shumë të drejtë kanë thënë se problemet kombëtare dhe ndërkombëtare duhet t'i vështrojmë në shkallë botërore e jo në mënyrë të veçuar. Këta marksistë të shquar dhe udhëheqës të proletariatit botëror e shikonin botën në prizmin e revolucionit proletar, në prizmin e aleancës së proletariatit me popujt e shtypur. Revizionistët kinezë, në kundërshtim flagrant me mësimet e Leninit e të Stalinin që citojnë, i shikojnë problemet kombëtare e ndërkombëtare jo në prizmin klasor e nga pozitat e materializmit dialektik e historik, por në mënyrë idealiste dhe metafizike. Ata i trajtojnë këto çështje në bazë të zhvillimit që i intereson Kinës aktualisht për t'u bërë lidërsip i vendeve që ajo i quan të «botës së tretë». Ky është një nga qëllimet e tyre.

Oportunistët kinezë shkruajnë se «teoria» e Mao Ce Dunit për ndarjen në «tri botë», në shikim të parë duket sikur ka të bëjë vetëm me marrëdhëniet bashkëkohore midis vendeve dhe midis kombeve. Ne nuk nxjerrim konkluzione duke u nisur nga një «shikim i parë». Marrëdhëniet midis vendeve e kombeve ekzistojnë rea-



lisht, por ne marksistë-leninistët duhet t'i shikojmë këto marrëdhënie dhe perspektivat e tyre në prizmin e interesave të revolucionit. Pikërisht këtë gjë nuk e bëjnë kinezët, që interesat e tyre të shtetit të madh dhe të luftës që bëjnë për të udhëhequr «botën e tretë», ia kundërvënë revolucionit. Lufta e klasave duhet të zhvillohet edhe në vendet e ashtuquajtura të botës së tretë, po në ç'prizëm? Ne themi: në prizmin e revolucionit dhe të përmbysjes së borgjezisë shfrytëzuese, të kapitalizmit barbar, kurse oportunistët kinezë janë për pajtimin klasor. Ata, sa për të qenë brenda, thonë nga një fjalë se këto ose ato çështje duhen shikuar në prizmin klasor, por, për të mohuar vështrimin klasor, aty për aty shtojnë se këto çështje qenkan «jashtëzakonisht të ndërlikuara dhe në të njëjtën kohë të lidhura reciprokisht». Kjo do të thotë se zhvillimi i luftës klasore sidomos në vendet e «botës së tretë» nuk qenka kaq i lehtë për t'u kuptuar, se shumë çështje të luftës së klasave nuk mund të zgjidhen veçse me ndihmën e «dijetarëve të shquar kinezë», prandaj fytyra duhet kthyer nga Kina! Ata pohojnë se, për të nxjerrë konkluzione për fenomenet e jetës politike ndërkombëtare dhe për të bërë një ndarje të drejtë të forcave politike në botë, duhet nisur nga lufta ndërkombëtare e klasave në tërësi dhe problemet konkrete të analizohen konkretisht në lidhje me kohën, me vendin dhe me kushtet e caktuara. Megjithëse thonë kështu, në praktikë, në jetë, ata veprojnë ndryshe, bëjnë të kundërtën, duke i interpretuar e duke i lidhur fenomenet dhe ngjarjet e jetës në mënyrë abstrakte, irrealë, koniunkturale. Termat «idealiste», «metafizike», «abstrakte», «të izoluar»

etj. revizionistët kinezë i përdorin për ata njerëz dhe parti që nuk i pranojnë sofizmat e tyre. Me këto slogane ata na drejtohen edhe neve, megjithëse e dinë se nuk jemi ne dhe marksistë-leninistët e tjerë të vërtetë në botë, por janë pikërisht revizionistët kinezë që, si gjithë revizionistët e tjerë, kuptimin dhe zbatimin e marksizëm-leninizmit, në teori e në praktikë, i kanë bastarduar si mos më keq.

Kinezët deklarojnë me të madhe se «marksistë-leninistët duhet të qëndrojnë në pozitë e proletariatit ndërkombëtar, të mbrojnë gjithnjë interesat e përbashkët të popujve revolucionarë të botës në luftën ndërkombëtare të klasave, të mbrojnë dhe të luftojnë gjithnjë për programin e tyre maksimal: zëvendësimin e rendit kapitalist me atë komunist». Në përgjithësi këto deklarime në artikullin kinez bëhen për demagogji dhe vetëm për të maskuar qëndrimet e tyre, sepse ata kurrë nuk kanë luftuar e nuk po luftojnë nga pozitë e proletariatit ndërkombëtar, nuk i kanë mbrojtur e nuk po i mbrojnë interesat e popujve revolucionarë. Të mbash lidhje me reaksionin dhe me fashistët më gjaktarë si me Pinoçetin, me shahun e Iranit e me Mobutun, që janë gjakpirës nga më të mëdhenjtë të popujve, do të thotë të mos i përfillësh aspak interesat e proletariatit ndërkombëtar, as interesat e proletariatit të një vendi të vetëm, që përputhen me ata të proletariatit ndërkombëtar. Frazë bombastike janë tjerrë pa kursim nga ana e kinezëve, por ne nuk i gjujmë fjalët e tyre të shkëputura nga veprat. Kur bëhet krahasimi i frazave marksiste-leniniste të kinezëve me qëndrimet e tyre në pra-

ktikë, atëherë del në pah falsiteti i teorive që ata zbatojnë.

Udhëheqësit revizionistë kinezë e mësojnë proletariatin që në zhvillimin e luftës në arenën ndërkombëtare, në periudha të caktuara historike, të përpiqet për të bashkuar të gjithë ata që mund të bashkohen, në mënyrë që të zgjerohen forcat përparimtare. Po, në realitet, ç'qëndrim mbajnë revizionistët kinezë në këtë drejtim? Ata i bëjnë apel proletariatit ndërkombëtar që ky të bashkohet deri edhe me reaksionin më të zi!

Kinezët në këtë artikull «këshillojnë» që në periudha historike të ndryshme proletariati duhet të zgjedhë aleatët e vet. Mirëpo kësaj teze të drejtë vetë ata i bëjnë bisht, duke i rekomanduar proletariatit ndërkombëtar që të pajtohet me reaksionin botëror dhe të bashkohet me forcat politike reaksionare. Më poshtë, «për të vërtetuar» qëndrimet e tyre gjoja të drejta, kinezët vazhdojnë me paraqitjen në artikull të serisë së citateve të Leninit dhe të Stalinit, të cilat i cungojnë e i shtrembërojnë me paturpësi. Po cilat qëndrime duan «të vërtetojnë» kinezët? Fjala është për ato që kanë lidhje me «analizat reale» të tyre për sa i përket gjendjes botërore, gjoja të mbështetura në marksizëm-leninizmin. Në këto «analiza» kinezët përdorin shumë nga ato citate të Leninit dhe të Stalinit që kemi vënë edhe ne në materialet tona, si për shembull, «...tani, në botë ka dy botë, bota e vjetër — kapitalizmi...», dhe bota e re që po lind...» që e ka thënë Lenini më 1921; ose fjalët e Stalinit se «Bota është e ndarë në mënyrë të vendosur dhe përfundimisht në dy kampe: kampi i imperializmit dhe kampi i socializmit».

Këto dy mendime të mëdha të Leninit e të Stalinit përbëjnë bazën themelore të analizës për çdo periudhë lidhur me ndarjen e forcave politike në botë, mirëpo kinezët, meqenëse kështu u përmbysët teoria për «tri botët», nuk mungojnë të theksojnë përnjëherë se këto dy citate «reflektojnë një kontradiktë të re themelore që u shfaq në botë pas Revolucionit të Tetorit». Pra, sipas tyre, edhe këto përcaktime na qenkan vjetruar, u paska kaluar koha! E gjetën kështu një «arsye të bukur» për të mbrojtur shpikjen e «tri botëve». Kinezët thonë se «Lenini dhe Stalini asnjëherë nuk kanë menduar se në botë nuk ka kontradikta të tjera themelore, se forcat politike në botë nuk mund të ndahen në një mënyrë tjetër». Ky «arsyetim» nuk është aspak i nevojshëm dhe shërben vetëm sa për të mbushur radhët e artikullit dhe për të krijuar përshtypjen e «arsyetimeve», e «argumenteve» në polemikë, për arsye se askush nuk ka thënë që Lenini dhe Stalini kanë menduar ndonjëherë se në botë nuk ekzistojnë edhe kontradikta të tjera kryesore. Lenini dhe Stalini, si materialistë dialektikë që ishin, i kanë përcaktuar drejt kontradiktat, por oportunistët kinezë, duke qenë eklektikë, nuk i përcaktojnë fare këto kontradikta në artikullin e tyre, sepse, po të ndërmerrenin një punë të tillë, atëherë do të dilte sheshit falsiteti i pikëpamjeve të tyre dhe do të dukej shtrembërimi që i bëjnë ata Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Kinezët orvaten «të provojnë» që teoria e «tri botëve», atësinë e së cilës ia njohin absolutisht Mao Ce Dunit, na qenka vazhdim i tezave të Leninit, i cili qysh

më 1920, në Kongresin e 2-të të Internacionales Komuniste, thoshte:

*«Një tipar karakteristik i imperializmit ësh-të se gjithë bota. . . ndahet sot në një numër të madh popujsh të shtypur dhe në një numër fare të vogël popujsh shtypës, të cilët zotërojnë pasurira kolosale dhe një forcë ushtarake të madhe»<sup>1</sup>.*

Këto mendime të Leninit janë të drejta dhe nuk i kundërshton asnjëri, por nuk vërtetojnë aspak se bota qenka e ndarë në tri pjesë, sipas oreksit të revizionistëve kinezë. Çdo analizë politike dhe ekonomike që raund t'i bëhet botës, në bazë të teorisë leniniste, do ta nxjerrë medoemos në evidencë karakteristikën thelbësore të ndarjes së saj në kapitaliste dhe në socialiste, ndryshe analiza nuk mund të jetë leniniste. Kjo analizë nuk vjen aspak në kundërshtim dhe nuk mohon faktin që në botë ekzistojnë kombe shfrytëzuese dhe të shfrytëzuara. Kurse të citosh Leninin për të provuar se në bazë të ideve të tij bota u dëshka ndarë në tri, një gjë të tillë mund ta bëjnë vetëm shtrembëruesit e leninizmit. Dhe shtrembëruesit e leninizmit në këtë ndarje fiktive të botës janë revizionistët kinezë.

Le të marrim citatin tjetër që Stalini e ka përdorur më 1924 në veprën e tij «Mbi bazat e leninizmit», ku shkruan:

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 31, f. 264.

a) bota është ndarë në dy kampe: në kampin e një grushti të vogël kombesh të qytetëruara, që zotërojnë kapitalin financiar dhe shfrytëzojnë shumicën dërrmuese të popullsisë së lëmshit tokësor, dhe në kampin e popujve të shtypur dhe të shfrytëzuar të kolonive dhe të vendeve të varura, që përbëjnë këtë shumicë»<sup>1</sup>.

Këtë citat kinezët e përmendin «për të vërtetuar» se në botë, përveç kontradiktës themelore, së cilës i referohen Lenini e Stalini, ekzistojnë edhe kontradikta të tjera, që gjoja ne komunistët shqiptarë i paskemi harruar!

Ne nuk i harrojmë këto kontradikta, përkundrazi, i kemi theksuar vazhdimisht. Nuk harrojmë se, duke marrë parasysh rollin e kontradiktave, këto ndahen në kontradikta kryesore dhe jokryesore, se në proceset e ndërlikuara që vërehen në sendet dhe në fenomenet e botës reale, pleksen lloj-lloj kontradiktash kryesore dhe jokryesore, por, për të studiuar dhe për të analizuar drejt proceset e ndërlikuara, duhet të zbulohet kontradikta më kryesore, pra kontradikta themelore që përcakton zhvillimin e të gjitha kontradiktave të tjera dhe nga zgjidhja e së cilës varet zgjidhja e të gjitha kontradiktave të tjera. Ne jo vetëm nuk i kemi harruar, por u përmbahemi me vendosmëri ligjeve të dialektikës. Revizionistët kinezë duan t'i shmangen dialektikës materialiste dhe të maskohen me citatet e shumta, të marra andej-këtej nga klasikët e marksizëm-

1. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 6, f. 148.

-leninizmit, të cilat i ndajnë e i bashkojnë në mënyrë të tillë në këtë artikull që jo vetëm të mos kuptohen drejt, por bile të shtrembërohet kuptimi në drejtim të kundërt me atë që e kanë thënë shumë qartë autorët e tyre.

Cilët janë ata komunistë të vërtetë që mohojnë, siç pretendojnë kinezët, se, kur duhej të bëhej një ndarje e gjithanshme dhe konkrete e forcave politike në botë në këtë apo në atë periudhë, Lenini dhe Stalini i analizonin kontradiktat themelore të botës në gjithë tërësinë e tyre? Të gjithë marksistë-leninistët në botë njohin faktin që për përcaktimin e epokës së sotme duhen analizuar në tërësinë e tyre kontradiktat kryesore, për të përcaktuar kontradiktën themelore. Janë pikërisht kinezët ata që i shmangen këtij shikimi realist të ndarjes së forcave politike në botë. Ndarja e botës në «botë të parë», «të dytë» e «të tretë», siç bëjnë kinezët, do të thotë mbulim i kontradiktave, mënjanim i njërës apo i tjetrës kontradiktë të madhe shoqërore dhe jo analizë e tyre në tërësi.

Edhe citatet e Marksit e të Engelsit revizionistët kinezë i përdorin vend e pa vend dhe u japin ato interpretime që mendojnë se u shërbejnë për të vërtetuar tezat e tyre antimarksiste. Ata citojnë thirrjen e famshme të Marksit dhe të Engelsit në «Manifestin e Partisë Komuniste»: «Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!» dhe pastaj shtojnë se, krahas kësaj, ata treguan për herë të parë «lidhjen e pandashme të çështjes së proletariatit ndërkombëtar me luftën çlirimtare të kombeve të shtypura». Këto janë të vërteta dhe dihen, por janë vetë kinezët ata që harrojnë se thirrja e Mark-

sit dhe e Engelsit doli që t'i bënte të njohur proletariatin botëror se kontradikta themelore e shoqërisë njerëzore tashmë ishte ajo midis punës e kapitalit, borgjezisë dhe proletariatit, i cili do ta zgjidhte këtë kontradiktë me revolucion. Revizionistët kinezë nuk flasin fare për lidhjen e luftës së proletariatit me luftën nacionalçlirimtare të popujve të shtypur, as për revolucionin proletar, por e vënë theksin në unitetin e proletariatit e të popujve që shtypen dhe shfrytëzohen, me shtypësit e shfrytëzuesit e tyre më barbarë dhe më të egër, me imperializmin amerikan dhe me borgjezinë reaksionare botërore!

Revizionistët kinezë përmendin në artikullin e tyre citatin e Engelsit, i cili ka thënë:

*«Asnjë komb nuk mund të jetë i lirë, sa kohë që vazhdon të shtypë kombet e tjera. Pra, Gjermania nuk mund të çlirohet pa u çliruar Polonia nga shtypësit gjermanë»<sup>1</sup>.*

Po çfarë duan të provojnë kinezët me këtë citat të Engelsit? Ata e kanë hallin «të vërtetojnë» se proletariati sovjetik nuk mund të pretendojë që lufton për çlirimin e popujve të tjerë, kur vetë i skllavëroka ata, se edhe proletariati i vendeve të Evropës Perëndimore, proletariati amerikan, proletariati i vendeve kapitaliste të «botës së tretë» për të njëjtën arsye nuk meritojnë të luftojnë për çlirimin e popujve të ndryshëm.

---

1. K. Marks — F. Engels, «Për lëvizjen nacionalçlirimtare», bot. shqip, 1936, f. 37.



Po atëherë kush qenka i denjë të luftojë për çlirimin e popujve? Sipas artikullit kinez del se vetëm Kina mund ta zhvilloka këtë luftë! Thënien e drejtë të Engelsit ata e vendosin diku në artikullin e tyre, pa bërë aspak diferencimin mes proletariatit rus e të vendeve të tjera, nga njëra anë, dhe shtypësve të tyre, nga ana tjetër, duke mos u bërë thirrje atyre që të ngrihen në revolucion kundër shtypësve dhe kundër një lufte imperialiste. Proletariati në çdo vend ku është i shtypur, duhet të ngrihet në luftë tok me aleatët e vet të natyrshëm për të realizuar misionin historik. Në qoftë se citati i Engelsit kuptohet jo ashtu siç është thënë nga Engelsi, por siç e interpretojnë revizionistët kinezë, atëherë nuk mund të kemi shpresa për revolucionin proletar. Pikërisht «komentet» që artikulli kinez u bën tezave të drejta të Marksit dhe të Engelsit përputhen tërësisht me pikëpamjet antimarksiste të revizionistëve kinezë.

Marksit dhe Engelsi i vinin rëndësi të madhe çlirimit të popujve të Polonisë, të Irlandës, të Kinës, të Indisë, sepse këta popuj ishin më të shtypurit. Të shtypur nga klikat sunduese borgjeze janë sot edhe proletariati francez, spanjoll, rus dhe amerikan. Ky proletariat nuk duhet të mënjanohet nga skena politike, përkundrazi, lypset të thotë fjalën e tij për të gjitha ato që po ngjasin dhe për të gjitha ato që po bëjnë sundimtarët imperialistë dhe tradhtarët socialimperialistë në vendet kapitaliste e revizioniste. Prandaj komunistët e vërtetë duhet t'i bëjnë thirrje proletariatit në këto vende që të ngrihet në revolucion dhe të përmbysë klikat borgjeze e tradhtarë që sundojnë popujt.

Klasikët tanë çdo lëvizje kombëtare dhe forcat e ndryshme politike i shikonin në prizmin e interesave të proletariatit ndërkombëtar; ata na kanë mësuar se revolucioni mund të triumfojë në hallkën më të dobët të kapitalizmit botëror. Mësuesit tanë të mëdhenj na mësojnë, gjithashtu, se pavarësia e një populli, e fituar me revolucion, ndihmon edhe çlirimin e popujve të tjerë, qofshin këta të Evropës, të Azisë apo të pjesëve të tjera të botës. Revizionistët kinezë nuk nisen nga këto konsiderata marksiste. Përkundrazi, ata i shikojnë lëvizjet kombëtare dhe forcat e ndryshme politike në prizmin e interesave të tyre për t'u bërë superfuqi, prandaj kanë përkrahur dhe përkrahin jo luftën e popujve për pavarësi, por klikat reaksionare që sundojnë mbi këta popuj. Kjo është arsyeja që proletariatit kinezët i predikojnë paqen sociale dhe bashkëpunimin me borgjezinë.

Me qëllim që të vërtetojnë tezën e tyre që «socialimperializmi sovjetik është bërë armiku kryesor i popujve të botës, se ai është qendra e reaksionit botëror, që kërcënon botën me një luftë», revizionistët kinezë në artikullin e tyre u referohen Marksit dhe Engelsit, duke cituar mendimet e shprehura prej tyre që më 1848 për rrezikshmërinë e carizmit. S'ka asnjë dyshim që carizmi ka qenë bastioni i reaksionit evropian, prandaj ai duhej luftuar dhe këtë luftë e bëri Lenini me bolshevikët rusë, me të cilët u bashkua proletariati i të gjitha vendeve të botës. Mirëpo mendimet shumë të drejta të Marksit kundër carizmit nuk vërtetojnë aspak atë që dëshirojnë kinezët aktualisht, së vetëm socialimperializmi sovjetik na qenka armiku

kryesor i popujve të botës. Ne, duke u nisur nga analiza marksiste-leniniste, ngulim këmbë se armiq të popujve, përveç socialimperializmit sovjetik, janë edhe imperializmi amerikan bashkë me gjithë reaksionin botëror. Të tërë këta armiq, në unitet dhe në kontradiktë me njëri-tjetrin, janë në luftë me proletariatin botëror në përgjithësi, si dhe me proletariatin e çdo vendi të veçantë. Ata janë të tërë në luftë me popujt që kërkojnë çlirim kombëtar e shoqëror, prandaj proletariati dhe popujt duhet të lidhen në unitet të çeliktë midis tyre për të luftuar armiqtë e rrezikshëm që kanë përpara.

Revizionistët kinezë na thonë se Marksi dhe Engelsi jo vetëm që nuk e harronin luftën e klasave në shkallë ndërkombëtare, por, duke i vënë gishtin reaksionit carist rus, ata mbanin parasysh interesat rrënjësorë të proletariatit botëror. Çfarë demagogësh që janë! Kur ata u besokan Marksit dhe Engelsit, përse nuk i zbatojnë mësimet e tyre? Përse bëjnë të kundërtën dhe hyjnë në aleancë me imperializmin amerikan, me imperializmin anglez, me atë francez, gjerman etj.? Nga studimi i Marksit del se, për të realizuar aspiratat e tij, proletariati, nëpërmjet zhvillimit të luftës së klasave në shkallë ndërkombëtare, kurrë nuk duhet të bashkohet me këtë reaksion të zi ndërkombëtar. Hovin revolucionar të popujve në luftë për çlirim nuk mjafton vetëm «ta përshëndetim», siç bëjnë revizionistët kinezë, por këtë hov duhet të dimë edhe ta orientojmë sa më mirë sipas mësimëve të katër klasikëve tanë të mëdhenj — Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit (jo edhe të ideve idealiste e eklektike të Mao Ce Dunit), të cilët na e kanë përcaktuar mirë se ç'duhet bërë për

t'ia arritur çlirimit të popujve nga zgjedha e kapitalit.

Për të treguar se gjoja janë me Leninin dhe, për ta përdorur emrin e Leninit si maskë për të fshehur antileninizmin e tyre, revizionistët kinezë e kanë mbushur artikullin e vet, midis të tjerash, edhe me citate të gjata të marra nga artikulli i Leninit «Fatet historike të doktrinës së Karl Marksit», ku ai shkruante:

*«Oportunistët s'kishin mbaruar mirë së mburruri «me paqen sociale» dhe me fjalët se shtrëngatat në kushtet e «demokracisë» nuk janë më të domosdoshme, kur doli në shesh një burim i ri shtrëngatash të mëdha botërore në Azi. Pas revolucionit rus shpërthyen revolucioni turk, revolucioni persian, revolucioni kinez»<sup>1</sup>.*

Po kështu mund të themi edhe për citatin tjetër të nxjerrë nga shkrimi i Leninit i vitit 1916 «Mbi karikaturën e marksizmit dhe «mbi ekonomizmin imperialist»», sipas të cilit:

*«Revolucioni social nuk mund të kryhet ndryshe, veçse në formën e një epoke që bashkon luftën civile të proletariatit kundër borgjezisë në vendet e përparuara me një varg të tërë lëvizjesh demokratike dhe revolucionare, duke përfshirë edhe lëvizjet nacionalçlirimtare në kombet e pazhvilluara, të prapambetura dhe të shtypura»<sup>2</sup>.*

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 18, f. 653.

2. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 23, f. 63.

Revizionistët kinezë, për të mos u ngatërruar gjatë, u bëjnë një «koment» shumë të shkurtër këtyre citateve dhe konkretisht: «Kjo pikëpamje leniniste sigurisht që e ruan forcën edhe sot». Por, në qoftë se e analizojmë vijën e Partisë Komuniste të Kinës sot, ajo është në kundërshtim flagrant me këto teza të mëdha të Leninit dhe me leninizmin në tërësi. Lenini kurrë nuk i këshilloi popujt që lëvizjet demokratike dhe revolucionare apo lëvizjet nacionalçlirimtare të drejtohen vetëm kundër armiqve të jashtëm imperialistë e jo edhe kundër armiqve të brendshëm, bashkëpunëtorë të imperializmit, siç bëjnë oportunistët kinezë. Këta «kanë harruar t'i zbatojnë» mësimet e Leninit për luftën e proletariatit në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.

Në Kongresin e 2-të të Internacionales Komuniste Lenini ka mbajtur raportin për gjendjen ndërkombëtare dhe për detyrat themelore të kësaj Internacionaleje. Ai, duke analizuar qëllimet e luftës imperialiste dhe duke paraqitur gjendjen e botës pas kësaj lufte, thotë se një pjesë e popullsisë së botës jeton në vendet koloniale, një pjesë në vendet që mundën të ruajnë gjendjen e vjetër, dhe më në fund përmend banorët e pak vendeve që përfituan nga ndarja e botës. Ky bilanc i pasojave të luftës imperialiste, i bërë nga Lenini në korrik të vitit 1920, është plotësisht i drejtë, por nuk mund të shërbejë aspak për të argumentuar tezën oportuniste kineze të «tri botëve» apo të «tri grupeve», siç thonë ata. Kur Partia jonë hedh poshtë teorinë antimarksiste kineze për «tri botët» ajo është udhëhequr plotësisht nga mësimet e Leninit dhe ka pasur para-

sysh dhe raportin e Leninit në Kongresin e 2-të të Internacionales Komuniste. Kurse revizionistët kinezë e citojnë këtë analizë marksiste të Leninit për të krijuar fokusin që mendimi i tij për shkaqet dhe pasojat e luftës imperialiste ndaj popujve të botës na qenka njësoj si ai i «tri botëve» të Mao Ce Dunit dhe, si konkluzion, edhe aleancat e proletariatit me popujt e shtypur kundër borgjezisë reaksionare, që predikonte Lenini, janë njësoj me aleancat që predikon Mao Ce Duni! Po të ishte se me të vërtetë Lenini në Kongresin e 2-të të Kominternit ka dashur të thotë se bota është ndarë në tri pjesë, siç ua do oreksi revizionistëve kinezë, ai nuk do të kishte deklaruar një vit më vonë, në dhjetor të vitit 1921, në Kongresin e 9-të të Sovjetëve të Ruisë, se «Tani në botë ka dy botë», por do të kishte folur për tri botë.

Lenini nuk ka thënë as më 1920, as më parë dhe as më pas që proletariati të bashkohet me imperializmin amerikan, me imperializmin anglez. Përkundrazi, ai ka theksuar kontradiktën themelore midis proletariatit e borgjezisë dhe ka treguar rrugën e çlirimit të proletariatit nëpërmjet revolucionit proletar dhe të çlirimit të popujve të shtypur nëpërmjet luftërave nacionalçlirimtare. Kurse teoria e «tri botëve» këto mësimë të Leninit i injoron, ajo nuk shtron asnjë detyrë për revolucionin.

Për përgatitjen e artikullit të tyre kinezët i janë vënë punës së grumbullimit të një numri të madh citatesh nga Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Këto citate mund të zënë një të tretën e gjithë artikullit dhe përdoren me qëllim që «të vërtetojnë» ato që nuk

mund të vërtetohen. Ata shkëputin nga konteksti citate të cingura për t'ia përshtatur teorisë së tyre të «tri botëve», të cilën e paraqesin sikur na qenka marksiste-leniniste dhe u bazoka në mësimet e klasikëve tanë të mëdhenj! Ata mendojnë se këto citate mund të interpretohen arbitrarisht dhe në mënyrë të shumëllojshme, duke i manipuluar, sipas dëshirës, edhe të djathtët, edhe të majtët. Shpërdorimi i citateve për të bashkuar mekanikisht e në mënyrë të paprincipitë pikëpamjet e klasikëve me pikëpamjet e tij janë qëndrime tipike të eklektizmit kinez të Mao Ce Dunit. Ky, sikurse e kam thënë edhe herë të tjera, ka pohuar vetë se mendimet e tij do të shfrytëzohen edhe nga të majtët, edhe nga të djathtët. Një interpretim i tillë evaziv mund t'u bëhet mendimeve të oportunistëve, atyre që lëkunden midis materializmit dhe idealizmit, sofistëve etj., por jo klasikëve tanë të mëdhenj, Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, për arsye se këta janë teoricienë të një doktrine të madhe shkencore, e cila i parashikon drejt të sotmen e të ardhmen dhe nuk lejon që në dinamizmin e zhvillimit dialektik të ngjarjeve t'u bëhen interpretime false periudhave historike. Analizat e klasikëve tanë mbështeten në të vërteta të pamohueshme, prandaj kush i kupton ato, mund të ballafaqojë me to veprimet e tij për të parë nëse janë të drejta këto veprime apo jo. Kush i shtrembëron konkluzionet e këtyre analizave, nuk mund të vërtetojë veprimet e tij të drejta me citate të cingura e me interpretime absurde. Marksistët e vërtetë i konfrontojnë veprimet e tyre me idetë e klasikëve të marksizëm-leninizmit, kurse renegatët tentojnë që veprimet e tyre të mbrapshta t'ua

imponojnë klasikëve nëpërmjet cungimit të citateve, interpretimeve arbitrare, falsifikimeve etj.

Kështu kanë bërë edhe revizionistët kinezë me numrin e madh të citateve që sjellin në artikullin e tyre. Dhe ata kanë bërë kështu, sepse nuk janë në gjendje të vërtetojnë tezat e tyre oportuniste. Le të marrim ndonjë shembull sa për ilustrim. Stalini, duke folur për karakterin e lëvizjeve të ndryshme nacionale në vepërn e tij «Mbi bazat e leninizmit», arrin në konkluzionin se karakteri revolucionar apo reaksionar i një lëvizjeje nacionale duhet gjykuar nga fakti nëse ajo objektivist drejtohet për të prishur dhe për të shkallmuar imperializmin, apo për ta konsoliduar fitoren e imperializmit.

*«Lufta e emirit të Afganistanit për pavarësinë e Afganistanit, — thotë Stalini, — objektivist është një luftë revolucionare...»<sup>1</sup>.*

Stalini ka të drejtë, se ky emir, për të cilin bëhet fjalë, i griu ushtritë angleze në qafat e Pamirit; nga gjithë ajo ushtri e madhe e pushtuesve anglezë arritën të dilnin në Indi vetëm 3 veta, në mes tyre një mjek. Këtë shembull të Stalinit, që me të drejtë i referohet një rasti historik konkret, revizionistët kinezë e absolutizojnë për të dalë me konkluzionin sikur paskan autorizimin e Stalinit për të ndihmuar dhe për të përkrahur të gjithë mbretërit e princërit reaksionarë të botës, gjer edhe Mobutun, i cili nuk është gjë tjetër

1. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 6, f. 146-147.



veçse një agjent i imperializmit amerikan, një shtypës «modern» i popullit kongolez.

Për të përligjur aleancën që predikojnë tash midis proletariatit dhe popujve të shtypur me imperializmin amerikan dhe me imperialistët e tjerë botërorë kundër socialimperializmit sovjetik, revizionistët kinezë nuk mungojnë të sjellin si «argument» aleancën e madhe antifashiste midis Bashkimit Sovjetik dhe anglo-amerikanëve kundër Gjermanisë hitleriane në Luftën e Dytë Botërore. Ky arsytim ala kinez është aq absurd, sa nuk mund të shërbejë ndryshe veçse për të demaskuar autorët e tij. Faktet dhe ngjarjet historike duhen konceptuar të lidhura ngushtë me kushtet dhe rrethanat e kohës së tyre.

Në një shkrimin tim të mëparshëm kam thënë se është e vërtetë që Stalini dhe qeveria sovjetike u propozuan anglezëve dhe francezëve një aleancë për të penguar luftën agresive që kishte shpallur Hitleri duke pushtuar Çekoslllovakinë. Dihet se Bashkimi Sovjetik dhe Franca në atë kohë kishin një marrëveshje për t'i ardhur në ndihmë Çekoslllovakisë, në rast se kjo do të sulmohej nga një fuqi e tretë. Franca nuk i mbajti premtimet dhe, pas tradhtisë së Mynihut nga «demokracitë» perëndimore, Çekoslllovakia u pushtua nga hitlerianët. «Demokracitë» perëndimore, pas këtij akti, u përpoqën ta drejtonin Gjermaninë hitleriane drejt Lindjes. Franca dhe Anglia, duke e parë rrezikshmërinë hitleriane, u orvatën për një «unitet luftarak» me Bashkimin Sovjetik, i cili u tregua i gatshëm. Por kjo ishte një «vënie në skenë» qesharake nga ana e Anglisë dhe e Francës. Bashkimi Sovjetik dhe Stalini, duke i gjy-

kuar drejt situatat, duke e ditur rrezikun e agresionit hitlerian, për të fituar kohë, nënshkruan me Gjermaninë naziste «traktatin e mossulmimit». Ky ishte një akt në rrugën marksiste-leniniste. Hitleri sulmoi Poloninë, atëherë Anglia dhe Franca u futën në luftë dhe, kur Gjermania sulmoi Bashkimin Sovjetik u arrit aleanca antifashiste e Bashkimit Sovjetik me Anglinë.

Në këto momente ishte krejt e natyrshme që Bashkimi Sovjetik të hynte në aleancë me këto shtete imperialiste kundër fashizmit gjerman që kërcënonte botën. Lufta e Dytë Botërore, pra, filloi si një luftë grabitqare, por me hyrjen e Bashkimit Sovjetik në të, kjo u shndërrua në një luftë çlirimtare, prandaj nuk mund të barazohet veprimi i Stalinit dhe i qeverisë sovjetike në këtë aleancë antifashiste me aleancën që predikon aktualisht Kina me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me imperialistët e tjerë dhe me «botën e tretë», kundër Bashkimit Sovjetik. Historia nuk mund të falsifikohet, siç po bëjnë revizionistët kinezë për të fshehur tradhtinë e tyre.

Kina konsideron sikur jemi para një lufte iminente. Lufta imperialiste mund të bëhet, në mos sot, nesër. Por Ten Hsiao Pini ka deklaruar se për 20 vjet nuk do të ketë luftë, prandaj, sipas tij dhe teorisë oportuniste kineze të «tri botëve», popujt, gjatë këtyre dy dekadave, duhet të mos ngrihen në revolucion. Ata nuk duhet të luftojnë kundër shtypësve të brendshëm dhe të jashtëm, por të konsolidojnë aleancat me imperialistët e me shtypësit e tyre dhe të mbrojnë të gjitha marrëveshjet e aleancat grabitqare që kanë realizuar imperializmi amerikan dhe imperialistët e tjerë perëndimo-

rë. Kina, aktualisht, predikon që gjatë gjithë këtyre 20 vjetëve të ardhshëm të ketë qetësi.

Duke vështruar qëndrimet e Stalinit para Luftës së Dytë Botërore kundër nazizmit gjerman dhe kundër fashizmit italian, del qartë se krahasimi që përpiqen të bëjnë revizionistët kinezë nuk mund të përputhet me tezat e marksizëm-leninizmit, por del në pah edhe qëllimi përse bëhet ky krahasim. Arsyeja e predikimit të aleancës me imperializmin qëndron në faktin që Kina dëshiron të ketë mbështetjen e imperializmit amerikan dhe të vendeve të tjera kapitaliste të zhvilluara të botës për t'u bërë edhe ajo një superfuqi. Shantazhin e luftës iminente dhe të bombës atomike që bëjnë amerikanët dhe sovjetikët, po e praktikojnë edhe kinezët, me qëllim që të frikësojnë proletariatin, që ky të mos ngrihet në revolucion, që të mos krijojë dhe të mos i konsolidojë aleancat me fshatarësinë e varfër dhe me punonjësit e shfrytëzuar të vendit të vet dhe aleancat në platformën ndërkombëtare, por të rrijë i qetë, derisa Kina të bëhet një superfuqi dhe të kundërbalancojë dy superfuqitë e tjera, me një fjalë derisa të përgatitet edhe ajo për luftë grabitqare dhe për zënie tregjesh.

Kur lexon këtë «goxha» artikull të kinezëve për teorinë e «tri botëve», secilit i lind pyetja: Pse është shkruar ky dhe kujt i shërben? Duke arsyetuar, përnjëherë dilet në përfundimin që ky artikull drejtohet kundër tezave revolucionare të Kongresit të 7-të të Partisë sonë, si dhe kundër artikullit të gazetës «Zëri i popullit» të datës 7 korrik të këtij viti me titull «Teoria dhe praktika e revolucionit» dhe artikujve të tjerë

që kemi botuar ne. Tezat tona janë të drejta, luftarake, marksiste-leniniste dhe kanë për qëllim të shpjegojnë drejt situatën ndërkombëtare dhe proceset revolucionare që e karakterizojnë atë, për të armatosur komunistët shqiptarë dhe gjithë ata njerëz që i lexojnë e i studiojnë. Këto teza të Partisë sonë për të luftuar imperializmin, qoftë atë amerikan, qoftë atë sovjetik, si dhe imperialistët e tjerë dhe reaksionin botëror, i shërbejnë luftës për revolucion, për të ngritur popujt në luftëra nacionalçlirimtare kundër kapitalizmit brenda vendit dhe në shkallë ndërkombëtare. Këto janë qëllimet e tezave që kemi shtruar ne. Përkundrazi, qëllimi i botimit të këtij artikulli, nga ana e revizionistëve kinezë është shumë i keq, se ai injoron çështjen kryesore, atë të luftës që duhet t'u bëjnë gjithë popujt e botës armiqve të tyre kryesorë. Në artikullin kinez, nuk shikon të shtruar asnjë detyrë revolucionare, nuk shikon detyrën kryesore revolucionare, luftën nacionalçlirimtare të popujve kundër shtypësve të tyre kapitalistë, nuk shikon interesat e revolucionit botëror ose interesat e një vendi të veçantë në hallkën e dobët të imperializmit botëror.

Në këtë artikull nuk i gjen fare fjalët «revolucion» dhe «luftë nacionalçlirimtare». Pra, ky artikull nuk është bërë me qëllim që t'i nxitë popujt, t'i edukojë dhe t'u tregojë atyre rrugën e luftës. Atëherë ç'u tregon proletariati dhe popujve ky artikull i kinezëve? Është e qartë se qëllimi kryesor është: të demonstrojë se teoria e «tri botëve» e Mao Ce Dunit është në vetvete një teori gjoja e drejtë, gjoja marksiste-leniniste dhe kjo vetëm sa për t'i shërbyer kauzës së tyre antimarksiste.

Në funksion të këtij qëllimi kryesor është shkruar ky artikull.

Qëllimi tjetër është që të luftojë kundër nesh dhe të shuajë revolucionin, të shuajë luftën nacionalçlirimtare dhe të predikojë aleancën e proletariatit dhe të popujve të shtypur me borgjezinë reaksionare, me imperializmin amerikan, me imperializmin anglez, francez, japonez etj. Me një fjalë, sipas këtij artikulli, proletariati aktualisht duhet të vejë në shkollë ku të mësojë marksizëm-leninizmin, sepse, sipas kinezëve, parimet e tij janë shumë të komplikuar, ato «i dinë» dhe «i kuptojnë» vetëm kinezët(!). Kjo, sipas tyre, është arsyeja që proletariati nuk paska arritur në atë shkallë sa të bëjë revolucionin, prandaj ai duhet më parë të mësojë marksizëm-leninizmin. Udhëheqësit kinezë janë shquar në të tilla marrëzi antimarksiste! Mao Ce Duni ngriti në këmbë kalamajtë, nxënësit e shkollave të mesme, «gardistët», që nuk kishin haber fare nga marksizëm-leninizmi, dhe do të ishin këta që do t'u mësonin partisë «marksiste-leniniste» të Kinës dhe proletariatit kinez se si duhej zbatuar marksizëm-leninizmi. Pra, ata që nuk kishin asnjë fije dijenie nga marksizmi do t'u mësonin Partisë Komuniste të Kinës dhe proletariatit kinez marksizëm-leninizmin! Kjo është brendia antimarksiste e tezave maoiste, sipas të cilave studentët duhet t'i mësojnë proletariatit ideologjinë e tij, t'i mësojnë këtij se si zbatohet ideologjia e tij, dhe këtë, siç po e shikojmë, ia paskan mësuar «fare mirë», duke arritur të shpartallojnë gjithë partinë, duke likuiduar Partinë Komuniste të Kinës.

Antimarksiste dhe revizioniste është edhe teza e

qenies së fshatarësisë hegjemone në revolucion. E tillë është edhe «këshilla», e vetmja «këshillë», por antimarksiste dhe fund e krye revizioniste, që Kina merr mundimin t'i japë proletariatit botëror dhe veçanërisht atij evropian, që ky të mësojë më parë marksizëm-leninizmin, pastaj të hidhet në revolucion. Kjo është njëlloj si «teoria e kuadrove» e Anastas Lulës dhe e Andrea Zisit, sipas së cilës duhen përgatitur më parë kuadrot, pastaj të shkohet në formimin e Partisë dhe në revolucion. Me një fjalë, sipas Ten Hsiao Pinit, kemi 20 vjet të tëra kohë, të lëmë që të forcohen imperializmi amerikan dhe borgjezia reaksionare në çdo vend të botës, pastaj shohim e bëjmë më tutje. Të njëjtën gjë ka bërë edhe ustai i tij i vjetër, revizionisti Liu Shao Çi, i cili në vitin 1949 ka predikuar që Kina nuk duhej të ndërmerre ndërtimin e socializmit, por të vazhdonte të ec-te në rrugën e trashëguar edhe 30 vjet të tëra pas çlirimit të saj, të lejonte borgjezinë kapitaliste dhe kulakët të drejtonin Kinën dhe gjatë kësaj kohe «proletariati të fitonte eksperiencë për të vepruar»!

Pra, është e qartë se qëllimet dhe tezat e këtij artikulli pseudomarksist kinez nuk u shërbejnë revolucionit dhe luftërave nacionalçlirimtare, por u shërbejnë shumë mirë imperializmit, reaksionit botëror dhe Kinës, që tashmë ka hyrë në rrugën kapitaliste dhe po përgatitet të shndërrohet në një superfuqi botërore socialimperialiste.

Lenini dhe Stalini predikonin revolucionin, kurse nga ana e revizionistëve kinezë në këtë artikull thuhet se duhet të mësojmë nga Lenini, të përshëndesim dhe të përkrahim ngrohtësisht në mënyrë leniniste lë-

vizjet çlirimtare të kombeve të shtypura të Azisë, të Afrikës, të Amerikës Latine dhe të rajoneve të tjera të botës. Vetëm kaq, sipas tyre, dhe pastaj, të duartrokasim. Po kë? Të duartrokasim të gjithë ata që kinezët i këshillojnë dhe i mësojnë që të mos luftojnë për revolucionin, të mos hidhen në luftën nacionalçlirimtare, të kënaqen me këtë pseudoliri dhe pseudosovranitet që kanë fituar ose që ua kanë dhënë për sadaka imperialistët e ndryshëm. Kjo është gjithë «filozofia» që predikojnë kinezët.

Në këtë artikull revizionistët kinezë tregohen shovinistë edhe në përdorimin e shifrave. Lenini dhe Stalini i kanë përdorur shifrat për të ilustruar numrin e njerëzve të robëruar nën sundimin dhe shfrytëzimin e imperializmit, duke treguar se ç'duhet të bëjnë ata dhe marksistë-leninistët për të çliruar veten dhe popujt e tyre nga robëria. Mirëpo ç'ndodh me revizionistët kinezë? Ata vazhdojnë t'i përsëritin këto shifra dhe t'i krahasojnë me madhësinë e territorit e të popullatës që ka Kina, për të vërtetuar gjoja se «bota e tretë» me futjen e Kinës në të përbën një shumicë të madhe dërmuese dhe se e tërë kjo «botë», si një entitet, është forca kryesore lëvizëse e revolucionit! Ky është një shtrembërim i kuptimit të citateve të Leninit dhe të Stalinit, një shtrembërim që bëhet me qëllim shumë të keq, antimarksist, për të gënjyer popujt dhe proletariatin që të mos ngrihen në revolucion, që të kenë një konsideratë të madhe deri në absurditet për Kinën e Mao Ce Dunit prej 800 milionësh. Domethënë ata të pranojnë, në mos *de jure*, *de facto* hegjemoninë e saj në të ashtuquajturën botë e tretë, sepse përdorimi

i shifrave nga ana e Kinës dhe futja e saj në «botën e tretë» tregon sheshit atë peshë të madhe që dëshiron të ketë ajo në këtë grumbull të madh prej qindra milionë njerëzish, pra të mendohet nga kjo «botë» se fjala e saj është fjala e zotit dhe këta popuj ta ndjekin atë qorrazi në rrugën e greminës, ku ajo kërkon t'i çojë.

Pak më parë shkrova se artikulli kinez doli pasi ka kaluar një kohë e gjatë që nga zhvillimi i punimeve të Kongresit tonë të 7-të dhe nga botimi i artikujve që e pasuan këtë Kongres. Gjatë kësaj kohe pseudoteoricienët kinezë tatuan pulsën botëror, pulsën e lëvizjes komuniste ndërkombëtare ndaj tezave tona. Në këtë artikull ne shikojmë të bëhen përpjekje të maskuara për të zbutur disi atë përshtypje të keqe që kanë bërë në botë dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare tezat e tyre false për teorinë e «tri botëve». Kjo është arsyeja që revizionistët kinezë, në artikullin e tyre redaksional, orvaten, po, natyrisht, në mënyrë shumë të zbeh-të, të vërtetojnë se imperializmi amerikan është prapë i fuqishëm, se ekonomia e tij nuk është dobësuar, se forcat e tij ushtarake nuk janë pakësuar, por janë shtuar, se ai mban në të gjitha anët e botës një numër të madh ushtarësh etj., etj., por për çudi jo vetëm nuk thonë një fjalë të keqe për NATO-n, këtë traktat agresiv kundër popujve, por nuk e zënë fare në gojë, nuk bëjnë dot qoftë edhe më të voglin arsyetim se kur u krijua dhe kundër kujt u krijua ky traktat famë-keq. Vetë Mao Ce Duni dhe kinezët, kur strategjia e tyre nuk ishte në këtë rrugë që është sot, nuk linin gjë pa thënë kundër imperializmit amerikan dhe NATO-s. Tash mbahet një heshtje e plotë ndaj tyre. Kjo tregon



aleancën e tyre me imperializmin amerikan. Këtë «kthim» në vlerësimin një çikë më realist ndaj socialimperializmit sovjetik dhe imperializmit amerikan ata e bëjnë për arsye se janë të detyruar. Natyrisht kjo gjendje nuk i vë ata në pozita të vështira përpara Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sepse këto janë mësuar me kritika dhe slogane të tilla, nga të cilat lëshonte sa të duash edhe Hrushovi, bile edhe shumë më të forta se kinezët. Amerikanët nuk bezdisen nga këto thënie bajate të kinezëve për fuqinë ekonomike ose ushtarake të imperializmit amerikan. As Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as shtetet e tjera imperialiste nuk çajnë kokën fare për këto thënie të kinezëve, sepse e kuptojnë thelbin e «teorisë» së këtyre, e kanë të qartë vijën që ndjekin, dhe e dinë se kjo vijë është përcaktuar si rezultat i marrëveshjes së plotë me ta.

Por kinezët janë të detyruar ta bëjnë këtë «kthesë» për shkak të luftës së Partisë së Punës të Shqipërisë dhe për t'i zbukuruar ca tezat e tyre antimarksiste, sepse këto kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë në botë një përshtypje jashtëzakonisht të keqe të njerëzit kur këta shohin që Kina mbron imperializmin amerikan, kur ajo predikon aleancë me të gjithë imperialistët kundër socialimperializmit sovjetik dhe kur predikon aleancë me borgjezinë kapitaliste shtypëse të të gjitha vendeve të botës. Prandaj kinezëve u duhej të merrnin disa qëndrime në këtë drejtim dhe të rregullonin disa qo-she.

Ky artikull orvatet t'i arrijë këto qëllime, por më kot. Gjithashtu më kot përpiqen revizionistët kinezë

që, me anë të këtij artikulli, të hiqen si realistë, gjoja për të shpjeguar atë teori të «tri botëve», që e hodhën si slogan pa asnjë shpjegim teorik, politik dhe ushtarak. Sido që orvaten për të shpjeguar se në këto vende të «botës së tretë» ka, natyrisht, edhe elementë dhe udhëheqës reaksionarë, edhe udhëheqës përparimtarë, ka edhe agjentë të imperializmit amerikan, edhe agjentë të socialimperializmit sovjetik etj., etj., prapëseprapë falsiteti i «objektivitetit» të tyre duket sheshit. Këtë qëndrim fals ata e mbajnë për t'u thënë lexuesve të tyre se gjoja këto gjëra janë të vërteta, pra, edhe në qoftë se nuk i kemi thënë ne, këto kështu i kuptojmë. Por kinezët nuk thonë asnjë fjalë se ç'duhet të bëjnë popujt, ç'duhet të bëjë proletariati kundër klikave që sundojnë në vendet e ndryshme të botës dhe që janë antipopullore, bile agjente të imperializmit amerikan ose të socialimperializmit sovjetik.

I tërë artikulli i «Zhenminzhibaos» për «tri botët» s'ka asnjë vlerë teorike, as bie erë marksizëm-leninizëm. Ai është nga kreu e deri në fund antimarksist, revizionist. Në të nuk gjen asgjë të vërtetë dhe asnjë qëllim revolucionar. Çdo gjë në këtë artikull vihet në shërbim të kauzës kundërrevolucionare për të ruajtur fuqitë imperialiste, për të ruajtur statukuonë e kapitalizmit në botë. Kjo statukuoa ka për qëllim që Kina, gjatë kësaj kohe, të armatohet me mjetet më moderne dhe të marrë ndihma për forcimin e ekonomisë së saj luftarake.

Udhëheqësit kinezë mendojnë se ky artikull do të bëjë efekt te popujt dhe te komunistët e botës, por ata gabohen. Dhe, në fakt, ne konstatojmë që në opinio-

nin botëror nuk ngjau një gjë e tillë për këtë farë artikulli të «Zhenminzhibaos». Për artikullin kinez nga agjencitë kryesore ne pamë vetëm dy-tri njoftime e komente të lajmeve, të cilat vinin në dukje se Kina në një artikull redaksional të saj sulmon Bashkimin Sovjetik. Kurse për artikullin e «Zërit të popullit» të 7 korrikut u fol nga të katër anët e botës dhe jo për shumë javë, por për muaj me radhë, dhe vazhdohet akoma të flitet e të komentohet pozitivisht për të.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 659*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 659*

# DEVIJIMI I KINËS NGA MARKSIZËM-LENINIZMI DHE NGA RRUGA SOCIALISTE

*Raport në Plenumin e 3-të të KQ  
të PPSH<sup>1</sup>*

15 nëntor 1977

Në Plenumin e 2-të të Komitetit Qendror të Partisë, duke analizuar strategjinë globale të imperializmit amerikan e të socialimperializmit sovjetik për sundimin e botës, duke analizuar lindjen dhe zhvillimin e varianteve të ndryshme të revizionizmit modern, si dhe luftën që bëjnë të gjithë këta armiq kundër marksizëm-leninizmit e revolucionit, folëm edhe për vendin dhe rolin e revizionizmit të ri kinez.

Devijimi i Kinës nga marksizëm-leninizmi dhe nga rruga socialiste kërkon një analizë të thellë për të pasur të qarta burimet dhe synimet e këtij varianti të ri revizionist. Duhet përcaktuar e vlerësuar akoma më

---

1. Plenumi i 3-të i KQ të PPSH mori në shqyrtim këtë raport të mbajtur nga shoku Enver Hoxha, si dhe raportin «Të forcojmë punën e Partisë për edukimin e komunistëve dhe të kuadrove», mbajtur nga shoku Ramiz Alia.

mirë qëllimet e kësaj fuqie të re të madhe revizioniste që po del tani në arenën botërore nën maskën e një vendi socialist. Këtij problemi ne do t'i kthohemi përsëri shumë herë, sepse lufta kundër pikëpamjeve e vepërimitarisë antimarksiste të udhëheqësve kinezë sapo ka filluar.

Vijën politike që ndjek, Kina e vetëquan marksiste-leniniste, por realiteti tregon të kundërtën. Pikërisht këtë realitet ne marksistë-leninistët duhet ta demaskojmë. Ne nuk duhet të lejojmë që teoritë revizioniste kineze të kalojnë për teori marksiste, nuk duhet të lejojmë që Kina, në rrugën ku është futur, të hiqet sikur po lufton për revolucionin, sepse në realitet ajo është kundër tij.

## Plani i Kinës për t'u bërë superfuqi

Me politikën që ndjek Kina, pas puçit që bëri grupi i Hua Kuo Fenit, po duket qartë se ajo kërkon të forcojë pozitën e kapitalizmit në vend dhe të vendosë hegjemoninë e saj në botë, të bëhet një fuqi e madhe imperialiste, për të zënë, si i thonë, edhe ajo «vendin që meriton».

Historia tregon se çdo vend i madh kapitalist synon të bëhet një fuqi e madhe botërore, të arrijë e t'u dalë përpara fuqive të tjera të mëdha, të konkurojë me to për sundimin botëror. Rrugët e shteteve të mëdha borgjeze për t'u shndërruar në fuqi imperialiste kanë qenë të ndryshme, ato janë kushtëzuar nga rrethana të caktuara historike e gjeografike, nga zhvi-

llimi i forcave prodhuese etj. E ndryshme është rruga e Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga ajo e fuqive të vjetra evropiane, si Anglia, Franca e Gjermania. Këto të fundit u formuan si të tilla mbi bazën e pushtimeve koloniale.

Pas Luftës së Dytë Botërore Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbetën fuqia më e madhe kapitaliste. Ato, mbi bazën e potencialit të madh ekonomik e ushtarak që dispononin dhe me zhvillimin e neokolonializmit u shndërruan në një superfuqi imperialiste. Por s'kaloi shumë kohë dhe kësaj superfuqie iu shtua edhe një tjetër, Bashkimi Sovjetik, i cili, pas vdekjes së Stalinit dhe pasi udhëheqja hrushoviane tradhtoi marksizëm-leninizmin, u shndërrua në një superfuqi imperialiste. Ai shfrytëzoi për këtë qëllim potencialin e madh ekonomik, teknik dhe ushtarak të ngritur nga socializmi.

Tani ndodhemi përpara përpjekjeve të një tjetër shteti të madh për t'u bërë superfuqi, të Kinës së sotme, pasi edhe kjo po ecën me shpejtësi në rrugën e kapitalizmit. Por Kinës i mungojnë kolonitë, i mungon një industri e madhe e zhvilluar, i mungon një ekonomi e fortë në përgjithësi, një potencial i madh termobërthamor i asaj shkalle që kanë të dyja superfuqitë e tjera imperialiste.

Për t'u bërë superfuqi nevojitet medoemos një ekonomi e zhvilluar, një ushtri e armatosur me bomba atomike, nevojitet sigurimi i tregjeve dhe i zonave të influencës, investimi i kapitaleve në vendet e huaja etj. Këto kushte Kina kërkon t'i sigurojë sa më shpejt. Kjo është shprehur në fjalimin që mbajti Çu En Lai në Asambleenë Popullore në vitin 1975 dhe u përsërit

në Kongresin e 11-të të Partisë Komuniste të Kinës, ku u shpall se, përpara fundit të këtij shekulli, Kina do të bëhet një vend i fuqishëm e modern, me synimin që të arrijë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Sovjetik. Tani i tërë ky plan është zgjeruar e përcizuar në atë që quhet politika e «katër modernizimeve».

Por ç'rrugë ka zgjedhur Kina për t'u bërë edhe kjo një superfuqi? Aktualisht kolonitë dhe tregjet në botë janë të zëna nga të tjerët. Krijimi me forcat e veta, brenda 20 vjetëve, siç pretendojnë udhëheqësit kinezë, i potencialit ekonomik dhe ushtarak, i barabartë me atë që kanë amerikanët dhe sovjetikët, është i pamundur.

Në këto kushte, për t'u bërë superfuqi, Kinës do t'i duhet të kalojë nëpër dy faza kryesore: E para, të kërkojë kredi dhe investime nga imperializmi amerikan dhe nga vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara, të blejë teknologji të re për të shfrytëzuar pasuritë e vendit të vet, një pjesë e madhe e të cilave do të kalojë si dividende për huadhënësit. E dyta, mbivlerat e fituara në kurriz të popullit kinez ajo do t'i investojë në shtete të kontinenteve të ndryshme, ashtu siç po bëjnë aktualisht imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë.

Përpjekjet e Kinës për t'u bërë superfuqi, në radhë të parë, qëndrojnë në zgjedhjen e aleatëve dhe në krijimin e aleancave. Sot në botë ekzistojnë dy superfuqi, imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik. Udhëheqësit kinezë kanë menduar se duhet të mbës-

teten tek imperializmi amerikan, nga i cili kanë shpresa të mëdha të ndihmohen në fushën e ekonomisë, të financës, të teknologjisë, të organizimit, por edhe nga ana ushtarake. Potenciali ekonomik-ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në të vërtetë është më i madh se ai i socialimperializmit sovjetik. Këtë revizionistët kinezë e dinë mirë, pavarësisht se thonë që Amerika është në rënie. Në rrugën ku po ecin, ata nuk mund të mbështeten në një partner të dobët, nga i cili s'mund të përfitojnë shumë. Pikërisht sepse janë të fuqishme, ata kanë zgjedhur për aleat Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Aleanca me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ujdia e politikës kineze me politikën e imperializmit amerikan ka edhe qëllime të tjera. Ajo përmban në vetvete edhe kërcënimin kundër socialimperializmit sovjetik, gjë që vihet re nga propaganda shurdhuese dhe veprimtaria e ethshme që zhvillojnë udhëheqësit kinezë kundër Bashkimit Sovjetik. Me këtë politikë që ndjek, Kina i jep të kuptojë Bashkimit Sovjetik revizionist se lidhjet e saj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës përbëjnë një forcë kolosale kundër tij në rastin e shpërthimit të një lufte imperialiste.

Politika aktuale kineze synon, gjithashtu, të lidhë miqësi dhe aleanca me të gjitha vendet e tjera të zhvilluara kapitaliste, nga të cilat kërkon të përfitojë politikisht dhe ekonomikisht. Kina dëshiron dhe përpiqet ta forcojë aleancën amerikane me këto vende të «botës së dytë», siç i quan ajo. Ajo nxit unitetin ose më mirë të themi nënshtrimin e tyre ndaj imperializmit amerikan, të cilin e konsideron si partnerin e saj më të madh.



Kështu shpjegohen të gjitha ato lidhje të ngushta që qeveria kineze kërkon të vendosë me të tëra shtetet kapitaliste të pasura, me Japoninë, Gjermaninë Perëndimore, Anglinë, Francën etj., kështu shpjegohen vizitat e shumta të delegacioneve qeveritare ekonomike, kulturore e shkencore, që dërgohen në Kinë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga të gjitha vendet e tjera të zhvilluara kapitaliste, qofshin këto republika ose mbretëri, ashtu si dhe vizitat e delegacioneve kineze në ato vende. Kështu shpjegohet që Kina vepron me sistem për të manifestuar në çdo rast qëndrimin e vet në favor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe të shteteve të tjera kapitaliste të industrializuara, duke u përpjekur të vërë në dukje çdo shkrim, çdo thënie e çdo veprim të këtyre shteteve kundër social-imperializmit sovjetik. Duket qartë mobilizimi i saj i madh në mbrojtje të imperializmit amerikan dhe të kapitalizmit botëror, deri edhe në mbrojtjen e hapët të regjimeve fashiste të Kilit, të Indonezisë, të Brazilit etj.

Kjo politikë e udhëheqësve kinezë nuk mund të mos bjerë në sy dhe të mos gjejë përkrahjen e duhur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Dihet se në kohën e Luftës së Dytë Botërore në Departamentin Amerikan të Shtetit ekzistonin dy lobi lidhur me çështjen kineze: njëra pro Çan Kai Shisë dhe tjetra pro Mao Ce Dunit. Natyrisht, në ato kohë në Departamentin e Shtetit dhe në Senatin Amerikan fitoi lobi i Çan Kai Shisë, kurse në terren, në kontinent, në Kinë fitoi lobi i Mao Ce Dunit. Nga frymëzuesit e këtij lobi ishin Marshalli e Vedemejeri, Edgar Snou dhe të tjerë, të cilët u bënë

miq e këshilltarë të kinezëve, nxitës e frymëzues të lloj-lloj organizimeve në Kinën e re. Këto fije lidhesh të vjetra aktualisht po ringjallen, po forcohen, po trashen e po bëhen më konkrete. Tani kushdo e sheh se Kina dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës po afrohen gjithnjë e më shumë. Para pak kohësh një nga gazetat më të informuara amerikane, «Uashington post», shkruante: «Ka tani një konsensus amerikan, i cili përkrahet, bile edhe nga e djathta, edhe nga ata që kanë pak simpati për Pekinin. Sipas këtij konsensusi çfarëdo të ketë ndodhur në të kaluarën, nuk ka më arsye që Kina të konsiderohet një kërcënim për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përveç Tajvanit, ka pak gjëra për të cilat të dyja qeveritë nuk bien dakord. Të dyja palët kanë pranuar, në fakt, për ta shtyrë çështjen e Tajvanit, me qëllim që të përfitojnë në fusha të tjera».

Çështja e Tajvanit, që ngrihet në marrëdhëniet midis Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka mbetur diçka formale. Tash Kina nuk insiston për këtë çështje. Ajo as çan kokën fare për Hong-Kongun dhe nuk bëhet fare merak që Makaoja gjendet akoma nën sundimin e portugezëve. Qeveria kineze nuk e pranon ofertën e qeverisë së re portugeze për t'ia kthyer Kinës këtë koloni, duke thënë se «dhurata nuk kthehet». Ekzistenca e këtyre kolonive është diçka anakronike, por politikës pragmatiste të udhëheqësve kinezë kjo nuk i prish punë. Sa kohë që qëndrojnë si koloni Hong-Kongu dhe Makaoja, pse të mos jetë i tillë edhe Tajvani? Siç duket, Kinës i intereson shumë që edhe në të ardhmen Tajvani të qëndrojë siç është. Asaj i intereson që, përveç marrëdhënieve të hapëta, marrëdhënie që i

zhvillon në dritën e diellit, përmes këtyre tri portave të zhvillojë edhe trafikun e maskuar me imperialistët amerikanë, me imperialistët anglezë, japonezë etj. Prandaj, profkat që kërkojnë të shesin Ten Hsiao Pini e Li Hsien Nieni, se gjoja marrëdhëniet kino-amerikane varen nga qëndrimi amerikan ndaj Tajvanit, nuk janë veçse mjegull për të fshehur rrugën e afrimit që ka marrë Kina drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës për t'u bërë superfuqi.

Karteri ka deklaruar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të lidhin marrëdhënie diplomatike me Kinën. Për sa i përket Tajvanit do të adoptojnë qëndrimin e Japonisë, domethënë formalisht do t'i presin marrëdhëniet diplomatike me ishullin, pa prerë marrëdhëniet ekonomike e kulturore dhe, nën to, edhe ato ushtarake. Në fakt marrëdhëniet ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me Tajvanin i interesojnë Kinës. Kjo dëshiron që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mbajnë forca në Tajvan, në Japoni, në Korenë e Jugut dhe në Oqeanin Indian, mbasi kështu mendon se është më mirë për të, sepse krijohet një kundërpeshë ndaj Bashkimit Sovjetik.

Të gjitha këto qëndrime kanë lidhje me rrugën që ka zgjedhur udhëheqja kineze, që Kina të bëhet superfuqi, duke u përpjekur të zhvillojë ekonominë dhe të rritë potencialin ushtarak nëpërmjet kredive dhe investimeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të vendeve të tjera të mëdha kapitaliste. Ajo e përligj këtë rrugë duke pretenduar se zbaton gjoja një politikë të drejtë, vijën «marksiste» të Mao Ce Dunit, sipas të cilit «Kina duhet të përfitojë nga sukseset e mëdha

të botës, nga patentat, nga teknologjitë e reja, duke e vënë të huajën në shërbim të zhvillimit të brendshëm» etj. Artikujt e «Zhenminzhibaos» dhe fjalimet e udhëheqësve kinezë janë mbushur plot me parulla të tilla. Sipas konceptit kinez, të përfitosh nga shpikjet e arritjet industriale të shteteve të tjera do të thotë të marrësh kredi e të pranosh investime nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Japonia, Gjermania Perëndimore, Franca, Anglia dhe nga të gjitha vendet e tjera kapitaliste, që i lajnë e i lyejnë.

Udhëheqësit kinezë i kanë bërë të tyret teoritë revizioniste, sipas të cilave vendet e mëdha, siç është edhe Kina, që kanë pasuri të shumta, mund të marrin kredi nga imperializmi amerikan ose nga çdo shtet, trust e bankë e fuqishme kapitaliste, mbasi ato gjoja kanë mundësi t'i shlyejnë kreditë. Në mbrojtje të kësaj pikëpamjeje kanë dalë revizionistët jugosllavë, të cilët, duke reklamuar përvojën e tyre të «ndërtimit të socializmit specifik» me ndihmat e oligarkisë financiare botërore dhe posaçërisht të kapitalit amerikan, i japin shembull dhe e inkurajojnë Kinën të ecë pa ngurrim në këtë rrugë.

Kreditë që marrin, vendet e mëdha mund t'i shlyejnë, por investimet imperialiste që bëhen në këto shtete të mëdha, si në Bashkimin revizionist Sovjetik ose në Kinë e kudo, nuk mund të mbeten pa konsekuenca të rëndë neokolonialiste. Pasuritë dhe djersa e popujve shfrytëzohen edhe në interes të koncerneve e të monopoleve të huaja kapitaliste. Imperialistët amerikanë, si dhe shtetet e zhvilluara kapitaliste të Evropës Perëndimore ose Japonia, që bëjnë investime në Kinë dhe në vendet

revizioniste, kanë për qëllim të ngulen aty, synojnë që koncernet e vendeve të tyre të pleksen në një bashkëpunim të ngushtë me trustet e dogët e industrive kryesore në këto vende.

Investimi i kapitaleve të shteteve imperialiste në Kinë nuk është një problem aq i thjeshtë, siç përpiqen ta paraqesin revizionistët, që e quajnë të parrezikshëm këtë depërtim të kapitalit në vendet e tyre, pasi ky nuk hyka nëpërmjet marrëdhënieve ndërshtetërore (megjithëse tani së fundi udhëheqës të lartë kinezë kanë deklaruar se do të pranojnë kredi qeveritare nga jashtë), por nëpërmjet bankash e shoqëriash private pa komplikime dhe interesa politikë. Kredhja në borxhe e çdo vendi të vogël ose të madh, te njëri imperializëm ose te një tjetër, paraqet gjithnjë rreziqe të pashmangshme për lirinë, pavarësinë e sovranitetin e vendit që futet në këtë rrugë, aq më tepër për vende të varfra ekonomisht, siç është Kina. Një vend i vërtetë socialist nuk ka nevojë për të tilla borxhe. Burimet e zhvillimit të tij ekonomik ai i gjen në vendin e vet, në pasuritë e veta, në akumulimin e tij të brendshëm dhe në forcën krijuese të popullit. Se ç'mjete, ç'burime dhe ç'aftësi të pashtershme ka një vend socialist për t'u zhvilluar, flet shumë qartë shembulli i Shqipërisë, i një vendi të vogël. Shumë më të mëdha janë mjetet e burimet për një vend të madh, në qoftë se ai ecën me konsekuencë në rrugën e marksizëm-leninizmit.

Hapja e tregut kinez për imperializmin amerikan dhe për shoqëritë e mëdha amerikane e perëndimore është pritur me gëzim të papërmbajtur nga imperialistët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe nga e

gjithë borgjezia ndërkombëtare. Shoqëritë shumëkombëshe, industrialistët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i njohin mirë ekonominë e Kinës e pasuritë e saj të mëdha, prandaj bëjnë çmos që atje të ndërtojnë rrjetin e tyre ekonomik, të krijojnë shoqëri të përbashkëta dhe të nxjerrin fitime të mëdha. Kështu po veprojnë në Kinë jo vetëm shoqëritë e mëdha amerikane, por edhe shoqëritë japoneze, gjermane dhe të vendeve të tjera të zhvilluara kapitaliste.

Kina që tani ka përfunduar një kontratë me Japoninë, për t'i livruar asaj deri në 10 milionë tonë naftë në vit. Përfaqësues të ENI-t italian shkuan me një ekip të madh për të ofruar edhe ata licenca për kërkim të naftës në Kinë, por gjetën atje grupe të mëdha të kompanive të vajgurit amerikan, të cilat kanë hyrë që më parë në ujdin me Kinën për nxjerrjen dhe shfrytëzimin e përbashkët të naftës. Kështu po bën Kina edhe në sektorët e tjerë të minierave, të hekurit e të mine-rave të ndryshme që mund të gjenden dhe që atje gjenden me shumicë të madhe. Manjatët gjermanë të qymyrit tanimë ndodhen në Kinë, ku përfunduan një kontratë prej disa dhjetëra miliardë markash. Ministrat kinezë po i bien kryq e tërthor Japonisë, Amerikës e Evropës për të marrë kredi, për të kontraktuar pajisje të reja teknologjike, për të blerë armë moderne, për të lidhur marrëveshje tekniko-shkencore etj. Të gjitha dyert e institucioneve dhe të ndërmarrjeve kineze janë hapur për biznesmenët e Tokios, të Uoll Stritit e të Tregut të Përbashkët Evropian që nxitojnë të shkojnë sikush më parë në Pekin për të akaparuar projektet e mëdha të «modernizimit» që u ofron qeveria kineze.

Në këtë mënyrë edhe Kina po hyn në xhironin e madh të gëlltitjes imperialiste, të urisë së madhe imperialiste për të shtënë në dorë pasuritë e nëntokës e lëndët e para, për të shfrytëzuar krahun e punës në vendin e saj.

Dihet se kapitalisti kurrkujt nuk i jep ndihma pa shikuar, në radhë të parë, interesin e tij ekonomik, politik dhe ideologjik. Nuk është çështja vetëm te përqindja që ai merr si fitim. Vendi kapitalist që jep kredinë, bashkë me këtë, fut në vendin që merr «ndihmën» edhe mënyrën e vet të jetesës, mënyrën e mendimit të tij kapitalist, krijon baza dhe përhapet pa u kuptuar si vaji në lakra, zgjeron rrjetën e merimangës dhe kjo merimangë qëndron kurdoherë në mes dhe u thith gjakun të gjitha mizave që bien në rrjetën e saj, siç ka ndodhur në Jugosllavi, siç po ndodh sot në Bashkimin Sovjetik. Po kështu do të ndodhë edhe në Kinë.

Si rrjedhim, Kina do të lëshojë, siç po lëshon, edhe në çështjet politike dhe ideologjike, kurse tregu kinez do të bëhet një *débouché* me rëndësi të madhe për imperializmin amerikan dhe për fuqitë e tjera kapitaliste të industrializuara.

Kreditë dhe investimet amerikane, gjermanoperëndimore, japoneze etj. në Kinë s'ka se si të mos prekin, në njërën ose në tjetrën shkallë, pavarësinë dhe sovranitetin e saj. Të tilla kredi e bëjnë të varur çdo shtet që i merr, pse huadhënësi imponon politikën e vet. Prandaj, qoftë i madh, qoftë i vogël, cilido shtet që futet në ingranazhet e imperializmit i cungon ose i humbet lirinë politike, pavarësinë dhe sovranitetin. Në këtë gjendje cungimi të sovranitetit ka rënë edhe Bashkimi Sovjetik, i cili, kur hyri në rrugën e rivendosjes së kapi-

talizmit, ishte shumë më i fuqishëm ekonomikisht e ushtarakisht nga sa është Kina sot, që po futet në të njëjtën rrugë.

Natyrisht, vendet e vogla, kur futen në ingrana-zhet e imperializmit, lirinë dhe pavarësinë i humbasin më shpejt se vendet e mëdha, siç janë Kina dhe Bashkimi Sovjetik, që mund t'i humbasin me një gradacion më të ngadalshëm, për shkak se kanë jo vetëm një potencial më të madh ekonomik dhe ushtarak, por edhe sepse, duke u mbështetur në këtë potencial, luftojnë që të ruajnë tregjet dhe të zënë të reja, të krijojnë dhe të zgjerojnë zona influence për t'i bërë presion njëri-tjetrit, për t'u futur edhe në luftë, kur të mos gjejnë tjetër rrugëdalje. Por kjo, prapëseprapë, nuk i shpëton dot ato nga zinxhirët e kredive dhe të investimeve që u lidhin këmbët. Kreditë dhe kamatat duhen shlyer. Mirëpo, duke mos qenë në gjendje t'i shlyesh, do të hysh në borxhe të reja. Borxhi zë borxhin dhe kapitalisti kërkon rentat dhe, kur s'ke t'ia paguash, ai t'i vë të dyja këmbët në një këpucë. Shoqëritë monopoliste amerikane, për shembull, që i imponojnë politikën qeverisë së vet, e detyrojnë atë t'i mbrojë me çdo mënyrë kapitalet, të deklarojë, po qe nevoja, edhe luftë për mbrojtjen e tyre.

Duke gjykuar nga zelli që tregojnë udhëheqësit kinezë për t'u mbështetur tek imperializmi amerikan, te kapitalistët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për zhvillimin e ekonomisë së vendit të tyre, bie poshtë edhe tërë ajo zhurmë shurdhuese që bëjnë ata rreth dobësimit të këtij imperializmi. Deklaratat e tyre, sikur gjoja imperializmi amerikan është dobësuar, janë vetëm



një bluf, ashtu siç është bluf edhe deklarata mbi mbështetjen në forcat e veta. Revizionistët kinezë mendojnë të kundërtën e asaj që thonë, këtë kushdo e shoh në praktikën e tyre.

Gazetat zyrtare kineze shprehin shpesh shqetësim për kreditë që merr Bashkimi Sovjetik socialimperialist nga bankat amerikane, gjermanoperëndimore, japoneze etj. Ato i paralajmërojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara që të kenë mendjen, se ndihmat teknologjike dhe kreditë që i japin Bashkimit Sovjetik, ky i përdor për zhvillimin dhe për forcimin e potencialit të tij ekonomik e ushtarak, se këto ndihma dhe kredi e rritin rrezikun që u kanoset nga socialimperializmi, i cili, siç thonë udhëheqësit kinezë, ka zënë sot vendin e Rajhut të Tretë. Prandaj u bëjnë thirrje t'i presin këto kredi sa më parë.

Nuk është vështirë të nxjerrësh kuptimin e vërtetë të «shqetësimeve» që tregojnë udhëheqësit kinezë rreth kredive që merr Bashkimi Sovjetik. Natyrisht, ata nuk merakosen për natyrën kapitaliste të këtyre kredive, as për rrezikun që paraqesin ato për sovranitetin e shtetit sovjetik. Por ata duan t'u thonë manjatëve të kapitalit amerikan dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kapitalistëve dhe qeverive të vendeve të tjera imperialiste, se ato kredi dhe ato ndihma duhet t'ia japin jo Bashkimit Sovjetik, por Kinës, nga e cila s'kanë asnjë rrezik, përveç fitimeve.

Kjo është njëra anë e planit kinez për t'u bërë superfuq. Ana tjetër janë përpjekjet për të dominuar

vendet më pak të zhvilluara të botës, për t'u bërë lider i asaj që Kina e quan «botë e tretë».

Grupi që sundon sot në Kinë e vë shumë theksin mbi «botën e tretë», duke futur jo rastësisht dhe jo pa qëllim edhe veten në këtë botë. Kina kërkon të mbledhë rreth vetes të gjitha vendet e «botës së tretë» ose të «vendeve të paangazhuara», ose të «vendeve në zhvillim» për të krijuar një forcë të madhe, e cila jo vetëm do të rritë potencialin e përgjithshëm kinez, por edhe do ta ndihmojë Kinën t'u kundërvihet dy superfuqive të tjera, Shteteve të Bashkuara të Amerikës e Bashkimit Sovjetik.

I gjithë ky zhvillim i politikës dhe i veprimeve kineze vërteton plotësisht karakteristikat që i ka bërë marksizëm-leninizmi imperializmit, si sundim i oligarkisë financiare që kërkon tregje, që kërkon pushtimin e botës dhe vendosjen kudo të hegjemonisë së vet. Në këtë rrugë Kina përpiqet të depërtojë dhe të zërë edhe ajo një copë «tokë» në vendet e «botës së tretë». Por kjo «tokë» duhet të fitohet me sakrificat të mëdha.

Për t'u futur në «botën e tretë», për të zënë tregjet, duhen kapitale. Klasat sunduese, që janë në fuqi në vendet e «botës së tretë», kërkojnë investime, kërkojnë kredi dhe «ndihma». Mirëpo Kina nuk është në gjendje t'u japë atyre «ndihma» në përmasa të mëdha, pse nuk e ka potencialin ekonomik që kërkohet. Pikërisht këtë potencial ajo po përpiqet ta krijojë tani me ndihmën e imperializmit amerikan. Në këto kushte borgjezia që sundon në vendet e «botës së tretë», e ka të qartë se hëpërhë nuk mund të përfitojë shumë nga Kina as nga ana ekonomike e teknologjike, as nga ana

ushtarake. Ajo mund të përfitojë më shumë nga imperializmi amerikan dhe nga socialimperializmi sovjetik, që kanë potencial të madh ekonomik, teknik dhe ushtarak.

Megjithatë, Kina, si çdo vend që ka synime imperialiste, lufton dhe do të luftojë edhe më shumë për tregje në botë, përpiqet dhe do të përpiqet edhe më tepër për të përhapur influencën dhe dominimin e saj. Këto plane duken qysh tani. Ajo po krijon bankat e veta jo vetëm në Hong-Kong, ku i ka prej kohësh, por edhe në Evropë e gjetkë. Ajo do të luftojë veçanërisht të krijojë banka dhe të eksportojë kapitale në vendet e «botës së tretë». Sot për sot në këtë fushë ajo bën shumë pak. «Ndihma» e Kinës konsiston në ndërtimin e ndonjë fabrike çimentoje, të ndonjë hekurudhe ose të ndonjë spitali, sepse aq i ka mundësitë. Vetëm kur investimet amerikane, japoneze etj. në Kinë do të fillojnë të japin frytet e dëshiruara prej saj, domethënë kur të zhvillohen ekonomia, tregtia dhe teknika ushtarake, Kina do të jetë e aftë të ndër marrë një ekspanSION të vërtetë ekonomik dhe ushtarak në shkallë të gjerë. Por, për t'ia arritur kësaj, duhet kohë.

Deri atëherë ajo do të manovrojë, siç ka filluar të manovrojë, me politikën e «ndihmave» dhe të kredive pa kamatë ose me kamatë fare të vogël, në një kohë kur sovjetikët edhe amerikanët kërkojnë shumë më tepër. Sa kohë që kapitalet kineze nuk do të jenë në gjendje të vërshojnë jashtë vendit të tyre, udhëheqja revizioniste e Kinës do ta përqendrojë vëmendjen në anën propagandistike të «ndihmave» dhe të kredive të pakta që ajo u jep vendeve në zhvillim, duke predi-

kuar «karakterin internacionalist», «qëllimet pa interese», duke e shoqëruar këtë me moton e «mbështetjes në forcat e veta», për çlirimin dhe ndërtimin e vendit.

Sa më tepër të zhvillohet Kina ekonomikisht dhe ushtarakisht, aq më tepër ajo do të kërkojë të futet dhe të dominojë në vendet e vogla e më pak të zhvilluara me anë të eksportit të kapitaleve të saj dhe atëherë s'do të kërkojë më 1-2 për qind kamatë për kreditë e saj, por do të veprojë si gjithë të tjerët.

Por të gjitha këto plane e përpjekje nuk mund të realizohen lehtë. Vendet imperialiste dhe kapitaliste të zhvilluara, të cilat kanë influencë në vendet e të ashtuquajturës botë e tretë, nuk e lejojnë Kinën të pushtojë kollaj tregjet që ato i kanë fituar me kohë me luftëra grabitqare. Ato jo vetëm i ruajnë fort pozitën e vjetra, por përpiqen me të gjitha mënyrat të zënë edhe pozita të reja dhe nuk i lejojnë Kinës ta shtrijë dorën në këto vende.

Imperializmi është i pamëshirshëm ndaj çdo partneri të vet, kur gjendet në vështirësi ose në lulëzim. Ai, nganjëherë, nga zori dhe për të arritur përfitime më të mëdha, mund të bëjë ndonjë lëshim, por më shumë përpiqet t'i forcojë zinxhirët, jo vetëm kundër vendeve të dobëta, por edhe kundër atyre të zhvilluara, siç janë shtetet kapitaliste të industrializuara. Këtë politikë kanë ndjekur, për shembull, kurdoherë Shtetet e Bashkuara të Amerikës me aleatët e tyre kapitalistë, kur këta janë gjendur në momente të vështira në luftërat imperialiste që kanë shpërthyer në mes tyre. Por, edhe pas këtyre luftërave, kur ata kanë bërë përpjekje

për t'u mëkëmbur, imperializmi amerikan ka vënë të gjitha forcat që t'i pengojë të futen në vendet e tjera të botës, ku ai kishte vendosur sundimin e tij. Në këtë mënyrë, pas Luftës së Dytë Botërore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, «duke ndihmuar» Anglinë dhe Francën, që dolën të dobësuar nga kjo luftë, hynë thellë në tregun e sterlinës, në atë të frangut etj. Monopolet dhe kartelet amerikane të metalurgjisë, të kimisë, të hekurudhave e të shumë degëve të tjera jetike për zhvillimin e kapitalizmit depërtuan në një masë dërrmuese në monopolet dhe në kartelet e Anglisë, të Francës etj., duke i vënë këto vende në varësi të imperializmit amerikan. Ky imperializëm i egër e i pangopur, si dhe çdo imperializëm tjetër, nuk mund të veprojë ndryshe edhe me Kinën.

Duke pasur parasysh vështirësitë që has për të depërtuar ekonomikisht dhe ushtarakisht në vendet e «botës së tretë», Kina mendon se hegjemonia e saj në to mund të sigurohet nëpërmjet vendosjes së influencës së saj politike dhe ideologjike. Ajo mendon se kjo do të arrihet duke lu përmbajtur tri drejtimeve: të mos luftojë imperializmin amerikan dhe klikat sunduese në vendet kapitaliste, përkundrazi, të hyjë në aleancë me këtë imperializëm dhe me këto klika; të luftojë social-imperializmin sovjetik, të cilin e ka në kufi, për t'ia dobësuar dhe për t'ia shkatërruar atij bazat në Azinë, Afrikë dhe në Amerikën Latine; të mashtrojë proletariatin dhe popujt e shumëvuajtur të këtyre kontinenteve me anë të demagogjisë dhe të manovrave pseudo-revolucionare dhe pseudosocialiste, duke minuar çdo

lëvizje çlirimtare revolucionare. Derisa ta ndiejë veten plotësisht të fuqishme për të konkurruar superfuqitë e tjera, Kina do të ndjekë politikën e ruajtjes së statukuosë kapitaliste. Derisa të fitojë «vendin e merituar» si superfuqi, Kina ka nevojë për paqe dhe për ndihmat e amerikanëve e të alcatëve të tyre. Nuk është e rastit deklarata e Ten Hsiao Pinit se nuk do të ketë luftë për 20 vjet. Me këtë ai do t'u thotë superfuqive dhe vendeve të tjera imperialiste që të mos kenë frikë nga Kina gjatë këtyre 20 vjetëve dhe, nga ana tjetër, ato të mos shkaktojnë konflagracione botërore që do të implikonin detyrimisht edhe Kinën. Sa do të jetë e mundshme kjo, është tjetër gjë, por udhëheqësit kinezë presionin e bëjnë, pasi e ndiejnë të domosdoshme nevojën e qetësisë për një periudhë që ata mendojnë se u duhet për të realizuar qëllimet e tyre të shndërrimit të Kinës në superfuqi.

Në të njëjtën kohë, duke vepruar kështu, udhëheqja kineze u thotë amerikanëve, gjermanoperëndimorëve, anglezëve, francezëve, japonezëve e të tjerëve se Kina gjoja nuk ka synime imperialiste ndaj «botës së tretë», se ajo lufton vetëm kundër planeve agresive dhe ekspansioniste të Bashkimit Sovjetik, i cili kërkon të pushtojë tregjet tradicionale të tyre.

Këto qëllime të Kinës imperializmi amerikan dhe fuqitë e tjera imperialiste, bashkë me socialimperializmin, i kuptojnë fare mirë. Këto i kuptojnë gjithashtu edhe vendet e «botës së tretë», prandaj dyshojnë dhe e shohin se Kina po bën një bluf me to, se ajo ka për qëllim jo t'i mbështetë e t'i ndihmojë, por të bëhet vetë një superfuqi. Shumica e udhëheqjeve që sundoj-

në në vendet e të ashtuquajturës botë e tretë, janë të lidhura ngushtë prej kohësh me imperializmin amerikan ose me fuqitë kapitaliste të zhvilluara, si Anglia, Franca, Gjermania, Belgjika, Japonia etj. Prandaj shteteve imperialiste e kapitaliste të zhvilluara nuk u shkakton ndonjë kokëçarje flirti i Kinës me «botën e tretë».

Përpjekjet e Kinës për të hyrë në «botën e tretë» me anë të politikës dhe të ideologjisë së saj të ashtuquajtur maocedunide, nuk mund të kenë sukses edhe për arsye se ideologjia dhe vija politike e saj janë një kaos. Vija politike e Kinës është e çoroditur, është një vijë pragmatiste që lëkundet e ndryshon sipas kuniunkturave dhe interesave të çastit. Klasat sunduese në shtetet e «botës së tretë» nuk kanë frikë nga kjo ideologji, pse e kuptojnë që ajo nuk është për revolucionin dhe për çlirimin e vërtetë kombëtar të popujve. Borgjezia në këto vende, për të ushtruar më lehtë shtypjen dhe shfrytëzimin mbi popullin, ka krijuar partitë e veta me gjithfarë etiketash. Këto parti, që janë lidhur ngushtë me kapitalet e huaja të investuara në shtetet e të ashtuquajturës botë e tretë, nuk e kanë të vështirë të luftojnë dhe të demaskojnë vijën kineze. Prandaj udhëheqësit revizionistë kinezë kanë zgjedhur rrugën e buzëqeshjes ndaj partive të këtyre vendeve dhe përpiqen me çdo mënyrë e në çdo rast të jenë «të ëmbël si sheqeri» me to.

Kina, duke pasur në plan të sundojë mbi «botën e tretë», përpiqet t'i kanalizojë sa të jetë e mundur në interesin e vet lëvizjet e masave punonjëse në këtë «botë». Por aktualisht popujt e shtypur, me proletariatin në krye, nuk ndodhen më në atë gjendje që ishin

nga fundi i shekullit të 19-të ose në fillim të shekullit të 20-të. Ata kundërshtojnë çdo politikë hegjemoniste e nënshtrimi nga fuqitë e mëdha imperialiste, qofshin këta imperialistë të vjetër ose të rinj, amerikanë, sovjetikë ose kinezë. Sot masat e gjera të popujve të botës, në përgjithësi, janë zgjuar dhe, nëpërmjet luftërave të tyre, në një mënyrë ose në një tjetër, kanë arritur të fitojnë njëfarë ndërgjegjeje për të mbrojtur të drejtat e tyre ekonomike dhe politike. Popujt e të ashtuquajturës botë e tretë nuk mund të mos e shohin se Kina punon jo për të çuar në vendet e tyre idetë e revolucionit e të çlirimit kombëtar, por për të shuar revolucionin, i cili pengon depërtimin e influencës kineze. Kursi kinez i aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me vendet e tjera neokolonialiste, gjithashtu, e demaskon socialimperializmin kinez në sytë e popujve.

Kina nuk mund të bëjë një propagandë pozitive e revolucionare në vendet e «botës së tretë» edhe për arsye se do të binte në kundërshtim me atë superfuqi, nga e cila kërkon të përfitojë nga kapitalet që kjo mund të investojë në Kinë dhe nga teknologjia e përparuar e saj. Gjithashtu Kina nuk mund ta bëjë këtë propagandë edhe për arsye se revolucioni do të përmbyste pikërisht ato klika reaksionare që sundojnë në disa vende të së ashtuquajturës botë e tretë, të cilat Kina i përkrah dhe i ndihmon që të qëndrojnë në fuqi.

Rruga e Kinës për t'u bërë superfuqi do të ketë pasoja të rënda, në radhë të parë, për vetë Kinën dhe për popullin kinez.



Analiza marksiste-leniniste e politikës kineze të çon në konkluzionin se udhëheqja kineze po e shpie Kinën në një rrugë pa krye. Duke u shërbyer imperializmit amerikan dhe kapitalizmit botëror, ajo mendon të nxjerrë për vete të saj disa fitime, por këto fitime janë të dyshimta dhe do t'i kushtojnë shtrenjtë Kinës. Ato do t'i sjellin katastrofën vendit e do të kenë, natyrisht, reperkusione të ndjeshme edhe në vende të tjera.

Politika kineze u hapi rrugë të gjerë e shumë të frytshme Shteteve të Bashkuara të Amerikës, rrugë që e çelën në fillim Mao Ce Duni, Çu En Lai dhe Niksoni. U hodhën shumë ura në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kinës, ura të maskuara, ura me efekte dhe me rezultate. Niksoni predikoi se «duhet të ndërtojmë një urë aq të madhe, sa të lidhë San-Franciskon me Pekinin». Ftesa që Mao Ce Duni dhe Çu En Lai i bënë Niksonit, pas skandalit të Uotergejtit, dhe pritja e tij nga Maoja nuk ishin pa arsye dhe nuk bëheshin pa qëllim. Kjo donte të thoshte se miqësia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës jo vetëm nuk është një miqësi koniunkturale në mes personash, por është një miqësi në mes vendesh, në mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pavarësisht se presidenti që e hapi këtë rrugë u rrëzua nga posti i tij për batakçillëqet që kishte bërë.

Tani që ka ardhur Karteri në fuqi marrëdhëniet e miqësisë mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës po trashen, shkëmbimet tregtare ndërmjet tyre po shtohen. Nga ana e Kinës u theksua akoma më me forcë politika proamerikane dhe kundër socialimperia-

lizmit sovjetik. Në këtë mënyrë Karteri e kishte rru-  
gën të hapur për një strategji të re, e cila nuk është  
gjë tjetër veçse shtrati i strategjisë së vjetër të Shte-  
teve të Bashkuara të Amerikës: mbajtja në këmbë e  
imperializmit dhe forcimi i neokolonializmit, shuarja  
e hovit të revolucionit dhe mbytja e socializmit. Nga  
ana tjetër, kjo strategji amerikane synon të dobësojë  
e të shkatërrojë Bashkimin Sovjetik që rivalizon Shte-  
tet e Bashkuara të Amerikës për sundimin e botës.  
Kjo ka qenë kurdoherë politika amerikane dhe kjo  
mbetet politika «e re» e Karterit.

Shteteve të Bashkuara të Amerikës u intereson  
shumë qëndrimi aktual i Kinës dhe strategjinë e kësaj  
Karteri e përkëdhel në shumë mënyra. Ai përpigjet të  
forcojë me të marrëdhëniet politike, ekonomike dhe  
ushtarake. Bile këto marrëdhënie kanë filluar të zhvi-  
llohen me ritëm të shpejtë.

Siç e kam theksuar edhe në mbledhjen e fundit  
të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, politika  
e Karterit shkon në drejtimin e dëshirave të Kinës.  
Në ç'mënyrë? Karteri është për t'i dhënë ndihmë Ki-  
nës që të forcojë ekonominë dhe ushtrinë e saj deri  
në atë shkallë që i intereson imperializmit amerikan.  
Ai u buzëqesh udhëheqësve kinezë dhe pranon propa-  
gandën e tyre të shfrenuar kundër socialimperializmit  
sovjetik, sepse kjo u shërben në mënyrë të shkëlqyer  
qëllimeve, strategjisë dhe propagandës amerikane. Pra,  
qëllimi i Karterit është ta përkëdhelë këtë politikë të  
Kinës, ta nxitë atë, sepse është në fitimin e tij.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës përkrahin të gjit-  
tha ato shtete që i ndihmojnë për të dominuar botën.

Strategjia e Kinës i ndihmon Shtetet e Bashkuara të Amerikës të bëhen hegjemone dhe të dobësojnë tendencat hegjemoniste të socialimperializmit sovjetik. Këtë shërbim po ua bën atyre Kina, prandaj kjo e meriton plotësisht ndihmën amerikane.

Kina predikon me të madhe forcimin e «unitetit evropian», të «unitetit të vendeve të zhvilluara kapitaliste të Evropës». Ajo në të gjitha çështjet e mbështet këtë unitet, duke u shitur mendje ujqve dhe dhelprave të vjetra, «duke i mësuar» ata si të forcojnë unitetin e tyre ushtarak dhe ekonomik, unitetin organizativ shtetëror etj. përballë rrezikut të madh të socialimperializmit sovjetik. Por këta nuk kanë nevojë për mësimet e Kinës, sepse janë në gjendje dhe e dinë shumë mirë se nga u vjen rreziku. Në radhë të parë rreziku të tërëve atyre u vjen nga revolucioni, dhe, në radhë të dytë, u vjen si nga socialimperializmi sovjetik, ashtu edhe nga imperializmi amerikan. Imperializmi amerikan i rrezikon ata nën petkun e shtetit mik e aleat, por vendet e Evropës Perëndimore janë kurdoherë në gatishmëri dhe përpiqen të mos bien në asnjërin nga të dy kurthet.

Strategjinë e Kinës e pëlqejnë edhe vendet e zhvilluara të Perëndimit, por nuk janë aq naive që t'i zbatojnë «a la lettre» këshillat dhe dëshirat kineze. Ato forcohen për të përballuar një rrezik eventual nga Bashkimi Sovjetik, por njëkohësisht bëjnë edhe përpjekje të shumta të mos acarohen me të. Kjo, natyrisht, bie në kundërshtim me dëshirën e Kinës. Vendet imperialiste kanë si strategji shmangien e luftës midis tyre dhe

Bashkimit Sovjetik dhe hedhjen e këtij në luftë kundër Kinës.

Shteteve kapitaliste të Evropës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës u pëlqen nxitja që Kina i bën kontradiktës së tyre me sovjetikët, për arsye se tërthorazi u thonë këtyre që «armiku juaj kryesor është Kina, ndërsa ne, së bashku me ju, kërkojmë të krijojmë një detantë, një bashkekzistencë paqësore, pavarësisht se ç'thotë ajo». Nga ana tjetër, këto shtete, ndërsa hiqen sikur duan paqe, armatosen për të forcuar hegjemoninë dhe unitetin e tyre ushtarak kundër revolucionit, armikut kryesor të tyre. Këtu e kanë qëllimin të gjitha mbledhjet, si ajo e Helsinkit dhe e Beogradit, që zgjaten e zgjaten e bëhen tërëzë dhe i përngjajnë Kongresit të Vjenës pas thyerjes së Napoleonit, që njihet si kongresi i valleve dhe i suareve.

Udhëheqësit kinezë, siç e deklaroi zyrtarisht Ten Hsiao Pini në intervistën e dhënë drejtorit të AFP-së, bëjnë thirrje për krijimin e «një fronti të gjerë që do të përfshijë botën e tretë, botën e dytë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës» për të luftuar kundër social-imperializmit sovjetik. Kjo thirrje e hapët për aleancë me imperializmin amerikan është ndërtuar mbi baza antimarksiste e shoviniste, pse fton popujt dhe proletariatin që të bashkohen me njërin imperializëm kundër një tjetri, të bashkohen me kapitalizmin botëror dhe t'i nënshtrohen atij. Ajo kërkon që popujt dhe proletariati të heqin dorë nga lufta revolucionare e çlirimtare, të pranojnë shfrytëzimin kapitalist e shtypjen nacionale dhe të kthehen në mish për top për luftërat ndër-imperialiste.

Thirrja e re e udhëheqësve kinezë për aleancë me imperializmin amerikan kundër socialimperializmit sovjetik nxit luftën midis dy superfuqive dhe shndërrimin e saj në një konflagracion botëror. E parë më thellë, aleanca që kërkon Kina të formohet midis «botës së tretë», «botës së dytë» dhe imperializmit amerikan kundër socialimperializmit sovjetik, synon të dobësojë atë që ajo e konsideron konkurrent të saj në luftën për t'u bërë superfuqi nën maskën e socializmit dhe të përkrahëses së luftës «së të gjithë popujve» kundër «armikut kryesor» të tyre.

Udhëheqësit kinezë përpiqen të krijojnë për vete aleanca me tërë reaksionin botëror, duke spekuluar me faktin që ky i fundit e konsideron Bashkimin Sovjetik si një vend komunist dhe ekspansionin e tij imperialist si përpjekje për të shtrirë komunizmin në të gjithë botën.

Në këtë mënyrë strategjia e Kinës kundër socialimperializmit sovjetik dhe pro imperializmit amerikan, pro Tregut të Përbashkët, pro Evropës së Bashkuar, i shërben në fakt imperializmit amerikan. Ajo e dobëson Kinën dhe rrezikon më shumë një luftë mes saj dhe Bashkimit Sovjetik, sesa një luftë midis Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës e aleatëve të tyre në NATO.

Ne vëmë re se, në përgjithësi, strategjinë antimarksiste, kundërrevolucionare dhe antisocialiste të Kinës e mbështetin shumë vende kapitaliste, herë hapur e herë mbuluar. Këto vende e mbështetin, pse Kina ndjek një politikë pro imperializmit amerikan, pro kapitalizmit botëror, pse është kundër revolucionit, kundër pro-

letariatit, kundër masave të shtypura, pse thellon më tej kontradiktat mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik. Imperializmi amerikan, vendet kapitaliste të zhvilluara dhe të gjitha vendet ku në fuqi janë klika borgjeze kapitaliste, socialimperializmin sovjetik e konsiderojnë armikun e tyre kryesor, pra, janë dakord me Kinën dhe e nxitin që të drejtohet kundër këtij armiku të përbashkët.

Atë që bën Kina duke nxitur të tjerët për luftë, e bëjnë edhe imperializmi amerikan, vendet kapitaliste të zhvilluara dhe të gjitha vendet ku në fuqi janë klika borgjeze kapitaliste, të cilat nxitin si Kinën, ashtu edhe Bashkimin Sovjetik, kundër njëri-tjetrit. Prandaj ka më shumë të ngjarë që politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vetë strategjia e gabuar e Kinës ta shtyjnë Bashkimin Sovjetik që të forcohet akoma më shumë ushtarakisht dhe, si fuqi imperialiste që është, të godasë më parë Kinën.

Kina, nga ana e saj, ka prirje të theksuara të godasë Bashkimin Sovjetik kur ta ndiejë veten të fuqishme, sepse ka ambicie të mëdha territoriale për Siberinë dhe për territore të tjera të Lindjes së Largme. Këto rivendikime ajo i ka ngritur me kohë, por ca më shumë do të pretendojë kur të jetë e përgatitur, kur të ketë ngritur në këmbë një ushtri të armatosur me të gjitha llojet e armëve. Këtë kuptim ka deklarata që i bëri Hua Kuo Feni ish-kryeministrit konservator anglez, Hith, kur tha: «Ne shpresojmë se do të shohim një Evropë të bashkuar e të fuqishme, ne besojmë se Evropa nga ana e saj shpreson gjithashtu të shikojë një Kinë të fuqishme». Me një fjalë Hua Kuo Feni i thotë

borgjezisë së madhe evropiane: «Ju forcohuni e sulmoni nga Perëndimi, kurse ne, kinezët, do të forcohemi dhe do të sulmojmë Bashkimin Sovjetik nga Lindja».

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të interesuara t'i japin Kinës ndihmë të gjithanshme politike, ushtarake dhe ekonomike, për ta nxitur atë kundër Bashkimit Sovjetik. Ato i kanë dhënë Kinës sekrete atomike. Tashmë kjo është e qartë. Ato i kanë dhënë gjithashtu ordinatorë nga më modernët që shërbejnë për luftën bërthamore. Kina ka marrë të dhëna të plota që të ndërtojë vetë nëndetëse atomike. Tani në Uashington po flitet hapur e zyrtarisht për ta furnizuar Kinën me armë moderne. Të gjitha këto «të mira» që Shtetet e Bashkuara të Amerikës i ofrojnë Kinës, natyrisht, nuk i jepen me qëllim që kjo të bëhet një fuqi e atillë e madhe tokësore dhe detare sa të rrezikojë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, siç bëri Japonia në Luftën e Dytë Botërore. Jo, imperializmi amerikan i mat mirë të ashtuquajturat ndihma që i jep gjithë botës, dhe veçanërisht Kinës.

Në këtë mënyrë synimi dhe përpjekjet e ethshme të Kinës për t'u bërë superfuqi, që të kundërbalancojë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe Bashkimin Sovjetik, nuk mund të mos çojnë në fërkime të reja, në konflagracione, në luftëra, të cilat mund të kenë edhe karakter lokal, por edhe karakterin e një lufte të përgjithshme.

Politika e Kinës për t'u bërë superfuqi, e frymëzuar nga një ideologji antimarksiste, po demaskohet dhe do të demaskohet akoma më shumë në sytë e të gjithë popujve, por sidomos të popujve të së ashtuquaj-

turës botë e tretë. Popujt e botës i kuptojnë qëllimet e politikës së çdo shteti, cilido qoftë ky, socialist, revizionist, kapitalist ose imperialist. Ata e shohin dhe e kuptojnë se Kina, megjithëse hiqet si pjesëtare e «botës së tretë», nuk ka po ato aspirata dhe po ato qëllime të këtyre popujve. Aleanca e Kinës me këto vende konsiston vetëm në aleancën me sunduesit e tyre. Prandaj është e kuptueshme se një politikë e tillë jopopullore, që ndihmon shtypjen shoqërore e kombëtare, është e papranueshme për popujt, është një politikë, e cila do të përplasë në kontradiktat e thella që krijohen nga fuqitë e mëdha imperialiste dhe nga ato qeveri borgjezo-kapitaliste që ndjekin një politikë antipopullore.

Kina mbështet dhe i jep armë Somalisë, e cila, e shtyrë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, lufton kundër Etiopisë. Ndërkaq, Etiopia ndihmohet nga Bashkimi Sovjetik për të gëlltitur Somalinë. Kështu ndodh edhe me Eritrenë. Pra, Kina mban një rëndësi anë, Bashkimi Sovjetik mban anën tjetër. Në qoftë se Kina shihet me sy të mirë në Somali, shihet nga ata që janë në fuqi, por jo nga populli i këtij vendi që po vritet. Ajo nuk shihet me sy të mirë as nga udhëheqja e Etiopisë, që mbështetet nga sovjetikët, por as nga populli etiopian, i cili është i fryrë kundër somalezëve, që gjoja kërkojnë të pushtojnë Etiopinë. Në këtë mënyrë Kina nuk ka asnjë influencë as në Etiopi e as në Somali.

Por ajo nuk shihet me sy të mirë edhe në Algjeri. Kjo e fundit mbështet frontin «Polisario», kurse Kina mban anën e Mauritanisë e të Marokut, domethënë anën e imperializmit amerikan.



Me politikën e saj të jashtme Kina ndjek një kurs gjoja pro popujve arabë. Por kjo politikë konsiston vetëm në çështjen që popujt arabë të bashkohen kundër socialimperializmit sovjetik. Vetëkuptohet, pra, që Kina ndihmon çdo afrim të arabëve, në radhë të parë, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Për sa i përket Izraelit, udhëheqja kineze flet shumë kundër tij. Por në fakt, me strategjinë e saj, ajo është pro Izraelit. Këtë e kanë vënë dhe e vënë re popujt arabë e sidomos ai palestinez.

Në vendet e Azisë mund të themi se Kina nuk ka ndonjë influencë të dukshme dhe të qëndrueshme. Ajo nuk ka asnjë influencë në Indi, e cila po lidhet me imperializmin amerikan, kurse më parë ishte e lidhur kryesisht me Bashkimin Sovjetik. Futja e Kinës në Indi për interesat e saj hegjemonistë është jashtëzakonisht e zorshme, gati e pamundur, për arsye se ajo nuk ka atë potencial ekonomik të lartë që i intereson Indisë. Gjithashtu nuk ka tradita miqësore mes dy popujve, për shkak të Tibetit, të provokacioneve kufitare etj. Natyrisht, një *modus vivendi* mund të gjendet që të stabilizojë marrëdhëniet midis tyre, por jo që të krijohen marrëdhënie të atilla që do të donte Kina për të realizuar qëllimet e saj.

Kina pretendon dhe ishte e sigurt se Pakistani ishte «një aleat besnik i Kinës së Mao Ce Dunit». Pakistani pati nevojë për Kinën derisa konflikti pakistano-indian ishte i acaruar. Por a janë sunduesit pakistanezë me Kinën? Ata mund të jenë me të përderisa e kërkojnë koniunkturën, por, të mendosh se mund të jenë me Kinën me gjithë shpirt në një aleancë të shën-

doshë politike, ideologjike dhe ekonomike, kjo as që mund të mendohet.

Kina nuk është në miqësi të singertë e të ngushtë me vendet e saj fqinje, pa lëre pastaj të mendohet për vendet e tjera që janë më larg. Politika e Kinës nuk është dhe nuk mund të jetë e drejtë, derisa nuk është marksiste-leniniste. Mbi bazën e një politike të tillë ajo nuk mund të jetë në miqësi të singertë me Vietnamin, me Korenë, me Kamboxhian, me Laosin, me Tajlandën etj. Kina hiqet sikur do miqësi me këto vende, por, në fakt, midis saj dhe këtyre ekzistojnë kundërshtime për çështje politike, territoriale dhe ekonomike.

Me politikën që po ndjek, Kina shpejt do të bjerë në konflikt me Vietnamin<sup>1</sup>. Mes këtyre dy vendeve po ndodhin incidente të rënda në kufi, ekzistojnë pretendime nga secila palë për disa ishuj. Kinezët thonë se janë ishujt e tyre, kurse vietnamezët shpallin të kundërtën. E ç'politikë parimore mund të jetë kjo, të grindesh me Vietnamin për disa ishuj të vegjël të pabënuar, kur braktisen ishuj-shtete si Tajvani? Por midis Kinës dhe Vietnamit ka edhe kontradikta politike. Kina kërkon «pjesën që i takon» në Vietnam, në bazë të kontributit që dha për çlirimin e tij, mirëpo tani ajo s'është as në gjendje, as e gatshme të japë atë «ndihmë» që japin sovjetikët etj.

---

1. Ky parashikim i bazuar i shokut Enver Hoxha u vërtetua më 19 shkurt 1979, kur Kina agresive socialimperialiste shpërtheu luftën me armë kundër Vietnamit, duke ndezur në këtë mënyrë një vatër zjarri në këtë rajon.

Po të flasim për influencën e Kinës në vendet e Amerikës Latine, do të humbasim kohë. Ajo nuk ka këtu asnjë influencë, as politike, as ideologjike, as ekonomike. E gjithë influenca e Kinës qëndron në miqësinë me njëfarë Pinoçeti, që është një fashist e gjakatar i tërbuar. Ky qëndrim i Kinës ka zemëruar jo vetëm popujt e Amerikës Latine, por edhe opinionin botëror. Këta shohin se udhëheqja kineze është pro qeveritarëve shtypës, pro diktatorëve dhe gjeneralëve që sundojnë mbi popujt, është pro imperializmit amerikan që u ka hedhur kthetrat në grykë popujve të këtij kontinenti. Pra, influenca e Kinës në vendet e Amerikës Latine mund të themi se është e parëndësishme, pa forcë, pa brendi.

Politika e udhëheqësve kinezë jo vetëm që nuk gëzon simpatinë dhe mbështetjen e popujve, por ajo do të bëjë që Kina të izolohet gjithnjë e më shumë nga shtetet përparimtare, nga proletariati botëror. Nuk mund të ketë popull, nuk mund të gjenden proletariat e revolucionarë që të mbështetin politikën e Kinës, kur shohin se në tribunën e Tien An Menit, siç ndodhi në ditën e festës kombëtare, më 1 Tetor të këtij viti, krahas udhëheqësve kinezë të qëndrojnë ish-gjeneralët nazistë gjermanë, ish-gjeneralët e admiralët militaristë japonezë, gjeneralët fashistë portugezë etj., etj.

Në rrugën e transformimit të saj në një superfuqi Kina nuk mund të ecë dot përpara pa intensifikuar shfrytëzimin e masave të gjera punonjëse të vendit të vet. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet e tjera kapitaliste do të kërkojnë të sigurojnë superfitime nga kapitalët që do të investojnë atje, do të bëjnë

edhe presione për ndryshime të shpejta e rrënjësore të bazës dhe të superstrukturës së shoqërisë kineze në drejtimin kapitalist. Intensifikimi i shfrytëzimit të masave shumëmilionëshe për të mbajtur borgjezinë kineze dhe aparatën e saj gjigant burokratik e për të përballuar shlyerjen e kredive dhe të kamatave të kapitalistëve të huaj, do të çojë patjetër në lindjen e kontradiktave të thella midis proletariatit dhe fshatarësisë kineze, nga njëra anë, dhe sundesve borgjezo-revizionistë, nga ana tjetër. Kjo do t'i vërë këta përballë masave punonjëse të vendit të vet, gjë që nuk mund të mos çojë në konflikte të mprehta e shpërthime revolucionare në Kinë.

### Maocedunideja — teori antimarksiste

Politika e Kinës për t'u bërë superfuqi e ka bazën e saj teorike te maocedunideja, që është një teori antimarksiste, revizioniste, shoviniste.

Vija politike dhe ideologjike që ndjek Partia Komuniste e Kinës po devijon drejt një oportunizmi të theksuar, drejt revizionizmit. Ky devijim, siç thamë, do ta kthejë Kinën në një vend kapitalist, në një shtet socialimperialist. Do të jetë socialimperialist, pavarësisht se Partia Komuniste e Kinës do të vazhdojë të vetëquhet marksiste-leniniste, pavarësisht se ajo do të vazhdojë të pretendojë se maocedunideja, nga e cila udhëhiqet, qenka barazi me marksizëm-leninizmin. Është më mirë të themi se ajo e hedh poshtë marksizëm-leninizmin.

Partia jonë u ka bërë një analizë të hollësishme lindjes e zhvillimit të revizionizmit jugosllav dhe atij sovjetik. Ajo ka demaskuar sidomos transformimet e thella kapitaliste dhe gjithë veprimtarinë e tyre kundërrevolucionare. Ne duhet të vazhdojmë t'i studiojmë lindjen dhe zhvillimin e revizionizmit në të gjitha variantet e tij dhe në luftë e sipër me të ta thellojmë këtë studim, t'i gjejmë rrënjët së keqes, pse kështu do ta luftojmë më mirë.

Rreziqet e mëdha të revizionizmit të mos i harrojmë, sidomos tani që ka dalë përpara një tjetër forcë e madhe oportuniste e antimarksiste, siç është revizionizmi kinez, sigurisht me specifikat e tij.

Partia jonë ka bindjen se Partia Komuniste e Kinës është në rrugën revizioniste. E ashtuquajtura teori e maocdunidesë është e zhveshur nga tiparet e marksizëm-leninizmit. Me këtë «teori» kanë spekuluar e spekulojnë në format e organizimit e në mënyrat e veprimit, në qëllimet strategjike e taktike të gjithë udhëheqësit kinezë, si ata që kanë qenë në fuqi më parë, ashtu edhe ata që kanë marrë aktualisht pushtetin për t'i vënë në jetë planet e tyre kundërrevolucionare.

Si kemi arritur në këto konkluzione?

Kur u krijua Partia jonë, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, si dhe pas Çlirimit, njohuritë e njerëzve tanë për Kinën ishin shumë të pakta. Por, si të gjithë revolucionarët në botë, edhe ne kishim krijuar një opinion progresist rreth saj: «Kina është një kontinent i madh, Kina lufton, në Kinë zien revolucioni kundër imperializmit të huaj, kundër koncesioneve» etj., etj. Në përgjithësi ne njihnim diçka për veprimtarinë e Sun

Jat Senit, për lidhjet dhe miqësinë e tij me Bashkimin Sovjetik dhe me Leninin; dinim diçka më në fund për Guomindanin, njihnim luftën e popullit kinez kundër japonezëve dhe ekzistencën e Partisë Komuniste të Kinës, që konsiderohej si një parti e madhe, me një marksist-leninist në krye, Mao Ce Dunin. Dhe kaq.

Kontaktet më të ngushta me kinezët: Partia jonë i pati vetëm pas vitit 1956. Këto kontakte erdhën duke u shtuar për arsyt e luftës që Partia jonë zhvilloi kundër revizionizmit modern hrushovian. Atëherë me Partinë Komuniste të Kinës, ose më saktë, me kuadrot drejtues të saj kontaktet tona u bënë më të shpeshta e më të afërta, sidomos kur Partia Komuniste e Kinës hyri vetë në konflikt të hapët me revizionistët hrushovianë. Por duhet të pohojmë se në takimet që kemi pasur me udhëheqësit kinezë, sido që kanë qenë të mira dhe shoqërore, Kina, Mao Ce Duni dhe Partia Komuniste e Kinës, në njëfarë mase, mbeteshin për ne një enigmë e madhe.

Po pse Kina, Partia e saj Komuniste dhe Mao Ce Duni ishin enigmë? Ishin enigmë, sepse shumë qëndrime, qofshin këto të përgjithshme, po edhe personale të udhëheqësve kinezë, për një sërë problemesh të mëdha politike, ideologjike, ushtarake dhe organizative ishin të lëkundura herë nga e djathta, herë nga e majta. Ata herë tregoheshin të vendosur, herë të pavendosur, nganjëherë mbanin edhe qëndrime të drejta, por më shumë binin në sy qëndrimet e tyre oportuniste. Politika kineze, në përgjithësi, gjatë gjithë periudhës që jetoi Maoja, ka qenë e lëkundshme, ajo ishte një politikë e koniunkturave, nuk kishte palcë kurrizore mark-

siste-leniniste. Ndryshe flitej sot për një problem të rëndësishëm politik, ndryshe nesër. Në politikën kinëze nuk mund të gjeje një fill të kuq të qëndrucshëm dhe konsekuent.

Natyrisht, të gjitha këto qëndrime tërhiqnin vëmendjen tonë dhe nuk i aprovonim, por megjithëkëtë për aq sa e njihnim veprimtarinë e Mao Ce Dunit, shkoni nga mendimi i përgjithshëm se ai ishte një marksist-leninist dhe disa pikëpamje të tjera e qëndrime politike të Mao Ce Dunit e të Partisë Komuniste të Kinës që nuk pajtoheshin me pikëpamjet dhe me qëndrimet marksist-leniniste të Partisë sonë, i konsideronim si taktika të përkohshme të një shteti të madh të diktuar nga situata të caktuara. Por me kalimin e kohës bëhej gjithnjë më e qartë se qëndrimet e Partisë Komuniste të Kinës nuk ishin vetëm taktikë.

Partia jonë, duke i analizuar faktet, arriti në disa konkluzione të përgjithshme dhe të veçanta, që e bënë të ishte vigjilente, por ajo i shmangej polemikës me Partinë Komuniste të Kinës dhe me udhëheqësit kinëzë, jo se kishte frikë të polemizonte me ta, por sepse të dhënat që kishte për rrugën e gabuar antimarksiste të kësaj partie dhe të vetë Mao Ce Dunit, nuk ishin të plota, ato nuk lejonin akoma të konkludohej plotësisht. Nga ana tjetër, për një kohë Partia Komuniste e Kinës kundërshtonte imperializmin amerikan dhe reaksionin. Ajo, gjithashtu, mbajti qëndrim kundër revizionizmit hrushovian sovjetik, pavarësisht se tashmë është e qartë se lufta e saj kundër revizionizmit sovjetik nuk diktohej nga pozita të drejta parimore marksist-leniniste.

Gjatë Revolucionit Kulturor, që shpërtheu Mac Ce

Duni, në veprimtarinë e Partisë Komuniste të Kinës dhe të shtetit kinez u vunë re ide dhe veprime politike, ideologjike dhe organizative të çuditshme, të cilat nuk bazoheshin në mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Duke gjykuar veprimet e dyshimta të mëparshme, si dhe ato që u konstatuan gjatë Revolucionit Kulturor, por sidomos ngjarjet pas këtij revolucioni e deri tash, ngritjet e uljet e njërit ose të tjetrit grup në udhëheqje, sot të grupit të Lin Biaos, nesër të atij të Ten Hsiao Pinit, të një Hua Kuo Feni etj., që secili kishte platformën e vet të kundërt me të tjetrit, të gjitha këto e nxitën Partinë tonë të thellohej më tepër në pikëpamjet e në veprimet e Mao Ce Dunit dhe të Partisë Komuniste të Kinës, në njohjen më të plotë të maocedunidesë.

Nga ana e Partisë Komuniste të Kinës nuk na është dhënë asnjë mundësi që t'i studionin format e organizimit të partisë e të shtetit kinez. Ne komunistët shqiptarë kishim dijeni vetëm për njëfarë organizimi të përgjithshëm shtetëror të Kinës dhe asgjë më shumë, mbasi nuk na krijoheshin mundësitë që të njiheshim me eksperiencën e partisë në Kinë, të shihnim si vepronte ajo, si ishte e organizuar, çfarë drejtimesh kishte marrë zhvillimi i punëve në sektorë të ndryshëm dhe cilat ishin konkretisht këto drejtime.

Udhëheqësit kinezë kanë vepruar me dinakëri. Ata nuk kanë bërë publike shumë dokumente të nevojshme për njohjen e veprimtarisë së partisë e të shtetit. Ata i ruheshin dhe i ruhen shumë botimit të dokumenteve të tyre. Edhe ato dokumente të pakta të botuara që disponohen, janë fragmentare. Ndërsa katër vëlli-



met me veprat e Maos, që mund të quhen zyrtare, jo vetëm përmbajnë materiale të shkruara deri në vitin 1949, por ato janë të ujditura me kujdes, në mënyrë të tillë që të mos i paraqesin ekzaktësisht situatat reale që janë zhvilluar në Kinë.

Paraqitja politike dhe teorike e problemeve në shtypin kinez, për të mos folur për literaturën, që ishte krejt e çoroditur, kishte vetëm karakter propagandistik. Artikujt ishin të mbushur plot me formula shabllone tipike kineze të shprehura me numra aritmetikë, si «tri të mirat dhe pesë të këqijat», «katër të vjetrat edhe katër të rejat», «dy kujtimet dhe pesë kontrollet e vetes», «tri të vërtetat dhe shtatë të rremat» etj., etj. Shtjellimi nga ana «teorike» i këtyre shifrave aritmetike ishte i zorshëm për ne që jemi mësuar të mendojmë, të veprojmë dhe të shkruajmë sipas teorisë dhe kulturës tradicionale marksiste-leniniste.

Udhëheqësit kinezë nuk ftuan për vizitë ndonjë delegacion të Partisë sonë për të studiuar eksperiencën e tyre. Edhe kur ka shkuar atje ndonjë delegacion, me kërkesën e Partisë sonë, më shumë i kanë bërë propagandë dhe e kanë çuar andej-këtej për vizita nëpër komuna e fabrika, sesa i kanë dhënë ndonjë shpjegim ose eksperiencë për punën e partisë. Dhe me kë e mbanin këtë qëndrim të çuditshëm? Me ne shqiptarët, miqtë e tyre, që i kemi mbrojtur në situatat më të vështira. Të gjitha këto veprime ishin për ne të pakuptueshme, por edhe një sinjal që tregonte se Partia Komuniste e Kinës nuk donte të na jepte një pasqyrë të qartë të gjendjes së saj.

Por akoma më shumë tërhoqi vëmendjen e Partisë

sonë Revolucionit Kulturor, për të cilin na dolën disa pikëpyetje të mëdha. Neve nuk na dukej qëndrim revolucionar kur shikonim që ky Revolucion Kulturor nuk udhëhiqej nga partia, por ishte një shpërthim kaotik pas një thirrjeje që bëri Mao Ce Duni. Autoriteti i Maos në Kinë bëri që të ngriheshin në këmbë miliona të rinj të paorganizuar, studentë dhe nxënës shkollash, që marshonin drejt Pekinit, drejt komiteteve të partisë dhe të pushtetit, të cilat i shpërndanë. Këta të rinj thuhej se përfaqësonin atëherë në Kinë «ideologjinë proletare», dhe do t'u mësonin partisë dhe proletarëve rrugën «e vërtetë»!

Një revolucion i tillë, që kishte karakter të theksuar politik, u quajt kulturor! Për Partinë tonë ky emërtim ishte jo i saktë, pse në të vërtetë në Kinë kishin shpërthyer një lëvizje politike dhe jo kulturore. Por kryesorja ishte fakti që ky «revolucion i madh proletar», nuk udhëhiqej as nga partia, as nga proletariati.

Kështu klasa punëtore u la mënjanë dhe kishte raste të shumta që ajo ishte kundër gardistëve të kuq, bile edhe përleshej me ta. Shokët tanë, që ishin atëherë në Kinë, kanë parë me sytë e tyre punëtorët e fabrikave që luftonin kundër të rinjve. Partia u shpërnda. Ajo u likuidua dhe komunistët e proletariati as përfilleshin. Kjo gjendje ishte shumë e rëndë.

Partia jonë e mbështeti Revolucionin Kulturor, sepse fitoret e revolucionit në Kinë ishin në rrezik. Vetë Mao Ce Duni na tha se partia dhe shteti atje ishin uzurpuar nga grupi renegat i Liu Shao Çisë dhe i Ten Hsiao Pinit dhe fitoret e revolucionit kinez ishin në rrezik. Në këto kushte, pavarësisht se kush ishte përgjegjës.

që punët kishin shkuar kaq larg, Partia jonë përkrahu Revolucionin Kulturor.

Zhvillimi kaotik i Revolucionit Kulturor dhe rezultatet e tij e forcuan edhe më shumë mendimin, të pakristalizuar mirë, se marksizëm-leninizmi në Kinë nuk njihej dhe nuk zbatohej, se në thelb Partia Komuniste e Kinës dhe Mao Ce Duni nuk kishin pikëpamje marksiste-leniniste, pavarësisht nga fasada dhe nga parullat që përdornin «për proletariatin, për diktaturën e tij dhe për aleancën me fshatarësinë e varfër» e të tjera e të tjera formula të tilla. Në realitet atje nuk ecej në bazë të ideologjisë proletare, pse qe futur një ideologji tjetër, maocedunideja, e përbërë nga një amalgamë pikëpamjesh që i ka rrënjët në të kaluarën politike, ideologjike të Kinës, në praktikën shtetërore dhe militariste të saj, në pikëpamjet e filozofëve të lashtë kinezë, por e kamufluar me disa parime të marksizëm-leninizmit. Këto pikëpamje nuk u zhdukën dot as gjatë luftës çlirimtare, as pas shpalljes së republikës, jo më në popull, por as te Partia Komuniste e Kinës dhe as te vetë Mao Ce Duni.

Partia Komuniste e Kinës, që në hapat e parë të veprimtarisë së saj, shfaqti tendenca të hapura nacionaliste e shoviniste, të cilat, siç tregojnë faktet, nuk mundën të çrrënjosen as në periudhat e mëvonshme. Li Da Çao, një nga themeluesit e Partisë Komuniste të Kinës, thoshte se «evropianët mendojnë që bota u përket ekskluzivisht të bardhëve dhe këta përbëjnë klasën superiore, ndërsa popujt me ngjyrë klasën inferiore. Populli kinez, vazhdon Li Da Çao, duhet të jetë i gatshëm të zhvillojë një luftë klasore kundër raca-

ve të tjera të botës, në të cilën ai do të tregojë edhe një herë veçoritë e veta kombëtare». Me të tilla pikëpamje u mbrujt që në fillim Partia Komuniste e Kinës.

Të tilla pikëpamje raciste dhe nacionaliste nuk duhej të ishin zhukur krejtësisht as nga mentaliteti i Mao Ce Dunit, pale i Liut dhe i Tenit. Në raportin që mbajti në Komitetin Qendror të Partisë, më 1938, Mao Ce Duni thoshte: «Kina e sotme është produkt i gjithë zhvillimit të kaluar të Kinës... Ne duhet të bëjmë përgjithësimin e gjithë të kaluarës sonë — që nga Konfuci deri te Sun Jat Seni — ...duhet të hyjmë në zotërim të këtyre vlerave. Kjo do të jetë një mbështetje e shëndoshë për udhëheqjen e lëvizjes së madhe të ditës së sotme»<sup>1</sup>.

Natyrisht, çdo parti marksiste-leniniste pohon se duhet të mbështetet në pasurinë e së kaluarës të popullit të vet, veçse mban parasysh se duhet të mbështetet jo në çdo pasuri të trashëguar, por vetëm në atë përparimtarë. Trashëgiminë reaksionare në fushën e ideve, si edhe në çdo fushë tjetër, komunistët e hedhin poshtë. Kinezët kanë qenë shumë konservatorë për sa u përket formave, brendisë dhe ideve të tyre të vjetra, bile edhe ksenofobë. Të vjetrën ata e ruanin si një thesar me vlerë të madhe. Gjithë eksperiencën revolucionare botërore, siç del nga bisedat që kemi bërë me ta, për kinezët nuk kishte shumë vlerë. Për ata ishin me vlerë vetëm politika e tyre, lufta që kanë zhvilluar

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 2, bot. shqip, f. 250-251.

kundër Çan Kai Shisë, marshimi i madh, teoria e Mao Ce Dunit. Sa për vlerat përparimtare të popujve të tjerë kinezët nuk kishin konsideratë, ose kishin fare pak, bile nuk merrnin as mundimin t'i studionin. Mao Ce Duni ka deklaruar se «kinezët duhet t'i lënë mënjanë formulat e krijuara nga të huajt». Po cilat janë këto formula, ai nuk e përcakton. Ai ka dënuar «të gjitha klishetë dhe dogmat e huajtura nga vendet e tjera». Këtu lind pyetja: mos vallë në këto «dogma» dhe «klishe» të huaja për Kinën përfshihet edhe teoria e socializmit shkencor që nuk është përpunuar prej kinezëve?

Udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës e ka konsideruar marksizëm-leninizmin si monopolin e Bashkimit Sovjetik, ndaj të cilit Mao Ce Duni dhe shokët e tij kanë ushqyer pikëpamje shoviniste, pikëpamje të shtetit të madh, kanë pasur, si të thuash, njëfarë xhelozie borgjeze. Ata nuk e kanë konsideruar Bashkimin Sovjetik të kohës së Leninit dhe të Stalinit si atdheun e madh të proletariatit botëror, tek i cili duhej të mbështeteshin proletarët e të gjithë botës për arritjen e revolucionit e që duhej ta mbronin me të gjitha forcat e tyre nga sulmi i madh i borgjezisë e i imperiaлизmit. Partia Komuniste e Kinës, me Mao Ce Dunin në krye, jo vetëm që nuk e kuptuan detyrën e mbrojtjes së Bashkimit Sovjetik, po bile edhe e luftuan shtetin e parë socialist të botës.

Po të thellohemi në gjithë zhvillimin e Kinës, do të kuptojmë se Mao Ce Duni, në fakt, nuk i ka pranuar të gjitha pikëpamjet shkencore të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Edhe ato që ka pranuar, ai

I ka shpjeguar dhe i ka zbatuar në mënyrë eklektike.

Është e vërtetë se Mao Ce Duni ka trajtuar teori-kisht disa probleme dhe është shprehur pozitivisht për disa parime bazë të marksizëm-leninizmit. Por bashkë me këtë në teoritë e tij ai ka përzier edhe pa-rime të tjera filozofike që janë idcaliste, oportuniste, liberale, revizioniste, bile shumë herë dhe të hapëta borgjeze.

Vetë Mao Ce Duni ka pranuar se mendimet e tij mund të shfrytëzohen nga të gjithë, edhe nga të maj-tët, edhe nga të djathtët. Dhe tani ato po shfrytëzohen nga të djathtët. Kjo do të thotë se Mao Ce Duni nuk ka qenë kurrë i vendosur në vijën e socializmit shken-cor. Ai ishte i vendosur për një lloj «socializmi» ki-nez. Pikërisht këtu i nxjerr veshët maocedunideja, që si «teori» u shpalos në Revolucionin Kulturor. Maoce-dunideja është një ideologji revizioniste, etatiste e spe-ciale për Kinën, që mbështetet në ushtrinë pretorianc dhe në administratorët teknokratë.

Prandaj shkrimet «teorike» të Mao Ce Dunit du-het të shikohen me një sy shumë kritik dhe jo në mënyrë të përciptë. Duhet të kemi kujdes nga lustra e përdorur në frazeologjinë e në sloganet dhe të mos harrojmë të vëzhgojmë më thellë zbatimin e parimeve të shprehura në këto slogane. Po të shikojmë se si zba-tohen në jetë ato që thuhën, do të dalim me mendimet që na janë krijuar nga zhvillimi i situatave konkre-te në Kinë, nga konsekuencat që ka pësuar revolu-cioni kinez, se maocedunideja është shumë larg mark-sizëm-leninizmit.

Le të shohim më konkretisht disa nga çështjet

kryesore ku duket më qartë ndryshimi rrënjësor i maocedunidesë nga marksizëm-leninizmi.

Maoja flet për parimet leniniste në formimin e partisë dhe të shtetit socialist në Kinë, por, kur analizon në shkrimet e tij çështjet e organizimit të partisë, normat e partisë, ideologjinë e partisë dhe organizimin e shtetit kinez, duket qartë se bazat e teorisë marksiste-leniniste, ku ai pretendon se mbështetet, janë shtrembëruar.

Këtë e dëshmon edhe situata politiko-ideologjike që sundon aktualisht në Kinë. Mao Ce Duni nuk e ka organizuar Partinë Komuniste të Kinës në bazë të parimeve të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Ai nuk ka punuar për ta bërë atë një parti të tipit leninist, një parti bolshevike. Mao Ce Duni nuk e ka sqaruar kurrë si duhet rolin e partisë. Gjatë gjithë jetës së Partisë Komuniste të Kinës jo vetëm kanë ekzistuar dhe kanë vepruar në gjirin e saj fraksione të ndryshme, por në këtë parti as ka pasur, as ka unitet të vërtetë marksist-leninist mendimi e veprimi. Atje predikohej nevoja e ekzistencës dhe e ruajtjes së «dy vijave» në parti.

Revizionizmi modern jo vetëm si parim, por edhe si praktikë, kudo krijon përçarjen në fushat politike, ideologjike dhe organizative; ai shkakton dobësimin e forcave të proletariatit dhe të luftës revolucionare dhe krijon në gjirin e tij fraksione të ndryshme. Kjo ka ngjarë në të gjitha vendet revizioniste ku është tradhtuar marksizëm-leninizmi, kjo ndodhi edhe në Kinë.

Kohët e fundit në gazetën «Zhenminzhibao» u bo-

tua një artikull, i shkruar nga një i ashtuquajtur grup teorik i Zyrës së Përgjithshme të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës<sup>1</sup>. Artikulli pohon se Maoja, nën emrin e Zyrës së Përgjithshme, kishte krijuar rreth vetes një aparat të posaçëm që survejonte dhe mbante nën kontroll Byronë Politike, Komitetin Qendror të Partisë, kuadrot e shtetit, të ushtrisë, të sigurimit etj. Në këtë zyrë u ishte ndaluar hyrja dhe njohja me punën e saj të gjithëve, duke përfshirë Komitetin Qendror dhe Byronë Politike. Këtu hartoheshin projektet për rrëzimin ose për ngritjen e këtij apo të atij grupi fraksionist. Njerëzit e kësaj zyre ndodheshin kudo, përgjonin, vëzhgonin e raportonin në mënyrë të pavarur dhe jashtë kontrollit të partisë. Përveç këtyre, kjo zyrë kishte në dispozicion të saj edhe reparte të tëra të armatosura, që fshiheshin pas emrit të «gardës së kryetarit Mao». Kjo gardë pretoriane prej më se 50 000 vetash hynte në veprim kur kryetari vendoste «të vepronte me një të goditur», siç ka ndodhur shpesh në historinë e Partisë Komuniste të Kinës dhe siç ndodhi tani së fundi me arrestimin e «katërshes» e të përkrahësve të saj nga Hua Kuo Feni.

Nën pretekstin e mbajtjes së kontakteve me masat, Mao Ce Duni kishte krijuar, gjithashtu, një rrjet të posaçëm informatorësh për terrenin, të cilëve u qe ngarkuar detyra të hetonin e të survejonin pa dijeninë e kurrkujt kuadrot e bazës, gjendjen dhe psikologjinë

---

1. «Të kemi gjithnjë në mendje mësimet e kryetarit Mao dhe të këmbëngulim në vazhdimin e revolucionit nën diktaturën e proletariatit», «Zhenminzhibao», 8 shtator 1977.



e masave. Këta i raportonin drejtpërdrejt vetëm Mao Ce Dunit, i cili i kishte prerë të gjitha mjetet e komunikimit me masat dhe e shihte botën nëpërmjet të dhënave të agjentëve të Zyrës së Përgjithshme.

Përse është shkruar dhe çfarë synon ky artikull, nuk dihet. Ndoshta ai bën pjesë dhe shpreh luftën e fraksioneve të ndryshme. Por, sidoqoftë, ai dëshmon se në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës kanë vepruar norma krejtësisht të huaja për marksizëm-leninizmin dhe për partinë e tipit leninist. Të tilla veprime janë të ngjashme me ato të perandorëve të mesjetës.

Artikulli i «Zhenminzhibaos» jep të dhëna të reja për të kuptuar edhe më mirë drejtimin antimarksist dhe pushtetin personal të Mao Ce Dunit në partinë dhe në shtetin kinez. Artikulli e bën të qartë se diktatura e proletariatit në Kinë nuk ka ekzistuar dhe nuk ekziston në realitet, se drejtim kolegjal në parti nuk ka pasur ndonjëherë, se organizimi shtetëror i Republikës Popullore të Kinës është një organizim i tipit konfucian modern, kapitalist, teknikist dhe praktikist, por në asnjë mënyrë revolucionar.

Në kinë ka pasë ekzistuar prej kohësh një drejtim prej perandori, që do të thotë se Mao Ce Duni, udhëheqësi i Partisë Komuniste dhe i shtetit kinez, kishte pushtet të pakufizuar, atje bëhej siç mendonte dhe urdhëronte ai. Dikur ai ka pasë caktuar Liu Shao Çinë si zëvendësin e tij. Më vonë ai shpalli se trashëgimtari i pushtetit dhe i partisë, pas vdekjes së tij, do të ishte Lin Biaoja. Kjo gjë, që nuk është parë ndonjëherë në praktikën e partive marksiste-leniniste, u sanksionua

deri në statutin e partisë. Ishte përsëri Mao Ce Duni ai që caktoi Hua Kuo Fenin kryetar të partisë, pasi të vdiste. Vetë Maoja, duke pasur fuqinë në dorë, kritikonte, gjykonte, ndëshkonte dhe pastaj rehabilitonte udhëheqës të lartë të partisë dhe të shtetit. Kështu ndodhi edhe me Ten Hsiao Pinin, i cili në të ashtuquajturën autokritikë të tij, më 23 tetor 1966, ka pohuar: «Unë dhe Liu Shao Çi jemi monarkistë të vërtetë. Thelbi i gabimeve të mia qëndron në faktin se unë nuk kam besim te masat, nuk i përkrah masat revolucionare, por qëndroj kundër tyre, kam ndjekur një vijë reacionare për të shtypur revolucionin, në luftën klasore nuk kam qëndruar në anën e proletariatit, por të borgjezisë... Të gjitha këto tregojnë se... nuk jam i përshtatshëm të mbaj poste me përgjegjësi»<sup>1</sup>. Dhe me gjithë këto krime që ka bërë ky revizionist me damkë, u rikthye në kolltukun që kishte.

Artikulli i «Zhenminzhibaos» jep të dhëna të reja për të kuptuar edhe më mirë drejtimin antimarksist dhe pushtetin personal të Mao Ce Dunit në partinë dhe në shtetin kinez. Mao Ce Duni nuk ka pasur konsideratën më të vogël as për Komitetin Qendror, as për kongresin e partisë, pa lëre më për partinë në tërësi dhe për komitetet e saj në bazë. Komitetet e partisë, kuadrot udhëheqës dhe deri vetë Komiteti Qendror merrnin urdhra nga Zyra e Përgjithshme, nga ky «shtab i veçantë», i cili pyeste vetëm Mao Ce Dunin. Forumet e partisë, organet e zgjedhura të saj nuk kishin asnjë kompetencë. Në artikullin e «Zhenminzhibaos» thuhet

---

1. Nga autokritika e Ten Hsiao Pinit (AQP).

se «asnjë telegram, asnjë letër, asnjë shkresë, asnjë urdhër, nuk mund të jepej nga kurrkush pa kaluar më parë nga Mao Ce Duni dhe pa u aprovuar më parë prej tij». Maoja ka thënë: «Për veten time, unë jam një njeri që nuk i dëgjoj radiot, as ato të huajat dhe as atë të Kinës, po vetëm transmetoj». Ai ka pohuar gjithashtu: «Kam deklaruar hapur se nuk do ta lexoj më gazetën «Zhenminzhibao». Këto ia thashë edhe kryeredaktorit të saj: Unë nuk e lexoj gazetën tënde»<sup>1</sup>.

Siç duket, partia në Kinë ekziston sa për formë, zhvillohen në të edhe diskutime e bëhen gjithfarëlloj muhabetesh, bëhet edhe «kritikë» e «autokritikë», por kjo parti nuk është operuese, nuk është e fortë dhe e unifikuar, në radhët e saj qarkullojnë njëqind e një pikëpamje dhe mendime, ka me të vërtetë «njëqind lule» që lulëzojnë. Me fjalë të tjera, Partia Komuniste e Kinës nuk është një parti leniniste, po një parti që udhëhiqet nga maocedunideja, që nuk është marksizëm-leninizëm.

Në Kinë pushteti vazhdon të jetë në duart e ushtrisë, kurse partia qëndron në bisht. Kjo është karakteristikë e përgjithshme e vendeve ku sundon revizionizmi. Vendet e vërteta socialiste e forcojnë ushtrinë, si armë të fuqishme të diktaturës së proletariatit, për të shtypur armiqtë e socializmit, në rast se ngrenë krye, si dhe për të mbrojtur vendin nga një sulm i mundshëm nga ana e imperialistëve dhe e reaksionit të jashtëm. Por që ushtria ta luajë gjithnjë këtë rol, ajo,

---

1. Nga biseda e Mao Ce Dunit me shokë të Partisë sonë, 3 shkurt 1967 (AQP).

siç na mëson marksizëm-leninizmi, duhet të jetë kurdoherë nën drejtimin e partisë dhe jo të jetë partia nën drejtimin e ushtrisë.

Aktualisht në Kinë ligjin e bëjnë fraksionet më të forta të ushtrisë dhe që janë ato më reaksionaret, që synojnë ta shndërrojnë Kinën në një vend socialimperialist.

Pavarësisht nga formulat që përdorte Mao Ce Duni duke thënë «partia mbi ushtrinë», «politika mbi pushkën» etj., etj., ai në praktikë rolin kryesor politik në jetën e vendit ia linte ushtrisë. Si në kohën e luftës çlirimtare, edhe pas krijimit të Republikës Popullore të Kinës, në të gjitha luftërat e vazhdueshme që janë bërë atje për marrjen e pushtetit nga ana e njërit ose e tjetrit fraksion, ushtria ka luajtur rolin vendimtar. Edhe gjatë Revolucionit Kulturor ushtria luajti rolin kryesor; ajo ishte rezerva e fundit e Maos. «Ne, — ka thënë Mao Ce Duni në vitin 1967, — mbështetemi në forcën e ushtrisë... Në Pekin kemi pasur vetëm dy divizione, por në maj sollëm dhe dy të tjera për të larë hesapet me ish-komitetin e partisë të Pekinit»<sup>1</sup>.

Mao Ce Duni, për të likuiduar kundërshtarët e vet ideologjikë, ka vënë kurdoherë në lëvizje ushtrinë. Ai ngriti ushtrinë me në krye Lin Biaon për të vepruar kundër grupit të Liu Shao Çisë dhe Ten Hsiao Pinit. Më vonë me Çu En Lain ai organizoi dhe e hodhi ushtrinë kundër Lin Biaos. E frymëzuar nga maocedunideja ushtria ka luajtur një rol të tillë edhe pas vdekjes së Maos. Si të gjithë ata që kanë ardhur në fuqi në

---

1. Nga biseda e Mao Ce Dunit me delegacionin e miqësisë të RPSH, 18 dhjetor 1967 (AQP).

Kinë, edhe Hua Kuo Feni u mbështet dhe veproi me ushtrinë. Ky, sa vdiq Maoja, ngriti përnjëherë ushtrinë, organizoi, bashkë me ushtarakët Jeh Çien Jin, Van Tun Hsin e të tjerë, puçin, arrestoi kundërshtarët e tij.

Në të ardhmen, krahas shndërrimit të Kinës në një superfuqi imperialiste, do të rriten gjithnjë e më shumë edhe roli e forca e ushtrisë në jetën e vendit. Ajo do të forcohet si një gardë pretoriane e armatosur deri në dhëmbë për mbrojtjen e një regjimi dhe të një ekonomie kapitaliste. Ajo do të jetë vegla e një diktature borgjeze kapitaliste, e një diktature që, në rast se rezistenca popullore do të jetë e fortë, mund të marrë edhe forma të hapëta fashiste.

Konceptet antimarksiste të maocedunidesë për revolucionin duken edhe më qartë në trajtimin që Maoja u ka bërë forcave lëvizëse të revolucionit. Mao Ce Duni nuk njihte rolin hegjemon të proletariatit. Lenini ka thënë se në periudhën e imperializmit, në çdo revolucion, pra edhe në revolucionin demokratik, në revolucionin antiimperialist nacionalçlirimtar dhe në revolucionin socialist, udhëheqja duhet t'i takojë proletariatit. Ndërsa Mao Ce Duni, megjithëse fliste për rolin e proletariatit, në praktikë nënvleftësonte hegjemoninë e tij në revolucion dhe ka ngritur lart rolin e fshatarësisë. Mao Ce Duni ka thënë se «...lufta e sotme kundër pushtuesve japonezë është, në thelb, luftë fshatare. Rendi politik i demokracisë së re, në thelb, do të thotë t'i japësh fshatarësisë pushtetin»<sup>1</sup>.

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 3, bot. shqip, t. 177-178.

Këtë teori mikroborgjeze Mao Ce Duni e shprehte në tezën globale «fshati të rrethojë qytetin», «...fshati revolucionar, — shkruante ai, — mund të rrethojë qytetet... puna në fshat duhet të luajë rolin kryesor në lëvizjen revolucionare kineze, kurse puna në qytet — një rol të dorës së dytë»<sup>1</sup>. Sipas Maos del se fshatarësia dhe jo klasa punëtore duhet të jetë hegjemone në revolucion.

Teza për rolin hegjemon të fshatarësisë në revolucion u predikua nga Mao Ce Duni edhe si rrugë e revolucionit botëror. Këtu e ka burimin koncepti anti-marksist që e konsideron të ashtuquajturën botë të tretë, që në letërsinë politike kineze quhet edhe «fshati botëror», si «forcën kryesore lëvizëse për transformimin e shoqërisë së sotme». Sipas pikëpamjeve kineze, proletariati është një forcë shoqërore e dorës së dytë, që nuk mund ta luajë atë rol që parashikojnë Marksi dhe Lenini në luftën kundër kapitalizmit dhe në fitoren e revolucionit, në aleancë me të gjitha forcat e shtypura nga kapitali.

Në revolucionin kinez ka dominuar borgjezia e vogël dhe e mesme. Është kjo shtresë e gjerë e mikroborgjezisë që ka influencuar në gjithë zhvillimin e Kinës.

Mao Ce Duni nuk bazohej në teorinë marksiste-leniniste që na mëson se fshatarësia, përgjithësisht borgjezia e vogël, është e lëkundshme. Natyrisht, fshatarësia e varfër dhe e mesme luan një rol të rëndësishëm në revolucion dhe ajo duhet të bëhet aleate e ngushtë e proletariatit. Por klasa fshatare, borgjezia e vogël,

---

1. Mao Ce Dun, Vepra të zgjedhura, vëll. 4, bot. shqip, f. 257, 259.

nuk mund ta udhëheqë proletariatin në revolucion. Të mendosh dhe të predikosh të kundërtën do të thotë të jesh kundër marksizëm-leninizmit. Këtu qëndron edhe një nga burimet kryesore të pikëpamjeve antimarksiste të Mao Ce Dunit, që kanë influencuar negativisht në tërë revolucionin kinez.

Parimi bazë revolucionar e udhërrëfyes për hegjemoninë e proletariatit në revolucion për Partinë Komuniste të Kinës nuk ka qenë i qartë as në teori dhe rrjedhimisht nuk zbatohet si duhet e me konsekuencë as në praktikë. Përvoja tregon se fshatarësia mund ta luajë rolin e saj revolucionar vetëm në qoftë se ajo vepron në aleancë me proletariatin dhe nën udhëheqjen e tij. Një gjë e tillë u provua edhe në vendin tonë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Fshatarësia shqiptare ishte forca kryesore në revolucionin tonë, megjithëkëtë klasa jonë punëtore, sido që ishte shumë e vogël në numër, e udhëhoqi fshatarësinë, sepse ideologjia marksiste-leniniste, ideologjia e proletariatit, e mishëruar në Partinë Komuniste, sot Partia e Punës, pararoja e klasës punëtore, ishte udhëheqësja e revolucionit. Prandaj ne fituam jo vetëm në Luftën Nacionalçlirimtare, por edhe në ndërtimin e socializmit.

Ne patëm suksese të njëpasnjëshme, me gjithë vështirësitë e panumërta që hasëm në rrugë. Këto suksese, në radhë të parë, i arritëm sepse Partia përvetësoi mirë thelbin e teorisë së Marksit e të Leninit, kuptoi ç'ishte revolucionit, kush e bënte dhe kush duhej ta udhëhiqte atë, kuptoi se në krye të klasës punëtore, në aleancë me fshatarësinë, duhej të ishte një parti e tipit leninist. Komunistët kuptuan se kjo parti nuk duhej të

kishte vetëm emrin komuniste, por të ishte edhe një parti që të zbatonte në kushtet e vendit tonë teorinë marksiste-leniniste të revolucionit e të ndërtimit të Partisë, t'i hynte punës për krijimin e shoqërisë së re socialiste në shembullin e ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik të kohës së Leninit e të Stalinit. Ky qëndrim i dha Partisë sonë fitoren, i dha vendit forcën e madhe politike, ekonomike dhe ushtarake që ka sot. Po të ishte vepruar ndryshe, po të mos zbatoheshin me konsekuencë këto parime të teorisë sonë të madhe, në një vend të vogël si yni, të rrethuar me armiq, nuk mund të ndërtohej socializmi. Edhe në qoftë se për një moment do të merrej pushteti, atë do ta rrëmbente përsëri borgjezia, sikundër ndodhi në Greqi, ku, akoma pa u fituar lufta, Partia Komuniste Greke ua dorëzoi armët borgjezisë reaksionare të vendit dhe imperializmit anglez.

Partia në Kinë edhe pas çlirimit ka mbajtur qëndrime dashamirëse oportuniste ndaj klasave shfrytëzuese dhe në praktikë e ka ndarë pushtetin me to.

Borgjezia kineze ka pasur rolin dhe pjesën e saj të paprekur në Kinën e çliruar. Administrata shtetërore mbeti në duart e funksionarëve të vjetër. Gjeneralët e Çan Kai Shisë u bënë edhe ministra. Kulakëria, në format që ka ekzistuar në Kinë, ka ruajtur, në një mënyrë ose në tjetrën, avantazhe dhe përfitime të caktuara. Partia Bolshevike dhe Lenini u bënë thirrje klasës punëtore dhe popullit sovjetik të ngriheshin në këmbë, të ishin vigjilentë, të mposhtnin intervencionin dhe të goditnin me ashpërsinë më të madhe kulakët, armiqtë e fshatarësisë, aleates besnike të klasës punë-



tore. Një politikë dhe një vendosmëri të tillë klasore nuk e kemi parë në Kinë. Mao Ce Duni ka predikuar butësinë ndaj armiqve të klasës punëtore. Ai ka thënë se «një kokë që pritet, qoftë kjo edhe e armikut, nuk vihet më në vend», prandaj thoshte: «Ta ruajmë kokën e armikut të klasës, të jemi të butë ndaj kësaj koke, s'ka gjë se ajo përpiqet dhe është gati të rrëmbejë përsëri fuqinë».

Pas çlirimit shohim të zbatohet deri diku në Kinë eksperiencia e Bashkimit Sovjetik në ndërtimin socialist. Por nga viti 1956 e më vonë kjo punë filloi të marrë pamje të reja për sa u përket organizimit, politikës dhe ideologjisë. Më 1956 ne kemi asistuar vetë në punimet e Kongresit të 8-të të Partisë Komuniste të Kinës dhe me të vërtetë u habitëm nga vija që u shtrua atje. Dukej qartë ekzistenca e një aleance të shumë klasave «demokratike». Kjo gjë, siç na u tha, midis të tjerave, reflektohet edhe në flamurin shtetëror të Republikës Popullore të Kinës me katër yje, që përfaqësojnë katër klasa: klasën punëtore, fshatarësinë, borgjezinë e vogël të qyteteve dhe borgjezinë kombëtare. Siç mundëm të vërenim gjatë zhvillimit të punimeve të kongresit, Partia Komuniste e Kinës, Liu Shao Çia dhe Mao Ce Duni u jepnin pushtet partive të borgjezisë kineze.

Më pas e pamë Mao Ce Dunin të dilte nga binarët e teorisë së luftës së klasave dhe të predikonte «lulëzimin e 100 luleve dhe të 100 shkollave». Këto fakte të hidhura të shoqërisë kineze tregonin se atje nuk po ecej në rrugën marksiste-leniniste.

Pasi erdhi në fuqi, Hua Kuo Feni publikoi fjalimin e Maos «Mbi dhjetë marrëdhëniet kryesore» që ai pas-

kësh parashtruar në një mbledhje të Byrosë Politike qysh më 1956. Në këtë fjalim thuhet haptazi se Kina nuk drejtohet vetëm nga Partia Komuniste, por nga të gjitha partitë që ekzistojnë atje. Këto parti, sipas pikëpamjeve të Maos, të shprehura në këtë fjalim, kanë të njëjtat të drejta që ka edhe Partia Komuniste. Mao Ce Duni nënvizon aty se të gjitha këto parti borgjeze do të zhduken kur të zhduket edhe Partia Komuniste e Kinës. Në drejtimin e revolucionit, në drejtimin e pushtetit, në luftën për ndërtimin e socializmit, sipas Maos, duhet të bashkëpunohet me të gjitha partitë, domethënë të zbatohet pluralizmi, pikërisht siç predikojnë aktualisht të ashtuquajturat parti komuniste italiane, spanjolle dhe franceze.

Si rrjedhim i kësaj vije jomarksiste, i koncepteve maoiste për klasat dhe për rolin e tyre në revolucion, në Kinë proletariati nuk ka qenë plotësisht në fuqi, atje nuk është ecur në rrugën e drejtë të ndërtimit të shoqërisë socialiste. Në shoqërinë kineze kanë ekzistuar dhe vazhdojnë të ekzistojnë jo vetëm mbeturina ekonomike, politike, ideologjike e sociale të së kaluarës, por atje ekzistojnë edhe klasat shfrytëzuese si klasa, të cilat kanë qëndruar dhe vazhdojnë të qëndrojnë në fuqi. Ekziston, gjithashtu, edhe degjenerimi i një shtrese ose i elementëve të ndryshëm, që dikur luftuan për çlirim të Kinës, por që tani janë borgjezuar.

Nga eksperiencia jonë dhe nga eksperiencia e revolucioneve të tjera socialiste dimë se në kthesat rrënjësore revolucionare, gjatë periudhës së ngritjes së revolucionit, me proletariatin bashkohen edhe shtresa të borgjezisë së mesme e të vogël. Partia duhet të mbajë

parasysh se disa nga këta elementë, edhe nga ata që kanë bërë luftën nacionalçlirimtare, në momente të caktuara mund ta braktisin qëllimin e madh për të cilin kanë luftuar ose shkojnë deri në një vend dhe pastaj qëndrojnë, nuk ecin më përpara ose e tradhtojnë këtë luftë. Ka, po ashtu, edhe njerëz të klasës, që kanë bërë luftën, që janë treguar dhe tregohen të vendosur, por që, po të mos ushqehen vazhdimisht me idealet e marksizëm-leninizmit, edhe ata mund të degjenerojnë. Kur elementë të tillë ndodhen në krye të partisë e të shtetit, për arsye se kanë bërë revolucionin, për arsye se kanë qenë në «marshimin e madh», por nga ana tjetër ruajnë koncepte e mentalitete borgjeze, rreziku për degjenerimin e partisë, për degjenerimin e rrugës socialiste, për restaurimin e kapitalizmit është më i madh. Këta njerëz që kanë pushtet luftojnë për të siguruar privilegje dhe mbështetin njëri-tjetrit, rrugë kjo që i çon në krijimin e një klase të re. Këtë çështje Partia Komuniste e Kinës nuk e ka pasur dhe nuk e ka të qartë dhe sa kohë që shkon, kjo bëhet akoma më e errët.

Nga ekipi që ka ardhur tani në fuqi në Kinë flitet se «katërshja» i nënvleftësonte kuadrot e vjetër. Ne nuk e dimë nëse i nënvleftësonte dhe sa i nënvleftësonte. Në rast se i nënvleftësonte, ajo natyrisht ka bërë gabim. Por jeta ka treguar se ka edhe kuadro të vjetër, të cilët mund të degjencrojnë, siç kanë degjeneruar disa edhe te ne, siç kanë degjeneruar sidomos në Bashkimin Sovjetik e gjetkë. Atëherë përse nuk paska edhe në Kinë elementë që kanë bërë luftën dhe që janë borgjezuar e kanë degjeneruar? Mundësitë kanë qenë dhe

janë, aq më tepër në Partinë Komuniste të Kinës, ku lejohej ekzistenca e dy vijave dhe ku shumë anëtarë të saj kanë ardhur nga partitë demokratike borgjeze, bile edhe nga Guomindani.

Vija maoceduniste e drejtoi Kinën jo në rrugën e vërtetë të socializmit. Partia Komuniste e Kinës quhej komuniste, por ajo u zhvillua në një drejtim tjetër, në një rrugë liberale, kaotike, në një rrugë oportuniste, që më vonë do të konkretizohej edhe më qartë, siç ndodh tani pas vdekjes së Maos. Ky drejtim nuk është socialist, përkundrazi, rruga ku po ecet çon drejt ndërtimit të një shteti të madh borgjez, socialimperialist.

Mao Ce Duni ka folur shumë herë për rrezikun e «shtetit të madh», të «botëkuptimit të shtetit han», por në realitet ky botëkuptim, edhe pse Maoja e ka kritikuar, nuk është zhdukur. Përkundrazi, ai është forcuar, pse Maoja e ka ushqyer me ideologjinë e tij jo-marksiste. Megalomania e shtetit të madh kinez është zhvilluar e është forcuar mbi bazën e gjerësisë së territorit dhe të numrit të madh të popullsisë, është nxitur edhe nga fitorja e revolucionit kinez mbi japonezët, mbi Çan Kai Shinë dhe mbi borgjezinë e madhe kompradore të vendit. Kjo ka krijuar në Partinë Komuniste të Kinës një sëmundje që nuk e ka lejuar atë të korrigjojë të metat. Dhe ajo nuk mund t'i korrigjonte dot këto të meta në vijë, në politikë, në organizim, përderisa nuk udhëhiqej nga busulla e marksizëm-leninizmit.

Pikëpamjet e Mao Ce Dunit dhe të Partisë Komuniste të Kinës, pas vdekjes së Leninit, janë zhvilluar në kundërshtim me idetë dhe me eksperiencën e Re-

volucionit të Madh Socialist të Tetorit. Kur në krye të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ishte Stalini, mendimet e Mao Ce Dunit janë zhvilluar në kundërshtim edhe me Kominternin. Dekada më parë, Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, dy nga liderët kryesorë të politikës e të ideologjisë së ashtuquajtur maocedunide, kanë folur dhe kanë vepruar kundër Bashkimit Sovjetik të udhëhequr nga Stalini, kanë folur kundër Stalinit dhe në përgjithësi kundër Kominternit. Qëndrimin e Kominternit në drejtim të Kinës ata e kanë quajtur të gabuar.

Por realiteti i sotëm kinez vërteton edhe një herë se qëndrimi i Kominternit ndaj Partisë Komuniste të Kinës ka qenë i drejtë. Kominterni dhe sidomos Stalini kishin kuptuar që në atë kohë se Partia Komuniste e Kinës dhe udhëheqja e saj nuk i zbatonin me konsekuencë parimet e marksizëm-leninizmit lidhur me rolin udhëheqës të proletariatit në revolucion, nuk i zbatonin drejt parimet e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar gjatë luftës çlirimtare kundër push-tuesve japonezë e më vonë kundër Çan Kai Shisë dhe përkrahësve të tyre, imperialistëve amerikanë. Duke biseduar me ne këtu në Tiranë, Çu En Lai na ka thënë: «Stalini dyshonte se mos ne ishim pro amerikanëve ose mos ndiqnim rrugën jugosllave»<sup>1</sup>. Koha provoi se Stalini ka pasur plotësisht të drejtë. Parashikimet e tij për revolucionin kinez dhe për idetë që e udhëhoqën atë dolën të sakta.

---

1. Nga biseda e Çu En Lait me shokët e Partisë sonë, 1968 (AQP).

Konsekuencat e vijës maoceduniste, antimarksizmi që karakterizon Partinë Komuniste të Kinës, duken jo vetëm në realitetin e sotëm kinez. Ato pasqyrohen edhe në qëndrimet e në veprimtarinë e kësaj partie në lëvizjen komuniste marksiste-leniniste ndërkombëtare. Partia Komuniste e Kinës ka hyrë në rrugën e përçarjes së unitetit të klasës punëtore kudo në botë, ajo ka bashkuar forcat e saj me forcat e revizionistëve dhe të oportunistëve të tjerë që të minojnë lëvizjen revolucionare antiimperialiste botërore.

Pas daljes së revizionizmit modern në Bashkimin Sovjetik dhe shndërrimit të shumë partive komuniste në revizioniste e si rrjedhim i intensifikimit të shtypjes së egër të masave punonjëse nga ana e kapitalizmit botëror, në shumë vende lindën parti të reja marksiste-leniniste revolucionare. Cili ka qenë qëndrimi kinez ndaj këtyre partive të reja? Partia Komuniste e Kinës në fillim nuk pati as më të voglin besim në to. Këtë pikëpamje e ka shprehur haptazi Gën Biaoja, personi që vendos në Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Kinës për sa u përket marrëdhënieve të saj me lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ai ka thënë se «Kina nuk e aprovon krijimin e partive marksiste-leniniste dhe nuk dëshiron që përfaqësuesit e këtyre partive të vijnë në Kinë. Ardhja e tyre na prish punë, ka nënvizuar ai, por nuk kemi ç't'u bëjmë, se nuk mund t'i dëbojmë. Ne i pranojmë ata ashtu sikurse pranojmë edhe përfaqësuesit e partive borgjeze»<sup>1</sup>. Një politikë

---

1. Nga blseda e Gën Biaos me shokë të Partisë sonë në Pekin, më 16.4.1973 (AQP).

e tillë, që nuk kishte asgjë të përbashkët me internacionalizmin proletar, ndiqej që në kohën kur ishte gjallë Mao Ce Duni, kur ai ishte plotësisht në gjendje të mendonte e të drejtonte, pra kishte aprovimin e plotë të tij.

Pasi këto parti të reja marksiste-leniniste, në kundërshtim me dëshirat e udhëheqësve kinezë, filluan të forcohen, atëherë ata ndoqën një taktikë tjetër, njohjen e të gjitha partive të reja dhe të çdo grupi pa përjashtim dhe pa asnjë dallim, mjaft që ta quanin veten «parti marksiste», «parti revolucionare», «gardë e kuqe» etj. Këtë qëndrim dhe taktikë që ka ndjekur Partia Komuniste e Kinës, Partia e Punës e Shqipërisë e ka kritikuar. Të njëjtën gjë kanë bërë edhe partitë e tjera marksiste-leniniste të vërteta. Megjithëkëtë udhëheqja revizioniste kineze ka vazhduar në po atë rrugë.

Udhëheqësit kinezë, në përputhje me politikën e tyre pragmatiste ndaj partive dhe grupeve të reja që u krijuan, kanë mbajtur qëndrime të diferencuara. Partitë e vërteta marksiste-leniniste ata i quanin armike të tyre, ndërsa grupet dhe partitë, që u kundërviheshin këtyre partive, u bënë shumë të dashura për ta. Aktualisht me këto parti dhe grupe antimarksiste, që ngrenë në qiell maocedunidenë, revizionistët kinezë jo vetëm mbajnë lidhje, por edhe i thërresin përfaqësuesit e tyre një nga një në Pekin, ku i përgatitin, u japin ndihma financiare dhe udhëzime politike e ideologjike, i instruktojnë si të veprojnë kundër Partisë së Punës së Shqipërisë dhe kundër partive marksiste-leniniste të vërteta. Ata kërkojnë prej tyre që të propagandojnë

maocedunidenë, teorinë e «tri botëve» dhe në përgjithësi politikën e jashtme të Kinës, të ngrenë kultin e Hua Kuo Fenit e të Ten Hsiao Pinit dhe të dënojnë «katërshen». Ajo parti që plotëson këto kërkesa, për revizionistët kinezë është «marksiste-leniniste», ndërsa ato parti që janë kundër tyre shpallen si antimarksiste, aventuriste etj.

Të gjitha këto tregojnë se udhëheqësit revizionistë kinezë në marrëdhëniet me partitë marksiste-leniniste nuk kanë zbatuar parimet dhe normat leniniste që rregullojnë marrëdhëniet midis partive të vërteta komuniste. Ata, ashtu si edhe revizionistët hrushovianë, kanë përdorur ndaj partive të tjera konceptin antimarksist të «partisë mëmë», diktatin, presionet, ndërhyrjet në punët e brendshme dhe s'kanë pranuar asnjëherë këshillat e sugjerimet shoqërore të partive motra. Ata kanë kundërshtuar takimet shumëpalëshe të partive marksiste-leniniste, mbledhjet për të diskutuar problemet e mëdha të përgatitjes dhe të fitores së revolucionit, të luftës kundër revizionizmit modern për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, për të shkëmbyer eksperiencën dhe për të koordinuar veprimet etj. Arsyeja e një qëndrimi të tillë, përveç të tjerash, është se ata kanë pasur frikë të ballafaqohen në mbledhje shumëpalëshe me marksistë-leninistët e vërtetë, për arsye se do të zbuloheshin e do të demaskoheshin teoritë e tyre antimarksiste e revizioniste në shërbim të kapitalit botëror dhe të strategjisë për ta shndërruar Kinën në superfuqi.

Një tregues tjetër i thelbit antimarksist të maocedunidesë janë edhe lidhjet që ka mbajtur e mban Partia Komuniste e Kinës me shumë parti e grupe



heterogjene fashiste, revizioniste etj. Aktualisht ajo përpiqet të krijojë terrenin për të depërtuar ose për të krijuar lidhje edhe me partitë e vjetra revizioniste të vendeve të ndryshme, si, për shembull, me atë të Italisë, të Francës, të Spanjës dhe të vendeve të tjera të Evropës, të Amerikës Latine etj. Këtyre lidhjeve revizionistët kinezë po u japin një rëndësi gjithnjë e më të madhe për arsye se ideologjikisht të gjitha ato janë në një vijë me Partinë Komuniste të Kinës, pavarësisht nga diferencat që kanë në taktikat, të cilat varen nga natyra, nga forca dhe nga fuqia e kapitalizmit në çdo vend.

Lidhjet e Partisë Komuniste të Kinës me këto parti tradicionale revizioniste gradualisht do të zgjerohen, veprimet e tyre do të akordohen, kurse grupet e vogla të quajtura «marksiste-leniniste», që ndjekin vijën kineze, do të vazhdojnë të përdoren prej saj për të luftuar dhe për të përçarë partitë e vërteta marksiste-leniniste, që ekzistojnë dhe që qëndrojnë në pozita të paturbueshme, si dhe partitë e tjera që lindin e do të lindin. Me këto veprime revizionistët kinezë ndihmojnë hapur kapitalizmin, partitë socialdemokrate e revizioniste, sabotojnë shpërthimin e fitoren e revolucionit dhe në mënyrë të veçantë përgatitjen e faktorit subjektiv, forcimin e partive të vërteta marksiste-leniniste që do ta udhëheqin këtë revolucion.

Këtë taktikë Partia Komuniste e Kinës e zbatoi në marrëdhëniet me të ashtuquajturën Lidhje të Komunistëve të Jugosllavisë, e cila ka punuar me të gjitha forcat për përçarjen e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe ka luftuar pa pushim kundër socializmit dhe

marksizëm-leninizmit. Udhëheqësit aktualë kinezë dëshirojnë të ecin së bashku me revizionistët jugosllavë dhe të koordinojnë veprimet në luftën kundër marksizëm-leninizmit dhe të gjitha partive marksiste-leniniste, kundër revolucionit, socializmit dhe komunizmit.

Hua Kuo Feni shfrytëzoi vizitën e Titos në Kinë dhe veçanërisht vizitën e vet në Jugosllavi për t'i bërë elozhe Titos, për ta paraqitur si një «marksist-leninist të shquar», si një «udhëheqës të madh» jo vetëm të Jugosllavisë, por edhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Në këtë mënyrë udhëheqja kineze aprovoi hapur edhe të gjitha sulmet e titistëve kundër Stalinit e Partisë Bolshevike, kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, kundër lëvizjes komuniste ndërkombëtare e marksizëm-leninizmit.

Mao Ce Duni dhe Partia Komuniste e Kinës kanë mbajtur një qëndrim pragmatist ndaj revizionizmit jugosllav dhe kanë bërë një evolucion të madh në pikëpamjet e tyre për Titon dhe titizmin. Në fillim Mao Ce Duni ka thënë se Titoja nuk ka gabuar, por ishte Stalini ai që kishte gabuar ndaj Titos. Më vonë po ai Mao Ce Dun e fut Titon në një radhë me Hitlerin dhe me Çan Kai Shinë dhe thotë se «njerëz të tillë... si Titoja, Hitleri, Çan Kai Shia dhe cari nuk mund të ndreqen, ata vriten». Mirëpo këtë qëndrim ai e ka ndryshuar përsëri dhe ka shprehur dëshirën e madhe për t'u takuar me presidentin Tito.

Marrëdhëniet e ngushta politike e ideologjike të revizionistëve kinezë me titizmin, me «eurokomunistët» si Karriljo e kompani, përkrahja që u japin partive

e grupeve antimarksiste, trockiste, anarkiste e socialdemokrate, tregojnë se udhëheqësit kinezë, të frymëzuar e të udhëhequr nga maocedunideja, po krijojnë një front ideologjik të përbashkët me renegatët e marksizëm-leninizmit, kundër revolucionit, kundër intereseve të luftës çlirimtare të popujve. Prandaj gjithë armiqtë e komunizmit gëzohen nga «teoritë» kineze, sepse ata e shikojnë se maocedunideja, politika kineze, drejtohen kundër revolucionit dhe socializmit.

Politika dhe teoritë maoiste kineze janë shumë të leverdishme për imperializmin amerikan, për kapitalizmin botëror e për revizionizmin modern. Të gjithë këta i aprovojnë dhe i propagandojnë ato, pse u japin mundësi që të infiltrojnë në Kinë dhe të likuidojnë totalisht fitoret e revolucionit në këtë vend kaq të madh. Shumë inkurajuese e të pranueshme për imperializmin amerikan janë sidomos teoritë e Hua Kuo Fenit dhe të shokëve të tij. Ato janë inkurajuese për faktin se, me propagandën dhe me qëndrimet e saj, Kina i sjell një dobësim dhe i bën një konkurrencë, në formë gjoja marksiste-leniniste, socialimperializmit sovjetik. Kjo u pëlqen shumë si Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe vendeve kapitaliste të zhvilluara të botës, pse në këtë mënyrë ato e përdorin Kinën edhe si një mashë për të dobësuar konkurrentin e tyre të fuqishëm. Por ajo që tërheq fort simpatinë dhe përkrahjen e imperializmit amerikan është fakti se teoria antimarksiste e «tri botëve» predikon edhe luftën për grumbullimin dhe për bashkimin e «botës së tretë» me «botën e dytë» me anën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kundër socialimperializmit sovjetik.

Revizionistëve dhe aristokracisë së klasës punëtore u leverdisin, gjithashtu, «teoritë» kincze, që predikojnë bashkimin me borgjezinë dhe mohimin e luftës së klasave. Ato i ndihmojnë këta armiq të proletariatit që të fshehin veprimtarinë e tyre kundërrevolucionare dhe të pasurohen për vete me thërrimet që bien nga tryeza e pasanikëve.

### **Partia jonë e ka për detyrë të demaskojë teoritë kundërrevolucionare të udhëheqësve kinczë**

Situatat e sotme ndërkombëtare janë të turbullta, kriza në vendet kapitalisto-revizioniste acarohet, politika agresive e superfuqive krijon çdo ditë e më shumë rreziqe të reja e të mëdha për lirinë e pavarësinë e popujve dhe për paqen e përgjithshme. Siç u tha edhe në Plenumin e 2-të të Komitetit Qendror të Partisë, teoritë borgjeze e revizioniste hrushoviane, titiste, eurokomuniste e së bashku me to edhe teoritë kincze janë pjesë përbërëse të planit të madh strategjik të imperializmit dhe të revizionizmit modern për të shkatërruar socializmin e për të mbytur revolucionin.

Në këto kushte mbrojtja e marksizëm-leninizmit, e parimeve të internacionalizmit proletar, qëndrimi konsekuent e revolucionar ndaj problemeve të mëdha botërore përbëjnë sot për Partinë tonë, ashtu si për të gjithë marksistë-leninistët e vërtetë, një detyrë themelore. Lufta jonë e drejtë duhet të nxitë te popujt dhe te njerëzit përparimtarë besimin në fitoren e çështjes së revolucionit, të socializmit e të çlirimit të popujve.

Partia jonë është në rrugë të drejtë dhe ajo do të fitojë, pse me të janë revolucionarët dhe popujt e botës, pse me të është e vërteta marksiste-leniniste.

Udhëheqësit kinezë u hodhën përpjetë kur Partia e Punës e Shqipërisë në Kongresin e saj të 7-të rrëzoi tezën e «botës së tretë» dhe demaskoi qëllimet e maocdunidesë për këtë çështje. Partia jonë në Kongres i shtroi drejt çështjet për kontradiktat e kohës sonë. Ajo tha se këto ekzistojnë jo vetëm mes fuqive imperialiste, jo vetëm mes dy superfuqive imperialiste e popujve, por edhe midis klasave sunduese të vendeve të «botës së tretë» etj., nga njëra anë, dhe popujve të tyre, nga ana tjetër. Ajo theksoi, sidomos, kontradiktat midis proletariatit e borgjezisë, midis kapitalizmit e socializmit.

Me këto teza dhe përgjithësisht me analizat e vlerësimet e situatës ndërkombëtare dhe të lëvizjes marksiste-leniniste botërore që bëri Kongresi i 7-të, Partia Komuniste e Kinës nuk polemizoi hapur e publikisht. Megjithëkëtë, me të mbaruar Kongresi, udhëheqësit kinezë na bënë një komunikim verbal, ku na akuzonin se i kemi sulmuar, se kemi sulmuar idenë e Mao Ce Dunit për «tri botët», por shtonin se për këtë nuk donin të hynin në polemikë me ne.

Këtu duhet sqaruar një çështje. Kur pretendojnë se ne i kemi atakuar, me këtë kinezët duan të thonë se vija e tyre është e drejtë, ndërsa vija e Partisë sonë është e shtrembër. Në qoftë se do të ishin marksistë, atëherë ata duhej të zhvillonin një polemikë të hapët kundër Partisë sonë dhe t'i rrëzonin tezat e Kongresit të saj të 7-të. Por ata nuk e bëjnë dot këtë. Nuk e

bëjnë sepse janë të bindur që do të humbasin, që do të demaskohen, mbasi tezat e tyre janë antimarksiste, kundërrevolucionare, ndërsa tezat tona janë të drejta, revolucionare.

Ç'taktikë po përdorin tani udhëheqësit kinezë kundër nesh? Ata po përdorin disa bishtra, disa udhëheqës oportunistë e lakej të tyre nga grupe ose nga parti që quhen marksiste-leniniste. U kanë dhënë atyre disa formulime të gatshme për të atakuar tezat tona, të cilat janë të patundura si shkëmb graniti. Por të tilla pretenca për mbrojtjen e vijës kineze, siç bëjnë francezi Zhyrke ose Lëfevri i Belgjikës, janë aq pa kripë dhe bajate, sa që i bëjnë ata qesharakë dhe i kanë shndërruar në sharlatanë të vegjël për të gënjyer disa njerëz që akoma nuk janë sqaruar e u venë pas ose që në tezat kineze shohin një vijë komode për t'u larguar nga lufta klasore, nga vështirësitë e sakrificat që kërkon revolucionin.

Nga ana tjetër, Partia Komuniste e Kinës ka përgatitur një material standard dhe thërret në Pekin përfaqësues nga të gjitha partitë komuniste (marksiste-leniniste) që mundet dhe ua lexon e ua komenton këto. Ky material drejtohet kundër vijës marksiste-leniniste të Partisë sonë në përgjithësi dhe në veçanti kundër Kongresit të saj të 7-të.

Një veprim të tillë revizionist, trockist, prapa kraheve të Partisë sonë dhe pa i shtruar më parë mosmarrëveshjet dhe kontradiktat me ne, as Hrushovi nuk e ka bërë, as kundër nesh, por, me sa dimë, as edhe kundër Partisë Komuniste të Kinës. Renegati dhe tra-

dhtari Hrushov na ka sulmuar, na ka atakuar e na ka kundërshtuar ose haptazi, ose me letra.

Partia e Punës e Shqipërisë për çdo çështje, për të cilat ka pasur divergjenca me udhëheqësit kinezë, u ka shkruar letra ose ua ka bërë të ditura pikëpamjet e saj me anë delegacionesh. Nga ana jonë qëndrimet kanë qenë korrekte, çdo gjë ua kemi thënë hapur. Por ata nuk u janë përgjigjur mesazheve tona. Udhëheqësit kinezë kanë nxjerrë pretendimin se «nuk donin të bënin polemikë me ne» për çka u shtronim dhe vazhdonin të vepronin sipas vijës së tyre. Në këtë rast edhe ne kishim të drejtë të vepronim sipas vijës dhe taktikës sonë.

Siç po rezulton tani, vijën dhe taktikën tonë udhëheqësit kinezë e konsiderojnë si sulm kundër partisë së tyre. Në këto kushte edhe ne kemi të drejtë t'i konsiderojmë vijën dhe taktikën e tyre si sulm kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, aq më tepër kur ata, për shembull, teorinë e «tri botëve» e paraqitin si strategji të revolucionit, si vijë për të gjithë lëvizjen revolucionare botërore. Del qartë se udhëheqësit kinezë, që në mënyrë hipokrite pretendojnë se nuk duhet të ketë «parti mëmë» dhe «parti bijë», kanë dashur dhe duan që Partia e Punës e Shqipërisë të ndjekë qorrazi vijën e tyre, bile ata kanë synuar edhe t'ia imponojnë Partisë sonë këtë vijë.

Pse kanë vepruar e veprojnë kështu udhëheqësit kinezë?

E para, ata mendojnë se «Kina është një vend i madh», se partia e tyre «është një parti e madhe», se «Mao Ce Duni është një udhëheqës i madh dhe i pa-

gabuar». Ndjenja e shtetit të madh dhe e partisë së madhe ka vepruar në bllok tek ata.

E dyta, Partia Komuniste e Kinës, megjithëse thotë se është për takime bilaterale midis partive, e pranon këtë vetëm me qëllim që në bisedimet e dyanshme të informohet dhe t'u japë direktiva të tjerëve. Ajo i është trembur kurdoherë ballafaqimit të mendimeve me Partinë tonë.

E treta, duke qenë se na jepnin disa kredi, udhëheqësit kinezë mendonin se ne duhej t'u bindeshim pikëpamjeve të tyre.

Në Kongresin e saj të 7-të Partia e Punës e Shqipërisë shprehu pikëpamjet e veta, ashtu siç i mendonte. Kina u thartua, po bëri gabimin trashanik që sulmoi Kongresin tonë në mënyrë të dënueshme, në kundërshtim me normat që ekzistojnë në marrëdhëniet midis partive marksiste-leniniste. Sa ishin gjallë, Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, ne kemi pasur kontradikta me udhëheqësit kinezë, të cilat ata nuk pranonin t'i diskutonin. Ata qëndronin në mendimet e tyre dhe ne, ngaqë s'kishim mundësi tjetër, qëndronim në tonat. Por një gabim të tillë antimarksist që të sulmonin një kongres të Partisë sonë, ata s'e bënë. Atëherë përse e bëri këtë Hua Kuo Feni? E bëri se politika e tij krijoi konfuzion dhe pësoi disfatë si brenda dhe jashtë vendit. Ne nuk mund ta mbronim atë në veprimet e tij të brendshme e aq më pak ta mbështetnim në politikën e jashtme dhe kishim shumë arsye të mos e bënim këtë. Ngjarjet në Kinë i dobësuan pozitat e saj ndërkombëtare. Tani u rrëzua për të dytën herë dhe u rehabilitua përsëri, katër anëtarë të byrosë politike, midis të cilëve një nën-



kryetar i partisë, Çan Çun Çiaoja, Çian Çini, Jao Ven Juani e Van Hun Veni, u demaskuan në mënyrë të ndyrë në platformë personale dhe jo politiko-ideologjike. Revolucioni Kulturor u errësua dhe u likuidua. Marksistë-leninistët e botës për të gjitha këto ngjarje që ndodhën në Kinë filluan të kenë dyshime të mëdha. Maoja dhe Çuja, që dinin të manovronin, vdiqën dhe Kina hyri në kaos.

Në këto situata u mbajt Kongresi i 7-të i Partisë sonë. Në të morën pjesë 43 parti marksiste-leniniste, nga të cilat 32 dërguan delegacione, tri vëzhgues dhe të tjerat përshëndetën me telegrame. Udhëheqësit kinezë këtë pjesëmarrje e konsideruan si një disfatë për ta, mbasi kjo shkonte kundër tezave të tyre dhe ngrihej autoriteti i Partisë së Punës të Shqipërisë. Që këtu filloi sulmi armiqësor trockist prapa krahëve të Partisë sonë, duke thirrur në Pekin një nga një delegacione të partive komuniste marksiste-leniniste për t'i përpunuar.

Udhëheqësit kinezë, ndërsa u fshehin përgjigjen e duhur që ne i dhamë menjëherë notës së tyre pa adresë dhe lakonike, u thonë të tjerëve se «në Kongresin e 7-të të PPSH janë sulmuar vija dhe strategjia e Mao Ce Dunit». Ndër të tjera ata shtrembërojnë dokumentet tona, si: letrën për çështjet e kufirit të Kinës me Bashkimin Sovjetik, atë për vajtjen e Çu En Lait në Moskë pas rrëzimit të Hrushovit, për vizitën e Niksonit në Pekin etj. Por letrat tona, për fatkeqësinë e tyre, ekzistojnë dhe, siç thuhet, *verba volant, scripta manent*. Këto letra, që flasin për veprimet jomarksiste që kanë bërë udhëheqësit kinezë, ata i shtrembërojnë, me qëllim që të justifikojnë shpifjet, mashtrimet dhe qëlli-

met e veta aktuale. Por me mashtrime nuk fshihen qëllimet. Mendimet dhe veprimet e Partisë sonë, kur ne u kemi dërguar letrat ose u kemi bërë vërejtjet, kanë qenë të drejta, koha vërtetoi se ato janë të drejta edhe sot e të tilla do të jenë edhe nesër. Faktet janë kryeneçe dhe ato vërtetojnë tezat tona. Demagogjia që përdorin udhëheqësit kinezë për gjoja bazat teorike leniniste, ku u bazokan për këto veprime të tyre kundër nesh, është e kotë. Ajo nuk e mbulon dot fytyrën e tyre prej revizionistësh dhe oportunistësh shovinistë.

Udhëheqësit kinezë pretendojnë se bëjnë një analizë objektive të situatës ndërkombëtare, kurse ne jo. Çështja kryesore për ta është të bindin njerëzit, duke bërë deklarata deri nga tribuna e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, siç bëri tash së fundi përfaqësuesi kinez se «Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndodhen në mbrojtje, kurse Bashkimi Sovjetik në ofensivë», se «Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë dobësuar ekonomikisht e ushtarakisht dhe nuk janë më të forta si më parë», se «rivaliteti mes dy superfuqive qëndron në Evropë» etj. E rëndësishme për ta është të bindin njerëzit vesh më vesh se «shqiptarët shikojnë vetëm bashkëpunimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me Bashkimin Sovjetik dhe nënvleftësojnë rivalitetin», se «shqiptarët deklarojnë se të dyja superfuqitë janë njëlloj të rrezikshme» etj.

Të tilla janë «argumentet» e kinezëve, me të cilat kërkojnë të vërtetojnë se Partia jonë gjoja nuk bën një analizë marksiste-leniniste të gjendjes ndërkombëtare e të kontradiktave. Por shpifjet dhe sofizmat e

udhëheqësve kinezë nuk mund as të fshehin revizionimin e marksizëm-leninizmit nga ana e tyre, as të errësojnë vijën dhe qëndrimet e drejta të Partisë sonë.

Udhëheqja kineze tani po zhvillon brenda në Kinë një fushatë të madhe propagandistike antishqiptare mbi bazën e akuzave që përmenda më sipër. Në të njëjtën kohë në shtypin e destinuar vetëm për kuadrot, që është mjaft masiv, botohen shpifjet dhe akuzat e lakejve të kinezëve dhe të shtypit reaksionar borgjez kundër Partisë së Punës dhe Shqipërisë socialiste.

Por ne shpresojmë se populli kinez nuk do të mashtrohet nga propaganda, nga shpifjet dhe nga gënjeshttrat antimarksiste e antishqiptare që udhëheqësit e tanishëm të Pekinit i servirin atij kundër Partisë e vendit tonë dhe do ta ruajnë miqësinë e dashurinë për Partinë e Punës dhe Shqipërinë, gjë që, në radhë të parë, është për të mirën e tyre.

Në kundërshtim me qëndrimin armiqësor të udhëheqësve kinezë, vëmë re se jehona pozitive e Kongresit të 7-të të Partisë sonë, ku rrëzuam tezat antimarksiste e oportuniste të kinezëve për ndarjen e botës, ku demaskuam qëndrimin e tyre pajtues ndaj imperializmit dhe interpretimet e tyre të gabuara për kontradiktat etj., ka qenë e madhe. Kjo është rritur edhe më shumë pas botimit të artikujve «Teoria dhe praktika e revolucionit», «Hrushovi në gjunjë para Titos», të bisedës me Çu En Lain, si dhe të materialeve të tjera të Partisë sonë në zbërthim të lideve të Kongresit.

Këto dokumente të Partisë sonë, siç jeni në dijeni, janë botuar gjerësisht nga të gjitha gazetatat e revistat e rëndësishme të botës, si në vendet e mëdha, ashtu.

edhe në vende fare të vogla, në Afrikë apo në Amerikën Latine. Radiot e televizionet kanë folur disa herë për to dhe komentet vazhdojnë.

Interesimi i madh për materialet tona në botën e jashtme nuk është një gjë e rastit.

Marksistë-leninistët dhe revolucionarët kudo në botë e shohin se Partia e Punës e Shqipërisë mbron marksizëm-leninizmin, kur të tjerët e sulmojnë, se ajo mbron parimet e internacionalizmit proletar, kur revizionistët e ndryshëm këto parime i kanë flakur tej. Ata e shohin se në qëndrimet e saj ajo niset jo vetëm nga interesat e vendit të vet, por shpreh dhe përfaqëson interesa shumë të mëdhenj, të afërt e të shtrenjtë për mbarë proletariatin, interesat e socializmit të vërtetë, interesat e të gjithë atyre që bazohen dhe udhëhiqen nga marksizëm-leninizmi për transformimin revolucionar të botës.

Materialet e Partisë sonë kanë ngjallur interesimin e opinionit të gjerë publik ndërkombëtar, pse në to shtrohen problemet kyç që preokupojnë sot të gjitha vendet, vihet gishti në plagët e dhimbshme që ka shkaktuar politika agresive e imperializmit amerikan dhe e socialimperializmit sovjetik, demaskohen komplotet, intrigat e dallaveret e revizionizmit modern dhe të të gjithë armiqve të tjerë të proletariatit e të popujve, theksohet se rruga për të dalë nga kjo gjendje është lufta e papajtueshme e konsekuente kundër imperializmit, borgjezisë ndërkombëtare, oportunizmit e reaktionit, rruga e revolucionit dhe e çlirimit të popujve.

Në qoftë se do të flisnim për jehonën në vendet e huaja, natyrisht kjo varet nga pozitat politike e ideo-

logjike që përfaqëson secila forcë politike, por në tërësi duhet thënë se qëndrimi është mjaft pozitiv dhe vlerësimet janë objektive.

Një pritje entuziaste u kanë bërë qëndrimeve dhe vlerësimeve tona shumica e partive marksiste-leniniste dhe e forcave të vërteta revolucionare. Ato, me deklarata zyrtare, rezoluta, artikuj, komente etj., kanë theksuar se materialet tona të kohëve të fundit i kanë ndihmuar të analizojnë e të kuptojnë edhe më mirë situatat e sotme botërore e detyrat revolucionare që qëndrojnë përpara lëvizjes marksiste-leniniste, se kritika jonë ndaj tezave oportuniste të së ashtuquajturës teori e tri botëve i ka çliruar edhe nga ndonjë iluzion që kishin akoma për kinezët dhe për teoritë e tyre. Në mjaft artikuj të partive marksiste-leniniste theksohet se Partia e Punës e Shqipërisë është e vetmja parti në pushtet që kryen detyrat e saj internacionaliste duke ndihmuar fuqimisht marksistë-leninistët dhe revolucionin.

Materialet e Partisë sonë marksistë-leninistët e vërtetë po i shndërrojnë tani në armë të luftës së tyre ideologjike kundër revizionizmit brenda dhe jashtë vendeve të veta. Në mënyrë të veçantë lufta e Partisë sonë kundër oportunitizmit të ri kinez po ndihmon për të bërë një diferencim të qartë të forcave në radhët e marksistë-leninistëve. S'ka asnjë dyshim se, ashtu siç ndodhi në kohën e tradhtisë së Hrushovit, edhe tani, me daljen e revizionizmit kinez, forcat e vërteta marksiste-leniniste do të bashkohen, do të organizohen dhe do të hidhen në luftë kundër kësaj tradhtie të re.

Nga marrëdhëniet që kanë punonjësit e ambasadave tona dhe njerëzit që dalin me shërbim jashtë

shtetit, më diplomatë të shteteve të huaja ose me përfaqësues të artit, të kulturës, të arsimit e të shkencës, pavarësisht se ata nuk kanë po ato bindje ideologjike dhe politike që kemi ne, bie në sy një simpati e madhe e një dashamirësi e hapur për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, si dhe një respekt për Partinë e Punës të Shqipërisë.

Në të njëjtën kohë ne vërejmë se politika që ndjek Kina në marrëdhëniet me imperializmin amerikan, edhe me socialimperializmin sovjetik, mbjell dyshim, pakënaqësi, kritikë të vazhdueshme kudo, sidomos në vendet e së ashtuquajturës botë e tretë. Kjo është e natyrshme, pse njerëzit e ndershëm në këto shtete e shikojnë që politika kineze nuk është e drejtë, se ajo është një politikë që përkrah një imperializëm, i cili i shtyp. Ata shikojnë, gjithashtu, se shumë nga predikimet e udhëheqësve kinezë nuk përputhen me veprat e tyre dhe me realitetin konkret. Popujt shohin se Kina bën një politikë koniunkturale të paqëndrueshme, e cila jo vetëm nuk u sjell asnjë përfitim, përkundrazi i kërcënon interesat e tyre.

Përveç lakejve dhe ultrareaksionarëve, asnjë nuk e merr në mbrojtje të drejtpërdrejtë teorinë e falimentuar të «tri botëve». Politika e afrimit të kinezëve me imperializmin amerikan ringjall fantazmat e luftërave imperialiste, të cilat asnjë nuk do t'i shikojë, ajo den-dëson errësirën koloniale e neokoloniale që asnjë nuk e duron, ajo mbështet shfrytëzimin kapitalist, të cilin të gjithë duan ta heqin qafe.

Por jehona që kanë gjetur në botë tezat e Partisë sonë dhe kritika e saj ndaj revizionizmit të ri kinez,

nuk duhet të na çojë në eufori dhe në krijimin e ndonjë iluzioni se të gjithë janë me ne. Armiqtë e ndryshëm që kemi përballë janë të egër e shumë dinakë dhe duhet të kemi parasysh se lufta kundër tyre do të jetë e gjatë, e ashpër dhe me sakrificë.

Partia e Punës e Shqipërisë ka luftuar, lufton e do të luftojë kurdoherë me vendosmëri për mbrojtjen e pastërtisë së ideve marksiste-leniniste. Ajo është e do të jetë kurdoherë kundër të gjithë atyre që përpiqen t'i shtrembërojnë e t'i zëvendësojnë ato me ide borgjeze, revizioniste e kundërrevolucionare. Partia jonë është një parti proletare, një parti marksiste-leniniste, një pjesëtare aktive e revolucionit botëror, për të cilin, ashtu si deri më sot, ajo është e vendosur të marrë parasysh çdo sakrificë. Nga kjo rrugë e nderit, plotësisht internacionaliste dhe e lavdishme, Partinë tonë s'ka forcë që ta largojë, s'ka forcë që ta frikësojë e ta mposhtë. Partia jonë nuk mund të pajtohet me asnjë lloj oportunizmi, me asnjë lloj devijimi nga marksizëm-leninizmi, me asnjë shtrembërim të tij. Ajo do të luftojë me vendosmëri edhe kundër revizionizmit kinëz, si dhe kundër çdo lloji tjetër.

Partia jonë është një parti e vogël marksiste-leniniste, por pse jemi një parti e tillë, ne nuk duhet të druhami dhe të mos e themi haptazi të vërtetën. Partia jonë është e vogël për sa i përket numrit të anëtarëve që militojnë në radhët e saj, por është një parti e kulltur në shumë luftëra. Ajo kurdoherë ka pasur guximin për t'i thënë hapur çështjet në mbrojtje të pastërtisë së marksizëm-leninizmit, të revolucionit dhe të socializmit. Faktet tregojnë se lufta jonë kundër revii-

zionizmit kinez është e drejtë, është e domosdoshme, prandaj aprovohet e mbështetet nga marksistë-leninistët e revolucionarët e vërtetë.

Një parti e vërtetë revolucionare, siç është Partia jonë, në asnjë rast nuk heq dorë nga qëndrimet parimore. Ne nuk mund të tërhiqemi pse të tjerët virtytin e guximit të Partisë sonë mund ta quajnë mendjemadhësi. Partia nuk i ka mësuar anëtarët e saj të jenë mendjemëdhën, por i ka mësuar të jenë kurdoherë të vendosur e të drejtë, të ashpër kundër armikut të klasës. Në këto çështje nuk ka diskutime nëse partia është e madhe ose e vogël.

Situatat do ta sjellin që lufta mes Partisë sonë dhe Partisë Komuniste të Kinës të ashpërsohet, pse revizionistët e rinj kinezë janë të vendosur të ecin me rrevan drejt transformimit të Kinës në një vend kapitalist dhe të Partisë Komuniste të Kinës në një parti revizioniste. Dihet se Partia dhe populli ynë nuk u janë trembur presioneve ekonomike dhe politike të titistëve kur ishte koha që ata duheshin luftuar dhe demaskuar pa mëshirë. Të njëjtin qëndrim kemi mbajtur ne edhe kur e desh nevoja e luftës dhe e demaskimit të revizionistëve sovjetikë dhe e të gjithë revizionistëve të tjerë. Edhe tani që Kina po rrëshqet në llumin e oportunitizmit dhe të revizionizmit, pavarësisht se ç'Veprime do të bëjë ajo kundër nesh në planin ekonomik ose në platformën ndërkombëtare, ne nuk mund të rrimë pa e thënë fjalën, pa e shprehur mendimin tonë.

Na vjen shumë keq që Kina të rrëshqasë në oportunitizëm, pse kjo është një humbje e madhe për revolucionin dhe për mbarë njerëzimin. Të gjitha mendimet



dhe përpjekjet tona kanë qenë që Kina të largohet nga kjo rrugë katastrofale në të cilën është futur për veten e saj, me pasoja të rënda edhe për revolucionin. Ne edhe më vonë do të përpiqemi që ajo të largohet nga rruga ku e kanë futur udhëheqësit e saj. Por, çfarëdo që të ndodhë, Partia jonë ka bindjen se të gjithë revolucionarët e botës nuk do të heqin dorë nga lufta e tyre e pamëshirshme kundër imperializmit amerikan, kapitalizmit botëror, socialimperializmit sovjetik dhe të gjitha rrymave të revizionizmit modern.

Komunistët, revolucionarët e vërtetë, marksistë-leninistët duhet ta kuptojnë mirë si po zhvillohen situatat sot në botë. Ato nuk zhvillohen në formën e një klisheje. Në rast se studiohen, kuptohen dhe asimilohen si duhet mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe të Stalinit, eksperiencia e luftërave revolucionare të proletariatit botëror, si dhe eksperiencia e çdo partie të vërtetë marksiste-leniniste, atëherë mund të kuptohen si duhet këto situata që po zhvillohen dhe të ndihmohet fuqimisht revolucioni.

Ne komunistët shqiptarë duhet të kuptojmë mirë se përvetësimi i marksizëm-leninizmit është absolutisht i domosdoshëm. Nuk duhet nënvleftësuar kurrë rrethimi kapitalisto-revizionist dhe presioni që na bën ai. Ne nuk duhet të jemi fodullë në kuptimin e këtyre çështjeve dhe në luftën e vërtetë që duhet t'u bëjmë armiqve që na rrethojnë.

Revolucioni ka gjetur dhe gjen përpara shkëmbinj, të cilëve duhet t'u vërë minat dhe t'i hedhë në erë. Disave duhet t'u vërë minat drejtpërdrejt, disa duhet t'i gërryëjë, disa të tjerëve duhet t'u marrë krahët dhe

pastaj t'u japë goditjen e fundit. Kësaj i thonë të kuptosh strategjinë dhe taktikën e revolucionit. Që të krijohet bindja në fitoren e tij, është e domosdoshme të organizosh masat e gjera të popullit, të bësh të ndërgjegjshëm proletariatin për udhëheqjen e palëkundshme të partisë së tij të vërtetë marksiste-leniniste, se ndryshe mund të shkohet edhe në aventura, të komprometohet çështja e revolucionit. Komunistët dhe masat e shtypura të popullit duhet të dinë se imperializmi dhe kapitalizmi botëror kanë një eksperiencë të madhe në shtypjen e masave, në organizimin e kundërrevolucionit. Prandaj edhe taktikat e strategjia e armiqve duhet të kuptohen dhe të përballohen, sepse ideologjia jonë, politika jonë, strategjia dhe taktikat tona janë më të fuqishme se çdo armik, mbasi këto i shërbejnë një kauze të drejtë, kauzës së komunizmit.

Problemi i revizionizmit kinez është sot shumë preokupant për gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Marksistë-leninistët i shqetëson problemi se si do të vazhdojë lufta kundër këtij varianti të ri të revizionizmit, cila do të jetë taktika e tyre në këtë luftë.

Edhe për Partinë tonë çështja që na del përpara është: A duhet t'i demaskojmë ne revizionizmin kinez dhe Mao Ce Dunin hapur dhe publikisht, siç po flasim në këtë Plenum? Byroja Politike akoma nuk ka arritur në këtë konkluzion.

Ne mendojmë se aktualisht në shtyp nuk duhet vepruar në mënyrë të adresuar ndaj revizionistëve kinezë. Por Partia duhet të punojë për të sqaruar situatat që zhvillohen në botë, duke vënë me guxim përballë antitezave të tyre tezave tona të drejta, të argumentua-

ra dhe bindëse, me qëllim që këto të zënë rrënjë kudo në masat e gjera të popullit tonë dhe të kuptohen qartë edhe nga opinioni i jashtëm përparimtar. Pse duhet të veprojmë kështu? Mos vallë kemi frikë se edhe Kina pastaj mund të na sulmojë publikisht dhe të na dëmtojë politikisht? Jo, nuk është kjo arsyeja. Por mendojmë se Kina është akoma e njohur në botë si një «fuqi e madhe socialiste», si «përkrahëse e çdo lëvizjeje përparimtare dhe e çlirimit të popujve», se ka shumë njerëz që mendojnë se popujt do të gjejnë mbështetje tek ajo. Të mos harrojmë, gjithashtu, atë që thamë në fillim, se akoma ruhen miti i Mao Ce Dunit si marksist e revolucionar i madh, miti i Kinës si kështjellë e revolucionit. Për këto arsye mendojmë se nuk janë krijuar akoma kushtet, nuk janë pjekur akoma situatat për të dalë hapur me emër kundër Partisë Komuniste të Kinës. Në këtë luftë ne duhet të përdorim taktika të drejta e të shkathëta.

Me qëndrimet politike dhe ideologjike që ka mbajtur Partia jonë, me artikujt e saj, edhe pse nuk ka dalë hapur, prapë gjithë marksistë-leninistët, gjithë njerëzit e rrethet përparimtare në botë e kanë kuptuar se kush atakohet dhe përse atakohet. Ne mendojmë se lufta e bazuar në një taktikë të tillë duhet të vazhdohet akoma, derisa të përgatitet terreni për shkallëzimin e mëtejshëm të saj. Të shpejtohemi ngadalë. Kjo do të thotë as të mos ndalemi në luftën tonë, por as të mos nxitohemi. Të veprojmë me kujdes dhe pa i sforcuar qëndrimet, sidomos duke pasur parasysh opinionin e klasës punëtore e të revolucionarëve në botë.

Në rrugën që do të ndjekim ne do të kemi edhe ndihmën e vetë revizionistëve kinezë, të cilët, me qëndrimet e veprimet që kryejnë, po e shpejtojnë demaskimin e tyre më shumë se revizionistët sovjetikë. Këta i ruajtën organizimin dhe disiplinën e trashëguar nga koha e Leninit dhe e Stalinit dhe i përdorën në interesin e tyre. Ata u përpoqën atëherë dhe vazhdojnë të përpiqen edhe sot për të ruajtur maskat dhe formulimet marksiste-leniniste. Kurse kinezët do t'i braktisin maskat dhe do të veprojnë haptas. Veprimet e paskëtajmë do ta vënë akoma më qartë në dukje atë që ne do të duhet ta luftojmë edhe hapur kur ta duan situatat.

Nga përpjekjet që bëjnë revizionistët kinezë për të popullarizuar kongresin e tyre të 11-të, Hua Kuo Fenin, teorinë e «tri botëve» etj. ne duhet të kuptojmë se brenda në Kinë ka rezistencë nga komunistët e vërtetë revolucionarë. Atje nuk është shuar rezistenca, por, në qoftë se kjo nuk do të arrijë të organizohet dhe të konkretizohet brenda këtyre dy-tre vjetëve të parë, siç ka treguar eksperiencia e titistëve dhe e hrushovianëve, atëherë shndërrimi kapitalist i vendit do të konsolidohet. Prandaj na vihet detyrë të ndihmojmë edhe revolucionarët kinezë. Por, në kushtet që janë krijuar në Kinë, përpjekjet e revolucionarëve, që të mundin të arrijnë fitoren, duhet të jenë kolosale.

Ne komunistët shqiptarë jemi të bindur që Mao Ce Duni, siç thamë, nuk është marksist-leninist i vërtetë, por një eklektik. Duhet njohur që Maoja ka edhe merita, se ai udhëhoqi revolucionin për çlirimin e popullit kinez nga zgjedha e të huajve, por famën e tij

do ta gërryejnë vetë kinezët që janë tash në fuqi dhe këta kanë filluar ta gërryejnë. Prandaj ne mendojmë se aktualisht nuk është momenti as për demaskimin e figurës së Mao Ce Dunit drejtpërdrejt në shtyp, por të vazhdojmë të përhapim dhe të mbrojmë me forcë e me guxim marksizëm-leninizmin. Çdo gjë duhet të vijë në kohën e duhur, që t'i shërbejë çështjes së marksizëm-leninizmit dhe të revolucionit.

Tani për Partinë tonë, si dhe për të gjitha partitë marksiste-leniniste në botë, lufta kundër revizionizmit kinez meriton një vëmendje kryesore. Kjo çështje është me rëndësi, por nuk do të thotë se, duke u marrë me të, na lejohej të harrojmë revizionizmin sovjetik, revizionizmin titist apo eurokomunizmin, që janë variante shumë të rrezikshme të revizionizmit modern. Të tëra këto korrente antimarksiste, pavarësisht nga ndryshimet në format e luftës, për sa u përket taktikave dhe strategjisë së tyre, janë të një rrjedhe, kanë të njëjtin qëllim, bëjnë të njëjtën luftë.

Për të gjitha këto arsye ne nuk duhet ta largojmë kurrë vëmendjen jo vetëm nga lufta që duhet bërë kundër imperializmit amerikan dhe gjithë borgjezisë reaksionare kapitaliste botërore, por edhe kundër revizionizmit sovjetik, revizionizmit jugosllav, revizionizmit kinez etj. Të tërë këta armiq, me gjithë kontraktat që kanë ndërmjet tyre, i lidh një fill i vetëm, që është lufta kundër revolucionit, kundër partive marksiste-leniniste, kundër unitetit të tyre, kundër organizimit të përgjithshëm të proletariatit e të mbarë masave punonjëse për t'u hedhur në revolucion.

Partia jonë u ka bërë një analizë pak a shumë të

hollësishme revizionizmit jugosllav dhe revizionizmit sovjetik, por ne kurrë nuk mund të pretendojmë se gjatë kësaj analize jemi thelluar në tërë gjerësinë e veprimtarisë armiqësore të tyre, sidomos në gjerësinë e transformimeve revizionisto-kapitaliste të Bashkimit Sovjetik.

Ndërsa për revizionizmin kinez ndodhemi në fillim, shtrohet detyra që të zbulojmë rrënjët dhe të ndjekim zhvillimin e tij, me qëllim që ta demaskojmë, ashtu siç kemi vepruar edhe me rrymat e tjera oportuniste. Këto janë probleme të mëdha, por kemi bindjen që do t'i përballojmë, se e madhe dhe e fuqishme është ideologjia jonë marksiste-leniniste.

Lufta kundër revizionizmit modern, dhe në veçanti kundër revizionizmit sovjetik, revizionizmit titist dhe revizionizmit kinez, nuk është një çështje e lehtë. Përkundrazi, kjo luftë është dhe do të jetë e rreptë. e gjatë. Që kjo luftë të bëhet me sukses, që të arrihen fitore hap pas hapi, komunistët, kuadrot, inteligjencia dhe të gjitha masat punonjëse të vendit tonë duhet të brumosen me ideologjinë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, duhet të studlojnë edhe eksperiencën e pasur të Partisë sonë në luftën kundër revizionizmit modern. Vetëm kështu do të jemi në gjendje të kalojmë pengesat dhe të mos na çjerrin ferrat në gjithë këtë pyll të madh armiqësor.

Ne duhet të mbajmë mirë parasysh se armiqtë e marksizëm-leninizmit, armiqtë e socializmit e të Shqipërisë kanë qenë dhe janë kurdoherë të egër, të pamëshirshëm dhe me një eksperiencë të madhe në luftën kundër nesh.

Për të përballuar me sukses, ashtu si deri sot, rrethimin imperialisto-revizionist, për të çuar përpara pa u ndalur çështjen e socializmit e të pavarësisë kombëtare, ne duhet të forcojmë pareshtur Partinë, ta kalitim nga ana ideologjike dhe organizative, të luftojmë për zbatimin me rreptësi të normave leniniste. Në luftë për zbatimin drejt e korrekt të vijës marksiste-leniniste të Partisë në të gjitha fushat ne duhet të forcojmë pareshtur unitetin e saj, të kalitim edhe më shumë bashkimin e popullit rreth Partisë, të zhvillojmë drejt dhe pa ndërprerje luftën e klasave në gjirin e Partisë e të popullit për të mbyllur shtigjet e depërtimit të ideologjisë së huaj armiqësore, për të mos lejuar që armiqtë të ngrenë krye e të dëmtojnë Partinë dhe rrugën socialiste të popullit tonë.

Partia ka theksuar se mbrojtja e atdheut është detyrë mbi të gjitha detyrat. Prandaj komunistët duhet të qëndrojnë në ballë të luftës që bëjnë Partia dhe populli për forcimin e mbrojtjes, për të ngritur gjithnjë e më lart frymën patriotike të masave, për të rritur vazhdimisht vigjilencën dhe gatishmërinë e tyre luftarake.

Të gjitha këto detyra të mëdha, kombëtare e ndërkombëtare, që na dalin përpara, i bëjnë edhe më të domosdoshëm fuqizimin dhe përparimin e ekonomisë, rritjen e prodhimit në të gjitha fushat, me qëllim që të plotësohen gjithnjë e më mirë nga ana e saj nevojat e shtetit e të popullit. Prandaj tani kërkohet një mobilizim edhe më i madh për t'i realizuar planet pa asnjë boshllëk në të gjithë sektorët, për të luftuar me vendosmëri e me ndërgjegje të lartë për kapërcimin e çdo vështirësie, e çdo natyre qoftë.

Ky plenum i Komitetit Qendror të Partisë do të shërbejë me siguri për plotësimin e detyrave që përmenda më lart, për kalitjen revolucionare të kuadrove, të klasës punëtore, të inteligjencies dhe të të gjithë njerëzve tanë për të përballuar me sukses luftërat e mëdha që kemi përpara. Detyrat e rëndësishme që do të shtrojë Plenumi duhet të shërbejnë për të ngritur në një nivel më të lartë të gjithë punën e Partisë për forcimin ideologjik, politik e organizativ të radhëve të saj.

Kur Partia është në këmbë dhe e bashkuar fort rreth vijës së saj të sprovuar marksiste-leniniste, vijilente dhe kurdoherë e gatshme për të luftuar kundër çdo armiku të jashtëm e të brendshëm, çështja e socializmit në Shqipëri është e pamposhtur, pavarësia e përparimi i atdheut tonë janë të sigurt.

Marksizëm-leninizmi është ideologjia fitimtare. Kush e përqafton, e mbron dhe e zhvillon atë, ai është pjesëtar i armatës së lavdishme të revolucionit, i asaj ushtrie të madhe e të pamposhtur të komunistëve të vërtetë, që udhëheqin proletariatin dhe gjithë të shtypurit për të transformuar botën, për të shkatërruar kapitalizmin dhe për të ndërtuar botën e re, botën socialiste.

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*



## SITUATAT E REJA KËRKOJNË DREJTIM DIJE ORGANIZIM MË TË MIRË TË PUNËVE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

18 nëntor 1977

Në situatat e reja që janë krijuar në marrëdhëniet me Kinën, vështirësitë do të na shtohen. Çështja është për eksport-importin, pa folur për ndërprerjen e kredisë që ajo duhet të na japë sipas marrëveshjes që kemi me të. Prandaj duhet të marrim masa për të përballuar çdo gjë me forcat tona. Për t'i kapërcyer këto vështirësi kërkohet, gjithashtu, që punonjësit tanë të tregtisë të ushtrojnë një aktivitet më të madh.

Aktualisht ne tregtinë e jashtme me atë të brendshme i kemi të bashkuara në një dikaster. Më parë këto i kemi pasur të ndara.

---

1. Në këtë mbledhje të Byrosë Politike, që u zhvillua në një nga pushimet midis seancave të Plenumit të 3-të të KQ të PPSH, u diskutua rreth disa ndryshimeve organizative në dikasterin e tregtisë dhe në Kryesinë e Këshillit të Ministrave.

Sot, sidomos tregtia e jashtme, është rritur e është zgjeruar, prandaj, duke e parë këtë edhe në lidhje me situatat e jashtme që janë krijuar, del nevoja që përsëri ne të ndajmë sektorin e tregtisë së jashtme nga ai i tregtisë së brendshme. Ky është një mendim që duhet ta diskutojmë së bashku.

E dyta, ne duhet të forcojmë edhe drejtimin në Kryeministri, që Kryesia e Këshillit të Ministrave dhe Qeveria të kenë mirë në drejtim kontrollin dhe ndihmën për të gjithë sektorët shtetërorë të ekonomisë, të kulturës, të ushtrisë etj., meqenëse jeta po na tregon se kërkojnë një punë akoma më e shëndoshë dhe kontakte më të ngushta të shokëve të udhëheqjes, të shokëve të dikastereve me bazën, me komitetet ekzekutive të rretheve.

Për t'ia arritur këtij qëllimi, mendoj që në Kryeministri të çojmë një zëvendëskryeministër të ri, jo për të shtuar numrin e zëvendëskryeministrave, por sepse kam propozimin që kryetari i Komisionit të Planit të Shtetit të lirohet nga funksioni i zëvendëskryeministrit dhe të merret vetëm me punën e Komisionit të Planit të Shtetit. Pra ai të mos drejtojë edhe sektorë të tjerë që ka pasur në varësi deri tani. Duke u nisur nga kjo, dal me propozimin që të caktojmë një zëvendëskryeministër të ri, dhe midis katër zëvendëskryeministrave të bëhet një shpërndarje e re e punës, pa ndryshuar sektorët që ata kanë në varësi. Zëvendëskryeministrit të ri t'i japim të drejtojë disa sektorë që të lehtësohet puna e shokëve të tjerë.

Këto dy çështje kisha për të shtruar.

Para se të vijmë në propozimin konkret të personave që do të caktohen në këto funksione, të vendosim një herë nga ana organizative. Jeni dakord, pra, që të bëhet ndarja e Ministrisë së Tregtisë në dy ministri dhe kryetari i Komisionit të Planit të Shtetit të mos jetë edhe zëvendëskryeministër?

*(Të gjithë shokët e Byrosë Politike të KQ të PPSH u shprehën dakord me këtë propozim dhe e miratuan atë.)*

Nga disa shokë të Byrosë Politike ka propozim që shoku Qirjako Mihali të lirohet nga detyra e sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës dhe të rekomandohet për t'u emëruar zëvendëskryeministër dhe në vend të tij si sekretar të parë të Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës propozojnë shokun Simon Stefani. Ne Byroja Politike ta bëjmë këtë rekomandim, se për ta zgjedhur, do ta zgjedhë plenumi i komitetit të Partisë të rrethit.

Mendoj se me këto ndryshime punët do të ecin edhe më mirë, pasi të dy këta shokë kanë eksperiencë. Kjo nuk e ekskludon ndihmën që duhet t'u jepet këtyre shokëve. Ndihma duhet të jetë e vazhdueshme, si për ata, edhe për ne. E theksoj që kjo ndihmë të jetë reciproke, me qëllim që ne të ndihmojmë njëri-tjetrin. Kjo është e domosdoshme dhe të mos e konsiderojmë veten, sidomos ne më të vjetrit, sikur i dimë të gjitha, sikur fjala dhe mendimi ynë janë gjithmonë të menduar drejt etj., etj. Bashkëpunimit mes shokëve, ndihmës reciproke, ndihmës kolegiale t'u kushtojmë rëndësi të jashtëzakonshme, domethënë shokët të shpre-

hin lirisht mendimet e tyre, ashtu siç i kanë shprehur deri sot, t'i argumentojnë, të sjellin eksperiencën e madhe që kanë, e cila nuk është një eksperiencë libeske, praktikiste, por eksperiencia e madhe e bazës. Me këtë kuptojmë që, si këtu në Byronë Politike, edhe në Qeveri ekzistojnë norma të shëndosha. Kjo frymë është edhe në bazë.

Ne të gjithë shokët e udhëheqjes kemi një bashkëpunim shumë të ngushtë e të hapët dhe përfitojmë nga njëri-tjetri, por të përfitojmë edhe më shumë edhe nga eksperiencia e madhe e bazës.

Thashë që do t'u jepet ndihmë këtyre shokëve, por ajo të jetë e menduar dhe e planifikuar. Nga ana tjetër, t'i lëmë shokët të rrihen me vaj e me uthull në punën e tyre, të mësohen dhe të dinë se me çfarë duhet të merren. Ndihma të mos jetë për çikërrima, por për çështjet kryesore të drejtimit, për çështjen e organizimit të punëve në mënyrë më të kualifikuar sesa bëhet tani. Ajo t'u hapë horizont për drejtim e për kontroll sa më efikas për zbatimin më të mirë të vendimeve. Një gjë e tillë duhet të bëhet duke sjellë kurdoherë përsosje në mënyrën e drejtimit dhe të organizimit. Kjo është dialektike. Këtë e kemi theksuar edhe herë të tjera, sepse situatat ecin përpara, bëhen më të komplikuar, prandaj kërkohen një drejtim më shkenkor, një organizim më kompleks, një koordinim më i mirë i punëve.

Në qoftë se këto nuk ngrihen në një nivel më të lartë dhe nuk marrim masa që të mposhtim rutinën që mund të krijohet dashje pa dashje, por gjendet një *modus vivendi*, në qoftë se punën nuk e shtyjmë

më përpara me drejtim shkencor dhe organizimin nuk e bëjmë në një shkallë më të lartë ngaqë këtu mund të lindë edhe njëfarë kënaqësie duke menduar se puna tani na ecën, do të kemi pasoja jo të mira. Këtë ta mbajmë parasysh edhe për situatat që janë krijuar, edhe në luftën që po bëhet kundër të gjitha shfaqjeve të huaja jo vetëm në frontin ideologjik të luftës së klasave, por edhe në çështje taktike, për të kapërcyer stilin dhe metodën e vjetruar në punë. Me këtë sy t'i shikojmë këto gjëra, me qëllim që punët të ecin përpara, sidomos duke pasur parasysh edhe luftën që po zhvillojmë me revizionistët kinezë, të cilën do ta bëjmë me forcat tona, në radhë të parë ne udhëheqja. Dhe kjo nuk është aq e lehtë të bëhet, prandaj të gjejmë metodën më të mirë të punës së udhëheqjes, të organizimit, të kontrollit etj.

Në goftë se e hedhim këtë mendim për diskutim e për zbatim, e bëjmë se e shohim që ka nevojë organizative për një ndryshim të tillë. Nuk e di ç'thonë shokët për këtë çështje.

*(Të gjithë shokët u shprehën se ky ndryshim ishte i domosdoshëm të bëhej.)*

Këtë ndryshim e kërkojnë situatat, e kërkon koha. Se çështja është që me partinë kineze nuk do të kemi më marrëdhënie, prej Kinës nuk do të marrim më kredi, por do të bëjmë vetëm tregti, do të kemi vetëm shkëmbime mallrash dhe kjo nuk është një punë që do të ecë lehtë. Kinezët që tani po na ngrenë çështjen e ndryshimit të çmimeve, prandaj kërkohet që shokët e tregtisë së jashtme të reflektojnë në këto drejtime dhe jo vetëm kaq, por të kualifikohen e të shkathtë-

sohen që me mallrat tona të çajnë në gjithë botën, duke i shitur ato me çmime të larta dhe t'i blejnë mallrat që na nevojiten me çmime sa më të lira.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# **TË MOS E NDALOJMË PËR ASNJË ÇAST LUFTËN IDEOLOGJIKE E POLITIKE KUNDËR TRADHTARËVE TË MARKSIZËM-LENINIZMIT**

*Fjala e mbylljes në Plenumin e 3-të  
të KQ të PPSH*

**18 nëntor 1977**

Diskutimet e të gjithë shokëve në këtë Plenum të Komitetit Qendror të Partisë ishin në një nivel të lartë politiko-ideologjik. Kjo tregon se Plenumi e ka kuptuar thellë këtë problem kapital, gjë që përbën një garanci për forcimin e mëtejshëm të Partisë dhe të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Eksperienca e pasur që fitojmë çdo ditë dhe çdo vit gjatë kapërcimit të vështirësive të mëdha në luftën për ndërtimin me sukses të socializmit, kurdoherë na armatos që të jemi në gjendje t'i kuptojmë drejt situatat që krijohen, na ndihmon të arrijmë në konkluzione të sakta për qëndrimet që na takon të mbajmë si parti, në tërësi, dhe si komunistë e luftëtarë të popullit, në veçanti. Komiteti Qendror i Partisë do të bëjë kurdoherë përgjithësimin e eksperiencës së bazës, të Partisë dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Këtë de-

tyrë na e ka ngarkuar Partia dhe ne do ta kryejmë me nder. Çështja është që eksperiencën e fituar të dimë ta përpunojmë drejt, në radhë të parë, në vijën marksiste-leniniste, ta shtjellojmë si duhet dhe pastaj ta përhapim në radhët e punonjësve me qëllim që ata të jenë në gjendje të orientohen edhe vetë në punën e tyre të përditshme.

Komunistët nuk duhet të kënaqen vetëm me kuptimin e thelbit të problemit në vija të përgjithshme. Kjo është kryesorja, por rëndësi ka që, pasi ta njohim këtë thelb, të dimë të kalojmë nga shtigjet e vështira për të realizuar qëllimet tona të pastra. Qëllimi i Partisë sonë është që, me dituritë, zotësitë dhe punën e anëtarëve të saj e të popullit, të realizohen detyrat.

Kur flasim për luftën e Partisë sonë, kemi parasysh ndeshjen e saj të madhe dhe të vazhdueshme jo vetëm me rrymat kryesore të revizionizmit, por edhe me imperializmin. E tillë ka qenë kjo luftë që nga koha e pushtimit fashist italian dhe gjerman. Pas luftës së ashpër kundër fashizmit, Partia zhvilloi luftën e saj jashtëzakonisht të vështirë e të ndërlikuar për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut. Ajo u përpoq me mish e me shpirt që, duke qëndruar në udhëheqje të popullit, të realizonte detyrat që i kishte vënë vetes. Dhe Partia i arriti objektivat e saj, me gjithë intrigat, pengesat e vështirësitë që i krijuan armiqtë. Në këtë luftë të rreptë kundër armiqve, të gërshtuar me luftën për ndërtimin e socializmit, që armiqtë kurrë nuk e kanë dashur, Partia jonë ka ecur gjithmonë përpara. Ne u ndeshëm me tradhtinë e revizionistëve titistë, të cilët, bashkë me Koçi Xoxen,



bënë çmos për të shpartalluar unitetin e Partisë, për të likuiduar udhëheqjen e saj.

Po të rishikojmë pak të kaluarën dhe ta krahasojmë me aktualitetin, do të vëmë re se lufta që bëhet nga revizionistët për të marrë pushtetin në duart e tyre dhe për të rivendosur kapitalizmin karakterizohet nga të njëjtat tipare si edhe tri dekada më parë. Rankoviçi dhe Titoja përpiqeshin ta vinin partinë në drejtimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kështu bënë ata në Jugosllavi, kështu bëri Brezhnjevi në Bashkimin Sovjetik, kështu kanë vepruar edhe Mao Ce Duni dhe pasuesit e tij me Zyrën e Përgjithshme në Kinë.

Gjithë eksperiencia e luftës që kemi bërë ne me armiqtë e egër e tepër të rrezikshëm përbën një thesar të madh për Partinë dhe për popullin tonë.

Përveç luftës me revizionistët jugosllavë, me ata sovjetikë dhe me imperialistët në planin ndërkombëtar, neve na është dashur të ndeshemi edhe me armiqtë e brendshëm, të cilët na krijojnë vështirësi për ndërtimin e socializmit, për ngritjen e industrisë sonë dhe për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Na është dashur, gjithashtu, të luftonim edhe kundër injorancës, analfabetizmit, prapambetjes në çdo drejtim etj. Lufta për emancipimin e gruas ishte kolosale, ashtu si edhe lëvizja kundër fesë, paragjykimëve fetare dhe zakoneve prapanike, lufta për elektrifikimin e vendit etj. Këto luftëra nuk janë fituar me lehtësi, për to janë dashur shumë përpjekje dhe sqarime politiko-ideologjike në masën e Partisë, të klasës punëtore, të fshatarësisë e të inteligjencies popullore.

Në themel të këtyre përpjekjeve të Partisë sonë ka qenë lufta e klasave. Partia jonë e ka mbajtur dhe do ta mbajë vazhdimisht të ngritur flamurin e luftës klasore. Edhe çështja që diskutojmë sot ka të bëjë me zhvillimin e rreptë të luftës së klasave në arenën ndërkombëtare. Çdo devijim nga marksizëm-leninizmi në arenën ndërkombëtare ka reperkusione edhe për lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e popullit tonë, që është i vetmi sovranitet i plotë në kuptimin e vërtetë të fjalës. Të gjithë imperialistët, me ata amerikanë në krye, dhe revizionistët e rrymave të ndryshme, me çfarëdo ngjyre nacionale që të maskohen, janë kundër sovranitetit të popullit. Sovraniteti e ka burimin te populli, te plotfuqishmëria e tij dhe realizohet nëpërmjet shtetit. Te ne është vendosur diktatura e proletariatit. Në Kushtetutën tonë thuhet: «Askush tjetër, veç organeve të përcaktuara shprehimisht në këtë Kushtetutë, nuk mund të ushtrojë në emër të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë sovranitetin e popullit dhe çdo atribut të tij».

Aktualisht, të gjithë deviatorët e kanë hedhur poshtë në mënyrë të hapur diktaturën e proletariatit, ata e kanë flakur edhe atë maskë që deri diku e mbanin kohë më parë. Armiqtë në arenën ndërkombëtare po luftojnë kundër diktaturës së proletariatit. Renegatët e marksizëm-leninizmit përpiqen ta çorientojnë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Megjithëse qëllimet e tyre armiqësore kanë qenë të njëjta, ata kurdoherë janë orvatur të krijojnë disa qendra për t'i grumbulluar e për t'i mbajtur të lidhur satelitët e vet ideologjikë dhe politiko-ekonomikë.

Shqipëria është e vetmja republikë popullore socialiste që ndjek me besnikëri të madhe mësimet e katër klasikëve tanë të mëdhenj, pra ne jemi i vetmi vend socialist në botë në kuptimin e vërtetë të fjalës. Nga kjo gjendje neve nuk duhet të na rritet mendja, por prej saj të nxjerrim detyra të mëdha. Kurrë të mos mendojmë se ne jemi «kërthiza e botës», kurrë të mos kujtojmë se qendra e marksizmit «fluturoi» nga Gjermania dhe tash qëndron këtu, në Shqipëri. Jo, ne jemi luftëtarë të pamposhtur, të paepur, konsekuentë për mbrojtjen dhe zbatimin e teorisë së marksizëm-leninizmit në kushtet e vendit tonë. Nuk ka asnjë dyshim se qëndrimi dhe shembulli ynë rrezatojnë dritën e ngrohtësinë e tyre dhe ndikojnë për të mirë në botë. Kjo na gëzon pa masë, por na vë edhe detyrën që ta forcojmë përshtur Republikën tonë Popullore Socialiste. Që ajo të jetë e fortë dhe që t'i kryejë si duhet të gjitha detyrat në këto situata shumë të turbullta, kërkohet që Partia, forca e vetme politike udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë sonë, të jetë në unitet dhe e çeliktë.

Entuziazmi, vendosmëria dhe trimëria e komunistëve, e klasës punëtore dhe e mbarë popullit shqiptar duhet të mos kenë kufi, por detyrat t'i kryejmë dhe realizimeve t'u gëzohemi pa mendjemadhësi. Marksizëm-leninizmi është ajo ideologji e madhe shkencore që, për sa i përket zbatimit të saj, nuk ka kufi. Në rast se jepet shembulli konkret dhe real i këtij zbatimi, ky ndihmon proletariatin botëror dhe popujt që kërkojnë çlirim të gjejnë rrugën e vërtetë në mjegullën që i rrethon.

Partia jonë po 'e kritikon ashpër revizionizmin kinez, siç ka bërë edhe për revizionizmin jugosllav, për atë sovjetik dhe për të gjitha rrymat e tjera revizioniste. Mao Ce Duni, siç u përmend këtu, na ka pasë thënë neve: «Nuk dihet kush fiton, fitojmë ne apo fitojnë armiqtë e socializmit në Kinë. Në rast se Partia Komuniste e Kinës tradhton dhe Kina bëhet vend revizionist, atëherë Partia e Punës e Shqipërisë e ka për detyrë ta kundërshtojë». Meqenëse Partia Komuniste e Kinës tradhtoi, ne po i kundërvihemi tradhtisë së saj. Mao Ce Duni na i tha fjalët e mësipërme në momente krize, në një kohë kur socializmi në Kinë ishte në rrezik dhe kur Shqipëria socialiste dhe Partia e Punës e Shqipërisë ishin të vetmet që mbronin Kinën nga revizionistët e hapët që kishin nxjerrë kokën. Ishin çaste tepër të vështira për Kinën e për Maon, i cili jetonte si në ëndërr, kur kundërshtarët e tij i vinin rrotull për t'i ngritur këmbët. Sido që kalonte çaste tepër të vështira, ai nuk hoqi dorë nga dredhita politike. Sot që ne jemi të bindur se Mao Ce Duni dhe maocedunideja janë kundër marksizëm-leninizmit dhe u shërbejnë udhëheqësve revizionistë kinezë si mbështetje për hapa të mëtejshëm në rrugën e tradhtisë, kur shihet qartë se Mao Ce Duni ka përgjegjësi të madhe për këtë shndërrim regresiv që duket çdo ditë e më mirë në Kinë, ngrihem i kundër vijës së tyre.

Çështjet që shtrënim ne para kinezëve dhe që ju i dini mirë, kishin rëndësi të madhe, ato bënë fjalë jo për episode sporadike, por për probleme serioze ndërkombëtare. Le të marrim vetëm dy vërejtjet që Partia e Punës e Shqipërisë i bëri Partisë Komuniste të

Kinësi për çështjen e konfliktit kino-sovjetik lidhur me kufijtë e vendosura para Luftës së Dytë Botërore, dhe për pritjen e ish-presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Nikson. Në to duket qartë se kritikën tona vinin në shenjë karakterin shovinist dhe racist të Kinës ndaj Bashkimit Sovjetik dhe afrimit të saj me imperializmin amerikan.

Udhëheqësit kinezë nuk e tregonin antisovjetizmin e tyre vetëm në ideologji, por ata atakuan edhe tërë kufijtë që ishin vendosur pas Luftës së Dytë Botërore. Nga ky qëndrim del qartë se ata kishin për qëllim të goditnin Stalinin, Bashkimin Sovjetik dhe Konferencën e Jaltës të vitit 1945. Ata pretendonin dhe pretendojnë sikur Bashkimi Sovjetik, pas Luftës së Dytë Botërore, që në kohën e Stalinit, paska rënë në ujdi me imperializmin amerikan dhe me atë anglez për të ndarë zonat e influencës. Kinezët e përhapnin me zell këtë pikëpamje të shpikur nga imperializmi botëror, që e mbronin dhe e mbron Titoja. Pra ata, duke dashur të fshihnin rivendikimet territoriale të tyre ndaj Bashkimit Sovjetik, ngritën çështjen e «rregullimit të të gjithë kufijve në Evropë». Çfarë synonte kjo ndërmarrje e tyre? Synonte të nxiste ndjenjat shoviniste e nacionaliste në Evropë, që të ndihmohej Kina për të tërhequr rreth vetes vendet e ish-demokracisë popullore. Për këtë arsye Mao Ce Duni foli edhe për kufijtë e Polonisë, të Rumanisë e të Çekoslovakisë, por «harroi» të zinte me gojë edhe kufijtë e Shqipërisë, harroi Kosovën, që fuqitë imperialiste ia rrëmbyen Shqipërisë dhe «ia falën» Jugosllavisë. Sot pasuesit e Maos po propagandojnë me zell të ashtu-

quajturat suksese të Kosovës, në një kohë që edhe vetë shtypi jugosllav nuk e fsheh dot prapambetjen e madhe të kësaj krahine. Edhe në vijën e politikës ndërkombëtare të kinezëve po dukeshin tendencat e maoizmit për të krijuar aleatë të rinj revizionistë që t'i kishin si mbështetje më vonë për sundimin e botës.

Çështja tjetër ishte ajo e qëndrimit krejtësisht reaksionar të udhëheqjes kineze ndaj imperialistëve amerikanë.

Byroja Politike dhe shumë shokë të Komitetit Qendror, për të mos thënë të gjithë, kanë qenë në dijeni me kohë për këto çështje që i raportuam Plenumit. Shokët janë njohur me një mijë e një fakte që vërtetojnë rrugën antimarksiste të Maos, të shokëve të tij dhe të Partisë Komuniste të Kinës. Për të arritur në këto konkluzione që raportuam, ne jemi mbështetur kryesisht në dokumentet e shumta që pasqyrojnë procesin e marrëdhënieve midis partisë e shtetit kinez, nga njëra anë, dhe Partisë e shtetit tonë, nga ana tjetër. Fakte pa mbarim rreth zhvillimeve në Kinë janë dhënë me dokumente të shkruara edhe nga të huaj. Natyrisht, ne e kemi lexuar dhe po e lexojmë shumicën e këtyre materialeve, duke i marrë të dhënat e tyre me rezerva. Në dritën e analizës së ngjarjeve në bazë të dokumenteve tona, ne konstatojmë se edhe faktet që sjellin të tjerët rreth zhvillimeve në Kinë duhet të jenë të sakta. Ato që na kanë thënë neve Mao Ce Duni ose Çu En Lai për çështjet botërore, ua kanë thënë edhe të tjerëve.

Aktualisht objektivi kryesor i imperializmit amerikan, i socialimperializmit sovjetik dhe i revizionistëve

kinezë, që synojnë të bëhen një superfuqi, është zhdukja e pavarësisë dhe e sovranitetit të popujve dhe të shteteve nëpërmjet varësisë ekonomike. Secila nga këto fuqi që përmenda përpiqet të futë nën varësinë ekonomike sa më shumë shtete të botës me anë kredish dhe investimesh. Edhe Kina tash është futur e do të futet akoma më thellë në këtë garë me imperialistët. Gati të gjitha shtetet e botës, drejtpërdrejt ose nëpërmjet shoqërive shumëkombëshe, janë pleksur në marrje kredish nga shtetet imperialiste dhe nga shtetet kapitaliste të zhvilluara. Shoqëritë shumëkombëshe përfaqësojnë shushunjat më të fuqishme që, nën maskën e zhvillimit të ekonomisë, shërbejnë për zhdukjen e pavarësisë së popujve.

Oligarkia financiare, e krijuar mbi bazën e shkrirjes së kapitalit bankar me kapitalin industrial, ashtu siç e ka parashikuar Lenini në veprën e tij «Imperializmi si faza më e lartë e kapitalizmit», po i fut kthe-trat e saj në mënyrë skandaloze kudo në botë, vetëm në Shqipëri jo. Këtë e themi me plot gojën. Për të mbrojtur pavarësinë e atdheut në fushën ekonomike, për të ruajtur të paprekur rendin shoqëror-ekonomik socialist dhe bazën e tij, pronën socialiste, Partia dhe populli ynë kryen një akt shembullor me qëndrimin e tyre konsekuent marksist-leninist, duke sanksionuar në Kushtetutën e Republikës sonë Popullore Socialiste se në Shqipëri «... ndalohet dhënia e koncesioneve, krijimi i shoqërive dhe i institucioneve të tjera ekonomike e financiare të huaja ose të përbashkëta me monoilet dhe me shtetet kapitaliste, borgjeze e revi-

zioniste, si dhe marrja e kredive prej tyre». Çdo qëndrim i kundërt në fakt do të ishte skllavërim.

Lufta që ne i bëjmë titizmit, që e vetëquan Jugosllavinë lidershipi i «vendeve të paangazhuara», është krejtësisht e drejtë. Teori të tilla si ajo e «tri botëve», e «botës së paangazhuar» etj., që shtrembërojnë kontraktat themelore të epokës sonë dhe karakterin klasor të forcave politike që veprojnë në këtë epokë, janë produkt i imperializmit në kalbëzim. Ky kalbëzim ka çuar në skandale të padëgjuesha. Sa për ilustrim mund të përmend vetëm faktin që mbreti i Arabisë Saudite, shtetin e të cilit kinezët e futën në «botën e tretë» dhe pazarllëqet e tij me imperialistët i quajnë «forcë kryesore në luftën kundër imperializmit», ka depozituar për llogari të tij në bankat e botës kapitaliste katërqind miliardë dollarë. Kështu kanë depozituar para në bankat edhe manjatët e tjerë, që shtypin popujt ku sundojnë, dhe që shpallen miq të Kinës.

Revolta e popujve kundër padrejtësive është ngritur në kulm, por kjo revoltë duhet kanalizuar në rrugë të drejtë. Kur flasim për detyrën e zgjimit të mëtejshëm të proletariatit e të popujve kundër borgjezisë, e dimë se nuk jemi vetëm ne ata që do t'i ngremë proletariatin dhe popujt e shtypur në revolucion, por kemi parasysh që do të japim kontributin tonë me të gjitha forcat për ta ndihmuar lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Do të jetë proletariati, do të jenë vetë popujt e botës, që kërkojnë çlirim, ata që do të ngrihen e do të luftojnë. Në këtë rrugë të revolucionit proletar ne kemi detyra të mëdha, një ndër të cilat është



kuptimi si duhet i rrezikshmërisë së theksuar të revizionizmit të ri, të këtij socialimperializmi që po ngrihet. Udhëheqësit kinezë, si revizionistë që janë, nuk mund ta durojnë qëndrimin marksist-leninist të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Në marrëdhëniet aktuale me ne atyre u ka zënë rrota bishtin, prandaj do të përpiqen t'i ndryshojnë këto marrëdhënie. Udhëheqësit kinezë na kanë dhënë kredi për të gjitha arsyet që dimë, për shkak të situatave që u krijuan, pra vetëm për interesat e tyre e jo në zbatim të parimeve të internacionalizmit proletar, që nuk janë praktikuar kurrë nga Partia Komuniste e Kinës. Ne nuk mohojmë se në këto kredi që na janë dhënë pasqyrohet edhe kontributi i popullit kinez, për të cilin kemi respekt.

Tani udhëheqësit kinezë do të përpiqen të ruajnë maskën e tyre, sepse, doemos, kanë interes që të mos demaskohen më tej, por megjithëkëtë, sa kohë që shkon, do t'u dalë boja akoma më shumë. Çështja nëse ata do t'u përmbahen ose jo detyrimeve kontraktore në marrëdhëniet e tyre me ne është e qartë: ata nuk do t'i realizojnë kontratat ose do t'i shtyjnë afatet e plotësimit të tyre në kalendat greke, prandaj për të ardhmen të mos kemi asnjë iluzion lidhur me kreditë dhe marrëdhëniet tregtare me Kinën. Sido që të jetë, neve, si një vend i lirë, i pavarur, sovran, socialist, na bie detyrë të mos e ndalojmë në asnjë mënyrë dhe për asnjë moment luftën tonë ideologjike dhe politike kundër këtyre dhe kundër të gjithë tradhtarëve të tjerë.

Tash që doli revizionizmi kinez, të kemi kujdes që të mos harrohet për asnjë çast revizionizmi titist, ai

sovjetik etj. Krahas luftës kundër revizionizmit në përgjithësi, ne nuk duhet të harrojmë as luftën kundër imperializmit amerikan dhe satelitëve të tij. Me një fjalë, të mos e heqim gishtin nga këmbëza e pushkës, e cila të drejtohet kurdoherë kundër të gjithë armiqve të Shqipërisë socialiste dhe të komunizmit.

Të gjitha aleancat që lidhin Kinën me shumë shtete kapitaliste e revizioniste, dhe sidomos trashja e miqësisë së udhëheqësve kinezë me Titon e me Çaushekun, e kanë shpjegimin në përputhjen e pikëpamjeve të tyre ideologjike. Si të gjithë armiqtë e marksizëm-leninizmit, edhe këta dëshirojnë dhe punojnë që këtu, në Shqipëri, të mos ekzistojë kjo vatër e fortë rezistence kundër qëndrimeve të tyre imperialiste, revizioniste. Kinezët, me anë të jugosllavëve, të rumunëve dhe miqve të tjerë të tyre, do të përpiqen të na dëmtojnë. Në qoftë se aktualisht nuk duket një sulm iminent kundër nesh, ideologjikisht dhe politikisht ky sulm ekziston dhe do të vijë gjithnjë duke u shtuar sa më shumë që të rritet influenca e ideve të marksizëm-leninizmit në botë, sa më tepër që të shumëfishohen lufta nacionalçlirimtare dhe rezistenca e popujve kundër superfuqive dhe klikave që sundojnë në vende të ndryshme.

Këtu u fol për përshtypjet e mira dhe ndjenjat e simpatisë që kanë shprehur për vendin tonë përfaqësuesit e klasës punëtore në vende të ndryshme të botës, diplomatët e shumë shteteve, si dhe njerëz përparimtarë të shkencës, të kulturës e të artit botëror. Ka ambasadorë të shteteve që aspirojnë për pavarësi dhe sovranitet, të cilët në pritje zyrtare flasin me admli-

rim për popullin e për Shqipërinë tonë socialiste dhe thonë: «Ne jemi të një mendjeje me ju dhe kemi bindje se vetëm ju jeni në rrugë të drejtë, prandaj ju jeni vëllezërit tanë». Ambasadori i një shteti afrikan, në sy të ambasadorit kinez, i tha një ambasadorit tonë: «Ty të kam vëlla!». Kurse po aty iu drejtua ambasadorit kinez e i tha: «Si jeni ju, shkëlqesi?».

Qëndrimi dashamirës i këtyre shteteve që luftojnë për mbrojtjen e sovranitetit kombëtar, është një inkurajim për ne; ai përbën një provë të vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë. Me të gjitha forcat ne duhet ta rritim dhe ta përhapim këtë influencë pozitive të vendit tonë, duke gjetur format e metodat më të përshtatshme, me materiale propagandistike, me qëndrime të drejta politike, me marrëdhënie tregtare dhe me shkëmbime delegacionesh. Të gjitha këto metoda të lidhjes së miqësisë me popujt e botës ne i kemi zbatuar dhe do t'i zbatojmë në një shkallë akoma më të gjerë. Është në interesin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe të revolucionit që në marrëdhëniet me të tjerët të mos jetë sektare, por të mos jetë as e shkujdesur, të mos humbasë vigjilencën e të mos mendojë se është e paprekshme nga çdo ndikim i huaj. Ne do të bëhemi të paprekshëm kur të jemi të kalitur mirë politikisht e ideologjikisht dhe ekonominë tonë ta kemi të pavarur. Kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme.

Të gjithë e kuptojmë, por duhet t'ia bëjmë të qartë edhe popullit, e në radhë të parë komunistëve, se pavarësia ekonomike luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e pavarësisë politike dhe ideologjike. Armiqtë

luftojnë të na vënë nën zgjedhë, kurse ne luftojmë që të ruajmë pavarësinë. Populli ynë, me Partinë në krye, edhe në kohët më të vështira nga pikëpamja ekonomike, kurrë nuk e ka ulur kurrizin. Shqiptari nuk u ka rënë kurrë në qafë atyre që s'kanë ngritur dorën kundër tij. Ai i ka nderuar dhe i ka respektuar të gjithë ata që e kanë ndihmuar si miq e aleatë. Por, kur miqtë dhe aleatët tradhtojnë marksizëm-leninizmin, shqiptari u vë topin, pavarësisht nga dëmet që do të pësonte dhe nga vështirësitë ekonomike që do të duhej të përballonte. Nën udhëheqjen e Partisë, ne u mësuar të ecim udhëve të vështira që na kanë imponuar armiqtë dhe e kemi të qartë se vështirësitë ekonomike që do të na dalin përpara tani do të jenë të mëdha, por prapëseprapë varet nga ne, nga puna jonë vetëmohuese, që këto vështirësi t'i kapërcejmë, mundësisht sa më me lehtësi, duke ruajtur lirinë, pavarësinë ekonomike e politike dhe tërësinë territoriale të vendit.

Klasa punëtore, si klasa udhëheqëse e shoqërisë, fshatarësia kooperativiste dhe punonjësit e tjerë, nën udhëheqjen e Partisë, duhet të punojnë që edhe mbrojtja të jetë e fuqishme, edhe niveli i jetesës të mos ulet, sepse, po të ndodhë kjo, atëherë do të zënë vend parullat armiqësore të imperialistëve e të revizionistëve, të cilët thonë se Shqipëria nuk mund të rrojë vetëm, prandaj do të jetë e detyruar t'u nderë dorën të tjerëve. Ky mentalitet i tyre është krijuar me kohë. Sipas imperialistëve e revizionistëve, asnjë shtet nuk mund të rrojë pa ndihmën e imperializmit amerikan dhe të kapitalit ndërkombëtar. Duke arsyetuar kështu, ata nisen nga fakti që edhe shtete të mëdha si Bashki-

mi Sovjetik e Kina u janë përrulur kredive të tyre, prandaj pyesin: «Po Shqipëria?». Dhe vetë përgjigjen: «Qëndrimi i saj është anakronik, se është e pamundur në kohën e sotme të rrojë një shtet i vogël pa ndihmën e të mëdhenjve. Qëndrimi i komunistëve shqiptarë është një gjë e përkohshme, ata do të detyrohen të nderin dorën e të ulin kurrizin». Por ka pastaj edhe borgjezë që e njohin historinë tonë dhe e dinë se populli shqiptar nuk është përrulur në shekuj. Këta e kuptojnë se shqiptarët mund të jetojnë më mirë pa ndihmën e imperialistëve, por nga vetë pozita e tyre klasore nuk mund të pohojnë se popullin shqiptar, aq krenar e të vendosur në të kaluarën, e ka bërë një mijë herë më të fuqishëm Partia e Punës e Shqipërisë e mbështetur në marksizëm-leninizmin.

Materialet për ngritjen e veprave ekonomike, për të cilat ka marrëveshje të dyanshme midis nesh dhe kinezëve, këta të fundit janë të detyruar t'i sjellin. Nuk mund të lihen në mes të udhës ato punë për të cilat kanë nënshkruar zyrtarisht dy qeveritë. Po që se kinezët do t'i shkelin arbitrarisht kontratat, le t'i shkelin, edhe ne do të dimë t'u përgjigjemi.

Përgjigjja më e mirë për kinezët, shokë, është ajo që të llogaritim sikur ata do të na i presin ndihmat që tani, sepse nga deviatorët çdo gjë mund të pritët. Prandaj ne duhet të mbledhim rripat. Të kuptohet drejt se të mbledhësh rripat do të thotë që asnjë kokërr ulliri të mos na vejë dëm, që planet t'i realizojmë zë për zë, që të prodhohet pa humbje, me cilësi, me kosto të lirë, që të punohet në mënyrë të disiplinuar dhe me ndër-gjegje të pastër. Ndryshe, shokë, nuk mund t'u për-

gjigjemi flakë për flakë vështirësive që do të na shkaktohen. A do ta lëmë ne të papërfunduar hidrocentralin e Fierzës, në qoftë se kinezët do të na lënë vetëm me një apo me dy turbina? Nuk do ta lëmë aspak! A do ta lëmë pa e ndërtuar hidrocentralin e Komanit? Jo, nuk do ta lëmë aspak! Mirëpo për këtë qëllim, që të mund të blejmë një, dy apo tri turbina etj., duhet devizë. Në qoftë se nuk i realizojmë e nuk i tejkalojmë planet, në qoftë se nuk realizojmë planin e eksportit në cilësi, në sasi dhe në kohën e duhur, devizën nuk e sigurojmë dot dhe, për rrjedhim, nuk do të jemi në gjendje të krijojmë atë forcë ekonomike që nevojitet për të vazhduar zhvillimin e forcave prodhuese e të prodhimit në bazë të planeve tona.

Ne të punojmë që t'i zhvillojmë sa më shumë forcat prodhuese dhe mundësitë janë, vetëm se duhet t'i vëmë gishtin kokës që t'i shfrytëzojmë këto mundësi. Të mos harrojmë se planet e prodhimit të mallrave të eksportit nuk realizohen, por edhe kur realizohen në sasi, cilësia dhe ambalazhi i tyre janë jo në shkallën që kërkohet.

Zhvillimi i tregtisë së jashtme, sidomos në këto situata, ka rëndësi të madhe ekonomike. E kam theksuar disa herë se në politikën ekonomike ne nuk kemi qenë e nuk do të jemi autarkikë, prandaj të luftohet për zgjerimin e tregjeve dhe për shfrytëzimin e koniunkturave. Ekzistojnë mjaft koniunktura që duhen shfrytëzuar në marrëdhëniet tregtare mes shteteve kapitaliste dhe revizioniste me të cilat ne po bëjmë tregti. Tregtia jonë e jashtme, qoftë me Hungarinë, me Çekosllovakinë, me Francën, Italinë etj., duhet të ruajë

kurdoherë qartësinë parimore. Në zhvillimin e tregtisë së jashtme nuk duhet lëshuar në parime në asnjë kohë dhe për asnjë arsye.

Tregtia jonë, siç e kemi theksuar edhe herë të tjera, duhet vështruar jo vetëm në prizmin ekonomik, por edhe politik, sepse shërben edhe si mjet komunikimi midis Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe popujve të atyre vendeve ku shiten mallrat tona. Kur mallrat «made in Albania» me cilësi të mirë i marrin masat popullore të vendeve të tjera, ato thonë: «U lumtë shqiptarëve! Shiko ç'mallra nxjerrin! Qenkan të vërteta të gjitha ato që na thonë ambasadorët e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, delegacionet e ndryshme shqiptare dhe materialet e Partisë së Punës të Shqipërisë».

Kur popujt e botës të mësojnë se Shqipëria socialiste zhvillohet e përparon dita-ditës pa marrë kredi nga shtetet kapitaliste, borgjeze ose revizioniste, do të thonë: «Ja, i vetmi vend i pavarur». Është një sukses i madh i Partisë sonë kur edhe armiqtë e saj detyrohen të pohojnë se nuk ka në botë një vend tjetër të pavarur si Shqipëria. Këtë pavarësi ne do ta mbrojmë e do ta forcojmë, veç të tjerave, edhe me anën e zhvillimit të tregtisë së jashtme. Të mos harrojmë se armiqtë do të përpiqen të na sabotojnë në këtë drejtim, të na krijojnë njëfarë izolimi ekonomik me anë të shpikjes së shumë formave e të gjetjes së shumë «arsyeve», duke manovruar me çmimet e me shumë koniunktura të tjera që mund t'i dalin tregtisë sonë të jashtme. Për këto arsye, duke pasur parasysh sa thamë, na vihet detyrë që ta organizojmë si duhet punën

tonë brenda vendit, ku të krijojmë një psikologji luftarake për realizimin e planeve, për mbrojtjen e lirisë, të pavarësisë e të sovranitetit. Kjo psikologji do të formohet çdo ditë, me luftë e me përpjekje, në unitet të çeliktë me shoqi-shoqin, me mendime të qarta që duhet të ketë çdo njeri. Ne i kemi të gjitha mundësitë që ta kalitim gjithmonë e më mirë ndërgjegjen e njerëzve tanë.

Problemet me karakter politiko-ideologjik që u shtruan në të dy raportet e Byrosë Politike para këtij Plenumi, ashtu si edhe problemet që janë shtruar më përpara, bashkë me të gjitha direktivat që kanë lëshuar Kongresi i 7-të dhe Komiteti Qendror i Partisë, duhet të materializohen. Kjo do të thotë që t'u vëmë rëndësi shumë të madhe çështjeve ekonomike. Ne duhet të realizojmë planet. Unë nuk do të hyj në detaje për domosdoshmërinë e plotësimit të detyrave, por dëshiroj të vë në dukje se, krahas sukseseve që janë arritur në zhvillimin e ekonomisë sonë socialiste, kemi akoma edhe shumë punë për të bërë në këtë drejtim. Kemi deficite nga vitet e kaluara dhe në disa degë të ekonomisë po krijohen deficite të reja. Nuk duhet ecur më me deficite, por të mbulohen këto e të shkohet përpara. Kur janë arsyet objektive që e pengojnë realizimin e planit, mungesat shpjegohen, por është për të ardhur keq se më të shumtat e herëve mungesat që vërehen vijnë për shkaqe subjektive. Këtëj duhet të nxjerrim konkluzionin që akoma nuk kemi arritur të sigurojmë plotësisht kuptimin politik dhe ideologjik të detyrave nga të gjithë punonjësit. Ne nuk e kemi ngulitur akoma si duhet në mendjen dhe në shpirtin e punonjësve e të



kuadrove tanë idenë që puna ideopolitike e organizuar mirë do të shërbejë, në mënyrë kolektive dhe individuale, si një impuls i vërtetë për kryerjen e detyrave. Prandaj në këto situata të vështira na vihet detyrë që kjo punë të bëhet më me kujdes, me një organizim më të mirë, me një sqarim politik më të zgjuar, me forma më të zhdërvjellëta e me një kombinim mënyrash dinamike. Sot më shumë se kurdoherë kërkohet t'u qëndrohet larg metodave të punës shabllone e rutinë e të braktisen ato. Problemet nuk duhen futur në korniza të mbyllura, që, disa herë, në komunikimin me masat, shndërrohen në formula stereotipe. Të gjithëve na pëlqen një bisedë që zhvillohet lirisht, kur në të flitet hapur dhe kur problemet shpjegohen shoqërisht e jo me shumë zyrtarizëm. Eksperienca na tregon se mbahen mend më mirë dhe nguliten më thellë në ndër-gjegjen e njerëzve ato biseda që janë zhvilluar lirshëm e pa fraza standarde.

Duhet të kemi parasysh që ta hedhim vështrimin kudo për të korrigjuar shokun që mbetet pas dhe për të përfituar nga ai që ecën më përpara se të tjerët. Në këto momente historike në të cilat po kalon vendi ynë, të na vrasë më tepër ndër-gjegjja për t'i plotësuar me korrektësi detyrat kaq të mëdha që vihen përpara popullit, përpara Partisë, përpara klasës për të ruajtur lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, si dhe për të ngritur më lart rolin e saj, që të jetë në gjendje të kryejë me nder detyrat ndërkombëtare. Në qoftë se i bëjmë të qarta këto detyra, atëherë të kemi bindje të plotë se punët do të na shkojnë më mirë.

Raporti i Byrosë Politike «Devijimi i Kinës nga marksizëm-leninizmi dhe nga rruga socialiste» ka nevojë për zbërthim. Ne duhet t'i thellojmë këto konkluzione që dalin si rezultat i një analize objektive të shumë fakteve. S'është e thënë që të tërë njerëzit t'i kuptojnë menjëherë të gjitha çështjet në këtë nivel që i kuptojnë Komiteti Qendror dhe shumica e komunistëve dhe e kuadrove. Por s'ka asnjë dyshim se njerëzit tanë kanë shumë besim te Partia, te rruga e saj e drejtë dhe te vendimet e saj, prandaj ne kuadrot udhëheqës e kemi për detyrë që këtë besim ta forcojmë më shumë, duke i bindur njerëzit me fakte të pakundërshtueshme. Diskutimet e mira që u bënë këtu nga shokët dhe shoqet përbëjnë një siguri për zbërthimin e raportit në një nivel të kënaqshëm. Por, megjithëkëtë, shokët duhen ndihmuar edhe me tema që duhet t'i përgatitë për këtë qëllim aparati i Komitetit Qendror të Partisë. Këto tema t'i argumentojmë me të dhëna akoma më të plota, që Partia të jetë tërësisht e qartë se ky devijim i udhëheqjes kineze do të ketë konsekuenca të mëdha negative për Kinën, kurse qëndrimi burrëror, i drejtë, marksist-leninist i Partisë sonë do të ketë konsekuenca pozitive për Partinë e vendin tonë, si edhe, për aq sa ka mundësi, për lëvizjen komuniste e punëtoare.

Komiteti Qendror në ato forma dhe në atë mënyrë që thamë, duhet t'i bëjë të qarta këto çështje në Parti e pastaj në popull. Ne, shokë, duhet të kemi iniciativë të drejtë revolucionare. Mbledhja e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë është një mbledhje pune. Këtu u shkëmbyen mendime me shumë vlerë, që shërbejnë

si një shkollë e madhe për probleme shumë të rëndësishme, të cilat kanë të bëjnë me fatet e revolucionit botëror, por edhe me fatet e vendit tonë. Këtëj del detyra që, kur të shkojmë në rrethe, të mos e mbajmë gojën të mbyllur, duke pritur derisa të vijë i deleguari i Komitetit Qendror të Partisë që të na i shpjegojë detyrat që dalin nga ky Plenum. Kur them që goja të mos mbahet mbyllur, nuk do të thotë të bisedohet gjithçka e me cilindo që ndeshemi në rrugë, por të sqarojmë mirë situatën, ato fakte e qëndrime që nuk mund të fshihen. Ne do të botojmë në shtyp komunikatën për mbledhjen e Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror. Prej saj populli ynë, që është shumë i interesuar për vendimet e Partisë, do të kuptojë se në këtë Plenum janë shtruar dhe janë diskutuar probleme me shumë rëndësi. Punëtorët, fshatarët dhe intelektualët, me të cilët ne, ushtarët e kësaj partie, na lidhin jeta, puna dhe lufta, do të na pyesin për mbledhjen. Diçka ne duhet t'ua shpjegojmë atyre që tani e t'u themi si paraqitet situata aktuale me kinezët, duke i njoftuar se, më vonë, Partia do të japë edhe shpjegime të tjera, më të qarta e më të thella. Kurdoherë për çështjet kryesore të politikës së saj Partia i është drejtuar popullit në kohën e duhur dhe ka komunikuar drejt e sinqerisht me të. Kështu do të veprohet edhe tani, edhe në të ardhmen, se Partia dhe populli janë në unitet. Në qoftë se nuk kemi mbështetjen e popullit, ne do të jemi të dobët. Përkundrazi, kur populli e përkrah Partinë, ajo është e fuqishme, e pathyeshme. Ne populli kurdoherë na ka mbështetur, prandaj jemi të bindur se rruga jonë ka qenë dhe është e drejtë. E kemi për

detyrë ta sqarojmë dhe ta bindim popullin për drejtësinë e vijës së Partisë, por kjo gjë nuk mjafton. Ne ta mësojmë atë që të jetë vigjilent dhe t'i kuptojë mirë taktikat e armikut për të mos rënë në grackën e tij. Populli të kuptojë se armiku mund ta dëmtojë sidomos në mënyrë të befasishme e tinzare. Ne duam që edhe punën sqaruese me popullin ta bëjmë, edhe të fitojmë kohë për ndeshjen me armikun.

Me specialistët kinezë që janë në vendin tonë të jemi të kujdesshëm. Në qoftë se ata sulmojnë tezat e politikës së Partisë sonë, goja nuk duhet të mbyllet, atëherë shokët komunistë, punëtorë dhe intelektualë, me mend, në kohën, në vendin e duhur dhe pa rënë në kurthin e provokacioneve, të mbrojnë tezat e Partisë sonë. Në qoftë se ata, në mënyrë të njëanshme, do të prishin kontratat e lidhura me ne, atëherë ne do ta vëmë mirë në dukje punën armiqësore që bëjnë. Po kështu, në qoftë se sulmohet vija e Partisë sonë nga kinezët, ne të mos tërhiqemi duke menduar se mund të na zemërohen e të na ikin. Shumë mirë bëri një ambasador yni, që, kur i tha ambasadori kinez se ju jeni një vend i vogël, jeni njerëz pa eksperiencë, prandaj këto që bëni nuk janë të udhës, ai iu përgjigj: «Jo, e ke gabim, ne kemi shumë eksperiencë, se kemi një parti të brumosur me mësimet e marksizëm-leninizmit, kemi një vijë politike të drejtë, por ju nuk jeni në rrugë të drejtë dhe ndiqni një vijë revizioniste». Ambasadori kinez mbylli gojën dhe iku me bishtin ndër shalë.

Lufta e ashpër që po zhvillojmë kundër revizionizmit sovjetik, titizmit, imperializmit amerikan dhe

aktualisht kundër revizionizmit kinez, do ta revolucionarizojë akoma më shumë situatën, do ta ngrejë në një shkallë më të lartë ndërgjegjen socialiste të njerëzve tanë, do t'i tendosë më tepër nervat dhe muskujt e klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste dhe të punonjësve të tjerë për të vënë në jetë direktivat e Kongresit të 7-të dhe të Komitetit Qendror të Partisë. Si kurdoherë komunistët duhet të qëndrojnë në ballë.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **RRTJA E AFTËSIVE DREJTUESE TË NJERËZVE KA RËNDËSI TË MADHE PËR ZGJIDHIJEN E PROBLEMIT TË KUADRIT**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**23 nëntor 1977**

E konsideroj të drejtë metodën e punës të organizatës së Partisë të rrethit të Krujës për zgjedhjen, edukimin dhe përgatitjen e kuadrit, sidomos të kuadrit rezervë. Kështu si në Krujë duhet punuar në çdo rreth për të konkretizuar direktivën e Komitetit Qendror për këtë problem. Përvojën e mirë ta përgjithësojmë dhe ta ndjekim që të zbatohet në të gjitha nomenklaturat. Nga ne duhet të hartohet një plan për zgjidhjen e përgatitjen e kuadrove për nevojat tona, si dhe për nomenklaturat e të tjerëve.

Eksperiencën e Krujës jo vetëm ta zbatojmë, por ka rëndësi që ta zhvillojmë më tej, prandaj për këtë duhet të na punojë koka. Nuk mjafton që në listën e kuadrove rezervë të vihet një person, natyrisht kur e ka merituar këtë me punë, çështja është që me këta zëvendës, jo vetëm kur të qëllojë, por në mënyrë të

organizuar dhe sistematike, të punohet vazhdimisht për t'i ngritur e për t'i aftësuar. Kuadri rezervë të mos figurojë vetëm nominalisht në listë, i shoqëruar me një karakteristikë të thatë, po ai të shihet në dinamizëm, në veprimtari e sipër, pra në punë e në jetë e kjo të pasqyrohet edhe në dokumente. Atë ta njohë mirë dhe ta dojë edhe kolektivi, jo se e caktojmë ne, por kur i meriton zgjedhjen dhe respektin.

Për ta zhvilluar e për ta aftësuar kuadrin në punë mund të gjenden dhe të praktikohen shumë mënyra, që kanë të bëjnë me aktivizimin e tij.

Përgjegjësi në fabrikë, në kantier, në kooperativë apo në çdo institucion mund ta ngarkojë me detyra nga koha në kohë kuadrin e vet rezervë, duke e parë në punë e sipër. Kështu, për shembull, po të vijë një njeri dhe t'i ngrejë një problem, në një moment ai mund t'i thotë: «Më fal, unë vetë tani jam shumë i zënë, prandaj shko te «Hasani», shtroja atij çështjen, se të thotë ai si të veprosh». Pasi të largohet dhe, si të kalojnë disa orë, përgjegjësi e thërret dhe e pyet «Hasanin»: «Të dërgova qëparë iksin, për t'i zgjidhur një problem, si ia zgjidhe?». Në qoftë se e ka zgjidhur drejt, atëherë i thotë: «Mirë ke bërë». Po pati vërejtje, ia bën, që të marrë masa të korigjorë pasaktësitë. Përgjegjësi e përsërit edhe një herë apo disa herë të tjera këtë praktikë, derisa të bindet që kuadri rezervë është në gjendje të thellohet në problemet dhe t'i zgjidhë drejt ato.

Çështja është që të punohet vazhdimisht për ta ngritur kuadrin rezervë, për ta aftësuar dhe për të krijuar për të një ndjenjë besimi dhe respekti nga ana e shokëve, si për punën që bën, edhe për atë që do të

ngarkohet të kryejë në të ardhmen. Secili përgjegjës, pra, duhet të mendojë paraprakisht për këtë çështje me rëndësi dhe jo të preokupohet për ta gjetur zëvendësin në fund, kur t'i vijë koha të dalë në pension. Në qoftë se në ndonjë rast shihet që mendimet e atij që do të lihet si zëvendës janë të pathëlluara, se, natyrisht, ai nuk mund ta ketë eksperiencën e përgjegjësit, ky aty është, organizata-bazë e Partisë gjithashtu aty është, ta ndihmojnë dhe jo të kapen pas ndonjë mosthëllimi të rastit dhe menjëherë të thonë me lehtësi: «Ai nuk bën».

Eksperienca e Krujës duhet kuptuar e duhet pasur parasysh jo vetëm për zëvendësimin e atyre që dalin në pension, por përgatitja e kuadrit rezervë të bëhet metodë e përgjithshme pune. Kjo ka të bëjë me rritjen e aftësive drejtuese të njerëzve tanë, gjë që ka rëndësi të madhe për zgjidhjen e problemit të kuadrit. Edhe karakteristikat duhen, këto të pasqyrojnë punën dhe aftësitë e secilit kuadër në një periudhë të caktuar, por kuadri edhe duhet të ndihmohet e të aktivizohet, të mbajë edhe përgjegjësi për të merituar vendin drejtues.

Pasi të ngarkohet kuadri me detyrën e re, duhet menduar edhe ç'të bëhet më tej me të, sepse çështje të reja ngrihen vazhdimisht dhe kërkojnë nivel kurdoherë më të lartë diturie, përgatitje ideoprofesionale dhe eksperiencë në punë. Prandaj duhet menduar e duhet punuar vazhdimisht që ta aftësojmë më tej secilin kuadër. Kryetari i kooperativës, drejtori, sekretari i organizatës-bazë të Partisë, punonjësit e kuadrit kërkohet të gjejnë forma pune nga më të ndryshmet e frytshëmë që t'i pasurojnë e jo t'i lënë «të ngrira» të dhënat



për kuadrin. Do të ishte mirë sikur me kuadrin rezervë të zhvilloheshin herë pas here leksione e forma të tjera pune të përshtatshme. Kështu, pasi të jenë grupuar më parë kuadrot, mendohet: «Këta që u kemi vënë syrin si ekonomistë, për çfarë kanë nevojë? Po këta teknikë?» etj. Për këtë qëllim mund të thirren kuadro të aftë nga degë të caktuara, të cilëve u kërkohet të mendojnë se ç'probleme financiare, për shembull, preokupojnë në atë periudhë rrethin. Atyre mund t'u jepen edhe disa të dhëna dhe të porositen që të thellohen për të përgatitur një ose disa leksione konkrete, të cilat do t'i mbajnë në një ditë të caktuar. Kësaj i thonë të bëhet një punë e studiuar. Kështu mund të përgatitet një referat për çështjet financiare, një për çështjet teknike, një për metodat e drejtimit etj. Kuadrove rezervë me siguri do t'u vlejë një punë e tillë për t'u hapur horizontin. Po të bëhet mirë ajo në të gjitha rrethet, ne do t'u hapim horizont edhe kuadrove të Partisë që të mos merren me çikërrima. Kjo nuk është e lehtë, se njerëzit në të njëjtën kohë kanë edhe shumë punë të tjera, megjithatë është e domosdoshme të bëhet, sepse, që të kesh kuadro, këta duhet të dinë dhe, që të dinë, duhet të mësojnë me këmbëngulje e pa u lodhur.

Për një punë të tillë kërkohet të reflektojnë drejtuesit, në radhë të parë. Kur t'i thonë kuadrit «Bëje referatin», ata të kenë reflektuar edhe vetë, të kenë të qartë përse e duan atë referat, nivelin, kërkesat e tij, auditorin që do t'i drejtohen. Njerëzit që kanë nevojë për atë referat, fjala vjen, llogaritarët, brigadierët e të tjerë, duhet të pyeten, por edhe vetë përgjegjësit duhet të dinë se cilat janë dobësitë dhe boshllëqet e tyre. Kë-

shtu, duke reflektuar në mënyrë të gjithanshme, atij që do të ngarkohet të bëjë referatin, i jepen të dhëna të sakta dhe orientohet se ku duhet të rrahë çekani. Kjo është një punë që vërtet kërkon kohë, por ka vlerë dhe jep fryt.

Tani më duket se kemi gjetur metodën më të mirë për të pasuruar dokumentet e njerëzve me karakteristika e me të dhëna të tjera të domosdoshme. Vetë fakti që i vihet syri një personi për ta pasur kuadër rezervë, do të thotë se ai është ndjekur me kohë gjatë punës që ka bërë dhe vazhdon të bëjë. Cilësitë e tij duhen pasqyruar në dokumente, më vonë këto të pasurohen në dinamikën e jetës. Në bazë të tyre, mund të propozohet, për shembull, që ai të dërgohet në Shkollën e Partisë ose t'i ngarkohet kjo apo ajo përgjegjësi. Një tjetri, emri i të cilit është dhënë për kuadër rezervë, mund t'i dalin në pah për një moment disa gjëra negative, prandaj kërkohet të bëhen përpjekje nga ai vetë dhe nga të tjerët për ta ndihmuar që të korrigohet e të ecë përpara. Është e domosdoshme që dobësitë t'i vihen në dukje atij që i ka, me qëllim që të ndreqet, por të mos harrohet që ato të reflektohen në të njëjtën kohë edhe në dosjen e dokumenteve të tij. Pra kuadri të ndiqet vazhdimisht në zhvillim, në jetë, të njihet plotësisht me të mirat dhe dobësitë e tij dhe të punohet që të parat t'i forcohen, dobësitë t'i veniten e t'i zhduken gradualisht.

Po të bëhet mirë kjo punë, do të evitohen me siguri rastet e subjektivizmit që vihen re herë pas here. Studimet dhe të dhënat për çdo kuadër duhet të dalin kryesisht nga mendimi kolektiv i organizatave-bazë

përkatëse dhe jo nga një person, qoftë ky punonjës i kuadrit, sekretar apo përgjegjës. Kjo do ta bëjë më të lehtë punën për përgatitjen e kuadrit.

Kuadrot, si rregull, duhet të ngrihen në sektorin e tyre dhe të mos kapëmi pas të njëjtit person për ta çuar sa në një ndërmarrje apo institucion në tjetrin. Ngritja e kuadrit në sektorin e vet, që e praktikojmë vazhdimisht, na ka dhënë rezultate të mira. Duke vepëruar kështu, kuadrit të ri nuk do t'i duhet një kohë e gjatë sa të njohë problemet, t'u hyjë punëve dhe t'i kryejë mirë ato. Me këtë mënyrë në fitojmë kohë në përgatitjen e zëvendësimit të kuadrove dhe punët do të na shkojnë më mirë. Sigurisht, kjo praktikë nuk duhet absolutizuar, por të merret si një kriter i përgjithshëm. Një punë e tillë me kuadrot, gjatë procesit të realizimit të detyrave që na vihen për të zgjidhur, duke e gërshtuar edhe me kalitjen e komunistëve, do të ndihmojë që Partia të jetë gjithmonë e re dhe të mos ketë mungesë kuadrosh.

Në qoftë se kuptohet drejt, puna me kuadrin rezervë do të na shkojë si një zinxhir i pakëputur në tërë piramidën. Kjo punë të jetë një drejtim i rëndësishëm i veprimtarisë së sektorëve të kuadrit, të organeve e të organizatave të Partisë dhe të secilit kuadër përgjegjës në çdo detyrë që të jetë.

Kur realizohet plani, drejtuesi ndien gëzim dhe lavdëron ata që punojnë më mirë, nxjerr edhe detyra që me disa të punohet akoma. Askush nuk duhet të kënaqet vetëm me faktin që ka në varësi punonjës, të cilët realizojnë vazhdimisht planin dhe të gjitha detyrat që u ngarkohen. Është shumë e rëndësishme që

drejtuesi të merret më shumë, seriozisht dhe çdo ditë me ata që realizojnë planin. Ai t'u vërë syrin në radhë të parë disave prej këtyre, më të mirëve, më të aftëve, t'i mbështetë, t'i ndihmojë dhe të mendojë një çikë më shumë për perspektivën e tyre. Kjo do të thotë të merresh vazhdimisht me punën për përgatitjen dhe aftëslimin e pandërprerë të kuadrove.

Në qoftë se do të dimë të futim mirë një metodë të tillë pune në veprimtarinë e përditshme të kuadrove drejtues, s'ka dyshim që kjo do të bëhet shprehi e traditë dhe do të trashëgohet nga njëri përgjegjës tek tjetri, sepse një kuadër i ri që ngrihet në këtë mënyrë, ka për të punuar me siguri po kështu me zëvendësit e vet, sepse do të ketë parasysh si u punua edhe me të nga paraardhësit që e sollën në detyrën me përgjegjësi që është duke kryer.

Herë pas here duhet të organizojmë edhe kontrole për këtë punë, jo vetëm për formën, por në radhë të parë për përmbajtjen e saj. Është e domosdoshme të luftohet rutina që krijohet dhe u ngjitet njerëzve si rrodhja. Disa kuadro tani kanë mjaft përvojë kur raportojnë përpara udhëheqjes ose përpara eprorëve për punën që kanë bërë, pse ata shkojnë vazhdimisht në rrethe e në bazë, bëjnë gjithfarë konstatimesh dhe, duke raportuar, kujtojnë se vetëm me këtë e kanë kryer detyrën. Duhet bërë shumë kujdes me konceptet dhe me praktikat rutinë, të cilat nuk shkulen kollaj, si domos po të mos shkohet në bazë. Instruktori, para se të nisët në bazë, duhet të ketë parasysh edhe listën e kuadrit rezervë të nomenklaturës për të cilën përgjigjet forumi që e dërgon. Ai verifikon nëpërmjet doku-

menëve, jo në mënyrë rutinë, por shkon, për shembull, në Fabrikën e Çimentos në Fushë-Krujë dhe i thotë sekretarit të organizatës së Partisë se ka ndër mend të rrijë të punojë ca ditë atje dhe të shikojë se si aktivizohen ata që janë kuadro rezervë. Kjo është një formë pune, por duhet menduar vazhdimisht për të gjetur forma të tjera, të larmishme e sa më efektive, me qëllim që të shpartallohet rutina që krijohet herë pas here dhe na pengon. Në qoftë se gjallërojmë kuadrot, organet dhe aparatet me forma pune jo rutinë, me siguri që rutina dhe formalizmi do të zhduken.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## ÇËSHITJA E DREJTË E POPUJVE ARABË ESIITË E PAMPOSIITUR

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

24 nëntor 1977

Ditët e fundit problemet e Lindjes së Mesme janë bërë objekt i një interesimi të madh të mbarë opinionit publik ndërkombëtar. Shkak për këtë ishte vizita që bëri në Jerusalem presidenti egjiptian Sadat dhe bisedimet që ai zhvilloi me kryeministrin izraelit Begin.

Fjalët për «paqe» janë me bollëk, por zgjidhja e vërtetë dhe e drejtë e problemeve të Lindjes së Mesme nuk duket në horizont. Izraeli, kjo vegël e armatosur e interesave politikë, ekonomikë e ushtarakë të imperialistëve amerikanë në Lindjen e Mesme, vazhdon të mbajë të pushtuara tokat arabe, palestinezët vazhdojnë të mbeten pa atdhe, superfuqitë vazhdojnë të intrigojnë e të ndërhyjnë në punët e brendshme të popujve të kësaj zone.

Armiqtë e popujve arabë kohë mbas kohe dalin plot bujë me plane e projekte nga më të ndryshmet gjoja për të zgjidhur problemet që preokupojnë Lindjen e Mesme dhe për t'i dhënë fund konfliktit arabo-

-izraelit, që vazhdon prej 30 vjetësh. Shumë është folur e është dëgjuar për këto plane, plane Roxhers e Kisinger, plane Gromiko e Vens, plane sheikësh e misionarësh të OKB-së. Por asgjë nuk ka ndryshuar dhe as që mund të ndryshonte. Të tëra këto plane kanë synuar e synojnë të shuajnë luftën çlirimtare të popujve arabë, t'i detyrojnë këta të heqin dorë nga interesat më të lartë kombëtarë, të braktisin popullin palestinez dhe ta lënë në të katër udhët, të kapitullojnë përpara shantazheve të Izraelit, t'i nënshtrohen plotësisht e përfundimisht sundimit të huaj imperialist.

Popujt arabë e njohin dhe e dinë mirë cilët janë armiqtë, ata e dinë se agresorët duhen demaskuar, izoluar e luftuar. Ata e dinë se një agresor i egër dhe i pangopur kundër popujve arabë, kundër lirisë e pavarësisë së tyre është Izraeli. Ky i ka gjakosur disa herë popujt vëllezër arabë, ka pushtuar tokat e tyre dhe ka kërcënuar vazhdimisht për ekspansione të reja. Izraeli çdo ditë e vazhdimisht godet, vret e pret një popull të lashtë e të lavdishëm, siç është populli vëlla palestinez, të cilin sionistët, të nxitur e të mbështetur nga imperialistët amerikanë, e kanë lënë pa strehë e pa atdhe. Në kundërshtim me çdo të drejtë, historike, ndërkombëtare e njerëzore, ai është shpërngulur me forcë nga vatrat e tij, nga tokat ku ka lindur e ka jetuar prej shekujsh, ku ka zhvilluar qytetërimin e tij të lartë, nga i cili ka përfituar mbarë njerëzimi. Tani ai është shpërndarë dhe i mjeruar jeton si muhaxhir, si mik në shtëpitë e vëllezërve të tij arabë. Por, megjithëse i vrarë e i copëtuar, populli palestinez ka ruajtur të paprekur frymën e pashuar luftarake dhe ndërgjegjen

e lartë kombëtare. Ai kurrë nuk i ka ulur ndonjëherë armët për të fituar lirinë, të drejtat dhe atdheun. Lufta heroike çlirimtare që ka bërë e bën populli palestinez do të mbetet në histori një shembull i madh i atyre popujve të vegjël, që nuk i tremb asnjë armik, sado i madh qoftë, që kur është puna për mbrojtjen e lirisë e të të drejtave të tyre, janë të gatshëm të bëjnë çdo sakrificë, të mbajnë mbi supe çdo vuajtje e vështirësi, sado e gjatë dhe e rëndë të jetë lufta.

Populli shqiptar, për të cilin lufta e popullit palestinez është shumë e afërt, ushqen një dashuri të sinqertë, një respekt e admirim të madh për këtë popull trim e të shumëvujtur dhe ka besim të patundur në fitoren e tij përfundimtare.

Përpyekje të shumta janë bërë e bëhen nga anë të ndryshme që të bihet në ujdi dhe të bëhet kompromis me Izraelin, të lihen mënjane dhe të merren nëpër këmbë interesat jetikë të popujve arabë, sidomos interesat e popullit palestinez e të atij sirian. Kjo është e dënueshme dhe nuk mund të pranohet as nga popujt arabë, as nga miqtë e tyre të vërtetë, as nga të gjithë ata për të cilët liria e pavarësia e popujve janë të shtrenjta. Populli ynë, si mik i ngushtë e besnik i popujve arabë që është, këto përpjekje për ujdi i konsideron si një veprimtarë të drejtuar kundër interesave të arabëve, si proimperialiste e që nxitin edhe më shumë agresionin izraelit.

Gjithë opinioni përparimtar e patriotik arab, që nga palestinezët e sirianët, që nga algjerianët e tek irakianët, që nga libianët e deri në Egjipt, është prononcuar hapur kundër ujdisë e kundër kompromisit



me Izraelin. Gjithashtu të gjithë ata që janë luftëtarë të vërtetë kundër imperializmit amerikan e socialimperializmit sovjetik, që janë kundër reaksionit e shtypjes, të gjithë ata që janë për lirinë e popujve dhe përkrahin luftën e tyre çlirimtare, e kanë kritikuar dhe e kanë dënuar pa mëdyshje ujdinë me Izraelin, kanë mbajtur një qëndrim të prerë ndaj çdo kompromisi me të.

Por në kundërshtim me këtë opinion të gjerë, me këtë opinion të shëndoshë, vihet re se aktualisht nuk po luan fare karta e «të paangazhuarve». Ata heshtin e manovrojnë me zor për të dalë nga pozita e vështirë në të cilën po i vë plani i ujdisë me Izraelin. Ku vanë gjithë ato fjalime e përbetime për mbrojtjen e të drejtave të popujve arabë e të palestinezëve, ku vanë gjithë ato rezoluta e vendime për «zgjidhjen e drejtë» të konfliktit në Lindjen e Mesme, ato kundërshtime nga tribuna e konferencave për ndërhyrjen imperialiste në këtë zonë?

Kjo heshtje për këta amatorë të papërmbajtur të llafeve nuk është e rastit. Falsitetin e «teorive» ose të «lëvizjeve» që janë destinuar për shuarjen e luftërave revolucionare e çlirimtare dhe për mashtrimin e popujve, e nxjerrin në shesh ngjarjet konkrete, ndodhitë zhvillimi i luftës së klasave. Këtë falsitet ua zbulojnë edhe vetë imperialistët, të cilët, kur është puna për të mbrojtur interesat e tyre, nuk bëhen fare merak se në ç'pozita të vështira i vënë miqtë e vet. Çfarë të thonë teoricienët dhe përkrahësit e lëvizjes së «të paangazhuarve» kur flamurtarë të «mosangazhimit» e tregojnë hapur veten se janë të angazhuar e të varur nga im-

perializmi, se bëjnë lojën e tij, se politika që ndjekin formalisht është e pavarur, por në realitet diktohet nga të tjerët, mbron interesa të huaj për popujt arabë?

Lëvizja e «të paangazhuarve» mund të vazhdojë të jetojë akoma në konferenca, në mbledhje e në propagandë, por ajo ka vdekur që kur në Lindjen e Mesme e në shkretëtirat e Ogadenit, në Angolë e Zaire, u tregua e paaftë të fshehë faktin se mjaft qeveri të vendeve që e heqin veten të paangazhuara janë të lidhura me këtë ose atë fuqi të madhe kapitaliste e imperialiste, se në shumë raste këto bëjnë lojën e imperializmit dhe mbrojnë interesat e tij neokolonialistë e ekspansionistë. Ajo është tashmë e paaftë të mbulojë dhe të justifikojë me sofizma boshe ndërhyrjet, intrigat e manovrat e superfuqive imperialiste në shumë vende «të paangazhuara», të fshehë e të justifikojë veprimet proimperialiste dhe kundër luftërave çlirimtare të shumë prej krerëve të këtyre vendeve.

Lidhur me ujdinë e kompromisin me Izraelin nuk po duket gjithashtu as veprimtaria e së ashtuquajturës botë e tretë. Përkrahësit e teorisë së «tri botëve», që bërtasin me të madhe dhe përpiqen të provojnë me citate se përkrahin pa kursim luftërat çlirimtare dhe mbrojnë interesat e popujve të botës, nuk po i shohim që të mbrojnë kauzën e drejtë të popujve arabë, nuk po i shohim të dalin në mbështetje të tyre. Përse vallë? Mos duhen sakrifikuar interesat e arabëve, tokat e tyre, fati dhe jeta e palestinezëve për hir të aleancës me «botën e dytë» dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Apo ndoshta kështu e duan interesat e lartë të

superfuqive imperialiste, që popujt e vegjël dhe njerëzit e thjeshtë nuk arrijnë t'i kuptojnë dot?

Është e kuptueshme pozita aspak e pëlqyeshme e përkrahësve të teorisë së «tri botëve», të cilëve ujdia e kompromisi me Izraelin ua shthur e ua bën lesh e li skemën që lidh «botët» e tyre. Pyetja është e thjeshtë: Në favor të kujt është kjo ujdë? Të «botës së parë», të së «dytës», apo të së «tretës»? I shërben çlirimit të popujve, apo shtypjes kombëtare, luftës anti-imperialiste, apo shuarjes së saj? Heshtja tregon se kjo ujdë nuk futet në asnjë kallëp propagandistik, se në këtë rast sloganet e «teoritë» nuk i bëjnë dot faktet të ndryshojnë natyrën e tyre.

Politika e imperialistëve amerikanë, që mbron e mbështet satelitin e saj më agresiv, Izraelin, a mund të konsiderohet politikë joagresive, në tërheqje? Në kohën e sotme lufta agresive përgatitet shkallë-shkallë, nëpërmjet luftërave të pjesshme, duke nxitur agresione të veçanta, duke ndezur luftëra lokale. Në qoftë se imperialistët amerikanë reklamojnë se janë gjoja për statukuonë, kjo nuk do të thotë se ata kanë hequr dorë nga synimet agresive e ekspansioniste, por se statukuoja u shërben qëllimeve të tyre hegjemoniste në dëm të popujve arabë e në favor të interesave imperialistë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të aleatit të tyre, Izraelit.

Ne jemi kundër dhe e demaskojmë këtë fshehje që Karteri mundohet t'i bëjë politikës së tij agresive. Ne jemi, gjithashtu, kundër paraqitjes së politikës amerikane të «statukuosë» si një politikë joagresive, por mbrojtëse. Imperializmit amerikan akoma s'i kanë rënë

dhëmbët, as i janë përë thonjtë. Të mbrosh politikën e statukuosë do të thotë të mbrosh pushtimet imperia-  
liste, të mbrosh ndarjen e botës midis fuqive të mëdha,  
të mbrosh neokolonializmin dhe shfrytëzimin që u bë-  
het popujve të shtypur nga imperializmi dhe nga gjithë  
fuqitë e tjera kapitaliste. Të mbrosh statukuonë do të  
thotë të bekosh pushtimin e tokave arabe nga izraelitët  
e shpërnguljen me dhunë të palestinezëve nga vatrat  
e tyre, do të thotë të mbrosh bazat ushtarake në ven-  
det e huaja, blloqet agresive të imperializmit, shoqë-  
ritë monopoliste shumëkombëshe, mbarë sistemin im-  
perialist shtypës e shfrytëzues.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar i  
hedhin poshtë me përbuzje të gjitha llogaritë imperia-  
liste. Populli ynë ka qenë dhe është gjithnjë me kau-  
zën e drejtë të popujve arabë dhe do të jetë përkrah  
tyre në çdo situatë, të mirë e të keqe, në gëzime e  
në fitore, në hidhërime e dështime të përkohshme. Popu-  
lli ynë është një popull i vogël, por për popujt që luftojnë  
për liri e për të drejtën, siç janë popujt arabë e po-  
pujt e Afrikës, ai është një vëlla besnik e i patundur.

Faktet dhe jeta e përditshme ndërkombëtare tre-  
gojnë qartë se politika e përgjithshme që ndjekin su-  
perfuqitë imperialiste është ndërtuar në përputhje me  
interesat e tyre egoistë, duke u nisur nga qëllimi se  
kush të vendosë më mirë e më shpejt hegjemoninë e  
vet mbi popujt e kontinentet. Secila nga superfuqitë  
imperialiste, si atëherë kur i ka futur thellë thonjtë në  
mishin e huaj, ashtu edhe kur është duke vënë piketat  
e para të ekspansionit, lufton t'u imponojë vendeve e  
grupvendeve politikën e saj.

Socialimperialistët sovjetikë punojnë me të gjitha forcat që të mashtrojnë udhëheqje të vendeve të ndryshme të Afrikës, duke u fshehur prapa maskës së vendit socialist dhe duke u shtirur si kampionë të lirisë. Ata u shesin armë këtyre vendeve dhe u shkëputin si shpërblim të drejtën për të krijuar baza ushtarake për interesat e tyre sundues dhe për të shtrirë më tej ekspansionin imperialist.

Njëkohësisht, një fuqi tjetër imperialiste, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, manovron nëpërmjet agjentëve të saj, nëpërmjet kredive, armëve e dollarëve dhe i lëviz të gjithë gurët për t'u ngritur këmbët social-imperialistëve sovjetikë. Gara e superfuqive për sundim e hegjemoni nuk ka kufi, ajo nuk njeh asnjë rregull ose moral, mashtrimi e pabesia ecin në një radhë me krimin e dhunën.

Viktimë e këtyre lojërave të rrezikshme të superfuqive bien popujt, bien vendet e ndryshme që bëhen objekt i rivalitetit të egër sovjeto-amerikan. Tani shohim që Etiopia e Somalia, dy popuj liridashës e paqdashës me një kulturë të lashtë dhe që kanë vuajtur të zita e ullirit nga pushtuesit kolonialistë italianë, kanë hyrë në luftë dhe po vriten njëri me tjetrin. A e duan këta popuj këtë luftë, që u shkakton aq vuajtje e aq mjerim? Aspak. A mund t'i zgjidhin mosmarrëveshjet që kanë midis tyre pa qenë nevoja të luftojnë e të theren me njëri-tjetrin? Sigurisht, ata kanë mundësi t'i zgjidhin këto mosmarrëveshje duke gjetur rrugët më të përshtatshme. Atëherë pse luftojnë? Është e qartë se në luftë këta popuj i shtyjnë të tjerët, fuqitë e

superfuqitë imperialiste për interesat e tyre grabitqarë e hegjemonistë.

Ndërkaq, ndërsa derdhet lumë gjaku i këtyre popujve të mjeruar dhe rritet urrejtja midis tyre, ka fuqi imperialiste e kapitaliste që herë marrin anën e njërit, herë të tjetrit, herë duartrokasin njërin vend, herë tjetrin, pa bërë as gjestin më të vogël për të ndihmuar këta popuj të shumëvujtur që të fitojnë paqen dhe mundësinë për të ndërtuar jetën e tyre në liri e pavarësi të plotë.

Politika e Partisë së Punës të Shqipërisë ka qenë kurdoherë në mbështetje të luftës nacionalçlirimtare të popujve, në mbrojtje të interesave të tyre. Ajo ka qenë dhe është gjithnjë e hapët e parimore. Siç e theksuam në Kongresin e 7-të të PPSH, «Partia jonë mendon se popujve u duhet folur hapur për situatat, pse vetëm kështu ndihmohet bashkimi i vërtetë i tyre, bashkimi i shteteve dhe i qeverive me të vërtetë anti-imperialiste e përparimtare. Për t'u bashkuar popujt në luftën për liri, pavarësi e përparim shoqëror, kundër çdo shtypjeje e shfrytëzimi nga kushdo qoftë, më parë duhen vënë kufijtë, duhet bërë e qartë se kush është armiku kryesor i tyre, kundër kujt duhet luftuar dhe me cilin duhet bashkuar»<sup>1</sup>.

Popujt duhet të ruhen nga intrigat e superfuqive imperialiste, të cilat vijnë si mike, si dashamire, por qëllimi i tyre i vërtetë është të dominojnë, të hedhin bazat për vendosjen e hegjemonisë. Kjo ngjet në Angolë, në Zaire e gjatë. Kjo po ndodh për një kohë të

---

1. Enver Hoxha, Vepra, vëll. 59, f. 196.

gjatë edhe në Lindjen e Mesme me dramën që po luhet me fatet e popujve arabë, ku superfuqitë imperialiste lëvizin të gjitha fijet, althernajnë njëra-tjetrën për të plotësuar ambiciet ekspansioniste e shfrytëzuese.

Historia e luftërave revolucionare e çlirimtare, si dhe praktika e jetës së përditshme ndërkombëtare na mësojnë se armiqtë nuk duhen lënë në qetësi që të kenë kohë të bien në ujdi, të grupojnë forcat e të organizohen në luftën e tyre kundër popujve. Ne kemi besim të plotë se të gjithë ata që shtypen e vuajnë nga imperialistët e reaksioni, të gjithë ata që duan lirinë e pavarësinë e vendeve të tyre, do të mobilizohen edhe më shumë për të demaskuar planet e synimet e superfuqive imperialiste për mbytjen e revolucionit e robërimin e popujve, do ta ngrenë edhe më lart luftën e tyre revolucionare për të përballuar e për të mposhtur armiqtë.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 282 (9141), 24 nëntor 1977*

*Botohet sipas gazetës «Zëri i popullit», nr. 282 (9141), 24 nëntor 1977*

# FORCA E PARTIVE TË VËRTETA MARKSISTE- -LENINISTE QËNDRON NË ZBATIMIN E DREJTË TË PARMEVE

Shënime

28 nëntor 1977

Me shokun Hysni pata një bisedë në lidhje me partitë marksiste-leniniste motra në Evropë dhe në vende të tjera të botës. Ato duhet të kenë parasysh se borgjezia me partitë e saj dhe revizionizmi modern me partitë e tij të ndryshme, po bëjnë një punë minuese shkatërruese kundërrevolucionare në shkallë të gjerë me metoda dhe me forma të ndryshme. Në bazë të këtyre metodave e formave është demagogjia. Veçanërisht revizionistët modernë, qofshin këta sovjetikë apo të Evropës Lindore, të Evropës Perëndimore ose revizionistët kinezë apo revizionistë të çfarëdo tipi tjetër, përdorin me shumicë citate dhe thënie të klasikëve të marksizëm-leninizmit për të maskuar veprimtarinë e tyre sabotuese kundër revolucionit, kundër socializmit. Ata janë reformistë, bernshtajnistë, trockistë, maoistë, hrushovianë etj.

Qëllimi i tyre është të mos bëhet revolucioni, prandaj përpiqen të shkatërrojnë, kudo që mundin, partinë



pararobjë të klasës punëtore, që kjo të mos mund të udhëheqë dot, të mos bëjë bashkimin e proletariatit të çdo vendi me revolucionarët e ndryshëm dhe të mos realizohet internacionalizmi proletar kundër shtypjes kapitaliste botërore. Prandaj rëndësia e demaskimit të metodave dhe të stilit të punës të partive revizioniste, të partive të kapitalit, merr një proporcion kolosal. Partitë e vërteta marksiste-leniniste duhet të dinë se kanë përpara një luftë të madhe e të ashpër në një platformë të gjerë, e cila nuk mund të zhvillohet, të zmadhohet dhe të fuqizohet pa një front antiimperialist dhe antirevizionist, pa një front të gjerë nacionalçlirimtar, ku partia marksiste-leniniste të luajë rolin kryesor, rol që ajo duhet ta fitojë dhe ta forcojë me luftë.

Partitë e vërteta marksiste-leniniste motra janë në një numër akoma të vogël dhe, sado që të rritet numri i tyre, nuk mund të arrijnë menjëherë atë forcë numerike që ne kërkojmë. Por forca e partive të vërteta marksiste-leniniste qëndron në kuptimin e thellë të parimeve marksiste-leniniste, në mbrojtjen e paepur të këtyre parimeve, në përpjekjet për përhapjen e tyre dhe në krijimin e aleancave me forcat revolucionare përparimtare antikapitaliste dhe antirevizioniste. Këtu ka rëndësi taktika e drejtë nga ana e tyre. Këtë taktikë të drejtë nuk mund ta aplikosh në rast se, e para, nuk i ruan parimet dhe, e dyta, nuk i njeh mirë situatat brenda në vend, nuk njeh mirë gjendjen politike, morale dhe ideologjike të proletariatit, në radhë të parë, dhe të të gjitha masave të tjera punonjëse. Prandaj lypset kurdoherë një pasqyrë, lypset një analizë, e cila duhet t'i vëre partitë marksiste-leniniste dhe udhëhe-

qjet e tyre përpara disa detyrave të caktuara, përpara disa objektivave, të cilat ato duhet t'i realizojnë nëpërmjet një lufte jositare, as edhe oportuniste, por me një vijë elastike, gjatë zbatimit të së cilës duhet të realizohet uniteti, fronti kundër imperializmit dhe revizionizmit, pa shkelur parimet, por edhe pa rënë në kompromis me këto forca.

Këtu partitë e vërteta marksiste-leniniste duhet të kenë mendjen të ruhen nga sektarizmi, pse të gjitha forcat armiqësore të kapitalit dhe të revizionizmit kanë tendencë ta izolojnë partinë komuniste marksiste-leniniste të çdo vendi, ta mbajnë të mbyllur në një qoshe. Tendenca e armiqve është të na izolojnë ne partitë marksiste-leniniste, kurse tendenca jonë është e kundërta, të mos izolohejmë. Por, që të mos izolohejmë, nuk duhet menduar vetëm për shtimin e radhëve me anëtarë partie. Kjo është një nga problemet me rëndësi të partisë, por çështja është të bashkosh rreth partisë, rreth vijës së saj, rreth qëllimeve të saj, rreth programit të saj minimal, një numër kurdoherë e më të madh njerëzish, me të cilët duhet hedhur në luftë. Këta njerëz ose këto grupe njerëzish duhet të njihen dhe për këtë qëllim duhet rënë në kontakt me ta. Në qoftë se do të ekzistojë frika për të marrë kontakt me këta njerëz, atëherë vjen edhe izolimi i partive marksiste-leniniste dhe tendenca e izolimit është, për arsye se këto grupe ose këta njerëz nuk janë plotësisht të kulluar, ka elementë që nuk janë pa lidhje e pa rrënjë me borgjezinë. Por situata në të cilën ndodhen, i bën të mos i pranojnë shtypjen dhe shfrytëzimin e tyre nga borgjezia. Ekzistojnë, pra, në këto grupe ose në

radhët e këtyre njerëzve ndjenja, si me thënë, të mira për masat e gjera të popullit, për pavarësinë dhe lirinë e atdheut, për shkëputjen e tij nga skllavëria e imperializmit, e superfuqive. Këto tendenca të tyre partitë marksiste-leniniste duhet t'i njohin dhe t'i shfrytëzojnë. Jo vetëm t'i shfrytëzojnë, por edhe t'i lidhin me partinë këto grupe dhe këta njerëz, me qëllim që të prekin bazën e tyre të shëndoshë. Këto grupe ose këta njerëz kanë në bazë edhe njerëz të mirë, por kanë dhe njerëz të këqij dhe pikërisht pse kanë njerëz të këqij, partitë marksiste-leniniste mund të hezitojnë që të bien në kontakt me ta. Pikërisht këtu duhet të spikatin zgjuarsia dhe elasticiteti i një partie marksiste-leniniste për të krijuar aleancë me ata njerëz, grupe ose parti që nuk janë marksiste-leniniste, që nuk janë plotësisht në pozitë e majta, që në pikëpamjet dhe në programet e tyre ka çështje që na bashkojnë. Ne duhet të bashkohemi me ta deri në njëfarë shkalle, deri në njëfarë vendi, pse pastaj ata, natyrisht, do të na braktisin. Por gjatë kësaj kohe ne do t'i kemi konsoliduar pozitë tona, do të kemi krijuar lidhje më të shëndosha me njerëzit e tyre të bazës dhe kjo bazë e shëndoshë, në sajë të punës së zhvilluar, do t'i ketë kuptuar rëndësinë e unitetit dhe drejtësinë e vijës së partisë marksiste-leniniste.

Borgjezia dhe kapitalizmi, për shembull, në Spanjë kanë krijuar deri në 200 parti. Po pse i krijojnë ata gjithë këto parti? Për të përçarë opinionin, pse çdo parti ka tendencat e veta, që janë të ndryshme nga të tjerave. Shumë prej tyre nuk kanë diferencë të mëdha në pikëpamjet e njëra-tjetrës, por disa kanë dife-

renca, nuanca, që janë krijuar për një arsye ose për një tjetër. Tashti Partia Komuniste e Spanjës (marksiste-leniniste) duhet të njohë qëllimin dhe brendinë e programeve të këtyre partive, që kanë lindur si kërpuhat pas shiut, dhe të mund të gjejë ato pika që mund ta bashkojnë me disa nga këto parti, qoftë edhe për veprime të veçanta të përkohshme. Edhe një gjë e tillë prapë mund dhe duhet të bëhet, se na shërben, në mos për veprime të një periudhe të gjatë, edhe për një kohë të shkurtër.

Në Francë, për shembull, Partia Komuniste Franceze ka luftuar, por edhe ka tradhtuar. Kur ajo ishte në pozita pak a shumë revolucionare, ka pasur edhe anë pozitive, por ka pasur edhe anë negative, të cilat me kohë u trashën dhe morën epërsinë. Kështu gradualisht Partia Komuniste Franceze shkoi në tradhti. Pra, marksistë-leninistëve të Francës, jo Zhyrkesë, por marksistë-leninistëve të vërtetë, atyre që do të krijojnë partinë e vërtetë marksiste-leniniste, u bie për detyrë ta studiojnë këtë eksperiencë të Partisë Komuniste Franceze, të ndajnë shapin nga sheqeri dhe anët e mira e revolucionare të kësaj partie të mos i braktisin e të mos i hedhin poshtë, sepse këto janë anët e mira të proletariatit francez, që ka luftuar kundër borgjezisë, kundër kapitalit.

Ne studiojmë veprat e Marksit, ku ka folur për proletariatin francez, për revolucionin e 1848-s, për Komunën e Parisit. Kjo është eksperiencia e revolucioneve në Francë, e kryengritjeve të proletariatit francez, e Komunës së Parisit, që Marksi i ktheu në ligje dhe që për ne janë një eksperiencë e madhe. Atëherë anët po-

zitive të Partisë Komuniste Franceze a nuk përbëjnë edhe ato eksperiencë në luftën e proletariatit francez? Sigurisht që po. Prandaj kjo eksperiencë nuk duhet hedhur poshtë, po të mësohet për të ditur si të shfrytëzohet në kushtet aktuale, pse ne e dimë që Partia Komuniste Franceze ruan një kontingjent të madh anëtarësh. Pse ndodh kjo? Sepse komunistët kanë nostalgji për partinë e tyre dhe kjo është një arsye që duhet kuptuar. Shumë komunistë të mirë kanë luftuar në radhët e Partisë Komuniste Franceze dhe u vjen keq të largohen prej saj. Udhëheqja tradhtare e Partisë Komuniste Franceze përpiket t'i bindë dhe t'i mbajë lidhur këta me tradhtinë e vet. Mirëpo shumë prej tyre nuk arrijnë dot ta kuptojnë si duhet mashtrimin e udhëheqjes tradhtare. Atëherë kujt i bie detyra t'ia hapë sytë proletariatit francez që ky të mos hedhë poshtë traditat e tij revolucionare dhe këto tradita revolucionare t'i ringjallë, duke luftuar revizionistët francezë, duke luftuar gjithë skoriet e kësaj partie? S'ka dyshim, marksistë-leninistëve francezë. Vetëm në këtë mënyrë do të fitojnë ata përkrahjen e proletariatit francez dhe partia e vërtetë marksiste-leniniste, që ata do të themelojnë, do të fitojë simpatinë e klasës dhe do të çimentojë unitetin e saj me të. Ndryshe nuk mund të ndodhë.

I duhet vënë në dukje proletariatit francez se si ka arritur aristokracia e klasës punëtore bashkë me borgjezinë t'ia hedhin atij zinxhirë të panumërt dhe të fortë, duke e detyruar të mos lëvizë e të mos hidhet në rivendikime politike e njëkohësisht ekonomike për të ndryshuar situatën në Francë.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për vende të tjera. Shohim, për shembull, Partinë Komuniste të Austrisë (marksiste-leniniste) me Strobelin në krye. Kjo parti nuk di të punojë dhe mund të themi se nuk ekziston. Në të ekzistojnë vetëm disa njerëz, por nuk i sheh ku janë. Strobeli me sektarizmin e tij e likuidoi, si me thënë, partinë e tij marksiste-leniniste dhe shokët e tij u shpërndanë. Ku shkuan? Ata nuk janë bashkuar me borgjezinë, po kanë filluar të krijojnë grupe të tyre. Përse janë ndarë me Strobelin? Janë ndarë për disa pikëpamje, për të cilat duhet diskutuar. Ata e kanë harruar luftën e Leninit për çështjen e unitetit, harrojnë se nuk janë në pushtet. Lenini ishte për unitetin e mendimit dhe të veprimit në parti, ai ishte për marksizmin, ishte për revolucionin, ishte për ndërtimin e socializmit. Edhe nxënësi i tij besnik, Stalini, duke ndjekur mësimet e Leninit, e kaliti Partinë Bolshevike. Kështu duhet të veprojnë edhe partitë e tjera marksiste-leniniste, të marrin mësim nga leninizmi.

Dje dëgjova se Karriljoja ka deklaruar në një universitet të Shteteve të Bashkuara të Amerikës se partia e tij nuk do të quhet më parti marksiste-leniniste, por do të quhet vetëm parti marksiste. Hapur flet ai dhe është konsekuent në pikëpamjet e tij tradhtarë prej re-negati, prej revizionisti, prej agjenti të imperializmit. Ai me këtë hedh poshtë kështu gjithë leninizmin, domethënë është kundër teorisë së Leninit, që na mëson se epoka aktuale është epoka e kalbëzimit të imperializmit, i cili është stadi i fundit i kapitalizmit, dhe e revolucioneve proletare.

Karriljoja nuk mund ta pranojë tezën leniniste se

Imperializmi është në kalbëzim. Përkundrazi, për Karriljon kapitalizmi dhe imperializmi janë në lulëzim dhe partia e tij pseudomarksiste duhet ta mbështetë kapitalizmin me reforma, ta bëjë atë më të përshtatshëm për kohët aktuale. Pra, Karriljoja është kundër revolucionit, kundër revolucioneve proletare, prandaj ai përpjetet ta quajë partinë e tij vetëm marksiste dhe përse vetëm marksiste? Për arsye se edhe Marksini ai e konsideron të vjetruar. Sidoqoftë ai thotë se Marksini i ka bërë kritikën kapitalizmit, por këtë kritikë, me disa deformime, duke e quajtur Marksini të vjetruar e të plakur, ne e zbutim dhe e shuajmë, ruajmë maskën dhe quhemi parti marksiste. Kurse në bazë të teorisë sonë, në bazë të revolucionit, në bazë të socializmit e të komunizmit është teoria e Marksini, të cilën e pasuruan Engelsi, Lenini e më vonë edhe Stalini. Prandaj Karriljoja i ka hedhur poshtë të gjithë këta udhëheqës të mëdhenj të doktrinës sonë, por, për të mos u shkëputur plotësisht e që të mos bëhet një parti fashiste edhe në pamje, ai i ruan emrin e emërtimin «marksiste» partisë së tij.

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 9, f. 822*

## SHQIPËRIA ËSHTË E FORTË. ATË E BËN TË TILLË MARKSIZËM-LENINIZMI

*Nga biseda me shokun Jakup Mahmuti*

29 nëntor 1977

*Shoku Jakup Mahmuti, shqiptar me banim jashtë atdheut, kishte ardhur në Shqipëri për të kaluar festat e nëntorit. I ftuar në darkën e shtruar me këtë rast në Pallatin e Brigadave, ai vajti për të tokur gotën me shokun Enver Hoxha, i cili e ftoi t'i ulej pranë dhe zhvilloi me të një bisedë të ngrohtë.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë se erdhe, xha Jakup! Si je me shëndet?

**SHOKU JAKUP MAHMUTI:** Shumë mirë jam. Kur të pashë, sikur u bëra edhe një herë i ri. Të gjithë tradhtarët do të gjejnë belanë, siç e kanë gjetur.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shqipëria është e fortë, atë e bën të tillë marksizëm-leninizmi, lufta kundër revizionizmit, kundër të gjithë armiqve. Është politika e drejtë e Partisë që e bën të tillë vendin tonë.

Si të dukem, xha Jakup, jam plakur ndonjë çikë?

**SHOKU JAKUP MAHMUTI:** Më dukeni më i ri r.ga sa keni qenë përpara.

Erdhi njëherë Moris Torezi dhe na foli kundër popullit shqiptar. E mora fjalën e i thashë: Pse flet ashtu?



Populli shqiptar ka luftuar heroikisht dhe me luftë u çlirua. «Nuk flas për popullin shqiptar, — «korrigoj» ai, — por e kam fjalën për Enver Hoxhën». Edhe Enver Hoxha, i thashë unë, djalë i popullit shqiptar është, ai e udhëhoqi Shqipërinë në fitore. Pastaj i thashë Vermershit: Deri tani kam qenë në Partinë Komuniste Franceze, por këtej e tutje nuk do të jem më, unë nuk e harroj kurrë Enver Hoxhën.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Falemnderit shumë!

Si nuk më kanë thënë tçua që keni ardhur? Sa ditë keni këtu?

**SHOKU JAKUP MAHMUTI:** Kemi nja katër ditë që kemi ardhur, do të rrimë edhe disa ditë akoma, pastaj do të shkojmë në Elbasan. Nuk e dini sa u gëzova dhe sa i ri u bëra kur ju pashë me sy! Gjithnjë jemi përpjekur e kemi luftuar, por na ka munguar udhëheqësi i vërtetë, kurse tani jemi ndryshe, ju kemi ju.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kemi Partinë të fortë, ashtu siç të thashë. Partia jonë është forcuar edhe më shumë në luftën kundër revizionistëve. Erdhën në vitin 1960 Morisi me gjithë Zhanetën, ndenjën këtu disa ditë dhe ne biseduam me ta tri ditë. Na këshillonin që «këto gjëra që keni me sovjetikët, duhet t'i bisedoni, t'i zgjidhni me udhëheqjen sovjetike». I kemi biseduar, u thoshim ne, por nuk na janë zgjidhur. Kështu biseduam atëherë dhe ata hiqeshin sikur bindeshin, nuk ishin kundër nesh në fillim. Por, kur shkuam në Mbledhjen e 81 partive në Moskë, Morisi na erdhë në vilën ku rrim, përpara se të bëhej mbledhja. Edhe francezët e kishin marrë dokumentin që kishte shpërndarë Hrushovi. Torezi na pyeti: «Si do të bëni?» (Hrushovi

për ne kishte shpifur shumë gjëra në atë dokument, na quante rebelë etj.) dhe na sugjeroi të pajtoheshim me sovjetikët, domethënë të futeshim në rrugën e tyre, por ne nuk mund të bëheshim revizionistë. Në atë vilë sovjetikët kishin vendosur aparatura përgjimi që të na regjistronin bisedat, por fjalimi ynë ishte mbyllur në kasafortë në ambasadën shqiptare dhe asnjëri nuk e dinte se çfarë do të thuhej nga ne në mbledhje, ku do të shprehnim mendimet tona, pavarësisht çfarë mund të thoshin të tjerët për ne. «Do t'ju sulmojnë», na tha Torezi. Ne jemi mësuar të na sulmojnë, nuk trembemi, ato që kanë për ne, le t'i thonë përpara të gjithëve, ngulëm këmbë ne. Në qoftë se udhëheqësit sovjetikë janë marksistë, le t'i tregojnë hapur të gjitha gabimet që kanë bërë ndaj nesh. «Ata nuk kanë bërë gabime», i mbrojti Moris Torezi. Atëherë, në qoftë se mendoni dhe flisni kështu, natën e mirë! — i thamë, dhe i dhama fund bisedës me të.

**SHOKU JAKUP MAHMUTI:** Kur ishim bashkë me Ali Kelmendin dhe me Gogo Nushin në Francë, ata të Partisë Komuniste Franceze, ç'është e vërteta, na kanë ndihmuar shumë, mirëpo, pas vdekjes së Stalinit na kanë sulmuar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duhet të jemi realistë, partitë komuniste, pas krijimit të Internacionales së Tretë, mbajtën qëndrim pro Bashkimit Sovjetik, kurse me ardhjen e Hrushovit në fuqi shumica e tyre hodhën baltë mbi Stalinin.

Kur ishim në një mbledhje në Moskë, pranë meje rrinin Dykloi dhe Vermershi, kështu siç po rri ti këtu, kaq afër. U ngrit Toliati dhe zhvilloi tezën e policen-

trizmit, ai futi me këtë rast edhe ca pyka kundër Stalinit. Menjëherë u ngritën francezët dhe i këputën një kritikë Toliatit, saqë ky nuk dinte çfarë të bënte, dridhej si balerina në majë të tërkuzës. Por pastaj më 1960 edhe francezët u dorëzuan. Në Partinë Komuniste Franceze ka pasur edhe komunistë të vërtetë, marksistë-leninistë, që kanë menduar si ti, por nuk kanë guxuar të qëndronin si ti, që u the hapur se nuk ishte dakord me ato që thoshin revizionistët francezë.

**SHOKU JAKUP MAHMUTI:** Më thanë: «Ti, Jakup, mos harro se je militant i kësaj partie». Por më përpara unë jam shqiptar, — u thashë, — dhe Partia e Punës e Shqipërisë nuk i ka bërë ato gabime që thoni ju, ajo e ka drejt, prandaj unë do të shkoj në gjurmët e saj. Këtë kartë të partisë që kam në xhep po e mbaj që prej 30 vjetësh dhe e kam mbajtur me nder, por tani unë jam me Partinë time, jam me Enver Hoxhën, jam me popullin shqiptar. Si është e mundur të më shani Enver Hoxhën dhe unë të rri t'ju dëgjoj? Jo, këtë nuk e bëj!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Faleminderit!

Vijën e drejtë të Partisë e tregojnë fitoret dhe sukseset që janë arritur në Shqipëri. Një nga këto suksese të mëdha është përparimi i gruas, e cila te ne është bërë një forcë e madhe. Para disa ditësh u mbledh Kuvendi Popullor dhe diskutoi për problemet e industrisë së lehtë. Tri të katërtat e atyre që diskutuan ishin gra. Vetëm t'i dëgjoje kur flisnin! Gratë në vendin tonë kanë ecur shumë përpara gjatë këtyre 33-vjetëve dhe të tëra këto i bëri Partia.

**SHOKU JAKUP MAHMUTI:** Populli shqiptar e ka

mbajtur kurdonerë lart flamurin, po nuk ka pasur udhëheqje. Edhe ne që luftonim atëherë, ikëm me Fan Nolin, kurse kishte të tjerë që thoshin: «Bejlerët të mos vriten, as me gurë të mos goditen». Unë kam luftuar në Gur të Bardhë me Sali Nivicën dhe, kur u plagos ai, mora komandën dhe kemi luftuar armiqtë deri në fund.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Popullit t'i qëndrojmë besnikë tërë jetën.

**SHOKU JAKUP MAHMUTI:** Më 1939, kur vendin e pushtoi Italia fashiste. Zogu me shokë e shitën atdheun, popullin e tradhtuan deri atje sa u hoqën edhe llozet armëve. Por ja, doli Enver Hoxha që e udhëhoqi këtë popull në luftë derisa fitoi. Emri i tij dëgjohet sot në të gjithë botën. E si të mos luftojmë ne për këtë Enver Hoxhë? Ai ka luftuar e ka punuar si asnjë tjetër.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të tërë kanë luftuar xha Jakup.

Ti, Jeta<sup>1</sup>, nuk e di. por xha Jakupi ka qenë trim Kur u bë Konferenca e Paqes në Paris në vitin 1946, xha Jakupi u tha atyre që ishin atje: «Pse. ju do ta ruani Enver Hoxhën?! Ikni, se do ta ruaj vetë!». Dhe ndenji sa kohë qëndroi delegacioni shqiptar në Paris.

**SHOKU JAKUP MAHMUTI:** Që thua ti, vajzë, asnjë nuk kishte folur deri atëherë në Paris si shoku Enver Hoxha, prandaj populli i këndoi:

*«Fol. Enver, të lumtë goja,  
Fol e mbro të drejtat tona...».*

---

1. Jeta Mitrushë, stenografe.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të na rrosh sa malet, shoku Jakup, të na rrojë Partia!

**SHOKU JAKUP MAHMUTI:** Të rrojë shoku Enver Hoxha, të rrojë populli shqiptar!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duhet të shikoni disa gjëra, xha Jakup, se janë ndërtuar shumë vepra në Shqipëri, nga të cilat mjaft janë të mëdha.

Do të bisedoj një çikë me Hysniun se ku mund të vesh për të bërë vizita, natyrisht, pasi të mbarosh vizitat që ke ndër mend të bësh vetë.

Ka ndonjë tjetër nga njerëzit tanë në Paris që vete në ambasadë? Për shembull ndonjë doktor?

**SHOKU JAKUP MAHMUTI:** Ka që venë, pastaj ka edhe të tjerë që rrëmbehen nga hija e armiqve.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Më tregonin njëherë për një grup armiqsh që ishin mbledhur në Nju-Jork. Tok me ta ishte edhe Bazi i Canës. Siç mund ta kesh marrë vesh, ai ka qenë në një front me ne, por pastaj u largua. Më kanë thënë se shumë nga ata që diskutonin në këtë mbledhje thoshin: «T'i luftojmë këta që kanë ardhur tashti në pushtet në Shqipëri, t'i rrëzojmë!». Por Abaz Kupi ishte ngritur e kishte thënë: «Mos u nxitoni, se i njoh unë ata, me luftë nuk e nxjerrim dot me komunistët, prandaj të rrimë urtë këtu ku jemi, të hamë një çikë bukë rehat e të mos matemi me ta».

**SHOKU JAKUP MAHMUTI:** Faleminderit Brigadës III që i ka qëlluar tradhtarët shqiptarë që ishin mbledhur në këtë pallat.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Këtu qenë mbledhur armiqtë kuislingë. Ne atëherë ishim në Pezë dhe vendosëm t'i goditnim me artileri. Predha e topit ra mu

këtu afër, ja, në atë qoshe. Tradhtarët, nga frika, do-  
lën të gjithë me vrap dhe u kthyen në Tiranë, vrima  
e miut u bë për ta pesëqind grosh!

Dje dhe sot në gjithë Shqipërinë njerëzit kënduan  
e kërcyen për festat tona të mëdha, për festën e Pa-  
varësisë dhe atë të Çlirimit, prandaj kudo ka gëzim.

**SHOKU JAKUP MAHMUTI:** Shoku Hysni, sa herë  
që ka qenë në Francë, ka ardhur e më ka takuar edhe  
mua.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Hysniu është një nga  
shokët më të mirë të Partisë, një nga shokët më të  
mirë që kemi.

**SHOKU JAKUP MAHMUTI:** I thashë shokut Hys-  
ni: Për Enver Hoxhën, po ta dojë nevoja, edhe tani,  
në këtë moshë 80-vjeçare sa jam, bëhem 20 vjeç.

Jam çuditur, shoku Enver, kur dëgjuam atëherë  
për armiqtë tradhtarë në krye të Partisë, thamë sikur  
këta njerëz kanë luajtur nga mendja që kanë bërë  
gjithë ato gjëra. Si arriti Beqir Balluku të bëjë një  
tradhti të tillë?

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ai mori dënimin që me-  
ritonte, ia dha populli dënimin.

**SHOKU JAKUP MAHMUTI:** U kënaqa shumë sa  
ndenja këtu, por më lejoni të shkoj tashti.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Edhe unë u gëzova shu-  
më që u poqëm bashkë. Faleminderit shumë!

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim, që gjenden në AQP*

**TREGUESIT**





## TREGUESI I LËNDËS

### A

Aftësia prodhuese, shfrytlëzimi i saj — 236-239.

Aleancat, kuptimi marksist-leninist i tyre — 340-343.

Armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm, veprimtaria armiqësore dhe lufta kundër tyre — 29, 124, 147, 203-204, 427, 434, 444-445, 446, 459, 486, 497-498.

Arsimi në RPSSH — sistemi arsimor, zhvillimi dhe masivizimi i arsimit; arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe profesional, arsimi i ulët profesional — 253-261;

— programet dhe lëndët mësimore; metodat e mësimdhënies; studentët, mësuesit dhe pedagogët — 152-154, 155, 160, 161, 307, 311.

Arti në RPSSH; kritikët e artit — 34, 35-36, 39-40.

Arti përparimtar botëror — 36-40.

Arti Ushtarak i Luftës Popullore — 185, 268.

Artizanati — konceptet e prodhimit të vogël artizanal — 234-292.

### B

Bashkimi Sovjetik (1917—1953): Partia Komuniste (bolshevike) e Bashkimit Sovjetik — 341-342, 393, 404, 405, 408-409, 490.

Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik — degjenerimi kapitalist; strategjia dhe taktikat; politika e jashtme demagogjike — 16, 53-59, 87, 175-176, 193, 354, 363-364, 370, 432, 481;

— qëndrimi armiqësor ndaj PPSH dhe RPS të Shqipërisë; qëndrimi ndaj Stalinit — 205-206, 418-419.

Delegtoria në RPSSH — zhvillimi i saj; përmirësimi racor i bagëtive; baza ushqimore.

Zooveterinaria — 142, 235, 237-238, 296-297.

Borgjezia, partitë borgjeze — 42-43, 46, 366-367, 371, 404, 484, 487-488.

Bujqësia në RPSSH — politika e Partisë për zhvillimin e saj; agroteknika dhe shërbimet në bujqësi; mekanizimi i bujqësisë — 126-150, 293-296, 298-299;

— toka, trajtimi dhe rritja e pjellorisë së saj, hapja e tokave të reja; ujitja, veprat ujtitëse — 143, 202, 254, 295-296;

— organizimi i punës; rendimentet në bujqësi; drithërat (misri); farërat — 127-128, 131-132, 138, 143, 149, 296;

— punonjësit, specialistët dhe kuadrot e bujqësisë — 137-140, 141-142.

Burokratizmi dhe lufta kundër shfaqjeve të tij — 145-146.

## D

Dëshmorët — 101, 165-166.

Disiplina proletare — disiplina teknike e shkencore — 61-63.

Drejtimi dhe organizimi i ekonomisë; lufta për një or-

ganizim e drejtim shkencor të saj; pjesëmarrja e masave në drejtimin e ekonomisë; organet ekonomike, përsosja e metodës dhe e stilit të tyre në punë — 105-107, 112-114, 235-236.

## E

Edukimi komunist; edukimi ideopolitik, arsimor, kulturor dhe tekniko-shkencor i masave — 61-63, 153-155, 270, 301-302, 303, 307, 310-311, 460-461;

— edukimi dhe masat administrative; bindja — 230-231, 232-234, 260.

Ekonomia në vendet kapitaliste e revizioniste — 360-365. Ekonomia popullore — zhvillimi i pavarur dhe fuqizimi i saj; shfrytëzimi i burimeve të brendshme të vendit — 27, 105-107, 287-288, 293-294, 435, 460-461.

Engels, Fridrih — 65, 89, 94, 155, 156, 200, 209, 280-281, 285, 328, 331-332, 333, 334, 335-336, 338, 339, 368, 393, 395, 429, 434, 491.

Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 2-3, 23, 36, 37, 85-86, 99-100, 129, 144, 181, 187-188, 205, 209, 254, 262-

-264, 305-306, 308-309, 493-494, 496, 497.

*Epoka jonë — kontradiktat themelore të saj, shtrembërimi revizionist i këtij problemi — 30, 32, 179-180, 327-338, 417, 490-491.*

*Evidencat, statistikat — 117-118.*

## F

*Faktori i brendshëm dhe i jashtëm; mbështetja në forcat tona — 24, 284, 293-294, 441.*

*Faktori objektiv dhe subjektiv — 132, 460-461.*

*Familja — fejesa, martesë, divorci; marrëdhëniet prindër-fëmijë — 245-249, 252.*

*Feja në Shqipëri — roli reaksionar dhe lufta kundër saj — 44, 45, 445.*

*Feja në vendet borgjeze e revizioniste — 30-37, 41-42, 44, 225.*

*Feudalizmi dhe feudalët në Shqipëri — 5, 6, 41-44.*

*Financat; kuadrot, punonjësit e financave — 50, 110-112, 138-139.*

*Forcat prodhuese; zhvillimi i pandërprerë i tyre — 277-283, 285-300, 453.*

*Fshatarësia, fshatarësia kooperativiste — politika e Par-*

*tisë dhe e shtetit ndaj saj — 50-51, 236-238, 244, 259.*

*Furnizimi, shpërndarja e produkteve — furnizimi materialo-teknik — 173;*

*— stoqet dhe mallrat me qarkullim e konsum të ngadalshëm; masat për parandalimin dhe evadimin e tyre; normativat e harxhimit të materialeve dhe të lëndëve të para — 107-108, 231-232.*

## G

*Greqia — historia dhe kultura e popullit grek; gjendja e brendshme; marrëdhëniet me Shqipërinë — 34-35, 36-38, 404. Gruaja, Bashkimi i Grave të Shqipërisë; emancipimi i gruas — 245, 249-250, 305-306, 445, 495.*

## II

*Historia e popujve të botës, e kulturës dhe e qytetërimit të tyre — 36-40, 206, 207-208.*

*Historia e Shqipërisë — trajtimi materialist-dialektik i saj — 1-12, 306-307;*

*— luftërat e popullit shqiptar për liri e pavarësi;*

- Rilindja Kombëtare Shqiptare, rilindësit Shqiptarë e Pavarësisë së Shqipërisë (28 nëntor 1912) — 10-11;
- regjimi feudo-borgjez i Zogut — 5-8, 44, 206-207.
- I**
- Ideologjia borgjezo-revizioniste, idealizmi; demaskimi i saj* — 43-44, 152, 154-155, 156-157, 160-161, 224-225.
- Imperializmi — tipare, strategjia dhe taktikat, politika hegjemoniste e luftës dhe e agresionit* — 52-54, 300, 368-369, 375-376, 401, 416, 430, 451, 477-482, 490-491;
- lufta e tij për shtypjen e lëvizjeve revolucionare e përparimtare të popujve; aleancat ndërmjet shteteve Imperialiste — 335, 355-356, 390;
- kapitall monopollist shtetëror; eksportimi i kapitalit, ndarja e tregjeve. Shoqëritë shumëkombëshe — 52-56, 174-177, 300-369, 451;
- thellimi i kontradiktave, kalbëzimi dhe pashmangësia e zhdukjes së Imperializmit — 177-179, 452.
- Indiferentizmi — lufta kundër shfaqjeve të tij* — 245.
- Industria e rëndë në RPSSH — industria e lëndëve djegëse (e naftës); industria kimike* — 122-125, 289, 294;
- industria elektrike; industria mekanike, prodhimi i makinave dhe i pjesëve të ndërrimit — 253-256, 286-289;
- gjeologjia, kërkimet gjeologjike, gjeologët — 62-63, 122-125.
- Industrializimi socialist — politika e Partisë për industrializimin socialist të vendit; zhvillimi i industrisë; përpunimi i lëndëve të para në vend* — 253-256, 258, 286-294;
- studimet në fushën e industrisë; punëtorët, specialistët — 61-63, 122-125.
- Iniciativa dhe vetëveprimi* — 146-147.
- Inteligjencia në Shqipëri; krijimi i inteligjencës së re dhe karakteristikat e saj; edukimi komunist, lufta kundër shfaqjeve të huaja në radhët e saj* — 41, 43-49, 51;
- inteligjencia para Çlirimit — 44-45.
- Inteligjencia në vendet borgjeze* — 41-44.
- Interesi i përgjithshëm dhe Interesi vetjak* — 62, 236-237.

*Internacionalizmi proletar* — 40, 185.  
*Internacionalja e Dytë* — 160.  
*Internacionalja e Tretë Komuniste (Kominterni)* — 409, 494.

## J

*Jetesa në shoqërinë tonë socialiste* — 145, 456.  
*Jugosllavia, revizionizmi jugosllav, Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë* — politika e jashtme demagogjike; marrëdhëniet me Kinën; roli përçarës në lëvizjen komuniste ndërkombëtare — 13, 17-20, 56, 156-157, 413-414.

## K

*Kapitalizmi* — karakteristika dhe ligje të zhvillimit të tij; ashpërsimi i krizës së përgjithshme dhe thellimi i kontradiktave — 46-47, 52-60, 167-168, 174-177, 301, 323, 353-354, 362-363, 377-378, 430.  
*Këshillat popullore* — komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve; metoda dhe stili i tyre në punë — 106-107, 112-113, 114, 120, 140-141, 217, 218, 239-240, 242, 315.

*Këshilli i Ministrave (Qeveria), Kryesia e Këshillit të Ministrave* — 1, 9, 62, 102, 103, 112-113, 117, 120-121, 126, 130, 132, 135, 136, 146, 148, 149, 216, 217-218, 241, 244, 263, 269, 271, 273, 298, 317, 438, 440.

*Kina, revizionizmi kinez; Partia Komuniste e Kinës* — maocedunideja, vija oportuniste dhe revizioniste; tradhtia ndaj marksizëm-leninizmit; kongreset; fraksionet në parti — 20, 52-60, 91, 205, 219-227, 263, 324-325, 327-342, 345, 352-353, 355, 369-373, 384, 385-416, 428-429, 432, 448, 450;  
 — gjendja e brendshme; Revolucioni Kulturor; lufta e grupeve për pushtet; Zyra e Përgjithshme — 64-84, 88, 90, 92-96, 97, 162, 193, 194, 195, 221-222, 264, 320, 345, 337-388, 390, 396-397, 399-401, 406, 408, 420-421, 432, 448;  
 — degjenerimi i partisë, i shtetit dhe i jetës ekonomike e shoqërore. Ndërhyrja e kapitalit të huaj në Kinë; shndërrimi i saj në shtet kapitalist — 14-15, 20, 55-57, 91-97, 159, 174, 176, 222-

- 223, 264, 355, 359-368, 379, 383-384;
- klasat dhe lufta e klasave në Kinë; borgjezla dhe partitë borgjeze — 219-220, 404-406, 407-408;
  - strategjia dhe taktikat; politika e jashtme koniunkturale; pikëpamjet shoviniste; përpjekjet për t'u bërë superfuqi — 14-16, 20-21, 56, 58-60, 89, 86-83, 89-90, 91, 156, 176-177, 204-205, 225-227, 321-322, 343, 347-351, 353-384, 391-392, 411, 419-451;
  - lidhjet dhe bashkëpunimi me ShBA dhe me shtete të tjera kapitaliste; qëndrimi ndaj BS dhe kontradiktat me revizionistët sovjetikë — 13-14, 17, 37, 88, 89-90, 321-322, 343-344, 348-349, 355-365, 373-380, 387, 393, 403-409, 426-427, 449-450;
  - roli i saj sabotues në lëvizjen komuniste marksiste-leniniste dhe në luftërat nacionalçlirimtare e revolucionare të popujve — 161-162, 204-205, 226-227, 322, 326-327, 332-333, 342-343, 344, 371-372, 376-377, 389-392, 410-412, 413, 418, 421;
  - kontradiktat dhe qëndrimi armiqësor ndaj PPSH dhe RPS të Shqipërisë — 77, 86-87, 91-92, 174, 193-195, 199-200, 317-318, 343-344, 345, 383, 399, 411, 414, 417-423, 441, 453, 457, 464-465;
  - marrëdhëniet dhe kontradiktat me vendet fqinjë — 381-382;
  - marrëdhëniet me revizionistët jugosllavë, me grupet dhe me partitë e tjera revizioniste; bashkëpunimi me klikat reaksionare e fashiste — 13, 17-20, 88-89, 200-201, 226, 326, 327, 334, 357, 377, 399, 383, 411-415, 418, 454;
  - demaskimi i revizionizmit kinez — 379-380, 383, 420, 421.
- Klasa punëtore (proletariati) në vendet borgjeze e revizioniste — lufta e saj revolucionare, rritja e ndërgjegjes klasore. Misioni i saj historik —* 56-60, 89, 178, 331-333, 401-403, 452, 488-490.
- Klasa punëtore; roli i saj në revolucion dhe në ndërtimin e socializmit; edukimi i saj ideopolitik e tekniko-profesional —* 46, 125, 144, 168, 215, 392-394, 403.

- Klasat dhe lufta e klasave; lufta e klasave në socializëm dhe në kapitalizëm* — 56-60, 182, 325, 435, 446;  
— shtrebbërlimi nga revizionistët i teorisë marksiste-leniniste për luftën e klasave — 193-194, 325, 404-406.
- Kolonializmi, neokolonializmi* — 52-56, 353.
- Komunisti, edukimi dhe detyrat e tij* — 210-211, 236-237, 243-244, 248, 429-430, 435, 444.
- Kontradiktat në kapitalizëm* — 16, 57-60, 225.
- Kontrolli i Partisë, i shtetit dhe i masave punonjëse* — 215, 234, 313-317.
- Kooperativat bujqësore — organizimi dhe drejtimi i punës. Marrëdhëniet e tyre me shtetin* — 235-242;  
— rezervat, investimet dhe shpërbllimi i punës; kuadrot, financierët dhe kualifikimi i tyre — 132, 139-140, 239-241.
- Kosova dhe viset e tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi* — 449-450.
- Kreditë, ndihmat ndërmjet shteteve dhe kuptimi marksist-leninist i tyre* — 24-27, 360-365, 451, 453, 456-460.
- Kritika dhe autokritika* — 133-134.
- Kuadrot, specialistët — cilësitë, virtytet moralopolitike; metoda dhe stili i tyre në punë* — 45, 118, 140-141, 271, 472-473;  
— roli dhe detyrat e tyre në ndërtimin socialist të vendit; edukimi komunist dhe kalitja e tyre revolucionare; kuadrot e Partisë — 45, 50-51, 124, 155, 161, 469;  
— zgjedhja, përgatitja, kualifikimi dhe vendosja e tyre; kuadrot rezervë; marrëdhëniet kuadër—masë — 46-49, 118, 124-125, 142-144, 154-155, 257-258, 466-473;  
— plotësimi i dokumenteve të kuadrit — 470-471.
- Kultura botërore dhe qëndrimi ndaj saj* — 36-40.
- Kultura në RPSSH — politika dhe kujdesi i Partisë për kulturën; roli i saj në zhvillimin e shoqërisë socialiste* — 207, 306-307;  
— institucionet dhe veprimtaritë kulturore-artistike; qëndrimi ndaj trashëgimisë kulturore; lufta kundër ndikimeve borgjezo-revizioniste në kulturë — 28, 207, 311, 392;

— marrëdhëniet kulturore me vendet e tjera — 27-28.

*Kushtetuta e RPSSh* — 25, 29, 446, 451-452.

## L

*Lenin, Vladimir Iliç* — 5, 6, 10, 53, 54, 55, 65, 89, 91, 93, 94, 97, 108-110, 113, 117-118, 119, 155, 156, 158, 160, 200-201, 209, 211, 264, 278, 285, 323, 324, 327, 328-329, 330, 331, 334, 335-336, 337-338, 339, 346, 347, 386, 388, 393, 395, 401, 402, 403, 404, 408, 429, 432, 434, 451, 490, 491.

*Lëvizja komuniste marksiste-leniniste ndërkombëtare — strategjia dhe taktikat; lufta kundër imperializmit, revizionizmit, borgjezisë dhe reaksionit; lindja e grupeve dhe e partive të reja marksiste-leniniste* — 227-228, 341-342, 410, 429, 430, 485-486;

— parimet dhe normat e ndërtimit të partisë marksiste-leniniste, uniteti në parti — 76-77, 191-192, 485-490;

— diferencimi në lëvizjen marksiste-leniniste; demaskimi i revizionizmit

modern në gjirin e saj — 425, 484-485;

— qëndrimi i partive marksiste-leniniste ndaj PK të Kinës; lufta për demaskimin e revizionizmit kinez — 197-198, 225, 227-228, 409, 411, 425-426;

— solidariteti dhe përkrahja internacionaliste e partive marksiste-leniniste për PPSH — 209, 421, 425;

— mbledhjet, takimet dhe shkëmbimi i mendimeve ndërmjet partive marksiste-leniniste — 189-192, 201, 203-204;

— lëvizja marksiste-leniniste në Austri, në Francë dhe në Spanjë — 488-490.

*Lëvizjet dhe luftërat nacionalçlirimtare e revolucionare të popujve* — 29, 206, 340, 371-372, 482-483.

*Lëvizjet revolucionare, iniciativat dhe aksionet* — 165, 281, 311, 445.

*Ligjet ekonomike të socializmit — njohja dhe zbatimi i tyre* — 105, 118-119.

*Ligjet, përmbajtja e ligjeve; njohja, zbatimi dhe mbrojtja e tyre* — 258, 260, 261, 315, 316-317.

*Liria, pavarësia dhe sovraniteti*



*teti kombëtar* — 24-25, 26, 27,  
363-364, 446, 451, 455-460.

*Literatura e huaj* — studimi  
kritik i saj — 152-153, 394.

*Lufta Antifashiste Nacional-  
çlirimtare e popullit shqiptar*  
— 7, 185.

*Lufta e Dytë Botërore (1939—  
1945)* — 341-342, 379.

*Lufta* — shkaqet dhe shkak-  
tarët e shpërthimit të luftëra-  
ve — 16-17, 378, 379, 479.

## M

*Marksizëm-leninizmi* — stu-  
dimi, zbatimi krijues dhe  
*mbrojtja e tij* — 41, 53, 54,  
89, 104, 153-155, 161, 162-163,  
182, 184, 198-199, 209, 211, 276,  
280-281, 285-286, 334, 339, 403-  
404, 416, 429, 433, 434-435,  
436, 447, 491, 492.

*Marks, Karl* — 65, 89, 91, 152,  
155, 156, 157, 158, 200, 209,  
277-278, 285, 289, 293-299,  
323, 328, 331-332, 333, 334,  
335-336, 338, 339, 388, 393,  
395, 402, 403, 429, 434, 436,  
491.

*Masat dhe individi; lufta ku-  
ndër kultit të individit* —  
2-3, 397-399.

*Materializmi dialektik dhe hi-  
stori* — trajtimi materialist-  
-dialektik i ngjarjeve historike

— 8-9, 12, 324-325, 330, 340-  
-342.

*Mbrojtja e atdheut* — 25-27,  
435.

*Metoda dhe stili në punë* —  
119, 274-275, 461.

*Ministritë* — 113, 114, 115, 146,  
214, 216, 217, 218, 239-240,  
242-243, 244, 268-269, 271, 273,  
438;

— *Ministria e Punëve të Ja-  
shtme* — 22-23;

— *Komisioni i Planit të  
Shtetit* — 102-103, 106-  
-107, 112-114, 116, 267-  
-268, 271, 272-273, 438-  
-439;

— *Ministria e Financave* —  
106-107, 173, 174;

— *Ministria e Industrisë  
dhe e Minerave* — 62-  
-63, 125, 273;

— *Ministria e Industrisë së  
Lehtë dhe Ushqimore* —  
120, 147;

— *Ministria e Bujqësisë* —  
126, 128-129, 137, 149, 242,  
269, 273;

— *Ministria e Ndërtimit* —  
273;

— *Ministria e Komunika-  
cioneve* — 148, 173, 273;

— *Ministria e Tregtisë* —  
173, 174, 317, 437-438,  
439;

— *Ministria e Arsimit dhe  
e Kulturës* — 1, 273.

Moralitë komuniste dhe morale  
borgjezo-revizioniste — 245-  
-249, 250-251.

Muzetë, Muzeu Historik Kom-  
bëtar — 1-12.

## N

Ndërmarrjet socialiste — ndë-  
rmarrjet bujqësore — 126-150.

Ndërtimet në RPSSH; ndër-  
timi i veprave industriale —  
253-258.

Ndërtimi i socializmit në Shqipëri — politika e Partisë për ndërtimin socialist të vendit — 165-166, 170, 275-276, 277, 283-285, 361, 447, 451-452, 453, 455-460.

Novatorizmi, novatorët, racio-  
nalizatorët — 279, 280.

## O

Opinionit shoqëror — 246-247.

Organizata-bazë e Partisë —  
rolli i saj udhëheqës; lufta ku-  
ndër shfaqjeve të huaja në  
të; sekretari — 209-210, 313-  
-314, 316;

— organizatat-bazë të Par-  
tisë në ndërmarrje dhe  
në kooperativa bujqësore  
— 131, 133, 147, 236-237,  
243-244, 249.

Organizimi dhe drejtimi —

49-51, 213-218, 269-292, 430,  
440-441.

## P

Palestina — çështja palesti-  
neze, lufta e popullit palesti-  
nez për liri, pavarësi dhe të  
drejta kombëtare — 474, 475-  
-477.

Partia e Punës e Shqipërisë  
— vijat, vendimet, direktivat;  
ndërtimi dhe jeta e brend-  
shme

— themelimi i Partisë; roli  
i saj udhëheqës, vijat, ve-  
ndimet, direktivat; njoh-  
ja dhe zbatimi i tyre —  
6, 8-9, 26, 45, 127, 130,  
134-137, 138, 171-172, 213-  
-216, 265-266, 270, 271-272,  
275, 282-283, 403-404, 436,  
444, 492, 495;

— puna e Partisë; metoda  
dhe stili i punës së saj;  
organizimi dhe drejtimi;  
ndihma dhe kontrolli për  
bazën, lidhjet me masat  
— 76-77, 128, 129, 130-  
-131, 132-133, 136-138, 145,  
148-149, 210-211, 216-218,  
230-231, 242-243, 315, 439-  
-441, 461-464, 466-473;

— uniteti në Parti; kolegja-  
liteti, forcimi dhe gjallë-  
rimi i jetës së brendshme  
— 184, 211-212, 265, 316,

- 435, 436, 439-440, 447;  
 — statuti i Partisë; pranimet në Parti — 99, 183, 189, 316;  
 — karakteristikat e saj; besnikëria ndaj marksizëm-leninizmit, mbrojtja dhe zbatimi krijues i tij — 183-184, 330, 416-417, 427-428;  
 — materialet e Partisë, studimi dhe përvetësimi i tyre; informacioni në Parti; materialet, studimet për organet udhëheqëse — 1, 102-103, 114, 126, 127, 128-130, 132, 134-135, 148-149, 189-190, 191-192, 197, 257, 262-266, 271-274, 295, 305, 423-425, 462.
- Partia e Punës e Shqipërisë*  
 — organet udhëheqëse qendrore dhe në rrethe  
 — Kongresi VII i PPSH (1-7 nëntor 1976) — 23, 103, 120-121, 127, 131, 162, 165, 166, 169, 190, 197, 262, 273, 276, 282-283, 286, 293, 343, 348, 417, 418, 420, 421, 423, 465, 462;  
 — Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretariati i KQ — 3, 102, 117, 120-121, 126-127, 128, 129-130, 132, 134-135, 146, 147-148, 149, 183, 190, 211-212, 213, 216, 244, 253-254, 262, 265, 270, 271-272, 439, 439, 440, 443-444, 450, 460, 462;  
 — Plenumi i 3-të i KQ (13-14 tetor 1967); Plenumi i 9-të i KQ (19-20 korrik 1976) — 107, 296-297;  
 — Plenumi i 2-të i KQ (28-29 qershor 1977); Plenumi i 3-të i KQ (15-18 nëntor 1977) — 189, 262, 272, 274, 276, 352-436, 443-465;  
 — aparati i KQ të Partisë dhe instruktorët — 126, 129, 130, 132, 134, 148-149, 244, 273, 303, 462;  
 — komitetet dhe aparatet e Partisë në rrethe, sekretarët — 146, 216, 217, 267, 314, 315-316;  
 — komitetet e Partisë të rrethëve të Tiranës dhe të Elbasanit — 133, 138-139, 146, 439;  
 — Organizata e Partisë e Rrethit të Krujës — 465, 463.
- Partia e Punës e Shqipërisë*  
 — politika e jashtme  
 — lufta për demaskimin e revizionistëve sovjetikë, jugosllavë dhe të revizionistëve të tjerë modernë — 87, 159-162, 344, 385,

424-425, 428, 433-434, 444, 453-454, 493-494;

- marrëdhëniet dhe kontraktat me PK të Kinës, qëndrimi parimor ndaj saj; lufta për demaskimin e revizionizmit kinez — 85-88, 89, 90-91, 155-156, 162, 191-192, 193-195, 196-198, 225-226, 227-228, 262-265, 352-353, 385-391, 411, 417-423, 427, 428-429, 430-434, 441, 448-450, 464-465;

- marrëdhëniet, mbështetja dhe përkrahja për partitë marksiste-leniniste — 188-189, 190-192, 201, 203-204, 209, 212, 424-425, 452-453.

*Partia Komuniste e Austrisë (marksiste-leniniste)* — 490.

*Partia Komuniste e Spanjës (marksiste-leniniste)* — 488.

*Partia Komuniste Greke* — 404.

*Partia Komuniste (marksiste-leniniste) e Brazilit* — 100, 101, 187, 189-191, 195-196, 200-201, 204, 209.

*Partia Komuniste (revizioniste) e Francës dhe e Spanjës* — 223-224, 488-489, 490-491, 493, 494-495.

*Përvoja e përparuar, përgjithësimi i saj* — 297, 443-444.

*Planifikimi — politika e Par-*

*tisë në fushën e planifikimit; zhvillimi i planifikuar e përpjesëtimor i ekonomisë; planet prognozë* — 102-121;

- metodologjia e planifikimit. Kontrolli dhe ndihma, lufta kundër të metave dhe gabimeve në planifikim — 102-121, 146-148, 213-217;

- plani i 6-të pesëvjeçar; realizimi i planeve në sasi, cilësi dhe asortiment; lufta për realizimin e planeve në bujqësi dhe në kooperativat bujqësore — 107-112, 115-116, 127, 137, 169-170, 282-283, 460.

*Politika dhe ideologjia, kupitimi ideopolitik i problemeve; politika ekonomike* — 40, 46-47, 61-62, 127, 128, 149, 215-216, 280-281, 310-311, 458-459, 460-461.

*Politika e jashtme e RPSSH — parimet themelore të saj* — 22-23, 24-28, 29;

- lufta për demaskimin e imperializmit, socialimperializmit dhe reaksionit — 25-27, 28, 31, 433-434, 454, 476-480;

- solidariteti dhe përkrahja internacionaliste për popujt e botës — 28-29,

- 30-31, 185-186, 476-477, 478-479, 480, 482;
- marrëdhëniet dhe qëndrimi parimor ndaj Kinës — 26, 86-87, 317-320, 437, 441, 453, 457-458;
  - marrëdhëniet me Greqinë — 34-35;
  - rritja e prestigjit dhe e autoritetit të PPSH dhe të RPSSH në botë; të huajt, miqtë për Shqipëri — 23, 31-32, 185-186, 265, 423-425, 426, 454-455.
- Populli shqiptar — lashtësia, traditat patriotike, kulturore dhe cilësitë moralopolitike* — 36, 169, 185, 206-207, 456, 457, 480;
- gjendja e tij gjatë regjimeve antipopullore dhe pushtimeve të huaja; roli i tij në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare — 2, 5-6.
- Prodhimi material; rritja e pandërprerë e prodhimit material; shtimi me përparësi i mjeteve të prodhimit; sasia dhe cilësia e produkteve. Asortimenti* — 107-109, 277-280, 284-288, 290-291, 292-293.
- Prona — prona shtetërore dhe ajo e grupit; oborri kooperativist; qëndrimi socialist ndaj pronës, ruajtja dhe adminis-*
- trimi i saj* — 49-51, 111-112, 230-245.
- Propaganda, agjitacioni. Propaganda për botën e jashtme* — 243, 455, 462.
- Propaganda dhe shtypi borjezo-revizionist* — 13, 64-65, 66, 71-72, 73, 74, 75-76, 81, 91, 92, 96, 151-152, 162, 167, 192, 195, 198, 205-206, 220, 222, 223-224, 275, 321-322, 324, 326, 327, 330-331, 332-333, 334, 338-339, 343, 344-345, 346-347, 349-351, 356, 358, 365, 374, 388-389, 395-397, 398-399, 415, 423, 450.
- Psikologjia shoqërore, psikologjia mikroborgjeze dhe lufta kundër shfaqjeve e mbe-turinave të saj në vendin tonë* — 246-249, 252, 284-285, 289-292.
- Puna — organizimi socialist i punës e i prodhimit; kategorizimi i vendeve të punës, normimi i punës, normat teknike* — 62-63, 105-106, 270, 287, 289-293.

## R

- Rendimenti i punës, kushtet dhe faktorët për rritjen e pandërprerë të tij* — 289-292, 298-300.
- Revizionizmi modern; strategjia dhe taktikat; roli i tij*

sabotues në lëvizjen marksiste-leniniste; lufta kundër tij — 58, 155, 157-159, 160-161, 395, 413, 416, 433-434, 445, 446, 484-485.

Revolucioni popullor në Shqipëri — 4-9, 403.

Revolucioni socialist, proletar dhe revolucionit demokratik — 7, 9, 30, 55, 56, 57-58, 331-338, 401-403, 406-407, 429-430.

Revolucioni tekniko-shkencor; politika e Partisë për zhvillimin e tij; mbështetja e tij në marksizëm-leninizmin — 273-304;

— roli i masave në zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor — 282, 300, 302-303;

— studimet, kërkimet dhe eksperimentimi shkencor; komisionet shkencore — 267-271, 277-278, 294, 298-300.

Rinia dhe Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë; udhëheqja dhe kujdesi i Partisë për rininë; edukimi komunist, lufta kundër shfaqjeve të huaja në radhët e saj. Kongresi i 7-të i BRPSH — 99, 164-165, 167, 168-169, 170-171, 172, 181, 183, 184, 187, 188, 258-261;

— virtytet, cilësitë, traditat

patriotike e revolucionare të rinisë — 47, 170-171, 181-183, 188;

— roli dhe pjesëmarrja e saj në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, në ndërtimin socialist të vendit, në zhvillimin e revolucionit socialist dhe në mbrojtjen e atdheut — 164-166, 170-171, 182-183, 184-185.

Rinia në vendet borgjezo-revizioniste — 167-168.

## RR

Rrethimi, bllokada e presioni imperialisto-revizionist dhe lufta për përballimin e çarjen e tyre — 41, 45, 48, 210, 263, 282, 429, 435, 457-458.

## S

Stalin, Josif Visarionoviç — 19, 53, 64, 86, 89, 91, 94, 97, 100, 119-120, 127, 155, 156, 160, 193-194, 205, 209, 220, 285, 324, 327, 328, 329-330, 331, 335-336, 338, 339, 340, 341-342, 343, 346, 347, 354, 388, 393, 395, 404, 409, 414, 429, 432, 434, 449, 490, 491, 494, 495.

Superfuqitë — politika hegjemoniste, ekspansioniste, e agresionit dhe e luftës; kom-

*promiset e tyre për ndarjen e zonave të influencës dhe të tregjeve* — 26-27, 171, 173-179, 226, 416, 450-451, 474, 479, 430-483.

## SH

*Shëndetësia në RPSSh — kujdesi për nënën e fëmijën; ulja e pandërprerë e vdekshmërisë foshnjore; propaganda higjieno-shëndetësore* — 249-250, 303, 311.

*Shfaqjet e huaja, mbeturinat e së kaluarës dhe lufta kundër tyre* — 245-249, 251-252, 307, 441.

*Shkenca dhe teknika botërore — studimi dhe përvetësimi kritik i tyre* — 46-47, 51, 123, 154-155.

*Shkenca në RPSSh — politika dhe roli udhëheqës i Partisë për zhvillimin e shkencës; mbështetja e saj në filozofinë marksiste-leniniste; roli i shkencës në zhvillimin e prodhimit dhe të shoqërisë* — 46-47, 273, 277-278, 280-281, 282, 295, 310-311;

— studimi, përvetësimi, masivizimi dhe zbatim i saj; organizimi i punës shkencore; lidhja e shkencës dhe e studimeve me

prodhimin. Punonjësit shkencorë, shkencëtarët — 46-47, 116-117, 128-129, 142-143, 273, 278, 279, 294-295, 298, 309-310.

*Shtetet e Bashkuara të Amerikës; strategjia dhe taktikat; politika e jashtme ekspansioniste e luftës dhe e agresionit; lufta për tregje dhe zona influente* — 15-16, 17, 177-179, 354, 356, 359, 360-361, 368-369, 370, 373-375, 376, 378, 379, 479-480, 481;

— marrëdhëniet me Kinën — 13-14, 17, 349, 357-358, 359, 373-375, 379.

*Shtetet kapitaliste* — 357, 360-361, 366-367, 368, 370-371, 375-376, 377-378.

*Shtypi marksist-leninist* — 204, 205, 425.

*Shtypi në RPSSh* — 23, 198, 205, 213, 314-315, 343-344, 430-431, 433, 463.

## T

*Teknika dhe teknologjia e re, zotërimi i tyre* — 273, 277-280, 286-289, 300-302.

*Teknokratizmi, lufta kundër tij* — 300-301.

*Teoria dhe praktika, lufta kundër praktikizmit dhe teori-zimeve abstrakte* — 61, 141-

- 143, 183, 211, 277-280.
- Teoritë dhe pikëpamjet borgjezo-revizioniste dhe kritika ndaj tyre* — 32, 52-54, 55-60, 157-158, 275, 300-301, 416;
- teoritë dhe pikëpamjet e revizionistëve kinezë — 52-54, 193, 325, 332-334, 339-340, 345-346, 347, 360, 367-368, 392-393, 401-402, 403, 404-406, 408, 412, 415-416, 419-420, 422;
- teoria kineze e «tri botëve», e mbështetjes në një imperializëm për të luftuar tjetrin, e «lulëzimit të njëqind luleve dhe e konkurrimit të njëqind shkollave» — 20-21, 23, 56-60, 83, 94, 151-152, 199-200, 219-221, 222-223, 264, 323-350, 355-356, 364-365, 366, 376-377, 405-406, 415, 419, 426, 452, 478-479;
- teoritë e eurokomunistëve për «shtetin borgjez dhe rrugën paqësore të kalimit në socializëm-dhe për pluralizmin politik — 158-159, 223-224;
- teoritë e revizionistëve jugosllavë për «vendet e paangazhuara» dhe për «socializmin specifik» — 56-60, 360, 452, 477-478;

— kritikë e pikëpamjeve revizioniste për analizën klasore të fenomeneve të shoqërisë — 32-33, 322-343, 422-423.

*Tregtia e brendshme — punonjësit dhe kuadrot e saj* — 232-234.

*Tregtia e jashtme — politika e Partisë për zhvillimin e saj; parimet themelore marksiste-leniniste për tregtinë e jashtme* — 317-320, 455, 458-460;

— eksporti, importi; realizimi i planeve të eksportit; organet dhe punonjësit e tregtisë së jashtme — 27, 28, 173-175, 179, 216, 293, 294, 318-319, 437, 441-442, 458-459

## U

*Uniteti Parti—popull* — 26, 184, 435, 462, 463.

*Ushtria Popullore — roli udhëheqës i Partisë* — 399-400.

*Ushtritë borgjezo-revizioniste* — 399, 400-401.

## V

*Vendet arabe — lufta e popujve arabë kundër agresorëve izraelitë, imperializmi dhe*



- 
- reaksonit* — 474-483.
- Vendet revizioniste* — 175,  
198.
- Vështirësitë* — lufta për ka-  
përcimin e tyre — 203, 250,  
437, 458.
- Vigjilenca revolucionare* —  
184-185, 188, 301, 387, 464.



## TREGUESI I EMRAVE

### A

- Alia, Ramiz — 22, 49, 153,  
187, 188, 190, 191, 199, 202,  
250, 263, 352.
- Alimani, Manush — 165.
- Amazonas, Zhoao — 100, 101,  
187, 189, 190, 192, 195-196,  
200-201, 202, 203-209.
- Antoni, Dashnor — 260-261.
- Aristofani — 38.
- Arruda, Diogenes — 101, 187,  
191, 192, 202, 209.

### B

- Babëf, Fransua Noel — 43.
- Balluku, Beqir — 498.
- Begin, Menahem — 474.
- Berlinguer, Enriko — 158.
- Bernshtajn, Eduard — 160.
- Biba, Bardhok — 311.
- Biba, Mrikë — 311.
- Bonaparti, Napoleon — 376.
- Brezhnjev, Leonid — 177, 445.

### C

- Ceka, Hysen — 99-100.

### Ç

- Çan Çun Çiao — 93, 421.
- Çan Kai Shi — 91, 357, 393,  
494, 402, 409, 414.
- Çausheku, Nikolae — 454.
- Çen Po Ta — 80.
- Çian Çin — 70, 71, 80, 93, 421.
- Çu En Lai — 14, 70, 80-81,  
86, 87, 193, 194, 221, 222,  
351, 373, 490, 409, 429, 421,  
423, 450.
- Çurre, Zonja — 165.

### D

- Dyklo, Zhak — 494.

### E

- Elisabeta II — 205.
- Eskili — 38.

### F

- Fan Ji — 83.
- Frojd, Zigmund — 152.

## G

- Garodi, Rozhe — 223, 224.  
 Gën Blao — 410.  
 Gopeshi, Kupe — 308-309.  
 Gram, Zenob — 142.  
 Gromiko, Andrei — 475.

## GJ

- Gjinushi, Ethem — 47.

## H

- Hoxha, Nexhmije — 93, 101,  
 264.  
 Hitler, Adolf — 341, 342, 411.  
 Hith, Eduard — 373.  
 Hoxha, Nedin — 317, 318.  
 Hrushov, Nikita — 87, 90, 97,  
 160, 103, 199, 205, 349, 413-  
 419, 421, 493, 494.  
 Hua Kuo Fen — 14, 17, 19,  
 65, 71, 72, 73, 79, 81-83,  
 84, 83, 175, 192, 195, 205, 222,  
 353, 373-379, 388, 396, 398,  
 400-401, 405-406, 412, 414,  
 415, 420, 432.  
 Huan Hua — 204-205.

## I

- Isai, Hekuran — 229, 245, 260,  
 313.  
 Ishmi, Shyqyri — 165.

## J

- Jao Ven Juan — 80, 96, 421.  
 Jeh Çien Jin — 73, 81, 82, 401.

## K

- Kapo, Hysni — 49, 74, 202,  
 233, 484, 497, 498.  
 Karafill, Kajo — 99.  
 Kan Shen — 80, 87.  
 Karter, Xhimi — 14, 359, 373,  
 374, 479.  
 Karriljo, Santiago — 153, 160,  
 200, 414, 490-491.  
 Kautski, Karl — 160.  
 Kepler, Johanes — 310.  
 Kisinger, Henri — 177, 475.  
 Kolaneci, Teki — 309.  
 Kupi, Abaz — 497.  
 Kushi, Vojo — 165.

## L

- Lako, Pirro — 308, 309-310.  
 Lëfevër, Fernand — 418.  
 Li Da Çao — 391-392.  
 Li Hsien Nien — 83, 86, 87,  
 359.  
 Lin Biao — 67, 69-70, 71, 78-  
 79, 80, 88, 383, 397, 400.  
 Liu Shao Çi — 67-68, 71, 76,  
 78, 79, 87, 90, 93, 193, 194,  
 219, 220, 221, 346, 390, 392,  
 397, 400, 405.

Lombrozo, Çezare — 152.  
Lula, Anastas — 346.

## M

Murra, Prokop — 173, 174.  
229-230, 231, 234-235.  
Myftiu, Manush — 258.  
Mihali, Qirjako — 142, 439.  
Mahmuti, Jakup — 492-493,  
494, 495-496, 497.  
Marme, Misto — 165.  
Mao Ce Dun — 14. 64-65, 66,  
67, 68, 69, 70, 71, 72, 73-  
75, 76, 77-80, 81, 82, 83-84,  
85, 86, 87, 88, 90, 92-93, 94,  
95, 96, 97, 175 192-193, 195,  
197-197, 199, 205, 212, 219,  
220-222, 224, 322, 323, 324,  
328, 335, 338, 339, 345, 347,  
348, 357, 359-360, 373, 381,  
386, 387-388, 390, 391, 392,  
393-394, 395, 396, 397, 398,  
399, 400, 401, 402, 403,  
405, 406, 408-409, 411, 414,  
417, 420, 421, 430-431, 432,  
433, 445, 448, 449, 450.

Mara, Gjyze — 142.  
Marinela — 38, 39, 40.  
Marshall, Nhorxh — 357-358.  
Marshe, Zhorzh — 158.  
Mitrushi, Jeta — 496.  
Mobutu, Sese Seko — 238.  
326, 340-341.  
Moglica, Hasan — 308, 309.  
Musolini, Benito — 6.

## N

Nushi, Gogo — 261.  
Nashi, Lipe — 147.  
Nikson, Riçard — 177, 373,  
421, 449.

## P

Pahlevi, Muhamed Reza —  
326.  
Pen Çen — 79, 90, 219, 221.  
Perikliu — 39.  
Peza, Myrvete — 99.  
Peza, Myslim (Baba) — 98,  
99, 100, 101.  
Pinoçet, Augusto — 200, 326,  
333.  
Pisli, Lezan — 142.  
Praksitell — 33.  
Ptolemeu — 310.

## R

Rankoviç, Aleksandër — 415.  
Rexha, Shaban — 99-100.  
Rikardo, David — 152.  
Roxhers, Uillam — 475.  
Rusvelt, Franklln — 199.

## S

Skënderbeu, Gjergj Kastrioti  
— 4, 10.  
Stefanl, Simon — 439.

Sadat, Anvar — 474.  
 Sata, Tonin — 311.  
 Snou, Edgar — 357-358.  
 Stafa, Qemal — 165.  
 Stralla, Naum — 318.  
 Strobek, Franc — 490.  
 Sun Jat Sen — 385-336.

**SH**

Shehu, Fehmi — 272.

**T**

Ten Hsiao Pin — 14, 17, 19,  
 68, 78, 79, 80-81, 82-83, 84,  
 90, 95, 193, 194, 195, 212,  
 219, 220, 221-222, 342, 346,  
 359, 370, 376, 388, 390, 392,  
 398, 400, 412, 420.  
 Tito, Josip Broz — 13, 17-20,  
 88, 414, 445, 449, 454.  
 Toliati, Palmiro — 494-495.  
 Torez, Moris — 493, 494.  
 Trocki, Lev — 160.  
 Tutulani, Margarita — 165.

**TH**

Thomai, Themije — 133, 272.

**V**

Van Hun Ven — 80, 96, 421.  
 Van Tun Hsin — 401.  
 Vedemejer, Albert — 357-358.  
 Vens, Sajrus — 13-14, 17, 475.  
 Vermersh, Zhanetë — 493, 494.  
 Vinçani, Nexhip — 308, 309.  
 Vokshi, Bije — 100-101.

**X**

Xoxe, Koçi — 444-445.

**XII**

Xholi, Zija — 151.

**Z**

Zisi, Andrea — 346.  
 Zogu, Ahmet — 4, 6, 44.

**ZH**

Zhyrke, Zhak — 418, 488.

## TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

### A

AFP (Agjencia Franceze e Shtypit) — 376.

Afrikë — 59-60, 175, 204, 206, 225, 226, 347, 369, 424, 480, 481.

Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë — 116, 273.

Algjeri — 380.

Ambasada e RPS të Shqipërisë në Greqi — 35.

Amerika e Jugut — 205.

Amerika Latine — 206, 347, 369, 383, 424.

Amfiteatri i Delfit të Dodonës (Greqi) — 38.

Angolë — 33, 178, 478, 482.

Ansamblu artistik grek «Marinela» — 34, 38-39, 40.

Arabia Saudite — 452.

Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara — 22, 23, 24, 26, 28, 30.

Atikë (Greqi) — 37.

Azi — 175, 225, 334, 347, 369, 381.

### B

Banka e Shtetit Shqiptar — 113.

Belgjikë — 371.

Belsh (Elbasan) — 146.

Bilisht (Korçë) — 308.

«Borba» (gazeta ~) — 13.

Brazil — 206, 357.

Britania e Madhe — 340, 341, 342, 354, 357, 360, 369, 371.

### C

Cakran (Fier) — 123, 124.

### Ç

Çekosllovakia — 341, 449, 458.

### D

Delfi (Greqi) — 37.

«Djemtë e Pireut» (kënga ~) — 39.

Dobërçan (Korçë) — 308.

Drin (lumi ~) — 254.

Durrës — 314, 316.

**E**

- Elbasan — 146, 165, 186, 305.  
 ENI (Enti Kombëtar për Hidrokarburet) — 362.  
 Etiopi — 33, 226, 380, 431.  
 Etruskët — 207-208.  
 Eube (Greqi) — 37.  
 Evropë — 58, 59, 332, 334, 360-361, 362, 367, 375, 377, 484.

**F**

- Fabrika e Trikotazhit [Kombinati i trikotazhit «Drapër e Çekan», Korçë — 245, 249.  
 «Fatet historike të doktrinës së Karl Marksit» (V. I. Lenin, Veprat, vëll. 18) — 336.  
 «Fitorja e Samotrakës» (monumenti ~) — 38.  
 Francë — 44, 47, 227, 341, 342, 354, 357, 360, 369, 371, 458, 488-489.  
 Fronti Nacionalçlirimtar — 9.

**G**

- Gopesh (Korçë) — 308.  
 Guomindan (Partia Nacionaliste, Kinë) — 386, 403.

**GJ**

- Gjermani — 341, 342, 354, 447.  
 Gjermania Perëndimore (RF e

- Gjermanisë) — 227, 357, 360, 362, 365, 371.  
 Gjirokastër — 144.

**H**

- Hidrocentrali i Fierzës [Hidrocentrali «Drita e Partisë»] — 254, 458  
 Hidrocentrali i Komanit [Hidrocentrali «Enver Hoxha»] — 255, 458.  
 Hidrocentrali i Skavicës — 254, 255.  
 Hidrocentrali i Vjosës [Kompleksi Hidroenergjetik i Banjës] — 254, 255.  
 «Historia e Luftës Nacionalçlirimtare» (teksti ~) — 8.  
 «Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë» (teksti ~) — 8.  
 Hong-Kong — 358, 367.  
 HSINHUA (Kina e Re) — 64.  
 Hungari — 458.

**I**

- «Imperializmi dhe revolucioni» (Enver Hoxha, vepra ~) — 263-264.  
 «Imperializmi si faza më e lartë e kapitalizmit» (V. I. Lenin, vepra ~) — 264, 451.  
 Indi — 333, 340, 381.



Indonezi — 357.  
 Inkasit — 208.  
 Instituti i Lartë Bujqësor,  
 Tiranë — 149-150.  
 Irlandë — 333.  
 Itali — 6, 44, 458.  
 Izrael — 381, 474-475, 476-  
 -477, 478, 479.

## J

Japoni — 227, 357, 359, 360-  
 -361, 362, 365, 371, 379.  
 Jerusalem — 474.

## K

Kamboxhia — 382.  
 «Karta» e Anshanit — 93.  
 Këshilli i Sigurimit Kombë-  
 tar (ShBA) — 66-67.  
 Kili — 357.  
 Kombinati i Tekstileve, Be-  
 rat — 268.  
 Kombinati i tekstileve «J. V.  
 Stalin», Tiranë — 290-291.  
 Kombinati Metalurgjik [Kom-  
 binati metalurgjik «Çeliku i  
 Partisë»], Elbasan — 165, 182,  
 186.

Konferenca e Jaltës (BRSS,  
 shkurt 1945) — 449.  
 Konferenca e Paqes e Parisit  
 (1946) — 496.  
 Konferenca I Nacionalçlirim-  
 tare e Pezës (16 shtator 1942)  
 — 9, 98.

Konferenca II Nacionalçlirim-  
 tare e Labinotit (4-9 shtator  
 1943) — 9.

Kongresi Antifashist Nacional-  
 çlirimtar i Përmetit — (24  
 maj 1944) — 9.

Kongresi i 2-të i Internacio-  
 nales Komuniste (1920) — 329,  
 337, 338.

Kongresi i 9-të i Sovjetëve të  
 Ruisë (dhjetor 1921) — 338.

Kongresi i Vjenës (shtator  
 1814 — qershor 1815) — 376.

Komuna e Parisit (1871) —  
 488.

Kongo — 33.

Kooperativa Bujqësore e Ba-  
 shkuar e Donofrosës, Berat —  
 131.

Koreja e Jugut — 359.

Koreja e Veriut (RDP e Ko-  
 resë) — 382.

Kretë (ishulli ~, Greqi) —  
 37.

Krujë — 234, 466.

Kurbnesh (Mirditë) — 311.

## L

Laos — 382.

«Lë Mond» (gazeta ~) —  
 223, 224.

Lindja e Largme — 378.

Lindja e Mesme — 33, 178,  
 474-483.

Lunxhëri (Gjirokastrë) — 308.  
Lushnjë — 294.  
Luz (Kavajë) — 316.

## M

Makao — 358.  
Marok — 380.  
«Manifesti i Partisë Komuniste» (K. Marks—F. Engels, vepra ~) — 331.  
Mat — 142.  
Mauritani — 380.  
«Mbi bazat e leninizmit» (J. V. Stalin, vepra ~) — 329-330, 340.  
«Mbi dhjetë marrëdhëniet kryesore» (Mao Ce Dun) — 192-193, 405-406.  
«Mbi karikaturën e marksizmit dhe «mbi ekonomizmin imperialist»» (V. I. Lenin, Veprat, vëll. 23) — 336.  
Mbledhja e Dytë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar e Beratit (20—23 tetor 1944) — 9.  
Mbledhja e partive komuniste e punëtore në Bukuresht (qershor 1960) — 87, 89-90.  
Mbledhja e përfaqësuesve të tri shtresave kryesore në Francë (1789) — 42.  
Mbledhja e 81 partive komuniste e punëtore në Moskë (10 nëntor — 1 dhjetor 1960) — 90, 493.

Meksikë — 206.  
Mikenë (Greqi) — 37.  
Mirditë — 303, 311.  
Moglicë (zona ~, Korçë) — 308.  
Monumenti i Afërditës [i Venusit] — 38.  
Monumenti i Lirisë — 1, 2-3.  
Moskë — 421.  
Mozambik — 178.

## N

NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior) — 59, 348, 377.  
Ndërmarrja bujqësore «Çlirimi», Fler — 133.  
Ndërmarrja Bujqësore e Beratit — 297.  
Ndërmarrja bujqësore «Gjergj Dimitrov», Tiranë — 142.  
Ndërmarrja bujqësore «8 Nëntori» e Sukthit, Durrës — 133, 135, 147.  
Ndërmarrja bujqësore «Ylli i Kuq» e Kamzës, Tiranë — 149.  
Ndreq (Tiranë) — 100.

## NJ

Nju-Jork — 497.

## O

Ogaden (shkretëtirat ~) — 478.

OKB (Organizata e Kombeve të Bashkuara) — 22-23, 422, 475.

Oqeani Indian — 359.

## P

Paris — 47, 496, 497.

Pakistan — 381.

Pamir (malet ~) — 340.

Panteoni i Athinës (Greqi) — 38.

Paraguaj — 200.

Parnas (mali ~, Greqi) — 36-37.

Pekin — 13, 317, 324, 362.

Peloponez (Greqi) — 37.

Peru — 206.

Pezë (Tiranë) — 98, 99, 497.

«Pirike» (vallja ~) — 37.

Pogon (Gjirokastër) — 308.

POLISARIO (fronti ~) — 380.

Poloni — 333, 342, 449.

Porti i Durrësit [Porti detar i Durrësit «Enver Hoxha»] — 173, 174.

Porti i Vlorës — 173.

Portugali — 178.

Pukë — 305-307.

## R

Rahovë (Greqi) — 36-37.

Revolucioni Demokratiko-Borgjez Francez (1789-1794) — 42, 43.

Revolucioni francez i 1848-s — 438.

Revolucioni i Madh Socialist i Tetorit (1917) — 53, 408-409.

Rubik (Mirditë) — 311.

Rumani — 449.

## RR

Rrëshen — 311.

## S

Siberi (Bashkimí Sovjetik) — 17, 175, 378.

Skandali i Uotergejtit (ShBA) — 373.

Somali — 33, 226, 380, 481.

Spanjë — 487-488.

## SII

Shangai (Kinë) — 95-96.

«Shënime për Kinën» (Enver Hoxha, vepra ~, vëll. I-II) — 264-265.

Shishtavec (Kukës) — 185.

Shkolla e lartë e Partisë «V. I. Lenin», Tiranë — 152, 210-211.

## T

Tajvan — 14, 358, 359, 382.

«Teoria dhe praktika e revolucionit» (artikulli ~, «Zëri

I popullit\*, 7 korrik 1977) — 190, 343, 423.

Tibet (Kinë) — 381.

Tiranë — 3, 243, 314, 315, 409, 498.

TPE (Tregu i Përbashkët Evropian) — 52, 53-54, 362, 377.

Traktati i mossulmimit ndër-mjet Bashkimit Sovjetik dhe Gjermanisë (gusht 1939) — 341-342.

Traktati i Varshavës — 25.

Trupa greke e baletit folklorik «Dora Stratu» — 37.

## U

Uashington — 379.

«Uashington post» (gazeta ~) — 358.

Universiteti i Tiranës [Universiteti i Tiranës «Enver Hoxha»] — 49.

Urugvaj — 206.

Uzina e Superfosfatit [Kom-

binati Kimiko-Metalurgjik], Laç — 294.

Uznovë (Berat) — 297.

## V

Varrezat e Dëshmorëve, Pezë — 98-99.

Vatikan — 44.

Vietnam — 177, 382.

Vjosë (lumi ~) — 255.

## Z

Zaire — 478, 482.

«Zëri i popullit» (gazeta ~) — 198, 213, 343, 351.

Zvarisht (Korçë) — 309.

## ZH

«Zhenminzhibao» (gazeta ~) — 64, 219, 222, 350, 351, 360, 395-398, 397, 398-399.

## L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 62-TË ..... V—VIII

1977

DISA MENDIME RRETH MATERIALIT PËR MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR DHE PËR MONUMENTIN E LIRISË — Shënime (27 korrik 1977) ..... 1—12

QËLLIMI I VIZITËS SË TITOS NË KINË DHE STRATEGJIA KINEZE — Shënime (28 korrik 1977) ..... 13—21

ÇFARË DUHET TË NGREMË NË FJALIMIN TONË NË SESIONIN E SIVJETSHËM TË OKB-SË — Shënime (11 gusht 1977) ..... 22—33

NJË POPULL ME FOLKLOR TË PASUR E TË LARMISHËM — Shënime (21 gusht 1977) ..... 34—40

INTELIGJENCIA JONË KA DALE NGA POPULLI DHE I SHËRBEN POPULLIT — Nga biseda në takim ditë të sekretarëve të KQ të PPSH (27 gusht 1977) ..... 41—51

NË ÇËSHTJET KAPITALE TË MARKSIZËM-LENINIZMIT UDHËHEQËSIT KINEZE JANË REVIZIONISTË ME DAMKË — Shënime (1 shtator 1977) ..... 52—60

PËRGATITJA TEKNIKE DHE NIVELI IDEOPOLITIK TË MATEN ME REALIZIMIN E DETYRAVE — Shënime (6 shtator 1977) .....	61—63
Ç'ËSHTË ZYRA E PËRGJITHSIEME NË KINË? Shënime (7 shtator 1977) .....	64—84
MANOVRIME REVIZIONISTE. STRUKTURË ANTI-MARKSISTE — Shënime (8 shtator 1977) .....	85—97
SOT ËSHTË NJË DITË E GËZUAR, SE KUJTOJMË KONFERENCËN E PEZËS — Nga biseda me shokun Myslim Peza (18 shtator 1977) .....	98—101
TË GJEJMË RRUGËT E PËRSHTATSHME PËR FORCIMIN E METODOLOGJISË SË PLANIFIKIMIT E TË DREJTIMIT TË EKONOMISË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (19 shtator 1977) .....	102—121
PËR NXJERRJEN E NAFTËS KËRKOHEN STUDI-ME DHE GUXIM — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (19 shtator 1977) .....	122—125
PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË NDERMARRJEVE BUJQËSORE PARTIA TË KAPË KYÇET KRYESORE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 shtator 1977) .....	126—150
STUDIMI I TEORISË MARKSISTE-LENINISTE TË BAZOHET NË VEPRAT E KLASIKËVE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 shtator 1977) .....	151—163
ÇDO PROGRAM I PARTISË ZGJON TE RINIA ENERGJI TË REJA — Përshëndetje drejtuar Kongresit të 7-të të BRPSH (26 shtator 1977) .....	164—172

- DEVIZË PËR NE ËSHTË EKSPORTI, NË KONIUNKTURAT AKTUALE TREGTIA TË SHESË SA MË SHUMË MALLRA ME DEVIZË — Shënime (27 shtator 1977) ..... 173—180
- PARTINË E RININË, TË BASHKUARA SI NJË TRUP I VETËM ME POPULLIN, S'KA FORCË NË BOTË QË T'I THYEJË — Fjala me rastin e mbylljes së Kongresit të 7-të të BRPSH (29 shtator 1977) .... 181—186
- LUFTA PËR FITOREN E SOCIALIZMIT NUK MUND TË MPOSHTET NGA ASNJË FORCË, SADO REGRESIVE DHE E EGËR QOFTË — Nga biseda me shokë të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Brazilit, Zhoao Amazonas dhe Diogenes Arruda (30 shtator 1977) ..... 187—201
- FORCA JONË QËNDRON NË IDETË DHE NË UNITETIN TONË — Nga biseda me shokët Zhoao Amazonas dhe Diogenes Arruda (5 tetor 1977) ..... 202—212
- VENDIMET TË ZBËRTHEHEN MIRË E TË ZBATOHEN DERI NË FUND — Shënime (14 tetor 1977) ..... 213—218
- REVIZIONIZËM I SHARTUAR — Shënime (14 tetor 1977) ..... 219—228
- TË MBAJMË GJITHMONË TË PASTËR EDUKATËN DHE MORALIN TONË PROLETAR — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (24 tetor 1977) ..... 229—252
- PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE LIDHET NË RADHË TË PARË ME ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 tetor 1977) ..... 253—256

- PLOTËSIMI I KONTINGJENTIT PËR SHKOLLAT E MESME KËRKON NJË PUNË MË TË MADHE POLITIKE DHE IDEOLOGJIKE** — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 tetor 1977) 257—261
- PARTIA JONË U DEL PËRPARA SITUATAVE** — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 tetor 1977) ..... 262—268
- SI DUHET TË KUPTOHET E TË THELLOHET MË TEJ REVOLUCIONI TEKNIKO-SHKENCOR** — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 tetor 1977) ..... 267—304
- PARTIA TË PUNOJË PËR NGRITJEN E KULTURËS SË PËRGJITHSHME TË MASAVE** — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 tetor 1977) ..... 305—312
- NË TREGTINË E JASHTME T'I BËJMË LLOGARITË MIRË** — Nga biseda në takimën ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (29 tetor 1977) ..... 313—320
- PËRSËRI PËR ARTIKULLIN KINEZ QË FLET PËR TEORINË E «TRI BOTËVE»** — Shënime (3 nëntor 1977) ..... 321—351
- DEVIJIMI I KINËS NGA MARKSIZËM-LENINIZMI DHE NGA RRUGA SOCIALISTE** — Raport në Plenumin e 3-të të KQ të PPSH (15 nëntor 1977) ..... 352—436
- SITUATAT E REJA KËRKOJNË DREJTIM DHE ORGANIZIM MË TË MIRË TË PUNËVE** — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (18 nëntor 1977) ..... 437—442



TË MOS E NDALOJMË PËR ASNJË ÇAST LUFTËN IDEOLOGJIKE E POLITIKE KUNDËR TRADHTARVE TË MARKSIZËM-LENINIZMIT — Fjala e mbylljes në Plenumin e 3-të të KQ të PPSH (18 nëntor 1977) .....	443—465
RRITJA E AFTËSIVE DREJTUESE TË NJERËZVE KA RËNDËSI TË MADHE PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMIT TË KUADRIT — Nga biseda në takim in ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (23 nëntor 1977) .....	466—473
ÇËSHTJA E DREJTË E POPUJVE ARABË ËSHTË E PAMPOSITUR — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (24 nëntor 1977) .....	474—483
FORCA E PARTIVE TË VËRTETA MARKSISTE-LENINISTE QËNDRON NË ZBATIMIN E DREJTË TË PARIMEVE — Shënime (28 nëntor 1977) .....	484—491
SHQIPËRIA ËSHTË E FORTË, ATË E BËN TË TILLË MARKSIZËM-LENINIZMI — Nga biseda me shokun Jakup Mahmuti (29 nëntor 1977) .....	492—493
Treguesi i lëndës .....	501
Treguesi i emrave .....	519
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera .....	523